



**UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I DREJTËSISË
DEPARTAMENTI I TË DREJTËS PUBLIKE**

**DISERTACION
PËR MBROJTJEN E GRADËS SHKENCORE
“DOKTOR”**

**NDIKIMI I TË DREJTËS NDËRKOMBËTARE TË MJEDISIT
NË LEGJISLACIONIN SHQIPTAR**

Kandidati

Erjon MUHARREMAJ

Udhëheqësi shkencor

Prof. Dr. Xhezair ZAGANJORI

TIRANË, 2014

Deklaratë vërtetësie

© E drejta e autorit: Erjon Muharremaj, 2014.

Vërtetoj se ky disertacion është punimi im dhe se të gjitha referencat dhe burimet janë të njohura rregullisht.

Përmbledhje

Ky punim realizon një analizë të hollësishme të legjislacionit mjedisor ndërkombëtar të përgjithshëm dhe atij evropian (acquis communautaire) në veçanti, si dhe të ndikimit të tyre në legjislacionin shqiptar për mbrojtjen e mjedisit, në kuadër të integritit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian. Ai synon të ofrojë këshillimet e nevojshme për përmirësimet që duhen bërë, me qëllim që legjislacioni shqiptar të krijojë bazën ligjore për një mbrojtje efektive të mjedisit.

Evidentimi i parimeve dhe normave të së drejtës mjedisore për shkak të rëndësisë së tyre të padiskutueshme dhe të aspekteve të gjithanshme, ekonomike, politike, sociale dhe ekologjike në nivel ndërkombëtar, rajonal e kombëtar, që ato përmbajnë, është një ndër arsyet kryesore të shtysës për të marrë përsipër të këtë studim. Ndaj në synimet e këtij punimi është radhitur si parësor evidentimi i rolit të normave të së drejtës mjedisore në disa nivele: së pari në nivelin e përgjithshëm ndërkombëtar, së dyti në nivelin rajonal evropian, e së treti në nivelin tonë kombëtar.

Pyetjet kërkimore që kanë orientuar këtë punim janë: Cili është roli i së drejtës ndërkombëtare në sigurimin e një mjedisi të pastër? Si kanë evoluar normat e kësaj të drejte përgjatë viteve? Cili ka qenë roli dhe ndikimi i parimeve mjedisore në formulimin e politikave dhe hartimin e legjislacionit mjedisor? Cilat janë normat e së drejtës ndërkombëtare të hartuara në fushat e veçanta të mbrojtjes së ajrit, ujit, biodiversitetit dhe administrimit të mbetjeve? Si janë reflektuar këto norma në kuadrin ligjor shqiptar? A mund të thuhet se normat e së drejtës mjedisore mbrojnë tashmë një të drejtë themelore të njeriut?

Për t'u dhënë përgjigje këtyre pyetjeve janë përdorur metodat e kërkimit shkencor të zbatuara gjerësisht në hulumtimet e shkencave shoqërore, të tilla si: metoda përshkruese, metoda krahasimore, metoda analitike dhe ajo interpretuese.

Punimi është i ndarë në krerë që trajtojnë respektivisht zhvillimin historik të së drejtës ndërkombëtare të mjedisit, raportin e saj me acquis communautaire dhe raportin e tyre me të drejtën e brendshme shqiptare, legjislacionin ndërkombëtar, evropian dhe atë shqiptar për mbrojtjen e ajrit, mbrojtjen e ujit, mbrojtjen e diversitetit biologjik, administrimin e mbetjeve, si edhe lidhjen e mbrojtjes së mjedisit me mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Në fund, punimi mbyllet me konkluzionet, ku bëhet një përmbledhje e analizës së kryer përgjatë punimit, si edhe ofrohen disa rekomandime për zhvillimin e mëtejshëm të së drejtës mjedisore në Shqipëri, për të mundësuar një mjedis të pastër për brezat e tanishëm e të ardhshëm.

Fjalë kyç: mjedis, legjislacion, jurisprudencë, biodiversitet, mbrojtje, të drejtat e njeriut.

Abstract

This study contains a detailed analysis of the general international environmental law, of the European environmental law (acquis communautaire), and their impact on the Albanian legislation for the protection of the environment, in the framework of the integration of Albania in the European Union. It strives to offer advice on the improvements needed, so that the Albanian legislation serves as the legal basis for the effective protection of the environment.

One of the main premises for undertaking this study is the identification of the principles and norms of environmental law, at the international, regional and national level, because of their indisputable importance and their encompassing economic, political, social and ecological aspects that they contain. For this reason, the identification of the principles and norms of the environmental law at several levels: at the general international level, at the regional level, and at our domestic level, has been given a primary role.

The research questions that have guided this study are: What is the role of international law in ensuring a clean environment? How have its norms evolved through the years? What has been the role and impact of the environmental principles in the formulation of policies and the drafting of environmental legislation? What are the norms of international law in the specific fields of the protection of air, water, biodiversity, and waste management? How have these norms been reflected in the Albanian legal framework? Have the norms of environmental law been transformed already into fundamental human rights?

In order to answer these questions, the research methods used in social sciences, such as the descriptive, comparative, analytical, and interpretative methods have been used.

This study is divided into chapters that analyze the historical development of the international environmental law, its standing towards the acquis communautaire and the Albanian domestic legislation for the protection of air, water, biodiversity, waste management, and the connection between the protection of environment and human rights. In the end, the study draws the conclusions, where the analysis conducted throughout the study is summarized and some recommendations for the further development of the environmental law in Albania are offered, in order to ensure a clean environment for the present and future generations.

Keywords: environment, legislation, jurisprudence, biodiversity, protection, human rights.

Falenderim

Me rastin e prezantimit të këtij punimi, dëshiroj të falenderoj të gjithë ata që më kanë mbështetur vazhdimisht për realizimin e këtij punimi. Dua të përmend këtu kolegët e Departamentit të së Drejtës Publike, veçanërisht udhëheqësin shkencor Prof. Xhezair Zaganjori për ndihmën dhe këshillat e paçmueshme gjatë punës për realizimin e disertacionit të doktoraturës. Udhëheqja miqësore, komentet dhe referencat e tij më kanë ndihmuar tej mase për përfundimin me sukses të këtij studimi.

Dëshiroj gjithashtu të falenderoj familjen time për inkurajimin dhe mbështetjen e vazhdueshme e të pakursyer, gjatë këtyre viteve të punës time kërkimore.

Erjon Muharremaj

Tiranë, 2014

Ky punim i kushtohet Deonës, mbesës time të shtrenjtë, me urimin që ajo dhe brezat që do të vijnë pas saj të trashëgojnë një mjedis të pastër!

PËRMBAJTJA

Deklaratë vërtetësie	1
Përmbledhje.....	2
Abstract.....	3
SHKURTIME.....	7
HYRJE, OBJEKTI I KËRKIMIT SHKENCOR DHE METODOLOGJIA	9
KREU I	
ZHVILLIMI HISTORIK I SË DREJTËS NDËRKOMBËTARE TË MJEDISIT	17
1.1 Fillimet e hershme të së drejtës ndërkombëtare të mjedisit.....	17
1.2 Zhvillimet bashkëkohore të së drejtës ndërkombëtare të mjedisit.....	18
KREU II	
RAPORTI I SË DREJTËS NDËRKOMBËTARE ME TË DREJTËN E BRENDSHME SHQIPTARE DHE PARIMET KRYESORE NDËRKOMBËTARE TË MBROJTJES SË MJEDISIT	26
2.1 Raporti midis të drejtës ndërkombëtare të përgjithshme dhe të drejtës së brendshme shqiptare.....	26
2.2 Raporti midis <i>acquis communautaire</i> dhe të drejtës së brendshme shqiptare.....	28
2.3 Parimet kryesore të mbrojtjes së mjedisit në të drejtën ndërkombëtare.....	36
2.3.1 Parimi i zhvillimit të qëndrueshëm.....	40
2.3.2 Parimi i integritimit.....	43
2.3.3 Parimi ‘Ndotësi paguan’.....	46
2.3.4 Parimi i parandalimit dhe i marrjes së masave paraprake.....	53
KREU III	
MBROJTJA E AJRIT	63
3.1 Legjislacioni ndërkombëtar për mbrojtjen e ajrit.....	64
3.2 Legjislacioni evropian për mbrojtjen e ajrit.....	69
3.3 Legjislacioni shqiptar për mbrojtjen e ajrit.....	72
KREU IV	
MBROJTJA E UJIT.....	79
4.1 Legjislacioni ndërkombëtar për mbrojtjen e ujit.....	80
4.1.1 Mbrojtja e mjedisit detar.....	89
4.2 Legjislacioni evropian për mbrojtjen e ujit.....	94
4.3 Legjislacioni shqiptar për mbrojtjen e ujit.....	96

KREU V

MBROJTJA E BIODIVERSITETIT.....	100
5.1 Legjislacioni ndërkombëtar për mbrojtjen e biodiversitetit.....	101
5.2 Legjislacioni evropian për mbrojtjen e biodiversitetit.....	109
5.2.1 Vlerësimi i ndikimit në mjedis, për mbrojtjen e biodiversitetit.....	113
5.3 Legjislacioni shqiptar për mbrojtjen e biodiversitetit.....	117
5.3.1 Mbrojtja e pyjeve në Shqipëri, në funksion të mbrojtjes së biodiversitetit.....	121

KREU VI

MBROJTJA E MJEDISIT NGA MBETJET.....	129
6.1 Legjislacioni ndërkombëtar për mbrojtjen e mjedisit nga mbetjet.....	130
6.2 Legjislacioni evropian për mbetjet.....	140
6.3 Legjislacioni shqiptar për mbrojtjen e mjedisit nga mbetjet.....	143

KREU VII

MBROJTJA E MJEDISIT DHE TË DREJTAT E NJERIUT.....	147
7.1 Të drejtat e njeriut dhe të drejtat mjedisore në të drejtën ndërkombëtare.....	148
7.2 Konventa e Aarhusit “Për të drejtën e publikut për të pasur informacion, për të marrë pjesë në vendimmarrje dhe për t’iu drejtuar gjykatës për çështjet e mjedisit” dhe të drejtat mjedisore.....	151
7.2.1 E drejta për të marrë informacion për çështjet e mjedisit.....	159
7.2.2 E drejta për të marrë pjesë në vendimmarrje për çështjet e mjedisit.....	165
7.2.3. E drejta për t’iu drejtuar gjykatës për çështjet e mjedisit.....	172
7.3 Konventa e Aarhusit dhe legjislacioni shqiptar.....	181
7.4 Traktatet për të Drejtat e Njeriut dhe të drejtat mjedisore.....	186
7.5 Të drejtat e njeriut dhe të drejtat mjedisore në të drejtën e brendshme shqiptare.....	192

KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME.....	196
---	------------

BIBLIOGRAFIA.....	201
--------------------------	------------

SHKURTIME

AKM – Agjencia Kombëtare e Mjedisit

ARM - Agjenci Rajonale e Mjedisit

BA – Bashkimi Afrikan

BB – Banka Botërore

BE - Bashkimi Evropian

CITES (Convention on International Trade in Endangered Species) – Konventa për Tregtinë Ndërkombëtare të Specieve të Rrezikuara

CSD (Commission on Sustainable Development) – Komisioni i Zhvillimit të Qëndrueshëm

ECOSOC - Këshilli Ekonomik dhe Social i OKB-së

EFFIS (European Forest Fire Information System) - Sistemi Evropian i Informimit për Zjarret në Pyje

EIONET (European Environment Information and Observation Network) - Rrjeti Evropian i Informacionit dhe Vëzhgimit Mjedisor

EUFJE (European Union Forum of Judges for the Environment) - Forumi i Gjyqtarëve të Bashkimit Evropian për Mjedisin

FAO (Food and Agriculture Organization) – Organizata e Bujqësisë dhe Ushqimit

FSC (Forest Stewardship Council) - Këshilli i Kujdestarisë së Pyjeve

GHG (Greenhouse Gases) – Gazet serë

GJED – Gjykata Evropiane e Drejtësisë

GJEDNJ – Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut

GJNADNJ - Gjykata Ndër-Amerikane për të Drejtat e Njeriut

GJND - Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë

GJPA – Gjykata e Përhershme e Arbitrazhit

GJPDN - Gjykata e Përhershme e Drejtësisë Ndërkombëtare

IAEA (International Atomic Energy Agency) - Agjencia Ndërkombëtare e Energjisë Bërthamore

IMO (International Maritime Organization) – Organizata Ndërkombëtare Detare

IMPEL (European Union Network for the Implementation and Enforcement of Environmental Law) - Rrjeti i Bashkimit Evropian për Zbatimin dhe Imponimin e së Drejtës Mjedisore

INSTAT - Instituti i Statistikave

ITLOS (International Tribunal for the Law of the Sea) - Gjykata Ndërkombëtare për të Drejtën e Detit)

IUCN (International Union for the Conservation of Nature) - Bashkimi Ndërkombëtar për Ruajtjen e Natyrës.

LRTAP (Long-Range Transboundary Air Pollution Convention) - Konventa për Ndotjen Ndërkufitare të Ajrit në Distanca të Largëta

MCPFE (Ministerial Conference on the Protection of Forests in Europe) - Konferenca Ministrore për Mbrojtjen e Pyjeve në Evropë

MM - Ministria e Mjedisit

NFP (National Focal Points) - Pikat Kryesore Kombëtare

NRC (National Reference Centres) - Qendrat Kombëtare të Referencës

NOQ – Ndotësit Organikë të Qëndrueshëm

OAS (Organization of American States) – Organizata e Shteteve Amerikane

OBSH (World Health Organisation) - Organizata Botërore e Shëndetësisë

OECD (Organisation for Economic Cooperation and Development) - Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik

OKB - Organizata e Kombeve të Bashkuara

PCB/PCT - Poliklorinate

PM (Particular Matter) - Grimca të Ngurta

PNUD [UNDP] (United Nations Development Programme) - Programi i Zhvillimit të Kombeve të Bashkuara

TFBE – Traktati i Funkcionimit të Bashkimit Evropian

TMD - Teknikat më të Mira të Mundshme

UNCLOS (United Nations Convention for the Law of the Sea) – Konventa e OKB për të Drejtën e Detit

UNECE (United Nations Economic Commission for Europe) - Komisioni i Ekonomisë i Kombeve të Bashkuara për Evropën

UNEP (United Nations Environment Programme) - Programi i Kombeve të Bashkuara për Mjedisin

UNESCO (United Nations Educational, Scientific and Cultural Organization) – Organizata e Kombeve të Bashkuara për Arsimin, Shkencën dhe Kulturën

UNFCCC (United Nations Framework Convention on Climate Change) - Konventa Kuadër e Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike

VNM - Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis

VSM - Vlerësimi Strategjik Mjedisor

WMO (World Meteorological Organization) - Organizata Botërore të Meteorologjisë

WWF (World Wildlife Fund) - Fondi i Kafshëve të Egra të Botës

HYRJE, OBJEKTI I KËRKIMIT SHKENCOR DHE METODOLOGJIA

*Ne nuk e trashëgojmë Tokën nga etërit tanë,
por e huazojmë atë nga fëmijët tanë.
(Shprehje inuite)*

Problemet që lidhen me mbrojtjen e mjedisit janë ndër problemet më të mprehta me të cilat përballet sot njerëzimi. Çështjet mjedisore përmbajnë problematika që lidhen drejtpërdrejt me jetën e përditshme të njerëzve, ato nuk janë probleme të një natyre abstrakte, por janë të lidhura me hapësirën jetësore, cilësinë e jetës dhe vetë shëndetin e njerëzve, përfshirë edhe brezat e ardhshëm.¹ Në një kuptim më të gjerë, mbrojtja e mjedisit nuk ka të bëjë vetëm me mbrojtjen e jetës njerëzore, por me mbrojtjen e jetës të të gjithë organizmave të gjallë dhe specieve që popullojnë planetin tonë. Ajo përfshin mbrojtjen e ajrit, ujit, tokës, kafshëve, bimëve, diversitetit biologjik, monumenteve të natyrës dhe të gjithë burimeve natyrore. Pavarësisht emërimit, në fakt, mbrojtja e mjedisit ka të bëjë me mbrojtjen e shëndetit publik, sigurinë ushqimore, mbrojtjen e konsumatorit, sigurinë energjetike, e deri tek siguria bërthamore.

Shtjellimi i problematikave fillon që me përkufizimin e vetë ‘mjedisit’, çfarë do të përfshihet në të. Në gjuhën shqipe, etimologjia e termit ‘mjedis’ është interpretuar se rrjedh prej fjalës ‘midis’, që do të thotë ‘ajo çka ndodhet midis njerëzve’.² Fjalori i Oksfordit jep të njëjtin përkufizim: “mjedisi fizik që na rrethon”.³ Komisioni Botëror për Mjedisin dhe Zhvillimin, në raportin përfundimtar të titulluar “E ardhmja jonë e përbashkët” të vitit 1987, e përkufizoi mjedisin si “atë në të cilin jetojmë ne të gjithë.”⁴

Sipas Komisionit të së Drejtës Ndërkombëtare,⁵ çështja e mbrojtjes ekologjike të një vendi është e të njëjtës rëndësi me situatat e rreziqeve të jashtëzakonshme që i kanosen vetë ekzistencës së shtetit, mbijetesës së tij politike apo ekonomike, ruajtjes së rendit të brendshëm, apo mbijetesës së një pjese të popullsisë së tij.⁶

Tema të tilla, si: shtimi eksponencial i popullsisë së botës, ndotja e ajrit dhe ujit, ngrohja globale dhe pasojat që rrjedhin prej saj, çarja e shtresës së ozonit, shiu acid, rritja e nivelit të deteve dhe oqeanëve, shkretëtirëzimi, zhdukja e specieve të ndryshme, prishja e ekosistemeve, shtimi i rasteve të fatkeqësive natyrore, organizmat e modifikuar gjenetikisht, etj, janë ato të cilat debatohen me shpesh. E veçanta e tyre qëndron në faktin se ato ndoshta nuk janë aq “të

¹ Mendimi Këshillimor i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë, “Ligjshmëria e Kërcënimit apo Përdorimit të Armëve Bërthamore”, datë 8.7.1996, parag. 29. Gjetet në: <http://www.icj-cij.org/docket/files/95/7495.pdf>

² Romeo Hanxhari, “Politikat e Mjedisit. Niveli global dhe niveli lokal. Analizë teorike dhe raste studimi”, Intergrafika, 2011, fq. 8.

³ <http://www.oed.com/view/Entry/63089?redirectedFrom=environment#eid>

⁴ Komisioni Botëror për Mjedisin dhe Zhvillimin (Komisioni Brundtland), “E ardhmja jonë e përbashkët”, 1987, Parathënie, fq. 7. Gjetet në: http://conspect.nl/pdf/Our_Common_Future-Brundtland_Report_1987.pdf

⁵ Komisioni i së Drejtës Ndërkombëtare është krijuar nga Asambleja e Përgjithshme e OKB me Rezolutën Nr. 174, datë 21.11.1947, për promovimin e zhvillimit progresiv të së drejtës ndërkombëtare dhe kodifikimin e saj.

⁶ Vjetari i Komisionit të së Drejtës Ndërkombëtare, 1980, Vol. II, Pjesa 2, fq. 35, parag. 3. Gjetet në: [http://legal.un.org/ilc/publications/yearbooks/Ybkvolumes\(e\)/ILC_1980_v2_p2_e.pdf](http://legal.un.org/ilc/publications/yearbooks/Ybkvolumes(e)/ILC_1980_v2_p2_e.pdf)

dukshme”, si konfliktet e armatosura, etnike, ideologjike, apo rreziku bërthamor, por kanë një ndikim të jashtëzakonshëm në jetën e njeriut. Sot është bërë e qartë se nuk është e nevojshme të zhvillohet një luftë botërore me armë të shkatërrimit në masë, për të zhdukur jetën prej planetit ku jetojmë. Mjafton që njerëzimi të vazhdojë të mbajë të njëjtin qëndrim ndaj natyrës, të ndjekë të njëjtën mënyrë jetese, të vazhdojë të ndotë me të njëjtin ritëm dhe të shfrytëzojë burimet natyrore me të njëjtin intensitet dhe pasojat do të jenë të njëjta me ato të zhvillimit të një lufte botërore. Nëse nuk merren masat e duhura, si teknike, ashtu dhe ligjore, problemet do të vijnë duke u shtuar.

Gjithashtu, njerëzimi po përballon mjaft humbje nga fatkeqësitë natyrore, të cilat po vijnë në rritje, por në të njëjtën kohë, po kontribuon në shtimin e ndotjes së ajrit, të ujit dhe tokës, në ndryshimet klimatike, me pasoja për jetën në Tokë. Shumë nga këto shqetësime të shkaktuara nga shoqëria njerëzore përgjatë zhvillimit të saj po e degradojnë planetin. Nga analiza e të dhënave shkencore, studiuesit kanë arritur të përcaktojnë kufijtë maksimalë për planetin tonë që lidhen me nëntë aspekte të mjedisit, kufij që nëse kapërcehen, do të çojnë në ndryshime klimatike të pakthyeshme dhe me pasoja të pariparueshme për njerëzimin. Një ndër to është çarja e shtresës së ozonit në stratosferë, shtresë e cila filtron rrezet ultraviolette të diellit. Një prej pasojave të kësaj çarjeje është rritja e numrit të njerëzve të prekur nga kanceri i lëkurës dhe dëmtimet e shkaktuara në sistemet biologjike tokësore dhe detare. Një kufi tjetër i identifikuar ka të bëjë me humbjen e biodiversitetit dhe zhdukjen përfundimtare të disa specieve në krejt planetin. Përhapja e kimikateve si metalet e rëndë, ndotësit organikë sintetikë dhe materialet radioaktive, edhe kur nuk është në nivele vdekjeprurëse të menjëhershme, sjell pasoja të tjera të rënda, si ulja e riprodhimit të gjallesave, prandaj edhe është ulur numri i zogjve dhe gjitarëve të detit. Alarmi për dëmtimin e shëndetit riprodhues të shpendëve si pasojë e përdorimit të insekticideve dhe pesticideve u dha për herë të parë që në vitin 1962 në veprën “Pranvera e heshtur” të Rachel Carson,⁷ që konsiderohet si momenti i fillimit të lëvizjes ambientaliste në SHBA. Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSH) ka vlerësuar se një e katërta e të gjitha sëmundjeve në botë dhe një e treta e sëmundjeve të fëmijëve shkaktohen prej faktorëve të ndryshueshëm mjedisorë.⁸

Ndryshimet klimatike të shkaktuara nga humbja e sipërfaqeve masive me pyje dhe zvogëlimi i zonave me akull polar janë të dukshme. Acidifikimi i ujërave të oqeanëve, të cilët përthithin rreth ¼ e të gjithë sasisë së çliruar të dioksidit të karbonit, ka sjellë pasoja për gjallesat ujore të cilat nuk mund të jetojnë në të tilla nivele acidifikimi. Niveli i (sh)përdorimit të ujit të pijshëm ka çuar në mungesën e tij për qindra milionë njerëz sot në botë, përfshirë Shqipërinë (edhe pse e pasur me burime ujore), duke shkaktuar probleme që lidhen deri me vetë mbijetesën e këtyre njerëzve. Ndryshimi i sistemit të tokave, nga toka pyjore e të pasura me bimësi, në toka për prodhim bujqësor e zgjerim të zonave urbane, ka çuar në ulje të biodiversitetit, ndryshim të rrjedhave të ujërave nëntokësore dhe ndotjen e tyre. Futja e nitrogjenit dhe fosforit në biosferë dhe oqeanë si rezultat i aktiviteteve industriale dhe bujqësore ka çuar në reduktimin gradual të numrit të gjallesave. Kufiri i fundit ka të bëjë me nivelin e klorofluorkarboneve (CFC) që

⁷ Rachel Carson, “*Silent Spring*”, The New Yorker, 1962. Gjetet në: <http://www.science.smith.edu/~jcardell/Courses/EGR100/protect/reading/SilentSpring.pdf>

⁸ Statistikat e OBSH mbi sëmundjet e shkaktuara prej faktorëve mjedisorë gjenden në: <http://apps.who.int/gho/data/node.main.162?lang=en>

gjenden te ngrirësit dhe që kanë ndikuar në dëmtimin e shtresës së ozonit.⁹ Siç është shprehur Norbert Wiener, “*Ne e kemi transformuar mjedisin në mënyrë kaq radikale, sa që tani duhet të transformojmë veten tonë për të mbijetuar në këtë mjedis të ri.*”¹⁰

Edhe në Shqipëri situata mjedisore është e rënduar. Në vitin 2000, UNEP identifikoi pesë ‘zona të nxehta’ mjedisore, në Durrës, Vlorë, Ballsh, Patos dhe Sharrë, në të cilat kërkohet ndërhyrje urgjente për të shmangur pasojat katastrofale në shëndetin e njeriut dhe në mjedis, si edhe katër zona të tjera me probleme të rënda mjedisore në Fier, Elbasan, Rubik dhe Laç.¹¹ Siç shihet, këtu nuk përfshihen prodhimi i çimentos dhe gëlqeres, djegia e kudondodhur dhe e pakontrolluar gomave dhe mbeturinave, mungesa e riciklimit, mospërpunimi i mbetjeve, etj. Ndërsa në nëntor 2013 kryeministri shqiptar deklaroi që “...në Shqipëri ka 31 zona të rrezikshme mbetjesh kimike të trashëguara nga e kaluara, të cilat nuk plasin po vrasin ngadalë... në Patos-Marinzë, Ballsh, Fier, Elbasan, Rubik, Laç, Berat, Lushnjë, Bajzë, Rrëshen, Fushë Arrëz, Prrenjas, Burrel... .”¹²

Problemet mjedisore nuk i përkasin vetëm ditëve të sotme. Studimet arkeologjike kanë zbuluar se që në Mesopotaminë e lashtë fenomeni i shkretëtirëzimit shkaktohej prej mbishfrytëzimit të burimeve ujore dhe bimore nga popullsia e kësaj zone, ndërsa përdorimi intensiv i shpateve të kodrave për mbjelljen e kulturave bujqësore nga ana e fiseve Maja solli pasoja të rënda dhe pamundësi të sigurimit të ushqimit, si rezultat i erozionit.¹³

Një problem i mprehtë sot është raporti i rritjes së popullsisë në vendet në zhvillim, në krahasim me vendet e industrializuara. Statistikat tregojnë që një fëmijë në një vend të industrializuar konsumon rreth 18 herë më shumë se një fëmijë në një vend në zhvillim.¹⁴ Detyrat që shtrohen para politikëbërësve janë të ndryshme, nga një vend, në tjetrin. Ndërsa në vendet në zhvillim duhet të ulet ritmi i rritjes së popullsisë, në vendet e industrializuara duhet të ulet niveli i konsumit për person, madje duhet thënë, niveli i shpërdorimit. Me shtimin e popullsisë së botës, e cila arriti 7 miliardë banorë në 31 tetor 2011,¹⁵ si edhe me industrializimin e shumë vendeve, kërkesat për burime minerale dhe për burime energjie do të vazhdojnë të rriten. Meqë njerëzit i kanë përdorur pasuritë natyrore prej mijëra vjetësh, shumica e mineraleve, karburanteve fosile dhe burimeve që gjenden në afërsi të tyre kanë shteruar tashmë. Diktuar nga nevoja, vëmendja e botës është përqendruar në zonat e largëta dhe që mbërrihen me vështirësi, si në fundin e oqeanëve, kontinentet polare dhe në pasuritë që gjenden më në thellësi të kores së Tokës. Gjetja dhe shfrytëzimi i këtyre pasurive pa dëmtuar mjedisin do të përbëjë një sfidë të vështirë në dekadat që vijnë.

⁹ Johan Rockström et. al, “*Planetary Boundaries: Exploring the Safe Operating Space for Humanity*”, Ecology & Society, 2009, Vol. 14, Nr. 2, fq. 3.

¹⁰ Norbert Wiener, “*The Human Use of Human Beings: Cybernetics and Society*”, Boston: Houghton-Mifflin, 1954.

¹¹ United Nations Environment Programme (UNEP): *Post-Conflict Environmental Assessment-Albania*, 2000.

Gjendet në: <http://postconflict.unep.ch/publications/albaniafinalasses.pdf>

¹² Edi Rama, “*Ja e vërteta e armëve kimike.*” Marrë nga gazeta Balkanweb, datë 15.11.2013. Gjendet në:

<http://www.balkanweb.com/analiza/2689/ja-e-verteta-e-armeve-kimike-158981.html>

¹³ Romeo Hanxhari, “*Politikat e Mjedisit. Niveli global dhe niveli lokal. Analizë teorike dhe raste studimi*”, Intergrafika, 2011, fq. 9.

¹⁴ Statistikat mbi varfërinë gjenden në <http://povertydata.worldbank.org/poverty/home/>

¹⁵ Statistikat demografike të OKB gjenden në <http://unstats.un.org/unsd/demographic/products/dyb/dyb2.htm>

Për çdo vend, objektiv madhor duhet të mbetet hartimi i politikave dhe i një legjislacioni mjedisor, si edhe zbatimi i tij, në mënyrë të tillë që të garantojë një mjedis natyror të qëndrueshëm. Mjedisi natyror i qëndrueshëm është një e mirë e përbashkët dhe shtetet përpiqen për arritjen e marrëveshjeve ndërkombëtare për shpërndarjen e kostove dhe përfitimeve prej tij. Por politikat e ndryshme kombëtare mjedisore kanë krijuar probleme të mprehta të *të mirës së përbashkët*. Problemet e *të mirës së përbashkët* lidhen me çështje që kanë të bëjnë me mjedisin, burimet natyrore, popullsinë, etj. Hapësira të tilla si Deti i Hapur dhe Hapësira e Përtejme janë të mira të përbashkëta për të gjithë njerëzimin. Mbishfrytëzimi i *të mirave të përbashkëta* konsiderohet si “*tragjedia e të mirave të përbashkëta*.”¹⁶

Vështirësia e menaxhimit të problemeve të të mirës së përbashkët qëndron tek numri relativisht i madh i aktorëve të përfshirë, rreth 200 shtete sot në botë, me interesa nga më të larmishmet. Sot, ndërvarësia dhe problemi të mirës së përbashkët janë zgjeruar për të përfshirë edhe marrëdhëniet e njeriut me natyrën, jo vetëm marrëdhëniet e shteteve me njëri-tjetrin. Zgjidhja e problemeve të të mirës së përbashkët në lidhje me mjedisin varet nga nxjerrja e përfitimeve të përbashkëta, duke kapërcyer konfliktet e interesave. Pjesë e rëndësishme e këtyre zgjidhjeve është hartimi i një legjislacioni mjedisor i cili duhet të përmbajë rregulla që ofrojnë mundësi për të orientuar aktorët vendimmarrës drejt marrëveshjeve. Kjo nuk është një detyrë e lehtë, po të mbahet parasysh që divergjencat në legjislacion nuk ekzistojnë vetëm midis shteteve të zhvilluara dhe atyre në zhvillim, por edhe midis vetë vendeve të zhvilluara. Kështu p.sh., Kanadaja, SHBA, dhe Gjermania janë të gjitha vende të zhvilluara, por kanë rregullime të ndryshme ligjore dhe pritshmëritë nga ana e shtetit dhe shoqërisë, prej industrisë, që është edhe ndotësi më i madh, janë krejt të ndryshme. Në krahasim me SHBA, në Gjermani, punonjësit në industri kryejnë më pak orë pune, kanë siguri më të madhe në punë, por edhe rregullat mjedisore janë më të rrepta.¹⁷ Rregullat përcaktojnë ndarjen midis përfituesve dhe atyre që paguajnë koston e mbrojtjes së mjedisit.¹⁸ Pjesë e zgjidhjeve janë organizatat ndërkombëtare të specializuara në anët teknike e menaxhuese të mbrojtjes së mjedisit. Këto organizata po përputhen përherë e më tepër me bashkësi ekspertësh për çështje të ndryshme që lidhen me mjedisin, të quajtura “bashkësi epistemike”.¹⁹

Përveç trajtimit të problematikave që bëjnë këto bashkësi, ekzistojnë edhe disa mënyra më revolucionare të trajtimit të problemeve ndërkombëtare të mjedisit që zbatohen nga OJF-të mjedisore, siç janë Greenpeace, Fondi i Kafshëve të Egra të Botës (WWF), Miqtë e Tokës (Friends of the Earth), Ruajtja Ndërkombëtare (Conservation International), Klubi Sierra (Sierra Club), Ruajtja e Natyrës (Nature Conservancy), Këshilli i Kujdestarisë së Pyjeve (FSC), etj. Këto organizata nuk e shikojnë problematikën nga këndvështrimi neoliberal si përpjekje për marrëveshje midis shteteve, por kërkojnë ndryshime radikale të gjendjes aktuale. Ato kundërshtojnë rregullat mbi tregtinë e lirë që dobësojnë standardet mjedisore, madje ato kundërshtojnë edhe organizatat ndërqeveritare që i kushtojnë më tepër vëmendje krijimit të

¹⁶ Garrett Hardin, “*Tragedy of the Commons*”, Science, 1968, Vol. 162, fq. 1244. Për një kritikë ndaj këtij qëndrimi shih Ellinor Ostrom, “*Governing the Commons*”, Cambridge University Press, 1990.

¹⁷ Lyuba Zarsky, (eds.), “*Human Rights and the Environment*”, Earthscan Publications Ltd., London, 2002, fq. 34.

¹⁸ Për trajtimin e problemeve të ndërvarësisë dhe bashkëpunimit midis shteteve për çështje të mjedisit shih K.A. Oye dhe J.H. Maxwell, “*Self-interest and environmental management*”, redaktuar nga R.O. Keohane, dhe E. Ostrom, në “*Local Commons and Global Interdependence: Heterogeneity and Cooperation in Two Domains*”, London: Sage Publications, 1995, fq. 191-221.

¹⁹ Nga greqishtja: epistimi = shkencë.

pasurisë, se sa mbrojtjes së mjedisit. Ndër të tjera, vetë Banka Botërore akuzohet se financon projekte gjigande që rrënojnë mjedisin.²⁰

Në këtë kontekst kundërshtish e përplasjesh interesash nga më të larmishmet, roli i së drejtës ndërkombëtare të mjedisit bëhet tepër i vështirë. Veçori e kësaj dege të së drejtës ndërkombëtare që e dallon nga të tjerat, është se në formësimin e saj, shkenca luan një rol të veçantë në identifikimin e problemeve mjedisore, e për rrjedhojë edhe në politikat që duhen ndjekur e masat ligjore që duhen marrë për t'u dhënë zgjidhje problemeve. Në një këndvështrim tjetër, ekonomia është faktori kryesor që ndikon në formësimin e normave të së drejtës ndërkombëtare mjedisore. Sipas këtij këndvështrimi, problemet mjedisore janë në thelb probleme ekonomike, që janë shkaktuar për shkak të mosdhënies së vlerës së duhur ekonomike elementëve të mjedisit. Për rrjedhojë, edhe masat që duhen marrë duhet të orientohen prej vlerave ekonomike që vetë mjedisi përmban. Nga ana tjetër, edhe vlerat etike që i vishen mjedisit shihen nga këndvështrime të ndryshme. Të tjerë elementë vlerësojnë ekologjistët nga ambientalistët, eko-feministët nga eko-liberalët, këta të fundit nga eko-radikalët, e kështu me radhë. Po të shtohet në këtë ekuacion edhe karakteri burokratik i procesit të vendimmarrjes për hartimin e politikave dhe legjislacionit mjedisor, situata bëhet edhe më e komplikuar. Pavarësisht këndvështrimeve dhe vështirësive të ndryshme, sot ekziston një kuadër i gjerë normash në fusha të ndryshme të mbrojtjes së mjedisit, që kanë ndikuar edhe në hartimin e politikave dhe legjislacioneve kombëtare mjedisore të vendeve të ndryshme.²¹

Këtë natyrë komplekse të së drejtës ndërkombëtare të mjedisit e ka përmbledhur në mënyrë koncize në dy paragrafët e parë të preambulës së saj Konventa për Biodiversitetin e vitit 1992: *“Të ndërgjegjshëm për vlerën thelbësore të biodiversitetit dhe të elementëve të tij ekologjik, gjenetik, social, ekonomik, shkencor, arsimor, kulturor, argëtues, vlerave estetike...të ndërgjegjshëm për rëndësinë e biodiversitetit për zhvillimin dhe sigurimin e vazhdimësisë së sistemeve jetësore të biosferës...”*. Në pak fjalë përmbledhet karakteri gjithëpërfshirës i së drejtës ndërkombëtare të mjedisit, që duhet të krijojë mekanizmat për një qasje gjithëpërfshirëse për mbrojtjen e mjedisit, për shkak të ndërvarësisë së jetës njerëzore me të gjithë botën natyrore, të shprehur në përkufizimin e të gjithë botës si ‘biosferë’.²²

Nga të gjithë këta elementë del që e drejta ndërkombëtare mjedisore duhet të studiohet nga perspektiva e lidhjeve dhe ndikimit që ka mbi legjislacionin që ka të bëjë me zhvillimin ekonomik të vendit, industrinë, bujqësinë, tokën, ajrin, ujin, peshkimin, pyjet, florën, faunën, praktikisht me të gjitha sistemet jetësore.

Në kuadrin e politikave të ndjekura nga Shqipëria në rrugën e saj të integritit evropian, politikat mjedisore zënë një vend të rëndësishëm. Legjislacioni i plotë dhe i harmonizuar hedh bazat për një mbrojtje më të efektshme të mjedisit, për përmirësimin e kapaciteteve dhe insitucioneve, për rritjen e efijencës në përdorimin e burimeve natyrore, për reduktimin dhe parandalimin e

²⁰ Robert Goodland, *“The World Bank versus the World Commission on Dams”*, Water Alternatives, Vol. 3, Nr. 2, fq. 384-398.

²¹ Jane Holder dhe Maria Lee, *“Environmental Protection, Law and Policy”*, Second Edition, Cambridge University Press, 2007, fq. 9-11.

²² Patricia Birnie, Alan Boyle, Catherine Redgwell, *“International Law and the Environment”*, Oxford University Press, Third Edition, 2009, fq. 8.

problemeve mjedisore, në përputhje me parimin e zhvillimit të qëndrueshëm, si edhe për nxitjen e rritjes ekonomike.

Pas miratimit të Kushtetutës në vitin 1998, është krijuar edhe një kuadër i gjerë ligjor mjedisor, i përbërë prej ligjesh dhe aktesh nënligjore, i cili ka synuar mbrojtjen e mjedisit nga ndotja dhe dëmtimet, si edhe marrjen e masave parandaluese dhe atyre rehabilituese. Ky kuadër ligjor është përgjithësisht i harmonizuar edhe me legjislacionin përkatës të BE, pasi mbështetet në të njëjtat parime që është mbështetur legjislacioni mjedisor evropian, është hartuar me asistencën e ekspertëve të huaj, si dhe pasqyron përgjithësisht kërkesat e konventave në të cilat Shqipëria është palë. Ndër to mund të përmendim Konventën Kuadër të Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike (UNFCCC), Konventën e Komisionit Ekonomik të Kombeve të Bashkuara për Evropën për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis në Kontekst Ndërkufitar, Konventën e Vjenës për Mbrojtjen e Shtresës së Ozonit, Konventën e Aarhus-it për të Drejtën e Publikut për të Patur Informacion për Mjedisin, Pjesëmarrjen e tij në Vendimmarrje për Çështjet e Mjedisit dhe të Drejtën për t'iu Drejtuar Gjykatës për Çështje që Lidhen me Mjedisin, Konventën për Mbrojtjen e Mesdheut nga Ndotja, Konventën për Mbrojtjen dhe Përdorimin e Ujërave Ndërkufitare dhe Liqeneve Ndërkombëtarë, Konventën për Ruajtjen e Florës dhe Faunës së Egër dhe të Mjedisit Natyror në Evropë, Konventën për Efektet Ndërkufitare të Aksidenteve Industriale, Konventën për Ndotjen Ndërkufitare të Ajrit në Distanca të Largëta (LRTAP), Konventën e OKB për të Drejtën e Detit, Konventën Ndërkombëtare për Ruajtjen e Peshkut Ton të Atlantikut (ICCAT), Konventën e Ramsarit për Ligatinat me Rëndësi Ndërkombëtare Veçanërisht si Habitata të Shpendëve Ujorë, e shumë konventa të tjera. Prandaj, ky studim synon të ofrojë një analizë të hollësishme të legjislacionit ndërkombëtar të përgjithshëm dhe të *acquis communautaire* në veçanti, për mbrojtjen e mjedisit, në kuadër të integritimit evropian të Shqipërisë, si edhe ndikimin e tyre mbi legjislacionin shqiptar.

Megjithëse është diskutuar shumë mbi rolin dhe rëndësinë e parimeve dhe normave të së drejtës mjedisore, sigurisht që gjithmonë ka vend për t'i rishikuar ato dhe rëndësinë që ato kanë marrë në kuadrin e gjerë ndërkombëtar, rajonal e kombëtar, për shkak të aspekteve të gjithanshme, ekonomike, politike, sociale dhe ekologjike që ato përmbajnë. Kjo ka qenë arsyeja e marrjes përsipër të këtij punimi, ku midis të tjerash është synuar evidentimi i rolit dhe rëndësisë së këtyre parimeve dhe normave dhe ndikimi i tyre në legjislacionin rajonal e kombëtar, zbatimin e të cilit ndikon më pas në jetën tonë e të brezave të ardhshëm, për shkak të vetë karakterit të tyre.

Krahas rritjes së rolit të normave mjedisore në të drejtën ndërkombëtare të përgjithshme, një qasje e re e cila është duke u forcuar përherë e më tepër, sidomos në nivelin rajonal dhe që i është kushtuar rëndësi e veçantë në këtë punim, është qasja e integruar, që do të thotë përfshirja e parimeve të mbrojtjes së mjedisit në të gjitha fushat e tjera, pasi për nga vetë natyra e tij, aktiviteti njerëzor ndikon në një formë apo në një tjetër në mjedisin ku jetojmë, e për rrjedhojë edhe në cilësinë e jetës sonë. Ndaj në synimet e këtij punimi është radhitur si parësor evidentimi i rolit të normave të së drejtës mjedisore në disa nivele: së pari në nivelin e përgjithshëm ndërkombëtar, së dyti në nivelin rajonal evropian, e së treti në nivelin tonë kombëtar.

Parë në këtë këndvështrim, pyetjet kërkimore që kanë orientuar këtë punim kanë qenë: Cili është roli i së drejtës ndërkombëtare të mjedisit në përgjithësi, i asaj rajonale dhe kombëtare, në sigurimin e një mjedisi të pastër, si garanci për shëndetin e brezave të tashëm dhe të atyre që do

të vijnë? Në këtë kuadër, si kanë evoluar normat e kësaj të drejte përgjatë viteve? Cili ka qenë roli dhe ndikimi i parimeve mjedisore në formulimin e politikave dhe hartimin e legjislacionit mjedisor? Cilat janë normat e së drejtës ndërkombëtare të hartuara në fushat e veçanta të mbrojtjes së ajrit, ujit, biodiversitetit, administrimit të mbetjeve dhe si janë përthithur ato në legjislacionet rajonale dhe kombëtare? A janë shndërruar tashmë normat e së drejtës mjedisore në të drejta themelore të njeriut? Dhënia përgjigje këtyre pyetjeve ka qenë synimi i këtij punimi.

Qëllimi i kërkimit shkencor është që të realizojë atë që inxhinierët e elektronikës e bëjnë në punën e tyre kur duan të kuptojnë se si funksionon një pajisje, duke e zbërthyer atë plotësisht dhe duke analizuar rolin e çdo pjese të veçantë dhe se si ajo lidhet me pjesët e tjera, në mënyrë që pajisja të funksionojë ashtu siç duhet. Nëse zhvendosemi në fushën e analizës ligjore, “zbërthimi” përfshin normat ligjore, parimet, doktrinën, praktikën dhe jurisprudencën. Sigurisht, çdo vend ka karakteristikat e tij, kështu që ky kërkim shkencor është munduar të analizojë mënyrën se si janë adoptuar normat e së drejtës ndërkombëtare mjedisore në Shqipëri dhe në ç’masë kanë ndikuar ato në mbrojtjen dhe përmirësimin e situatës së mjedisit në vend.

Siç ndodh me kërkimin shkencor në përgjithësi, edhe ky studim ka kaluar nëpër fazat e ndryshme të hartimit të strukturës, mbledhjes së materialeve, analizës së të dhënave dhe arritjen e përfundimeve e raportimin e tyre. Për t’u dhënë përgjigje pyetjeve kërkimore, janë përdorur disa metoda kërkimi shkencor, si ajo përshkruese, metoda krahasimore, metoda analitike dhe ajo interpretuese. Analiza arkivore ka përfshirë një mori traktatesh mjedisore ndërkombëtare, legjislacionin mjedisor evropian, ligje të parlamentit shqiptar, vendime të Këshillit të Ministrave e akte të tjera nënligjore, strategji të sektorëve të ndryshëm, dokumente të ndryshëm të politikave mjedisore dhe vendime të gjykatave ndërkombëtare e atyre shqiptare.

Duke lënë mënjane specifikat e çdo vendi, ashtu siç janë globalizuar aspektet e ndryshme të jetës sonë të përditshme, po ashtu janë globalizuar edhe problemet mjedisore me të cilat ndeshet shoqëria njerëzore. Për këtë shkak, edhe parimet e përgjithshme dhe normat e mbrojtjes së mjedisit janë pak a shumë të përbashkëta në të gjitha sistemet ligjore dhe po ashtu interpretimi i tyre nga organet gjyqësore respektive ka ndjekur të njëjtën linjë. Parë në këtë prizëm, gjatë analizës së parimeve dhe të normave të së drejtës mjedisore, një pjesë e mirë e këtij punimi është mbështetur në vendimet e dhëna nga gjykatat e ndryshme ndërkombëtare, por më së shumti në vendimet e Gjykatës Evropiane të Drejtësisë (GJED) dhe të Gjykatës Evropiane të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ), për vetë faktin se janë gjykata që funksionojnë në kuadër të organizatave rajonale, respektivisht Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës, me të cilat vendi ynë ka një raport të veçantë. Tashmë Shqipëria gëzon statusin e vendit kandidat për anëtarësim në BE, çka sjell si domosdoshmëri njohjen e jurisprudencës së GJED dhe vendimet e saj duhet të orientojnë edhe vendimmarrjen e gjykatave shqiptare. Po ashtu, si vend anëtar i Këshillit të Evropës, bazuar në nenin 46 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Shqipëria ka marrë përsipër të respektojë vendimet e formës së prerë të GJEDNJ në çdo çështje ku ajo është palë, e prandaj edhe njohja e jurisprudencës së saj është e domosdoshme. Përveç këtyre, janë analizuar edhe disa vendime të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë (GJND), të Gjykatës Ndër-Amerikane të Drejtave të Njeriut (GJNADNJ), e të gjykatave të tjera, për të krijuar një tablo më të gjerë të zbatimit të normave të së drejtës mjedisore.

Struktura e punimit është e tillë, ku fillimisht prezantohet zhvillimi historik i së drejtës ndërkombëtare të mjedisit e më pas, raporti i së drejtës ndërkombëtare me të drejtën e brendshme në Shqipëri dhe parimet kryesore ndërkombëtare të mbrojtjes së mjedisit. Më tej, në kërçet III, IV, V dhe VI, përmes analizës ligjore shqyrtohet legjislacioni ndërkombëtar, evropian dhe shqiptar për mbrojtjen e ajrit, ujit, biodiversitetit dhe mbrojtjen e mjedisit nga mbetjet. Në kreun VII analizohet lidhja midis mbrojtjes së mjedisit dhe të drejtave të njeriut, ndërsa në mbyllje të punimit paraqiten gjetjet, nxirren konkluzionet e studimit dhe ofrohen disa rekomandime.

KREU I

ZHVILLIMI HISTORIK I SË DREJTËS NDËRKOMBËTARE TË MJEDISIT

“E drejta ndërkombëtare e mjedisit është një nga degët e së drejtës ndërkombëtare me zhvillimin më të shpejtë.”
(Gjyqtari Weeramantry, çështja Gabčikovo-Nagymaros, GJND, 1997.)

1.1 Fillimet e hershme të së drejtës ndërkombëtare të mjedisit.

Deri pas Luftës së Dytë Botërore shtetet konsideroheshin si aktorët e vetëm në të drejtën ndërkombëtare. Në atë kohë, çështjet mjedisore nuk hynin aspak në grupin e çështjeve shqetësuese për shtetet, kështu që rëndësia që ata i kushtonin dhe normat që rregullonin marrëdhëniet midis tyre në lidhje me problemet mjedisore ishin shumë të kufizuara. Deri në vitin 1920 numëroheshin 8 traktate ndërkombëtare mjedisore, në vitin 1940 u bënë 20 të tillë, në vitin 1970 numri i tyre arriti në 100,²³ për të mbërritur në ditët e sotme kur sipas FAO-s, që prej vitit 805 e.s janë nënshkruar rreth 3,600 traktate që kanë të bëjnë me rrjedhat ujore ndërkombëtare.²⁴

Siç ka ndodhur edhe me degët e tjera të së drejtës ndërkombëtare, përpjekjet për marrëveshje në lidhje me mjedisin lindën me qëllim mbrojtjen e interesave të shteteve, kryesisht për shfrytëzimin e burimeve të tyre natyrore. Përpjekjet e para për institucionalizimin e traktateve që trajtonin çështjet e burimeve natyrore gjenden në komisionet evropiane të lumenjve, në shekullin XIX. Komisioni Qendror për Lundrimin në Lumin Rin daton që nga Kongresi i Vjenës, në vitin 1815, duke qenë kështu institucioni ndërkombëtar më i vjetër për burimet natyrore, i kohëve moderne. Ai u pasua nga marrëveshja për krijimin e Komisionit Evropian të Lumenjve, bazuar në Traktatin e Paqes së Parisit, të vitit 1856.²⁵

Pasojat tragjike të Luftës së Dytë Botërore i ndërgjegjësuan shtetet që e vetmja mënyrë për të ecur përpara ishte bashkëpunimi midis tyre, pavarësisht pikëpamjeve të kundërta që mund të kishin për çështje të ndryshme. Çështjet mjedisore nuk bënë pjesë në grupin e çështjeve me karakter të ngutshëm për t'u rregulluar në atë kohë, kështu që as nenet 1 dhe 55 të Kartës së OKB, ku shpaloseshin qëllimet e veprimtarisë së saj dhe bashkëpunimi ndërkombëtar në fushën ekonomike dhe sociale, nuk e përmendnin mjedisin. Por, pavarësisht nga mungesa e përmendjes së mbrojtjes së mjedisit në Kartën e OKB, organizata ka luajtur një rol të rëndësishëm në sferën e mjedisit. Pikat më kulmore të veprimtarisë së saj janë tre konferencat e mbajtura në Stokholm në vitin 1972, në Rio de Janeiro në vitin 1992 dhe në Johaneshburg në vitin 2002.

²³ Alexios Antypas, “From Stockholm to Johannesburg”, Lectures on Environment, Central European University, Budapest, 2010.

²⁴ Të dhënat gjenden në: http://www.un.org/waterforlifedecade/transboundary_waters.shtml

²⁵ Ulrich Beyerlin dhe Thilo Marauhn, “International Environmental Law”, Hart Publishing, 2011, fq. 246.

Në vitin 1962, Asambleja e Përgjithshme e OKB miratoi rezolutën 1803, e cila sanksiononte sovranitetin e përhershëm të popujve mbi pasuritë e tyre natyrore. E gjithë veprimtaria shtetërore në këtë drejtim duhet të orientohet nga përmbushja e interesave të njerëzve dhe në respektim të sovranitetit dhe të interesave të vendeve të tjerë.²⁶

Dekada që pasoi Luftën e Dytë Botërore nuk solli ndonjë zhvillim të rëndësishëm për sa i përket normave ndërkombëtare mbi mjedisin. Fillimet e krijimit dhe fuqizimit të strukturës organizative ndërkombëtare mjedisore gjenden në vitet '60. Gjatë këtyre viteve u rritën përpjekjet për hartimin e traktateve mjedisore, siç ishin Konventa për Ndërhyrjet në Det të Hapur në Rastet e Dëmeve të Shkaktuara nga Ndotja prej Naftës, Konventa për Përgjegjësinë Civile për Dëmet e Shkaktuara nga Ndotja prej Naftës, Konventa Afrikane për Mbrojtjen e Natyrës dhe Burimeve Natyrore, etj. Rritja e ndjeshmërisë së njerëzve për problemet mjedisore çoi në organizimin e protestave gjithandej nëpër SHBA dhe në shpalljen e Ditës së Tokës në 22 prill të vitit 1970, ditë e cila festohet edhe sot në shumicën e vendeve të botës.²⁷

1.2 Zhvillimet bashkëkohore të së drejtës ndërkombëtare të mjedisit.

Dekada e viteve 70³ konsiderohet si dekada e lëvizjeve mjedisore. Në atë kohë krijohen partitë e para të gjelbëra dhe përfshihen për herë të parë ministritë e mjedisit në kabinetet qeveritare të vendeve të ndryshme të botës. Në vitin 1971 themelohet në Vancouver të Kanadasë organizata ndërkombëtare mjedisore Greenpeace, e cila vazhdon edhe sot e kësaj dite të jetë ndër më aktivet për çështjet e mbrojtjes së mjedisit në të gjithë kontinentet.

Si moment kyç, i cili përbën edhe fillimin e *Periudhës Moderne* të së Drejtës Ndërkombëtare të Mjedisit, konsiderohet organizimi i Konferencës së OKB për Mjedisin Njerëzor (Konferenca e Stokholmit) në vitin 1972. Në përfundim të kësaj konference u miratua Deklarata e Stokholmit për Mjedisin Njerëzor (Deklarata e Stokholmit), si edhe Plani i Veprimit për Mjedisin Njerëzor.²⁸ Dita e fillimit të punimeve të konferencës, 5 qershori i vitit 1972 u shpall nga Asambleja e Përgjithshme e OKB si Dita Botërore e Mjedisit, e cila kremtohet sot me veprimtari mjedisore anembanë botës.

Deklarata e Stokholmit përbën një zhvillim tepër të rëndësishëm për të drejtën ndërkombëtare të mjedisit. Edhe pse vetë titulli i saj tregon që kemi të bëjmë me një dokument që nuk ka fuqi detyruese, *ligj i butë* në kuptim të së drejtës ndërkombëtare, rëndësia e saj qëndron në formulimin e disa parimeve bazë që do të udhëhiqnin zhvillimin e së drejtës ndërkombëtare mjedisore në të ardhmen. Që në preambulën e saj, deklarata e shpall mbrojtjen e mjedisit si një çështje madhore, që ndikon në mirëqenien e njerëzve dhe zhvillimin ekonomik. Në paragrafin e dytë, mbrojtja e mjedisit konsiderohet një *dëshirë e popujve* dhe *detyrë e të gjithë qeverive*. Përveç ritheksimit të parimit të sovranitetit mbi pasuritë natyrore, nga ana tjetër, deklarata bën edhe dallimin midis problemeve mjedisore me të cilat ndeshen vendet në zhvillim, ku njerëzit jetojnë nën nivelin e nevojshëm për një jetesë dinjitoze, në kushtet e ndotjes së tokës, ujit, ajrit,

²⁶ Gjendet në

[http://www.un.org/en/ga/search/view_doc.asp?symbol=A/RES/1803\(XVII\)&Lang=E&Area=RESOLUTION](http://www.un.org/en/ga/search/view_doc.asp?symbol=A/RES/1803(XVII)&Lang=E&Area=RESOLUTION)

²⁷ Për më tepër shih: <http://www.earthday.org/earth-day-history-movement>

²⁸ Gjenden në: <http://untreaty.un.org/cod/avl/ha/dunche/dunche.html#3>

dhe atyre në vendet e industrializuara, ku problemet shkaktohen si rrjedhojë e industrializimit dhe zhvillimit teknologjik. Vendeve në zhvillim u bëhet thirrje që të orientojnë politikatat e tyre drejt zhvillimit, por jo në dëm të mjedisit, ndërsa vendet e zhvilluara duhet të japin kontributin e tyre për të zvogëluar dallimet me vendet në zhvillim, nëpërmjet transferimit të të dhënave shkencore dhe të teknologjisë së përparuar drejt tyre.

Përveç miratimit të deklaratës, bazuar në nenin 22 të Kartës së OKB, në Konferencën e Stokholmit u themelua Programi Mjedisor i Kombeve të Bashkuara (UNEP), si një organ dytësor i Asamblesë së Përgjithshme, me qendër në Nairobi të Kenias, për të nxitur bashkëpunimin ndërkombëtar në fushën e mjedisit, të rekomandojë politikatat e përshtatshme për këtë qëllim, si edhe të mundësojë një udhëheqje të përgjithshme politike për drejtimin dhe koordinimin e programeve mjedisore brenda sistemit të OKB.²⁹

Që nga themelimi i UNEP, Këshilli Drejtues i tij ka marrë disa vendime të rëndësishme në ushtrim të rolit të tij për udhëheqjen politike dhe koordinimin në fushën mjedisore, duke marrë parasysh perspektivën e zhvillimit, siç është Deklarata e Nairobit për Rolin dhe Mandatin e UNEP, e vitit 1997,³⁰ e cila ripërcaktoi dhe fuqizoi mandatin e UNEP dhe Deklarata e Malmoes e vitit 2000,³¹ e miratuar nga Forumi i Parë Global i Ministrave të Mjedisit, me qëllim koordinimin e strategjive për të ardhmen.

Pas përfundimit të punimeve të konferencës, Asambleja e Përgjithshme miratoi në dhjetor 1972 disa rezoluta për çështjet mjedisore, nr. 2994, 2995 dhe 2996, respektivisht rezolutën për Konferencën e Stokholmit dhe Planin e Veprimit, rezolutën për Bashkëpunimin Midis Shteteve në Fushën e Mjedisit dhe rezolutën për Përgjegjësinë Ndërkombëtare të Shteteve në Lidhje me Mjedisin.³²

Që prej këtij momenti kyç në vitin 1972, ka patur një rritje të vullshme të numrit të traktateve ndërkombëtare mjedisore, mbi 100 të tillë vetëm deri në vitin 1992, të cilët përfshijnë një gamë të gjerë çështjesh mjedisore. Në po atë vit, 1972, u miratuan dy traktatet për mbrojtjen e deteve nga ndotja: Konventa e Oslos për Parandalimin e Ndotjes së Deteve prej Hedhjeve nga Anijet dhe Avionët dhe Konventa e Londrës për Parandalimin e Ndotjes së Deteve prej Hedhjeve të Mbeturave dhe Substancave të Tjera. Ato janë pasuar nga Konventa Ndërkombëtare për Parandalimin e Ndotjes prej Anijeve (MARPOL) e vitit 1973, Konventa e Parisit për Parandalimin e Ndotjes së Deteve që Vjen nga Burimet Tokësore e vitit 1974. Më tej, u miratua Konventa për Tregtinë Ndërkombëtare të Specieve të Rrezikuara të Florës dhe Faunës (CITES) e vitit 1973, Konventa për Ndotjen Ndërkufitare të Ajrit në Distanca të Largëta (LRTAP) e vitit 1979, Konventa e OKB për të Drejtën e Detit (UNCLOS) e vitit 1982. Në 1982 Asambleja e Përgjithshme e OKB miratoi edhe Kartën Botërore të OKB për Natyrën, e cila përmban parimin se çdo formë e jetës është unike dhe duhet të respektohet, pavarësisht vlerës së saj për njerëzimin dhe se njerëzimi duhet të kuptojë varësinë e tij prej burimeve natyrore e të ndërgjegjësohet për

²⁹ Informacion më i hollësishëm gjendet në: <http://www.unep.org/>

³⁰ Gjendet në: <http://www.unep.org/Documents/Multilingual/Default.asp?DocumentID=287&ArticleID=1728>

³¹ Gjendet në: http://www.unep.org/malmo/malmo_ministerial.htm

³² Gjenden në: [http://www.un.org/ga/search/view_doc.asp?symbol=A/RES/2994\(XXVII\)](http://www.un.org/ga/search/view_doc.asp?symbol=A/RES/2994(XXVII))

nevojën e ushtrimit të kontrollit mbi shfrytëzimin e tyre.³³ Më pas hartohen Konventa e Vjenës për Mbrojtjen e Shtresës së Ozonit, e vitit 1985, Konventa e Vjenës për Njoftimin e Hershëm të një Aksidenti Bërthamor e vitit 1986 dhe Konventa e Vjenës për Ndhimën në Rast të një Aksidenti Bërthamor ose Emergjence Radiologjike e vitit 1986, pas shpërthimit të centralit bërthamor në Çernobil të Ukrainës në 26 prill 1986.

Në vitin 1988, OKB-ja, duke përfshirë Programin Mjedisor të OKB (UNEP) dhe Organizatën Botërore të Meteorologjisë (WMO), krijoi Panelin Ndërqeveritar për Ndryshimet Klimatike (IPCC), të përbërë prej 200 shkencëtarësh. IPCC është një organizëm shkencor ndërkombëtar kryesor për vlerësimin e ndryshimeve klimatike. Aktualisht, të gjithë vendet anëtare të OKB janë anëtare të IPCC. Paneli studion dhe jep shpjegime shkencore për gjendjen aktuale lidhur me ndryshimet klimatike dhe ndikimet e mundshme mjedisore e shoqërore-ekonomike. IPCC shqyrton dhe vlerëson informacionet më të fundit shkencore, teknike dhe shoqërore-ekonomike në botë, për kuptimin e ndryshimeve klimatike. Mijëra shkencëtarë nga e gjithë bota kontribuojnë në punën e IPCC. Puna e IPCC konsiston në shqyrtimin e këtyre informacioneve, për të siguruar një vlerësim objektiv dhe të plotë të tyre, në shërbim të vendimmarrësve.

IPCC ka arritur në përfundimin se rritja e përqendrimit të gazeve serë të prodhuar nga aktivitetet njerëzore si djegia e karburanteve fosile (qymyri, nafta dhe gazi natyror) dhe shpyllëzimet, kanë shkaktuar shumicën e rritjes së temperaturës të vërtetuar që nga mesi i shek. XX. IPCC ka arritur gjithashtu në përfundimin se variacionet në dukuritë natyrore si rrezatimi diellor dhe vullkanet, kanë shkaktuar shumicën e ngrohjes që nga kohët para-industriale deri në vitin 1950 dhe pas kësaj ka patur një ftohje të vogël. Këto konkluzione janë mbështetur nga mbi 40 shoqata shkencore dhe akademi shkencash, përfshirë akademitë e shkencave të shumicës së vendeve të industrializuara. Megjithatë, nuk kanë munguar edhe kritikantët në drejtim të këtij paneli, duke e akuzuar se ekzagjeron të dhënat për ndryshimet klimatike, ku një numër i kufizuar shkencëtarësh kundërshtojnë konkluzionet e mësipërme.³⁴

Në 8 dhjetor të vitit 1989, në Frankfurt të Gjermanisë u miratua edhe Karta Evropiane për Mjedisin dhe Shëndetin, në Konferencën e Parë Evropiane për Mjedisin dhe Shëndetin të Organizatës Botërore të Shëndetësisë.

Në vitin 1991 u miratua Konventa e Bamakos për Ndalimin e Importit në Afrikë dhe Kontrollin e Lëvizjes Ndërkufitare dhe Menaxhimit të Mbetjeve të Rrezikshme Brenda Afrikës, e cila ndalon importin e të gjitha mbetjeve të rrezikshme në Afrikë, nga vendet që nuk i përkasin Bashkimit Afrikan (BA). Në vitin 1992 u miratua edhe Konventa e Helsinkit për Mbrojtjen e Mjedisit Detar të Zonës së Detit Balltik.

Në Konferencën e OKB për Mjedisin dhe Zhvillimin, të mbajtur në vitin 1992, në Rio De Zhaneiro (i quajtur Samiti i Tokës, ose Samiti i Rios) u arrit numri më i madh i udhëheqësve të lartë shtetërorë të mbledhur ndonjëherë së bashku. Mbi 130 shtete nënshkruan Konventën Kuadër për Ndryshimet Klimatike, Konventën për Biodiversitetin dhe Konventën për të Luftuar

³³ Karta Botërore e OKB për Natyrën, miratuar me Rezolutën e Asamblesë së Përgjithshme A/RES/37/7, datë 28 tetor 1982. Gjetet në: <http://www.un.org/documents/ga/res/37/a37r007.htm>

³⁴ Kritikantët ndaj veprimtarisë së IPCC gjenden në <http://www.globalresearch.ca/global-warming-a-convenient-lie/5086>

Shkretëtirëzimin. Në vend të tejkalimit të aftësive mbajtëse të Tokës, njerëzimit do t'i duhet t'u përshtatet këtyre aftësive në kohën e duhur, për të arritur në një ekonomi me gjendje të qëndrueshme, në të cilën popullsia, industria, përdorimi i energjisë dhe nxjerrja e burimeve natyrore, të jenë të qëndrueshme, nga një vit, në tjetrin. Sipas këtij skenari, detyra kryesore e brezit të tashëm do të ishte përshtatja e ekonomisë dhe politikës, në mënyrë të tillë që të futet në një marrëdhënie afatgjatë e të qëndrueshme me mjedisin. Koncepti i zhvillimit të qëndrueshëm u përmend për herë të parë në vitin 1972, në Deklaratën e Stokholmit, e më pas në vitin 1980 në Strategjinë e Ruajtjes së Botës,³⁵ hartuar nga Unioni Ndërkombëtar për Ruajtjen e Natyrës (IUCN), ndërsa përkufizimi i plotë i tij u dha nga Komisioni Brundtland, i njohur zyrtarisht me emrin Komisioni Botëror për Mjedisin dhe Zhvillimin, i cili kishte si mision bashkimin e vendeve për të ndjekur politika të zhvillimit të qëndrueshëm. Kryetarja e Komisionit, kryeministria e Norvegjisë, Gro Harlem Brundtland, u emërua nga Sekretari i Përgjithshëm i OKB, Javier Pérez de Cuéllar, në Dhjetor 1983. Në përfundim të punës së tij, Komisioni hartoi raportin përfundimtar të titulluar "E ardhmja jonë e përbashkët", në të cilin u përdor ky përkufizim i zhvillimit të qëndrueshëm: "*Zhvillim që plotëson nevojat e tashme, pa cënuar mundësitë e brezave të ardhshëm që të plotësojnë nevojat e tyre.*"³⁶

Dokumentet kryesore të Samitit të Rios ishin: Deklarata e Rios,³⁷ e përbërë nga 27 parime udhëheqëse për veprimtarinë e të gjithë vendeve; Axhenda 21,³⁸ një plan veprimi mjedisor për shekullin XXI, si edhe Parimet e Pyjeve.³⁹ Si dokumente, këto nuk kanë fuqi ligjore detyruese, por hodhën bazat e një bashkëpunimi të ri ndërkombëtar për zhvillimin e qëndrueshëm dhe mbrojtjen e mjedisit në shkallë botërore.

Deklarata e Rios, emërtimi i plotë i së cilës është Deklarata për Mjedisin dhe Zhvillimin, edhe pse nuk përmend njerëzit në titull, në parimin e parë të saj i vendos ata në qendër të shqetësimeve që kanë të bëjnë me zhvillimin e qëndrueshëm dhe konfirmon të drejtën e tyre për një jetë të shëndetshme dhe produktive, në harmoni me natyrën. Më tej, deklarata vazhdon me shpalljen e parimit të sovranitetit të shteteve për shfrytëzimin e burimeve të tyre natyrore, por në mënyrë që të mos dëmtojnë interesat e shteteve të tjerë, eliminimin e varfërisë, kujdesjen për brezat e ardhshëm, të drejtën e individëve për të marrë informacion mbi mjedisin dhe për të marrë pjesë në vendimmarrje, pjesëmarrjen e grave, të rinjve dhe popullsive autoktone, bashkëpunimin e shteteve, hartimin e legjislacionit mjedisor efektiv, mbrojtjen e ekosistemeve, parimin 'ndotësi paguan', vlerësimin e ndikimit në mjedis dhe zgjidhjen paqësore të mosmarrëveshjeve.

Axhenda 21 ka si qëllim kryesor përballjen me problemet e rënda të degradimit të burimeve natyrore, ndihmesën që i duhet dhënë vendeve në zhvillim dhe garantimin e zhvillimit të qëndrueshëm. Sistemi i nxitjes dhe penalizimeve që motivon sjelljen ekonomike duhet riorientuar, që të bëhet një faktor i rëndësishëm për zhvillimin e qëndrueshëm. Një tjetër synim afatgjatë është eliminimi i varfërisë nëpërmjet menaxhimit më të mirë të burimeve natyrore dhe

³⁵ Strategjia e Ruajtjes së Botës gjendet në: <http://data.iucn.org/dbtw-wpd/edocs/WCS-004.pdf>

³⁶ Raporti gjendet në: http://conspect.nl/pdf/Our_Common_Future-Brundtland_Report_1987.pdf

³⁷ Deklarata e Rios gjendet në:

<http://www.unep.org/Documents.Multilingual/Default.asp?documentid=78&articleid=1163>

³⁸ Axhenda 21 gjendet në: <http://sustainabledevelopment.un.org/content/documents/Agenda21.pdf>

³⁹ Parimet e Pyjeve gjenden në: <http://www.un.org/documents/ga/conf151/aconf15126-3annex3.htm>

përmirësimin të cilësisë së jetës, duke siguruar strehim dhe ujë të pastër, kanalizime të përshtatshme dhe trajtim të mbetjeve të ngurta.

Axhenda 21 synon të arrijë përdorimin e qëndrueshëm të burimeve rajonale dhe globale, si atmosfera, oqeanet, detet dhe ujërat e embla, si edhe të gjallesave detare. Objektivi i fundit është përmirësimi i menaxhimit të kimikateve dhe mbetjeve kimike. OBSH ka vlerësuar se një e treta e vdekjeve në vendet në zhvillim shkaktohen prej kontaminimit të ushqimit dhe ujit nga mbetjet njerëzore dhe industriale.⁴⁰

Axhenda 21 u drejtohet të gjithë grupeve dhe profesioneve që janë të lidhur me arritjen e këtyre objektivave. Synimi është të arrihet rritja e transferimit të teknologjive të përshtatshme për mjedisin si edhe theksimi i nevojës për financime nga Veriu drejt Jugut botëror.

Për një numër çështjesh që përmbajnë kundërshti, nuk u arrit marrëveshje, si p.sh. mbrojtja e pyjeve, financimi, si edhe kush duhet të mbikëqyrë zbatimin e Axhendës 21. Vendet e Jugut argumentojnë se vendet e Veriut propagandojnë mbrojtjen e pyjeve në Jug, që të shërbejnë si rezervuarë të dioksidit të karbonit të prodhuar në Veri. Ndarja Veri-Jug për këtë çështje u zgjidh duke ndryshuar gjuhën e përdorur në tekst: “Palët do marrin në konsideratë në të ardhmen mundësinë e një traktati për pyjet”.

Një vendim shumë i rëndësishëm ishte themelimi nga Asambleja e Përgjithshme e OKB në dhjetor 1992 i Komisionit të Zhvillimit të Qëndrueshëm (CSD), për të siguruar zbatimin e vendimeve të Samitit të Rios. Veprimtaria e CSD përqendrohet në zhvillimin e qëndrueshëm, zbatimin e Axhendës 21 dhe Deklaratës së Rios. Komisioni vepron si komision funksional i Këshillit Ekonomik dhe Social të OKB (ECOSOC), është i përbërë prej 53 anëtarëve, ku 1/3 e tyre ripërtërihet çdo vit. Çdo sesion i CSD zgjedh një byro të përbërë nga 1 kryetar dhe 4 nënkryetarë.⁴¹

Në vitin 1998 u miratua Konventa e Roterdamit për Pëlqimin Paraprak të Informuar për Tregtinë e Kimikateve të Dëmshme dhe Pesticideve, si edhe Konventa e Aarhusit “Për të drejtën e publikut për të pasur informacion, për të marrë pjesë në vendimmarrje dhe për t’iu drejtuar gjykatës për çështjet e mjedisit” (Konventa e Aarhusit). Në vijim, në vitin 2001 u miratua Konventa e Stokholmit për Ndotësit Organikë të Qëndrueshëm.

Mbrojtja e mjedisit u shpall si një nga synimet kryesore të OKB në Deklaratën e Mijëvjeçarit, të miratuar me Rezolutën 55/2 të Asamblesë së Përgjithshme, në 18 shtator 2000. Deklarata shpreh shqetësimin që brezat e ardhshëm kërcënohen me trashëgimin e një planeti, burimet natyrore të të cilit mund të mos jenë të mjaftueshme që ata të përbushin të gjitha nevojat e tyre. Prandaj konfirmohet vendosmëria për mbështetjen e parimeve të zhvillimit të qëndrueshëm për mbrojtjen e pyjeve, burimeve ujore, uljen e nivelit të çlirimit të gazeve në hapësirë, shmangien e katastrofave që vijnë si rezultat i veprimeve të njeriut dhe angazhimit për hyrjen në fuqi të Protokollit të Kiotos dhe zbatimin me rigorozitet të Konventës për Biodiversitetin dhe Konventës për të Luftuar Shkretëtirëzimin.⁴²

⁴⁰ *Supra*, shënimi fundor nr. 8.

⁴¹ Për më tepër shih <http://sustainabledevelopment.un.org/index.php?menu=1673>

⁴² Rezoluta gjendet në: <http://www.un.org/millennium/declaration/ares552e.pdf>

Samiti i Rios u pasua nga një tjetër mbledhje e krerëve të shteteve dhe qeverive nga 176 vende të botës, i ashtuquajtur "Rio+10" - Samiti Botëror i OKB për Zhvillimin e Qëndrueshëm - i mbajtur në vitin 2002, në Johannesburg të Afrikës së Jugut. Në përfundim të punimeve të samitit u miratuan dy dokumente kryesorë: Deklarata për Zhvillimin e Qëndrueshëm dhe Plani i Zbatimit.⁴³ Njëpërmjet deklaratës, palët pjesëmarrëse morën përsipër përgjegjësinë kolektive për të çuar më tej dhe forcuar 3 kolonat e zhvillimit të qëndrueshëm, që janë zhvillimi ekonomik, zhvillimi social dhe mbrojtja e mjedisit, në nivel lokal, kombëtar, rajonal and global. Megjithatë, një qasje e tillë e ndarjes në 3 kolona në vend të 2 kolonave me rëndësi të njëjtë, që duhej të ishin zhvillimi dhe mbrojtja e mjedisit, është kritikuar se ka zbehur rëndësinë e mbrojtjes së mjedisit, duke ulur peshën e tij.⁴⁴

Përmbushja e synimeve të deklaratës do të arrihej njëpërmjet Planit të Zbatimit, si mjeti kryesor për arritjen e qëllimeve madhore të eliminimit të varfërisë dhe zhvillimit njerëzor, duke u siguruar njerëzve akses në ujë të pijshëm, kushte të përshtatshme higjienë, strehim, burime energjie, kujdes shëndetësor dhe mbrojtje të biodiversitetit.⁴⁵ Ndërsa Plani i Zbatimit përcaktonte mjetet që duhen përdorur për realizimin e këtyre objektivave. Një ndër veçoritë e këtij dokumenti është theksimi që i bëhet forcimit të partneriteteve në planet dypalëshe, si partneritetit midis vendeve të zhvilluara dhe atyre në zhvillim, ashtu edhe midis sektorit publik dhe atij privat, njëpërmjet hartimit të strategjive gjithëpërfshirëse dhe koordinimit të veprimeve të qeverive kombëtare e vendore me shoqërinë civile dhe biznesin privat.⁴⁶ Sigurisht që partneritete të tilla mbështeten në iniciativa vullnetare dhe nuk kanë fuqi detyruese. Prandaj merr një rol të veçantë hartimi i politikave të tilla nga organet vendimmarrëse që të përfshijnë të gjithë aktorët e interesuar, duke ofruar mekanizma që nxisin zbatimin e praktikave të zhvillimit të qëndrueshëm.

Po kështu, një veçori tjetër e këtij dokumenti që e dallon prej shumicës së marrëveshjeve shumëpalëshe mjedisore ku gjuha e përdorur është kryesisht e një karakteri të përgjithshëm, është caktimi i objektivave konkretë për t'u arritur brenda afateve kohore të caktuara. Kështu, duhet përmendur zotimi për të ndërmarrë veprime që të arrihet përgjysmimi i numrit të popullsisë që nuk ka akses në ujë të pijshëm, që vuan nga uria dhe që jeton me më pak se 1 dollar në ditë brenda vitit 2015, apo ulja e vdekshmërisë foshnjore me 2/3, brenda po këtij afati. Ndërsa brenda vitit 2020 të gjithë vendet duhet të plotësojnë standarde të tilla të prodhimit dhe përdorimit të kimikateve që të minimizonin në mënyrë absolute ndikimin në shëndetin e njeriut.⁴⁷

Me gjithë përpjekjet për të rritur bashkëpunimin ndërkombëtar për çështjet mjedisore, ajo që u vërejt në Samitin e Johannesburgut e në vijim është zhvendosja e fokusit nga mbrojtja e mjedisit tek zhvillimi ekonomik. Kjo duket edhe në vetë ndryshimin e titujve të samiteve, nga "Mjedisi Njerëzor" në Stokholm, në "Mjedisi dhe Zhvillimi" në Rio, në "Zhvillimi i Qëndrueshëm" në Johannesburg, ku mjedisi nuk përmendet më në titullin e samitit. Fatkeqësisht, kjo ka qenë tendenca e vërejtur edhe në takimet shumëpalëshe që janë mbajtur pas Samitit të Johannesburgut.

⁴³ Raporti i Samitit të Johannesburgut gjendet në:

http://www.un.org/jsummit/html/documents/summit_docs/131302_wssd_report_reissued.pdf

⁴⁴ *Supra.*, shënimi fundor nr. 25, fq. 26.

⁴⁵ Deklarata e Samitit të Johannesburgut mbi Zhvillimin e Qëndrueshëm, parag. 5-7.

⁴⁶ Plani i Zbatimit të Samitit të Johannesburgut, parag. 9, 46, 64, 71.

⁴⁷ *Ibid.*, parag. 23, 25, 40, 54, 67.

Kështu, në vitin 2009, në Konferencën e Kopenhagenit për Ndryshimet Klimatike nuk u arrit një marrëveshje në Konferencën e Palëve në lidhje me uljen e nivelit të çlirimit në atmosferë të gazeve serë pas vitit 2012, i cili ishte edhe fundi i zbatimit të fazës së parë të Protokollit të Kiotos. Ky ishte një moment delikat, pasi ndodhi një ndërprerje e një procesi të mundimshëm bisedimesh e marrëveshjesh shumëpalëshe për të reflektuar ndaj ndryshimeve klimatike. Po në këtë vit, Kina e tejkaloi SHBA si çliruesi i gazeve serë më i madh në botë në terma absolutë, por jo për frymë popullsie.

Po ashtu, në vitin 2009 u prezantua për herë të parë koncepti i “Nëntë Limiteve të Planetit”, çështjet për të cilat konsiderohet se planeti ynë ka arritur kapacitetin mbajtës maksimal e për të cilat kërkohen masa urgjente, në mos për kthimin e gjendjes së mëparshme apo përmirësimin e situatës, të paktën për ruajtjen e *status quo*-së. Siç u përmend më sipër, këtu u futën: shtresa e ozonit, biodiversiteti, mbetjet kimike e radioaktive, ndryshimet klimatike, shiu acid, uji i pijshëm, mbrojtja e tokës, futja e nitrogjenit dhe fosforit në biosferë e oqeanë dhe shpërndarja e aerosoleve në atmosferë.⁴⁸

Për të analizuar progresin e arritur që nga Deklarata e Mijëvjeçarit, në vitin 2010 Asambleja e Përgjithshme e OKB miratoi Rezolutën 65/1. Pavarësisht arritjeve pozitive që identifikohen, në të thuhet qartë se ajo çka është arritur është shumë larg objektivave dhe asaj që duhet synuar. Përfaqësuesit e të gjithë vendeve shprehën vendosmërinë për atë arritur synimet e zhvillimit të qëndrueshëm nëpërmjet bashkëpunimit, për të realizuar objektiva konkretë, duke përfshirë masat për zhvillimin e industrisë ricikluese, rritjen e investimeve për zhvillime teknologjike që zgjerojnë përdorimin e energjive të pastra, transferimin e teknologjive të përparuara drejt vendeve në zhvillim, veçanërisht garantimin e ujit të pijshëm për popullsitë e këtyre vendeve, marrjen e masave për ndalimin e degradimit të tokës dhe shkretëtirëzimit të saj, mbrojtjen e biodiversitetit, mësimin prej praktikave shekullore të popujve autoktonë, ngritjen e një sistemi botëror paralajmërimi për katastrofat natyrore, përdorimin e kujdeshëm dhe menaxhimin e duhur të substancave kimike e mbetjeve radioaktive, si edhe forcimin e kujdesit dhe menaxhimin e qëndrueshëm të pyjeve, në dobi të brezave të tashëm dhe atyre që do vijnë më pas.⁴⁹

Pas dështimeve të Konferencës së Kopenhagenit për Ndryshimet Klimatike, janë mbajtur dy konferenca të rëndësishme të palëve të Konventës Kuadër për Ndryshimet Klimatike dhe Protokollit të Kiotos: ajo e Kankunit, në Meksikë, në vitin 2010 dhe ajo e Durbanit, në Afrikën Jugut, në vitin 2011. Vendimet më të rëndësishme të këtyre konferencave kishin të bënin me fillimin e fazës së dytë të zbatimit të Protokollit të Kiotos, vazhdimin e përmbushjes së detyrimeve në kuadër të konventës, veçanërisht uljen e nivelit të çlirimit të gazeve nga shpyllëzimet dhe degradimi i pyjeve në vendet në zhvillim, masat për mbrojtjen dhe menaxhimin e qëndrueshëm të pyjeve dhe aktivizimin e Fondit të Klimës së Gjelbër, i cili funksionon si një entitet i mekanizmit financiar të Konventës.⁵⁰

⁴⁸ Për një shtjellim më të hollësishëm shih:

<http://www.stockholmresilience.org/research/researchnews/tippingtowardstheunknown/thenineplanetaryboundaries.4.1fe8f33123572b59ab80007039.html>

⁴⁹ Rezoluta 65/1 e Asamblesë së Përgjithshme të OKB gjendet në:

http://www.un.org/en/mdg/summit2010/pdf/outcome_documentN1051260.pdf

⁵⁰ Për një shtjellim më të hollësishëm shih: <http://www.iisd.ca/download/pdf/enb12534e.pdf>

Një ndër zhvillimet e rëndësishme të vitit 2012 ishte sukcesi në arritjen e një prej objektivave të Zhvillimit të Mijëvjeçarit para afatit të parashikuar për vitin 2015, përgjysmimi në shkallë botërore i numrit të njerëzve që nuk kanë akses në ujë të pijshëm. Ndërsa pikën kulmore e përbën Konferenca “Rio+20”, me objektiv kryesor arritjen e marrëveshjes për “gjelbërimin” e ekonomive në shkallë botërore nëpërmjet masave për një energji të pastër dhe përdorim të drejtë të burimeve. Vlerësimet për këtë konferencë kanë qenë përgjithësisht negative, madje kanë arritur deri në ekstrem, duke e etiketuar si një dështim të përmasave epike.⁵¹ Rezultatet përfundimtare të Konferencës u përmblodhën në Rezolutën 66/288 të Asamblesë së Përgjithshme të OKB, të titulluar “E ardhmja që duam”.⁵² Kjo rezolutë, ashtu si edhe pararendëset e saj, deklaratat e Stokholmit, Rios dhe Johannesburgut, nuk ka karakter detyrues. Ajo është më tepër një rikonfirmim i detyrimeve të mëparshme, prandaj edhe ajo u referohet traktateve mjedisore ekzistuese. Ajo rikonfirmon rolin e UNEP si autoriteti udhëheqës global mjedisor që përcakton axhendën mjedisore dhe nxit zbatimin e elementëve të zhvillimit të qëndrueshëm, në veçanti të elementit mjedisor. Një arritje që duhet veçuar është edhe caktimi i limitit maksimal të rritjes globale të temperaturës në masën 1.5 gradë Celsius mbi nivelet para-industrialë. Ndryshime u bënë edhe për sa i përket strukturës institucionale, ku u vendos krijimi i një forumi politik ndërqeveritar të nivelit të lartë, i cili do të zëvendësonte CSD, por duke u mbështetur në eksperiencën dhe burimet e tij. Ndërsa në lidhje me mekanizmat e së drejtës ndërkombëtare mjedisore të përdorur në këtë konferencë, nuk pati ndonjë ndryshim në krahasim me të mëparshmet. Përsëri kemi të bëjmë me detyrime të marra përsipër në mënyrë vullnetare nga palët në formën e një *ligji të butë*, që reflekton konsensusin e arritur, dhe jo një dokument detyrues që cakton detyra specifike. Mbi të gjitha, rëndësia e këtij dokumenti qëndron në rritjen e rëndësisë që i dedikohet veprimtarisë së shoqërisë civile dhe partneriteteve të saj me aktorët e tjerë që ndikojnë në menaxhimin e mjedisit.⁵³

Konferenca e fundit e OKB për Ndryshimet Klimatike u mbajt në Varshavë në nëntor 2013 dhe i shërbeu nxitjes së vazhdimësisë së angazhimeve të marra përsipër nga qeveritë e vendeve të ndryshme të botës. Në konferencë u vendos krijimi i një mekanizmi ndërkombëtar për të ofruar mbështetje ndaj popullsisë më të pambrojtura nga dëmet që shkaktohen prej fatkeqësive natyrore, kushteve klimatike ekstreme dhe rritja e nivelit të detit. Një ndër vendimet më të rëndësishme kishte të bënte me ndihmën që do u jepet vendeve në zhvillim për të ulur nivelin e çlirimit në atmosferë të gazeve serë si rezultat i shpyllëzimit dhe degradimit të pyjeve, që përlllogariten në rreth 1/5 e të gjithë totalit që çlirohet në atmosferë prej aktivitetit njerëzor. Në kuadër të REDD+⁵⁴ u premtuan financime prej 280 milion dollarësh prej SHBA, Norvegjisë dhe Mbretërisë së Bashkuar.⁵⁵ Një marrëveshje e re për ndryshimet klimatike pritet të arrihet në Samitin e Parisit, që do të mbahet në vitin 2015.

⁵¹ Një ndër qëndrimet më të ashpër ka qenë ai i mbajtur nga OJF-ja ambientaliste Greenpeace. Gjetet në: <http://www.greenpeace.org/international/en/press/releases/Greenpeace-Press-Statement-Rio20-Earth-Summit-a-failure-of-epic-proportions/>

⁵² Rezoluta 66/288 e Asamblesë së Përgjithshme të OKB gjendet në: <http://www.uncsd2012.org/content/documents/814UNCSD%20REPORT%20final%20revs.pdf>

⁵³ Ann Powers, “*The Rio+20 Process: Forward Movement for the Environment?*” Transnational Environmental Law, Vol.1, Nr.2, tetor 2012, fq. 410.

⁵⁴ REDD - Reducing Emissions from Deforestation and Forest Degradation (Pakësimi i gazeve të çliuar prej shpyllëzimit dhe degradimit të pyjeve). REDD u prezantua për here të parë në Konferencën e Palëve në Konventën Kundër Ndryshimeve Klimatike në Montreal, në dhjetor 2005.

⁵⁵ Për më tepër shih: http://unfccc.int/meetings/warsaw_nov_2013/meeting/7649/php/view/decisions.php

KREU II

RAPORTI I SË DREJTËS NDËRKOMBËTARE ME TË DREJTËN E BRENDSHME SHQIPTARE DHE PARIMET KRYESORE NDËRKOMBËTARE TË MBROJTJES SË MJEDISIT

Në të drejtën e brendshme, parimet e përgjithshme të saj sanksionohen zakonisht në kushtetutë, si ligji themelor i vendit. Mbi bazën e këtyre parimeve ngrihet i gjithë kuadri ligjor i detyrueshëm për t'u zbatuar në vend. Në dallim nga e drejta e brendshme, në mungesë të një autoriteti ndërkombëtar suprem që të bëjë të detyrueshëm zbatimin e tyre, në të drejtën ndërkombëtare parimet e përgjithshme luajnë një rol të ndryshëm nga e drejta e brendshme. Ato përbëjnë burimin e tretë kryesor, pas traktateve dhe të drejtës zakonore,⁵⁶ ndërsa zbatimi i tyre në praktikë i shërben përmbushjes së interesave të subjekteve që hyjnë në marrëdhënie me njëri-tjetrin në arenën ndërkombëtare. Ndër këto subjekte, më të rëndësishmit vazhdojnë të mbeten shtetet, si aktorët kryesorë në qeverisjen ndërkombëtare në përgjithësi dhe në atë mjedisore në veçanti. Gjithësesi, sot kanë ndodhur ndryshime në të drejtën ndërkombëtare mjedisore, që kanë transformuar disi edhe rolin e shteteve, duke u rritur ndjeshëm roli i organizatave ndërkombëtare mjedisore. Kanë ekzistuar disa përpjekje për të përmbledhur këto organizata në një bashkësi të vetme, por deri tani këto kanë rezultuar të pasuksesshme. Në realitet, ashtu siç ekziston një tendencë copëzimi në të drejtën ndërkombëtare, ashtu ndodh edhe në të drejtën ndërkombëtare mjedisore. Organizatat jo-qeveritare kanë luajtur një rol të rëndësishëm në mbrojtjen e mjedisit, në një kohë kur edhe individit është bërë një aktor i rëndësishëm në rritje, në të drejtën ndërkombëtare mjedisore.

Në të drejtën ndërkombëtare të mjedisit, parimet e përgjithshme të zbatueshme rrjedhin kryesisht prej praktikës midis shteteve, në funksion të ruajtjes së mjedisit të përbashkët dhe jo prej ndonjë dokumenti ndërkombëtar me fuqi detyruese. Përpara analizës së këtyre parimeve mjedisore sipas të cilëve sillen aktorët në arenën ndërkombëtare, është e nevojshme që fillimisht të shqyrtohet vendi që zë e drejta ndërkombëtare në të drejtën e brendshme shqiptare.

2.1 Raporti midis të drejtës ndërkombëtare të përgjithshme dhe të drejtës së brendshme shqiptare.

Raporti midis të drejtës ndërkombëtare dhe të drejtës së brendshme shqiptare është përcaktuar në disa prej neneve të kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Fillimisht, në nenin 5 të saj thuhet se “Republika e Shqipërisë zbaton të drejtën ndërkombëtare të detyrueshme për të.” Në pamje të parë, kjo dispozitë mund të shihet si një formulim i një karakteri të përgjithshëm, e bërë nga një shtet që deklaron se do të silltet në arenën ndërkombëtare në përputhje me rregullat e gjithëpranuara të komunitetit të shteteve. Në tërësinë e këtyre rregullave do të përfshiheshin

⁵⁶ Neni 38 i Statutit të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë. Gjetet në: <http://www.icj-cij.org/documents/index.php?p1=4&p2=2&p3=0&>

traktatet, e drejta zakonore, parimet e përgjithshme të së drejtës, doktrina dhe jurisprudenca, ku dy të fundit shërbejnë si burime dytësore, plotësuese ndaj të parave që konsiderohen si burime kryesore, në kuptim të nenit 38 të statutit të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë (GJND).

Mirëpo kuptimi i ngushtë i kësaj dispozite do ta kufizonte atë thjesht në kuadrin e një deklarate formale, pa ndonjë vlerë të veçantë, pasi sjellja e shteteve sipas normave të së drejtës ndërkombëtare është kusht *sine qua non* që ata të mund të marrin pjesë në jetën ndërkombëtare, e kështu kjo dispozitë nuk do sillte ndonjë risi. Prandaj, nenit 5 i duhet dhënë një kuptim më i gjerë, referuar edhe dispozitave të tjera të kushtetutës shqiptare, ndonëse është vlerësuar se “Ky nen [neni 5] duhet interpretuar në mënyrë të ngushtë lidhur vetëm me nenin 122 të Kushtetutës, që do të thotë që R.SH njuh dhe zbaton marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara prej saj dhe të botuara në Fletoren Zyrtare, pasi në këtë mënyrë ato bëhen pjesë e sistemit të brendshëm juridik të vendit tonë.”⁵⁷

Traktatet në të cilat Republika e Shqipërisë është bërë palë, përfshirë ato mjedisore, janë bërë pjesë e rendit të brendshëm juridik shqiptar nëpërmjet miratimit të ligjeve prej Kuvendit të Shqipërisë. Kështu p.sh, ligji nr. 8216, datë 13.5.1997, realizoi aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën e Bazelit “Për kontrollin e lëvizjeve ndërkufitare të mbetjeve të rrezikshme dhe asgjësimin e tyre”; ligji nr. 8294, datë 2.3.1998, bëri ratifikimin e Konventës së Bernës “Për ruajtjen e florës dhe faunës së egër dhe mjedisit natyror të Evropës”; ligji nr. 8556, datë 22.12.1999, realizoi aderimin në Konventën e Kombeve të Bashkuara “Për të luftuar shkretëtirëzimin në ato vende që kanë kaluar thatësira serioze dhe/ose shkretëtirëzim, veçanërisht në Afrikë”; ligji nr. 8672, datë 26.10.2000, bëri ratifikimin e Konventës së Aarhusit “Për të drejtën e publikut për të pasur informacion, për të marrë pjesë në vendimmarrje dhe për t’iu drejtuar gjykatës për çështjet e mjedisit”; ligji nr. 9021, datë 6.3.2003, realizoi aderimin në Konventën “Për tregtinë ndërkombëtare të llojeve të rrezikuara të florës dhe faunës së egër”; ligji nr. 10277, datë 13.5.2010, realizoi aderimin në Konventën e Roterdamit “Mbi procedurën e njoftimit të pëlqimit paraprak për disa kimikate dhe produkte të rrezikshme për mbrojtjen e bimëve në tregtinë ndërkombëtare”, etj.

Në përgjithësi, marrëveshjet ndërkombëtare bëhen pjesë e rendeve të brendshme juridike të shteteve palë në të, pas nxjerrjes së një akti të brendshëm legjislativ. Në Mbretërinë e Bashkuar, para reformës kushtetuese të vitit 2010, zbatohet i ashtuquajti “Rregulli Ponsonby”,⁵⁸ por që në fakt ishte thjesht një praktikë kushtetuese, sipas së cilës marrëveshjet e nënshkuara nga qeveria i paraqiteshin parlamentit për një periudhë 21 ditore, para se qeveria të vazhdonte me ratifikimin dhe botimin e traktatit pas kalimit të afatit. Me miratimin e Ligjit të Reformës Kushtetuese dhe Qeverisjes të vitit 2010, tashmë praktika kushtetuese u shndërrua në një ligj të veçantë, i cili i jep mundësinë të dy dhomave të parlamentit të pengojnë qeverinë, që të mos e ratifikojë traktatin, duke e shtyrë atë në kohë me periudha të njëpasnjëshme 21-ditore.⁵⁹ Ndërsa në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, e ashtuquajtura “Klauzola e Supremacisë”, Neni 6§2 i Kushtetutës,

⁵⁷ Xhezair Zaganjori, “Vendi i së Drejtës Ndërkombëtare në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë”, Jeta Juridike, Nr. 2, shkurt 2004, Shkolla e Magjistraturës së R.SH, Tiranë, fq. 32.

⁵⁸ Rregulli ka marrë emrin e Nënsekretarit të Shtetit të Punëve të Jashtme të Mbretërisë së Bashkuar në vitin 1924, Arthur Ponsonby, i cili shërbeu në qeverinë laboriste të kryeministrit Ramsay MacDonald.

⁵⁹ Ligji i Reformës Kushtetuese dhe Qeverisjes i Mbretërisë së Bashkuar gjendet në: http://www.legislation.gov.uk/ukpga/2010/25/pdfs/ukpga_20100025_en.pdf

përcakton se ajo, bashkë me ligjet e SHBA, si edhe të gjitha traktatet e lidhur në emër të SHBA, përbëjnë ligjin themelor të vendit. Gjyqtarët në çdo shtet të veçantë i përmbahen këtij ligji themelor, pa marrë parasysh ndonjë ndryshim që mund të kenë kushtetuta apo ligjet e cilitdo shteti të veçantë.⁶⁰ Në lidhje me vetëzbatueshmërinë e traktateve, vlen të analizohet vendimi i Gjykatës së Lartë të SHBA në çështjen *Medellin kundër Teksasit*.⁶¹ Në arsyetimin e tyre, gjyqtarët e shumicës gjykan se vendimi i GjND për rishqyrtimin e çështjes *Medellin* nuk është direkt i zbatueshëm në SHBA. Në të kundërt, gjyqtarët e pakicës argumentuan se SHBA kanë detyrimin të zbatojnë vendimin e GjND, detyrim ky që buron prej nenit 94 të Kartës së OKB, i cili thotë se secili prej anëtarëve të Kombeve të Bashkuara merr përsipër që në çdo rast konflikti ku ai është palë, të respektojë vendimin e GjND. Përderisa SHBA e kanë ratifikuar këtë traktat, Kartën e OKB, janë të detyruara t'i binden vendimit të GjND, pa patur nevojë për një ligj të veçantë të Kongresit, sepse Karta është bërë pjesë e rendit të brendshëm juridik të SHBA. Me tej, gjyqtarët e pakicës shprehën se: “Çështja nëse nevojitet legjislacion shtesë përpara se një traktat të marrë fuqi juridike në të drejtën e brendshme të një shteti palë, është shpesh çështje se si e konsideron e drejta e brendshme statusin ligjor të këtij traktati. Dhe ky proces i brendshëm i përcaktimit të statusit ligjor të një traktati ndërkombëtar ku është palë, ndryshon në mënyrë të dukshme nga një shtet në tjetrin.”⁶²

Në vijim të kësaj analize, mund të themi se Republika e Shqipërisë ka marrë përsipër një sërë detyrimesh në kuadër të traktateve të ndryshme mjedisore, duke i bërë dispozitat e tyre të detyrueshme për zbatim në territorin e saj nëpërmjet ratifikimit të tyre me ligj.

2.2 Raporti midis *acquis communautaire* dhe të drejtës së brendshme shqiptare.

Pas analizës së mësipërme dhe me qëllim që të analizohet raporti midis *acquis communautaire* dhe të drejtës së brendshme shqiptare, duhet të shihet më parë raporti midis vetë *acquis communautaire* dhe të drejtës ndërkombëtare të përgjithshme.

Në kuadër të së drejtës së BE, çështjet e mjedisit hyjnë në kompetencat e përbashkëta ndërmjet BE dhe shteteve anëtare, ku shtetet anëtare do t'i ushtrojnë kompetencat e tyre nëse ato nuk ushtrohen prej vetë BE. Këtu hyjnë ndër të tjera: mjedisi, bujqësia dhe peshkimi, me përjashtim të ruajtjes së burimeve biologjike detare, energjisë, etj. Traktati i Bashkimit Evropian,⁶³ në nenin 3§5 të tij sanksionon se në marrëdhëniet e tij ndërkombëtare, Bashkimi do të mbrojë vlerat dhe interesat e tij dhe do të kontribuojë për paqen, sigurinë, zhvillimin e qëndrueshëm të Tokës [theksimi im], solidaritetin dhe respektin reciprok midis popujve, tregtinë e lirë dhe të ndershme, eliminimin e varfërisë, mbrojtjen e të drejtave të njeriut, veçanërisht të fëmijëve, si edhe respektimin e të drejtës ndërkombëtare, përfshirë parimet e Kartës së OKB [theksimi im]. Ndërsa në nenin 21, BE angazhohet të zbatojë politika të përbashkëta për një bashkëpunim të

⁶⁰ Kushtetuta e SHBA gjendet në: http://www.archives.gov/exhibits/charters/constitution_transcript.html

⁶¹ Për një analizë të detajuar të vendimit, shih Xhezair Zaganjori, “*Jurisprudencë dhe praktikë ndërkombëtare*”, Adelprint, 2012, fq. 247.

⁶² Vendimi i Gjykatës së Lartë Amerikane në çështjen *Medellin v. Texas*, datë 25.8.2008, mendimi i pakicës i gjyqtarëve Breyer, Souter dhe Ginsburg. Gjendet në: <http://www.supremecourt.gov/opinions/07pdf/06-984.pdf>

⁶³ Traktati i Bashkimit Evropian gjendet në: <http://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=OJ:C:2010:083:0013:0046:en:PDF>

ngushtë për të nxitur *zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik, social dhe mjedisor* [theksimi im] të vendeve në zhvillim, me synim parësor eliminimin e varfërisë, si edhe marrjen e masave për *përmirësimin e cilësisë së mjedisit dhe zhvillimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore* [theksimi im] në mënyrë globale. Në lidhje me dualitetin e anëtarëve të BE, që janë njëkohësisht edhe anëtarë të Këshillit të Sigurimit të OKB (Mbretëria e Bashkuar dhe Franca), neni 34§2 i traktatit u kërkon këtyre shteteve që të mbajnë të informuar shtetet e tjerë dhe Përfaqësuesin e Lartë të Bashkimit për Punët e Jashtme dhe Politikën e Sigurisë. Ata ngarkohen që në ushtrim të funksioneve të tyre të mbrojnë interesat e BE, pa rënë ndesh me detyrimet dhe përgjegjësitë që kanë marrë përsipër në kuadër të Kartës së OKB.

Nga ana e saj, Karta e OKB konsiderohet se ka arritur statusin e jo thjesht një traktati ndërkombëtar, por atë të një “Kushtetute” të mbarë komunitetit botëror. Kjo del nga një interpretim i nenit 2§6 të saj, të marrë së bashku me nenin 103, ku OKB merr përsipër të garantojë që edhe shtetet jo-anëtare të veprojnë sipas parimeve të së drejtës ndërkombëtare dhe se detyrimet e anëtarëve të Kombeve të Bashkuara që burojnë prej Kartës, kur bien ndesh me ato që ata marrin përsipër në kuadër të marrëveshjeve të tjera ndërkombëtare, atëherë detyrimet që rrjedhin nga Karta do të kenë përparësi.⁶⁴ Prej këtyre dispozitave mund të nxirret konkluzioni se Karta e OKB ka një karakter *quasi-kushtetues*, ku edhe marrëveshjet e tjera ndërkombëtare duhet të jenë në përputhje me të.⁶⁵

Referuar të drejtës së BE, në tekstet e traktateve nuk gjendet ndonjë dispozitë specifike që të sanksionojë epërsinë e *acquis communautaire* ndaj të drejtës së brendshme. Kjo epërsi ndaj të drejtës së brendshme është sanksionuar nga Gjykata Evropiane e Drejtësisë (GJED) dhe nuk ekzistonte në ndonjë prej dispozitave të Traktatit të Komunitetit Evropian (TKE) apo të Traktatit të Bashkimit Evropian (TBE). Për herë të parë, mjedisi u përfshi ndër çështjet e kompetencës së BE në Aktin Unik Evropian dhe nga interpretimi i gjerë i nenit 2 të Traktatit të KE që kishte të bënte me objektivat e Komunitetit. Duke u munduar të balanconte interesat ekonomike në lëvizjen e lirë të mallrave, me interesat e mbrojtjes së mjedisit, GJED i pranoi këto të fundit si të detyrueshme, çka mund të legjitimonte edhe vendosjen e kufizimeve për tregtinë. Për sa i përket zgjedhjes së bazës së duhur ligjore për mbrojtjen e mjedisit, GJED ka aplikuar konceptin e “*qendrës së gravitetit*”, çka nënkupton lejimin e përdorimit të dispozitave të Traktatit të KE për harmonizimin e legjislacioneve kombëtare, në mënyrë që të garantohet mbrojtja e mjedisit.⁶⁶

Megjithatë, për të konfirmuar këtë parim të konsoliduar nga jurisprudenca e GJED, Traktatit të Lisbonës i është bashkëlidhur Deklarata 17, lidhur me epërsinë e *acquis communautaire*. Në të deklarohet se në përputhje me jurisprudencën e konsoliduar të GJED, traktatet dhe legjislacioni i miratuar nga BE kanë epërsi ndaj legjislacionit të brendshëm të vendeve anëtare. Deklaratës iu bashkëlidh edhe Mendimi i Zyrës Juridike të Këshillit, Nr. 11197/07, datë 22 qershor 2007, i cili përcakton se “*Epërsia e acquis communautaire është një gur themeli i të drejtës së BE, i cili sipas GJED buron natyrshëm prej karakterit të veçantë të kësaj organizate. Që prej vendimit të*

⁶⁴ Karta e OKB gjendet në: <https://www.un.org/en/documents/charter/>

⁶⁵ Ronald St. J. Macdonald, “*The Charter of the United Nations as a World Constitution*”, në Michael N. Schmitt (red.), “*International Law Across the Spectrum of Conflict. Essays in Honour of Professor L.C. Green on the Occasion of His Eightieth Birthday*”. International Law Studies, Naval War College, Newport, 2000, Vol.75, fq.272.

⁶⁶ Ludwig Krämer, “*The Single European Act and Environmental Protection, Reflections on Several New Provisions in Community Law*”, Common Market Law Review, Vol. 24, 1987, fq. 682-688.

*parë të GJED, Costa kundër ENEL, datë 5 korrik 1964, në traktat nuk përmendej epërsia, çka mbetet e tillë edhe sot, por fakti që parimi i epërsisë së *acquis communautaire* nuk do të përfshihet as në traktatet e ardhshme, nuk do të çënojë në asnjë mënyrë zbatueshmërinë e këtij parimi dhe jurisprudencën e GJED. Për rrjedhojë (...) legjislacioni që rrjedh prej traktatit, për shkak të natyrës së tij të veçantë si një burim i pavarur i së drejtës, nuk mundet të kundërshtohet prej të drejtës së brendshme, e çfarëdo forme qoftë ajo, pa humbur karakterin e saj si e drejtë komunitare dhe pa vënë në dyshim bazën ligjore të vetë Komunitetit”.*⁶⁷

Për më tepër, neni 216 i Traktatit të Funkcionimit të Bashkimit Evropian (TFBE), sanksionon që Bashkimi mund të lidhë traktate me vende të treta apo organizata ndërkombëtare kur kjo është e nevojshme për të arritur një prej objektivave të përmendur në Traktatet, dhe se këto traktate kanë fuqi ligjore detyruese për institucionet e Bashkimit dhe shtetet anëtare. Në këto kushte, duke qenë se mbrojtja e mjedisit është një prej objektivave të BE dhe ajo vetë është bërë palë në shumë traktate mjedisore, edhe nëse një prej shteteve anëtare nuk është palë në një prej këtyre traktateve, përsëri ka detyrimin për të respektuar dispozitat e tij, detyrim që buron prej anëtarësisë në BE.

Nga ana tjetër, jurisprudenca e GJED është konsoliduar vazhdimisht që prej vendimit në çështjen *Costa kundër ENEL*, pasi “... ajo [GJED – shënimi im] interpreton Traktatin dhe pjesët e tjera të legjislacionit në mënyrë të tillë, duke i kushtuar rëndësi frymës, jo gërmës së Traktatit. Gjykata e sheh Komunitetin si një organizatë dinamike, në rritje, mendon dhe interpreton sipas kuptimit të dispozitave të Traktatit dhe legjislacionit dytësor të Komunitetit dhe reagon në një mënyrë fleksible.”⁶⁸ GJED luan një rol të rëndësishëm në sigurimin e zbatimit praktik të së drejtës mjedisore evropiane, nëpërmjet vendimeve të veta të përditshme, që luajnë rolin e precedentit dhe përbëjnë një burim të rëndësishëm për dhënien jetë dhe interpretimin e normave të së drejtës mjedisore evropiane.⁶⁹

Përveç sigurimit të zbatimit praktik të *acquis communautaire* në përgjithësi, GJED zotëron edhe mekanizmin e kontrollit gjyqësor të zbatimit të unifikuar, ose *quasi* të unifikuar të së drejtës mjedisore, duke patur kështu një rol kyç në fushën e zhvillimit të legjislacionit mjedisor evropian.⁷⁰

Sipas një ish-këshilltari ligjor të GJED, “...mbrojtjes së mjedisit, si interes publik, iu dha vlerë kushtetuese prej GJED edhe më parë se të ekzistonte ndonjë bazë ligjore në tekstin e Traktatit. Ajo ishte përcaktuar si një objektiv themelor i Komunitetit, i cili në rrethana të caktuara dhe në kushte të caktuara, merr përparësi edhe ndaj parimeve të tregtisë së lirë.”⁷¹ Këtu, autori i

⁶⁷ Deklarata 17, bashkëlidhur Traktatit të Lisbonës. Gjetet në: <http://eur-lex.europa.eu/en/treaties/dat/12007L/htm/C2007306EN.01025602.htm>

⁶⁸ Allan F. Tatham, “*EC Law in Practice. A Case-Study Approach.*”, HVG-Orac, 2006, fq. 21.

⁶⁹ Alexandre Kiss, Dinah Shelton, “*Manual of European Environmental Law*”, Cambridge: Grotius Publications, 1993, fq. 22.

⁷⁰ Gyula Bándi, “*ECJ Environmental Jurisprudence – The Role of Explanatory Provisions*”, fq. 11, në Gyula Bándi, (red.), “*The Impact of ECJ Jurisprudence on Environmental Law*”, Akaprint Kft, 2009.

⁷¹ Francis Jacobs, “*The role of the European Court of Justice in the Protection of the Environment*”, Journal of Environmental Law, 2006, Vol. 18, Nr. 2, fq. 194.

referohet vendimit të GJED në çështjen *Shishet Daneze*,⁷² në të cilin gjykata konfirmoi atë që kishte vendosur në vendimin e saj të mëparshëm Nr. 240/83, të 7 shkurtit 1985, *Procureur de la République v Association de défense des brûleurs d'huiles usagées*, se mbrojtja e mjedisit është një nga objektivat themelorë të Komunitetit, i cili mund të justifikojë disa kufizime të caktuara të parimit të lëvizjes së lirë të mallrave, të sanksionuar në nenin 30 të Traktatit të KEE. Në çështjen konkrete, GJED shkoi më tej, duke thënë se përveç kësaj, një pikëpamje e tillë është konfirmuar edhe prej Aktit Unik Evropian dhe se masat e marra nga autoritetet kombëtare për mbrojtjen e mjedisit, pranohet se përbëjnë një nga 'kërkesat e detyrueshme' për të mundësuar kufizimin e lëvizjes së lirë të mallrave. Megjithatë, në çështjen *Shishet Daneze*, GJED vendosi se Danimarka kishte shkelur parimin e proporcionalitetit, pasi masat që merren për mbrojtjen e mjedisit nuk duhet të shkojnë përtej "kufizimeve të cilat justifikohen nga ndjekja e objektivit të mbrojtjes së mjedisit."⁷³

Krahasuar me kohën e dhënies së vendimeve të sipërpërmendura në vitet 80', mund të thuhet se e drejta mjedisore evropiane nuk përbën tashmë thjesht një politikë sektoriale, që ka vetëm një drejtim të caktuar, por ka arritur një stad të tillë saqë ndikon edhe në hartimin e politikave të sektorëve të tjerë. Një analizë më e hollësishme e këtij ndikimi do të bëhet në vijim, në pjesën ku flitet për *parimin e integritetit*, si një nga parimet themelore të së drejtës mjedisore, por për momentin do të analizohet roli që ka luajtur GJED në këtë drejtim. Në çështjen *Komisioni kundër Irlandës*, Nr. C-494/01, GJED shqyrtoi përgjegjësinë e Irlandës për moszbatimin e neneve 4, 5, 8, 9, 10, 12, 13 dhe 14 të Direktivës së Këshillit 75/442/EEC, për Mbetjet, e ndryshuar. Ajo u shpreh se në parim, asgjë nuk e ndalon Komisionin që përveç gjetjes që këto dispozita specifike të Direktivës nuk janë zbatuar nga ana e Irlandës, të arrijë edhe në gjetjen tjetër, që ky moszbatim vjen për shkak të praktikave të kundërta të adopsuara nga autoritetet kombëtare, të cilat vetëm sa ilustron nga rastet në shqyrtim.⁷⁴ Pra, nga rastet e veçuara, të arrihet në konkluzionin e një praktike të përgjithshme të moszbatimit të *acquis communautaire* prej një shteti anëtar, që mund të përfshijë edhe sektorë të tjerë, përveç mjedisit.

Shumica e çështjeve mjedisore të shqyrtuara nga GJED janë padi të paraqitura nga Komisioni kundër shteteve anëtare, bazuar në nenet 258 (ish-220) dhe 260 (ish-228) të Traktatit të Funkionimit të Bashkimit Evropian. Nëse Komisioni është i mendimit se një shtet anëtar nuk e ka përmbushur një detyrim që rrjedh nga traktatet, ai nxjerr një opinion të arsyetuar për çështjen në fjalë, pasi i ka dhënë shtetit anëtar mundësinë të paraqesë komentet e veta. Nëse shteti në fjalë nuk e zbaton opinionin brenda periudhës së caktuar nga Komisioni, ky i fundit mund ta dërgojë çështjen në GJED, pasi i ka dhënë mundësi shtetit të paditur të paraqesë komentet e veta. Nëse gjykata konstaton se shteti anëtar nuk e ka respektuar vendimin e saj, ajo mund të vendosë një shumë ose gjobë për t'u paguar nga ky shtet. Kur Komisioni e dërgon çështjen në GJED, sipas

⁷² Vendimi i GJED Nr. 302/86, datë 20.9.1988, *Komisioni i Komuniteteve Evropian e kundër Mbretërisë së Danimarkës*.

<http://curia.europa.eu/juris/showPdf.jsf?jsessionid=9ea7d2dc30d59fff14b66b78496fa271f18da1a09f5b.e34KaxiLc3qMb40Rch0SaxuNbNz0?text=&docid=95033&pageIndex=0&doclang=EN&mode=lst&dir=&occ=first&part=1&cid=361426>

⁷³ *Ibid.*, parag. 11 i vendimit.

⁷⁴ Vendimi i GJED Nr. C-494/01, datë 26.4.2005, parag. 27. Gjendet në:

<http://curia.europa.eu/juris/showPdf.jsf?jsessionid=9ea7d2dc30d509ab2b017680409a94aaadca0c537c51.e34KaxiLc3qMb40Rch0SaxuNc3j0?text=&docid=58802&pageIndex=0&doclang=EN&mode=lst&dir=&occ=first&part=1&cid=159073>

nenit 258, me arsyetimin se shteti anëtar nuk e ka përmbushur detyrimin për të njoftuar masat që transpozojnë një direktivë të miratuar sipas një procedure legislative, ai mund të përcaktojë vlerën e shumës së njëhershme ose të gjobës që duhet të paguajë shteti anëtar, siç e gjykon të arsyeshme sipas rrethanave. Nëse GJED konstaton se ka shkelje, ajo mund të vendosë shumën ose gjobën për shtetin anëtar, e cila nuk duhet të jetë më e madhe se vlera e përcaktuar nga Komisioni. Detyrimi për të paguar fillon në datën e caktuar nga GJED në vendimin e saj.

Për të reduktuar kohën e gjykimeve në GJED dhe në funksion të dhënies së shpejtë të drejtësisë, përpara dhënies së vendimit, GJED merr edhe mendimin e Avokatit të Përgjithshëm, pasi GJED, përveç 28 gjyqtarëve, nga një për çdo vend anëtar, përbëhet edhe prej 9 Avokatëve të Përgjithshëm, të zgjedhur me marrëveshje midis shteteve anëtare, me mandat 6 vjeçar, të rinovueshëm. Roli i Avokatit të Përgjithshëm është shumë i rëndësishëm, pasi është ai që bën i pari vlerësimin ligjor të çështjes dhe ia referon GJED, ku statistikat tregojnë se në rreth $\frac{3}{4}$ e vendimeve, GJED ndjek mendimin e Avokatit të Përgjithshëm.⁷⁵ Në trajtimin e disa prej çështjeve në vijim, do të analizohet edhe mendimi i Avokatit të Përgjithshëm.

Për sa i përket interpretimit që gjykatat kombëtare të vendeve të BE u bëjnë dispozitave të së drejtës së tyre të brendshme, në krahasim me dispozitat e direktivave të BE, në çështjen *Marleasing SA*, Nr. 106/89, GJED u shpreh se detyrimet e vendeve anëtare që burojnë prej një direktive për të arritur një rezultat të caktuar nga vetë direktiva, bëjnë që këto vende anëtare të detyrohen të marrin të gjitha masat e duhura, qofshin këto të karakterit të përgjithshëm apo të posaçëm, në mënyrë që të garantohet përmbushja e këtij detyrimi, i cili është i detyrueshëm për të gjitha autoritetet e vendeve anëtare, përfshirë gjykatat e tyre kombëtare, për çështjet nën juridiksionin e tyre. Prej kësaj, rrjedh që në zbatimin e të drejtës së brendshme, nëse dispozitat në fjalë ishin miratuar para apo pas direktivës, gjykata kombëtare e thirrur për të bërë interpretimin, duhet ta bëjë këtë, sa më shumë të jetë e mundur, në dritën e kuptimit të fjalëve dhe qëllimit të direktivës, në mënyrë që të arrihet rezultati që synohet prej kësaj të fundit. Siç ka vendosur GJED në shumë raste të tjera, përjashtimi në parim i mundësisë së individit që të mbështetet në këto direktiva është në kundërshtim me karakterin e detyrueshëm të direktivave, të sanksionuar në nenin 249 të Traktatit të KEE. Kjo vlen veçanërisht në rastet e direktivave që synojnë kontrollin dhe reduktimin e ndotjes atmosferike, të hartuara me qëllim mbrojtjen e shëndetit publik.⁷⁶

Gjykatat kombëtare të vendeve anëtare janë në fakt ato që interpretojnë gjatë veprimtarisë së tyre të përditshme *acquis communautaire*, përfshirë *acquis* mjedisore, së bashku me GJED, e cila garanton zbatimin në mënyrë të njëjtë të legjislacionit të BE dhe shmang mundësinë e interpretimeve të ndryshme apo të kundërta, prej gjykatave kombëtare. Këto të fundit mund t'ia referojnë çështjet GJED për interpretim të *acquis*, ku ajo vendos edhe nëse legjislacioni i atij vendi është në përputhje me *acquis communautaire*, apo jo. Nëpërmjet një kërkesë për një vendim paraprak, gjykatat kombëtare mund të kërkojnë edhe vlerësimin e vlefshmërisë së një akti ligjor të vetë BE. Në këto raste, vendimi i GJED nuk është thjesht një përgjigje që u jepet

⁷⁵ Përbërja dhe funksionimi i GJED, procedura që ndiqet dhe të gjitha vendimet e saj, përfshirë ato mjedisore, gjenden në: http://curia.europa.eu/jcms/jcms/Jo2_9089/?hlText=environment

⁷⁶ Vendimi i GJED Nr. 106/89, datë 13.11.1990. Gjendet në: http://eur-lex.europa.eu/resource.html?uri=cellar:384f064c-f467-4dda-a3cb-a44d930a6e25.0002.06/DOC_1&format=PDF

gjykatave kombëtare nëpërmjet një opinioni, por jepet në formën e një vendimi plotësisht të arsyetuar, i cili është i detyrueshëm për t'u ndjekur nga gjykata kombëtare në dhënien e vendimit për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së paraqitur para saj. Vendimi vlen jo vetëm për gjykatën që e ka kërkuar atë, por edhe për të gjitha gjykatat e tjera kombëtare të vendeve anëtare të BE, të cilat shqyrtojnë mosmarrëveshje që kanë të njëjtin objekt. Pikërisht nëpërmjet këtyre kërkesave për vendime paraprake, çdo shtetas i një vendi anëtar të BE-së mund të kërkojë interpretimin dhe sqarimin e normave që kanë ndikim tek ai. Pavarësisht faktit që një kërkesë e tillë GJED mund t'i drejtohet vetëm prej një gjykate kombëtare, të gjitha palët e një çështjeje, së bashku me shtetet anëtare dhe institucionet e BE mund të marrin pjesë në gjykimin para GJED. Pikërisht nëpërmjet këtyre vendimeve, shumë parime të *acquis communautaire*, përfshirë ato të së drejtës mjedisore, janë interpretuar prej GJED.⁷⁷

Roli i gjykatave në mbrojtjen e mjedisit është kaq i rëndësishëm, sa që madje mund të shkojë deri atje sa të zgjerojë edhe sferën e veprimit në hapësirë të vetë normave juridike. Në çështjen *Komisioni kundër Mbretërisë së Bashkuar*, GJED theksoi se "...palët bien dakord që Mbretëria e Bashkuar ushtron të drejta sovraane në Zonën Ekonomike Ekskluzive dhe në Shelfin Kontinental të saj dhe që Direktiva e Habitaveve [Direktiva 92/43/EE, për Mbrojtjen e Habitaveve Natyrore dhe të Faunës dhe Florës së Egër – shënimi im] është e zbatueshme përtej ujërave territoriale të Shteteve Anëtare. Prej kësaj, rrjedh që direktiva duhet të zbatohet në Zonën Ekonomike Ekskluzive."⁷⁸ Pikërisht për këto arsye, një pjesë e mirë e analizës së bërë në kuadër të këtij punimi është mbështetur në vendimet e dhëna nga gjykatat e ndryshme ndërkombëtare, por më së shumti në vendimet e GJED dhe GJEDNJ, siç u sqarua edhe më sipër, në pjesën e metodologjisë.

Në kushtet e një raporti të tillë të *acquis communautaire* me të drejtën e brendshme të vendeve anëtare të BE, duke qenë se për vite me radhë objektivi kryesor i politikës së jashtme të Republikës së Shqipërisë është anëtarësimi në BE dhe në funksion të të gjithë procesit të integritimit evropian, i njëjti raport duhet të ekzistojë edhe midis *acquis communautaire* dhe të drejtës së brendshme shqiptare. Aktualisht, Republika e Shqipërisë ka statusin e vendit kandidat për anëtarësim në BE, e në këtë stad të integritimit, një dokument themelor është Marrëveshja e Stabilizim Asociimit (MSA), e nënshkruar në 12 qershor 2006 dhe që ka hyrë në fuqi në 1 prill 2009.

Baza kushtetuese për anëtarësimin e Shqipërisë në BE gjendet në nenet 122§3 dhe 123 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të cilët parashikojnë epërsinë e normave të nxjerra prej një organizate ndërkombëtare mbi të drejtën e vendit në rast konflikti, si edhe delegimin e kompetencave shtetërore për çështje të caktuara organizatave ndërkombëtare, në bazë të marrëveshjeve të lidhura me to.⁷⁹ Pavarësisht mendimeve më të hershme për një status të

⁷⁷ http://curia.europa.eu/jcms/jcms/Jo2_9089/?hlText=environment

⁷⁸ Vendimi i GJED Nr. 6/04, datë 20.10.2005. Gjendet në:
<http://curia.europa.eu/juris/showPdf.jsf?text=&docid=60655&pageIndex=0&doclang=EN&mode=lst&dir=&occ=first&part=1&cid=2836>

⁷⁹ Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë gjendet në:
http://www.parlament.al/web/Kushtetuta_e_Republikes_se_Shqiperise_e_perditesuar_1150_1.php

papërcaktuar të BE,⁸⁰ këto dispozita të marra së bashku i japin BE kuptimin e një organizate më të lartë.⁸¹

Detyrimet e marra përsipër në kuadrin e MSA në fushën e mjedisit janë përcaktuar në nenin 108 të saj, ku palët marrin përsipër të zhvillojnë dhe forcojnë bashkëpunimin në detyrën shumë të rëndësishme të luftës kundër degradimit mjedisor, me synim promovimin e qëndrueshmërisë mjedisore. Bashkëpunimi përqendrohet kryesisht në fushat prioritare që lidhen me *acquis communautaire* për fushën e mjedisit. Përafrimi i legjislacionit mjedisor shqiptar me atë të BE është pjesë e planit kombëtar (PKZMSA) të hartuar për këtë qëllim.⁸²

Të gjitha qeveritë shqiptare e kanë prioritet absolut përafrimin e legjislacionit shqiptar me atë të *acquis communautaire* dhe zbatimin e tij me efektivitet. Vendi ynë duhet të përpiqet që të sigurojë që ligjet ekzistuese dhe legjislacioni i ardhshëm të shkojnë gradualisht drejt përputhjes me *acquis communautaire*.

Është me rëndësi të theksohet që “përafrim” nuk do të thotë thjesht “kopjim dhe përkthim” i legjislacionit të BE, por hartimi i një kuadri të plotë ligjor dhe garantimi i zbatimit në praktikë. Për sa i përket aspektit të parë, sipas nenit 70 të MSA, përafrimi i legjislacionit do të bëhet në dy faza. Në fazën e parë tranzitore prej 10 vjetësh, legjislacioni duhet të përafrohet në fushat kryesore: tregun e përbashkët, konkurrencën, tregtinë, prokurimet publike, pronësinë intelektuale, si edhe standardizimin dhe certifikimin e produkteve. Ndërsa faza e dytë duhet të vazhdojë me fushat e tjera.

Sigurisht që edhe hartimi i një kuadri të plotë ligjor, në përputhje me *acquis communautaire*, nuk sjell në vetvete si rezultat garantimin e mbrojtjes së mjedisit, nëse ai nuk zbatohet me rigorozitet. Aq më tepër kur edhe vetë vendet e BE kanë probleme me zbatimin e legjislacionit mjedisor. Sfidat e vetë BE për zbatimin e këtij legjislacioni kanë të bëjnë në radhë të parë me faktin që ai është shumë i gjerë dhe i larmishëm, përfshin çështje që kanë të bëjnë me ndryshimet klimatike, mbrojtjen e ajrit, tokës, ujit, biodiversitetit, e deri në menaxhimin e kimikateve dhe të mbetjeve. Po ashtu, *acquis* mjedisore përfshin edhe një larmishmëri teknikash, duke filluar që nga ato për garantimin e standardeve të produkteve, për arritjen e objektivave mjedisore, për vendosjen e kufizimeve dhe ndalimeve, për përdorimin e instrumenteve ekonomikë, për përcaktimin e zonave delikate që kërkojnë nivel më të lartë mbrojtjeje, për vlerësimin e planeve dhe programeve që kanë ndikim në mjedis, e deri tek ato për garantimin e pjesëmarrjes së publikut në vendimmarrje dhe dhënien e informacioneve mjedisore. Më tej, *acquis* mjedisore duhet edhe të zbatohet në një larmishmëri kushtesh e mjedisesh natyrore, po aq të larmishme sa bota që na rrethon, duke filluar që me larmishmërinë e rajoneve të ndryshme kombëtare e rajonale, ndarjeve të ndryshme administrative, e deri tek rajonet që fusin në lojë edhe aspekte të marrëdhënieve ndërshtetërore. Përveç këtyre aspekteve, zbatimi i *acquis* mjedisore komplikohet akoma më tepër po të marrim parasysh edhe faktin që në të përfshihen çështje për të cilat publiku është shumë i ndjeshëm dhe përherë i gatshëm që të vërë në lëvizje mekanizmat që ka në dispozicion për të sfiduar

⁸⁰ Alfred Kellermann, “Impakti i anëtarësimit në BE në rendin e brendshëm ligjor të Republikës së Shqipërisë”, botuar në revistën “E drejta parlamentare dhe politikat ligjore”, nr.1, 2007.

⁸¹ Luan Omari, Aurela Anastasi, “E drejta kushtetuese”, Shtëpia Botuese ABC, Tiranë, 2010, fq. 61.

⁸² Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit dhe PKZMSA, gjenden në <http://www.integrimi.gov.al/al/dokumenta/dokumente-strategjike>

vendimmarrjen e autoriteteve, duke përdorur ankimin administrativ dhe atë gjyqësor. Këtyre u shtohen edhe sfidat që kanë të bëjnë me mungesën e vëmendjes së mjaftueshme nga ana e autoriteteve kombëtare për respektimin e afateve të caktuara prej *acquis* mjedisore, mungesa e njohurive dhe kapaciteteve në administratat publike kombëtare, mangësitë në aftësitë e organeve ligjzbatuese kombëtare, si edhe mungesa e investimeve në infrastrukturën që garanton ndalimin e ndotjes dhe mbrojtjen e mjedisit. Së fundmi, por jo për nga rëndësia, janë edhe sfidat që burojnë prej zgjerimit të vazhdueshëm të BE me vende të tjera, ku përfshihen edhe vende që vijnë nga sisteme të dikurshme totalitare, me mendësi e kapacitete krejt të ndryshme nga ato të vendeve anëtare.⁸³

Legjislacioni mjedisor i BE adoptohet nga shtetet anëtare (e për analogji, edhe në atë të vendeve kandidatë për anëtarësim) pothuajse në mënyrë ekskluzive, nëpërmjet direktivave. Në këto kushte, këto rregulla nuk u drejtohen në mënyrë të drejtpërdrejtë subjekteve juridike, por ato u drejtohen shteteve anëtare në formën e “kërkesave” për të harmonizuar legjislacionin e tyre, çka si rrjedhojë, detyron subjektet të sillen në përputhje me normat e brendshme të harmonizuara.⁸⁴ Sipas Programit të Gjashtë të Veprimit Mjedisor të Komunitetit të vitit 2007, legjislacioni i BE qëndron pas rreth 80% të legjislacionit mjedisor kombëtar.⁸⁵

Në lidhje me rolin e direktivave në të drejtën e brendshme shqiptare, Gjykata e Lartë është shprehur në vendimin e Kolegjit Civil, Nr. 22, datë 19.1.2011: *“Pavarësisht se vendi ynë ende nuk është bërë anëtar i Bashkimit Evropian me të drejta të plota, direktivat (rregulloret) e miratuara prej tyre janë udhërrëfyese në praktikën tonë ligjore.”* Po ashtu, në një vendim tjetër të Gjykatës së Lartë, përmendet se Shqipëria do të sigurojë që legjislacioni ekzistues dhe i ardhshëm do të zbatohet dhe të imponohet siç duhet (neni 70 i Marrëveshjes të Stabilizim-Asocimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komuniteteve Evropiane e Shteteve të Tyre Anëtare, ratifikuar me Ligjin nr. 9590, datë 27.07.2006), siç është konfirmuar edhe në qëndrimin e palëkundur të mbajtur edhe nga gjyqësori shqiptar.⁸⁶

Është shumë pozitiv fakti që gjyqësori shqiptar i referohet që tani legjislacionit evropian, edhe për çështje që kanë të bëjnë me aspekte procedurale. Kështu, në vendimin e Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, Nr. 2, datë 27.3.2012, në lidhje me afatet, ajo u shpreh: *“Të njëjtin qëndrim mban edhe Rregullorja (EEC Euratom) nr.1182/71 e Këshillit e datës 03.06.1971, që përcakton normat e aplikueshme për periudhat kohore, datat dhe afatet, të cilat zbatohen për aktet e Këshillit ose Komisionit, të miratuar apo për t’u miratuar në bazë të Traktatit që krijon Komunitetin Ekonomik Evropian apo të Traktatit që krijon Komunitetin Evropian të Energjisë Atomike.”*

Por në dallim nga gjykatat kombëtare, të cilat veprojnë në një kuadër më të ngushtë e në një mjedis ligjor pak a shumë homogjen dhe ku mbizotëron një kulturë ligjore unike, GJED i duhet të marrë përsipër rolin e një interpretuesi të një kulture ligjore heterogjene, pasi vendimet e saj,

⁸³ Komunikim i Komisionit me Parlamentin Evropian, Këshillin, Komitetin Evropian Ekonomik dhe Social dhe Komitetin e Rajoneve, mbi Zbatimin e së Drejtës Komunitare Evropiane Mjedisore, COM (2008), fq. 2.

⁸⁴ Ludwig Krämer, *“EC Environmental Law”*, London, Thomson-Sweet&Maxwell, 2007, fq. 65.

⁸⁵ Komunikim i Komisionit me Parlamentin Evropian, Këshillin, Komitetin Evropian Ekonomik dhe Social dhe Komitetin e Rajoneve, mbi Rishikimin e Ndërmjetëm të Programit të Gjashtë të Veprimit Mjedisor të Komunitetit, COM (2007), fq. 3.

⁸⁶ Vendimi Unifikues Nr. 1, datë 17.1.2011, i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, fq.13.

përfshirë ato që kanë të bëjnë me mbrojtjen e mjedisit, jepen në një kontekst në të cilin bashkëjetojnë kultura të ndryshme ligjore.⁸⁷

Për sa më sipër, merr një rëndësi të veçantë zbatimi i MSA dhe përafrimi i legjislacionit mjedisor shqiptar me *acquis communautaire*, çka do të sjellë edhe respektimin e parimeve të rëndësishme mjedisore, që janë bërë pjesë e saj.

2.3 Parimet kryesore të mbrojtjes së mjedisit në të drejtën ndërkombëtare.

Arsyeja se përse parimeve mjedisore u është kushtuar një pjesë e veçantë e një kapitulli të tërë në këtë punim qëndron në faktin se në fushën e së drejtës së mjedisit parimet kanë një rol akoma më të rëndësishëm krahasuar me fushat e tjera, për shkak se është tepër e vështirë të arrish në rregulla të prera, të detyrueshme për zbatim, sidomos në planin ndërkombëtar. Prandaj rruga e ndjekur deri tani dhe që ka rezultuar të jetë pozitive, ka qenë formulimi i parimeve të përgjithshme, fillimisht nisur me Deklaratën e Stokholmit të vitit 1972, për të arritur më pas tek adoptimi i normave ligjore në marrëveshjet e shumta ndërkombëtare që kanë pasuar.

Ashtu si parimet e së drejtës ndërkombëtare në përgjithësi, edhe parimet kryesore të mbrojtjes ndërkombëtare të mjedisit (parimet mjedisore) kanë ardhur duke u zhvilluar gradualisht, përgjatë praktikës së marrëdhënieve midis shteteve. Këto parime përbëjnë atë që në kuptim të së drejtës ndërkombëtare janë quajtur ‘e drejta e butë’,⁸⁸ për shkak se janë gjykuar si mjete më i mirë për arritjen e rezultateve të dëshirueshme në fushën e mbrojtjes së mjedisit. Edhe forma e sanksionimit të tyre në marrëveshjet e ndryshme ndërkombëtare është nga më të larmishmet, duke filluar që prej formulimeve shumë të përgjithshme, siç është për shembull parimi i zhvillimit të qëndrueshëm, që do të analizohet me hollësi në vijim, e deri tek parimi “më i ulëti që mund të arrihet në mënyrë të arsyeshme” (ALARA),⁸⁹ që është një parim sigurie që zbatohet në fushën e sigurisë së rrezatimeve radioaktive për t’i ulur ato në nivelin më të ulët të mundshëm dhe që nuk mbetet thjesht në kuadrin e një formulimi të përgjithshëm, por merr formën e rregulloreve të detyrueshme për zbatim në të gjitha programet e sigurisë së rrezatimeve radioaktive. Po ashtu, ato variojnë që prej parimeve që janë të kufizuara në zbatimin në një fushë të veçantë të së drejtës mjedisore, p.sh. parimi i trajtimit sa më të afërt dhe me efikasitet në fushën e menaxhimit të mbetjeve, e deri tek parimet që zbatohen përgjatë gjithë spektrit, në të gjitha fushat e mjedisit, p.sh. parimi i parandalimit dhe i marrjes së masave paraprake,⁹⁰ i cili do të trajtohet gjithashtu me hollësi në vijim.

Rëndësia e parimeve mjedisore buron prej disa drejtimeve. Së pari, normat e së drejtës mjedisore janë relativisht të reja në krahasim me ato të degëve të tjera të së drejtës, kështu që kjo bën të domosdoshme ekzistencën e këtyre parimeve orientuese. Së dyti, ato gradualisht shkojnë drejt caktimit të detyrimeve për autoritetet publike duke u imponuar atyre një mënyrë sjelljeje të

⁸⁷ *Supra.*, shënimi fundor nr. 84, fq. 51.

⁸⁸ Anglisht: *soft law*

⁸⁹ ALARA, anglisht: ‘As Low As Reasonably Achievable’ – ‘Më i Ulëti që Mund të Arrihet në Mënyrë të Arsyeshme’.

⁹⁰ Nicolas de Sadeleer, “*Environmental Principles. From Political Slogans to Legal Rules*”, Oxford University Press, 2002, fq. 2.

caktuar dhe ndjekjen e metodave të punës që sigurojnë mbrojtjen maksimale të mjedisit, duke realizuar në fund të fundit të drejtën e njeriut për një mjedis të shëndetshëm. Së treti, për shkak të vetë natyrës së saj, ndryshimeve të vazhdueshme dhe llojeve të dëmeve që mund t'i shkaktohen mjedisit, po ashtu edhe zgjidhjet që mund t'i jepen problemeve të ndryshme janë përherë të ndryshueshme, prandaj kjo degë e së drejtës është në ndryshim të vazhdueshëm e nxjerrja e normave respektive nuk mund të konsiderohet asnjëherë si e ezauruar. Së katërti, zgjerimi i fushës së zbatimit të normave mjedisore është i vazhdueshëm, pasi pothuajse çdo aktivitet i përditshëm njerëzor ka ndikimin e vet në mjedis. Këto karakteristika e bëjnë të domosdoshme hartimin e një baze konceptuale, mbi të cilën duhet të ngrihen normat.⁹¹

Për më tepër, duhet theksuar se parimet nuk mbeten thjesht në kuadrin e pohimeve të përgjithshme me karakter teorik apo me vlera të përgjithshme orientuese. Përderisa ato janë të përfshira në tekstet e traktateve që sjellin si të drejta, ashtu edhe detyrime për palët, qofshin këto shtete apo apo organizata ndërkombëtare, siç është rasti i BE, tregon që ndjekja dhe zbatimi i tyre janë të detyrueshme.⁹² Traktati i Komunitetit Evropian (KE) përmbante një Titull të veçantë, Titullin VI, ku në nenin 174 (shndërruar në nenin 130r të Traktatit të BE me Traktatin e Maastrichtit, në vitin 1993), thuhej se politika komunitare do të kontribuojë në ndjekjen e objektivave të ruajtjes, mbrojtjes dhe përmirësimit të cilësisë së mjedisit, shëndetit të njeriut, përdorimin e matur dhe racional të burimeve natyrore...duke synuar një nivel të lartë të mbrojtjes...bazuar në parimin e parandalimit dhe të marrjes së masave paraprake, ndërsa dëmi mjedisor duhet që si prioritet të riparohet në burim dhe ndotësi duhet të paguajë.⁹³

Akti Unik Evropian i vitit 1987 ishte dokumenti i parë që përmbante mbrojtjen e mjedisit nën një titull të veçantë, nenet 130r–130t. Ky moment konsiderohet si i rëndësishëm së veçantë, për shkak se ofroi bazën ligjore për masat që duheshin marrë për mbrojtjen e mjedisit në nivel komunitar, duke përcaktuar objektivat dhe parimet orientuese, si edhe duke caktuar shumicën e cilësuar si të domosdoshme për miratimin e propozimeve që kishin të bënin me mjedisin. Mbrojtja e mjedisit tashmë përcaktohej si komponent i të gjitha politikave të tjera komunitare.⁹⁴

Neni 191 i Traktatit të Funkcionimit të BE (TFBE) (ish-neni 174 i Traktatit të Komunitetit Evropian [TKE]), ka përcaktuar se politika e BE për mjedisin kontribuon në arritjen e objektivave të tillë si: ruajtja, mbrojtja dhe përmirësimi i cilësisë së mjedisit, mbrojtja e shëndetit të njeriut, shfrytëzimi i kujdesshëm dhe racional i burimeve natyrore, promovimi i masave në nivel ndërkombëtar për të trajtuar problemet mjedisore rajonale ose botërore, dhe në veçanti për të luftuar ndryshimet klimatike. Për të realizuar këto objektiva dhe arritjen e një niveli të lartë mbrojtjeje të mjedisit, paragrafi i dytë vazhdon me parimet që ndjek BE, duke mbajtur parasysh larminë e situatave në rajonet e ndryshme të BE, duke u mbështetur në parimin e marrjes së masave parandaluese, që dëmi ndaj mjedisit si përparësi duhet ndrequr në burim dhe që ndotësi duhet të paguajë.⁹⁵

⁹¹ Gyula Bándi, (red.), “*The Impact of ECJ Jurisprudence on Environmental Law*”, Akaprint Kft, 2009, fq. 24.

⁹² *Ibid.*, fq. 25.

⁹³ Gjendet në: <http://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=CELEX:12002E174:EN:HTML>

⁹⁴ Akti Unik Evropian gjendet në: <http://www.eurotreaties.com/singleeuropeanact.pdf>

⁹⁵ Traktatet e BE gjenden në: http://europa.eu/about-eu/basic-information/decision-making/treaties/index_en.htm

Po ashtu, në TFBE përmendet që BE ka kompetencë të përbashkët me shtetet anëtare në fushën e mjedisit dhe se kërkesat për mbrojtjen e mjedisit duhet të integrohen në përcaktimin dhe zbatimin e politikave dhe aktiviteteve të Bashkimit, sidomos me synim nxitjen e zhvillimit të qëndrueshëm.⁹⁶ Në pjesën që përshkruan funksionet e Komisionit, ndër të tjera përcaktohet se “...Komisioni, në propozimet tij të parashikuara lidhur me shëndetin, sigurinë, mbrojtjen e mjedisit dhe mbrojtjen e konsumatorëve, merr për bazë një nivel të lartë mbrojtjeje, duke marrë në konsideratë, në veçanti, çdo zhvillim të ri të mbështetur në fakte shkencore.”⁹⁷ Më tej, i gjithë Titulli XX i dedikohet mjedisit, ku neni 191 ripërsërit objektivat dhe parimet e cituar më sipër, por thekson që masat e harmonizimit që u përgjigjen kërkesave për mbrojtjen e mjedisit përfshijnë, sipas rastit, një klauzolë për masat mbrojtëse që u lejon shteteve anëtare të marrin masa të përkohshme, për arsye mjedisore jo-ekonomike, në varësi të një procedure kontrolli nga Bashkimi. Gjatë përgatitjes së politikës së tij për mjedisin, Bashkimi merr në konsideratë të dhënat shkencore dhe teknike të disponueshme, kushtet mjedisore në rajonet e ndryshme të Bashkimit, përfitimet dhe kostot e mundshme të veprimit ose mungesës së veprimit, zhvillimin ekonomik dhe social të Bashkimit në tërësi dhe zhvillimin e drejtpeshuar të rajoneve të tij. Brenda sferave përkatëse të kompetencës, Bashkimi dhe Shtetet Anëtare bashkëpunojnë me vendet e treta dhe me organizatat kompetente ndërkombëtare. Organizimi i bashkëpunimit të Bashkimit mund të jetë objekt i marrëveshjeve midis Bashkimit dhe palëve të treta të interesuara, por edhe shtetet anëtare ruajnë kompetencën për të negociuar në kuadër të mekanizmave ndërkombëtarë dhe për të lidhur marrëveshje ndërkombëtare.⁹⁸

Ndërsa në Traktatin e Lisbonës, që në preambul sanksionohet se shtetet palë, “të vendosur për të nxitur përparimin ekonomik dhe shoqëror për popujt e tyre, duke mbajtur parasysh *parimin e zhvillimit të qëndrueshëm* dhe brenda kuadrit të arritjes së tregut të brendshëm të kohezionit të përforcuar dhe *mbrojtjes së mjedisit* [theksimi im]...”, do të punojnë për “... përparimin shoqëror si dhe një nivel të lartë mbrojtjeje dhe përmirësimi të cilësisë së mjedisit...të ndihmojë përgatitjen e masave ndërkombëtare për ruajtjen dhe përmirësimin e cilësisë së mjedisit dhe administrimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore botërore, në mënyrë që të sigurohet zhvillimi i qëndrueshëm.”⁹⁹

Edhe Karta e të Drejtave Themelore të Njeriut e BE, në nenin 37 sanksionon se një nivel i lartë i mbrojtjes mjedisore si edhe përmirësimi i cilësisë së mjedisit duhet të integrohen në politikat e Bashkimit si dhe të garantohen në përputhje me parimin e zhvillimit të qëndrueshëm.

Përveç dispozitave të traktateve, një rol të jashtëzakonshëm për njohjen e parimeve mjedisore si parime ligjore ka luajtur GJED nëpërmjet vendimeve të saj, duke mundësuar përfshirjen dhe integrimin e kërkesave për mbrojtjen e mjedisit në politikat e tjera të BE. Një rol i tillë i pamohueshëm është vlerësuar pa dyshim edhe në qarqet akademike, deri në atë pikë sa disa autorë e kanë quajtur GJED një “tribunal mjedisor”.¹⁰⁰

⁹⁶ Traktati për Funkcionimin e Bashkimit Evropian, neni 4§e, neni 11.

⁹⁷ *Ibid.*, neni 114.

⁹⁸ *Ibid.*, neni 191.

⁹⁹ Traktati i Lisbonës, neni 3§3 dhe neni 21§2§f.

¹⁰⁰ Philippe Sands, “*The European Court of Justice: An Environmental Tribunal?*”, në Han Somsen (red.), “*Protecting the European Environment: Enforcing EC Environmental Law*”, London, Blackstone, 1996, 23-35.

Jo më pak i rëndësishëm është edhe roli i parimeve mjedisore si balancues të interesave, një aspekt shumë i rëndësishëm i së drejtës bashkëkohore, duke ndihmuar kështu gjykatat të kuptojnë dhe interpretojnë vlerat specifike të rregullimeve të hartuara për mbrojtjen e mjedisit.¹⁰¹

Për sa i përket reflektimit të parimeve të mbrojtjes së mjedisit në legjislacionin shqiptar, mund të thuhet që procesi është ende në fazën fillestare. Siç u përmend që në hyrje të këtij punimi, vetë etimologjia e termit ‘mjedis’ në gjuhën shqipe është interpretuar se rrjedh prej fjalës ‘midis’, që do të thotë ‘ajo çka ndodhet midis njerëzve’, prandaj edhe synimi i të gjithë parimeve dhe kuadrit ligjor shqiptar për mjedisin duhet të jetë krijimi i një raporti të drejtë e të qëndrueshëm të njeriut me mjedisin që e rrethon.¹⁰²

Si dokument që përcakton edhe të drejtat themelore të njeriut, Kushtetuta e Shqipërisë sanksionon që shteti, brenda kompetencave kushtetuese dhe mjeteve që disponon, si dhe në përmbushje të nismës dhe të përgjegjësisë private, synon, ndër të tjera, një mjedis të shëndetshëm dhe ekologjikisht të përshtatshëm për brezat e sotëm dhe të ardhshëm.¹⁰³ Ky është një miratim i parimit të zhvillimit dhe përdorimit të burimeve natyrore, pa i dëmtuar mundësitë dhe nevojat e brezave të ardhshëm, si alternativë e vetme për të ardhmen në lidhje me mjedisin. Përveç kësaj, duke pasur parasysh se ishte duke u hartuar në të njëjtën kohë me Konventën e Aarhusit, Kushtetuta gjithashtu miratoi parimin themelor të së drejtës së publikut për të marrë informacion që lidhet me mjedisin dhe mbrojtjen e tij.¹⁰⁴

Pas miratimit të Kushtetutës shqiptare, u miratua një kuadër i gjerë ligjor për mjedisin, i përbërë nga ligjet dhe aktet nënligjore, të cilat synojnë të mbrojnë mjedisin nga ndotja dhe dëmtimi, si dhe miratimin e masave parandaluese dhe rehabilituese. Ndër këto, një nga më të rëndësishmit është ligji nr.10431, datë 9.6.2011, “Për mbrojtjen e mjedisit”, i ndryshuar, i cili synon rregullimin e marrëdhënieve mes njerëzve dhe mjedisit, mbrojtjen e përbërësve të mjedisit dhe proceset mjedisore, sigurimin e kushteve materiale për zhvillimin e qëndrueshëm, duke kompletuar kornizën që është e nevojshme për të përmbushur kërkesat kushtetuese për një mjedis ekologjikisht të pastër. Ai mishëron parimet kryesore që duhet të merren në konsideratë nga politikat e mjedisit, të tilla si: parimi i zhvillimit të qëndrueshëm, parimi i parandalimit dhe marrjes së masave paraprake, parimi i ruajtjes së burimeve natyrore, parimi i zëvendësimit dhe/ose kompensimit, parimi i qasjes së integruar, parimi i përgjegjësisë së ndërsjellë dhe bashkëpunimit, parimi “Ndotësi paguan”, parimi i së drejtës për informim dhe i pjesëmarrjes së publikut në vendimmarrjen mjedisore dhe parimi i nxitjes së veprimtarive për mbrojtjen e mjedisit.¹⁰⁵

Siç u theksua më lart, në kuadrin e përpjekjeve të Shqipërisë në rrugën e saj drejt integritit evropian, kuadri ligjor shqiptar në përgjithësi është i harmonizuar me legjislacionin përkatës të BE, pasi ai mbështetet në të njëjtat parime që mbështetet legjislacioni mjedisor evropian, ai ka

¹⁰¹ Nicolas De Sadeleer, “*Environmental Principles, Modern and Post-modern Law.*” Në Richard Macrory (red.), “*Principles of European Environmental Law*”, Groningen, Europa Law Publishing, 2004, fq. 232.

¹⁰² Romeo Hanxhari, “*Politikat e Mjedisit. Niveli global dhe niveli lokal. Analizë teorike dhe raste studimi*”, Intergrafika, 2011, fq. 8.

¹⁰³ Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, Neni 59.

¹⁰⁴ *Ibid.*, Neni 56.

¹⁰⁵ Ligji Nr.10431, datë 9.6.2011, “Për mbrojtjen e mjedisit”, i ndryshuar, nenet 6-14.

qenë hartuar me ndihmën e ekspertëve të huaj dhe në përgjithësi reflekton detyrimet e marra përsipër në kuadër të konventave ndërkombëtare në të cilat Shqipëria është palë.

Nxitja e bashkëpunimit midis shteteve nëpërmjet normave të ‘së drejtës së butë’, të përcjella me ndihmën e parimeve mjedisore, konsiderohen si më efektive për arritjen e qëllimit përfundimtar, mbrojtjen e mjedisit, sesa vendosja e rregullave detyruese apo marrja e masave ndëshkuese ndaj shkelësve të këtyre normave. Bashkëpunimi dhe bashkërendimi kanë fituar përparësi ndaj sanksionimit dhe ndëshkimit, prandaj është e rëndësishme të analizohen disa prej parimeve kryesore mjedisore.

2.3.1 Parimi i zhvillimit të qëndrueshëm.

Siç u përmend më sipër, Deklarata e Stokholmit e vitit 1972 e ka formuluar parimin e zhvillimit të qëndrueshëm, por pa e përkufizuar atë, në Parimin 1 të saj: “Njeriu ka të drejtën themelore të lirisë, barazisë dhe kushteve të përshatshme të jetesës, në një mjedis të një cilësie të tillë që i mundëson një jetesë dinjitoze dhe në mirëqenie, dhe ai ka një përgjegjësi solemne për të mbrojtur dhe përmirësuar mjedisin **për brezat e sotëm e të ardhshëm** [thexsimi im].” Parimi i dytë po ashtu e rikthekson detyrimin e shoqërisë ndaj brezave të ardhshëm dhe deklaron se burimet natyrore të Tokës, përfshirë ajrin, ujin, florën dhe faunën, duhet të ruhen për të mirën e brezave të sotëm e të ardhshëm, nëpërmjet planifikimit dhe menaxhimit të kujdesshëm.¹⁰⁶

Ndërsa përkufizimi i parimit të zhvillimit të qëndrueshëm, u dha për herë të parë në vitin 1980 nga Komisioni Brundtland në raportin e tij të titulluar “E ardhmja jonë e përbashkët”, i cili e përkufizoi zhvillimin e qëndrueshëm si zhvillim që plotëson nevojat e tashme, pa cënuar mundësitë e brezave të ardhshëm që të plotësojnë nevojat e tyre. Që në emërtim, ky parim mishëron lidhjen e ngushtë midis zhvillimit (i cili përfshin zhvillimin ekonomik dhe zhvillimin social) dhe mbrojtjes së mjedisit, ku zhvillimi është qartazi njëri nga komponentët e këtij parimi, ndërsa mbrojtja e mjedisit del prej vetë konceptit të qëndrueshmërisë, që nënkupton mbrojtjen e mjedisit të sotëm, në mënyrë që ai të jetë i qëndrueshëm për të siguruar vazhdimësinë e jetës edhe në të ardhmen. Me fjalë të tjera, ky është një parim që synon ruajtjen e një ekuilibri midis nevojës për zhvillim të vendeve të ndryshme dhe aftësive të shterueshme të planetit ku jetojmë, që të mund të ofrojë sigurimin e ushqimit dhe sistemet mbështetëse të jetesës për të gjithë njerëzimin dhe gjallesat e tjera, e ndërkohë të jetë në gjendje të përthithë të gjitha mbetjet që hidhen në të, si rrjedhojë e aktivitetit njerëzor jashtëzakonisht intensiv.

Nga sa shihet prej terminologjisë së përmendur në lidhje me zhvillimin e qëndrueshëm, nuk arrihet dot në një konkluzion të prerë për thelbin e përmbajtjes së tij, por ndoshta është pikërisht kjo ‘paqartësi’ e një koncepti të tillë integrues që në vend që të përbëjë një disavantazh, në fakt, ka shërbyer pikërisht për të kundërtën, të pranohet gjerësisht nga i gjithë komuniteti ndërkombëtar.¹⁰⁷

¹⁰⁶ *Supra.*, shënimi fundor 28.

¹⁰⁷ Bruno Simma, ‘Forewords’, në Nico Schrijver dhe Friedl Weiss (red.), “*International Law and Sustainable Development: Principles and Practice*”, Leiden: Martinus Nijhoff, 2004, fq. vi.

Në fakt, koncepti i zhvillimit të qëndrueshëm mbart në vetvete një kontradiktë: nga njëra anë, përmban synimin për zhvillim ekonomik dhe social, çka nënkupton edhe investime dhe vepra infrastrukturore që kanë patjetër ndikim në mjedis dhe nga ana tjetër, përfshin marrjen e masave për të mbrojtur mjedisin nga investimet që e dëmtojnë atë. Raste tipike janë ndërtimi i komplekseve industriale prodhuese ose përpunuese, apo centralet e prodhimit të energjisë. Vetë komunitetet pranë këtyre veprave përballen me efektet e dyfishta, si me nxjerrjen e përfitimeve prej investimeve të tilla, siç janë sigurimi i energjisë dhe punësimi, por edhe me pasojat mbi mjedisin përreth dhe mbi shëndetin e tyre. Rastet e fabrikave të çimentos në Fushë-Krujë dhe parku industrial në Vlorë ilustronjë qartë këto kontradikta.

Kontradikta midis zhvillimit ekonomik dhe mbrojtjes së mjedisit është më e mprehtë në vendet në zhvillim, pasi është e kuptueshme që rritja ekonomike përbën interes parësor për këto vende. Ato janë përherë më hezituese ndaj çdo traktati që përmban norma imponuese apo çfarëdolloj mase kufizuese për zhvillimin ekonomik të tyre, duke e quajtur të padrejtë vendosjen në të njëjtin nivel me vendet në zhvillim. Nga ana tjetër, debati zhvillohet edhe përbrenda vetë vendeve në zhvillim, të cilat janë etiketuar edhe si “*armiq të gëzuar të natyrës*”,¹⁰⁸ për shkak të dëshirës së pandalur për të rritur prodhimin kombëtar me çdo kusht.

Në konfliktin midis interesave ekonomike dhe interesave mjedisore, në shumicën dërrmuese të rasteve këto të fundit dalin të humbura. Formulimi i nenit 24§1 të kushtetutës greke është ilustrues në këtë drejtim: “*Mbrojtja e mjedisit natyror dhe kulturor është detyrë e shtetit. Shteti ka për detyrë të marrë masa të veçanta parandaluese ose ndëshkuese për ruajtjen e mjedisit. Çështjet që kanë të bëjnë me mbrojtjen e pyjeve dhe zonave pyjore në përgjithësi rregullohen me ligj. Ndryshimi i destinacionit të pyjeve shtetërorë dhe të zonave pyjore shtetërore është i ndaluar, përveç rasteve të zhvillimit të bujqësisë ose të rasteve të përdorimeve të tjera të interesit publik që **prevalojnë për ekonominë** [theksimi im] kombëtare.*”¹⁰⁹

Arsyeja kryesore e këtij “inferioriteti” është se mjedisi nuk ka një mbështetje të fuqishme pas vetes, ashtu siç bujqësia ka fermerët, peshkimi ka peshkatarët, arsimit ka mësuesit, transporti ka shoferët, e kështu me radhë.¹¹⁰ Në këto kushte, autoriteteve vendimmarrëse qendrore dhe vendore u bie barra të ndërmarrin politikën e duhura dhe kuadrin rregullator përkatës, për të garantuar ekuilibrat që mundësojnë zhvillimin e qëndrueshëm, pavarësisht vështirësive në vendosjen e këtyre ekuilibrave, sidomos në kushtet e vështirësive ekonomike siç është kriza aktuale, ku zhvillimi ekonomik është preokupimi kryesor i tyre.

Një vështirësi tjetër për zbatimin e këtij parimi ka të bëjë me mënyrën se si brezat e tashëm do të mund të përllorarisnin nevojat e brezave të ardhshëm dhe atë çka do të ishte e domosdoshme për përmbushjen e tyre. Në realitet, shfrytëzimi i cilitdo prej burimeve natyrore të sotëm zvogëlon atë çka mbetet për t’u shfrytëzuar në të ardhmen. Rrugëzgjdhja gjendet në përdorimin e atyre burimeve që janë të rinovueshme, si p.sh. energjia diellore, energjia e erës, etj, të cilat jo vetëm që janë të pashtershme (të paktën për të ardhmen e afërt), por edhe të pastra nga pikëpamja ekologjike.

¹⁰⁸ Wolfgang Sachs, “*The Development Dictionary*”, Zed Books, 1992, fq. 28.

¹⁰⁹ Kushtetuta e Greqisë gjendet në: <https://www.constituteproject.org/search?q=greece>

¹¹⁰ Ludwig Krämer, “*EU Environmental Law*”, 7th edition, Sweet & Maxwell, 2012, fq. v.

Në një takim me studentët e Universitetit të Molises, në Campobasso, në Italinë Jugore, në 5 korrik 2014, Papa Françesko u shpreh që një nga sfidat më të mëdha të njerëzimit është që ta shndërrojë veten në një lloj zhvillimi që di të respektojë krijimin, ndërsa e quajti ‘mëkat të kohëve moderne’ shfrytëzimin e Tokës pa e lejuar atë që të na japë atë ç’ka brenda saj.¹¹¹

Në thelb, zhvillimi i qëndrueshëm synon të garantojë vazhdimësinë e ‘stafetës’ midis brezave, që mishërohet në shprehjen e lashtë inuite të përmendur që në fillim të këtij punimi, “*Botën nuk e kemi trashëguar prej prindërve, por ua kemi marrë borxh fëmijëve*”. Në mënyrë shumë elokuate, koncepti i ‘barazisë midis brezave’ (i njohur ndryshe edhe si ‘drejtësia mjedisore’) është shtjelluar nga gjyqtari i GJND Weeramantry, në mendimin e tij paralel në çështjen e Ishujve Jan Mayen, *Danimarka kundër Norvegjisë*, të 14 qershorit 1993. Ai shprehet se “...parimi i harmonisë së njeriut me mjedisin përshkon të drejtën zakonore të aborigjinëve të Australisë dhe...nacionet e natyrës së shenjtë të burimeve të tokës dhe të harmonisë së aktivitetit njerëzor me mjedisin, respekti për të drejtat e brezave të ardhshëm dhe për kujdesja për burimet e tokës me një standard të tillë që pritet prej një kujdestari...janë parime të drejtësisë dhe barazisë...”¹¹²

Në të njëjtën mënyrë, gjyqtari Weeramantry u shpreh edhe në mendimin e tij të pakicës në Opinionin Këshillimor *Ligjshmëria e Kërcënimit apo Përdorimit të Armëve Bërthamore*, të 8 korrikut 1996, ku argumentonte se GJND, si organi kryesor gjyqësor i OKB kishte detyrën të njihte parimin e barazisë midis brezave, duke qenë se ky parim tashmë nuk ndodhej më në fazën e vet embrionale, por ishte mishëruar në shumë traktate mjedisore, si edhe në mendimet juridike. Ndër traktatet që përmbajnë dispozita ku është mishëruar ky parim përmenden Konventa për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore dhe Natyrore të Botës e vitit 1972, Konventa CITES e vitit 1973 dhe Konventa e Londrës kundër Hedhjes së Mbetjeve në Oqeanet e vitit 1979. Të gjitha këto konventa e kanë ngritur parimin e mbrojtjes së mjedisit për brezat e ardhshëm në nivelin e detyrimeve shtetërore, përveç detyrimeve që janë të sanksionuara në të drejtat e brendshme të vendeve që u përkasin sistemeve të ndryshme ligjore. Këtyre u shtohen edhe shumë deklarata ndërkombëtare që fillojnë me Deklaratën e Stokholmit të vitit 1972. Me tej, gjyqtari Weeramantry i referohet Kartës së OKB, idealet e së cilës “*nuk kufizohen vetëm në të tashmen, por shohin më tej, drejt promovimit të zhvillimit shoqëror dhe standardeve më të mira të jetesës dhe vizioni i tyre përfshin jo vetëm të tashmen, por edhe brezat e ardhshëm.*”¹¹³

Në lidhje me këtë parim, në vendimin e saj në çështjen *Projekti Gabčíkovo-Nagyymaros (Hungaria kundër Sllovakisë)*, të 25 shtatorit 1997, GJND u shpreh se “...Kjo nevojë për të balancuar nevojën për zhvillim ekonomik me mbrojtjen e mjedisit, shprehet në mënyrë të saktë në konceptin e zhvillimit të qëndrueshëm. Në rastin konkret, kjo do të thotë që palët duhet të rimarrin në konsideratë së bashku efektet mjedisore të projektit të Hidrocentralit Gabčíkovo. Në

¹¹¹ Philip Pullella, “*Pope calls exploitation of nature a sin of our time*”, Reuters, 5 korrik 2014. Gjetet në: <http://uk.reuters.com/article/2014/07/05/uk-pope-environment-idUKKBN0FA0BC20140705>

¹¹² Mendimi paralel i gjyqtarit Weeramantry në çështjen *Danimarka kundër Norvegjisë*, fq. 242. Gjetet në: <http://www.icj-cij.org/docket/files/78/6761.pdf>

¹¹³ Mendimi i pakicës i gjyqtarit Weeramantry në Mendimin Këshillimor *Ligjshmëria e Kërcënimit apo Përdorimit të Armëve Bërthamore*, fq. 455-456.

mënyrë të veçantë, ato duhet të gjejnë një zgjidhje të kënaqshme për volumin e ujit që duhet të lëshohet në shtratin e lumit Danub dhe në degët e tij paralele në të dyja anët e lumit.”¹¹⁴

Ndërsa në Evropë, neni 37 i Kartës së të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian vendos ndaj organizatës detyrimin për të integruar në politikat e saj një nivel të lartë të mbrojtjes së mjedisit dhe përmirësimit të cilësisë së mjedisit, në përputhje me parimin e zhvillimit të qëndrueshëm.¹¹⁵

Në Shqipëri, adoptimi gradual i parimit të zhvillimit të qëndrueshëm duket edhe në mënyrën se si ka evoluar formulimi i legjislacionit brenda të njëjtës fushë. Kështu, në objektin e ligjit nr. 8025, datë 9.11.1995 “Për mbrojtjen nga rrezatimet jonizuese”, thuhet që ligji synon “...përcaktimin e kushteve të mbrojtjes dhe të sigurisë nga rrezatimet jonizuese, për të gjitha veprimtaritë që kryhen me lëndë radioaktive dhe pajisje rrezatuese, me qëllim mbrojtjen e punonjësve të ekspozuar profesionalisht ndaj rrezatimeve, **të popullatës dhe mjedisit**, [theksimi im] në tërësi, nga rreziqet e mundshme të rrezatimeve...”, ndërsa në aktin nënligjor të nxjerrë në bazë dhe për zbatim të tij, pas 7 vitesh ndeshet një formulim i tillë në VKM Nr. 481, datë 25.7.2012, Për miratimin e rregullores “Për sigurinë e publikut ndaj ekspozimeve që shkaktohen nga burimet e rrezatimeve jonizuese”: “...Personat fizikë e juridikë të licencuar janë përgjegjës për burimet nën përgjegjësinë e tyre, për përgatitjen dhe zbatimin e... b) masave që sigurojnë: ... ii) kufizimin e ekspozimit normal për grupet kritike përkatëse që lidhet me këto burime, në mënyrë që ekspozimi total të jetë jo më i lartë se doza kufi për publikun. Në zgjedhjen e grupeve kritike duhet të merren parasysh **të gjithë brezat e tanishëm ose të ardhshëm** [theksimi im] në vendet ku ndodhen burimet apo dhe në vende të tjera.” Shihet qartë përfshirja edhe e brezave të ardhshëm në grupet kritike, interesat e të cilëve duhen mbajtur parasysh. Ky është një formulim që vijon atë të nenit 6 të ligjit nr. 10 431, datë 9.6.2011, “Për mbrojtjen e mjedisit”, i ndryshuar, i cili thekson se autoritetet publike, përmes hartimit, miratimit dhe zbatimit të akteve normative, strategjive, planeve, programeve e projekteve brenda kompetencave të tyre, nxitin zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik dhe shoqëror, duke përdorur burimet natyrore në atë mënyrë që të plotësohen nevojat aktuale dhe të ruhet mjedisi, pa cenuar mundësinë e brezave të ardhshëm për të plotësuar nevojat e tyre.

2.3.2 Parimi i integritimit.

Siç u përmend më sipër, ky parim u sanksionua për herë të parë në Deklaratën e Stokholmit të vitit 1972, ku u theksua ndjekja e një qasjeje të integruar, e më pas, në Deklaratën e Rios¹¹⁶ të vitit 1992, ku u përcaktua se për të arritur një zhvillim të qëndrueshëm, mbrojtja e mjedisit duhet të jetë pjesë e integruar e procesit të zhvillimit dhe nuk mund të konsiderohet si e shkëputur prej tij.¹¹⁷ Ky parim nënkupton që politikat mjedisore, nëse mbeten të shkëputura, nuk mund të arrijnë të vetme të mbrojnë mjedisin, nëse nuk përfshihen në politikat që kanë të bëjnë me fushat

¹¹⁴ Vendimi i GJND Hungaria kundër Sllovakisë, datë 25.9.1997, paragrafi 140. Gjetet në: <http://www.icj-cij.org/docket/files/92/7375.pdf>

¹¹⁵ Karta e të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian, Neni 37. Fletorja Zyrtare e Komuniteteve Evropiane, C364/1, datë 18.12.2000. Gjetet në: http://www.europarl.europa.eu/charter/pdf/text_en.pdf

¹¹⁶ Deklarata e Rios gjetet në: <http://www.un.org/documents/ga/conf/151/aconf15126-1annex1.htm>

¹¹⁷ Deklarata e Rios, Parimi 13.

e tjera që janë edhe vetë shkaktaret e ndotjes, siç janë ato për zhvillimin e industrisë, infrastrukturës, transportit, bujqësisë, etj. Në këtë kuptim, secila prej këtyre fushave duhet të bëjë pjesë të saj arritjen edhe të objektivave mjedisore, krahas objektivave specifike të sektorit përkatës.

Ky parim u bë pjesë e politikave mjedisore të BE me miratimin e Programit të Parë të Veprimit Mjedisor në vitin 1973, i cili përcaktonte se aktivitetet e Komunitetit në sektorë të ndryshëm duhet të mbajnë parasysh edhe çështjet mjedisore në hartimin e politikave të tyre. Përveç integritit të politikave mjedisore në politikat e sektorëve të tjerë, ky program veprimi e shtriu aplikimin e këtij parimi edhe në rrafshin e politikave midis shteteve anëtare. Programi sanksiononte që aspektet e politikave mjedisore në vendet e veçanta nuk duhet të planifikoheshin dhe të zbatoheshin në izolim nga njëri-tjetri. Mbi bazën e një koncepti të përbashkët afatgjatë, programet kombëtare duhet të koordinoheshin dhe politikat kombëtare duhet të harmonizoheshin brenda Komunitetit. Qëllimi i përbashkët i të gjithë këtyre politikave duhet të ishte përmirësimi i cilësisë së jetës. Në këtë aspekt, rritja ekonomike nuk duhej parë vetëm në këndvështrimin e aspekteve sasiore, por edhe atyre cilësore. Koordinimi dhe harmonizimi duhej në mënyrë të veçantë të mundësonte rritjen e efikasitetit të veprimitarisë komunitare në nivele të ndryshme, për të siguruar mbrojtjen e mjedisit, si edhe të mbante parasysh dallimet rajonale që ekzistonin brenda Komunitetit bashkë me kërkesat për funksionimin e kënaqshëm të tregut të përbashkët. Një koordinim dhe harmonizim i tillë i politikave kombëtare mund të arrihej veçanërisht duke zbatuar dispozitat e traktateve dhe duke zbatuar planin e veprimit.¹¹⁸

Programi i Tretë i Veprimit renditi të gjitha fushat ku kërkohej një ndërgjegjësim më i madh për mbrojtjen e mjedisit dhe shtroi nevojën e hartimit të një strategjie gjithëpërfshirëse për integrimin.¹¹⁹

Pas tij, Programi i Pestë i Veprimit caktoi synimin e hartimit të një strategjie gjithëpërfshirëse për zhvillimin e qëndrueshëm, zbatimin e cilës do të kërkonte ndryshime të konsiderueshme në pothuajse të gjitha fushat kryesore të veprimit komunitar. Integrimi i plotë i mbrojtjes së mjedisit në politikat e tjera komunitare konsiderohej si një instrument i domosdoshëm, një strategji bazë që do të sillte ndryshimet. Për sektorë të veçantë, siç ishin industria, energjetika, transporti, bujqësia dhe turizmi, të cilat kanë një ndikim të theksuar në mjedis, u caktuan detyra dhe objektiva që duheshin arritur.¹²⁰

Programi i Gjashtë i Veprimit përcaktoi nevojën e integritit të kërkesave mjedisore në të gjitha politikat e veprimit komunitar dhe të kontributit drejt zhvillimit të qëndrueshëm në Komunitet *si edhe në anëtarët e ardhshëm të tij* [theksimi im]. Ndër të tjera, theksohet nevoja e përpjekjeve të mëtejshme për integrimin e kërkesave mjedisore në përgatitjen, përkufizimin dhe zbatimin e politikave komunitare në sektorët e politikave të ndryshme dhe kërkon që strategjitë e integritit të hartuara nga Këshilli të përkthehen në veprime konkrete.¹²¹

¹¹⁸ Programi i Parë i Veprimit Mjedisor, Titulli II, parag. 11. Gjetet në: <http://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=OJ:C:1973:112:FULL&from=EN>

¹¹⁹ Programi i Tretë i Veprimit, Fletorja Zyrtare e BE, OJ C 139, 13.6.1977, fq. 5.

¹²⁰ Programi i Pestë i Veprimit, fq. 28-41. Gjetet në: <http://ec.europa.eu/environment/archives/actionpr.htm>

¹²¹ "Mjedisi 2020: E Ardhmja Jonë, Zgjedhja Jonë", Fletorja Zyrtare e BE, OJ L 242, 10.9.2002, fq. 2-5.

Ndërsa Programi i Shtatë i Veprimit i cili hyri në fuqi në janar 2014 i përcakton drejtimet kryesore të politikave evropiane mjedisore deri në vitin 2020 si të tilla që duhet të garantojnë një mjedis të pastër e të shëndetshëm, me një ekonomi të zhvilluar në të cilën asgjë nuk shkon dëm, ku mbrohet biodiversiteti dhe burimet natyrore. Si objektivi kryesor i programit theksohet arritja e një ekonomie të gjelbër, efiçente, që të shmangë tensionet ndaj popullatës, me shkaktar mjedisin, ku qytetet evropiane ndjekin një zhvillim të qëndrueshëm dhe i gjithë Bashkimi të jetë më i aftë të përballet me sfidat e ndryshimeve mjedisore e klimatike. Kjo synohet të arrihet nëpërmjet *integritit të plotë* [theksimi im] të kërkesave mjedisore në politikat e tjera, zbatimit më të mirë të legjislacionit, shpërndarjes më të mirë të informacionit, si edhe nëpërmjet investimeve më të shumta, por më efektive, në fushat e mjedisit dhe ndryshimeve klimatike.¹²²

Me hyrjen në fuqi të Traktatit të Lisbonës, neni 11 i Traktatit të Funkcionimit të Bashkimit Evropian (TFEU) (ish-neni 6 TKE), sanksionon që kërkesat për mbrojtjen e mjedisit duhet të *integrohen* [theksimi im] në përcaktimin dhe zbatimin e politikave dhe aktiviteteve të Bashkimit, sidomos me synim nxitjen e zhvillimit të qëndrueshëm. Theksi kryesor është vendosur në integrimin me politikat ekonomike të BE, në mënyrë që mbrojtja e mjedisit të mos bëhet pengesë për zhvillimin ekonomik. Edhe jurisprudenca e GJED reflekton pikërisht këtë ndërthurje, duke interpretuar objektivat ekonomike të BE në përputhje me standardet mjedisore.

Akti Unik Evropian i vitit 1987, siç u tha më sipër, ishte dokumenti i parë që i akordoi një titull të veçantë mbrojtjes së mjedisit. Neni 130r§2 i tij sanksiononte: “...Kërkesat për mbrojtjen e mjedisit do të jenë *pjesë përbërëse* [theksimi im] e politikave të tjera komunitare.”¹²³

Amendimet e bëra më pas nga Traktati i Maastrichtit në vitin 1993, përveç që sollën përcaktimin e objektivave dhe parimeve të reja, bënë edhe një riformulim të parimit të integritit, në nenin 130r§2, tashmë duke përdorur në mënyrë direkte termin “*integrim*”: “...Kërkesat për mbrojtjen e mjedisit *duhet të integrohen* [theksimi im] në përkufizimet dhe zbatimin e politikave të tjera komunitare.” Përdorimi i dy termave “*duhet*” dhe “*integrohen*” lë të kuptohet që tashmë nuk kemi të bëjmë thjesht me një “*parim*”, por me një “*detyrim*”, që duhet të përmbushet nga anëtarët e Bashkimit. Në këtë kontekst, harmonizimi i masave që do të merren për të përmbushur këto detyrime do të përfshijnë, aty ku është e mundur, edhe klauzola sigurie, të cilat i lejojnë shtetet anëtare të marrin masa të përkohshme për arsye mjedisore jo-ekonomike, por që bëhen objekt i procedurave të inspektimit prej Komunitetit.¹²⁴

Në vijim, Traktati i Amsterdimit i vitit 1999 e forcoi akoma më tepër zbatimin e parimit të integritit, i cili tashmë vetëm në emërtim është i tillë, sepse në realitet përbën një objektivi të detyrueshëm për t’u arritur, krahas zhvillimit të qëndrueshëm, nivelit të lartë të mbrojtjes dhe përmirësimit të cilësisë së mjedisit. Edhe vetë pozicioni në tekstin e traktatit iu ndryshua, duke e vendosur atë në pjesën e parë të tij, të renditur në parimet e Komunitetit.¹²⁵

¹²² Programi i Shtatë i Veprimit Mjedisor gjendet në:

<http://ec.europa.eu/environment/pubs/pdf/factsheets/7eap/en.pdf>

¹²³ *Supra*, shënimi fundor nr. 94.

¹²⁴ Traktati i Maastrichtit. Gjendet në: <http://www.eurotreaties.com/maastrichtec.pdf>

¹²⁵ Traktati i Amsterdimit, Neni 6. Gjendet në: <http://www.eurotreaties.com/amsterdamtreaty.pdf>

Parimi i integritetit është i konsoliduar tashmë edhe në jurisprudencën e GJED. Në vendimin e saj në çështjen *Chernobyl*, GJED shqyrtoi kërkesën e Greqisë për shfuqizimin e Rregullores 3955/87 mbi kushtet e importit të produkteve bujqësore prej vendeve të treta, pas aksidentit në centralin bërthamor të vitit 1986 në Chernobyl të Ukrainës. Rregullorja 3955/87, e cila ishte nxjerrë në bazë dhe për zbatim të nenit 113 (aktualisht neni 133) të Traktatit të KE, mbi politikën e përbashkët tregtare, u kërkonte shteteve anëtare të verifikonin nivelin e kontaminimit radioaktiv që gjendej në produktet bujqësore të importuara prej vendeve të treta. Në rast tejkalimi të këtij niveli, duhet të merreshin masa mbrojtëse, deri në ndalimin e importit të këtyre produkteve. Pretendimi grek konsistonte në korrigjimin e bazës ligjore për nxjerrjen e Rregullores 3955/87, pasi kjo ishte një masë që kishte të bënte me mbrojtjen e shëndetit publik, prandaj duhet të ishte bazuar në nenin 130 (aktualisht neni 175) të Traktatit të KE. Gjykata theksoi se në varësi të zgjedhjes së bazës ligjore, mund të ndryshojë edhe përmbajtja e masës së marrë, përdërisa kërkesat procedurale për miratimin e dispozitave ishin të ndryshme.¹²⁶ Ajo vazhdoi më tej se Rregullorja 3955/87 kishte synime të dyfishta: nga njëra anë synonte mbrojtjen e shëndetit të konsumatorëve dhe nga ana tjetër synonte rregullimin e tregtisë midis KE dhe vendeve të treta. Kështu që fakti që dispozita synonte mbrojtjen e shëndetit, nuk e nxjerr atë jashtë rregullimit të fushave të tjera. Ky interpretim konfirmohet edhe nga fjalia e dytë e nenit 130r§2, sipas të cilit mbrojtja e mjedisit do të jetë komponent i politikave të tjera komunitare. Kjo dispozitë e cila reflekton parimin sipas të cilit të gjitha masat e marra nga Komuniteti duhet të përmbushin kërkesat e mbrojtjes mjedisore, do të thotë që një masë e marrë nga Komuniteti nuk do të thotë që është pjesë e veprimit mjedisor, vetëm sepse mban parasysh këto kërkesa.¹²⁷ Të njëjtin qëndrim ka mbajtur GJED edhe në çështjet *Titanium Dioxide*¹²⁸ dhe *Bettati v. Safety High Tech*.¹²⁹

Neni 10 i ligjit nr. 10 431, datë 9.6.2011, “Për mbrojtjen e mjedisit”, i ndryshuar, sanksionon se qëllimi i parimit të qasjes së integruar është parandalimi dhe/ose reduktimi i rrezikut ndaj mjedisit, në tërësinë e tij dhe se autoritetet publike, gjatë hartimit dhe miratimit të dokumenteve të planifikimit të territorit, brenda kompetencave të tyre, marrin parasysh, në mënyrë të veçantë, cënueshmërinë e mjedisit, lidhjen ndërmjet ekuilibrit dhe vlerave të peizazhit natyror, lidhjen ndërmjet burimeve natyrore të përtëritshme dhe jo të përtëritshme, trashëgiminë kulturore dhe të pasurive materiale, tërësinë e ndërveprimeve të tyre të ndërsjella, si dhe ndërveprimin ndërmjet projekteve ekzistuese dhe atyre të planifikuara.

2.3.3 Parimi ‘Ndotësi paguan’.

Me ritmet e zotme të zhvillimit e të konsumit është e qartë që ciklet e ripërtëritjes së natyrës nuk i mundësojnë asaj që të përballojë dëmet që i vijnë prej aktivitetit njerëzor e të ripërtërihet. Në këto kushte, parimi ‘ndotësi paguan’ synon që aty ku është e mundshme, nëpërmjet kostos së ngarkuar shkaktarit të ndotjes, të ripërtërihet mjedisi në ato zona ku është dëmtuar e të rigjenerohen burimet natyrore të dëmtuara. Në rastet kur burimet e dëmtuara nuk mund të

¹²⁶ Vendimi C-62/88, datë 29.3.1990, parag. 10. Gjendet në: http://eur-lex.europa.eu/resource.html?uri=cellar:ac3505e3-6311-4c44-811d-15a86b50576a.0002.03/DOC_1&format=PDF

¹²⁷ *Ibid.*, parag. 20.

¹²⁸ Gjendet në: <http://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=CELEX:61989CJ0300>

¹²⁹ Gjendet në: <http://curia.europa.eu/juris/liste.jsf?language=en&num=C-341/95>

ripërtërihen, atëherë pagesa duhet të shkojë për të mbrojtur burimet e tjera të disponueshme që kanë mbetur ende të pacënuara.

Siç është lehtësisht e kuptueshme, ky parim ngarkon shkaktarin e ndotjes mjedisore me kostot për riparimin e dëmit të shkaktuar, duke sanksionuar qartazi, në kuptim të ligjit, përgjegjësinë civile për dëmin e shkaktuar, përgjegjësi kjo jo ndaj një personi tjetër fizik apo juridik, por ndaj komunitetit në tërësi. Është një masë e karakterit *ex post facto*, që krijon mundësinë e eliminimit të pasojave pasi ato kanë ardhur, duke ua ngarkuar autoriteteve publike detyrën që me fondet e grumbulluara si rezultat i zbatimit të këtij parimi, të kujdesen që të sigurohet ose rigjenerimi i mjedisit të dëmtuar, ose ruajtja e pjesës tjetër të tij.

Autoritetet publike mund ta vënë në zbatim në praktikë parimin “ndotësi paguan” në dy mënyra: 1. Nëpërmjet vendosjes së taksave që mbajnë parasysh vlerën e përafërt ekonomike të dëmit që do të shkaktohet; dhe 2. Duke vendosur rregulla që sanksionojnë standardet dhe caktojnë nivelet maksimale të lejueshme të dëmit që mund t’i shkaktohet mjedisit, si edhe duke ndaluar çdo aktivitet që ka potencialin t’i tejkalojë këto limite.¹³⁰

Parimi “ndotësi paguan” e ka origjinën nga ekonomia, ku kostot e jashtme të produkteve, që i përballon komuniteti, siç është ndotja e mjedisit, duhet të futen koston e produktit, por që prodhuesi duhet ta paguajë në formë detyrimi ndaj shtetit.

Në jurisprudencën ndërkombëtare përgjegjësia për dëmet e shkaktuara një shteti tjetër e ka zanafillën në çështjen arbitrazhit ndërkombëtar *Trail Smelter* (Fonderia Trail) midis SHBA dhe Kanadasë. Gjykata e arbitrazhit shpalli përgjegjëse Kanadanë për dëmtimin mjedisor të shkaktuar shtetit të Washingtonit në SHBA, si rezultat i veprimtarisë së fonderisë Trail në British Columbia të Kanadasë, e cila prej shkrirjes së zinkut dhe plumbit, kishte shkarkuar në ajër dioksid sulfuri përgjatë viteve 1932-1937. Ajo i akordoi SHBA një dëmshpërblim prej 78,000 dollarësh, për dëmet e shkaktuara ndaj sipërfaqeve të tokave dhe të mbjellave dhe urdhëroi ndalimin e veprimeve të mëtejshme që mund të shkaktonin dëme në të ardhmen, si një regjim i përkohshëm, deri sa gjykata të kishte të dhëna të mjaftueshme mbi kushtet meteorologjike, kur mund të caktohej një regjim përfudimtar.¹³¹

Në të drejtën ndërkombëtare bashkëkohore, në aktet ndërkombëtare ky parim u sanksionua për herë të parë në Rezolutën (68) 4 të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës në 8 mars 1968, “Deklarata e Parimeve mbi Kontrollin e Ndotjes së Ajrit”,¹³² ku paragrafi 6 i Pjesës II sanksiononte që kostot e parandalimit dhe eliminimit të ndotjes duhet të përballohen prej atij që e shkakton atë. Pas katër vitesh, parimi “ndotësi paguan” adoptohet në 1972 nga Organizata për Bashkëpunimin dhe Zhvillimin Ekonomik (OECD), në Rekomandimin e Këshillit për Parimet Udhëzuese mbi Aspektet Ekonomike Ndërkombëtare të Politikave Mjedisore. Thelbi i rekomandimit konsistonte në atë që parimi duhet të shërbejë për shpërndarjen e kostove për

¹³⁰ Nicolas de Sadeleer, “*Environmental Principles. From Political Slogans to Legal Rules*”, Oxford University Press, 2002, fq. 21.

¹³¹ Trail Smelter Arbitration Tribunal, U.S.A v. Canada, American Journal of International Law, 1939, Vol. 33, fq. 182.

¹³² Rezoluta (68) 4 e Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës gjendet në: <https://wed.coe.int/com.instranet.InstraServlet?command=com.instranet.CmdBlobGet&InstranetImage=584176&SecMode=1&DocId=632300&Usage=2>

parandalimin dhe kontrollimin e ndotjes, në mënyrë që të inkurajohet përdorimi racional i burimeve të pakta mjedisore dhe për të eliminuar deformimet në tregtinë dhe investimet ndërkombëtare. Në bazën e parimit ‘ndotësi paguan’ qëndron arsyetimi që ndotësi duhet të përballojë kostot e marrjes së masave të tilla të vendosura nga autoritetet publike për të garantuar që mjedisi të jetë në një gjendje të pranueshme. Me fjalë të tjera, kostoja e këtyre masave duhet të reflektohet në kostot e mallrave dhe shërbimeve që shkaktojnë ndotje në prodhim apo konsumim. Masa të tilla nuk duhet të shoqërohen me subvencionime që do të shkaktonin deformime në tregtinë dhe investimet ndërkombëtare.¹³³

Përveç këtij formulimi fillestar, OECD e ka zgjeruar kuptimin e këtij parimi, duke përfshirë edhe konceptin e ‘Përgjegjësisë së Zgjeruar të Prodhuesit’, çka nënkupton që prodhuesit dhe importuesit e produkteve duhet të marrin përsipër një pjesë të rëndësishme të përgjegjësisë për ndikimin në mjedis të produkteve të tyre gjatë kohës së përdorimit të produktit, duke përfshirë ndikimin fillestar në mjedis gjatë procesit të përzgjedhjes së materialeve, ndikimin prej vetë procesit të prodhimit, dhe ndikimin prej përdorimit dhe hedhjes si mbetje në fund të ciklit të jetës së produktit.¹³⁴

Më pas, parimi “ndotësi paguan” u shndërrua në një parim ligjor ndërkombëtar në vitin 1987 duke u sanksionuar në nenin 130r të Titullin VII (Mjedisi) të Aktit Unik Evropian, ku mbrojtja e mjedisit u përcaktua si pjesë përbërëse e politikave të tjera komunitare, për t’u rikonfirmuar në Parimin 16 të Deklaratës së Rios në vitin 1992. I vetmi dallim është që në këtë fundit formulimi është më i përgjithshëm dhe me konotacion rekomandues, e aspak detyrues, në krahasim me rekomandimin e OECD. Ndërsa formulimi i rezolutës së OECD ishte: “... **ndotësi duhet të përballojë kostot** [theksimi im] *e marrjes së masave të tilla të vendosura nga autoritetet publike për të garantuar që mjedisi të jetë në një gjendje të pranueshme...*”, Parimi 16 i Deklaratës së Rios shprehet: “*Autoritetet kombëtare duhet të bëjnë përpjekje* [theksimi im] *për të promovuar përfshirjen e kostove mjedisore dhe përdorimin e instrumenteve ekonomike, duke mbajtur parasysh qasjen që në parim, ndotësi duhet të marrë përsipër koston e ndotjes* [theksimi im], *duke mbajtur parasysh interesin publik dhe pa deformuar tregtinë dhe investimet ndërkombëtare.*”

Parimi “ndotësi paguan” është tashmë prezent në formën e dispozitave me fuqi detyruese në Marrëveshjen për Ruajtjen e Natyrës dhe të Burimeve Natyrore të Shoqatës së Kombeve të Azisë Juglindore (ASEAN) të vitit 1985,¹³⁵ në Konventën për Mbrojtjen e Alpeve të vitit 1991,¹³⁶ në Konventën OSPAR (Konventa për Mbrojtjen e Mjedisit Detar të Atlantikut Verilindor) të vitit 1992,¹³⁷ në Konventën e Helsinkit për Mbrojtjen dhe Përdorimin e Rrjedhave Ujore Ndërkufitare

¹³³ Organizata për Bashkëpunimin dhe Zhvillimin Ekonomik (OECD), “*Recommendation of the Council on Guiding Principles concerning International Economic Aspects of Environmental Policies*”, C(72)128, datë 26 maj 1972, parag. 4. Gjendet në:

<http://webnet.oecd.org/OECDACTS/Instruments/ShowInstrumentView.aspx?InstrumentID=4&InstrumentPID=255&Lang=en&Book=>

¹³⁴ Trajtimi analitik i konceptit të Përgjegjësisë së Zgjeruar të Prodhuesit gjendet në:

<http://www.oecd.org/env/waste/factsheetextendedproducerresponsibility.htm>

¹³⁵ Gjendet në: <http://sedac.ciesin.org/entri/texts/asean.natural.resources.1985.html>

¹³⁶ Gjendet në: <http://www.alpconv.org/en/convention/framework/default.html>

¹³⁷ Gjendet në: http://www.ospar.org/html_documents/ospar/html/ospar_convention_e_updated_text_2007.pdf

dhe Liqeneve Ndërkombëtare të vitit 1992,¹³⁸ në Konventën tjetër të Helsinkit për Mbrojtjen e Mjedisit Detar të Zonës së Detit Balltik, të vitit 1992,¹³⁹ si edhe në Konventën e Barcelonës për Mbrojtjen e Mjedisit Detar dhe Rajonit Bregdetar të Mesdheut, të vitit 1976 (amenduar në vitin 1995).¹⁴⁰

Këto janë zhvillime të rëndësishme në kuadrin e së drejtës ndërkombëtare publike, por që kanë të bëjnë me elementë të së drejtës private, pasi bëhet fjalë për përgjegjësinë e entiteteve private (përveç rasteve kur veprimtaria kryhet prej kompanive shtetërore, por numri i këtyre të fundit është i papërfillshëm në krahasim me kompanitë private), duke shmangur kështu implikimin e përgjegjësisë ndërshtetërore (ose duke ofruar një alternativë ndaj saj) dhe duke e lënë rregullimin në sferën e së drejtës private. Pavarësisht se prej vitit 1960 e më pas janë miratuar një numër konventash mbi përgjegjësinë civile dhe kompensimin (si p.sh. Konventa për Përgjegjësinë Civile për Dëmin e Ndotjes nga Nafta, e vitit 1992, Konventa për Krijimin e një Fondi Ndërkombëtar për Kompensimin e Dëmit prej Ndotjes nga Nafta, e vitit 1992, Konventa për Përgjegjësinë Civile për Dëmin e Ndotjes nga Nafta të Hambarëve të Anijeve, e vitit 2001, Konventa për Përgjegjësinë dhe Kompensimin për Dëmin në lidhje me Transportin e Substancave të Rrezikshme dhe Helmuere nga Deti, e vitit 1996, Konventa për Përgjegjësinë Civile për Dëmin e Shkaktuar gjatë Transportimit të Mallrave të Rrezikshme me Automjete Rrugore, Hekurudhore dhe Anije, e vitit 1989, Konventa e Parisit për Përgjegjësinë e Palëve të Treta në Fushën e Energjisë Bërthamore e vitit 1960, Konventa Plotësuese e Brukselit e vitit 1963, Konventa e Vjenës për Përgjegjësinë Civile për Dëmin Bërthamor e vitit 1963, Konventa për Kompensimin Plotësues për Dëmin Bërthamor e vitit 1997, Protokollin i Përbashkët për Zbatimin e Konventës së Vjenës dhe Konventës së Parisit i vitit 1988, Konventa e Brukselit për Përgjegjësinë Civile në Fushën e Transportit Detar të Materialeve Bërthamore e vitit 1971), për të zgjidhur çështjen e ndotjes prej dy nga llojet e ndotjeve më të rrezikshme, ndotjen prej karburanteve në det dhe aksidentet bërthamore, ato janë kufizuar vetëm në këto dy kategori të ndotësve: pronarët e anijeve dhe zotëruesit e centraleve bërthamore. Në kushtet aktuale, nuk është miratuar ndonjë traktat i një karakteri të përgjithshëm me shtrirje globale, që të merret me çështjen e ndotjeve ndërkufitare, përveç marrëveshjeve rajonale, por edhe këto me një numër të kufizuar shtetesh palë. Prandaj ende nuk mund të konsiderohen si të disponueshëm mekanizmat e së drejtës private për zhdëmtimin e ndotjes me karakter ndërshtetëror.¹⁴¹

Në këtë drejtim janë bërë përpjekje prej Komisionit të së Drejtës Ndërkombëtare, i cili në vitin 2006 finalizoi Projekt-Parimet për Caktimin e Dëmit në Rastet e Dëmeve Ndërkufitare të Shkaktuara prej Aktiviteteve të Rrezikshme. Qëllimi i punës së komisionit ishte hartimi i parimeve për të nxitur shtetet që të garantojnë kompensimin e menjëhershëm e të plotë të viktimave të dëmeve ndërkufitare dhe mbrojtjen e mjedisit, duke eliminuar pasojat dhe duke rikthyer gjendjen e mëparshme. Për këtë, projekti parashikon që çdo shtet duhet të marrë masat e domosdoshme për të siguruar që ai disponon mjetet e duhura për kompensimin e menjëhershëm e të plotë të viktimave të dëmeve ndërkufitare të shkaktuara prej aktiviteteve të rrezikshme të

¹³⁸ Gjendet në: <http://www.unece.org/fileadmin/DAM/env/water/pdf/watercon.pdf>

¹³⁹ Gjendet në:

http://www.helcom.fi/Documents/About%20us/Convention%20and%20commitments/Helsinki%20Convention/1992_Convention_1108.pdf

¹⁴⁰ Gjendet në: http://www.unep.ch/regionalseas/regions/med/t_barcel.htm

¹⁴¹ Alan E. Boyle, "Globalising environmental liability: The interplay of national and international law", *Journal of Environmental Law*, Vol 17, No 1, 2005, fq. 4.

kryera brenda territorit të tyre, ose në territore nën juridiksionin apo kontrollin e tyre. Në këto masa duhet të përfshihet caktimi i përgjegjësisë së ushtruesit të aktivitetit, ose sipas rastit, përgjegjësia e një personi apo entiteti tjetër. Caktimi i kësaj përgjegjësie nuk duhet të ketë nevojë për të provuar fajin. Përveç kësaj, këto masa duhet të përfshijnë edhe kërkesën që ushtruesi i aktivitetit, personi apo entiteti duhet të krijojë një fond financiar garancie, të tillë si siguracion, bono thesari, apo garanci të tjera financiare për të mbuluar çdo kërkesë për ndonjë kompensim të mundshëm. Në raste të caktuara, kjo mund të përfshijë edhe kërkesën për krijimin e një fondi që të përfshijë një industri të tërë, në rang kombëtar. Kur të gjitha këto masa nuk janë të mjaftueshme për të dhënë kompensimin e duhur, shteti prej nga ka ardhur dëmi duhet të sigurojë disponueshmërinë e mjeteve të tjera financiare.¹⁴²

Në kuadër të BE, është miratuar Direktiva 2004/35/CE për përgjegjësinë në lidhje me parandalimin dhe riparimin e dëmeve mjedisore, që zbatohet në lidhje me dëmin mjedisor, për aktivitetet profesionale që paraqesin rrezik për shëndetin e njeriut ose mjedisin, dëmin ndaj specieve të mbrojtura dhe habitateve natyrore, ujit, tokës, që përcakton se operatori duhet të jetë përgjegjës sipas kësaj Direktive kurdoherë që ai është fajtor ose neglizhent.¹⁴³

Është e rëndësishme që autoritet publike nuk duhet ta kuptojnë këtë parim si mundësi legjitimimi të çdo aktiviteti, duke e interpretuar atë se çdo dëm ka një vlerë, e cila mund të zhdëmtohet, ose 'ndot tani, se paguan më vonë'. Ka disa dëme që janë të pariparueshme, siç është për shembull prerja e një pylli. Vërtet mund të paguhet vlera monetare e tij, që të mund të mbrohet një pyll tjetër, por zhdëmtimi nuk arrin të sigurojë ajrin e pastër prej thithjes së dioksidit të karbonit në atë zonë, mbrojtjen nga erozioni, vlerën estetike, e kështu me radhë. Në mënyrë ideale, autoritetet publike duhet të shmangen nga autorizimi i atyre veprimtarive që shkaktojnë dëme të tilla, pasojat e të cilave janë të pariparueshme.

Edhe zbatimi i këtij parimi në praktikë ka implikimet e veta, pikërisht për sa i përket shpërndarjes së këtyre kostove. Kështu p.sh., nëse një industri prodhuese thjesht do të taksohej më shumë prej autoriteteve, pra do i ngarkoheshin kosto shtesë për shkak të emetimit të gazeve ndotës në mjedis, ajo fare lehtë mund t'i transferonte këto kosto tek blerësit nëpërmjet rritjes së çmimit të produktit, në vend që të instalonte filtra që reduktojnë nivelin e çlirimit të gazeve. Në këtë mënyrë, njerëzit paguajnë edhe koston mjedisore (ndotja e mjedisit të tyre), edhe koston e rritur të produktit që e blejnë më shtrenjtë. Prandaj edhe duhen gjetur mekanizmat që të bëjnë shpërndarje të kostove ndaj aktorëve të ndryshëm.

Qëndrimi i GJEDNJ në lidhje me përgjegjësinë e autoriteteve shtetërore në rastet e ndotjes, edhe kur ajo është shkaktuar si rrjedhojë e veprimtarisë private, ka evoluar përgjatë viteve. Në vendimin e saj në çështjen *Zander kundër Suedisë*, GJEDNJ iu referua ligjit suedez për shpërblimin e dëmit për shkak të ndotjes së ujit të pijshëm të aplikantit nga kompania e trajtimit të mbetjeve që ushtronte aktivitetin e saj ngjitur me shtëpinë e aplikantit, duke ndotur burimet e ujit të pijshëm. Sipas ligjit suedez, kusht për pagimin e kompensimit ishte lidhja shkakësore

¹⁴² Komisioni i së Drejtës Ndërkombëtare, "Projekt-Parimet për Caktimin e Dëmit në Rastet e Dëmeve Ndërkufitare të Shkaktuara prej Aktiviteteve të Rrezikshme", 2006, Parimet 4 dhe 5. Gjetet në:

http://legal.un.org/ilc/texts/instruments/english/draft%20articles/9_10_2006.pdf

¹⁴³ Direktiva 2004/35/CE për përgjegjësinë në lidhje me parandalimin dhe riparimin e dëmeve mjedisore, parag. 8 dhe 9. Gjetet në: <http://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=OJ:L:2004:143:0056:0075:en:PDF>

midis aktivitetit të kompanisë dhe dëmit të shkaktuar. Në kushtet e ekzistencës së një lidhjeje të tillë, ndotësi nuk mund të çlirohej nga përgjegjësia për shkaktimin e dëmit edhe pse ai ishte pajisur në mënyrë të ligjshme me licencë prej autoriteteve shtetërore.¹⁴⁴

Ndërsa në çështjen *Hatton kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Gjykata theksoi se neni 8 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ) mund të gjejë zbatim në çështjet mjedisore, pavarësisht faktit nëse ndotja është shkaktuar direkt prej autoriteteve shtetërore apo nëse përgjegjësia e shtetit rrjedh prej mungesës së rregullimit të aktivitetit privat në mënyrën e duhur. Nga ana tjetër, në çdo rast shtetit i lihet në dorë hapësira e vlerësimit për vendosjen e ekuilibrit midis interesit të individit dhe të komunitetit në tërësi. Gjykata theksoi se në raste të tilla, kur gjykohen veprimet e autoriteteve shtetërore të cilat kanë ndikim në mjedis, analiza përfshin dy aspekte: analizën e përmbajtjes së vendimit, e cila duhet të jetë në përputhje me nenin 8 dhe analizën e procesit të vendimmarjes, i cili duhet të ketë mbajtur parasysh interesat e aplikantit.¹⁴⁵

Për ndotjen e shkaktuar nga një fabrikë produktesh kimike, në çështjen *Guerra dhe të tjerë kundër Italisë*, vendimi nr. 116/1996/735/932, datë 19.2.1998, Dhoma e Madhe e GJEDNJ shpalli përgjegjës shtetin italian, përsëri bazuar në nenin 8 të KEDNJ, për shkak të mosveprimit, moslajmërimit e banorëve të Manfredonias që jetonin vetëm 1 km larg fabrikës, për ndotjen si rrjedhojë e çlirimit prej saj të gazeve të djegshme, dioksidit të sulfurit dhe oksideve nitrike, përgjatë shumë viteve, si edhe për moslajmërimit për masat që duheshin marrë dhe veprimet që duheshin kryer në rast të një aksidenti industrial.

Në funksion të zbatimit të parimit ‘ndotësi paguan’, në legjislacionin shqiptar janë marrë disa iniciativa. Një ndër to ishte edhe shtimi i nenit 13/1 të ligjit nr. 10 183, datë 29.10.2009 ‘Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9374, datë 21.4.2005 “Për ndihmën shtetërore”, i cili përcakton se ndihma për mbrojtjen e mjedisit mund të jepet vetëm për: 1. Investim për nxitjen e energjisë nga burime të rinovueshme të energjisë; 2. Investim për menaxhimin e mbetjeve të ndërmarrjeve të tjera, përfshirë këtu ripërdorimin, riciklimin dhe kthimin; 3. Investim për ndërmarrjet që merren me riparimin e dëmeve mjedisore, duke rehabilituar zonat e ndotura; 4. Investim për prodhimin e kombinuar e me efikasitet të lartë të energjisë dhe nxehtësisë.

Në bazë dhe për zbatim të kësaj dispozite, Komisioni i Ndhmës Shtetërore, me Vendimin Nr.32, datë 15.2.2010 miratoi udhëzimin “Për ndihmën shtetërore për mbrojtjen e mjedisit”, i cili përcakton kushtet dhe kriteret në përputhje me të cilat mund të lejohet ndihma shtetërore për mbrojtjen e mjedisit. Objektivi kryesor i kontrollit të ndihmës shtetërore në fushën e mbrojtjes së mjedisit është të sigurojë që masat e ndihmës shtetërore të çojnë në një nivel më të lartë të mbrojtjes së tij, krahasuar me atë që do të arrihej pa këtë ndihmë, duke marrë parasysh parimin ‘ndotësi paguan’. Qëllimi është që ndihma shtetërore të ofrojë një stimul pozitiv për ndërmarrjet që të kryejnë veprimtari ose të bëjnë investime që nuk janë të detyrueshme dhe që pa praninë e ndihmës shtetërore, nuk do të merreshin përsipër nga kompanitë, të cilat kanë për qëllim fitimin. Megjithatë, vetë udhëzimi e pranon në tekstin e tij që aktualisht ka kufizime në zbatimin e parimit ‘ndotësi paguan’, por dështimi nuk duhet të pengojë dhënësit e ndihmës që të imponojnë kërkesa për mbrojtjen e mjedisit.

¹⁴⁴ Vendimi i GJEDNJ *Zander kundër Suedisë*, nr. 14282/88, datë 25.11.1993, paragrafi 16.

¹⁴⁵ Vendimi i GJEDNJ *Hatton kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 36022/97, datë 8.7.2003, paragrafi 98 dhe 99.

Pas tij, neni 12 i ligjit nr. 10 431, datë 9.6.2011, “Për mbrojtjen e mjedisit”, i ndryshuar, për sa i përket zbatimit të parimit ‘Ndotësi paguan’, sanksionon se personi fizik apo juridik, veprimet ose mosveprimet e të cilit ndikojnë në ndotjen e mjedisit, mban përgjegjësi financiare, duke përballuar kostot e shkaktuara nga ky dëmtim apo rrezik për dëmtimin e mjedisit. Kosto të tilla përfshijnë kostot e vlerësimit të dëmtimit të mjedisit, ato të vlerësimit të masave të nevojshme, si dhe kostot e shmangies së dëmtimit të mjedisit, përfshirë kostot e rehabilitimit e të kompensimit të personave fizikë apo juridikë të dëmtuar. Më tej, krejt Kreu VIII i ligjit i kushtohet përgjegjësisë për dëmin në mjedis, qëllimi i të cilës, mbështetur në parimin ‘Ndotësi paguan’, është parandalimi dhe zhdëmtimi i të gjithë dëmit që i shkaktohet mjedisit, rehabilitimi i mjedisit dhe prezantimi i masave dhe i praktikave për minimizimin e rrezikut të dëmtimit të mjedisit. Neni 50 i ligjit përcakton se përgjegjësia për dëmin në mjedis përcaktohet në bazë të dëmit të shkaktuar në mjedis, dëmit të shkaktuar ndaj llojeve të mbrojtura dhe habitateve natyrore dhe ngarkon Këshillin e Ministrave të miratojë listën e veprimtarive që konsiderohen si të rrezikshme për mjedisin, kriteret në bazë të të cilave bëhet vlerësimi i kërcënimit të mundshëm dhe përcaktimi i dëmit në mjedis. Operatori i cili ka shkaktuar një dëm apo paraqet një kërcënim të drejtpërdrejtë për dëmtim të mjedisit, është përgjegjës për këtë dëm nëse nuk merr masat e nevojshme parandaluese, nuk merr masat e nevojshme zhdëmtuese, apo nuk njofton Agjencinë Kombëtare të Mjedisit (AKM) për rrezikun e dëmit në mjedis, i cili mund të ishte shkaktuar, pavarësisht nga masat e marra, apo se dëmi mund të ketë ndodhur ose jo. Roli i AKM është thelbësor, pasi ligji i ka dhënë kompetenca të gjera për sa i përket masave për parandalimin apo kompensimin dhe zhdëmtimin në rastet e shkaktimit të dëmit. Në rast se operatori nuk arrin të eliminojë kërcënimin e drejtpërdrejtë të dëmit në mjedis, ai njofton menjëherë dhe pa vonesë Agjencinë Kombëtare të Mjedisit, e cila i kërkon operatorit të sigurojë informacion për çdo kërcënim për dëmet në mjedis ose për rastet kur dyshohet për ekzistencën e një kërcënimi të drejtpërdrejtë për dëme në mjedis, i kërkon operatorit të marrë masat e nevojshme dhe i jep atij udhëzime për masat parandaluese, si edhe merr masat e nevojshme parandaluese apo cakton një subjekt tjetër, fizik apo juridik, për të marrë masat e duhura, me shpenzimet e operatorit. Në rast se dëmi në mjedis ka ndodhur, operatori duhet të informojë Agjencinë Kombëtare të Mjedisit për dëmin e shkaktuar, të kryejë rehabilitimin e të gjithë dëmit, në përputhje me parimin ‘Ndotësi paguan’, të marrë të gjitha masat e nevojshme për kontrollin, ruajtjen, eliminimin apo për ndonjë lloj tjetër menaxhimi të faktorëve që kanë shkaktuar dëmin në mjedis, me qëllim kufizimin apo parandalimin e dëmeve të mëtejshme në mjedis, të efekteve negative në jetën dhe shëndetin e njeriut, si dhe vënien në rrezik të burimeve natyrore. Nga ana e saj, në rast se dëmi në mjedis ka ndodhur, Agjencia Kombëtare e Mjedisit i kërkon operatorit të sigurojë informacion të mëtejshëm për dëmin e shkaktuar, merr, i kërkon apo i jep udhëzime operatorit për të marrë të gjitha masat e nevojshme për kontrollin, ruajtjen, eliminimin apo për ndonjë lloj tjetër menaxhimi të faktorëve që kanë shkaktuar dëmin në mjedis, me qëllim kufizimin apo parandalimin e dëmeve të mëtejshme në mjedis, efekteve negative në jetën dhe shëndetin e njeriut, si dhe vënien në rrezik të burimeve natyrore, i kërkon operatorit të marrë masat e nevojshme rehabilituese, si dhe i siguron atij udhëzimet e duhura për masat rehabilituese që duhet të merren, merr masat e nevojshme rehabilituese apo cakton një subjekt tjetër fizik apo juridik, për të marrë masat e duhura, me shpenzimet e operatorit, në rast se operatori nuk e ka përmbushur këtë detyrim. Operatori mbulon shpenzimet për masat parandaluese dhe rehabilituese për dëmin që ai ka shkaktuar në mjedis, por në rastet kur ai vërteton që dëmi i shkaktuar apo kërcënim i për shkaktimin e një dëmi në mjedis është pasojë e një fenomeni

natyror të paparashikueshëm dhe të pashmangshëm, i cili nuk mund të parandalohej apo të eliminohej, është shkaktuar nga një palë e tretë dhe/ose ka ndodhur pavarësisht nga marrja e masave të duhura, apo është pasojë e zbatimit të një vendimi të detyrueshëm, të lëshuar nga një autoritet publik, ai nuk bën kompensimin e shpenzimeve për dëmin e shkaktuar në mjedis. Të njëjtat rregulla vlejnë edhe për kompensimin për dëmin e shkaktuar në mjedis.

Ndërsa në lidhje me përgjegjësinë civile për ndotjen e mjedisit, sipas nenit 624 të Kodit Civil shqiptar, personi që me faj ka cënuar mjedisin, duke e keqësuar, ndryshuar ose dëmtuar atë, tërësisht ose pjesërisht, detyrohet të shpërblejë dëmin e shkaktuar.

2.3.4 Parimi i parandalimit dhe i marrjes së masave paraprake.

Pas sanksionimit të parimit ‘ndotësi paguan’, që siç u analizua më sipër është një parim që vepron *ex post facto*, pasi dëmi mjedisor është shkaktuar, hapi tjetër i natyrshëm do të ishte rritja e përpjekjeve për marrjen e masave paraprake, për parandalimin e dëmeve mjedisore. Parimi i parandalimit dhe i marrjes së masave paraprake është përmendur për herë të parë në fillim të viteve 70’ dhe nënkupton kryerjen e veprimeve paraprake, në mënyrë që të evitohet sa më shumë që të jetë e mundur shkaktimi i dëmeve mjedisore, bazuar dhe në parimin e mjekësisë ‘parandalimi është më mirë se kurimi’. Diku në literaturë apo edhe në ndonjë marrëveshje ndërkombëtare, formulimi i këtij parimi mund të jetë i copëzuar në dy parime të veçantë, por pavarësisht kësaj, thelbi është që ky parim është i lidhur ngushtë me konceptin e ‘rrezikut’, si një koncept i gjerë në të drejtën mjedisore bashkëkohore. Kjo, sepse në ditët tona, për shkak të ndryshimeve klimatike dhe të zhvillimeve teknologjike të jashtëzakonshme, në jetën e përditshme, përveç rreziqeve natyrore përballemi edhe me një sërë rreziqesh të shkaktuara prej vetë zhvillimit. Në vetvete, zhvillimi nënkupton marrjen përsipër të rreziqeve, por kur të gjitha këto mblidhen bashkë, mund të rrezikojnë jo vetëm aspekte të veçanta të mjedisit, por vetë ekzistencën e njerëzimit në këtë planet.¹⁴⁶ Mjafton të sjellim ndërmend rreziqet e përdorimit të energjisë bërthamore, si për qëllime civile, ashtu edhe për qëllime ushtarake, për të kuptuar shkallën e rreziqeve të cilat i kanosen mjedisit dhe njerëzimit.

Në aktet ndërkombëtare, parimi i parandalimit dhe i marrjes së masave paraprake ndeshet për herë të parë Kartën Botërore për Natyrën të miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e OKB në vitin 1982. Në Parimin 11§2 të saj, Karta sanksionon që “*Aktivitetet që ka gjasa të jenë të rrezikshme për natyrën do të paraprihen nga një ekzaminim tërësor; përkrahësit e tyre duhet të tregojnë që përfitimet e pritshme i tejkalojnë dëmet e mundshme ndaj natyrës, dhe aty ku dëmet e mundshme të pakthyeshme nuk kuptohen plotësisht, aktivitetet nuk duhet të vazhdojnë më.*”¹⁴⁷

Në të njëjtin vit u miratua edhe Konventa e OKB për të Drejtën e Detit, neni 194§2 i të cilës sanksionon se shtetet duhet të marrin të gjitha masat e nevojshme për të siguruar që veprimtaritë e kryera në territoret brenda juridiksionit ose kontrollit të tyre të mos u shkaktojnë dëme prej ndotjes shteteve të tjera dhe mjedisit të tyre, si edhe që ndotja që vjen nga një incident të mos përhapet përtej zonave ku ushtrohen të drejtat sovraane në përputhje me këtë Konventë.

¹⁴⁶ *Supra*, shënimi fundor nr. 130, fq. 3.

¹⁴⁷ Karta Botërore për Natyrën gjendet në: <http://www.un.org/documents/ga/res/37/a37r007.htm>

Parandalimit të dëmeve mjedisore i dedikohet e gjithë Konventa e Espoo-s për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis në Kontekstin Ndërkufitar e vitit 1991,¹⁴⁸ e cila synon zbatimin e parimeve 17 dhe 19 të Deklaratës së Rios, që prashikojnë se vlerësimi i ndikimit në mjedis si një instrument kombëtar duhet të ndërmerret për aktivitetet e propozuara që mund të kenë ndikim negativ dhe se shtetet duhet të njoftojnë sa më parë dhe në kohë shtetet që mund të preken, në një fazë të hershme dhe në mirëbesim. Në nenin 2§7 konventa parashikon se Vlerësimet e Ndikimit në Mjedis (VNM), si kërkesë minimale, do të ndërmerren në nivel projekti të veprimtarisë së propozuar dhe se palët do të përpiqen të zbatojnë parimet e vlerësimin të ndikimit të mjedisit në politikat, planet dhe programet që hartojnë. Ajo u kërkon shteteve palë që për një veprimtari të propozuar që mund shkaktojë një ndikim negativ të rëndë përtej kufijve, pala e origjinës, për hir të konsultimeve të mjaftueshme dhe efektive, do të njoftojë sa më shpejt të jetë e mundur dhe jo më vonë se sa njoftimi i publikut të saj për këtë veprimtari të propozuar, çdo palë që ajo konsideron që mund të jetë palë e prekur. Njoftimi duhet të përmbajë ndër të tjera, informacionin mbi veprimtarinë e propozuar, duke përfshirë çdo të dhënë të disponueshme për ndikimin ndërkufitar, natyrën e vendimit të mundshëm dhe një tregues të kohës së arsyeshme brenda së cilës kërkohet përgjigje, duke marrë parasysh natyrën e veprimtarisë së propozuar. Kur një palë mendon se mund të preket nga një ndikim negativ i rëndësishëm ndërkufitar prej një veprimtarie të propozuar dhe kur nuk është bërë asnjë njoftim, palët e interesuara, me kërkesë të palës së prekur, do të shkëmbejnë informacion të mjaftueshëm për të zhvilluar diskutime, nëse ekziston mundësia që të ketë ndikime negative të rëndësishme ndërkufitare. Në qoftë se palët nuk bien dakord, secila palë mund t'ia paraqesë këtë çështje një komisioni, për t'u këshilluar mbi mundësinë e një ndikimi negativ të rëndësishëm ndërkufitar, në rast se s'bien dakord për ndonjë metodë tjetër të zgjidhjes së mosmarrëveshjes. Palët e interesuara duhet të sigurojnë që publiku i palës së prekur në zonat që mund të preken të jetë i informuar dhe t'i jepen mundësitë për të bërë komente e për të kundërshtuar veprimtaritë e propozuara dhe për të transmetuar këto komente ose kundërshtime tek autoriteti kompetent i palës së origjinës, ose drejtpërdrejt këtij autoriteti ose nëpërmjet palës së origjinës.

Më pas, ky parim gjendet i sanksionuar edhe në Konventën OSPAR (Konventa për Mbrojtjen e Mjedisit Detar të Atlantikut Verilindor) të vitit 1992.¹⁴⁹ Në nenin 2§2§a të saj, konventa përcakton si detyrim të palëve, ndër parimet e tjerë, edhe zbatimin e parimit të parandalimit, sipas të cilit masa paraprake duhen marrë kur ka dyshime të arsyeshme për t'u shqetësuar në lidhje me shkarkimin në mjedisin detar të substancave apo energjisë, në mënyrë direkte ose indirekte, shkarkim që mund të shkaktojë dëme në shëndetin e njeriut, të gjallesave dhe të ekosistemeve detare, të dëmtojë instalimet apo të ndërhyjë në përdorimin e ligjshëm të detit, pavarësisht faktit nëse nuk ekzistojnë prova të pakundërshtueshme mbi lidhjen shkakësore midis aktit dhe pasojës. Mospasja e provave të pakundërshtueshme, pra mungesa e provave shkencore për shkak të mungesës së njohurive apo të informacionit shkencor, në lidhje me dëmet që mund t'u shkaktohen organizmave të gjallë, është përmendur edhe në nenet 10§6 dhe 11§8 të Protokollit të Kartagjenës për Sigurinë Biologjike (protokoll i Konventës për Biodiversitetin), nene që parashikojnë se këto mungesa nuk duhet të shërbejnë si arsye për palët që të mos marrin masa për të ndaluar importin e organizmave të gjallë të modifikuar, për të minimizuar efektet e

¹⁴⁸ Informacion i detajuar për Konventën e Espoo-s gjendet në: <http://www.unece.org/env/eia/eia.html>

¹⁴⁹ Konventa OSPAR gjendet në:

http://www.ospar.org/html_documents/ospar/html/ospar_convention_e_updated_text_2007.pdf

mundshme të dëmshme.¹⁵⁰ Në rastet e kërcënimeve për shkaktim dëmi serioz apo dëmi të pakthyeshem, mungesa e sigurisë shkencore nuk duhet të shërbejë si shkak për të shtyrë në kohë marrjen e masave me kosto efektive për të parandaluar degradimin e mjedisit. E thënë me fjalë të thjeshta, ky parim nënkupton që kurdoherë që ekzistojnë dyshime, vendimmarrja duhet të jetë në favor të mjedisit.

Përveç këtyre, parimi i i parandalimit dhe i marrjes së masave paraprake gjendet i shprehur në një sërë konventash, siç janë: Konventa Kuadër e Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike (UNFCCC) e vitit 1992,¹⁵¹ Konventa për Biodiversitetin e vitit 1992,¹⁵² Konventa e Helsinkit për Mbrojtjen dhe Përdorimin e Rrjedhave Ujore Ndërkufitare dhe Liqeneve Ndërkombëtarë e vitit 1992,¹⁵³ Konventa e Sofjes për Bashkëpunimin për Ruajtjen dhe Përdorimin e Qëndrueshëm të Lumit Danub e vitit 1994,¹⁵⁴ Konventa e Barcelonës për Mbrojtjen e Mjedisit Detar dhe Rajonit Bregdetar të Mesdheut e vitit 1976 (amenduar në vitin 1995),¹⁵⁵ Konventa e Bernës për Mbrojtjen e Rinit e vitit 1999,¹⁵⁶ etj.

Në fakt, në aktet e ndryshme ndërkombëtare vihet re një mungesë konsekuence në lidhje me vetë emërtimin e këtij parimi. Për shembull, Parimi 15 i Deklaratës së Rios thekson se në mënyrë që të mbrohet mjedisi, *qasja* [theksimi im] e marrjes së masave paraprake do të aplikohet gjerësisht prej shteteve, sipas kapaciteteve të tyre. Këtij formulimi i referohet edhe Konventa e Stokholmit për Ndotësit Organikë të Qëndrueshëm e vitit 2001, cila në nenin 1 sanksionon se duke mbajtur parasysh *qasjen* [theksimi im] e marrjes së masave paraprake siç është parashtruar në Parimin 15 të Deklaratës së Rios për Mjedisin dhe Zhvillimin,¹⁵⁷ objektivi i kësaj konvente është mbrojtja e shëndetit të njeriut dhe mjedisit prej ndotësve organikë të qëndrueshëm. Në të njëjtën mënyrë, në Protokollin e Londrës të vitit 1996 (amenduar në vitin 2006),¹⁵⁸ të Konventës për Parandalimin e Ndotjes së Mjedisit Detar prej Hedhjes së Mbetjeve dhe Materialeve të Tjera, të vitit 1972, neni 3 sanksionon se palët, në zbatimin e Protokollit do të zbatojnë *qasjen* [theksimi im] parandaluese për mbrojtjen e mjedisit.

Nga ana tjetër, në nenin 2 të Konventës OSPAR të përmendur më sipër, në nenin 3 të Konventës së Helsinkit për Mbrojtjen e Mjedisit Detar të Zonës së Detit Balltik dhe në nenin 5 të Konventës së Barcelonës për Mbrojtjen e Mjedisit Detar dhe Rajonit Bregdetar të Mesdheut, të vitit 1976 (amenduar në vitin 1995), parandalimi dhe marrja e masave paraprake është përcaktuar

¹⁵⁰ Protokollin e Kartagjenës për Sigurinë Biologjike gjendet në: <https://www.cbd.int/doc/legal/cartagena-protocol-en.pdf>

¹⁵¹ Konventa Kuadër e Kombeve të Bashkuara mbi Ndryshimet Klimatike (UNFCCC), neni 3§3. Gjendet në: <http://unfccc.int/resource/docs/convkp/conveng.pdf>

¹⁵² Konventa mbi Biodiversitetin, Preambula, parag. 9. Gjendet në: <https://www.cbd.int/doc/legal/cbd-en.pdf>

¹⁵³ Konventa e Helsinkit për Mbrojtjen dhe Përdorimin e Rrjedhave Ujore Ndërkufitare dhe Liqeneve Ndërkombëtarë, neni 2§5§a. Gjendet në: <http://www.unece.org/fileadmin/DAM/env/water/pdf/watercon.pdf>

¹⁵⁴ Konventa e Sofjes mbi Bashkëpunimin për Ruajtjen dhe Përdorimin e Qëndrueshëm të Lumit Danub, neni 2§4. Gjendet në: <http://www.icpdr.org/main/icpdr/danube-river-protection-convention>

¹⁵⁵ Konventa e Barcelonës për Mbrojtjen e Mjedisit Detar dhe Rajonit Bregdetar të Mesdheut, neni 4§1. Gjendet në: http://www.unep.ch/regionalseas/regions/med/t_barcel.htm

¹⁵⁶ Konventa e Bernës për Mbrojtjen e Rinit, nenet 4§a dhe 4§b. Gjendet në: http://www.iksr.org/fileadmin/user_upload/Dokumente_en/Convention_on_the_Protection_of_the_Rhine_12.04.99-EN_01.pdf

¹⁵⁷ Gjendet në: <http://chm.pops.int/TheConvention/Overview/TextoftheConvention/tabid/2232/Default.aspx>

¹⁵⁸ Gjendet në: http://www.gc.noaa.gov/documents/gcil_lp.pdf

shprehimisht si “*parimi* [theksimi im] i cili duhet respektuar nga të gjitha shtetet palë.” Ndërsa në mënyrë të habitshme, në Konventën e Bamakos për Ndalimin e Importit në Afrikë dhe Kontrollin e Lëvizjes Ndërkufitare dhe Menaxhimit të Mbetjeve të Rrezikshme Brenda Afrikës,¹⁵⁹ në të njëjtën dispozitë, në nenin 4§3§f, parandalimi dhe marrja e masave paraprake emërtohet në fillim si *qasje*, pastaj si *parim*. Në të thuhet: “Çdo palë do të përpiqet të adoptojë dhe zbatojë *qasjen* [theksimi im] e parandalimit, marrjen e masave paraprake ndaj problemeve të ndotjes, çka përfshin ndër të tjera parandalimin e lëshimit në mjedis të substancave që mund të dëmtojnë njeriun ose mjedisin, pa qenë nevoja të presin për prova shkencore në lidhje me këtë dëm. Palët do të bashkëpunojnë me njëra-tjetrën për marrjen e masave të duhura për zbatimin e *parimit* [theksimi im] të parandalimit të ndotjes së mjedisit nëpërmjet zbatimit të metodave të pastra të prodhimit... .” Nga ana tjetër, siç u përmend në paragrafin e mëparshëm, në nenet 10§6 dhe 11§8 të Protokollit të Kartagjenës për Sigurinë Biologjike, parashikohet se mungesat e provave shkencore nuk duhet të shërbejnë si arsye për palët që të mos marrin masa për të ndaluar importin e organizmave të gjallë të modifikuar, pra zbatim i qartë i *parimit* të parandalimit dhe marrjes së masave paraprake, ndërsa paragrafi i 5 i premabulës dhe neni 1 i Protokollit e quajnë atë çuditërisht ‘*qasje*’. Në rastin më të mirë, kjo është thjesht një shenjë pakujdesie në momentin e hartimit të traktateve, por në rastin më të keq është një tregues paqartësie në lidhje me vetë vlerën e këtij parimi.

Këtë paqartësi e shpreh edhe qëndrimi i SHBA kundrejt BE, në lidhje me raportin midis mjedisit dhe tregtisë. Ndërsa BE thekson zgjerimin përherë e më tepër të parimit të parandalimit dhe marrjes së masave paraprake, SHBA janë kategorisht kundër, duke pranuar ta zbatojnë atë vetëm në rastet kur mundësia e shkakimit të dëmit provohet nëpërmjet provave shkencore të sakta e të pakontestueshme.¹⁶⁰

Dallimin midis termave ‘*qasje*’ dhe ‘*parim*’ e ka ilustruar në mënyrë shumë elokumente në mendimin e tij paralel gjyqtari Laing, në vendimet e Gjykatës Ndërkombëtare për të Drejtën e Detit (ITLOS) në çështjen *Peshku Ton Bishtblu Jugor (Zelanda e Re kundër Japonisë dhe Australia kundër Japonisë)*, për marrjen e masave të përkohshme.¹⁶¹ Që në fillim, gjyqtari Laing shprehet se kjo çështje shtron trajtimin e problemit të pasigurisë shkencore në një kontekst gjyqësor. Kërkuesit i mbështetën pretendimet e tyre për marrjen e masave të përkohshme në nenet 64, 116–119 dhe 300 të UNCLOS, si edhe në detyrimet që burojnë prej parimeve të përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare, në veçanti në parimin e parandalimit. Por në argumentimin e saj shumica nuk i referohet këtij parimi por përmend mendimet e kundërta të paditësve dhe të paditurve dhe thekson që “...*palët duhet që sipas rrethanave të veprojnë me ‘maturi dhe kujdes’, për të garantuar që do të merren masa mbrotjëse efektive për të ruajtur gjendjen e peshkut.*” Megjithatë, nuk mund të mohohet që UNCLOS adopton një *qasje* parandaluese. Kjo mund të shihet ndër të tjera nga paragrafi 4 i preambulës, që identifikon si një aspekt të “*rendit juridik të deteve dhe oqeanëve...ruajtjen e burimeve të tyre të gjalla...*” Disa dispozita të Pjesës V të Konventës p.sh. nenet 63-66, mbi ruajtjen dhe përdorimin e një numri specimesh në zonën ekonomike ekskluzive, identifikojnë ruajtjen si një vlerë themelore. Po kështu, edhe nenet 61, 64, 116, 117, 118, 119, ku veçanërisht ky i fundit, së bashku me nenin 166, janë

¹⁵⁹ Gjendet në: <http://www.cetim.ch/en/documents/conv-bamako-ang.pdf>

¹⁶⁰ Philip Sand, “*Transnational Environmental Law*”, Kluwer Law International, London, 1999, fq. 134.

¹⁶¹ Vendimet e ITLOS në çështjen *Peshku Ton Bishtblu Jugor* gjenden në:

http://www.itlos.org/fileadmin/itlos/documents/cases/case_no_3_4/Order.27.08.99.E.pdf

konsideruar si ‘parimi i parandalimit’ në administrimin e peshkimit, ndërsa neni 199 është konsideruar se reflekton të drejtën zakonore të ‘qasjes’ parandaluese, “kur nuk ka të dhëna shkencore ose kur janë të pamjaftueshme për një vendimmarrje gjithëpërfshirëse”. Sa më sipër, duket qartë që gjykata ka adoptuar qasjen parandaluese në lidhje me marrjen e masave parandaluese, në raste si ky tanishmi. Sipas mendimit të gjyqtarit, “...duke adoptuar një ‘qasje’, në vend të një ‘parimi’, lejon një shkallë të duhur fleksibiliteti, i cili ndonëse jo në formën e një dispozitivi vendimi, nënvizon hezitimin për të bërë vlerësime të parakohshme rreth strukturave normative të dëshiruara.”¹⁶²

Në vendimin e saj në çështjen *Projekti Gabčíkovo-Nagymaros (Hungaria kundër Sllovakisë)*, datë 25.9.1997, GJND u shpreh se në sferën e mbrojtjes së mjedisit, vigjilenca dhe parandalimi janë të domosdoshme, duke mbajtur parasysh karakterin shpesh të pakthyeshëm të dëmeve mjedisore dhe të kufizimeve të natyrshme për pasjen e mekanizmave për riparimin e këtyre llojeve dëmeve. Ndër kohëra, njerëzimi ka ndikuar në mënyrë të vazhdueshme tek natyra për arsye ekonomike apo të tjera. Në të kaluarën, kjo shpesh është bërë pa i marrë parasysh pasojat në mjedis. Për shkak të zbulimeve të reja shkencore dhe të rritjes së shkallës së ndërgjegjësimit për dëmet e mundshme që mund t’i shkaktohen njerëzimit, brezave të tashëm dhe të ardhshëm, nga ndërhyrje të tilla pa e marrë në konsideratë mjedisin dhe me të tilla ritme të pandalshme, janë krijuar norma dhe standarde të reja të përfshira në një numër të madh instrumentesh në dy dekadat e fundit. Këto norma të reja duhet të mbahen parasysh dhe këtyre standardeve të reja duhet t’u kushtohet rëndësia e duhur, jo vetëm kur shtetet mendojnë të zhvillojnë aktivitete të reja, por edhe kur vazhdojnë ato të nisura më parë. Ndërsa në mendimin e pakicës, gjyqtari Weeramantry e konsideroi parandalimin dhe marrjen e masave paraprake si të përthithur në parimin më gjithëpërfshirës të zhvillimit të qëndrueshëm.¹⁶³

Në jurisprudencën e saj të mëpasme, GJND jo vetëm që e vlerëson si parim, por për më tepër, e ka konsideruar parimin e parandalimit si pjesë të së drejtës zakonore, në vendimin e saj në çështjen *Fabrikat e Letrës në Lumin Uruguaj (Argjentina kundër Uruguajit)*, datë 20.4.2010. Ajo u shpreh se parimi i parandalimit, si pjesë e së drejtës zakonore, e ka origjinën në kujdesin e duhur që një shtet duhet të tregojë në territorin e tij. Është detyrim i çdo shteti që të mos lejojë në mënyrë të vetëdijshme që territori i tij të përdoret për akte që çenojnë interesat e shteteve të tjerë, prandaj ai është i detyruar që të perdorë të gjithë mjetet që ka në dispozicion për të mos lejuar kryerjen e aktiviteteve në territorin e tij, apo në cilëndo zonë që ndodhet nën juridiksionin e tij, të cilat mund t’i shkaktojnë dëm të konsiderueshëm mjedisit të një shteti tjetër. Kjo gjykatë e ka përcaktuar tashmë se ky detyrim është pjesë e korpusit të së drejtës ndërkombëtare mjedisore.¹⁶⁴

Si parim mjedisor evropian, parandalimi dhe marrja e masave paraprake u përfshi për herë të parë në Programin e Pestë të Veprimit, të vitit 1993, si një nga parimet bazë që duhej të udhëhiqte të gjitha parimet e tjera. Edhe vendimi Nr. 2179/98/EC i Parlamentit Evropian dhe Këshillit, i datës 24.9.1998, i cili rishikoi Programin e Pestë të Veprimit, në nenin 11§7§c të tij

¹⁶² Mendimi paralel i gjyqtarit Edward A. Laing, paragraf. 16-19. Gjetet në:

http://www.itlos.org/fileadmin/itlos/documents/cases/case_no_3_4/Separate.Laing.27.08.99.E.pdf

¹⁶³ Vendimi i GJND *Hungaria kundër Sllovakisë*, datë 25.9.1997, paragraf. 140, Vendimi dhe mendimi i pakicës së gjyqtarit Weeramantry gjenden në: <http://www.icj-cij.org/docket/files/92/7375.pdf>

¹⁶⁴ Vendimi i GJND *Argjentina kundër Uruguajit*, datë 20.4.2010, paragraf. 101. Gjetet në: <http://www.icj-cij.org/docket/files/135/15877.pdf>

parashikonte: “...hartimin dhe prezantimin e një strategjie, e cila do të shpjerë, ndër të tjera, në zhvillimin e mëtejshëm të politikave të cilat do ezaurojnë tërësisht çështjet e Axhendës 21, për sa u përket kimikateve të dëmshme, duke i kushtuar vëmendje të veçantë **parimit të parandalimit** [theksimi im]...”¹⁶⁵

Traktati i Maastrichtit i vitit 1993, në nenin 130r§2 (aktualisht neni 174§2) përfshinte parimin e parandalimit, duke theksuar që “...Politika komunitare e mjedisit do të synojë mbrojtjen e tij në shkallën më të lartë, duke mbajtur parasysh situatat e ndryshme në rajonet e ndryshme të Komunitetit. Do të bazohet në **parimin e parandalimit dhe të marrjes së masave paraprake** [theksimi im]... .”

Nga sa shihet në të gjithë dokumentet e sipërpërmendur, askund nuk ndeshet një përkufizim i këtij parimi, pra çfarë përmban në vetvete ky parim. Ajo çka nënkuptohet nga konteksti i të gjithë dispozitave ku ky parim përmendet është se ai gjen zbatim në rastet kur shkenca nuk jep një përgjigje të saktë mbi dëmet që mund t’i vijnë mjedisit dhe shëndetit të të gjithë gjallesave, jo vetëm të njeriut. Në të gjitha rastet kur nuk ka prova të pakontestueshme, duhen marrë masa paraprake për të parandaluar ardhjen e pasojave të mundshme dhe jo të pritet për eliminimin e tyre më pas.

Për shkak të kësaj paqartësie, vetë Këshilli tregoi gatishmërinë për të vendosur mbi zbatimin më gjerësisht të këtij parimi, duke i kërkuar Komisionit Evropian të elaboronte mbi të. Nga ana e tij, Komisioni nëpërmjet Komunikimit të datës 2.2.2000, “Mbi Parimin e Parandalimit”, saktësoi se ky parim, edhe pse jo i përkufizuar në Traktat i cili e përmend vetëm një herë, për mbrojtjen e mjedisit ka një fushë veprimi shumë më të gjerë. Veçanërisht kur mungojnë të dhënat paraprake shkencore, por ka indicje të mundësisë për shkaktim dëmi ndaj mjedisit, apo shëndetit të njeriut, kafshëve ose bimëve, aktivitetet mund të mos jenë në përputhje me nivelin e lartë të mbrojtjes të zgjedhur nga Komuniteti. Ky parim duhet konsideruar në kuadër të një qasjeje të strukturuar të analizës së rrezikut, i cili përmban tre elementë: vlerësimin e rrezikut, menaxhimin e rrezikut dhe njoftimin në lidhje me të, por në mënyrë të veçantë ka të bëjë me menaxhimin e rrezikut.¹⁶⁶

Neni 95§3 i Traktatit të KE e detyron Komisionin që: “... në propozimet e tij...që kanë të bëjnë me shëndetin, sigurinë, mbrojtjen e mjedisit dhe të konsumatorit, do të marrë për bazë nivelin e lartë të mbrojtjes, duke mbajtur parasysh çdo zhvillim të ri të bazuar në fakte shkencore...”, ndërsa paragrafi i parë i nenit 152 të Traktatit të KE thekson se: “Niveli i lartë i mbrojtjes së shëndetit të njeriut do të garantohet në përkufizimet dhe zbatimin e të gjitha politikave dhe aktiviteteve të Komunitetit.”

Nga ana tjetër, vetë veprimet e Komisionit kanë qenë objekt shqyrtimi prej GJED, ku ajo ka analizuar respektimin e parimit të parandalimit dhe të marrjes së masave paraprake. Në vendimet e saj në çështjen e *Sëmundjes së Lopës së Çmendur*, Nr. C-157/96 dhe C-180/96, të vitit 1998, u shqyrtua vendimi i Komisionit për të ndaluar eksportin e mishit të lopës dhe të mishit të viçit nga Mbretëria e Bashkuar, me qëllim uljen e rrezikut të infektimit prej BSE (Bovine Spongiform

¹⁶⁵ Vendimi Nr. 2179/98/EC i Parlamentit Evropian dhe Këshillit. Gjetet në: <http://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:31998D2179&from=EN>

¹⁶⁶ Komunikimi i Komisionit Evropian, datë 2.2.2000, fq. 3. Gjetet në: http://ec.europa.eu/dgs/health_consumer/library/pub/pub07_en.pdf

Encephalopathy). Në këto vendime GJED u shpreh: “Kur ka pasiguri në lidhje me ekzistencën apo shkallën e rrezikut ndaj shëndetit të njeriut, institucionet mund të marrin masa mbrojtëse, pa patur nevojë të presin deri sa rreziqet dhe serioziteti i tyre të jenë qartësisht të dukshme¹⁶⁷ ...Kjo qasje rrjedh prej nenit 130r§1 të Traktatit të KE, sipas të cilit, politika e Komunitetit për mjedisin është që të ndjekë ndër të tjera, objektivin e mbrojtjes së shëndetit të njeriut. Neni 130r§2 sanksionon se kjo politikë synon të arrijë një nivel të lartë mbrojtjeje dhe kjo duhet të mbështetet në mënyrë të veçantë në parimin e parandalimit, që kërkesat e mbrojtjes së mjedisit të integrohen në përkufizimin dhe zbatimin e politikave të tjera të Komunitetit.”¹⁶⁸

Këtyre vendimeve u është referuar edhe Gjykata e Shkallës së Parë e BE, në vendimin Nr. T-199/96, të datës 16.7.1998, në paragrafin 66 të tij, ku ka përsëritur në mënyrë të plotë formulimin e GJED të sipërcituar.¹⁶⁹ Detyrimi për respektimin e parimit të parandalimit dhe të marrjes së masave paraprake është sanksionuar edhe në vendime të tjera të GJED. Në çështjen *Greenpeace France*,¹⁷⁰ gjykata interpretoi Direktivën 90/220/EEC të Këshillit, ndërsa në çështjen *Waddensee*,¹⁷¹ interpretoi Direktivën 92/43 (Direktivën e Habitave) dhe në të dy rastet parimi i parandalimit dhe i marrjes së masave paraprake është konsideruar si thelbësor për politikat komunitare.

Ndërsa në çështjen *Artegodan kundër Komisionit*,¹⁷² Gjykata e Shkallës së Parë të BE shqyrtoi paditë e disa kompanive farmaceutike kundër vendimit të Komisionit që urdhëronte heqjen nga tregu të produkteve mjekësore për përdorim nga njerëzit, produkte që përmbanin substanca me agjentë anorektikë, pas opinionit shkencor negativ të dhënë nga Komiteti për Produktet e Duhura Mjekësore, një komitet ky i Agjencisë Evropiane për Vlerësimin e Produkteve Mjekësore. Paditësit kërkonin shfuqizimin e vendimit të Komisionit, pasi ai binte ndesh me Direktivën e Këshillit 65/65/EEC, datë 26.1.1965, e cila autorizonte nxjerrjen në treg këtyre produkteve. Në dallim nga çështjet e sipërpërmendura, Gjykata e Shkallës së Parë vendosi kundër Komisionit, pasi në rastin konkret nuk kishte ndonjë të dhënë të re shkencore që të provonte dëmin që mund të shkaktonin këto substanca. Ajo theksoi se nuk kishte asnjë dyshim që mbrojtja e shëndetit publik kishte përparësi në krahasim me aspektet ekonomike, por në rastet kur ka pasiguri në lidhje me substancat, vendimmarrja i përket autoriteteve kompetente, të cilat duhet të marrin vendimin pikërisht duke u bazuar në parimin e parandalimit dhe të marrjes së masave paraprake. Origjina e parimit, theksoi gjykata, vjen prej nenit 174 të Traktatit të KE, i cili i jep atij karakter detyrues, për të arritur objektivin e mbrojtjes së shëndetit të njeriut, por pavarësisht se përmendet

¹⁶⁷ Vendimi C-157/96, datë 5.5.1998, parag. 64. Gjendet në:

<http://curia.europa.eu/juris/document/document.jsf?jsessionid=9ea7d2dc30d5ef4044ebc6604a94ad98a7eace2e997f.e34KaxiLc3qMb40Rch0SaxuNc3j0?text=&docid=43817&pageIndex=0&doclang=EN&mode=lst&dir=&occ=first&part=1&cid=57868>

¹⁶⁸ Vendimi C-180/96, datë 12.7.1998, parag. 99 & 100. Gjendet në:

<http://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/HTML/?isOldUri=true&uri=CELEX:61996CJ0180>

¹⁶⁹ Vendimi T-199/96, të datë 16.7.1998 gjendet në: <http://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:61996TJ0199&from=EN>

¹⁷⁰ Vendimi C-6/99, datë 21.3.2000, gjendet në: <http://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=CELEX:61999CJ0006>

¹⁷¹ Vendimi C-127/02, datë 7.9.2004, gjendet në: <http://curia.europa.eu/juris/liste.jsf?language=en&num=C-127/02>

¹⁷² Vendim i përbashkët i çështjeve Nr. T-74/00, T-76/00, T-83/00 to T-85/00, T-132/00, T-137/00 dhe T-141/00. Gjendet në

<http://curia.europa.eu/juris/showPdf.jsf?text=&docid=47533&pageIndex=0&doclang=EN&mode=lst&dir=&occ=first&part=1&cid=34006>

vetëm në lidhje me politikat mjedisore, shtrirja e tij është shumë më e gjerë, duke synuar arritjen e nivelit më të lartë të mbrojtjes së shëndetit, sigurisë së konsumatorit dhe të mjedisit, në të gjitha sferat e aktivitetit. Këto kërkesa janë të integruara në përkufizimin dhe zbatimin e të gjitha politikave dhe aktiviteteve komunitare, në kuptim të neneve 6 dhe 152 të Traktatit të KE, që nënkupton integrimin e mbrojtjes së shëndetit publik në politikat e tjera. Prej këtej, rrjedh që parimi i parandalimit dhe i marrjes së masave paraprake konsiderohet si parim i përgjithshëm i së drejtës komunitare, çka i vendos autoritetet para detyrimit për të marrë masat e duhura për të parandaluar rreziqet potenciale ndaj shëndetit publik, sigurisë dhe mjedisit. Meqë institucionet komunitare janë përgjegjëse për mbrojtjen e shëndetit publik, sigurisë dhe mjedisit, nga dispozitat e cituara të Traktatit të KE del që parimi i parandalimit dhe i marrjes së masave paraprake ka karakter autonom. Duke iu referuar edhe vendimit të GJED në çështjen e *Sëmundjes së Lopës së Çmendur*, Gjykata e Shkallës së Parë theksoi se në atë vendim GJED kishte zbatuar parimin e parandalimit dhe të marrjes së masave paraprake, në kuptim të proporcionalitetit. Në ato raste kur mendimi shkencor nuk e bën të mundur përcaktimin me një probabilitet të lartë, nëse ekziston apo jo një rrezik, autoritetet duhet të japin prova bindëse, të cilat ndoshta nuk mund të zgjidhin dilemat shkencore, por të paktën duhet të ngrenë dyshime të arsyeshme rreth sigurisë apo efektshmërisë së produkteve mjekësore.¹⁷³ Edhe pas ankimimit prej Komisionit, GJED la në fuqi vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë.¹⁷⁴

Një çështje tjetër në të cilën u diskutua diskrecioni i Komisionit për vendimmarrje bazuar në parimin e parandalimit dhe të marrjes së masave paraprake është ajo e *Suedisë kundër Komisionit* (çështja *paraquat*), e vitit 2007. Në vendimin e saj Nr. T-229/04, datë 11.7.2007, Gjykata e Shkallës së Parë shqyrtoi pretendimin suedez se Direktiva 2003/112 (që kishte amenduar Direktivën 91/414), e cila përfshinte *paraquat*-in si substancë aktive për mbrojtjen e bimëve (ndërkohë që në Suedi kjo substancë ishte e ndaluar), kishte shkelur parimin e parandalimit dhe të marrjes së masave paraprake (përveç parimit të integritetit dhe të garantimit të nivelit më të lartë të mbrojtjes), në kushtet e mungesës së informacionit shkencor mbi dëmin që mund të sillte kjo substancë në shëndetin e njeriut. Gjykata vlerësoi se Direktiva 91/414 kërkonte që në dritën e të dhënave shkencore aktuale dhe të njohurive teknike, produktet për mbrojtjen e bimëve nuk duhej të ishin të dëmshme për shëndetin e njeriut. Nga kjo del që duke e interpretuar këtë në kombinim me parimin e integritetit, në fushën e mbrojtjes së shëndetit të njeriut, ekzistenca e provave bindëse të cilat ndoshta nuk mund të zgjidhin dilemat shkencore, por të paktën duhet të ngrenë dyshime të arsyeshme rreth sigurisë së një substance mund të çojë, në parim, në refuzimin e përfshirjes së substancës në Aneksin 1 të Direktivës 91/414. Parimi i parandalimit dhe i marrjes së masave paraprake është formuluar që të parandalojë rreziqet potenciale. Në të kundërt, rreziqet thjesht hipotetike, të bazuar vetëm në hipoteza që nuk janë shkencërisht të konfirmuara, nuk mund të pranohen (siç kishte theksuar gjykata edhe në vendimin Nr. T-392/02, datë 21.10.2003, *Solvay Pharmaceuticals kundër Këshillit*). Në pjesën e dytë të vendimit gjykata u mor edhe me ndikimin në shëndetin e kafshëve dhe arriti në të njëjtin konkluzion për sa i përket mungesës së provave shkencore bindëse për dëmet potenciale të substancës.¹⁷⁵ Me këtë

¹⁷³ *Ibid.*, parag. 173, 182, 183, 185 dhe 192.

¹⁷⁴ Vendimi Nr. C-440/01 P(R), datë 14.2.2002, gjendet në:

<http://curia.europa.eu/juris/showPdf.jsf?text=&docid=46719&pageIndex=0&doclang=EN&mode=lst&dir=&occ=first&part=1&cid=35105>

¹⁷⁵ Vendimi i Gjykatës së Shkallës së Parë të BE, Nr. T-229/04, datë 11.7.2007, parag. 160 dhe 161. Gjendet në:

<http://curia.europa.eu/juris/showPdf.jsf?text=&docid=62401&pageIndex=0&doclang=en&mode=lst&dir=&occ=first&part=1&cid=38503>

vendim, gjykata pranoi marrjen e masave parandaluese dhe mbrojtëse në rastet e dyshimeve të forta mbi dëmet potenciale, por kërkon të mos lejojë abuzimin me parimin e parandalimit dhe të marrjes së masave paraprake për ta përdorur për qëllime proteksioniste nga ana e shteteve anëtare.¹⁷⁶

I gjithë thelbi i parimit të parandalimit dhe të marrjes së masave paraprake është që të pengohet shkaktimi i dëmeve, kështu që çdo veprim nga ana e shteteve anëtare që nuk mban parasysh këtë parim, mund të konsiderohet si shkelje e *acquis communautaire*. Siç u shpreh GJED në çështjen *Komisioni kundër Hollandës*, (e njohur ndryshe si çështja e *Vitaminave Hollandeze*),¹⁷⁷ një shtet anëtar, në përputhje me parimin e parandalimit dhe të marrjes së masave paraprake, mund të marrë masa mbrojtëse, pa patur nevojë të presë që ekzistenca dhe pasojat e këtij rreziku të bëhen të dukshme (duke iu referuar edhe jurisprudencës së mëparshme në çështjen *Unioni Kombëtar i Fermerëve*, parag. 63). Gjithësesi, vlerësimi i rrezikut nuk mund të mbështetet thjesht në hipoteza (përsëri referuar edhe jurisprudencës së mëparshme në çështjet *Monsanto Agricoltura Italia*, parag. 106; *Komisioni kundër Danimarkës*, parag.49; dhe *Komisioni kundër Francës*, parag. 56). Edhe pas këtyre vendimeve, në çështjen *Komisioni kundër Irlandës*, ku diskutohej shkelja prej kësaj të fundit e dispozitave të direktivave mbi menaxhimin e mbetjeve, meqë direktivat duhen interpretuar në përputhje me parimin e parandalimit dhe të marrjes së masave paraprake, nuk është e nevojshme që të ketë ardhur dëmi, që ato të konsiderohen se janë shkelur.¹⁷⁸

Ndërsa në ligjin shqiptar “Për mbrojtjen e mjedisit”, nr. 10 431, datë 9.6.2011, i ndryshuar, neni 7 i tij sanksionon se masat për mbrojtjen e mjedisit merren në një fazë të hershme të zhvillimit të çdo veprimtarie, në mënyrë që të parandalojnë apo, në rast se nuk është e mundur, të minimizojnë efektet negative të asaj veprimtarie në mjedis. Gjatë përcaktimit të masave dhe veprimtarive specifike të mbrojtjes së mjedisit zbatohet një qasje paraprake me qëllim që, në rast se ka kërcënime për dëme të rënda apo të pakthyeshme mbi mjedisin, mungesa e sigurisë shkencore të mos pengojë apo të mos shtyjë në kohë marrjen e masave efektive me kosto më të ulët, që parandalojnë dëmtimin e mjedisit.

Nga analiza e mësipërme e parimeve mjedisore mund të arrihet në përfundimin se fillimisht ato kanë patur vlerë orientuese, të shprehura në mënyrë deklarative në dokumente ndërkombëtare pa fuqi ligjore detyruese, por që tashmë kanë fituar statusin e normave të detyrueshme për t’u zbatuar, si në konventat e ndryshme ndërkombëtare, ashtu edhe në ato të adoptuara nga legjislacionet kombëtare të vendeve të ndryshme. Tashmë fokusi është zhvendosur nga riparimi i dëmit pasi ai ka ndodhur, tek marrja e masave paraprake që ai të mos ndodhë, në mënyrë që të ruhen burimet natyrore, biodiversiteti, ekosistemet, i gjithë mjedisi në tërësi. Nëse e drejta mjedisore nuk do të kishte evoluar përtej parimit ‘ndotësi paguan’, do të ishte absolutisht e

¹⁷⁶ Zsuzsana Horváth, “Principles of integration and precaution in the case law of the European Courts”, fq. 80, në Gyula Bándi, (red.), “The Impact of ECJ Jurisprudence on Environmental Law”, Akaprint Kft, 2009.

¹⁷⁷ Vendimi Nr. C-41/02, datë 2.12.2004, parag. 52. Gjendet në:

<http://curia.europa.eu/juris/showPdf.jsf?text=&docid=49727&pageIndex=0&doclang=en&mode=lst&dir=&occ=first&part=1&cid=306696>

¹⁷⁸ Vendimi Nr. C-494/01, datë 26.4.2005, parag. 160. Gjendet në:

<http://curia.europa.eu/juris/showPdf.jsf?jsessionid=9ea7d2dc30d509ab2b017680409a94aaadca0c537c51.e34KaxiLc3qMb40Rch0SaxuNc3j0?text=&docid=58802&pageIndex=0&doclang=EN&mode=lst&dir=&occ=first&part=1&cid=159073>

pamundur të përballoheshin problemet aktuale mjedisore në rang global, siç janë mbrojtja e shtresës së ozonit apo reduktimi i efekteve negative të ngrohjes globale, e aq më pak, mbajtja parasysh e interesave të brezave të ardhshëm.

Ndër të tjera, parimet shërbejnë edhe për të ndihmuar në interpretimin e normave ligjore e nënligjore të cilat duhet të jenë në harmoni me to, si edhe të detyrimeve që shtetet marrin përsipër në kuadër të traktateve. Në këtë rritje të vazhdueshme të rëndësisë së tyre, ka qenë i pazëvendësueshëm roli i gjykatave, e veçanërisht atyre të BE, siç ilustron shembujt e sjellë nga jurisprudenca e tyre. Ndërsa për trajtimin e këtyre parimeve në jurisprudencën e GJEDNJ do të bëhet një analizë e veçantë në Kreun VII, ‘Mbrojtja e mjedisit dhe të drejtat e njeriut’.

KREU III

MBROJTJA E AJRIT

Cilësia e ajrit është përkeqësuar dramatikisht në shumë vende. Sipas Organizatës Botërore të Shëndetësisë (OBSH), të paktën 3 milionë njerëz vdesin çdo vit nga sëmundjet e shkaktuara nga ndotja e ajrit, prej të cilëve 1.7 milionë vdesin nga kanceri i mushkërive. Ndërsa në Tiranë vdesin rreth 500 banorë në vit dhe u shkurtohet jeta mesatarisht me 2 vjet banorëve të saj për shkak të ndotjes së ajrit.¹⁷⁹

Me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit dhe marrjen e masave ndaj ndotjes së ajrit, që në vitin 1661 u botua në Londër pamfleti “*Fumifugium*” i publicistit John Evelyn, që njihet si një nga veprat e para në të cilën trajtohet problemi i ndotjes së ajrit dhe dëmtimet që i shkaktohen shëndetit të njeriut dhe bimësisë prej tymrave ndotës.¹⁸⁰

Ndotësit që rezistojnë gjatë, grumbullohen në ekosistemet, e prej këtij tek njerëzit, pasi ato transportohen nga rrymat ajrore prej rajoneve industriale që mund të ndodhen mijëra kilometra larg. Një nga mënyrat për të siguruar mbrojtjen e ajrit është nëpërmjet marrjes së masave për mbrojtjen e shtresës së ozonit. Shkatërrimi i shtresës së ozonit në stratosferë është një problem mjedisor që rezulton nga rritja e sasisë së gazeve ndotës të çliruar në atmosferë. Dukuria e shkatërrimit të shtresës së ozonit lidhet më tepër me ndotjen e ajrit nga efektet industriale, veçanërisht nga klorofluorokarbonet (CFC), të cilat gjenden tek ngrirësit dhe aerosolet, sesa me ndotjen bujqësore të ajrit. Transporti në ajër i ultratingujve dhe valëve mendohet të kontribuojë në shkatërrimin e ozonit.¹⁸¹

Çarjet më të mëdha të shtresës së ozonit ndodhen mbi Antarktidë dhe mbi Amerikën e Veriut. Si rezultat i tyre ka ardhur edhe rritja e temperaturës mesatare të sipërfaqes së Tokës, e cila aktualisht është afërsisht 15°C. Gjatë 100 vjetëve të kaluar (1906 – 2005), temperatura mesatare është rritur me 0.74 ± 0.18°C. Për krahasim, ngrohja pas periudhës së fundit akullnajore ishte në shkallë globale 4–7°C dhe kjo ndodhi përgjatë 5,000 vjetëve. Ajo ngrohje ishte 10 herë më e ngadaltë se kjo që po provojmë ne sot. Pra, aktualisht duket se Toka po përballet me një ngrohje të shpejtë.¹⁸² Si rrjedhojë e aktivitetit të shtuar njerëzor, atmosfera është gjithnjë e më tepër duke u ndotur me më shumë gaze, duke u bërë një izolator i fortë dhe duke mbajtur më shumë nxehtësi të ardhur nga dielli. Shkencëtarët parashikojnë ngrohje të mëtejshme me 1.4 deri 5.8°C në vitin 2100, nëse nuk merren masa të rrepta për të ulur nivelin e gazeve që çlirohen në atmosferë. Një rritje e tillë temperature shkrin kurorat e akullit polar dhe akullnajat, ngroh oqeanet dhe këto së bashku zmadhojnë vëllimin e oqeanëve dhe ngrenë nivelin e detit me rreth 9 deri 100 cm, gjë që shkaktonte përmbytje në rajonet bregdetare.

¹⁷⁹ Statistikat e OBSH gjenden në: <http://www.who.int/mediacentre/factsheets/fs297/en/>

¹⁸⁰ Romeo Hanxhari, “Politikat e Mjedisit. Niveli global dhe niveli lokal. Analizë teorike dhe raste studimi”, Intergrafika, 2011, fq. 10.

¹⁸¹ Vezir Muharremaj, “Shkenca e Tokës”, Vol. 2, Polis Press, 2013, fq. 213.

¹⁸² *Ibid.*, fq. 119.

3.1 Legjislacioni ndërkombëtar për mbrojtjen e ajrit

Masat legislative për mbrojtjen e ajrit i kanë fillimet shumë të hershme, që me nxjerrjen e dekretit mbretëror nga mbreti Eduard I në vitin 1273, mbi kufizimin e çlirimit të tymit të zi nga djegia e qymyrgurit brenda qytetit, çka shkaktonte ndotje të rëndë të ajrit në qytetet e Anglisë.¹⁸³

Në nivel kombëtar, akti i parë gjithëpërfshirës për mbrojtjen e ajrit ishte Ligji për Ajrin e Pastër (Clean Air Act) i miratuar në SHBA në vitin 1970 dhe amenduar në vitet 1977 dhe 1990, për të përfshirë edhe masat parandaluese ndaj shiut acid dhe dëmtimit të shtresës së ozonit. Ky ligj vendosi për herë të parë marrjen e masave nga ana e Agjencisë për Mbrojtjen e Mjedisit të SHBA për të ndaluar ndotjen e ajrit nga grimcat e ngurta, dioksidi i sulfurit, dioksidi i nitrogjenit, monoksidi i karbonit dhe plumbi.¹⁸⁴

Në nivel rajonal, dokumenti i parë me fuqi detyruese që trajtonte problemet e ndotjes së ajrit ishte Konventa për Ndotjen Ndërkufitare të Ajrit në Distanca të Largëta (LRTAP) e vitit 1979, e miratuar në kuadrin e veprimtarisë së Komisionit Ekonomik të OKB për Evropën (UNECE).¹⁸⁵ Konventa vendosi themelet e bashkëpunimit midis vendeve evropiane për të ulur nivelin e ndotjes së ajrit dhe krijoi edhe kuadrin institucional për këtë qëllim, duke bashkuar hartimin e politikave dhe kërkimin shkencor. Ajo është pasuar nga 8 protokolle, secili i fokusuar në një element të veçantë të ndotjes së ajrit, siç është financimi i Programit të Monitorimit të Ndotjes Ndërkufitare në Evropë, ulja e nivelit të çlirimit të sulfurit, të oksideve të nitrogjenit, të përbërësve organikë të avullueshëm (VOC), të metaleve të rëndë, të ndotësve organikë të qëndrueshëm (NOQ) dhe për uljen e acidifikimit të ozonit të nivelit pranë tokës.

Palët kontraktuese duhet të bëjnë konsultime sa më shpejt të jetë e mundur me njëra-tjetrën, në rastet kur janë efektivisht të prekura ose të ekspozuara ndaj një rreziku potencial nga ndotja ndërkufitare e ajrit në distancë të madhe dhe nga ana tjetër, me palët kontraktuese mbi territorin dhe në juridiksionin e të cilave krijohet ose mund të krijohet një ndotje e madhe ndërkufitare e ajrit në distancë të madhe si rezultat i aktiviteteve që kryhen, janë kryer ose parashikohen të kryhen. Ato duhet të shkëmbejnë informacione dhe të zhvillojnë aktivitete e vrojtime si edhe të shkëmbejnë rezultatet e tyre, kostot dhe efikasitetin e masave të marra për të luftuar ndotjen e ajrit. Ato duhet të angazhohen për të përpunuar politika e strategji më të mira, përfshirë sistemet e administrimit të cilësisë së ajrit dhe në kuadrin e këtyre sistemeve, të masave të kontrollit që janë të pajtueshme me një zhvillim të ekuilibruar, duke iu drejtuar veçanërisht teknologjive më të mira që disponohen dhe ekonomikisht më të zbatueshme si dhe teknikave që shkaktojnë pak ose aspak mbetje. Konventa përcaktoi që përfaqësuesit e palëve kontraktuese do të përbënin Organin Ekzekutiv të saj, i cili në mbledhjet e përvitshme merr në shqyrtim zbatimin e konventës, krijon grupet e punës për të studiuar çështjet që lidhen me zbatimin dhe zhvillimin e saj, bën përgatitjen e studimeve dhe parashtrimin e rekomandimeve. Po ashtu, u vendos që Sekretariati Ekzekutiv i Komisionit Ekonomik për Evropën do të merrte përsipër, për llogari të Organit Ekzekutiv, edhe funksionet e Sekretariatit të konventës.¹⁸⁶

¹⁸³ Ellyn Adrienne Hershman, "California Legislation on Air Contaminant Emissions from Stationary Sources", California Law Review, Vol. 58, Nr. 6, 1970, fq. 1474.

¹⁸⁴ Për informacion më të hollësishëm shih <http://www.epa.gov/air/caa/index.html>

¹⁸⁵ Për informacion më të hollësishëm shih http://www.apis.ac.uk/overview/regulations/overview_CLRTAP.htm

¹⁸⁶ Konventa mbi Ndotjen Ndërkufitare të Ajrit në Distanca të Largëta (LRTAP), nenet 5, 6, 10 dhe 11.

Përveç konventës LRTAP të vitit 1979 dhe protokolleve të saj, një traktat shumë i rëndësishëm ndërkombëtar për mbrojtjen e ajrit në nivel global është Konventa e Vjenës për Mbrojtjen e Shtresës së Ozonit e vitit 1985, e pasuar nga protokollat e saj shtesë.¹⁸⁷ Kryesori ndër ta është Protokollin e Montrealit të vitit 1987, mbi Substancat që Dëmtojnë Shtresën e Ozonit, i cili është rishikuar 7 herë: në vitin 1990 në Londër, në vitin 1991 në Nairobi, në vitin 1992 në Kopenhagen, në vitin 1993 në Bangkok, në vitin 1995 në Vjenë, në vitin 1997 në Montreal, dhe në vitin 1999 në Pekin. Sot këto traktate numërojnë 197 palë, përfshirë të gjithë shtetet e OKB, BE, si edhe Ishujt Niue dhe Ishujt Cook. Kësisoj, mbeten traktatet më të ratifikuara në historinë e OKB dhe mund të thuhet me siguri të plotë se kanë siguruar pranim universal sot në botë.

Vetë teksti i Konventës së Vjenës për Mbrojtjen e Shtresës së Ozonit nuk përmban detyrime të qarta për shtetet palë, por vetëm ofron një platformë për nxitjen e shteteve që të marrin masat e duhura legjislative dhe administrative për të luftuar dëmtimin e shtresës së ozonit, duke rritur bashkëpunimin nëpërmjet vëzhgimeve dhe kërkimeve shkencore sistematike, duke shkëmbyer informacion, në mënyrë që të kuptohet më mirë ndikimi që ka aktiviteti njerëzor në shtresën e ozonit, si edhe ndikimi që ka dëmtimi i kësaj shtrese në mjedisin dhe shëndetin njerëzor. Për sa i përket bashkëpunimit midis shteteve, theksi vihet më tepër në mbajtjen parasysh të nevojave që kanë vendet në zhvillim, drejt të cilave vendet e industrializuara duhet të transferojnë teknologjitë e avancuara dhe njohuritë shkencore, nëpërmjet ofrimit të pajisjeve të ndryshme dhe trainimit të personelit të këtyre vendeve.¹⁸⁸

Nga ana tjetër, roli kryesor i kësaj konvente i atribuohet faktit se shërbeu si pikënisje për Protokollin e Montrealit të vitit 1987. Në të drejtën e traktateve, protokollin është një instrument me anën e të cilit bëhet i mundur zbatimi në praktikë i detyrimeve që përcakton traktati dhe përmbushja e objektivave të tij, duke përshpejtuar procedurat dhe eliminuar pengesat procedurale dhe formalitetet që kërkon një traktat. Pikërisht për këto arsye, bazuar në nenet 2 dhe 8 të Konventës së Vjenës për Mbrojtjen e Shtresës së Ozonit, u hartua Protokollin e Montrealit, i cili përcakton rregulla specifike për sa i përket uljes së prodhimit, konsumit dhe tregimit të substancave ozon-holluese si edhe mekanizmat mbikëqyrës për zbatimin e këtyre rregullave.

Ky regjim ka ardhur duke u përpunuar përherë e më tepër në rishikimet që i janë bërë Protokollit të Montrealit në takimet e përfaqësuesve të palëve të përmendur më lart. Lidhja midis këtyre dokumenteve të së drejtës ndërkombëtare mjedisore është përcaktuar nga neni 16 i konventës, i cili sanksionon se shtetet apo organizatat rajonale të integritit ekonomik nuk mund të bëhen palë në protokolle pa qenë palë edhe në konventë, duke e bërë një kusht *sine qua non* pranimin e dispozitave të konventës.

Të dy konventat për mbrojtjen e ajrit janë shembulli më i mirë për progresin gradual që mund të arrihet për të përballuar problemet e ndotjes. Ato nisën thjesht si udhërrëfyese për të nxitur procesin e bashkëpunimit midis shteteve, për t'u plotësuar më pas nga protokollat shtesë, që në tërësinë e tyre kanë patur efekt pozitiv.

¹⁸⁷ Teksti i plotë dhe protokollat shtesë gjenden në: http://ozone.unep.org/Publications/VC_Handbook/VC-Handbook-2012.pdf

¹⁸⁸ Konventa e Vjenës për Mbrojtjen e Shtresës së Ozonit, neni 4.

E njëjta strategji mund të ndiqet edhe për sa i përket përpjekjeve në rang botëror për t'u përballur me ndryshimet klimatike, pasi përveç çarjes së shtresës së ozonit, ky është kërcënimi i dytë më serioz që i kanoset atmosferës. Për këtë qëllim, në vitin 1992 u miratua Konventa Kuadër e Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike (UNFCCC), e cila hyri në fuqi në vitin 1994. Sot kjo konventë numëron 195 palë, duke qenë një ndër konventat më universale në botë, e pranuar gjerësisht.

Siç u përmend në fillim të punimit, Konventa për Ndryshimet Klimatike është një ndër tre konventat e miratuara në Samitin e Rios, së bashku me Konventën për Biodiversitetin dhe Konventën për të Luftuar Shkretëtirëzimin. Të tre këto traktate të rëndësishme mjedisore janë të lidhur ngushtë me njëri-tjetrin, e për të realizuar në praktikë këtë ndërveprim, është ngritur edhe Grup i Përbashkët Kooordinues. Ky grup e ka zgjeruar fushën e aktivitetit të tij duke përfshirë edhe Konventën e Ramsarit për Ligatinat me Rëndësi Ndërkombëtare, Veçanërisht si Habitata të Shpendëve Ujorë.¹⁸⁹

Sipas UNFCCC, qeveritë angazhohen të shkëmbejnë informacion për lëshimet e gazeve serë, për politikat kombëtare dhe praktikat më të mira, që të mund të përhapen edhe në vendet e tjera, të zbatojnë strategjitë kombëtare për trajtimin e lëshimit të gazeve serë dhe përshtatjen ndaj ndikimeve të pritshme, përfshirë dhënie e mbështetjes financiare e teknologjike vendeve në zhvillim, si edhe të nxisin bashkëpunimin për përgatitjen për përshtatjen ndaj ndikimeve të ndryshimeve klimatike. Qëllimi kryesor i konventës është parandalimi i veprimtarive njerëzore që janë të rrezikshme dhe që ndryshojnë sistemin klimatik.

Zbatimi i konventës ka kaluar nëpër disa etapa, duke nisur fillimisht nga pranimi i faktit që ndryshimet klimatike përbënin një problem global. Kjo nuk ishte e thjeshtë për t'u bërë në 1994, kur edhe të dhënat shkencore nuk ishin të njëjtit nivel me të dhënat që disponohen sot, pavarësisht kontestimit që u bëhet edhe këtyre. Konventa adoptoi një prej elementëve të një marrëveshjeje tjetër ndërkombëtare shumë të suksesshme, siç ishte Protokollin e Montrealit i vitit 1987, marrjen përsipër prej palëve të detyrimit për marrë masa në interes të njerëzimit edhe në kushtet e mungesës së provave të plota shkencore.¹⁹⁰ Ky është pikërisht zbatim i parimit të parandalimit dhe të marrjes së masave paraprake të analizuar më sipër.

Në qendër të masave reaguese ndaj ndryshimeve klimatike qëndron nevoja për pakësimin e lëshimit të gazeve serë. Palët kanë rënë dakord që lëshimet duhet të pakësohen në masë të tillë që rritja e temperaturës globale të kufizohet nën 2°C, i konsideruar si një objektivi specifik dhe si një prag që i stabilizon gazet serë në një nivel që parandalon ndikimin e faktorëve të rrezikshëm të shkaktuar prej njeriut, në sistemin klimatik. Ky nivel duhet të arrihet brenda një kuadri të tillë që t'i lejojë ekosistemet të adaptohen në mënyrë të natyrshme ndaj ndryshimeve klimatike, të garantohet sigurimi i prodhimit të ushqimeve dhe të mundësohet zhvillimi ekonomik i qëndrueshëm. Për të përmbushur këto objektiva, barra kryesore u bie vendeve të industrializuara, të cilët janë edhe ndotësit më të mëdhenj. Ato marrin përsipër që të caktojnë fonde të veçanta për ndërmarrjen e veprimtarive në vendet në zhvillim të cilat kanë të bëjnë me përballimin e ndryshimeve klimatike, si edhe të transferojnë teknologjitë e tyre të avancuara drejt këtyre vendeve.

¹⁸⁹Për informacion të hollësishëm mbi UNFCCC, shih: <http://unfccc.int/2860.php>

¹⁹⁰ *Ibid.*

Konventa i klasifikon vendet palë në tre grupe, të ndarë sipas anekseve. Aneksi I përfshin Vendet e Industrializuara dhe Ekonomitë në Tranzicion (EIT), të cilat duhet të raportojnë rregullisht mbi politikat e tyre të ndryshimeve klimatike, për çështjet e Protokollit të Kiotos, për ato vende që e kanë ratifikuar atë, si edhe duhet të paraqesin një inventar vjetor të gazeve serë, përfshirë bazën e të dhënave duke filluar që nga viti bazë 1990, e në vazhdim. Aneksi II përfshin vetëm vendet e industrializuara, të cilat sigurojnë burime financiare për të ndihmuar vendet në zhvillim dhe nxisin transferimin e teknologjive ndaj vendeve që nuk janë anëtare të Aneksit I.¹⁹¹

Ndërsa në grupin e tretë futen vendet e quajtura “Jo të Aneksit I”, praktikisht vendet në zhvillim, ku bën pjesë edhe Shqipëria. Këto vende nuk kanë detyrime sasiore në lidhje me UNFCCC dhe kanë trajtim të diferencuar, për shkak se janë edhe ndotësit më të vegjël.

Në mënyrë të ngjashme me Konventën LRTAP të analizuar më sipër, edhe UNFCCC cakton Konferencën e Palëve si organ që mbikëqyr zbatimin e dispozitave të saj, Sekretariatit si organ që ushtron funksione administrative, si edhe dy organe ndihmëse të Konferencës së Palëve, njërin që i ofron kësaj të fundit këshilla shkencore dhe teknologjike, ndërsa tjetrin për të mbikëqyruar, vlerësuar dhe rishikuar zbatimin me efektivitet të konventës.¹⁹²

Pesë vjet pas miratimit të konventës në vitin 1997 në Japoni, 160 vende, ndër to edhe Shqipëria, hartuan një marrëveshje shumë më të fortë, të quajtur Protokollin e Kiotos. Protokollin sot numëron 192 shtete palë. Ky traktat, që hyri në fuqi në shkurt 2005, miratoi një formulë për uljen e nivelit të lëshimeve të gazeve serë, sipas të cilës vendet në zhvillim favorizoheshin prej pagesave të vendeve të zhvilluara. Traktati sanksiononte që vendet e industrializuara, të cilat çlirojnë shumicën e gazeve serë, të zvogëlojnë lëshimin e tyre në nivele 5% më të ulët se ato të vitit 1990. Ky pakësim duhej të arrihej jo më vonë se viti 2012, por që në fakt ky objektiv nuk u arrit. Në Protokollin e Kiotos u përcaktuan objektiva të detyrueshme për vendet e industrializuara dhe Komunitetin Evropian, si dhe objektiva vullnetare për vendet e tjera, për pakësimin e lëshimit të gazeve serë, të cilat përfshijnë dioksidin e karbonit, metanin, grupin e hidrofluorokarbonit dhe gaze të tjerë.

Zbatimi i Protokollit të Kiotos ka hasur në vështirësi, pasi rritja ekonomike kërkon rritjen e gazeve serë. Ka disa përpjekje në këtë drejtim. P.sh., vendet që kanë vështirësi për përmirësim të mëtëjshme si Holanda, mund të blejnë kredite ndotjeje në treg ose ndoshta i fitojnë ato duke ndihmuar pakësimin e gazeve serë në vendet më pak të zhvilluara, ku mund të arrihet më shumë, me shpenzime më të pakta. Sidomos Rusia përfitoi nga ky sistem. Që atëherë ekonomia ruse ka pakësuar lëshimin e gazeve serë më tepër se 5% në nivelin e vitit 1990, kur industria e rëndë e ish-Bashkimit Sovjetik kishte norma shumë të larta ndotjeje, dhe sot është në një pozicion që u shet kredite lëshimi gazesh vendeve të tjera të industrializuara, veçanërisht vendeve të Bashkimit Evropian.

Megjithatë, interesat ekonomike të shteteve kanë qenë mbizotëruese në raport me respektimin e traktateve të tilla mjedisore. SHBA, megjithëse e nënshkruan Protokollin e Kiotos, nuk e ratifikuan atë. Në 2001, Presidenti i SHBA George W. Bush deklaroi heqjen dorë nga ratifikimi i

¹⁹¹ UNFCCC, neni 4.

¹⁹² *Ibid.*, nenet 7-10.

traktatit, për shkak se pakësime të tilla të dioksidit të karbonit në SHBA do të ishin shumë të kushtueshme. Pas kësaj, ishte befasuese edhe tërheqja e Kanadasë në dhjetor të vitit 2011, me argumentin se sipas Protokollit të Kiotos, Kanada duhet të paguante 13.6 miliardë USD, në një kohë që dy ndotësit më të mëdhenj, SHBA dhe Kina nuk paguanin. Ky ishte një veprim zhgënjyes për ambientalistët, pasi Kanadaja është ndër vendet me politika dhe legjislacion më të avancuar mjedisor në botë.

Për rëndësinë që ka, çdo vit OKB organizon konferencën për ndryshimet klimatike, ku marrin pjesë përfaqësues pothuajse nga të gjithë shtetet dhe ku diskutohet për zbatimin e Konventës Kuadër të OKB për Ndryshimet Klimatike dhe Protokollit të Kiotos për Pakësimin e Lëshimit të Gazeve Serë, Planin e Veprimit të Balit, si dhe Marrëveshjet e Kankunit lidhur me ndryshimet klimatike.

Në fund të vitit 2012, në Doha të Katarit u zhvillua Konferenca Ndërkombëtare e përvitshme për Ndryshimet Klimatike. Në Konferencë u amendua Protokollin e Kiotos, ku palët morën përsipër detyrimin që të zvogëlojnë lëshimin e gazeve serë gjatë periudhës 2013-2020 në nivele të paktën 18% më të ulët se viti 1990, si edhe u ra dakord që në vitin 2015 të arrihet një marrëveshje nga të gjithë shtetet, që të hyjë në fuqi në vitin 2020, për pakësimin e lëshimit të gazeve serë, me synimin që rritja e temperaturës të mbahet maksimumi nën 2°C. Vendet e zhvilluara pranuan të vazhdojnë mbështetjen e tyre financiare afatgjatë me shumën prej 6 miliardë USD deri në vitin 2015 dhe me 100 miliardë USD deri në vitin 2020 për masat e përshtatjes dhe zbutjes së ndryshimeve klimatike në vendet e varfëra.

Ndërsa në konferencën e vitit 2013 në Varshavë, u vendos vazhdimi i përpjekjeve për të arritur një marrëveshje mbi ndryshimet klimatike në vitin 2015. Objektivi i marrëveshjes së vitit 2015 do të jetë i dyfishtë. Së pari ajo synon të bëjë bashkë shtetet për të rritur përpjekjet globale për zvogëlimin e nivelit të shkarkimeve në ajër, aq shpejt, sa që njerëzimi të largohet nga rruga drejt zonës së rrezikut për ndryshimet klimatike, ndërkohë duke ngritur edhe kapacitetet përshtatëse. Së dyti, synon të stimulojë një veprim ndërkombëtar më të shpejtë e më të gjerë.¹⁹³

Sot mbetet ende aktuale nevoja për uljen e nivelit të shkarkimeve me më shumë se 50% deri në 2050 dhe sidomos për një ristrukturim të plotë të sistemeve energjetike, që përlllogaritet në rreth 20 trilionë dollarë në infrastrukturën e furnizimit me energji deri në vitin 2030, ku gjysma e kësaj shume duhet investuar në vendet në zhvillim. Në këtë prizëm, mbeten sfidë investimet për energjitë e rinovueshme, për panelet diellorë dhe turbinat e erës. Në përputhje me nenin 12 të Protokollit, është zhvilluar edhe Mekanizmi i Zhvillimit të Pastër (MZHP), i cili i mundëson një vendi të zhvilluar, të zbatojë një projekt për uljen e nivelit të shkarkimeve në një vend në zhvillim. Ky projekt sjell fitimin e krediteve të çertifikuara, secili i barabartë me 1 ton CO₂, që llogaritet kundrejt arritjes së objektivave të Kiotos. Një projekt i tillë mund të jetë për shembull një projekt elektrifikimi rural duke përdorur panele diellorë. Qëllimi i mekanizmit është të stimulojë zhvillimin e qëndrueshëm dhe uljen e nivelit të shkarkimeve, duke u lejuar fleksibilitet vendeve të zhvilluara për të arritur objektivat e tyre.¹⁹⁴

¹⁹³ http://unfccc.int/key_steps/warsaw_outcomes/items/8006.php

¹⁹⁴ http://unfccc.int/kyoto_protocol/mechanisms/clean_development_mechanism/items/2718.php

Ngjarjet ekstreme të kohëve të fundit janë tregues të ndikimit të ndryshimeve klimatike, që sipas mendimit shkencor ka shumë gjasa të jenë shkaktuar prej aktivitetit njerëzor. Ndryshimet në frekuencat dhe intensitetin e temperaturave ekstreme janë dyfishuar që prej mesit të shekullit XX, ndërsa 14 vitet e parë të shekullit XXI kanë sjellë temperatura rekord, shkrirjen e akujve në Arktik, valë të jashtëzakonshme të nxehti në Evropën Perëndimore në vitin 2003 dhe në Rusi në vitin 2010, uraganin Katrina në vitin 2005 që ishte më shkatërrimtari deri më sot në Atlantik, dhe përmbajtje masive në shumë vende të botës, përfshirë ato në Pakistan në vitin 2010 që prekën mbi 20 milionë njerëz. Ndërsa viti 2013 shënoi temeperatura rekord në Australi dhe Kinë dhe thatësira të tejzgjatura në Brazil dhe SHBA. Sipas Raportit të Pestë të Panelit Ndërqeveritar për Ndryshimet Klimatike (IPCC) të vitit 2013¹⁹⁵ dhe Akademive të Shkencave të 11 prej vendeve më të zhvilluara të botës,¹⁹⁶ SHBA-së, Japonisë, Gjermanisë, Francës, Mbretërisë së Bashkuar, Italisë, Brazilit, Kanadasë, Kinës, Indisë dhe Rusisë, të dhënat shkencore mbi ndryshimet klimatike janë tashmë të plota për t'i nxitur shtetet të marrin masa të menjëhershme.

3.2 Legjislacioni evropian për mbrojtjen e ajrit.

Që nga koha e Revolucionit Industrial në shekujt XVIII-XIX cilësia e ajrit në Evropë ka ardhur duke u përkeqësuar, si rezultat i rritjes së prodhimit industrial dhe të prodhimit të energjisë, shtimit të trafikut, etj. Statistikat e BE-së tregojnë se vdekjet si pasojë e ajrit të ndotur janë më të shumta në numër sesa ato që shkaktohen prej aksidenteve automobilistike, duke qenë kështu shkaktari kryesor i vdekjeve të parakohshme. Sëmundjet si astma apo sëmundjet e tjera të rrugëve të frymëmarrjes kanë kosto të lartë si për shkak të trajtimit mjekësor, ashtu edhe për numrin e ditëve të punës apo të ditëve të mësimit të humbura si pasojë e tyre. Kostot prej ndotjes së ajrit, përfshirë dëmtimet e të mbjellave dhe të godinave përllëgariten në rreth 23 miliardë euro në vit.¹⁹⁷ Në këto kushte, edhe *acquis communautaire* për mbrojtjen e ajrit ka pësuar zhvillim të vazhdueshëm, duke përfshirë masat për të ulur shkarkimin e substancave të dëmshme në ajër, përmirësimin e cilësisë së karburanteve, përmirësimin e politikave të transportit, ato të prodhimit të energjisë, etj.

Një nga aktet e parë të legjislacionit evropian për mbrojtjen e ajrit ka qenë Direktiva 94/63/EC e Parlamentit dhe Këshillit, e datës 20 dhjetor 1994, për kontrollin e kimikateve organike VOC¹⁹⁸ që çlirohen nga depozitimi dhe shpërndarja e karburanteve në stacionet e furnizimit, ndryshuar me Rregulloren nr.1882/2003, të datës 29 shtator 2003 dhe Rregulloren nr. 1137/2008, datë 22 tetor 2008. Substancat VOC shkaktajnë formimin e oksidantëve fotokimikë, siç është ozoni, i cili kur ndodhet në përqendrime të mëdha në atmosferë, mund të dëmtojë jetën e njeriut dhe të bimësisë. Prandaj edhe kjo direktivë caktoi rregulla teknike specifike, të detyrueshme për zbatim nga të gjithë vendet anëtare të Komunitetit për minimizimin e çlirimit në ajër të substancave VOC gjatë transportit me automjete apo anije, si edhe gjatë depozitimit të karburanteve. Gjithashtu, në fushën e mbrojtjes së ajrit nga efektet e dëmshme të përdorimit të karburanteve u miratua Direktiva 1999/32/EC e Këshillit, e datës 26 prill 1999, e ndryshuar më pas në vitet

¹⁹⁵ <http://www.ipcc.ch/report/ar5/wg1/>

¹⁹⁶ <http://www.nationalacademies.org/onpi/06072005.pdf>

¹⁹⁷ Statistikat mbi cilësinë e ajrit në BE gjenden në: http://ec.europa.eu/environment/air/index_en.htm

¹⁹⁸ VOC (Volatile Organic Compounds – Elementë Organikë të Avullueshëm) janë kimikate organike të cilat kanë një trysni të lartë të avullimit në kushtet e temperaturave normale, i cili vjen si rezultat i pikes së ulët të zierjes, çka bën që një numër i madh molekulash të avullojnë nga forma e lëngët apo e ngurtë dhe të çlirohen e të enden në ajër.

2003, 2005 dhe 2009, për uljen e përmbajtjes së squfurit në disa lloje karburantesh, djegia e të cilëve shkakton ndotje të ajrit.¹⁹⁹

Një nga aktet më të rëndësishëm të *acquis communautaire* për mbrojtjen e ajrit është Direktiva 2008/50/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e 21 majit 2008, “Për cilësinë e ajrit të ambientit dhe për ajër më të pastër për Evropën.”²⁰⁰ Kjo direktivë u miratua në vijim të Programit të Gjashtë të Veprimit të Mjedisit të Komunitetit të vitit 2002, i cili përcaktoi nevojën për uljen e ndotjes në nivele që minimizojnë efektet e dëmshme në shëndetin e njeriut, duke treguar kujdes të veçantë për pjesët më delikate të popullsisë, si edhe nevojën e përmirësimit të monitorimit dhe vlerësimit të cilësisë së ajrit, përfshirë depozitimim e ndotësve dhe në mënyrë të veçantë, informimin e publikut, kryesisht nëpërmjet internetit, ku duhet të hidhen rregullisht të dhëna të përditësuara. Shtetet anëtare të BE kishin dy vjet afat për të transpozuar direktivën në legjislationet e tyre të brendshme.

Direktiva përcakton si mënyrën me efikase të mbrojtjes së cilësisë së ajrit luftën që në burimin e ndotjes, përpara se të përhapen efektet e tij më gjerë, duke mbajtur parasysh caktimin e objektivave në nivel lokal, rajonal e kombëtar në përputhje me standardet, udhëzimet dhe programet e Organizatës Botërore të Shëndetësisë.²⁰¹ Në mënyrë që informacioni i mbledhur për ndotjen e ajrit të jetë i krahasueshëm midis vendeve të BE, rëndësi i jepet standardizimit të teknikave të matjes dhe kriterëve të njëjta vlerësuese, si edhe numrit dhe vendndodhjes së stacioneve të matjes. Po kështu, direktiva kërkon nga vendet anëtare që të bëjnë edhe veçimin e faktorëve natyrorë që ndikojnë në ndotjen e ajrit (siç janë grimcat e ngurta nga erërat e rërës apo të kripës së hedhur në rrugët me dëborë), prej faktorëve njerëzorë, sepse janë këta të fundit ndaj të cilëve mund të merren masa për uljen e ndotjes.

Direktiva i referohet në mënyrë specifike edhe respektimit të të drejtave dhe parimeve të Kartës së të Drejtave Themelore të BE, veçanërisht integritimit në politikat e Bashkimit të një niveli të lartë të mbrojtjes së mjedisit dhe përmirësimit të cilësisë së ajrit, në përputhje me parimin e zhvillimit të qëndrueshëm, të sanksionuar në nenin 37 të Kartës.²⁰² Ajo shkriu në një të vetme tre direktivat e mëparshme, të quajtura “direktiva bija”, ku përfshiheshin direktivat 1999/30/EC, 2000/69/EC, 2002/3/EC, dhe Vendimin për Shkëmbimin e Informacionit 97/101/EC, me përjashtim të Direktivës Kuadër të Cilësisë së Ajrit, 96/62/EC, “Për Vlerësimin dhe Menaxhimin e Cilësisë së Ajrit në Mjedis”.²⁰³ Ajo formulon parimet themelore për mënyrën se si duhet të vlerësohet dhe menaxhohet cilësia e ajrit në shtetet anëtare, si edhe rendit ndotësit për të cilët do të zhvillohen standardet e cilësisë së ajrit, me objektivat përkatës.

¹⁹⁹ Informacion i hollësishëm mbi *acquis communautaire* për mbrojtjen e ajrit gjendet në:

http://ec.europa.eu/environment/air/quality/legislation/existing_leg.htm

²⁰⁰ Gjendet në: <http://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=OJ:L:2008:152:0001:0044:EN:PDF>

²⁰¹ Informacion më i hollësishëm gjendet në: http://www.who.int/topics/air_pollution/en/index.html

²⁰² Neni 37: “Niveli i lartë i mbrojtjes së mjedisit dhe përmirësimi i cilësisë së mjedisit duhet të integrohen në politikat e Bashkimit Evropian dhe të sigurohen në përputhje me parimin e zhvillimit të qëndrueshëm.” Karta e të Drejtave Themelore të BE gjendet në:

http://www.kmdp.al/web/pub/statuti_i_te_drejtave_themelore_te_bashkimit_evropian_519_1.pdf

²⁰³ Direktiva Kuadër e Cilësisë së Ajrit gjendet në: <http://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:31996L0062&from=EN>

Direktiva 2004/107/EC e Parlamentit dhe Këshillit,²⁰⁴ e quajtur “direktiva e katërt bijë”, u referohet niveleve të arsenikut, kadmiumit, merkurit, nikelit dhe hidrokarbureve aromatikë në ajër, të cilat janë substanca që të dhënat shkencore i vlerësojnë si kanceroze, kur janë në përqendrim të lartë në ajër. Kjo direktivë plotësoi listën e ndotësve të hartuar fillimisht nga Direktiva Kuadër.

Për sigurimin e të dhënave për të gjithë Bashkimin, Vendimi i Këshillit 97/101/EC²⁰⁵ përcaktoi shkëmbimin reciprok të informacionit dhe të dhënave midis vendeve anëtare, prej rrjeteve dhe stacioneve të tyre të matjes së cilësisë së ajrit. Ai saktësoi procedurën për monitorimin e cilësisë së ajrit dhe shpërndarjen e informacionit midis shteteve, por edhe dhënien e informacionit publikut. Për raportimin vjetor të shteteve anëtare të BE mbi cilësinë e ajrit në territoret e tyre u miratua Vendimi i Komisionit 2004/461/EC,²⁰⁶ i cili bazuar në nenet 11§1 dhe 12§1 të Direktivës 96/62/EC caktoi formularin sipas të cilit shtetet do të bënin raportimin. Në lidhje me këtë të fundit, GJED mori një vendim historik në çështjen *Dieter Janecek kundër Freistaat Bayern*, çështje e referuar prej gjykatës gjermane në lidhje me interpretimin e nenit 7§3 të Direktivës së Këshillit 96/62/EC, datë 27.9.1996, për vlerësimin dhe menaxhimin e cilësisë së ajrit.²⁰⁷

Paditësi Dieter Janecek kishte kërkuar nga gjykata gjermane detyrimin e autoritetit vendor të Bajernit që të hartonte një plan veprimi për cilësinë e ajrit në distriktin Landshuter të Mynihut, ku ai banonte, plan i cili duhet të përfshinte masat afatshkurtëra që duheshin marrë për të garantuar zbatimin e normave maksimale të caktuara nga legjislacioni komunitar në lidhje me shkarkimet në ajër të grimcave PM₁₀, pasi nga matjet e stacionit që ndodhej vetëm 900 metra larg banesës së paditësit, norma maksimale e lejuar ishte tejkaluar mbi 35 herë gjatë vitit të fundit. Gjykata u shpreh që neni 7§3 i Direktivës 96/62, interpretuar së bashku me paragrafin 12 të preambulës së saj, cakton një detyrim të qartë ndaj shteteve anëtare që të hartojnë planet e veprimit për cilësinë e ajrit. Për më tepër, ajo theksoi se ajo vazhdimisht ka vendosur që individit gëzon të drejtën kundrejt autoriteteve publike, që të bazohet në dispozitat e një direktive të cilat janë jo kushtëzuese dhe mjaftueshmërisht të sakta. Autoritetet kombëtare duhet të interpretojnë ligjin e brendshëm në mënyrën më të gjerë të mundshme, që të jetë në përputhje me qëllimin e direktivës. Aty ku një interpretim i tillë nuk është i mundur, atëherë autoritetet kombëtare duhet të mos e zbatojnë ligjin e brendshëm që nuk përputhet me direktivën. Siç e ka theksuar shumë herë GJED, do të binte ndesh me karakterin e detyrueshëm që neni 249 i Traktatit të KE i jep një direktive, që t'i hiqej në parim mundësia një individit që të mbështetet në detyrimin që ajo direktivë cakton. Kjo vlen aq më tepër në rastet kur bëhet fjalë për direktivat që synojnë të kontrollojnë dhe ulin ndotjen atmosferike, që janë hartuar për të mbrojtur shëndetin publik. Prej këtej rrjedh që personat fizikë ose juridikë që janë direkt të shqetësuar për rrezikun që vlerat maksimale të ndotjes mund të tejkalohen, duhet të jenë në gjendje t'u kërkojnë autoriteteve kompetente të hartojnë plane veprimi kurdoherë që ekzistojnë rreziqe të tilla, dhe kur është e

²⁰⁴ Gjendet në: <http://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=OJ:L:2005:023:0003:0016:EN:PDF>

²⁰⁵ Gjendet në: <http://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:31997D0101&from=en>

²⁰⁶ Gjendet në: <http://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:32004D0461&from=EN>

²⁰⁷ Vendimi Nr. C-237/07, datë 25.7.2008, *Dieter Janecek kundër Freistaat Bayern*. Gjendet në:

http://curia.europa.eu/juris/document/document.jsf?jsessionid=9ea7d2dc30d645379924062d4d709cb1905edc7d4f03_e34KaxiLc3qMb40Rch0SaxuOa310?text=&docid=68148&pageIndex=0&doclang=en&mode=lst&dir=&occ=first&part=1&cid=262387

nevojshme, të ngrenë edhe padi para gjykatave kompetente. Fakti që këta persona mund të kenë mundësi për të përdorur mjete të tjera në dispozicion për t'i detyruar autoritetet publike të hartojnë planet e veprimit, nuk do të thotë asgjë në rastin konkret. Kështu që neni 7§3 i Direktivës 96/62, duhet interpretuar që kurdoherë që ka një rrezik që vlerat maksimale të ndotjes mund të tejkalohen, personat direkt të shqetësuar duhet të jenë në gjendje t'u kërkojnë autoriteteve kombëtare kompetente të hartojnë plane veprimi, edhe pse sipas të drejtës së brendshme ata mund të kenë mjete të tjera në dispozicion për t'u kërkuar autoriteteve që të marrin masa për të luftuar ndotjen atmosferike.²⁰⁸

Ky është një vendim shumë i rëndësishëm për sa i përket të drejtës së individit për t'iu drejtuar gjykatës për çështjet mjedisore, në kuptim të Konventës së Aarhusit, e cila do të analizohet me hollësi në Kreun VII.

3.3 Legjislacioni shqiptar për mbrojtjen e ajrit.

Përpjekjet për të përafruar legjislacionin mjedisor shqiptar me atë ndërkombëtar kanë qenë të vazhdueshme. Në këtë aspekt, për sa i përket konventave ndërkombëtare për mbrojtjen e ajrit të analizuar më sipër, ato janë bërë pjesë e legjislacionit të brendshëm shqiptar. Kështu, Shqipëria aderoi në Konventën Kuadër të Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike në 3 tetor 1995 dhe ligji nr. 9334, datë 16.12.2004, realizoi aderimin e Republikës së Shqipërisë në Protokollin e Kiotos të Konventës Kuadër të Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike. Më pas, nëpërmjet ligjeve 9480, 9484, 9485, 9486, të miratuar në muajt shkurt dhe mars 2006, është bërë aderimi i Shqipërisë respektivisht në Amendamentin e Kopenhagenit të Protokollit të Montrealit “Për substancat që hollojnë shtresën e ozonit”, e më pas në amendamentet e Londrës, Montrealit dhe të Pekinit. Ndërsa ligji nr. 9548, datë 1.6.2006, realizoi aderimin në Protokollin “Mbi Regjistrat e Shkarkimit dhe Transferimit të Ndotësve” i Konventës së Aarhus-it “Mbi të drejtën e informimit, pjesëmarrjen e publikut në vendimmarrje si dhe të drejtën për t'iu drejtuar gjykatës për problemet mjedisore”.

Në Konventën Kuadër të Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike (UNFCCC), dhe Protokollin e saj të Kiotos, Shqipëria gëzon statusin e një pale të aneksit të tretë, si vend në zhvillim, që shkarkon një sasi relativisht të ulët të gazeve serë (GHG), rreth 9,4 milionë ton CO₂ në vit. Arsyeja për këtë klasifikim është sepse mbi 95% e energjisë elektrike në Shqipëri prodhohet nga hidrorcentralet, ndërsa ndotja prej industrisë së rëndë që kërkonte burime të mëdha energjie është ulur për shkak se fabrikat, uzinat dhe kombinatet janë mbyllur. Ndotësit më të mëdhenj të ajrit në Shqipëri janë transporti, bujqësia dhe mbetjet. Nëse nuk merren masa për reduktimin dhe shkarkimin e GHG, atëherë nivelet e ndotjes do të vazhdojnë të rriten në të ardhmen. Edhe pse Shqipëria nuk është ndër ndotësit e mëdhenj në rang botëror, duhen marrë masa që vendi të jetë i përgatitur për t'u përballur me pasojat mjedisore, sociale dhe ekonomike që vijnë për shkak të ndryshimeve klimatike.²⁰⁹

Në zbatim të detyrimeve të marra përsipër në kuadrin e Protokollit të Kiotos, me VKM nr.1553, datë 26.11.2008, u vendos krijimi i Autoritetit Kombëtar të Përcaktuar, i cili vepron si një njësi e

²⁰⁸ *Ibid.*, parag. 34-42.

²⁰⁹ <http://www.ccalb.org/>

specializuar brenda Ministrisë së Mjedisit dhe është përgjegjës për rishikimin dhe miratimin e projekteve të Mekanizmit të Zhvillimit të Pastër (MZHP). Ai përbëhet nga dy njësi: Komiteti me 7 anëtarë dhe Sekretariati Teknik me 4 anëtarë. Funkcionet e tyre përshijnë koordinimin e aktiviteteve për zbatimin e angazhimeve në kuadrin e UNFCCC dhe Protokollit të Kiotos, duke siguruar që projektet e MZHP të realizohen në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe marrëveshjet ndërkombëtare.

Deri tani janë marrë disa masa në lidhje me përballimin e ndryshimeve klimatike. Masat e para u propozuan në vitin 2002, nëpërmjet Programit Kombëtar për Ndryshimet Klimatike, që ishte pjesë e Programit të Rinovuar Kombëtar për Mjedisin. Theksi u vendos në sektorin e energjisë, si përgjegjësi kryesor për ndryshimet klimatike në Shqipëri, me qëllim marrjen e masave për reduktimin e ritmit të shkarkimeve të gazeve serë. Mënyra më efikase për të arritur këtë është integrimi i problemit të ndryshimeve klimatike në procesin e hartimit të politikave sektoriale, përfshirë edhe masat praktike, si izolimi termik në banesa, përdorimi i energjisë diellore për ngrohjen e ujit, realizimi i gatimit dhe ngrohjes me gaz të lëngët, përdorimi i llampave eficiente për ndriçim, etj. Me miratimin e ligjit nr. 9379, datë 28.4.2005, “Për eficientën e energjisë”, u synua përmirësimi e eficientës së përdorimit të energjisë gjatë gjithë ciklit, duke përcaktuar mënyrën e përdorimit ekonomik të burimeve të energjisë, krijimin e kushteve të qëndrueshme të furnizimit me energji, si dhe uljen e ndikimit të dëmshëm në mjedis. Ligji vendosi krijimin e Fondit për Eficientën e Energjisë, administrimi i të cilit bëhet nga Agjencia Kombëtare e Energjisë, por që në realitet nuk duket të ketë patur ndonjë ndikim real në kursimin e energjisë, të paktën në sektorin publik.

Një ndihmesë e madhe i është dhënë Shqipërisë nga Programi i PNUD-it për Ndryshimet Klimatike, i cili asiston qeverinë shqiptare në trajtimin e problemeve të ndryshimeve klimatike dhe në zbatimin e Konventës Kuadër të Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike dhe Protokollit të Kiotos. Objektivi kryesor i programit është të ndërtojë dhe të zhvillojë kapacitete njerëzore dhe institucionale në nivel kombëtar për zbatimin e këtyre traktateve ndërkombëtare. Me ndihmën financiare të Kombeve të Bashkuara ekspertët shqiptarë kanë llogaritur nivelin e shkarkimeve totale të gazeve serë për Shqipërinë, ku në vitin 1994 ka shkarkuar rreth 7 milion ton gaze serë që do të thotë rreth 2.2 ton për frymë të popullsisë. Pas një dekade, në 2004 janë shkarkuar rreth 8.5 milion ton gaze serë, që do të thotë rreth 2.5 ton për frymë të popullsisë. Sektori që mban peshën kryesore në shkarkimet është sektori i energjisë, që kontribuon me 60%. Parashikimet janë që nëse nuk merren masa për të reduktuar shkarkimet, deri në vitin 2020 pritet një rritje deri në 37 milion ton gaze serë, që do të thotë një rritje mbi 5 herë më e lartë se në vitin 1994. Po ashtu, parashikohen rritje të temperaturave mesatare, ulje të sasisë së reshjeve dhe reduktim i rezervave ujore, si dhe pakësim i sipërfaqes së tokës të punueshme. Zona më e ndjeshme ndaj ndryshimeve klimatike është zona bregdetare, kurse për sa i përket sektorëve, më të ndjeshmit janë rezervat ujore, energjia, bujqësia dhe turizmi. Zvogëlimi i rezervave ujore pritet të ndikojë negativisht në prurjet e lumenjve, e kjo do të shkaktojë edhe reaksion zinxhir në prodhimin më të ulët të energjisë elektrike nga hidrocentralet. Ky është një problem që duhet të merret në konsideratë me përparësi absolute, pasi garantimi i furnizimit me energji elektrike është çështje e sigurisë kombëtare dhe ka rëndësi vendimtare për zhvillimin ekonomik të vendit.²¹⁰ Shqipëria ka shumë hapësira për reduktimin e emetimeve, kryesisht në sektorin e energjisë, duke synuar përdorimin maksimal të mundshëm të energjive të rinovueshme, duke

²¹⁰ Informacion i hollësishëm për Programin e PNUD-it për Ndryshimet Klimatike gjendet në: <http://www.ccalb.org/>

bërë transformim rrënjësor të sektorit të mbetjeve, që është tepër i prapambetur, në një kohë që mbetjet mund të përbëjnë një burim energjie, për shembull, nëpërmjet djegies.

Në vijim të plotësimit të detyrimeve ndërkombëtare, me miratimin e ligjit nr. 9425, datë 6.10.2005, u realizua aderimi në Konventën e vitit 1979, “Për ndotjen ndërkufitare të ajrit në distanca të largëta”, e pas tij ligji nr.10062, datë 29.01.2009, realizoi aderimin në Protokollin e Sofies të vitit 1988 “Për kontrollin e shkarkimeve të oksideve të azotit apo flukseve të tyre ndërkufitare” dhe ligji nr. 10063, datë 29.1.2009, realizoi aderimin në Protokollin e Helsinkit të vitit 1985, “Për reduktimin e shkarkimeve të squfurit apo të flukseve të tyre ndërkufitare të paktën me 30%”, të kësaj konvente.

Me gjithë përpjekjet e Shqipërisë për t’u bërë pjesë në shumë prej traktateve ndërkombëtare që kanë të bëjnë me mbrojtjen e ajrit, vihet re një farë mungese koordinimi edhe në aspekte formale, siç është p.sh. vetë emërtimi i traktateve në të cilët vendi ynë aderon, çka nuk lë përshtypje të mirë për sa i përket seriozitetit në lidhje me punën që bëhet për to. Kështu p.sh., në ligjin nr.10476, datë 3.11.2011, Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Protokollin e Konventës së vitit 1979 “Për ndotjen ndërkufitare të ajrit në *Distanca të Largëta*, për të pakësuar acidifikimin, eutrofikimin dhe ozonin në shtresën e poshtme të atmosferës”, titulli i konventës është përkthyer ‘*në Distanca të Largëta*’, ndërsa në ligjin nr.10436, datë 28.6.2011, Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Protokollin “Për reduktimin e mëtejshëm të çlirimit të squfurit” të Konventës “Për ndotjen ndërkufitare të ajrit *në rreze të gjatë*”, 1979, është përdorur termi *në rreze të gjatë*, kur bëhet fjalë për të njëjtën konventë.

Legjislacioni mjedisor shqiptar i ka dhënë një vend prioritar *acquis communautaire* në lidhje me përcaktimin e vlerës së normave në mjedis ose të përbërësve të tij, ku sigurisht përfshihet edhe ajri, për sasinë, cilësinë, përqendrimin e lëndëve dhe të energjisë që shkarkohen në mjedis. Për këto vlera, fillimisht neni 50 i ligjit nr. 8934, datë 5.9.2002, “Për mbrojtjen e mjedisit” dhe më pas ligji nr.10431, datë 9.6.2011 i cili e shfuqizoi atë, përcaktojnë qartësisht se duhet të mbështeten në udhëzimet e Bashkimit Evropian, si edhe në objektivat e politikës shtetërore mjedisore dhe në teknikat më të mira të mundshme.

Ligji Nr. 8897 datë 16.05.2002 “Për mbrojtjen e ajrit nga ndotja”, i ndryshuar, parashikon masat për mbrojtjen e cilësisë së ajrit, me qëllim shmangien, parandalimin ose uljen e pasojave të dëmshme mbi shëndetin dhe mjedisin në tërësi, vlerësimin e cilësisë së ajrit të mjedisit në bazë të metodave e të kriterëve që përdoren në BE dhe dhënien e informacionit të përshtatshëm për cilësinë e ajrit të mjedisit, duke siguruar disponueshmërinë e këtij informacioni për publikun. Ligji bën klasifikimin e burimeve të ndotjes, treguesve mjedisorë bazë të gjendjes së ajrit që shprehin përmbajtjen e ndotësve atmosferikë dhe thekson se për zona të veçanta, në varësi të natyrës së shkarkimeve në ajër dhe sipas nevojës, Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për mjedisin dhe atij përgjegjës për shëndetësinë, miratojnë vlerat kufi, pragun sinjalizues, kufirin e tolerancës dhe vlerat e synuara të cilësisë së ajrit për ndotësit.

Në Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit, neni 108 i saj i cili bën fjalë për mjedisin, sanksionon që palët do të zhvillojnë dhe forcojnë bashkëpunimin në detyrën shumë të rëndësishme të luftës kundër degradimit mjedisor, me synim promovimin e qëndrueshmërisë mjedisore. Bashkëpunimi përqendrohet kryesisht në fushat prioritare që lidhen me *acquis* e Komunitetit për fushën e

mjedisit. Ndërsa në Deklaratën e Përbashkët të Komunitetit me Shqipërinë përcaktohen nivelet e emetimeve të gazta dhe të zhurmave, aktualisht të pranuar në Komunitet për qëllime të miratimit të tipave të automjeteve, tregohen masa e monoksidit të karbonit, masa e hidrokarboneve, masa e metanit, masa e oksideve të nitrogjenit, ku Komuniteti dhe Shqipëria angazhohen që në të ardhmen do të përpiqen të pakësojnë emetimet e automjeteve nëpërmjet përdorimit të teknologjisë moderne të kontrollit të emetimit të automjeteve, e kombinuar kjo me cilësinë e përmirësuar të karburantit të motorit. Në Protokollin 5, ku bëhet fjalë për Transportin Tokësor, në nenin 15 palët angazhohen që për mbrojtjen e mjedisit do të përpiqen të paraqesin standarde mbi emetimet e gazta dhe grimcore dhe nivelet e zhurmave për automjetet e rënda të mallrave, të cilat sigurojnë një nivel të lartë mbrojtjeje.

Mbrojtja e ajrit në nivel kombëtar realizohet edhe nëpërmjet sistemit të licencimit të subjekteve që angazhohen në veprimtari të tilla që shkaktojnë ndotjen e tij, siç janë impiantet e ndryshme industriale prodhuese e përpunuese. Kontrolli i ndotjes mund të arrihet vetëm në mënyrë të integruar, që do të thotë kuadri rregullator duhet të përfshijë të gjithë elementët e mundshëm të ndotjes si edhe të përfshihet në të gjitha aktet ligjore që kanë të bëjnë me të. Kjo është edhe pjesa më delikate, pasi për nga natyra e veprimtarisë së tyre, autoritetet që mbulojnë sektorë të veçantë kujdesen vetëm për atë fushë për të cilën janë përgjegjës, duke mos i kushtuar rëndësi aspekteve të tjera. Këtu merr vlerë të veçantë roli i rëndësishëm koordinues i autoriteteve më të larta mbikëqyrëse, për të kombinuar aktivitetet në mënyrë që të realizohet kontrolli i integruar.

Politikat e hartuara në këtë sektor synojnë arritjen e objektivave kryesorë të strategjisë, nëpërmjet: Monitorimit të cilësisë së ajrit në përputhje me kërkesat e BE, duke grumbulluar të të dhënat mbi cilësinë e ajrit, pas krijimit të një rrjeti kombëtar të plotë monitorimi; Kontrollit dhe reduktimit të nivelit të shkarkimeve të gazeve në ajër nga automjetet, si rrjedhojë e përdorimit të karburanteve sipas standardeve të BE; Kontrollit dhe uljes së nivelit të shkarkimit të substancave ndotëse nga impiantet industriale; Kontrollit dhe uljes së nivelit të pluhurit që krijohet nga ndërtime; Planifikimit të menaxhimit të cilësisë së ajrit, duke u kërkuar autoriteteve vendore, rajonale dhe kombëtare të vlerësojnë rezultatet e të dhënave të siguruara nga sistemi i monitorimit dhe të përcaktojnë marrjen e masave më të përshtatshme për të adresuar rastet kur ka mospërputhje me standardet e cilësisë së mjedisit.

Aktualisht, në vendin tonë ndotja e ajrit prej transportit zë vendin e dytë pas prodhimit të energjisë. Numri i automjeteve në rrugët e Shqipërisë ka ardhur duke u rritur vazhdimisht, duke qenë kryesisht automjete të përdorura, pjesa më e madhe e të cilëve punojnë me naftë. Rrjedhimisht, niveli i ndotjes prej tyre është i lartë, veçanërisht në qytetet kryesore të vendit, ku edhe përqendrimi është më i madh. Edhe pse kontrolli teknik periodik i automjeteve është ligjërish i detyrueshëm dhe shumica e automjeteve i nënshtrohet këtij kontrolli, nëpër rrugë qarkullojnë shumë automjete që edhe me sy të lirë dallohen që ndotin rëndë ambientin, pasi kontrolli i shkarkimeve të automjeteve nuk ka të njëjtët parametra që zbatohen në vendet e BE. Megjithatë, duhet thënë që janë marrë masa që cilësia e karburanteve që tregtohen të jetë në përputhje me standardet evropiane, nëpërmjet caktimit të kuotave të detyrueshme për përmbajtjen e squfurit në lëndën djegëse për motorët me naftë, si edhe përputhjen e parametrave mjedisorë të benzinës me standardet evropiane, por aktualisht jemi ende larg atyre standardeve.

Ndër burimet industriale që kontribuojnë më shumë në ndotjen e ajrit janë industria e prodhimit të çimentos, industria metalurgjike, nxjerrja dhe përpunimi i naftës dhe prodhimi i energjisë elektrike prej termocentraleve. Këto industri përdorin ende teknologji të vjetra, shumë të amortizuara, të cilat nuk kanë linja të trajtimit të shkarkimeve të gazta, duke çliruar kështu gaze që krijojnë efektin serë. Niveli i ndotjes së ajrit mbetet i lartë, veçanërisht për sa i përket grimcave të ngurta. Akoma nuk ekzistojnë politika afatgjata për të ndryshuar situatën dhe për të ulur shkarkimet nga automjetet dhe industria. Të dhënat e monitorimit të ajrit në zonat urbane tregojnë se përmbajtja e blazës dhe e lëndës së ngurtë të pezull është shqetësuese. Mungesa e një rrjeti kombëtar për monitorimin e cilësisë së ajrit e bën të pamundur vlerësimin e saktë të ndikimit në shëndet nga ndotja e ajrit. Statistikat tregojnë se sëmundjet e rrugëve të frymëmarrjes shkaktajnë 16 % të vdekjeve në Shqipëri dhe zënë vendin e dytë në totalin e vdekshmërisë. Vdekshmëria foshnjore nga këto lloj sëmundjesh është e lartë. Vlerat e treguesve, si përmbajtja e plumbit, dioksidit të squfurit, oksideve të azotit, etj. rezultojnë të jenë nën standardet shtetërore dhe të Organizatës Botërore të Shëndetësisë. Vetë Instituti i Shëndetit Publik, në Raportin Vjetor të fundit që ka botuar, të vitit 2012, ka pranuar që Tirana vazhdon të mbetet një ndër qytet me ajër të rrezikshëm për jetën, në qendrën e saj.²¹¹

Prej Direktivës 2008/50/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e 21 majit 2008, “Për cilësinë e ajrit të ambientit dhe ajër më të pastër për Evropën” buron edhe detyrimi për të gjithë anëtarët që të caktojnë një entitet të veçantë që të merret me vlerësimin cilësisë së ajrit dhe raportimin për të. Në përmbushje të këtij detyrimi, neni 2§22 i ligjit nr.8897, datë 16.5.2002, “Për mbrojtjen e ajrit nga ndotja”, i ndryshuar, ka caktuar Ministrinë e Mjedisit si autoritet të mbrojtjes së ajrit. Nga ana e saj ministria i propozon Këshillit të Ministrave planin e monitorimit dhe menaxhimit të cilësisë së ajrit, ku i gjithë territori i vendit ndahet sipas zonave të veçanta të monitorimit të cilësisë së ajrit, sipas përqendrimit të popullsisë në këto zona.²¹² Aktualisht, monitorohen vetëm qytetet kryesore: Tirana, Durrësi, Elbasani, Korça, Fieri, Vlora dhe Saranda, ku edhe niveli i ndotjes është më i madh për shkak të përqendrimit të popullsisë dhe të industrisë.

Në bazë dhe për zbatim të ligjit për mbrojtjen e mjedisit dhe atij për mbrojtjen e ajrit, u miratua VKM nr.1189, datë 18.11.2009, “Për rregullat dhe procedurat për hartimin dhe zbatimin e programit kombëtar të monitorimit të mjedisit”, vendim i cili ngarkon ministrinë të bashkërendojë punën edhe me Agjencinë Kombëtare të Mjedisit për zbatimin e programit, në bashkëpunim me ministrinë e tjera, në përputhje me fushën që ato mbulojnë, me organet e qeverisjes vendore dhe me institucionet monitoruese, për monitorimin e treguesve konkretë mjedisorë. Për ajrin, treguesit konkretë përfshijnë: temperaturën mesatare të ajrit, përmbajtjen e dioksidit të squfurit, oksideve të azotit, plumbit, ozonit, monoksidit të karbonit, rrezatimit elektromagnetik, radioaktivitetit dhe të lëndës së ngurtë të pezull në ajër. Vendimi sanksionon se programi kombëtar i monitorimit të mjedisit duhet të përcaktojë treguesit kryesorë të gjendjes, të ndikimit dhe të trysnisë në ajër, në ujërat sipërfaqësore e nëntokësore, në tokë, në zonën bregdetare, në detet, pyjet e në larinë biologjike. Vendimi i referohet në mënyrë specifike Agjencisë Evropiane të Mjedisit, për rastet kur duhen miratuar tregues të rinj për monitorimin e mjedisit, nga ana e ministrit. I gjithë procesi i monitorimit të mjedisit duhet të realizohet duke koordinuar veprimtaritë e Ministrisë së Mjedisit, të Shëndetësisë, të Transportit, të Mbrojtjes, me

²¹¹ Raporti Vjetor i Cilësisë së Ajrit, Instituti i Shëndetit Publik, 2012, fq. 22. Gjetet në: http://www.ishp.gov.al/multimedia/raporti_vjetor_i_cilesise_se_ajrit.pdf

²¹² Ligji nr.8897, datë 16.5.2002, “Për mbrojtjen e ajrit nga ndotja”, i ndryshuar, neni 5§1.

Agjencinë Kombëtare të Mjedisit (AKM), Qendrën e Transferimit të Teknologjive Bujqësore dhe Shërbimin Gjeologjik Shqiptar, në varësi të treguesve që përfshihen brenda sferës së veprimtarisë së tyre. Të gjithë këto institucione autorizohen të lidhin kontrata me institucione monitoruese të specializuara, të cilat paraqesin të gjitha të dhënat e rezultuara nga monitorimi, të dhëna që regjistrohen në regjistrat përkatës në AKM dhe hidhen në bazën elektronike të të dhënave të mjedisit. Agjencitë Rajonale të Mjedisit (ARM) përgatisin raportin e gjendjes së mjedisit në bazë qarku dhe ia paraqesin AKM, e cila pas grumbullimit të të dhënave në shkallë vendi, ia përcjell ministrisë. Bazuar në këto të dhëna, ministria përgatit çdo vit raportin për gjendjen e mjedisit, të cilin ia paraqet Këshillit të Ministrave dhe organizmave ndërkombëtarë ku duhet të raportojë.²¹³

Në mënyrë paradoksale, VKM nr. 435, datë 12.9.2002, “Për miratimin e normave të shkarkimeve në ajër në Republikën e Shqipërisë”, në pikën 2 të tij, parashikon që normat e shkarkimeve në ajër të miratuara me atë vendim, do të zbatoheshin vetëm nga subjektet që do të fillonin veprimtarinë pas hyrjes në fuqi të tij. Një dispozitë e tillë jo vetëm që nuk garanton mbrojtjen e ajrit, duke lejuar që subjektet ekzistuese të vazhdojnë veprimtarinë e tyre, pavarësisht shkarkimeve që ato mund të kryejnë në ajër, por edhe shkel një parim të rëndësishëm të shtetit të së drejtës, atë të mosdiskriminimit, duke bërë haptazi dallime midis subjekteve ekonomike.

Për plotësimin e kuadrit ligjor për mbrojtjen e ajrit janë miratuar edhe VKM nr. 803, datë 4.12.2003, mbi Miratimin e Normave të Cilësisë së Ajrit, si edhe Udhëzimi i Ministrisë së Mjedisit dhe Ministrisë së Transportit nr. 6527, datë 24.12.2004, mbi Vlerat e Lejueshme të Elementëve Ndotës të Ajrit nga Shkarkimet e Gazrave, Shkaktuar nga Mjetet Rrugore. Në funksion të zbatimit të kërkesave të Konventës së Vjenës, të Protokollit të Montrealit e të katër amendimeve të tij, ligji i kohës për mbrojtjen e mjedisit i kushtoi një nen të veçantë gazeve ozonholluese si dhe pajisjeve që i përdorin ato. Gjithashtu, janë në zbatim vendimet e Këshillit të Ministrave për miratimin e listës së pajisjeve që përdorin lëndë ozonholluese, të cilat ndalohen të prodhohen e të importohen, si dhe rregullat e procedurat e zëvendësimit të lëndëve ozonholluese në pajisjet ekzistuese, në përputhje me kërkesat e katër amendimeve të protokollit të Montrealit në të cilët Shqipëria ka aderuar. Po ashtu, me VKM nr. 481, datë 25.7.2012, u miratua rregullorja për sigurinë e publikut ndaj ekspozimeve që shkaktohen nga burimet e rrezatimeve jonizuese, e cila në zbatim të parimit të zhvillimit të qëndrueshëm sanksionon se duhet realizuar kufizimi i ekspozimit normal për grupet kritike përkatëse që lidhen me këto burime, në mënyrë që ekspozimi total të jetë jo më i lartë se doza kufi për publikun. Në zgjedhjen e grupeve kritike duhet të merren parasysh të gjithë brezat e tashëm ose të ardhshëm në vendet ku ndodhen burimet apo edhe në vende të tjera.

Së fundmi, për sa i përket legjislacionit penal, neni 201 i Kodit Penal sanksionon se ndotja e ajrit përmes çlirimit të tymrave, gazrave dhe lëndëve të tjera toksike radioaktive e bërë tej kufirit të normave të lejuara, kur vepra nuk përbën kundërvajtje administrative, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në dy vjet. Po kjo vepër, kur ka shkaktuar pasoja të rënda për jetën e shëndetin e njerëzve, dënohet me burgim gjer në dhjetë vjet.

²¹³ VKM nr.1189, datë 18.11.2009, “Për rregullat dhe procedurat për hartimin dhe zbatimin e programit kombëtar të monitorimit të mjedisit”, pjesa II dhe IV.

Praktika tregon se për të siguruar cilësi dhe efektivitet në punën që bëhet për zbatimin e konventave, me ndikime të ndjeshme pozitive janë kualifikimet e trainimet e personelit që merret me zbatimin e tyre. Për kualifikimet e personelit, investimet e angazhimet më prestigjioze që kontribuojnë dukshëm në forcimin e kapaciteteve vendase ndërmerren dhe realizohen nga sekretariatet e konventave. Për secilën konventë, sekretariatet përkatëse programojnë e realizojnë trainime, seminare, konferenca e takime rajonale, që aftësojnë specialistët që marrin pjesë në to, të cilët në fundit të fundit, janë ata që mund të garantojnë vënien në zbatim të normave të legjislacionit kombëtar e ndërkombëtar.

KREU IV

MBROJTJA E UJIT

Uji është një ndër elementët e domosdoshëm për jetën e njeriut, duke filluar që prej përbërjes së vetë trupit të njeriut në masën rreth 80% të tij, për të vazhduar më tej me përdorimin e tij për ujitjen e bimëve për të siguruar ushqimin, mbajtjen e higjienës, lundrimin, peshkimin, prodhimin e energjisë, turizmin, etj.

E drejta për të patur ujë të pijshëm konsiderohet si një e drejtë themelore e njeriut, që në vetvete është e lidhur ngushtësisht me pasjen e një mjedisi të pastër, i cili siguron cilësinë e ujit. Në Komentin e Përgjithshëm Nr. 15,²¹⁴ Komiteti i OKB për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore është shprehur se shtetet kanë detyrimin të sigurojnë furnizimin me ujë të pijshëm, si ushqim dhe për mbajtjen e higjienës, në përputhje me nenet 11 and 12 të Paktit mbi të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore të vitit 1966. Neni 11 i Paktit sanksionon detyrimin e shteteve palë që të njohin të drejtën e çdokujt për një standard të përshtatshëm jetese për vete dhe familjen, që përfshin ushqim të mjaftueshëm, veshmbathje dhe strehim, si edhe përmirësimin e vazhdueshëm të kushteve të jetesës. Ndërsa neni 12 sanksionon detyrimin e shteteve palë që të njohin të drejtën e çdokujt për standardin më të lartë të mundshëm të shëndetit fizik dhe mendor.

Asambleja e Përgjithshme e OKB ka shprehur shqetësimin për gjendjen alarmante në botë për sa i përket furnizimit me ujë të pijshëm. Rreth 884 milionë njerëz nuk kanë akses në ujën e pijshëm dhe më tepër se 2.6 miliardë njerëz nuk kanë as kushtet më elementare të sigurimit të higjienës. Rreth 1.5 milionë fëmijë vdesin nën moshën 5 vjeç dhe 443 milionë ditë shkolle humbasin çdo vit prej sëmundjeve që kanë të bëjnë me mungesën e ujit dhe kushteve të përshtatshme të higjienës.²¹⁵

Në kuadrin e marrjes së masave për përmirësimin e një situate të tillë, Komisioni i OKB për Evropën ka miratuar në vitin 2000 Protokollin për Ujin dhe Shëndetin,²¹⁶ që i bashkëlidhet Konventës së UNECE (Helsinki) për Mbrotjen dhe Përdorimin e Rrjedhave Ujore Ndërkufitare dhe Liqeneve Ndërkombëtare, të vitit 1992. Gjuha e përdorur në këtë protokoll është e tillë që e konsideron aksesin në ujën e pijshëm si një të drejtë themelore të njeriut, për rrjedhojë edhe interpretimi i traktateve ndërkombëtare mbi përdorimin e rrjedhave ujore ndërkufitare (ku përfshihen edhe ujërat nëntokësore, përveç atyre sipërfaqësore, siç janë lumenjtë), duhet bërë duke mbajtur parasysh këtë përjasje. Nga kjo lindin pikëpyetje mbi ligjshmërinë e veprimeve të shteteve të ndryshme në praktikatat e tyre të përdorimit të rrjedhave ujore në mënyrë jo të

²¹⁴ Gjendet në: http://www.un.org/waterforlifedecade/human_right_to_water.shtml

²¹⁵ Rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme të OKB, A/RES/64/292, datë 3.8.2010, par. 4. Gjendet në: http://www.un.org/es/comun/docs/index.asp?symbol=A/RES/64/292&referer=http://www.un.org/waterforlifedecade/human_right_to_water.shtml&Lang=E

²¹⁶ Protokollin për Ujin dhe Shëndetin gjendet në <http://www.unece.org/fileadmin/DAM/env/documents/2000/wat/mp.wat.2000.1.e.pdf>

qëndrueshme, që mund t'i mohojnë popullsisë aksesin në ujin e pijshëm dhe kushte të përshtatshme të higjienës.²¹⁷

Rreth 40% e popullsisë së botës jeton në zona afër baseneve ujëmbledhës që ndodhen midis dy apo më shumë vendeve.²¹⁸ Në këto kushte, rregullimi ligjor i përdorimit të këtyre burimeve ujore merr një rëndësi të veçantë për jetesën e njerëzve që jetojnë në këto zona dhe për vetë marrëdhëniet midis këtyre vendeve, prej nga lind edhe domosdoshmëria për të rregulluar marrëdhëniet ndërshtetërore në lidhje me përdorimin e ujërave që kalojnë ose lagin dy apo më shumë shtete.

Ujërat e pastër sot në botë janë më pak se 3% e të gjithë sasisë totale të ujit në planet dhe nga kjo, pjesa më e madhe janë të ngrirë në formë akujsh. Liqenet e Mëdhenj të Amerikës së Veriut,²¹⁹ të shtrira midis SHBA dhe Kanadasë, mbajnë rreth 20% të ujërave të pastër të të gjithë planetit. Sot në botë numërohen 261 lumenj ndërkombëtarë, që zënë rreth 45% të sipërfaqes së globit, e nga të gjithë shtetet sot në botë, 21 prej tyre shtrihen krejtësisht brenda baseneve ujëmbledhës të lumenjve ndërkombëtarë. Nga basenet ujëmbledhës, 19 prej tyre ndahen midis 5 apo më tepër shteteve: pellgjet e Danubit, Kongos, Nigerit, Nilit, Rinit dhe Zambezit, ndahen midis 9-11 shtetesh. Ndërsa ujërat e 13 baseneve të tjerë: Amazonës, Gangut-Brahmaputrës-Meghnës, Liqenit të Çadit, Tarimit, Detit Aral, Jordanit, Kura-Araksit, Mekongut, Tigris-Eufratit, Vollgës, La Platës, Nemanit, Vistulës, kanë midis 5-8 shtete në brigjet e tyre.²²⁰ Danubi me degët e tij është lumi i cili rrjedh nëpër territoret e 18 shteteve, numri më i lartë në botë.²²¹ Në këto kushte, normat e së drejtës ndërkombëtare mbi menaxhimin dhe përdorimin e qëndrueshëm të këtyre burimeve ujore natyrore marrin rëndësi të veçantë.

4.1 Legjislacioni ndërkombëtar për mbrojtjen e ujit.

Kontrolli i ujërave ka përbërë sfidë për njerëzimin që në lashtësi. Shfrytëzimi i lumenjve në Mesopotami, Egjipt, Perandorinë Inkase, Kinë dhe Indi mundësoi përparimin e atyre shoqërive për kohën, aq sa autori Karl Wittfogel i ka quajtur këto shoqëri si “*shoqëri hidraulike*”.²²² Ndërsa traktati i parë i zbuluar prej arkeologëve ka të bëjë pikërisht me dhënien fund një konflikti për përdorimin e lumit Tigris midis dy sundimtarëve të qytet-shteteve sumeriane Lagash and Umma, në vitin 2500 p.e.s. Sipas Agjencisë së OKB për Ushqimin dhe Bujqësinë (FAO), që prej vitit 805 e.s janë nënshkruar rreth 3,600 traktate që kanë të bëjnë me rrjedhat ujore ndërkombëtare. Shumica e këtyre traktateve kanë të bëjnë me çështje të lundrimit dhe të

²¹⁷ Francesco Francioni, “*Antarctica and the Common Heritage of Mankind*”, në Francesco Francioni dhe Tullio Scovazzi (red.), “*International Law for Antarctica*”, Giuffrè Editore, Milano, 1987, fq. 46.

²¹⁸ Romeo Hanxhari, “*Politikat e Mjedisit. Niveli global dhe niveli lokal. Analizë teorike dhe raste studimi*”, Intergrafika, 2011, fq. 28.

²¹⁹ Liqenet e Mëdhenj të Amerikës së Veriut (Anglisht: The Great Lakes of North America) janë liqene në kufirin midis SHBA dhe Kanadasë, të ndërlidhur me njëri-tjetrin, ku futen liqenet Superior, Michigan, Huron, Erie dhe Ontario.

²²⁰ Stephen McCaffrey, Dinah Shelton, John Cerone, “*Public International Law: Cases, Problems and Texts*”, LexisNexis, 2011, fq. vi.

²²¹ http://www.un.org/waterforlifedecade/transboundary_waters.shtml

²²² Eyal Benvenisti, “*Collective action in the utilization of shared freshwater: The challenges of international water resources law*”, American Journal of International Law, Vol. 90, 1996, fq. 385.

çaktimit të kufijve ujorë. Në kohët e sotme po fitojnë gjithmonë e më tepër terren traktatet që kanë të bëjnë me zhvillimin, mbrojtjen dhe ruajtjen e burimeve ujore.²²³

Për shkak të rëndësisë së madhe të lundrimit për njerëzimin, për të mundësuar peshkimin dhe për transport, siç u përmend në fillim të këtij punimi, traktatet e para të kohëve moderne për rregullimin e marrëdhënieve midis shteteve për administrimin e burimeve ujore janë ato të hartuara nga Kongresi i Vjenës, për krijimin e Komisionit Qendror për Lundrimin në Lumin Rin në vitin 1815, si edhe marrëveshja për krijimin e Komisionit Evropian të Lumenjve, bazuar në Traktatin e Paqes së Parisit, të vitit 1856. Kongresi i Vjenës e shpalli lumin Danub të lirë për lundrim për të gjithë shtetet që lageshin prej tij.

Me marrjen hov të zhvillimit të industrisë pas Revolucionit Industrial, e prej këtej edhe të intensifikimit të bujqësisë dhe zgjerimit të sipërfaqeve bujqësore, u rrit në mënyrë progresive nevoja për burime ujore për t'u përdorur për qëllime të tjera veç lundrimit, siç ishin përdorimi për industrinë dhe bujqësinë. Prandaj edhe lindi nevoja e hartimit të normave që do të rregullonin marrëdhëniet midis shteteve edhe për sa i përket përdorimit të ujërave për këto qëllime të tjera veç lundrimit, i cili ishte i rregulluar fillimisht prej normave të së drejtës zakonore, e më pas prej traktateve.

Traktati i parë dypalësh që vazhdon të jetë ende në fuqi, i cili trajton si aspektet e cilësisë së ujërave, ashtu edhe aspektet sasiore të tyre, është marrëveshja e vitit 1909 midis SHBA dhe Britanisë së Madhe për ujërat ndërkufitare midis SHBA dhe Kanadasë,²²⁴ duke krijuar edhe një komision të përbashkët për këtë qëllim. Palët bien dakord që lundrimi në të gjithë ujërat ndërkufitare të mbetet përgjithmonë i lirë dhe i hapur për qëllime të tregtisë dhe të transportit, të banorëve, të anijeve dhe mjeteve të tjera të lundrimit, për të dyja vendet në mënyrë të barabartë, pa mohuar të drejtat e tyre që të hartojnë ligje brenda territoreve respektive, të cilat nuk çenojnë lirinë e lundrimit dhe që duhet të zbatohen në mënyrë të barabartë e pa diskriminim ndaj mjeteve lundruese dhe banorëve të të dyja vendeve.

Në mënyrë specifike, kjo marrëveshje parashikon që secila prej palëve ruan të drejtën e juridiksionit ekskluziv dhe të kontrollit mbi përdorimin dhe devijimin e përkohshëm apo të përhershëm të ujërave në brendësi të territorit të tyre të cilat në mënyrë të natyrshme rrjedhin përgjatë kufirit. Por, nga ana tjetër, ato bien gjithashtu dakord që çdo ndërhyrje apo devijim që sjell si pasojë ndonjë dëm të shkaktuar në anën tjetër të kufirit, i jep të drejtën palës së dëmtuar të përdorë të gjitha mjetet ligjore për shpërblimin e dëmit, ashtu siç gëzohet kjo e drejtë sikur dëmi të ishte shkaktuar në atë vend. Asnjë ndërhyrje e kësaj natyre nuk mund të bëhet pa miratimin e Komisionit të Përbashkët të përbërë prej 6 vetësh, nga 3 anëtarë për secilën palë. Marrëveshja ndalonte çdo devijim të ujërave të lumit Niagara, në mënyrë që të mos ndikohej në masë të madhe niveli i ujit në liqenin Erie.²²⁵

Në lidhje me përdorimin e ujërave ndërkufitare janë hartuar disa teori të ndryshme përgjatë viteve. Në ndër më ekstremet ishte doktrina e “sovrانيتit absolut territorial” e hartuar në vitin

²²³ http://www.un.org/waterforlifedecade/transboundary_waters.shtml

²²⁴ Marrëveshja SHBA-Britani e Madhe gjendet në:

http://www.ijc.org/files/tiny_mce/uploaded/Boundary%20Waters%20Treaty%20of%201909.pdf

²²⁵ *Ibid.*, nenet II, III dhe V.

1895, në formën e një opinionioni ligjor prej Prokurorit të Përgjithshëm të SHBA Judson Harmon,²²⁶ prej nga ka marrë edhe emrin, në përgjigje të kërkesës prej Departamentit të Shtetit, për shkak të mosmarrëveshjes me Meksikën për përdorimin e ujërave të lumit Rio Grande. Thelbi i kësaj doktrine konsiston në të drejtën sovraane të shtetit që ndodhet në rrjedhën e sipërme të ujërave që t'i përdorë ato për të përmbushur nevojat e veta pa asnjë lloj kufizimi.²²⁷ E të njëjtës natyrë është edhe e ashtuquajtura “doktrina e integritetit absolut të rrjedhës ujore”, që në dallim nga doktrina e “sovrانيتetit absolut territorial”, të drejtat nuk ia atribuon shtetit që ndodhet në rrjedhën e sipërme të ujërave, por atij që ndodhet në rrjedhën e poshtme të tyre.²²⁸

Kuptohet që e drejta ndërkombëtare bashkëkohore i ka hedhur poshtë këto doktrina të sovranitetit absolut, pasi sovraniteti i një shteti nuk nënkupton vetëm ushtrimin e të drejtave, por edhe marrjen përsipër të detyrimeve, duke respektuar kështu sovranitetin e shteteve të tjerë. Në çështjen Incidenti i Kanalit të Korfuzit, GJND theksoi në mënyrë të prerë që “Çdo shtet ka detyrimin që të mos lejojë që me dijeninë e tij, territori i tij të përdoret për akte që shkelin të drejtat e shteteve të tjerë.”²²⁹

Edhe përpara këtij vendimi, që në vitin 1927, Gjykata Supreme Shtetërore e Republikës së Vajmarit (*Reichsgerichtshof*) mori në shqyrtim mosmarrëveshjen midis shteteve gjermane, ku shtetet e Württembergut dhe Prusisë paditën shtetin e Badenit, për shkak të fenomenit të quajtur “Zhytja e Danubit” (tharja e lumit), prej të cilit mori emrin edhe vetë çështja, “*Donauversinkung*”. Dy shtetet paditës kërkuar marrjen e masave të përkohshme, ndërprerjen e punimeve nga ana e shtetit të Badenit, pasi ato shkaktonin tharjen e disa pjesëve të Danubit në sezona të caktuara të vitit. Për të zgjidhur mosmarrëveshjen, Gjykata Supreme gjermane vendosi të zbatojë normat e së drejtës ndërkombëtare, pasi nuk mund të zbatoheshin normat e të drejtës së brendshme të shteteve ndërgjyqës, ndërkohë që kushtetuta gjermane nuk kishte norma të tilla që mund të zbatoheshin. Ajo theksoi që “...Ushtrimi i të drejtave sovraane nga një shtet në lidhje me lumenjtë ndërkombëtarë që kalojnë nëpër territorin e tij kufizohet nga detyrimi për të mos cënuar interesat e anëtarëve të tjerë të komunitetit ndërkombëtar...Asnjë shtet nuk mund të cënojë ndjeshëm përdorimin e natyrshëm të rrjedhës së një lumi të tillë nga ana e fqinjit të tij. Ky parim ka gjetur njohje përherë e më të madhe në marrëdhëniet ndërkombëtare...Zbatimi i këtij parimi diktohet nga rrethanat e çdo rasti të veçantë. Interesat e shteteve në fjalë duhet të barazpeshohen në mënyrë të drejtë e të barabartë kundër njëri-tjetrit.”²³⁰

Për nga vetë natyra, burimet ujore përbëjnë një të mirë të përbashkët, e për rrjedhojë, përdorimi eficient i tyre bën të domosdoshëm bashkëpunimin e aktorëve që mund t'i shfytëzojnë këto burime. Në të kundërtën, konfliktet janë të pashmangshme, madje është diskutuar edhe një tezë e cila thotë që nëse luftërat e tanishme nëpër botë bëhen për naftën, në të ardhmen ato do të bëhen për ujë, për shkak të rritjes së numrit të popullsisë dhe pakësimit të mundësive për të plotësuar

²²⁶ Në atë kohë, në vitin 1895, Prokurori i Përgjithshëm drejtonte Departamentin e Drejtësisë të SHBA dhe i jepte opinione ligjore Departamentit të Shtetit, pasi ky i fundit nuk kishte ende shërbimin e vet ligjor.

²²⁷ Stephen C. McCaffrey, “*The Harmon Doctrine One Hundred Years Later: Buried, Not Praised*”, *Natural Resources Journal*, Vol. 36, 1996, fq. 965-1007.

²²⁸ *Supra.*, shënimi fundor nr. 22, fq. 541.

²²⁹ Vendimi i GJND, Incidenti i Kanalit të Korfuzit, Fq. 22, parag. 4. Gjendet në:

<http://www.icj-cij.org/docket/files/1/1645.pdf>

²³⁰ Yearbook of the International Law Commission, 1991, Vol. II, Pjesa 1, fq. 56-57. Gjendet në:

[http://legal.un.org/ilc/publications/yearbooks/Ybkvolumes\(e\)/ILC_1991_v2_p1_e.pdf](http://legal.un.org/ilc/publications/yearbooks/Ybkvolumes(e)/ILC_1991_v2_p1_e.pdf)

nevojat me ujë. Sipas të dhënave të Bankës Botërore, sot në 80 shtete konsumi vjetor i ujit i tejkalon burimet kombëtare të furnizimit me ujë.²³¹ Jo më kot, etimologjia e fjalës ‘rival’ është interpretuar se rrjedh prej fjalës latine ‘rivus’, që do të thotë ‘rrjedhë’, pra rivalitetet midis banorëve që jetojnë në anët e kundërta të lumit.²³²

Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë e përmendi disa herë çështjen e mohimit të së drejtës për ujë të popullsisë palestineze prej ndërtimit të murit nga ana e Izraelit, në Mendimin Këshillimor “Pasojat Ligjore të Ndërtimit të një Muri në Tokat e Pushtuara Palestineze”. Ajo iu referua Raportuesit Special për Situatën e të Drejtave të Njeriut në territoret palestineze të pushtuara prej Izraelit që në vitin 1967, i cili raportonte që një pjesë e madhe e tokave bujqësore pjellore palestineze dhe pusët më të rëndësishëm të ujit në rajon janë në anën e Izraelit dhe se ndërtimi i murit i ndante palestinezët nga tokat e tyre bujqësore, pusët e ujit dhe mjetet e mbijetesës. Ndërsa Raportuesi Special për të Drejtën për Ushqim i Komisionit të OKB për Drejtat e Njeriut raportonte që duke ndërtuar murin, Izraeli aneksonte efektivisht pjesën më të madhe të basenit ujëmbledhës që përbën 51% të rezervave ujore të Bregut Perëndimor. Duke i ndarë komunitetet me mur nga tokat dhe uji, pa mjete të tjera për mbijetesë, shumë prej palestinezëve do të detyrohen të largohen. Prandaj gjykata e vlerësoi ndërtimin e murit se cënonte lirinë e lëvizjes së banorëve të Territoreve të Pushtuara Palestineze, që mbrohet prej paragrafit 1 të nenit 12 të Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike, si edhe të drejtën për punë, për një jetë të shëndetshme, për arsim dhe për një standard të përshtatshëm jetese, që mbrohen nga Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore dhe nga Konventa e OKB për të Drejtat e Fëmijëve.²³³

Në të drejtën zakonore të brendshme, individët e kanë zgjidhur me marrëveshje përdorimin e ujit nëpër fshatra. Në të drejtën e sotme ndërkombëtare, mbizotërojnë parimi i ndarjes së drejtë e të ndershme²³⁴ të këtyre burimeve dhe parimi i menaxhimit të integruar të tyre. Parimi i parë gjendet i përmendur në Projektnevet e Komisionit të së Drejtës Ndërkombëtare, “Për të Drejtën e Përdorimit të Rrjedhave Ujore Ndërkombëtare për Qëllime të Ndryshme nga Lundrimi dhe Rezoluta për Ujërat Ndërkufitare Nëntokësore.”²³⁵ Neni 5 i projektneve sanksionon që shtetet që lagen prej rrjedhave ujore ndërkombëtare do i përdorin ato në territoret e tyre në mënyrë të drejtë e të ndershme dhe të arsyeshme. Ata do të marrin pjesë në përdorimin, zhvillimin dhe mbrojtjen e këtyre rrjedhave e kjo pjesëmarrje përfshin si të drejtën e përdorimit, ashtu edhe detyrimin për të bashkëpunuar për mbrojtjen dhe zhvillimin e tyre. Komisioni nënvizon se parimi i ndarjes së drejtë e të ndershme u jep të drejtën shteteve të shfrytëzojnë ujërat për të përmbushur nevojat optimale të tyre, por nuk duhet të tejkalojnë atë çka është e drejtë dhe e ndershme, për të mos u mohuar edhe vendeve të tjera të drejtën e shfrytëzimit. Nevojat optimale nuk nënkuptojnë

²³¹ Të dhënat e Bankës Botërore për ujin gjenden në: <http://www.worldbank.org/en/topic/water>

²³² Joseph W. Dellapenna, “The International Law The International Law Association’s Berlin Rules on Water Resources and Their Relevance to Australia”. Gjendet në:

<http://www.icewarm.com.au/userfiles/File/Berlin%20Rules-Relevance%20to%20Australia.pdf>

²³³ Mendimi Këshillimor i GJND “Pasojat Ligjore të Ndërtimit të një Muri në Tokat e Pushtuara Palestineze”, fq. 58-60. Gjendet në: <http://www.icj-cij.org/docket/files/131/1671.pdf>

²³⁴ Ekiteja (Anglisht *equity*). Për një trajtim të hollësishëm të parimit të ekitesë në të drejtën e detit shih: Xhezair Zaganjori, “Jurisprudencë dhe praktikë ndërkombëtare”, Adelprint, Tiranë 2012, fq. 64-66.

²³⁵ Projektnevet e Komisionit të së Drejtës Ndërkombëtare, “Për të Drejtën e Përdorimit të Rrjedhave Ujore Ndërkombëtare për Qëllime të Ndryshme nga Lundrimi dhe Rezoluta për Ujërat Ndërkufitare Nëntokësore gjenden në: http://legal.un.org/ilc/texts/instruments/english/commentaries/8_3_1994.pdf

përdorimin e sasisë maksimale, por përfshijnë përfitimin prej të gjithë shteteve që lagen nga këto ujëra. Ndërsa parimi i menaxhimit të integruar nënkupton që për të arritur zhvillimin e qëndrueshëm, përdorimi dhe menaxhimi i burimeve ujore duhet të bëhet duke marrë në konsideratë planifikimin e nevojave afatgjata, të cilat duhet të përfshijnë aspektet mjedisore, ekonomike dhe sociale, si edhe shmangien e rreziqeve lidhur me përdorimin e ujërave. Kuptohet, të tilla norma nuk janë detyruese, pasi kanë mbetur thjesht në kuadrin e projektneve, ende të papërfshira në ndonjë traktat ndërkombëtar, por janë një përpjekje për të kodifikuar normat e së drejtës zakonore për përdorimin e rrjedhave ujore ndërkombëtare.

Bazuar në këto parime dhe në të drejtën zakonore, Gjykata e Përhershme e Drejtësisë Ndërkombëtare (GJPDN) ka marrë në shqyrtim dy çështje për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve midis shteteve për përdorimin e lumenjve Oder dhe Meuse. Në çështjen lidhur me Juridiksionin Territorial të Komisionit Ndërkombëtar të Lumit Oder, të vitit 1929, midis Mbretërisë së Bashkuar, Çekosllovakisë, Danimarkës, Francës, Gjermanisë, Suedisë, nga njëra anë, dhe Polonisë nga ana tjetër, palët in drejtuan gjykatës me pyetjen nëse juridiksioni i Komisionit Ndërkombëtar të Lumit Oder sipas dispozitave të Traktatit të Versajës shtrihej edhe mbi ujërat e degëve të tij, Warta dhe Notec që ndodheshin në territorin polak, dhe nëse po, cili parim duhet të zbatohet për të përcaktuar limitet e juridiksionit të Komisionit për rrjedhën e sipërme? Ndërsa të gjashtë shtetet pretendonin që Komisioni kishte juridiksion, Polonia argumentonte që neni 331 i Traktatit të Versajës thjesht deklaronte që vetëm ato pjesë të sistemit të lumit Oder që i mundësojnë më shumë se një shteti daljen në det do të konsiderohen si ndërkombëtare, e për rrjedhojë, përjashtohen nga ky përkufizim ato pjesë të degëve të lumit që shtrihen mbi vijën e kufirit polak. Një nga parimet që gjykata pranoi si të vlefshëm ishte ai që kishte të bënte me qëllimin e shteteve që nëpërmjet traktateve të ndërkombëtarizonin regjimet e lumenjve e të siguronin mundësinë e daljes në det edhe për shtetet që ndodheshin në rrjedhën e sipërme të tyre. Pastaj gjykata u shpreh që neni 331 i Traktatit të Versajës duhet të interpretohet në dritën e parimeve që nuk lënë asnjë dyshim që ndërkombëtarizimi i një rrjedhe ndërkombëtare që kalon nëpër shtete të ndryshme nuk ndalon në kufirin e fundit, por shtrihet përgjatë të gjithë lumit të lundrueshëm.²³⁶

Ndërsa në çështjen Devijimi i Ujit prej (Lumit) Meuse, të vitit 1937, midis Hollandës dhe Belgjikës, u diskutua kryerja e punimeve nga ana e Belgjikës për furnizimin e disa kanaleve duke marrë ujë nga lumi Meuse. Holanda iu drejtua GJPDN për të vlerësuar nëse punimet e kryera nga Belgjika për ndërtimin e Kanalit Albert, që do lidhte Liezhin me Antverpin, dhe mënyra se si kishte vepruar Belgjika, pa marrë miratimin e Hollandës, për të furnizuar në të ardhmen kanalet e projektuar në veri të territorit të saj, ishin apo jo në përputhje me detyrimet e marra përsipër në Traktatin e nënshkruar në Hagë në 12 maj 1863, i cili përcaktonte regjimin e përdorimit të lumit Meuse, për marrjen e ujit prej tij. Nga ana tjetër edhe Belgjika pretendonte që ndërtimi i një dige pritëse në Borgharen përbënte shkelje të traktatit, si edhe ndërtimi i Kanalit Juliana duhet të rregullohet nga dispozitat e të njëjtit traktat. Në vitin 1906 palët kishin vendosur krijimin e një Komisioni të Përbashkët për shqyrtimin e punimeve që mund të ndërmerreshin për përmirësimin e lundrimit në lumin Meuse. Duke qenë se Belgjika kishte kundërshtuar ndërtimin e kanaleve nga ana e Hollandës, për shkak se do të ndikonin në lundrueshmërinë në anën e saj të lumit, palët hartuan një traktat tjetër në vitin 1925, i cili mundësonte hapjen e kanaleve nga të dyja palët, por

²³⁶ Vendimi i GJPDN, Juridiksioni Territorial i Komisionit Ndërkombëtar të Lumit Oder, fq. 26 dhe 29. Gjetet në http://www.icj-cij.org/pcij/serie_A/A_23/74_Commission_internationale_de_l_Oder_Arret.pdf

që nuk u ratifikua nga Holanda. GJPDN i rrëzoi të gjitha pretendimet respektive të palëve, por në lidhje me Kanalin Juliana të ndërtuar nga Holanda tha që edhe pse ai nuk u nënshtrohet dispozitave të traktatit të vitit 1863, kjo nuk do të thoshte që ajo kishte të drejtë ta përdorte lumin Meuse si të donte.²³⁷

Të njëjtin qëndrim ka mbajtur në vitin 1957 edhe gjykata e arbitrazhit në çështjen *Lac Lanoux*, e cila shqyrtoi mosmarrëveshjen midis Spanjës dhe Francës në lidhje me liqenin prej nga ka marrë edhe emrin kjo çështje.²³⁸ Spanja pretendonte që planet e qeverisë franceze për të kryer punime që do të ndikonin në sasinë e ujërave të liqenit Lanoux në gadishullin e Pirenejve do të cënonin interesat e saj dhe do të shkelnin dispozitat e Traktatit të Bayonne-s të 26 majit 1866 të nënshkruar midis tyre. Gjykata theksoi se kërkesa që Spanja pretendon se duhet respektuar, që një shtet mund t'i shfrytëzojë rrjedhat ujore ndërkombëtare vetëm pasi të jetë marrë vesh më parë me shtetet e tjera të interesuara, nuk gjendet e bazuar në të drejtën zakonore, aq më pak si një parim i përgjithshëm i të drejtës. Ajo vazhdon më tej duke thënë që kur diskutohet çështja nëse Franca i ka mbajtur parasysh mjaftueshëm interesat e Spanjës qoftë gjatë bisedimeve, qoftë kur parashtrroi propozimet, duhet theksuar fakti se sa ngushtë janë të lidhur së bashku detyrimi për të mbajtur parasysh interesat gjatë bisedimeve, me mbajtjen parasysh të tyre kur merret vendimi përfundimtar. Një shtet që i ka zhvilluar bisedimet në mirëbesim, nuk çlirohet nga detyrimi që t'i japë një rëndësi të arsyeshme edhe interesave të kundërta kur merr vendimin përfundimtar për shkak të ndërprerjes së bisedimeve, qoftë edhe kur kjo ndodh për shkak të qëndrimit jo fleksibël të palës tjetër. Anasjelltas, për të parë se sa janë mbajtur parasysh interesa të tilla, kjo do të përcaktohet duke mbajtur parasysh numrin e përgjithshëm të interesave të pretenduara dhe çmimin që secila palë është e përgatitur të paguajë për të garantuar këto interesa. Bazuar në këta elementë, gjykata arriti në përfundimin që Franca nuk kishte shkelur dispozitat e Traktatit të Bayonne-s të vitit 1866.²³⁹

Përpyekjet fillestare për kodifikimin e normave të së drejtës zakonore u bënë me hartimin e Rregullave të Helsinkit për Përdorimin e Ujërave të Lumenjve Ndërkombëtarë, të hartuar nga Shoqata e së Drejtës Ndërkombëtare (ILA)²⁴⁰ në vitin 1966,²⁴¹ e më pas me hartimin e Rregullave të Berlinit, të vitit 2004.²⁴² I gjithë kreu 2 i Rregullave të Helsinkit i kushtohet parimit të përdorimit të drejtë e të ndershëm të ujërave të pellgjeve ndërkombëtarë. Sipas nenit 4, shtetet gëzojnë të drejtën e përdorimit të një pjese të drejtë e të ndershme dhe të arsyeshme të ujërave të pellgut që ndodhen në territorin e tyre. Më tej neni 5 sqaron kuptimin e termave 'të arsyeshëm' dhe 'të drejtë e të ndershme', duke theksuar se këta terma kuptohen në dritën e të gjithë

²³⁷ Vendimi i GJPDN, Devijimi i Ujit prej (Lumit) Meuse, fq. 32, parag. 1. Gjendet në: http://www.icj-cij.org/pej/serie_AB/AB_70/01_Meuse_Arret.pdf

²³⁸ Vendimi i Gjykatës së Arbitrazhit në çështjen *Lac Lanoux*, Spanja kundër Francës, datë 16.11.1957, gjendet në: <http://www.ecolex.org/server2.php/libcat/docs/COU/Full/En/COU-143747E.pdf>

²³⁹ *Ibid.*, parag. 13 dhe 34.

²⁴⁰ Shoqata e së Drejtës Ndërkombëtare (ILA) është një organizatë ndërkombëtare që ka si objekt të veprimtarisë së saj studimin dhe zhvillimin e së drejtës ndërkombëtare, publike e private. Autori i këtij punimi është një ndër anëtarët themelues dhe Zv. Drejtor i Shoqatës Shqiptare të së Drejtës Ndërkombëtare (SHSHDN). Informacion i hollësishëm për veprimtarinë e ILA gjendet në: http://www.ila-hq.org/en/about_us/index.cfm

²⁴¹ Rregullat e Helsinkit të ILA të vitit 1966 gjenden në:

http://www.unece.org/fileadmin/DAM/env/water/meetings/legal_board/2010/annexes_groundwater_paper/Annex_II_Helsinki_Rules_ILA.pdf

²⁴² Rregullat e Berlinit të ILA të vitit 2004 gjenden në:

http://internationalwaterlaw.org/documents/intldocs/ILA_Berlin_Rules-2004.pdf

faktorëve relevantë të çdo rasti të veçantë. Faktorët përkatës që duhen marrë në konsideratë përfshijnë, por nuk janë shterues: gjeografinë e basenit ujëmbledhës, duke përfshirë në mënyrë të veçantë masën e shtrirjes së zonës së precipitimit në territorin e çdo shteti; hidrologjinë e basenit, duke përfshirë në mënyrë të veçantë kontributin me ujë të çdo shteti; klimën e cila ndikon tek baseni; përdorimin e mëparshëm të ujërave të basenit, duke përfshirë në mënyrë të veçantë përdorimin aktual; nevojat ekonomike dhe sociale të secilit shtet të basenit; popullsinë që varet prej ujërave të basenit në secilin shtet; kostot e krahasuara të mjeteve alternative për përmbushjen e nevojave ekonomike dhe sociale të secilit shtet; disponueshmërinë e burimeve të tjera; shmangien e mbetjeve të panevojshme për përdorimin e ujërave të basenit; anën praktike të kompensimit të mundshëm të një apo më shumë shteteve si një mjet për të shmangur përplasjet midis përdorimeve të ndryshme dhe masën në të cilën mund të plotësohen nevojat e një shteti, pa i shkaktuar dëme të konsiderueshme një shteti tjetër të pellgut. Pësha specifike që i jepet çdo faktori përcaktohet prej rëndësisë që ka në krahasim me atë të faktorëve të tjerë relevantë. Për përcaktimin e asaj se çfarë është pjesë e arsyeshme, e drejtë dhe e ndershme, të gjithë faktorët duhet të merren në konsideratë bashkërisht dhe konkluzioni arrihet mbi bazën e të gjithë faktorëve në tërësi. Ndërsa në lidhje me ndotjen, ky nen sanksionon se në përputhje me parimin e ndarjes së drejtë e të ndershme të ujërave të një baseni ujëmbledhës ndërkombëtar, një shtet duhet të parandalojë çdo formë të ndotjes së ujit apo çdo rritje të shkallës së ndotjes së ujit, që do të mund të shkaktonte dëme të konsiderueshme në territorin e një shteti tjetër. Po ashtu, shtetet duhet të marrin të gjitha masat e arsyeshme për të pakësuar ndotjen ekzistuese, në mënyrë që të mos i shkaktohet dëm një shteti tjetër të pellgut. Në rast shkeljeje të këtyre normave, neni 11 parashikon që shteti përgjegjës duhet të ndalojë veprimtarinë që shkakton shkeljen dhe duhet të kompensojë shtetin e dëmtuar.

Pas shqyrtimit të këtyre rregullave, Asambleja e Përgjithshme e OKB nuk arriti konsensus në lidhje me to, kështu që në vitin 1992 u miratua Konventa e UNECE (e Helsinkit) për Mbrojtjen dhe Përdorimin e Rrjedhave Ujore Ndërkufitare dhe Liqeneve Ndërkombëtarë,²⁴³ me qëllim forcimin e masave kombëtare për mbrojtjen e ujërave ndërkombëtare sipërfaqësore e nëntokësore. Konventa i përkufizon ujërat ndërkufitare si *“ujëra sipërfaqësore ose nëntokësore, të cilët ndajnë, kalojnë ose ndodhen në kufirin midis dy ose më shumë shteteve”*. Ajo cakton detyrimin që shtetet palë duhet t'i menaxhojnë dhe ruajnë në mënyrë ekologjike dhe racionale këto ujëra e t'i përdorin në mënyrë të arsyeshme e të drejtë. Ato kanë gjithashtu detyrimin të mbajnë nën kontroll efektet ndërkufitare, përfshirë ndotjen, të sigurojnë ruajtjen dhe rigjallërimin e ekosistemeve, si edhe të bashkëpunojnë për mbrojtjen jo vetëm të ujërave ndërkufitare, por edhe të mjedisit që ndikohet nga këto ujëra, përfshirë mjedisin ujor detar.

Fillimisht konventa u negociua si një instrument rajonal evropian, në kuadër të UNECE, Komisionit Ekonomik të OKB për Evropën, por me amendamentin e vitit 2003 i cili hyri në fuqi në vitin 2013, u shndërrua në një traktat global për bashkëpunimin ndërkufitar në lidhje me ujërat ndërkufitare, i hapur për aderim për të gjithë anëtarët e OKB. Sot konventa numëron 40 shtete palë, përfshirë Shqipërinë, e cila është bërë palë që prej 5 janarit 1994, ndërsa amendamentet numërojnë 26 palë, ku Shqipëria është bërë palë në 29 maj 2014.

²⁴³ Informacion i detajuar mbi Konventën e Helsinkit për Mbrojtjen dhe Përdorimin e Rrjedhave Ujore Ndërkufitare dhe Liqeneve Ndërkombëtarë gjendet në: <http://www.unece.org/env/water/text/text.html>

Teksti i konventës është plotësuar edhe me dy protokolle shtesë. Duke marrë shkas nga fakti që vetëm në Evropë janë 140 milionë banorë (16% e popullsisë së saj), të cilët jetojnë në banesa që nuk janë të lidhura me rrjetin e ujit të pijshëm, dhe në kushtet kur 85 milionë nuk kanë akses në mjetet e duhura të higjienës,²⁴⁴ në vitin 1999 u miratua Protokoll i Londrës për Ujin dhe Shëndetin. Deri tani janë bërë palë në protokoll 27 shtete, midis tyre edhe Shqipëria, palë që nga 8 marsi 2002. Protokoll i hyri në fuqi në vitin 2005. Kjo marrëveshje synon mbrojtjen e shëndetit dhe mirëqenies njerëzore nëpërmjet menaxhimit më të mirë të ujit, duke përfshirë mbrojtjen e ekosistemeve ujore, duke parandaluar, kontrolluar dhe pakësuar sëmundjet që shkaktohen prej papastërtive të ujit. Qëllimi i hartimit të këtij protokoll është sigurimi i sasive të mjaftueshme të ujit të pijshëm për të gjithë.

Pas tij, në vitin 2003 u nënshkrua Protokoll i Kievit për Përgjegjësinë Civile dhe Kompensimin për Dëmet e Shkaktuara në Ujërat Ndërkufitare prej Efekteve Ndërkufitare të Aksidenteve Industriale, i cili synon krijimin e një regjimi gjithëpërfshirës të përgjegjësisë civile, për kompensimin e duhur dhe të menjëhershëm për dëmet që shkaktohen nga efektet mbi ujërat ndërkufitare të aksidenteve industriale. Protokoll i nënshkrua nga 22 shtete në kuadër të Konferencës Ministrore “Mjedisi për Evropën”, ku u bashkuan edhe 2 shtete të tjerë në fund të vitit 2003, por që do të hyjë në fuqi me dorëzimin e instrumentit të 16 të ratifikimit. Protokoll është i hapur për ratifikim nga shtetet që janë palë në secilën prej dy konventave: Konventën e Helsinkit për Mbrojtjen dhe Përdorimin e Rrjedhave Ujore Ndërkufitare dhe Liqeneve Ndërkombëtare dhe Konventën për Efektet Ndërkufitare të Aksidenteve Industriale. Rëndësia e këtij protokoll qëndron në faktin që do u japë individëve të prekur prej dëmeve të shkaktuara në ujërat ndërkufitare prej efekteve ndërkufitare të aksidenteve industriale (p.sh. peshkatarëve apo personave që punojnë në instalimet ujore), të drejtën ligjore që të pretendojnë kompensimin e duhur dhe të menjëhershëm për dëmet që vijnë si pasojë e aksidenteve industriale, si edhe nga digat, apo prej transportit në tubacione. Po ashtu, protokoll mbulon edhe dëmtimet fizike, dëmtimet e pronave, humbjen e të ardhurave, etj. Protokoll vendos edhe limitet financiare të përgjegjësisë, në varësi të rrezikshmërisë së aktivitetit, p.sh. në lidhje me sasinë e substancave të rrezikshme që mund të mbahen dhe rreziqet që mund t’i kanosen mjedisit prej tyre. Për të mbuluar përgjegjësi të tilla, kompanive u duhet të kenë siguri financiare, siç mund të jenë siguracionet apo garanci të tjera. Protokoll synon të garantojë mosdiskriminimin e viktimave, të cilët nuk duhet të trajtohen në mënyrë më pak të favorshme se viktimat prej vendit ku ka ndodhur aksidenti. Por një ndër aspektet më të rëndësishëm të protokollit është se ai synon të plotësojë një boshllëk të rëndësishëm ligjor të në të drejtën ndërkombëtare mjedisore, zgjidhjen e problemit të dëmeve të pakompensuara vendeve fqinje të dëmtuara. Duke inkurajuar kompanitë të marrin masa për të parandaluar dëmet për të cilat ato mbajnë përgjegjësi, protokoll do të ndihmojë në parandalimin e aksidenteve dhe shmangien e pasojave ndaj njeriut dhe mjedisit. Limitet financiare të përgjegjësisë dhe normat minimale të siguracioneve caktohen në marrëveshje me të gjithë pjesëmarrësit në negociata, përfshirë sektorin e siguracioneve, duke caktuar shuma realiste dhe jo të ekzagjeruara.²⁴⁵

Pas konventës së UNECE të vitit 1992, Asambleja e Përgjithshme e OKB miratoi në vitin 1997 Konventën për të Drejtën e Përdorimit të Rrjedhave Ujore Ndërkombëtare për Qëllime të

²⁴⁴ Statistikat gjenden në:

http://www.unece.org/fileadmin/DAM/env/water/publications/brochure/Protocol_E_A4.pdf

²⁴⁵ <http://www.unece.org/env/civil-liability/welcome.html>

Ndryshme nga Lundrimi”²⁴⁶ Dispozitat e saj janë tipike të një konvente kuadër, pasi përmbledhin parime dhe rregulla që mund të zbatohen dhe përshtaten sipas kushteve konkrete të një baseni ujëmbledhës ndërkombëtar specifik, siç përcaktohet në nenin 3 të saj. Ajo përfshin parimin e përdorimit të barabartë e të ndershëm rrjedhave ujore ndërkombëtare, parimin e parandalimit, duke marrë masat e duhura për të parandaluar dëmet që mund t’u shkaktohen shteteve të tjera të pellgut, si edhe parimin e njoftimit paraprak të masave të planifikuara për t’u marrë.

Edhe pse kjo konventë nuk ka hyrë ende në fuqi, pasi nuk është plotësuar numri minimum i ratifikimit prej 35 shtetesh, ajo ka realizuar në një masë të konsiderueshme kodifikimin e normave të së drejtës zakonore mbi menaxhimin e rrjedhave ujore ndërkombëtare. Madje GJND iu referua në mënyrë specifike nenit 5§2 të konventës në vendimin e saj në çështjen *Projekti Gabčíkovo-Nagyymaros* të përmendur më sipër, ku deklaroi se “*Rivendosja e një regjimi të përbashkët do të reflektonte në mënyrë të përshtatshme konceptin e përdorimit të përbashkët të burimeve ujore, për të realizuar disa prej objektivave të përmendur në traktat, në përputje me nenin 5§2 të Konventës për të Drejtën e Përdorimit të Rrjedhave Ujore Ndërkombëtare për Qëllime të Ndryshme nga Lundrimi, sipas të cilit shtetet e rrjedhave ujore do të marrin pjesë në përdorimin, zhvillimin dhe mbrojtjen e rrjedhave ujore ndërkombëtare në mënyrë të drejtë e të ndershme dhe të arsyeshme. Pjesëmarrja përfshin si të drejtën e përdorimit të rrjedhës ujore, ashtu edhe detyrimin për të bashkëpunuar për mbrojtjen dhe zhvillimin e saj, siç parashikohet në Konventë.*”²⁴⁷

Si konventa e vitit 1992, ashtu edhe ajo e vitit 1997, përmbajnë dispozita për menaxhimin e përbashkët të ujërave ndërkombëtare, por me terma të ndryshëm. Konventa e vitit 1992 ka norma më të forta, ajo kërkon nga shtetet palë që të hartojnë marrëveshje dypalëshe ose shumëpalëshe, për të parandaluar, reduktuar dhe kontrolluar ndotjen ndërkufitare ose ndikimet e tjera, si edhe të krijojnë autoritete të përbashkëta, funksionet e të cilëve duhet të jenë deri diku të përcaktuara.²⁴⁸

Duke qenë që konventa e vitit 1997 nuk ka hyrë ende në fuqi, në vitin 2004 Shoqata e së Drejtës Ndërkombëtare miratoi Rregullat e Berlinit për Burimet Ujore, në vijim të Rregullave të Helsinkit. Edhe kjo ishte një përpjekje tjetër për kodifikimin e normave të së drejtës zakonore për rrjedhat ujore, por këtë herë siç reflektohet edhe në titullin e tyre, për të gjitha ujërat, jo vetëm për ato ndërkombëtare. Disa prej neneve të Rregullave të Berlinit janë gjithëpërfshirës, duke adresuar edhe probleme të mjedisit më të gjerë ujor dhe detyrimin për të integruar menaxhimin e ujërave me atë të mjedisit përreth. Nenet 4-9 sanksionojnë parimet e përgjithshme që zbatohen për të gjitha llojet e ujërave: të drejtën e pjesëmarrjes së publikut, detyrimin për të bërë përpjekjet maksimale për të realizuar lidhjen dhe integrimin e menaxhimit të ujërave, si edhe detyrimin për të arritur qëndrueshmërinë dhe minimizimin e dëmeve mjedisore. Nenet 10-16 shpalosin parimet të cilët janë të zbatueshëm vetëm për ujërat ndërkombëtare, ku futen pjesëmarrja e shteteve të pellgut ujëmbledhës, parimi i bashkëpunimit, parimi i përdorimit të

²⁴⁶ Konventa e OKB për të Drejtën e Përdorimit të Rrjedhave Ujore Ndërkombëtare për Qëllime të Ndryshme nga Lundrimi gjendet në: http://legal.un.org/ilc/texts/instruments/english/conventions/8_3_1997.pdf

²⁴⁷ *Supra.*, shënimi fundor nr. 114. Vendimi i GJND Hungaria kundër Sllovakisë, *Projekti Gabčíkovo-Nagyymaros*, parag. 147. Gjendet në: <http://www.icj-cij.org/docket/files/92/7375.pdf>

²⁴⁸ *Supra.*, shënimi fundor nr. 22, fq. 545.

drejtë e të ndershëm, faktorët që duhen mbajtur parasysh për të përcaktuar përdorimin e drejtë e të ndershëm, preferencat midis përdorimeve, etj.

Risia e Rregullave të Berlinit janë nenet 36-42, që kanë të bëjnë me ujërat nëntokësore. Meqë Rregullat e Helsinkit mbulonin vetëm ujërat sipërfaqësore, në vitin 1986 Shoqata e së Drejtës Ndërkombëtare miratoi Rregullat e Seulit, për çështjet që lidheshin me ujërat nëntokësore, të përbëra prej vetëm 4 nenesh. Ato thjesht vendosën shenjën e barazisë me regjimin e ujërave sipërfaqësore, duke thënë që të njëjtat rregulla vlenin edhe për ujërat nëntokësore. Ndërsa Konventa e OKB e vitit 1997 nuk merret me ujërat nëntokësore. Kështu që për të plotësuar këtë boshllëk u miratuan Rregullat e Berlinit. Neni 37 i Rregullave të Berlinit parashikon menaxhimin e ujërave nëntokësore të lidhur me ato sipërfaqësore në cilindo pellg ujëmbledhës, pjesë e të cilit ata janë, duke mbajtur parasysh edhe lidhjet midis akuiferëve ose midis një akuiferi dhe ujërave të tjera sipërfaqësore, si edhe çdo ndikim mbi akuiferët të shkaktuar nga aktivitetet brenda juridiksionit ose kontrollit të shtetit.²⁴⁹ Gjithësesi, deri tani nuk ka patur ndonjë zhvillim të mëtejshëm në lidhje me këto rregulla, kështu që mbetet për t'u parë nëse këto do të përfshihen në të ardhmen në tekstin e ndonjë konvente tjetër.

Aktualisht, ekziston një konsensus midis ekspertëve që marrëveshjet mbi rrjedhat ujore ndërkombëtare duhet të jenë më preçize, të përmbajnë dispozita më të forta për zbatimin e tyre dhe të kenë dispozita më të detajuara që parashikojnë mekanizmat e zgjidhjes paqësore të mosmarrëveshjeve midis shteteve.²⁵⁰

4.1.1 Mbrojtja e mjedisit detar.

Sipërfaqja detare zë 71% të të gjithë hapësirës së globit. Deti është ndër pasuritë më të mëdha që ka njerëzimi, i cili i ka shërbyer ndër shekuj për sigurimin e ushqimit nëpërmjet peshkimit (sot rreth 1.3 miliardë njerëz janë të varur nga ky burim për t'u ushqyer, peshkimi siguron 16.6% të të gjithë sasisë botërore të proteinave shtazore, ndërsa 4.3 miliardë njerëz sigurojnë prej tij rreth 15% të proteinave.)²⁵¹; si një rezervuar gjigand gjallesash të shumëllojshme dhe uji të pijshëm (nëpërmjet procesit të shkripëzimit 16,000 impiantet e eliminimit të kripës nga uji i detit sot në botë prodhojnë rreth 70 milionë m³, afërsisht 70 miliardë litra ujë të pijshëm në ditë, kapacitet që përlloritet të dyfishohet brenda vitit 2020);²⁵² për të mundësuar komunikimin midis popujve dhe shkëmbimet e mallrave, si një rrugë transporti jashtëzakonisht e rëndësishme për lëvizjen e njerëzve dhe tregtinë ndërkombëtare (nëpërmjet detit realizohet 80% e të transportit të mallrave në të gjithë botën);²⁵³ për të pushuar pranë brigjeve të tij dhe për zhvillimin e industrisë së turizmit; si një laborator i stërmadh për të kryer kërkime shkencore dhe studime; si edhe si një rezervuar gjigand energjie, me rezerva naftë, gazi dhe mineralesh, e që ka filluar të shfrytëzohet së fundmi edhe për prodhimin e energjisë, nëpërmjet transformimit të energjisë kinetike të

²⁴⁹ Rregullat e Berlinit dhe komentet e ILA gjenden në:

http://internationalwaterlaw.org/documents/intldocs/ILA_Berlin_Rules-2004.pdf

²⁵⁰ http://www.un.org/waterforlifedecade/transboundary_waters.shtml

²⁵¹ <http://www.fao.org/docrep/016/i2727e/i2727e.pdf>

²⁵² The United Nations World Water Development Report 2014: Water and Energy. Paris, UNESCO. fq. 25. Gjetet në: <http://unesdoc.unesco.org/images/0022/002257/225741E.pdf>

²⁵³ Statistikat e transportit detar gjenden në: http://unctad.org/en/publicationslibrary/rmt2013_en.pdf

rrymave të detit gjatë baticë-zbaticave, në energji elektrike. Për të mbërritur pastaj te roli i pazëvendësueshëm i detit si rregullator i temperaturës së globit dhe si burim i rëndësishëm nxehtësie, duke mënjanuar temperaturat ekstreme, me një temperaturë mesatare prej 17°C në sipërfaqe,²⁵⁴ dhe si rregullator i sistemit klimatik global duke çliruar oksigjen dhe duke përthithur rreth 30% të sasisë globale të dioksidit të karbonit.²⁵⁵

Fatkeqësisht, këto nuk janë të vetmet aspekte të përdorimit të detit prej njeriut, pasi ai e ka përdorur atë edhe si një hapësirë për kryerjen e akteve të dhunshme (terrorizmi dhe pirateria) si edhe një vend gjigand të depozitimit të mbeturinave, deri te ato më të rrezikshmet për çdo formë të jetës në planet, mbetjet bërthamore, apo edhe për kryerjen e testimit të armëve bërthamore, me potencial shkatërrues për të gjithë botën.

Pavarësisht vlerave të jashtëzakonshme për planetin, sot deti është një nga ekosistemet më të rrezikuara të tij. Rreth 85% e sasisë totale të peshkut në botë kërcënohet prej mbipeshkimit. Speciet detare ‘pushtuese’ (llojet joindigjene që lëvizin në një zonë tjetër, e cila është jashtë habitatit të saj natyror) po përhapen, si rezultat shtimit të mbetjeve plastike në det, mbi të cilat mund të udhëtojnë këto specie duke përkrahur distanca shumë të largëta, që në kushte të tjera nuk do e kishin të mundur, duke asgjësuar llojet vendase. Habitatet bregdetare po degradojnë, duke shkaktuar humbje të biodiversitetit detar. Janë rritur së tepërmi problemet e ndotjes prej anijeve dhe derdhjet aksidentale të naftës në det, prej mbyrtjes së anijeve, prej platformave të nxjerrjes së naftës në det, apo prej aksidenteve të centraleve bërthamore, siç ishte rasti i Fukushima në Japoni, në vitin 2011. Parashikimet e shkencëtarëve tregojnë që niveli i aciditetit në oqeanë mund të rritet me 150% në vitin 2100 dhe kjo mund të çojë në ulje drastike të sasisë së peshkut dhe zhdukje të shumë gjallesave të detit, dule përbërë kërcënim për sigurimin e ushqimit për miliarda njerëz.²⁵⁶

Për shkak të ndryshimeve klimatike, rritjes së temperaturës dhe aciditetit të detit, sot rreth 75% të barrierave koralore të botës janë nën kërcënim për t’u shkatërruar. Nëse nuk merren masa për të ndryshuar situatën, mbi 90% e barrierave koralore do të jenë të rrezikuara në vitin 2030 dhe pothuajse që të gjitha do jenë në rrezik në vitin 2050. Vendet ku këto barriera koralore janë më të rrezikuara janë Haiti, Grenada, Filipinet, Komoros, Vanuatu, Tanzania, Kiribati, Fixhi dhe Indonezia.

Studimet tregojnë që rreth 80% e ndotjes së detit është me prejardhje nga toka dhe pjesa tjetër prej 20% e ka prejardhjen nga burimet në det. Burimet e ndotjes së detit klasifikohen në 4 grupe: 1. Ndotja e bregut të detit prej turizmit, si rezultat i hedhjeve prej pushuesve, që prej shisheve plastike e metalike, ambalazhet e ndryshme, e deri te lodrat e varkat plastike të femijëve. 2. Ndotja që vjen prej shkarkimeve të ujërave të zeza të pa trajtuara, që ose shkarkohen direkt në det, ose shkarkohen në rrjedha uji e lumenj, për të përfunduar më pas në det, bashkë me të gjitha mbeturinat e tjera që hidhen nëpër lumenj. 3. Ndotja prej aktivitetit masiv të peshkimit, ku futen pajisjet e ndryshme që hidhen qëllimisht apo humbasin aksidentalisht në det, pajisjet e peshkimit, rrjetat, grepat, fildispanjat, koshat metalikë dhe kurthet e peshkimit, etj. 4. Ndotja prej hedhjeve

²⁵⁴ *Supra*, shënimi fundor nr. 181, fq. 131.

²⁵⁵ *Supra*, shënimi fundor nr. 251. <http://www.fao.org/docrep/016/i2727e/i2727e.pdf>

²⁵⁶ *Ibid.*

nga anijet, siç janë mbeturinat e tyre, por veçanërisht ndotja pas shpëlarjes së depozitave të çisternave të naftës, që ka përmasa të pallogaritshme.²⁵⁷

Në kushtet e një problematike të tillë shqetësuese, janë miratuar disa marrëveshje ndërkombëtare për të kufizuar nivelet e ndotjes në det dhe për të ruajtur ekosistemet detare. Në 11 mars të vitit 1967 ndodhi një nga katastrofat më të mëdha ekologjike, më e madhja deri në atë kohë, e shkaktuar nga mbytja e anijes-çisternë liberiane *Torrey Canyon* në brigjet britanike, ku u derdhën në det rreth 136 milionë litra naftë.²⁵⁸ Pas saj, përgjatë viteve kanë ndodhur disa katastrofa të rënda ekologjike, deri në katastrofën më të madhe të të gjitha kohërave, atë të Platformës Detare *Deepwater Horizon* të kompanisë së naftës BP, në Gjirin e Meksikës, që vazhdoi nga prilli deri në korrik 2010, ku sipas përlllogaritjeve u derdh në det një sasi naftë e barabartë me 4.9 milionë fuçi.²⁵⁹

Dy vjet pas mbytjes së anijes-çisternë *Torrey Canyon*, u miratua Konventa e Brukselit për Ndërhyrjet në Det të Hapur në Rastet e Dëmeve të Shkaktuara nga Ndotja prej Naftës, e cila hyri në fuqi në vitin 1975. Ajo sanksionon të drejtën e shtetit bregdetar për të marrë masa në det të hapur për të parandaluar, minimizuar ose eliminuar rreziqet që mund të vijnë në bregdetin e tij prej ndotjes nga nafta në rastet e një aksidenti detar, ku përfshihen të gjitha llojet e ndryshme të mjeteve lundruese, por duke përjashtuar luftanijet dhe anijet shtetërore. Këto masa mund të merren pas konsultimeve me shtetin e flamurit të anijes, pronarët e anijes ose të ngarkesës, dhe sipas rrethanave, edhe me ekspertë të pavarur të caktuar për këtë qëllim, për të shmangur përgjegjësinë civile që shteti bregdetar do të mbante në rast shkaktimi të dëmeve prej tij.

Që nga titulli, kuptohet që kjo konventë u jep mundësi shteteve të ndërhyjnë vetëm për të shmangur dëmet që vijnë prej ndotjes nga nafta. Mirëpo mjetet lundruese transportojnë edhe substanca të tjera shumë të rrezikshme, siç janë kimikatet, prandaj lindi nevoja për të përfshirë edhe substanca të tjera, përveç naftës, kështu që në Konferencën e Londrës për Ndotjen e Detit të vitit 1973 u miratua Protokoll i kësaj konvente që përfshinte edhe substanca të tjera. Protokoll i vitit 1973 hyri në fuqi në vitin 1983 dhe është amenduar dy herë, në vitet 1996 dhe 2002, për të zgjeruar listën e substancave të përfshira në të.²⁶⁰ Dy vjet pas konventës së parë u miratua Konventa e Brukselit për Krijimin e një Fondi Ndërkombëtar për Kompensimin e Dëmeve të Shkaktuara nga Ndotja prej Naftës, e vitit 1971, që plotësonte boshllëqet ligjore mbi çështjet e përgjegjësisë civile. Më pas u miratuan protokolle shtesë në vitet 1976 dhe 1984, por që të gjitha këto marrëveshje u zëvendësuan nga një protokoll i tretë në vitin 1992.

I gjithë ky regjim i përgjegjësisë civile për ndotjet nga nafta funksionon nën ombrellën e Organizatës Ndërkombëtare Detare (IMO), dhe të gjithë dokumentet përfaqësojnë dy traktate: Konventën e mbi Përgjegjësinë Civile të vitit 1992 dhe Konventën e Fondit të vitit 1992. Konventa e vitit 1971 pushoi së vepruari në 24 maj 2002, kur numri i palëve ra nën 25 shtete.

²⁵⁷ http://www.unep.org/regionalseas/marinelitter/publications/docs/plastic_ocean_report.pdf

²⁵⁸ http://news.bbc.co.uk/local/cornwall/hi/people_and_places/nature/newsid_8753000/8753329.stm

²⁵⁹ Elliott A. Norse and John Amos, "Impacts, Perception, and Policy Implications of the Deepwater Horizon Oil and Gas Disaster", Environmental Law Reporter, Vol. 40, 2010. Gjetet në:

http://mcbi.marine-conservation.org/publications/pub_pdfs/Norse-and-Amos-2010.pdf

²⁶⁰ Konventa dhe materialet shpjeguese gjenden në:

<http://www.imo.org/About/Conventions/ListOfConventions/Pages/International-Convention-Relating-to-Intervention-on-the-High-Seas-in-Cases-of-Oil-Pollution-Casualties.aspx>

Protokolli i vitit 1992 krijoi një skemë të re, Fondin Ndërkombëtar të Kompensimit të Ndotjes (IOPC), i cili menaxhohet prej Sekretariatit që ndodhet në Londër.

Në vitin 1972 u miratuan dy traktate për mbrojtjen e deteve nga ndotja: Konventa e Oslos për Parandalimin e Ndotjes së Deteve prej Hedhjeve nga Anijet dhe Avionët dhe Konventa e Londrës për Parandalimin e Ndotjes së Deteve prej Hedhjeve të Mbeturinave dhe Substancave të Tjera. Ato u pasuan nga Konventa për Tregtinë Ndërkombëtare të Specieve të Rrezikuara të Florës dhe Faunës (CITES) e vitit 1973, e cila përfshin florën dhe faunën detare, dhe nga Konventa e Parisit për Parandalimin e Ndotjes së Deteve që Vjen nga Burimet Tokësore, e vitit 1974.

Për t'u marrë në mënyrë të posaçme me problemet që vinin prej ndotjes nga anijet, IMO miratoi Konventën Ndërkombëtare për Parandalimin e Ndotjes prej Anijeve (MARPOL) e vitit 1973, e cila u plotësua më pas me Protokollin e vitit 1978. Për shkak se teksti fillestar i konventës nuk kishte hyrë ende në fuqi kur u miratua protokollin, tani traktati referohet si Konventa MARPOL 73/78. Aneksat që i bashkëlidhen konventës amendohen vazhdimisht, ku Aneksi VI i është dedikuar jo vetëm mbrojtjes së mjedisit detar, por është titulluar si aneksi për Parandalimin e Ndotjes së Ajrit nga anijet, amendimi i fundit i të cilit u bë në vitin 2012.²⁶¹

Ndërsa ndër konventat me ndikim rajonal, me interes të veçantë për Shqipërinë, është edhe Konventa e Barcelonës për Mbrojtjen e Mjedisit Detar dhe Rajonit Bregdetar të Mesdheut e vitit 1976 (amenduar në vitin 1995), si edhe protokollin e saj shtesë që kanë të bëjnë me mbrojtjen nga ndotja prej burimeve dhe aktiviteteve tokësore, me zonat e veçanta të mbrojtura dhe diversitetin biologjik në Mesdhe, me parandalimin dhe eliminimin e ndotjes prej anijeve dhe avionëve apo prej djegies në det, me mbrojtjen nga ndotja prej eksplorimit dhe shfrytëzimit të shelfit kontinental dhe shtratit të tij e nëntokës, me parandalimin e ndotjes prej transportimit ndëkufitar të mbetjeve të rrezikshme dhe depozitimit të tyre, me bashkëpunimin për parandalimin e ndotjes prej anijeve dhe në raste emergjencash, për mbrojtjen e Mesdheut nga ndotja dhe për menaxhimin e integruar të zonave bregdetare.

Traktati më i rëndësishëm në lidhje me hapësirat detare, e quajtur 'Kushtetuta e Detit',²⁶² është Konventa e OKB për të Drejtën e Detit (UNCLOS) e vitit 1982,²⁶³ diskutimi i dispozitave të së cilës zgjati plot 9 vjet, në Montego Bay të Xhamajkës. Nga totali prej 320 nenesh, krahas dispozitave që përcaktojnë ndarjen dhe regjimet juridike të hapësirave detare, një pjesë e mirë e tyre i dedikohen ruajtjes së mjedisit detar. Neni 61 i konventës parashikon detyrimin e shtetit bregdetar që duke marrë parasysh të dhënat shkencore, duhet të sigurojë nëpërmjet masave të marra, menaxhimin dhe ruajtjen e burimeve të gjalla në zonën e tij ekonomike ekskluzive, që të mos rrezikohen nga mbishfrytëzimi.

²⁶¹ Për zhvillimet historike të MARPOL 73/78 shih:

<http://www.imo.org/KnowledgeCentre/ReferencesAndArchives/HistoryofMARPOL/Documents/MARPOL%2073-78%20Brief%20History%20-%20List%20of%20amendments%20and%20how%20to%20find%20them.htm>

²⁶² David Freestone dhe Salman M.A Salman, "Ocean and Freshwater Resources", në Daniel Bodansky, Jutta Brunnée and Ellen Hey, "The Oxford Handbook of International Environmental Law", (red.) Oxford University Press, 2007.fq. 340.

²⁶³ Konventa e OKB për të Drejtën e Detit Detit (Montego Bay) gjendet në:

http://www.un.org/depts/los/convention_agreements/texts/unclos/unclos_e.pdf

Pjesa XII e konventës i dedikohet mbrojtjes së mjedisit detar. Dispozitat e kësaj pjese njohin të drejtën sovrane të shteteve që të shfrytëzojnë burimet natyrore sipas politikave të tyre mjedisore, por edhe i ngarkojnë shtetet me detyrimin që të mbrojnë dhe ruajnë mjedisin detar, të vrojtojnë, të masin, vlerësojnë dhe analizojnë me metoda të njohura shkencore rreziqet ose efektet e ndotjes së mjedisit detar dhe të bashkëpunojnë me organizatat ndërkombëtare kompetente duke publikuar raporte me të dhëna në intervale të caktuara, të cilat duhet t'u bëhen të ditura të gjitha shteteve. Në marrjen e masave për parandalimin, reduktimin dhe kontrollin e ndotjes së mjedisit detar, shtetet do të veprojnë në mënyrë të tillë që të mos i zhvendosin dëmet apo rreziqet nga një zonë në tjetrën ose të zëvendësojnë një lloj ndotjeje me një tjetër.

Kur shtetet kanë arsye të besojnë që veprimtaritë e planifikuara për t'u kryer prej tyre mund të shkaktojnë ndotje të rëndë, transformime të mëdha e të rrezikshme të mjedisit detar, ato duhet të vlerësojnë ndikimin e mundshëm në mjedis dhe të komunikojnë rezultatet e vlerësimeve të tilla. Ato duhet gjithashtu të miratojnë ligje dhe rregulla për parandalimin, reduktimin dhe kontrollin e ndotjes së mjedisit detar që vjen nga toka, duke përfshirë lumenjtë, deltat, tubacionet dhe strukturat e ndryshme, duke marrë në konsideratë rregullat, standardet dhe procedurat e praktikave të mira ndërkombëtare.

Konventa u referohet edhe traktateve MARPOL, kur sanksionon në nenin 211 se shtetet duhet të miratojnë ligje dhe rregullore për parandalimin, reduktimin, dhe kontrollin e ndotjeve të mjedisit detar prej anijeve që mbajnë flamurin e tyre. Ligjet dhe rregulloret duhet që së paku të kenë të njëjtin efekt si rregullat dhe standardet ndërkombëtare të hartuara nga organizatat ndërkombëtare kompetente. Përveç kësaj, shtetet duhet të miratojnë ligje dhe rregullore për parandalimin, reduktimin dhe kontrollin e ndotjeve të mjedisit detar nga ajri, të zbatueshme në hapësirën ajrore nën sovranitetin e tyre, duke mbajtur parasysh rregullat dhe standardet ndërkombëtare. Ato autorizohen të përdorin edhe forcën për zbatimin e këtyre ligjeve dhe rregullave sipas normave të së drejtës ndërkombëtare. Po ashtu, konventa parashikon edhe ushtrimin e forcës nga shtetet ndaj anijeve të huaja që gjenden të ankoruara në portet e tyre, ushtrimin e forcës nga ana e shteteve bregdetare, marrjen e masave për shmangien e ndotjes prej një avarie detare, si edhe respektimin e parimit të mosdiskriminimit midis anijeve të huaja dhe atyre që mbajnë flamurin e vet.²⁶⁴

Pas UNCLOS, në 22 shtator 1992 u miratua edhe Konventa OSPAR (Konventa për Mbrojtjen e Mjedisit Detar të Atlantikut Verilindor), së bashku me një Deklaratë Përfundimtare dhe një Plan Veprimi, që hyri në fuqi në 25 mars 1998. Kjo konventë zëvendësoi konventat e mëparshme të Oslos dhe Parisit, ku të gjitha palët (Belgjika, Danimarka, BE, Finlanda, Franca, Gjermania, Islanda, Irlanda, Holanda, Norvegjia, Portugalia, Spanja, Suedia dhe Mbretëria e Bashkuar) së bashku me Luksemburgun dhe Zvicrën, janë bërë palë edhe në Konventën OSPAR. Edhe kjo konventë shoqërohet nga disa anekse që kanë të bëjnë me parandalimin dhe eliminimin e ndotjes prej tokës, prej hedhjes apo djegies, prej platformave detare, si edhe me vlerësimin e cilësisë së mjedisit detar.²⁶⁵

Ndërsa për mbrojtjen e peshkut, që në vitin 1958 u hartua Konventa e Gjenevës për Peshkimin dhe Ruajtjen e Gjallesave në Det të Hapur, e cila është pasuar nga Marrëveshja e vitit 1995 për

²⁶⁴ Konventa e OKB për të Drejtën e Detit Detit, nenet 192-237

²⁶⁵ Konventa dhe materialet shpjeguese gjenden në:

http://www.ospar.org/content/content.asp?menu=0148120000000_000000_000000

Peshqit Migratorë në Distanca të Largëta. Pas hyrjes në fuqi të Marrëveshjes së OKB për Sasinë e Peshkut në vitin 2001, është duke u diskutuar një propozim për arritjen e një marrëveshjeje tjetër në kuadrin e UNCLOS, për ruajtjen dhe shfrytëzimin e qëndrueshëm të sasisë së peshkut dhe biodiversitetit detar përtej zonave të juridiksionit kombëtar. Po ashtu, janë në diskutim disa iniciativa të tjera në kuadër të bashkëpunimit midis OKB, qeverive të ndryshme dhe OJF mjedisore, për menaxhimin dhe ruajtjen e mjedisit detar.²⁶⁶

4.2 Legjislacioni evropian për mbrojtjen e ujit.

Për shkak të rëndësisë së jashtëzakonshme, mbrojtjes së ujit i është kushtuar një pjesë e posaçme e *acquis communautaire*. Që në vitin 1979 u miratua Direktiva e Këshillit 80/68s/EEC, për mbrojtjen e ujërave sipërfaqësore nga ndotja prej substancave të rrezikshme, ndërsa në vitet 1992 dhe 1995 Këshilli shtroi nevojën e një programi veprimi për këtë qëllim. Më tej, në vitin 1996 Komisioni i paraqiti një propozim Parlamentit dhe Këshillit për mbrojtjen dhe administrimin e integruar të ujërave sipërfaqësore.

Një ndër aktet ligjorë më të rëndësishëm të BE për mbrojtjen dhe administrimin e ujërave është Direktiva 2000/60/EC e Parlamentit Evropian dhe Këshillit, për “Krijimin e një Kuadri Veprimi të Komunitetit në Fushën e Politikës së Ujit”, e quajtur ndryshe si Direktiva Kuadër për Ujin.²⁶⁷ Kjo direktivë ka marrë këtë emërtim për shkak se krijoi një kuadër të përgjithshëm për mbrojtjen e ujit, duke mos u kufizuar vetëm në parashikimin e masave për parandalimin e ndotjes së burimeve të ujërave apo rrjedhave të tyre, por shkoi më tej, duke hedhur bazat për një administrim të integruar të krejt baseneve ujëmbledhës, me qëllim arritjen e objektivave ekologjikë.

Mbrojtja e baseneve ujëmbledhës në BE ka një rëndësi të veçantë, pasi në shtetet anëtare basenet ujëmbledhës të lumenjve, përfshirë edhe deltat e tyre pranë brigjeve të deteve, ndodhen në 110 zona të tilla, 40 prej të cilave janë të një karakteri ndërkombëtar, duke mbuluar kështu rreth 60% të territorit të BE. Këtu futen rajonet e Danubit, Balltikut, Mesdheut, Detit të Zi, etj.

Shtetet anëtare të BE kanë detyrimin të hartojnë Planet e Administrimit të Baseneve Ujëmbledhës, pjesë thelbësore e realizimit të objektivave mjedisore, që përfshijnë menaxhimin afatgjatë të ujërave, marrjen e masave për parandalimin dhe përballimin e përmytjeve, përballimin e thatësirave, trajtimin e ujërave urbane, sigurimin e cilësisë së lartë të ujërave të plazheve, të zonave të shumëzimit të peshkut, mbrojtjen e florës dhe faunës së detit, etj.²⁶⁸

Direktiva Kuadër i referohet nenit 174 të Traktatit, mbi politikën e Komunitetit për mjedisin, që kanë për qëllim arritjen e objektivave për ruajtjen, mbrojtjen dhe përmirësimin e cilësisë së mjedisit, si edhe përdorimin me efikasitet dhe në mënyrë racionale të burimeve natyrore, bazuar në parimet e parandalimit dhe të marrjes së masave paraprake, të ndreqjes së dëmit në vend dhe

²⁶⁶ http://www.un.org/en/sustainablefuture/pdf/Rio+20_FS_Oceans.pdf

²⁶⁷ Direktiva Kuadër për Ujin, botuar në Fletoren Zyrtare të BE OJ L 327, datë 22.12. 2000. Gjetendet në: http://eur-lex.europa.eu/resource.html?uri=cellar:5c835afb-2ec6-4577-bdf8-756d3d694eeb.0004.02/DOC_1&format=PDF

²⁶⁸ <http://ec.europa.eu/environment/pubs/pdf/factsheets/water-framework-directive.pdf>

parimin ndotësi paguan.²⁶⁹ Po kështu, informimi dhe pjesëmarrja e publikut të gjerë në çështjet që lidhen me përdorimin, planet dhe raportimin për ecurinë e tyre për administrimin e ujërave, janë të domosdoshme për të siguruar ndërgjegjësimin e publikut për rëndësinë e përdorimit të burimeve ujore, mbrojtjen dhe përdorimin e tyre me efikasitet.

Ajo i referohet gjithashtu edhe Konventës së UNECE (Helsinki) për Mbrojtjen dhe Përdorimin e Rrjedhave Ujore Ndërkufitare dhe Liqeneve Ndërkombëtare, e cila është vënë në zbatim nëpërmjet Vendimit të Këshillit 95/308/EC dhe marrëveshjeve të tjera të mëpasme. Ajo thekson në paragrafin 35 të preambulës, se në çdo basen ujëmbledhës lumor që mund të ketë efekte ndërkufitare, plotësimi i të gjitha kërkesave të direktivës për arritjen e objektivave mjedisore, veçanërisht planet e masave, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të jenë të koordinuara për të gjithë basenin ujëmbledhës lumor, duke përfshirë burimin, rrjedhën, degëzimet, deltën, etj. Për ato basene që shtrihen përtej kufijve të Komunitetit, shtetet anëtare duhet të koordinojnë veprimtarinë e tyre me atë të shteteve jo-anëtare. Në këtë kuadër është hartuar edhe marrëveshja e vitit 2003 midis Shqipërisë dhe Greqisë për Krijimin e Komisionit të Përhershëm Shqiptaro-Grek për Ujërat e Ëmbla Ndërkufitare.

Direktiva i kushton rëndësi edhe përdorimit të instrumenteve ekonomike për përballimin e shpenzimeve të kryera për shërbimet që lidhen me ujin, përfshirë kostot mjedisore dhe ato të lidhura me dëmtimet apo ndikimet negative në mjedisin ujor, duke mbajtur gjithmonë parasysh parimin 'ndotësi paguan'. Për këtë qëllim është i domosdoshëm edhe planifikimi i masave që duhen marrë, duke u bazuar në parashikimet afatgjata në lidhje me kërkesën dhe ofertën për ujë në zonën e basenit ujëmbledhës.²⁷⁰

Pas Direktivës Kuadër është miratuar edhe legjislacioni i veçantë sektorial nga ana e Parlamentit Evropian dhe Këshillit, siç janë Direktiva 2006/118/EC,²⁷¹ për Ujërat Sipërfaqësore, e nxjerrë në zbatim të nenit 17 të saj, për mbrojtjen ujërave sipërfaqësore nga ndotja prej kimikateve, si edhe Direktiva 2008/105/EC,²⁷² për Standardet e Cilësisë Mjedisore (SCM) në Fushën e Politikave për Ujërat, e cila amendoi vetë Direktivën Kuadër dhe shfuqizoi direktivat 82/176/EEC, 83/513/EEC, 84/156/EEC, 84/491/EEC, 86/280/EEC.

Për shkak të ndryshimeve klimatike, numri i katastrofave natyrore, përfshirë përmbytjet masive të shkaktuara nga dalja e lumenjve prej shtratit, janë shtuar së tepërmi në vitet e fundit, fatkeqësisht të shoqëruara me numër të lartë viktimash. Me qëllim marrjen e masave të duhura për të parandaluar dhe për t'u përballur me pasojat e përmbytjeve është miratuar Direktiva 2007/60/EC²⁷³ e Parlamentit Evropian dhe Këshillit për vlerësimin dhe menaxhimin e rreziqeve nga përmbytjet. Ajo kërkon nga shtetet anëtare që të kryejnë studime e vlerësime për parashikueshmërinë e përmbytjeve të mundshme prej lumenjve si edhe krijimin e hartave të posaçme të zonave me rrezikshmëri të lartë. Pas tyre, shtetet duhet të hartojnë dhe të kenë gati për zbatim plane menaxhimi të përmbytjeve për çdo basen ujëmbledhës, përfshirë hartimin e planeve të përbashkëta ndërshtetërore, në rastet kur lumenjtë kanë karakter ndërkufitar.

²⁶⁹ Direktiva Kuadër, Preambula, parag. 11.

²⁷⁰ *Ibid.*, parag. 38.

²⁷¹ Gjendet në: <http://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=OJ:L:2006:372:0019:0031:EN:PDF>

²⁷² Gjendet në: <http://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:32008L0105&from=EN>

²⁷³ Gjendet në: <http://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:32007L0060&from=EN>

Mbrojtjes së mjedisit detar i është kushtuar Direktiva 2008/56/EC²⁷⁴ e Parlamentit Evropian dhe Këshillit, e cila krijoi kuadrin e veprimit komunitar në fushën e politikës mjedisore detare, e quajtur ndryshe Direktiva Kuadër e Strategjisë Detare. Bazuar në dispozitat e saj, shtetet anëtare duhet të hartojnë plane për mbrojtjen dhe ruajtjen e mjedisit detar, në zonat detare ku ushtrojnë juridiksionet respektive, si edhe të ndjekin në vijimësi zbatimin e tyre.

4.3 Legjislacioni shqiptar për mbrojtjen e ujit.

Shqipëria është ndër vendet më të pasura në Evropë me ujëra, duke u renditur ndër vendet e para për frymë popullsie. Rrjeti i saj hidrografik përbëhet nga lumenj, ujëra nëntokësore, përrenj, laguna, liqene natyrore, liqene artificiale dhe dete. Për kushtet gjeografike në të cilat ndodhet Shqipëria, respektimi i normave për përdorimin dhe menaxhimin e rrjedhave ujore ndërkombëtare është jetik, pasi rreth 33% e pellgut hidrografik ndodhet jashtë territorit shtetëror shqiptar, një gjë e rrallë në botë për ujërat kufitare ndërkombëtare. Prandaj edhe është e kuptueshme ndjeshmëria e lartë që u shfaq në marrëdhëniet shqiptaro-maqedonase kur u diskutua para disa kohësh projekti maqedonas për devijimin e lumit Radika.

Burimi kryesor i furnizimit me ujë të pijshëm në Shqipëri janë ujërat nëntokësore. Përdorimi i ujit për nevoja industriale ka rënë për shkak të mbylljes së një pjese të industrisë së rëndë. Ashtu siç ndodh me energjinë elektrike, humbjet e ujit në rrjetin shpërndarës janë të larta, për shkak të amortizimit të rrjetit dhe të ndërhyrjeve të paligjshme në të, qoftë nga pronarët e ndërtimeve pa leje, qoftë për veprimtari ekonomike informale, siç është rasti i lavazheve të makinave. Kjo është një nga arsyet e ndotjes së ujërave nëntokësore, së cilës i shtohen edhe ndotjet nga veprimtaritë industriale e bujqësore dhe nga shkarkimet e ujërave të zeza. Ujërat sipërfaqësore pranë zonave urbane karakterizohen nga ndotje prej lëndëve organike, me prejardhje kryesisht nga shkarkimet e ujërave të zeza të patrajtuara. Kjo bëhet shkak që edhe sëmundjet virale dhe epidemitë e shkaktuara nga ujërat e ndotura të jenë në shkallë të lartë. Ndotja më e madhe e ujërave të lumenjve ndodh kur ata kalojnë pranë zonave të banuara, zonave industriale, zonave të nxjerrjes e të përpunimit të naftës, të cilat janë të ndotura me përbërje organike. Edhe ujërat bregdetare janë të ndotura në afërsi të zonave ku kryhen shkarkimet urbane, zona në të cilat ndotja i kalon normat e lejuara të ndotjes bakteriologjike.

Përveç detyrimeve që ka marrë në kuadër të zbatimit të MSA, siç u përmend edhe në fillim të këtij punimi, Shqipëria është bërë palë në Konventën e UNECE “Për mbrojtjen dhe përdorimin e rrjedhave ujore ndërkufitare dhe të liqeneve ndërkombëtare”, si dhe në Protokollin shoqëruar “Për ujin dhe shëndetin”. Ajo ka ratifikuar Konventën ‘Për mbrojtjen e detit Mesdhe nga ndotja dhe ruajtjen e biodiversitetit’, si dhe protokollin shoqëruar.

Në kuadër të bashkëpunimit ndërkufitar me vendet fqinje, për mbrojtjen e ujërave Shqipëria ka nënshkruar në vitin 2003 me Greqinë Marrëveshjen për Krijimin e Komisionit të Përhershëm Shqiptaro-Grek për Ujërat e Ëmbla Ndërkufitare, Marrëveshjen për Mbrojtjen dhe Zhvillimin e Qëndrueshëm të Liqenit të Ohrit dhe të Basenit të tij Ujëmbledhës me Maqedoninë, në vitin

²⁷⁴ Gjendet në: <http://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:32008L0056&from=EN>

2004, si edhe Memorandumin e Mirëkuptimit me Malin e Zi për Administrimin e Ujërave të Liqenit të Shkodrës dhe Lumit të Bunës, në vitin 2010. Në bazë të këtyre detyrimeve, Shqipëria duhet të përcaktojë dhe të zbatojë objektiva të qartë dhe të matshëm për pakësimin e mëtejshëm të shkarkimeve ndotëse në ujërat ndërkufitare e në zonën bregdetare, si edhe duhet të hartojë plane të menaxhimit të aksidenteve për shmangien e ndotjes së detit.

Transpozimi i Direktivës Kuadër të Ujit të BE në legjislacionin shqiptar është realizuar me miratimin e ligjit nr. 111/2012, datë 15.11.2012, “Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore”, i cili ka përcaktuar edhe strukturën institucionale për administrimin dhe menaxhimin e burimeve ujore, ku përfshihen Këshilli i Ministrave, ministria përgjegjëse për administrimin e burimeve ujore, Këshilli Kombëtar i Ujit dhe Sekretariati i tij Teknik, ndërsa në nivel vendor, për menaxhimin e integruar të burimeve ujore ngrihen këshillat e baseneve ujore dhe agjencitë e baseneve ujore. Sekretariati Teknik i Këshillit Kombëtar të Ujit drejton punën e institucioneve të specializuara në fushën e ujërave për hartimin e Strategjisë Kombëtare të Menaxhimit të Burimeve Ujore, me afat 15 vjeçar, si edhe dhe të planeve dhe dokumenteve të tjera strategjike, me afat 6 vjeçar.

Këshilli Kombëtar i Ujit është organi qendror vendimmarrës, ndërministror, që kryesohet nga Kryeministri dhe trajton çështjet e administrimit dhe menaxhimit të integruar të burimeve ujore. Ai miraton planet dhe projektet ndërrajonale dhe kombëtare në fushat që lidhen me ruajtjen dhe administrimin e ujërave, si edhe kujdeset për zbatimin traktateve ndërkombëtare për burimet ujore, në të cilat vendi ynë është palë. Në rastet e marrëveshjeve koncesionare të cilat kanë si objekt burimet ujore me rëndësi kombëtare, ato hyjnë në fuqi pas ratifikimit nga Kuvendi. Nenet 18-22 të ligjit i janë kushtuar bashkëpunimit ndërkombëtar për mbrojtjen e ujërave ndërkufitare në gjendjen e tyre natyrore, për parandalimin e ndotjes së burimeve ujore, për garantimin e kushteve të përshtatshme për zhvillimin e jetës dhe ekosistemeve në to, duke nxitur zhvillimin e veprimtarive të dobishme, në përputhje me kërkesat e parimit të zhvillimit të qëndrueshëm. Në ta përcaktohet se ujërat ndërkufitare mund të përdoren vetëm në mënyrë të kontrolluar, brenda kufijve shkencorë, pa dëmtuar kushtet natyrore dhe balancat biologjike dhe ekologjike të tyre. Për të siguruar mbrojtjen e burimeve ujore, subjektet që u njihet e drejta e shfrytëzimit të tyre duhet të pajisen me leje mjedisore, pas shqyrtimit të raportit të thelluar të ndikimit në mjedisin ujor. Ministria përgjegjëse ngarkohet me kontrollin e vazhdueshëm për të siguruar ruajtjen e gjendjes natyrore të faunës dhe florës së ujërave ndërkufitare. Ligji parashikon edhe krijimin e komisioneve të posaçëm për administrimin e ujërave ndërkufitare, siç u përmend edhe më sipër. Një nga risitë që ka sjellë ky ligj është edhe ndarja e ujërave në zona të ndryshme mbrojtjeje, duke përcaktuar si të tilla zonat higjieno-sanitare për mbrojtjen e burimeve ujore, zonat për peshkim dhe rritjen e butakëve, zonat e prirura ndaj eutrofikimit dhe zonat në rrezik nga nitratet e nitritet, zonat e synuara për mbrojtjen e bimëve apo kafshëve, si dhe të habitateve, zonat e prirura ndaj ndotjes, zonat e mbrojtjes emergjente, zonat e veçanta të ruajtjes, zonat e rrezikshme për shëndetin, etj. Të gjitha këto zona, duhet të jenë të identifikuar në Kadastrën Kombëtare të Burimeve Ujore, e cila administrohet nga ministria përgjegjëse. E drejta për të marrë dhe për të përdorur informacionin për burimet ujore u njihet shprehimisht çdo personi fizik dhe juridik, në lidhje me dokumentet bazë dhe të dhënat e përdorura për hartimin e planeve të menaxhimit të baseneve, dhe këtyre personave u krijohet mundësia për të marrë pjesë në procesin e konsultimit dhe komentimit të planeve të menaxhimit të baseneve ujore.

Krahas kadastrës, i rëndësishëm është edhe hartimi i Regjistrit Kombëtar të Shfrytëzuesve të Burimeve Ujore, që përbën një bazë të dhënash të grumbulluar nga agjencitë zbatuese në terren, e cila evidenton të gjitha lejet e shfrytëzimit të burimeve ujore.

Një strukturë tjetër e krijuar që prej vitit 1998, është edhe Enti Rregullator i Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura, i cili funksionon si një institucion publik i pavaruar dhe që i raporton Këshillit të Ministrave dhe Kuvendit të Shqipërisë.

Ndër reformat e kryera nga qeveria e re shqiptare, në muajin janar 2014 u krijua Inspektorati Shtetëror i Mjedisit, Pyjeve dhe Ujërave (ISHMPU), nën varësinë e Ministrisë së Mjedisit, që siç parashikohet në Planin Kombëtar të Integritimit Evropian 2014-2020, do të garantojë zbatimin dhe imponimin e ligjit në fushën e mjedisit, pyjeve dhe *ujërave* [theksimi im]. Mbeten disi të paqarta arsyet se pse kontrolli i administrimit të ujërave, i cili duhet t'i përkiste Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe *Administrimit të Ujërave* [theksimi im], i ka kaluar një inspektorati shtetëror nën varësinë e Ministrisë së Mjedisit.

Gjithësesi, përveç ligjit, janë miratuar edhe një sërë aktesh nënligjore për menaxhimin e burimeve ujore. Ndër to, përmendet VKM nr. 177, datë 31.5.2005, “Për normat e lejuara të shkarkimeve të lëngëta dhe kriteret e zonimit të mjediseve ujore pritëse”, i cili plotëson kërkesat e Direktivës Kuadër të Ujit të BE dhe ngarkon Këshillat e Baseneve Ujëmbledhës dhe Agjencitë Rajonale të Mjedisit që çdo dy vjet të përgatisin dhe publikojnë programet për parandalimin dhe eliminimin e ndotjes së mjediseve ujore pritëse, nga shkarkimet e lëngëta. Këto programe duhet të përfshijnë identifikimin e shkarkimeve të lëngëta dhe të mjediseve ujore pritëse që ndoten, të masave dhe teknikave më të mira të mundshme për zvogëlimin e ndotjes, të bëjnë propozimet për zëvendësimin ose riciklimin e substancave të rrezikshme nga veprimtaritë industriale, etj. Çdo dy vjet, Këshillat e Baseneve Ujëmbledhës publikojnë raportet për gjendjen e ujërave të baseneve nën juridiksionin e tyre, lidhur me shkarkimet e lëngëta dhe largimin e llumrave nga impiantet e trajtimit të ujërave të ndotura.

Një tjetër akt i rëndësishëm nënligjor që nuk ka të bëjë vetëm me ujërat, është VKM nr.1189, datë 18.11.2009, “Për rregullat dhe procedurat për hartimin dhe zbatimin e programit kombëtar të monitorimit të mjedisit”, ku në lidhje me ujërat, parashikohet monitorimi i i treguesve që kanë të bëjnë me alkalinitetin, aciditetin, përmbajtjen e nitrateve, azotit e fosforit në ujërat sipërfaqësore e nëntokësore.

Pas tij u miratua edhe VKM nr.797, datë 29.9.2010, “Për miratimin e rregullores higjieno-sanitare për administrimin e cilësisë së ujërave të larjes”, përsëri në zbatim të Direktivës Kuadër për Ujin, që përcakton kriteret shëndetësore që duhet të plotësojnë ujërat e larjes për të siguruar cilësinë e tyre, me qëllim mbrojtjen e shëndetit publik nga efektet negative të ndotjes, i cili u plotësua kohët e fundit prej VKM nr. 246, datë 30.4.2014, “Për përcaktimin e normave të cilësisë së mjedisit për ujërat sipërfaqësore” dhe VKM nr. 321, datë 28.5.2014, “Për sigurinë në det, plazhe, në ujërat e brendshme në thellësi të territorit dhe gjatë ushtrimit të sporteve ujore”.

Ndërsa në kuadër të sanksioneve për mbrojtjen e ujërave nga ndotja, neni 203 i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë parashikon se ndotja e ujërave të deteve, lumenjve, liqeneve apo burimeve të rrjetit grumbullues e shpërndarës të ujërave me lëndë toksike, radioaktive apo

substancia të tjera, që prishin ekuilibrin ekologjik, dënohet me burgim nga një deri në pesë vjet. Po kjo vepër, kur ka shkaktuar pasoja të rënda për jetën e shëndetin e njerëzve, dënohet me burgim nga pesë deri në dhjetë vjet.

Për sa i përket përafrimit me legjislacionin komunitar, Shqipërisë i duhet të ndërmarrë hapa seriozë në këtë drejtim, sepse administrimi i ujërave është një nga fushat që ka rregullimin më të gjerë. Politika e re evropiane e ujërave dhe Direktiva Kuadër e Ujit, janë të bazuara në qasjen e kombinuar, parimin e marrjes së masave paraprake, parimin e parandalimit, parimin sipas të cilit dëmet mjedisore duhen riparuar në burim, si edhe në parimin e mbajtjes parasysh të kushteve mjedisore specifike të rajoneve të ndryshme. Në Shqipëri, kapacitetet për menaxhimin e ujërave janë ende të kufizuara, dhe ngritja e tyre është një domosdoshmëri. Një mangësi jo e vogël është mungesa e një strategjie për administrimin e burimeve ujore, e cila duhet hartuar sa më parë.

Përpjekje serioze duhen bërë për zbatimin e legjislacionit të BE për ujërat, ku një rol të rëndësishëm luajnë organet e pushtetit vendor, të cilat në vetvete janë në proces transformimi e ristrukturimi. Me to duhet punuar, sidomos për ushtrimin e kontrolleve për mbrojtjen e ujërave nga ndotja dhe për hartimin e programeve të trainimit për mënyrat e inspektimit dhe kontrollit të cilësisë së ujërave. Transferimi i dijeve, ekspertizës dhe mbështetja për njohjen e legjislacionit evropian duhet të aplikohet në të gjitha nivelet.

KREU V

MBROJTJA E BIODIVERSITETIT

Udhëzuesi i Konventës për Biodiversitetin e përkufizon diversitetin biologjik si “...ndryshueshmëria e jetës në të gjitha format, nivelet, dhe kombinimet. Nuk është shuma e të gjithë ekosistemeve, specieve dhe materialeve gjenetike, por përfaqëson ndryshueshmërinë brenda dhe midis tyre. Pra, është një atribut i jetës, në kontrast me “burimet biologjike”, të cilat janë komponentët e prekshëm biotikë të ekosistemeve.”²⁷⁵

Siç shihet, shumëllojshmëria e specieve është vetëm njëri aspekt i biodiversitetit. Planeti sot gjendet në kushtet kur shumë prej specieve kërcënohen nga shfarosja një herë e përgjithmonë. Shkatërrimi i habitateve, mbishfrytëzimi, ndotja dhe futja e organizmave të huaj, po eliminojnë speciet me një ritëm të krahasueshëm me shkatërrimin e madh katastrofik, që shënoi fundin e epokës së dinosaurëve. Speciet biologjike të botës janë pasuri e madhe, por veprimtaritë njerëzore kanë shkaktuar zhdukjen e tyre me një ritëm të përshpejtuar. Gjatë shekullit të kaluar, më shumë se 800 specie janë zhdukur dhe të paktën 10,000 specie tashmë konsiderohen të kërcënuara. Këtu përfshihen rreth gjysma e primatëve dhe peshqit e ujërave të ëmbla, së bashku me rreth 10% të të gjitha specieve bimore. Nëse tendenca të tilla do të vazhdojnë, një pjesë e mirë e këtyre specieve që ekzistojnë sot, mund të zhduken brenda pak dekadave të ardhshme. Prej të gjithë specieve, 4574 kanë arritur pikën kritike, para zhdukjes përfundimtare.²⁷⁶ Nga zhdukja kërcënohen 1 në 8 zogj, 1 në 4 gjitarë, 1 në 4 koniferë, 1 në 3 amfibë, 6 në 7 breshka uji, ndërsa ka humbur 75% e diversitetit të kulturave bujqësore dhe siç u theksua në kapitullin e mëparshëm, 75% e sasisë totale të llojeve të peshkut është e mbishfrytëzuar. Vlerësimi i Ekosistemeve të Mijëvjeçarit i vitit 2005, arriti në konkluzionin që ndryshimet në biodiversitet për shkak të veprimtarisë njerëzore kanë qenë më të shpejta në 50 vitet e fundit, sesa në të gjithë historinë e njerëzimit, duke rritur rrezikun e ndryshimeve të menjëhershme dhe të pakthyeshme në ekosistemet.²⁷⁷

Nëse ritmet e ngrohjes globale nuk ndryshojnë dhe temperatura mesatare globale rritet me më tepër se 3.5°C, 70% e specieve do të zhduken. Biodiversiteti luan një rol të pazëvendësueshëm për zbutjen e efekteve të ngrohjes globale. Ekosistemet përthithin dhe depozitojnë brenda tyre karbonin nëpërmjet proceseve biologjike dhe biofizike që mbështeten në biodiversitet. Rreth 2,500 miliardë ton karbon depozitohen në ekosistemet tokësore, rreth 750 miliardë ton në atmosferë, rreth 38 trilionë ton në oqeanë (prej të cilave 37 trilionë ton janë të depozituara në fundin e tyre dhe çlirohen në atmosferë tepër ngadalë përgjatë viteve), si edhe rreth 1,15 trilionë ton janë të depozituara në pyje (prej të cilave 30-40% në biomasë dhe rreth 60-70% në tokën e pyllit). Pyjet kanë rëndësi të veçantë në depozitim dhe pothuajse gjysmës së sasisë të karbonit

²⁷⁵ Lyle Glowka, Françoise Burhenne-Guilmin, Hugh Synge, Jeffrey A. McNeely and Lothar Gündling, “A guide to the Convention on Biological Diversity”, International Union for the Conservation of Nature, 1994. Gjendet në: <https://portals.iucn.org/library/efiles/documents/EPLP-no.030.pdf>

²⁷⁶ Lista e specieve që kërcënohen nga zhdukja gjendet në: <http://www.iucnredlist.org/>

²⁷⁷ <http://www.unep.org/maweb/documents/document.354.aspx.pdf>

tokësor dhe përthithjen e karbonit prej atmosferës, duke luajtur një rol parësor në zbutjen e efekteve të ndryshimeve klimatike.²⁷⁸

Sot, të paktën gjysma e sipërfaqeve me pyje që ekzistojnë para zhvillimit masiv të bujqësisë janë shpyllëzuar, e megjithatë nuk ka ende një traktat ndërkombëtar për mbrojtjen e pyjeve. Pyjet zënë 6% të sipërfaqes së Tokës, por mbajnë mbi gjysmën e specieve të botës. Problem i rëndësishëm sot mbetet shfarosja e pyjeve tropikalë. Sipas të dhënave satelitore të Administratës Kombëtare të Aeronautikës dhe Hapësirës së SHBA (NASA), në pyjet e Amazonës në Brazil ritmi i shpyllëzimit ka arritur shifrat e rreth 20,000 km² pyll në vit,²⁷⁹ diçka më pak se sipërfaqja totale e Shqipërisë. Vetëm në 5 vite, gjatë periudhës 2000-2005 planeti u zhvesh nga 100 milionë hektarë pyje.²⁸⁰ E gjithë kjo humbje biodiversiteti mund të rrezikojë sistemet ekologjike mbështetëse të jetës, nga të cilët varemi të gjithë ne.

5.1 Legjislacioni ndërkombëtar për mbrojtjen e biodiversitetit.

Një nga masat e para të marra për ruajtjen e biodiversitetit ka qenë vendosja e zonave të caktuara nën mbrojtje të veçantë, duke penguar çdo lloj aktiviteti që mund të çënojë larinë biologjike të ekosistemeve. Parku i parë natyror i shpallur në botë është Parku Yellowstone në SHBA, me një sipërfaqe prej rreth 800.000 hektarësh, i krijuar në vitin 1872.²⁸¹ Këtë shembull e ndoqën edhe shumë shtete të tjera më pas.

Në rrafshin ndërkombëtar, përpjekjet e para për hartimin e traktateve për ruajtjen e biodiversitetit ndeshen në shek. XIX, por që nuk patën ndonjë ndikim të rëndësishëm, për shkak të numrit të kufizuar të specieve që ato mbulonin, shtrirjes së kufizuar gjeografike, ose për shkak të numrit të vogël të shteteve palë.²⁸² Në vitin 1893, vendimi i gjykatës së arbitrazhit në çështjen *Fokat e Detit të Behringut (Behring Fur Seals)*, në mosmarrëveshjen midis SHBA dhe Mbretërisë së Bashkuar mori në shqyrtim pretendimin e SHBA mbi të drejtën e saj të ushtrimit të juridiksionit në Detin Bering dhe marrjen e masave për ruajtjen e fokave.²⁸³ Gjykata e rrëzoi pretendimin amerikan për ushtrim juridiksioni, pasi sipërfaqet e pretenduara ndodheshin jashtë ujërave territoriale të SHBA, por vendosi që ruajtja e fokave në ujërat jashtë deteve territoriale duhej të bëhej sipas rregullave të përkohshme të caktuara prej saj. Më pas, si reagim ndaj gjuetisë pa kriter dhe shfarosjes së dhjetëra mijëra fokave, në Washington u hartua Konventa për Mbrojtjen e Fokave e vitit 1911, midis SHBA, Ruisë, Britanisë së Madhe dhe Japonisë.²⁸⁴ Ndërsa në vitin 1900 ishte hartuar Konventa e Londrës për Mbrojtjen e Florës dhe Faunës në Afrikë, e cila u amendua në vitin 1933.

²⁷⁸ UNEP, “*The Fifth Global Environmental Outlook-5: Environment for the future we want.*”, Progress Press Ltd, Malta, 2012. Fq. 149.

²⁷⁹ http://www.nasa.gov/centers/goddard/news/topstory/2005/amazon_deforest.html

²⁸⁰ *Supra.*, shënimi fundor nr. 278, fq. 134.

²⁸¹ <http://www.nps.gov/yell/index.htm>

²⁸² *Supra.*, shënimi fundor nr. 25, fq. 177.

²⁸³ Vendimi i gjykatës së arbitrazhit në çështjen *Fokat e Detit të Behringut (Behring Fur Seals)* gjendet në: http://legal.un.org/riaa/cases/vol_XXVIII/263-276.pdf

²⁸⁴ Konventa për Mbrojtjen e Fokave e vitit 1911 gjendet në:

http://pribilof.noaa.gov/documents/THE_FUR_SEAL_TREATY_OF_1911.pdf

Që të ruhet biodiversiteti, duhet të ruhen speciet e ndryshme të florës dhe faunës që e përbëjnë atë. Siç u përmend në kapitullin e mëparshëm, Konventa e Gjenevës për Peshkimin dhe Ruajtjen e Gjallesave në Det të Hapur e vitit 1958, ka pikërisht në fokus ruajtjen e specieve të ndryshme të peshkut.²⁸⁵ Që në preambulën e saj thuhet që zhvillimi i teknikave moderne për shfrytëzimin e gjallesave të detit i ka ekspozuar disa prej tyre ndaj rrezikut të mbishfrytëzimit. Për shkak të natyrës së problemeve që lidhen me ruajtjen e gjallesave të detit të hapur, është e qartë që bëhet e domosdoshme zgjidhja e tyre mbi bazën e bashkëpunimit midis shteteve, nëpërmjet veprimeve të koordinuara.

Konventa u njeh të gjitha shteteve të drejtën e peshkimit në det të hapur, por duke respektuar detyrimet e marra përsipër në kuadrin e traktateve, interesat dhe të drejtat e shteteve bregdetare, si edhe ruajtjen e gjallesave të detit të hapur. Kjo dispozitë reflekton në fakt dallimin që bëhet në doktrinë midis burimeve natyrore që janë ‘pasuri e përbashkët’, siç është deti i hapur (*res communis omnium*), me burimet që duhet të jenë në ‘administrim dhe shfrytëzim të përbashkët’, siç janë basenet ujëmbledhës, në pellgjet e të cilëve shtrihen dy apo më shumë shtete, çka u analizua në kapitullin e mëparshëm. Në lidhje me gjallesat e detit, ky regjim i fundit duhet të zbatohet, për shembull, në rastin e shteteve fqinjë bregdetarë që ndajnë të njëjtin gji detar, që është regjim i ndryshëm nga ai që zbatohet në detin e hapur.

Në konventë jepet edhe kuptimi i konceptit ‘ruajtja e gjallesave të detit të hapur’, ku përfshihen të gjitha masat për arritjen e një niveli të qëndrueshëm të sasisë së këtyre gjallesave të kapura, që të sigurohet një furnizim maksimal me ushqim dhe produkte të tjera të detit, brenda këtij niveli. Programet e ruajtjes duhet të formulohen duke mbajtur parasysh mbi të gjitha sigurimin e ushqimit për njerëzit. Qëndrimi antropocentrist duket i shpehur qartë në këtë formulim të nenit 2 të konventës.

Pas dy konventave të Londrës të viteve 1900 dhe 1933 për Mbrojtjen e Florës dhe Faunës në Afrikë, që i përkisnin periudhës koloniale, një ndër traktatet e parë rajonalë të hartuar për mbrojtjen e biodiversitetit është Konventa Afrikane për Ruajtjen e Natyrës dhe të Burimeve Natyrore, e miratuar në Algjier, në vitin 1968.²⁸⁶ Ajo avancon parimet e sanksionuara në Kartën Afrikane për Mbrojtjen dhe Ruajtjen e Natyrës të vitit 1963 dhe sanksionon rëndësinë e mbrojtjes së burimeve natyrore për shkak të vlerave të tyre ekonomike, ushqyese, shkencore, arsimore, kulturore dhe estetike. Prandaj shtetet palë, anëtare të Organizatës së Unitetit Afrikan të asaj kohe, angazhoheshin të merrnin masat e nevojshme për të siguruar ruajtjen, përdorimin dhe zhvillimin e tokës, ujërave, florës dhe faunës, në përputhje me parimet shkencore dhe interesat më të mira të njerëzve. Neni 3 i konventës bën ndarjen e zonave të mbrojtura në kategori të ndryshme, sipas nivelit të mbrojtjes: “zonë ruajtjeje”, “rezervë strikte natyrore”, “park kombëtar”, “rezervë e veçantë” dhe “rezervë e pjesëshme”. Dispozitat e saj prezantuan një zhvendosje prej qëndrimit të mëparshëm të fokusuar vetëm në shfrytëzimin e natyrës për të përfituar prej saj, drejt pranimit të parimit të përgjegjësisë së përbashkët të shteteve afrikane për mbrojtjen e natyrës në të gjithë kontinentin.

²⁸⁵ <https://treaties.un.org/doc/Publication/UNTS/Volume%20559/v559.pdf>

²⁸⁶ Konventa Afrikane për Ruajtjen e Natyrës dhe të Burimeve Natyrore, e vitit 1968 gjendet në: <http://www.african-court.org/en/images/documents/Sources%20of%20Law/Conservation%20of%20Nature/nature%20eng.pdf>

Dukë qenë që Konventa Afrikane për Ruajtjen e Natyrës dhe të Burimeve Natyrore e vitit 1968 nuk dha rezultatet që priteshin, për shumë arsye, por ndër të tjera edhe sepse nuk parashikonte institucione dhe mekanizma efikas për zbatimin e saj, iu nënshtrua procesit të rishikimit, tashmë në kuadrin e Bashkimit Afrikan, të themeluar në vitin 2001. Në përfundim të procesit u miratua një konventë e re me të njëjtin emërtim, në Maputo të Mozambikut në vitin 2003,²⁸⁷ por që nuk ka hyrë ende në fuqi, pasi nuk ka siguruar 15 ratifikimet e domosdoshme për këtë qëllim. Teksti i ri e ka zhvendosur fokusin nga dënimet dhe sanksionet për shkeljet, drejt parandalimit të dëmeve në mjedis dhe menaxhimit të kujdesshëm të burimeve natyrore. Konventa e re përmban një fushë më të zgjeruar veprimtarie se ajo e vitit 1968, duke përfshirë në burimet natyrore burimet e rinovueshme, së bashku me ato të parinovueshme. Ajo sanksionon parimin e të drejtës së të gjithë njerëzve për një mjedis të kënaqshëm [theximi im], të favorshëm për zhvillimin e tyre, detyrimin e shteteve që individualisht dhe kolektivisht të sigurojnë gëzimin e të drejtës për zhvillim dhe parimin e zhvillimit të qëndrueshëm. Përdorimi i termit ‘i kënaqshëm’ duket shumë evaziv, pasi është vështirë të ketë një standard të përcaktuar referimi, kundrejt të cilit duhet bërë vlerësimi nëse është arritur ky nivel, apo jo.

Konventa parashikon në dispozita të veçanta mbrojtjen e tokës, ujit, vegjetacionit, specieve, biodiversitetit, zonat e ruajtjes, mbrojtjen e mjedisit gjatë konflikteve të armatosura, të drejtat procedurale, të drejtat e komuniteteve indigjene, kërkimin shkencor, si edhe ngritjen e një sekretariati, si një strukturë institucionale. Sipas nenit 21, çdo palë duhet të krijojë një autoritet kombëtar për të siguruar zbatimin e dispozitave të konventës dhe të kenë një mekanizëm funksional për koordinimin e veprimtarisë së autoriteteve kombëtare. Neni 34 i konventës përbën po ashtu një risi në kuptim të së drejtës së traktateve, pasi ai parashikon që midis palëve që ratifikojnë këtë konventë, veprojnë dispozitat e saj, ndërsa për shtetet e tjerë, mbetet në fuqi Konventa e vitit 1968, dispozitë që vlen për kushtet aktuale, pasi akoma nuk ka hyrë në fuqi konventa e re. Ky është një rast i ngjashëm me Protokollin 14*bis* të KEDNJ në kohën që Rusia refuzonte prej vitesh ratifikimin e Protokollit 14, duke pamundësuar hyrjen e tij në fuqi. Por më vonë nuk lindi nevoja e futjes në fuqi të Protokollit 14*bis* pasi Rusia ratifikoi Protokollin 14 në vitin 2010.

Pas Konferencës së Stokholmit, në kuadër të UNESCO u hartua Konventa e Parisit për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore dhe Natyrore të Botës, në 16 nëntor 1972.²⁸⁸ Në përkufizimet e saj, “trashëgimia natyrore” përfshin formacionet e ndryshme fizike e biologjike apo grupe të formacioneve të tilla, me vlera universale nga pikëpamja estetike apo shkencore, formacionet që shërbejnë si habitate për speciet e bimëve dhe kafshëve me vlera universale, të cilat janë të kërcënuara dhe zonat natyrore me vlera universale nga pikëpamja shkencore, e bukurisë natyrore apo vlerat ruajtëse. Shteteve palë u kërkohet që të identifikojnë, mbrojnë, ruajnë, prezantojnë dhe t’ua përcjellin brezave të ardhshëm trashëgiminë kulturore dhe natyrore. Konventa vendosi krijimin e një Komiteti Ndërqeveritar për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore dhe Natyrore me Vlera Universale të Jashtëzakonshme, të quajtur Komiteti i Trashëgimisë Botërore, në kuadër të UNESCO-s, në të cilin duhet të përfaqësohen rajonet dhe kulturat e

²⁸⁷ Konventa Afrikane për Ruajtjen e Natyrës dhe të Burimeve Natyrore gjendet në:

http://www.au.int/en/sites/default/files/AFRICAN_CONVENTION_CONSERVATION_NATURE_NATURAL_RESOURCES.pdf

²⁸⁸ Konventa e Parisit për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore dhe Natyrore të Botës gjendet në:

<http://whc.unesco.org/archive/convention-en.pdf>

ndryshme të botës. Secili prej shteteve duhet të bëjë një inventar dhe të hartojë një listë drejtuar Komitetit të Trashëgimisë Botërore, ku të përfshihen të gjitha veprat e trashëgimisë kulturore dhe natyrore që gjenden në territorin e tij, mbi bazën e të cilëve Komiteti harton Listën e Trashëgimisë Botërore, e cila përditësohet dhe shpallet çdo dy vjet. Në këtë listë, nga Shqipëria janë përfshirë si vepra të kulturës botërore Butrinti, në vitin 1992 dhe qendrat historike të Beratit e Gjirokastrës, në vitin 2005.²⁸⁹ Konventa vendosi edhe krijimin e një sekretariati dhe të një fondi të veçantë për trashëgiminë kulturore dhe natyrore.

Tregtia ndërkombëtare e kafshëve dhe bimëve të egra, që fillon që nga tregtia e drurit e deri të gëzofi dhe prodhimet e lëkurës, kap shifra të jashtëzakonshme në tregun botëror, duke rrezikuar vetë ekzistencën e tyre dhe të habitateve ku jetojnë. Me qëllim mbrojtjen e specieve të florës dhe faunës nga rreziku i zhdukjes, në vitin 1973 u hartua në Washington, Konventa për Tregtinë Ndërkombëtare të Specieve të Rrezikuara të Florës dhe Faunës së Egër (CITES), e cila u amendua në Bon në vitin 1979.²⁹⁰ Sot kjo është shndërruar në një ndër konventat më universale, që numëron 180 palë.

CITES u hartua me synimin për të vendosur tregtinë ndërkombëtare të kafshëve dhe bimëve të egra nën kontroll, duke mbikëqyrur importimin, eksportimin dhe riekportimin e specieve, si edhe nëpërmjet sistemit të licencimit. Konventës i bashkëlidhen edhe tre shtojca, ku shtojca I përmban të gjitha speciet që rrezikojnë të zhduken, që mund të ndikohen nga tregtia. Shtojca II përmban speciet që për momentin nuk rrezikojnë të zhduken, por që mund të bëhen të tilla pavarësisht se tregtia e ekzemplarëve të këtyre specieve rregullohet në mënyrë strikte, si edhe specie të tjera që mund t'i nënshtrohen rregullimit, me qëllim që tregtia e ekzemplarëve të specieve të tilla t'i nënshtrohet një kontrolli efektiv. Ndërsa shtojca III përmban speciet që palët i përcaktojnë si të tilla në legjislacionin e tyre të brendshëm, me qëllim parandalimin ose kufizimin e shfrytëzimit të tyre.

Eksporti apo importi i ekzemplarëve të specieve të përfshira në shtojcat e konventës bëhet vetëm pas dhënies së lejes së eksportit apo importit nga autoritetet kombëtare, leje e cila jepet pas plotësimit të disa kushteve të caktuara nga konventa në nenet 3, 4 dhe 5. Të gjitha palët marrin përsipër detyrimin për caktimin e Institucioneve Administruese dhe Institucioneve Shkencore, të cilat gëzojnë kompetencën për të dhënë leje ose çertifikata në emër të asaj pale. Konventa vendosi edhe krijimin e Sekretariatit, i cili duhet të organizojë takime të rregullta të paktën një herë në dy vjet, dhe takime të jashtëzakonshme në çdo kohë, në rast kërkesë me shkrim prej të paktën 1/3 e palëve. Deri sot mbetet një nga konventat më të rëndësishme për ruajtjen e biodiversitetit.

Një nga arritjet kryesore të Konferencës së Rios të vitit 1992 ishte hapja për nënshkrim e Konventës për Biodiversitetin,²⁹¹ e cila hyri në fuqi në vitin 1993. Është traktati kryesor që merret me çështjet e ruajtjes së biodiversitetit që ka një qasje gjithëpërfshirëse për mbrojtjen e të gjithë aspekteve të tij: specieve, ekosistemeve dhe burimeve gjenetike. Përveç ruajtjes së tyre, shtetet marrin përsipër që t'i shfrytëzojnë në mënyrë të qëndrueshme burimet natyrore dhe të

²⁸⁹ <http://whc.unesco.org/en/statesparties/AL/>

²⁹⁰ Konventa për Tregtinë Ndërkombëtare të Specieve të Rrezikuara të Florës dhe Faunës (CITES) gjendet në: <http://www.cites.org/eng/disc/text.php>

²⁹¹ Konventa për Biodiversitetin gjendet në: <https://www.cbd.int/doc/legal/cbd-en.pdf>

përfitojnë në mënyrë të drejtë e të ndershme prej tyre. Të tre këto objektiva të konventës të shpalosur në nenin 1 shtetet duhet t'i përmbushin nëpërmjet hartimit të strategjive, planeve dhe programeve kombëtare për ruajtjen dhe shfrytëzimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore dhe integritit të tyre në politikat e sektorëve të ndryshëm.

Konventa stimulon bashkëpunimin midis shteteve me njëri-tjetrin, në mënyrë të drejtpërdrejtë, ose nëpërmjet organizatave të ndryshme ndërkombëtare dhe identifikimin e komponentëve të diversitetit biologjik të rëndësishëm për t'u ruajtur, sipas listës orientuese të Aneksit I që i bashkëlidhet asaj. Kjo listë përfshin identifikimin dhe monitorimin e ekosistemeve dhe habitateve që kanë diversitet të madh, numër të madh specimesh endemike apo të rrezikuara, ose që kanë zona të egra, që janë të nevojshme për speciet migratore, që kanë vlera sociale, ekonomike, kulturore apo shkencore, ose që përfaqësojnë një lloj të veçantë, janë unike apo që janë të lidhura me procese të rëndësishme të evolucionit ose proceset biologjike. Përveç tyre, listat duhet të përfshijnë speciet dhe komunitetet që janë të kërcënuara, llojet e egra të specieve të zbutura apo të kultivuara, që kanë vlera mjekësore, bujqësore, apo vlera të tjera ekonomike, shkencore, sociale, ose kulturore, të rëndësishme për kërkimin shkencor, në drejtim të ruajtjes dhe shfrytëzimit të qëndrueshëm të biodiversitetit, si edhe gjenomet dhe gjenet që kanë rëndësi sociale, shkencore, apo ekonomike. Për të gjitha këto, shtetet duhet të mbajnë dhe të shkëmbejnë të dhëna të sakta.

Për ruajtjen *in situ* (ruajtja e ekosistemeve dhe habitateve natyrore dhe mirëmbajtja dhe ripërtëritja e popullatave të qëndrueshme të specieve në mjedisin e tyre natyror), konventa kërkon nga palët ngritjen e sistemeve të zonave të mbrojtura ose të zonave ku merren masa të veçanta për ruajtjen e biodiversitetit, hartimin e udhëzuesve për përzgjedhjen, krijimin dhe administrimin e këtyre zonave, hartimin e rregullave për administrimin e burimeve biologjike të rëndësishme për ruajtjen e biodiversitetit, qoftë brenda apo jashtë këtyre zonave, për ruajtjen dhe shfrytëzimin e qëndrueshëm të tyre. Masa duhen marrë për promovimin e mbrojtjes së ekosistemeve, habitateve natyrore dhe ruajtjen e një numri të qëndrueshëm të specieve në mjedis natyror, promovimin e zhvillimit të qëndrueshëm nga pikëpamja mjedisore në hapësirat afër zonave të mbrojtura, me synim rritjen e shkallës së mbrojtjes së këtyre zonave, rehabilitimin e ekosistemeve të dëmtuara të specieve të kërcënuara nëpërmjet zbatimit të planeve apo strategjive të tjera të administrimit.²⁹²

Për të plotësuar këto masa, konventa parashikon edhe marrjen e masave për ruajtjen *ex situ*, (ruajtjen e elementëve të biodiversitetit jashtë kushteve të tyre natyrore), masa nëpërmjet të cilave palët duhet të krijojnë mekanizmat përkatës duke bërë kërkime mbi bimët, kafshët dhe mikro-organizmat, kryesisht në vendet origjinë të burimeve gjenetike, të marrin masa për ripërtëritjen dhe rehabilitimin e specieve të rrezikuara dhe për rifutjen e tyre në habitatet natyrore në kushte të përshtatshme, të rregullojnë dhe organizojnë mbledhjen e pasurive biologjike nga habitatet natyrore, për të shmangur rrezikimin e ekosistemeve dhe popullatave *in situ* të specieve. Po ashtu, në zbatim të parimit të integritit, palët duhet të integrojnë masat për ruajtjen dhe përdorimin e qëndrueshëm të pasurive biologjike në vendimmarrjen kombëtare, të marrin masa në lidhje me përdorimin e pasurive biologjike për të eliminuar ose minimizuar efektet negative mbi biodiversitetin, të mbrojnë dhe nxisin përdorimin tradicional të pasurive biologjike në përputhje me praktikat tradicionale kulturore që i përgjigjen kërkesave të ruajtjes dhe përdorimit

²⁹² *Ibid.*, neni 8.

të qëndrueshëm, të mbështesin komunitetet vendore në organizimin dhe zbatimin e veprimtarive ripërtëritëse në zonat e degraduara me biodiversitet të pakësuar, si edhe të nxisin bashkëpunimin midis autoriteteve të veta shtetërore dhe sektorit privat, në zhvillimin e metodave të përdorimit të qëndrueshëm të pasurive biologjike. Ndër të tjera, konventa thekson edhe domosdoshmërinë e marrjes së masave të duhura ekonomiko-shoqërore për të nxitur ruajtjen dhe përdorimin e qëndrueshëm të elementëve përbërës të biodiversitetit, hartimin e programeve për edukimin dhe përgatitjen tekniko-shkencore të specialistëve, për edukimin publik dhe ndërgjegjësimin për rëndësinë e ruajtjes së biodiversitetit, për vlerësimin e ndikimeve dhe minimizimin e efekteve negative, të drejtën e përdorimit të pasurive gjenetike, marrjen e masave në lidhje me bioteknologjinë dhe për sigurimin e lehtësimin e kushteve të përdorimit dhe transferimit të teknologjisë që shërben për ruajtjen dhe përdorimin e qëndrueshëm të burimeve të biodiversitetit, dhe shkëmbimin e informacionit.²⁹³

Në lidhje me strukturën institucionale, nenet 23-25 vendosin themelimin e Konferencës së Palëve dhe të Sekretariatit për ta ndihmuar të përgatisë raporte për zbatimin e detyrave të caktuara nga konventa, si edhe krijimin e një organizmi të brendshëm për këshillim shkencor, teknik e teknologjik, për t'i ofruar këshilla Konferencës së Palëve në lidhje me zbatimin e konventës. Konferenca e Palëve ka miratuar Planin Strategjik për Biodiversitetin për periudhën 2011–2020, i cili përmbledh 5 synime strategjike si edhe 20 Objektivat Aichi për Biodiversitetin, në tetor të vitit 2010.²⁹⁴

Një ndër çështjet më të debatuar sot në botë është çështja e organizmave të modifikuar gjenetikisht (OMGJ), për shkak se nga njëra anë ato ofrojnë mundësi të mëdha për të përmbushur nevojat e njerëzimit për ushqim, por nga ana tjetër, mund të përbëjnë edhe një rrezik të madh për shëndetin e njeriut dhe për mjedisin. Teknologjia përkatëse ka gjetur zbatim të gjerë në industrinë farmaceutike dhe prodhimin e drithërave. Mbjellja e bimëve të modifikuara gjenetikisht për qëllime tregtimi filloi në vitin 1996 dhe në vitin 2010 ato zinin një sipërfaqe prej 148 milionë hektarësh, ku sipërfaqet më të mëdha janë në SHBA, Kanada, Brazil, Kinë dhe Argjentinë.²⁹⁵ Për shkak të ndikimeve negative që mund të ketë bioteknologjia në ruajtjen dhe përdorimin e qëndrueshëm të biodiversitetit, rreziqet për shëndetin e njeriut dhe sidomos përhapjen e tyre për shkak të lëvizjeve ndërkufitare dhe për të siguruar mbrojtjen e duhur në lidhje me transferimin, administrimin dhe përdorimin e sigurtë të organizmave të gjallë të modifikuar, në vitin 2000 u hartua në Montreal të Kanadasë, Protokollin i Kartagenës për Biosigurinë,²⁹⁶ si protokoll i Konventës për Biodiversitetin.

Objektivi i protokollit është të kontribuojë në sigurimin e nje niveli të duhur të sigurisë për sa i përket transferimit, administrimit dhe përdorimit të sigurtë të organizmave të gjallë të modifikuar që rezultojnë nga bioteknologjia moderne e që mund të kenë ndikim negativ në ruajtjen dhe përdorimin e qëndrueshëm të biodiversitetit, duke marrë parasysh rreziqet për shëndetin e njeriut dhe veçanërisht duke u përqendruar në lëvizjet ndërkufitare. Protokollin parashikon që pala eksportuese do t'a njoftojë apo do t'i kërkojë eksportuesit të sigurojë njoftimin me shkrim të

²⁹³ *Ibid.*, nenet 9-18.

²⁹⁴ Informacion i detajuar për zbatimin e Konventës për Biodiversitetin gjendet në: <http://www.cbd.int/sp/elements/default.shtml>

²⁹⁵ *Supra.*, shënimi fundor nr. 278, fq. 150.

²⁹⁶ Protokollin i Kartagenës për Biosigurinë gjendet në: <https://www.cbd.int/doc/legal/cartagena-protocol-en.pdf>

autoritetit kombëtar kompetent të palës importuese, përpara lëvizjes ndërkufitare të një OMGJ dhe pala importuese do të konfirmojë me shkrim marrjen e njoftimit brenda 90 ditësh. Më tej, protokollit trajton procedurat për OMGJ që do të përdoren drejtpërsëdrejti si ushqim për njerëzit ose kafshët apo për t'u përpunuar, rishikimin e vendimeve, procedurën e thjeshtuar, marrëveshjet dypalëshe, rajonale dhe shumëpalëshe, vlerësimin dhe menaxhimin e rrezikut, lëvizjet ndërkufitare dhe masat e sigurisë, administrimin, transportin, paketimin dhe identifikimin, autoritetet kompetente kombëtare dhe rolin e funksionet e tyre, shpërndarjen e informacionit dhe mekanizmin e shkëmbimit të informacionit për biosigurinë, informacionet konfidenciale, ngritjen e kapaciteteve, ndërgjegjësimin, edukimin dhe pjesëmarrjen e publikut, marrjen e masave për parandalimin dhe penalizimin e lëvizjeve ndërkufitare të jashtëligjshme të OMGJ, përgjegjësinë dhe zhdëmtimin, mekanizmat dhe burimet financiare dhe raportin që ky protokoll ka me konventën. Secila palë ka detyrimin që të monitorojë zbatimin e detyrimeve të saj që burojnë prej protokollit dhe duhet të raportojë në intervale kohore që vendosen nga Konferenca e Palëve, e cila shërben si takim i palëve të protokollit.

Një dekadë pas Protokollit të Kartagjenës, Konventës për Biodiversitetin iu shtua edhe Protokollit i Nagoyas i vitit 2010, për Aksesin në Burimet Gjenetike dhe Ndarjen e Drejtë e të Ndershme të Përfitimeve prej Përdorimit të tyre. Nga vetë titulli kuptohet që objektivi i tij është krijimi i një kuadri ligjor transparent për zbatimin e njërit prej objektivave të konventës, ndarjen e drejtë e të ndershme të përfitimeve prej përdorimit të burimeve gjenetike. Sipas protokollit, palët angazhohen për marrjen e masave kombëtare për krijimin e sigurisë ligjore, qartësisë, transparencës, hartimin e rregullave dhe procedurave të drejta, hartimin e rregullave për lëshimin e lejeve apo licencave, si edhe krijimin e kushteve për promovimin dhe inkurajimin e kërkimit shkencor që kontribuon në ruajtjen dhe përdorimin e qëndrueshëm të biodiversitetit.²⁹⁷

Përveç konventave për mbrojtjen e biodiversitetit ujon e detar, të analizuar në kapitullin e mëparshëm, shumë e rëndësishme është edhe Konventa e Ramsarit për Ligatinat me Rëndësi Ndërkombëtare Veçanërisht si Habitata të Shpendëve Ujorë e vitit 1971. Ligatinat janë zona kënetore, moçalore ose ujore, natyrore ose artificiale, të përhershme ose të përkohshme, me ujë të qëndrueshëm ose të rrjedhshëm, të freskët, pak të kripur ose të kripur, duke përfshirë zona me ujë deti, thellësia e të cilave gjatë zbatimit nuk i kalon gjashtë metrat. Ato luajnë një rol të rëndësishëm për ruajtjen e biodiversitetit dhe rritjen e qëndrueshmërisë për t'i rezistuar ndryshimeve klimatike dhe kanë funksione bazë ekologjike si rregullatorë të regjimit ujon, si habitata që kanë një florë dhe faunë karakteristike. Ato përbëjnë një burim me vlera të mëdha ekonomike, kulturore, shkencore, dhe argëtuese. Për të mbrojtur shpendët e ujit gjatë migrimit të tyre sezonal, u miratua Konventa e Ramsarit.²⁹⁸ Sipas konventës, shtetet palë angazhohen të përcaktojnë ligatinat e territorit të tyre të përshtatshme për t'u përfshirë në listën e ligatinave me rëndësi ndërkombëtare, e cila mbahet nga byroja e krijuar për këtë qëllim. Ligatinat duhet të përzgjidhen në bazë të rëndësisë së tyre ndërkombëtare duke marrë në konsideratë ekologjinë, botanikën, zoologjinë, limnologjinë, ose hidrologjinë dhe shtetet duhet të formulojnë dhe zbatojnë plane për promovimin, mbrojtjen dhe përdorimin sa më racional të ligatinave në territorin e tyre.

²⁹⁷ Informacion i detajuar për Protokollin e Nagoyas gjendet në: <http://www.cbd.int/abs/about/>

²⁹⁸ Informacion i detajuar për Konventën e Ramsarit gjendet në: http://www.ramsar.org/cda/en/ramsar-about-about-ramsar/main/ramsar/1-36%5E7687_4000_0

Ndër traktatet rajonale, me rëndësi për ruajtjen e biodiversitetit është edhe Konventa e Bernës për Ruajtjen e Florës dhe Faunës së Egër dhe Mjedisit Natyror të Evropës, e hartuar në vitin 1979, në kuadër të Këshillit të Evropës. Konventa synon ruajtjen e florës, të faunës së egër, habitatet e tyre natyrale, specieve, përfshirë speciet shtegtare të kërcënuara të zhduken dhe ato të pambrojtura, për të cilat ruajtja kërkon bashkëpunimin e shumë shteteve. Palët angazhohen të marrin masat e nevojshme për ruajtjen florës dhe të faunës së egër në një nivel që t'i përgjigjet veçanërisht kërkesave ekologjike, shkencore dhe kulturore, duke pasur parasysh kërkesat ekonomike, argëtuese dhe nevojat e nën-specieve, varieteteve ose formave të kërcënuara në nivel kombëtar. Konventës i bashkëlidhen edhe katër shtojca që rendisin llojet e mbrojtura të florës dhe të faunës, si edhe mjetet dhe metodat e ndaluara të vrasjes, kapjes dhe formave të tjera të shfrytëzimit të tyre.

Në vitin 1979 u miratua edhe Konventa e Bonit për Mbrojtjen e Specieve Shtegtuese të Kafshëve të Egra. Për të mbrojtur kafshët e egra dhe vendbanimet e tyre, si pjesë e pazëvendësueshme e sistemit natyror të tokës, palët marrin përsipër mbrojtjen e specieve shtegtuese, gjendja e mbrojtjes e të cilave është e pafavorshme, duke marrë masa individualisht, ose në bashkëveprim me njëra-tjetrën. Konventës i bashkëlidhen edhe dy shtojca që përmbajnë speciet shtegtuese që janë të rrezikuara, speciet shtegtare që kanë një status mbrojtjeje të pafavorshëm dhe që kërkojnë bashkëpunimin ndërkombëtar për mbrojtjen dhe menaxhimin e tyre.²⁹⁹

Në jurisprudencë, fillimisht çështja e ruajtjes së gjallesave u trajtua nga GJND në vendimin e saj në çështjen *Juridiksioni i Peshkimit* të vitit 1974, por pa shkuar deri tek përmendja e ruajtjes së tyre për brezat e ardhshëm. Kur shqyrtoi kundërshtimin e Mbretërisë së Bashkuar ndaj vendimit të njëanshëm të Islandës për të zgjeruar zonën e saj ekskluzive të peshkimit nga 12 në 50 milje, në lidhje me ruajtjen e burimeve natyrore gjykata u shpreh: “Një nga përparimet e të drejtës ndërkombëtare të detit që ka ardhur si pasojë e intensifikimit të peshkimit është se qëndrimi i mëparshëm i lirisë së pakufizuar ndaj gjallesave të detit është zëvendësuar me njohjen e detyrimit që shtetet kanë ndaj shteteve të tjera dhe për nevojën e ruajtjes së gjallesave për të mirën e të gjithëve.”³⁰⁰

Mbrojtja e florës, faunës dhe biodiversitetit janë të lidhura pazgjidhshmërisht me administrimin e qëndrueshëm të pyjeve, pasi në to ndodhen një pjesë e mirë e habitateve natyrore. Në një vendim të paprecedent në jurisprudencën botërore, Gjykata Supreme e Filipineve analizoi parimin e ‘drejtësisë ndër-brezo’, ruajtjen e diversitetit biologjik për brezat e ardhshëm. Në vendimin *Të Miturit Oposa kundër Sekretarit të Departamentit të Mjedisit dhe Burimeve Natyrore*, (*Oposa et al. v. Fulgencio S. Factoran, Jr. et al*), datë 30.7.1993, u shqyrtua drejtësia midis brezave në kontekstin e menaxhimit të pyjeve publikë tropikalë, si pjesë e burimeve natyrore të vendit. Gjykata Supreme e Filipineve pranoi legjitimitimin e një grupi fëmijësh të Filipineve, përfshirë fëmijët e një ambientalisti të shquar, Antonio Oposa, së bashku me OJF mjedisore “Rrjeti Ekologjik Filipinez” (Philippine Ecological Network, Inc.) që kërkonin ndalimin e shkatërrimit të pyjeve tropikalë. Kërkesa e tyre bazohej në Kushtetutën e Filipineve të vitit 1987, e cila sanksionon të drejtën individit për një “ekologji të shëndetshme e të balancuar”. Madje gjykata

²⁹⁹ Informacion i detajuar për Konventën e Bonit gjendet në: <http://www.cms.int/en/legalinstrument/cms>

³⁰⁰ Vendimi i GJND *Mbretëria e Bashkuar kundër Islandës*, paragraf 72. Gjendet në: <http://www.icj-cij.org/docket/files/55/5977.pdf>

shkoi deri atje sa të deklaronte që në paragrafin e parë të vendimit: “Në fakt, këto të drejta themelore nuk ka nevojë as të shkruhen në kushtetutë, pasi kuptohet që ato ekzistojnë që nga lindja e njerëzimit.” Ideja kryesore e padisë ishte ‘drejtësia ndër-brezore’, bazuar në faktin që burimet natyrore u përkasin njerëzve të të gjitha moshave, e nëse të rriturit i shfrytëzojnë të gjitha burimet natyrore të vendit, ata ishin duke “vjedhur” nga pasuria e fëmijëve të tyre, fëmijëve të fëmijëve të tyre dhe të të gjithë brezave të ardhshëm. Gjykata e vlerësoi çështjen në këndvështrimin e përgjegjësisë së një brezi ndaj një tjetri dhe pranoi që paditësit gëzonin *locus standi*. Gjykata pranoi provat statistikore të paditësve në lidhje me sasinë e prerjeve të pyjeve dhe nevojën e mbrojtjes së tyre, bazuar në detyrimin kushtetues të autoriteteve shtetërore për ruajtjen e një mjedisi të shëndetshëm për brezat e tashëm dhe të ardhshëm.³⁰¹

Një aspekt i dytë interesant i këtij vendimi është referimi që i bën një vendimi tjetër të mëparshëm të saj, *Tan kundër Drejtorit të Pyjeve (Tan v. Director of Forestry)* të vitit 1983, ku gjykata ishte shprehur: “...Një licencë për shfrytëzimin e pyjeve është një instrument nëpërmjet të cilit shteti rregullon përdorimin dhe shpërndarjen e burimeve pyjore me qëllim që të promovohet mirëqënia e publikut. Një licencë për prerjen e drurëve nuk është kontratë që përfshihet brenda sferës së rregullimit të procesit të rregullt, është vetëm një licencë ose privilegj që mund të anulohet në mënyrë të ligjshme kurdoherë që diktohet prej interesit publik apo prej mirëqënies së publikut, si në rastin konkret. Një licencë është thjesht një leje ose privilegj për të bërë diçka që në kushte të tjera do të ishte veprim i paligjshëm, nuk është kontratë midis autoritetit federal, njësisë federale apo vendore që e lëshon atë dhe personit të cilit i lëshohet, as nuk është pronë ose e drejtë pronësie, as nuk krijon një të drejtë, as nuk është taksë”. Siç shihet, në këtë vendim balanca anon krejtësisht në anën e interesit publik dhe është qëndrim krejtësisht i kundërt nga ai i mbajtur nga ana e GJEDNJ në çështjet që kanë të bëjnë me të drejtën e pronës, të mbrojtur nga neni 1 i Protokollit 1 të KEDNJ.

5.2 Legjislacioni evropian për mbrojtjen e biodiversitetit.

Larmia biologjike në Evropë është e konsiderueshme, duke përfshirë 488 specie zogjsh, 260 specie gjitarësh, 85 specie amfibe, 546 specie peshqish të ujërave të embla, 1100 specie peshqish të deteve, si edhe mbi 100,000 specie jovertebrorësh.³⁰² Me gjithë këtë pasuri të jashtëzakonshme biologjike, kryesisht për shkak të aktiviteteve njerëzore, një pjesë jo e vogël e tyre janë pakësuar shumë, ose kërcënohen nga zhdukja.

Për të marrë masat për të ndaluar rrezikimin dhe zhdukjen e specieve të ndryshme, legjislacioni evropian ka njohur zhvillime të rëndësishme, që kanë patur ndikim jo të vogël në ruajtjen e diversitetit biologjik. Një nga mënyrat e konsideruar si më efektive është krijimi i zonave të mbrojtura, në të cilat zbatohet një kontroll strikt i aktiviteteve, apo ndalimi total i tyre.

Në dekadat e fundit, BE ka krijuar një hapësirë gjigande prej 26.000 zonash të mbrojtura, që përfshijnë mbi 750.000 km², rreth 18% të të gjithë masës tokësore të BE, i njohur me emërtimin

³⁰¹ International Law Materials, 1994, Vol. 33, fq. 173.

³⁰² Statistikat mbi larminë biologjike në Evropë gjenden në:

http://www.iucn.org/knowledge/focus/europe_focus_2012_gb/?9061/Facts-and-figures-on-Europe

Natura 2000, duke qenë rrjeti më i madh në botë i zonave të mbrojtura, çka tregon edhe vetë rëndësinë që BE i kushton ruajtjes së biodiversitetit.³⁰³

Për të arritur deri në krijimin e Natura 2000, BE ka kaluar nëpër një rrugë të gjatë të krijimit të legjislacionit për mbrojtjen e natyrës në mënyrë graduale, duke patur si bazë ligjore Direktivën e Shpendëve dhe Direktivën e Habitaveve, të cilat krijuan bazën ligjore për zbatimin e politikave të BE për mbrojtjen e biodiversitetit. Si gur themeli konsiderohet Direktiva e Këshillit 79/409/EEC, datë, 2.4.1979, e quajtur Direktiva e Shpendëve.³⁰⁴ Si shkas për miratimin e kësaj direktive shërbeu fakti që të dhënat tregonin se numri i shpendëve në Evropë po pakësohej me shpejtësi, duke përbërë kështu një kërcënim serioz për ruajtjen e mjedisit natyror dhe të balancave biologjike, në kushtet kur shumica e llojeve të shpendëve në Evropë janë kryesisht shtegtarë, duke qenë trashëgimi e përbashkët dhe mbrojtja e tyre përfshin aspekte të përgjegjësive së përbashkët dhe të bashkëpunimit ndërshtetëror.

Direktiva e Shpendëve gjen zbatim ndaj të gjitha llojeve të shpendëve të egër që gjenden në territoret e shteteve anëtare të BE dhe vendos detyrime ndaj tyre në lidhje me mbrojtjen, administrimin, dhe kontrollin e specieve të shpendëve dhe shfrytëzimin e tyre, të foleve dhe të habitaveve të tyre. Neni 2 i direktivës kërkon prej palëve që të marrin masat e duhura për të ruajtur numrat e specieve të shpendëve në një nivel të tillë që përputhet me kërkesat ekologjike, shkencore dhe kulturore të mjedisit, duke mbajtur parasysh edhe aspektet ekonomike dhe kërkesat për aktivitete argëtuese. Në mënyrë që të përmbushen këto kërkesa, shteteve anëtare u kërkohet që të marrin masat e duhura për ruajtjen e diversitetit nëpër habitatet e shpendëve, duke krijuar zona të mbrojtura, administrimin e kujdesshëm të tyre, në përputhje me nevojat ekologjike të habitaveve si brenda, ashtu edhe jashtë zonave të mbrojtura.

Direktivës i bashkëlidhen edhe 5 shtojca, në të cilat renditen speciet e shpendëve që duhen vendosur në mbrojtje, llojet e kurtheve dhe armatimeve përdorimi i të cilëve është i ndaluar, si edhe kërkesat për hartimin e listave kombëtare të shpendëve që kërcënohen nga zhdukja, duke mbajtur parasysh edhe shpërndarjen e tyre gjeografike, të specieveve shtegtare dhe rrugët e tyre të shtegtimit, së bashku me zonat ku ata ngrenë fole të për dimërim, vlerësimin e ndikimit të metodave të kapjes dhe gjuetisë së shpendëve, masat që duhen marrë për të pakësuar dëmet prej shpendëve, përcaktimin e rolit të specieveve të veçanta, si tregues të ndotjes, si edhe studimin e efekteve negative të ndotjes prej kimikateve në numrin e specieveve të shpendëve. Ajo ndalon shitjen, transportimin apo mbajtjen me qëllim shitjen e shpendëve që u përkasin specieveve që janë të listuara si të rrezikuara, si edhe vendosjen e rregullave strikte për gjuetinë e shpendëve dhe ndalimin gjatë periudhave të shumëzimit, veçanërisht të shpendëve shtegtarë, në mënyrë që të mos kërcënohen apo rrezikohen nga zhdukja prej një aktiviteti të tillë. Të gjitha shtetet anëtare kanë detyrimin të informojnë Komisionin për të dhënat dhe masat e ndryshme, në mënyrë që t'i mundësojnë atij ndërmarrjen e iniciativave për koordinimin e veprimtarive të tyre dhe hartimin e rekomandimeve përkatëse.

Pas Direktivës së Shpendëve, si guri i dytë i themelit për mbrojtjen e biodiversitetit në BE ka shërbyer Direktiva e Këshillit 92/43/EEC, datë 21.5.1992, e quajtur Direktiva e Habitaveve, e cila

³⁰³ <http://ec.europa.eu/environment/newprg/>

³⁰⁴ Direktiva e Shpendëve gjendet në: <http://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=CELEX:31979L0409:en:HTML>

është amenduar në vitet 1997, 2003 dhe 2006.³⁰⁵ Synimi i saj ishte krijimi i një rrjeti ekologjik evropian zonash të veçanta të ruajtjes së biodiversitetit, duke ruajtur habitatet natyrore të florës dhe faunës, të quajtura Natura 2000, në funksion të realizimit të një prej objektivave themelore të BE, siç përcaktohej në nënin 130r të Traktatit të BE. Sipas nenit 4 të direktivës, procesi i përcaktimit të zonave pjesë e rrjetit Natura 2000 kalon nëpër 4 faza. Në fazën e parë, shtetet anëtare hartojnë një listë të zonave të tyre, ku ndodhen habitatet e listuar në Shtojcën I dhe speciet e listuara në Shtojcën II, që ndodhen në këto zona, duke ia përcjellë këto Komisionit Evropian brenda 3 vjetëve. Prej këtej, në fazën e dytë, Komisioni, në marrëveshje me shtetet palë, harton një projektlistë me zonat që i konsideron si të rëndësishme për Komunitetin, e cila shndërohet në listë përfundimtare prej Komisionit. Faza 4 vazhdon me përcaktimin sa më shpejt prej shteteve anëtare të zonave të rëndësishme për ruajtjen e biodiversitetit, e në çdo rast, brenda jo më shumë se 6 vjetëve. Kjo bëhet duke caktuar prioritetet sipas rëndësisë së këtyre zonave për ruajtjen apo rigjallërimin e habitateve natyrore dhe duke mbajtur parasysh kërcënimet për degradimin apo shkatërrimin e zonave që janë të ekspozuara ndaj rreziqeve.

Për të ruajtur larminë biologjike në Evropës, neni 6 i direktivës parashikon edhe një skemë mbrojtëse të zonave të veçanta të ruajtjes, duke kërkuar prej shteteve marrjen e masave aktive ruajtëse në rastet e problematikave që ka gjasa të shkaktojnë pasoja negative në këto zona. Si rregull, masa të tilla duhet të autorizohen vetëm për të ruajtur integritetin e rrjetit Natura 2000. Neni 6§3 parashikon që çdo plan apo projekt që nuk është drejtpërdrejt i lidhur me një prej zonave të rrjetit, por që ka gjasa të ketë një ndikim në të, duhet të bëhet objekt i një vlerësimi të këtij ndikimi në mjedis, me synim mbrojtjen e kësaj zone. Në varësi të rezultateve të vlerësimit, autoritetet kombëtare kompetente mund ta miratojnë planin ose projektin vetëm pasi të jenë siguruar që ai nuk çënon integritetin e zonës dhe kur është rasti edhe pas marrjes së mendimit të publikut. Vetëm në raste përjashtimore të një interesi publik madhor, përfshirë ato të një natyre ekonomike apo sociale, mund të miratohen plane ose projekte që kanë ndikim në këto zona kur nuk ka asnjë alternativë tjetër. Në këto raste, shtetet duhet të marrin masa kompensuese, për të siguruar ruajtjen e integritetit të rrjetit Natura 2000.

Një hap tjetër i rëndësishëm u hodh me miratimin e Rregullores së Këshillit (EC) Nr. 338/97, datë 9.12.1996, për Mbrojtjen e Specieve të Faunës dhe Florës së Egër dhe rregullimin e tregtisë së tyre.³⁰⁶ Ajo synonte të përfshinte në rregullim të dhënat më të fundit shkencore për mbrojtjen e specieve si edhe për nivelin e tregtimit, lidhur këto edhe me kushtet e reja në të cilat ndodheshin vendet e BE, pas heqjes së kontrolleve kufitare midis tyre. Kjo duhet të shoqërohej me marrjen e masave më të forta për të kontrolluar tregtinë me vendet e tjera, që nuk ishin pjesë e komunitetit, duke kryer kontrolle të imtësishme të dokumentacionit që paraqitej para autoriteteve doganore.

Ndërsa në 20 prill 2012, Parlamenti Evropian miratoi Rezolutën “Siguracioni i Jetës Tonë, Kapitali Ynë Natyror: Strategjia e BE për Biodiversitetin drejt 2020”.³⁰⁷ Rezoluta paraqet një tablo të gjendjes së përgjithshme të ruajtjes së biodiversitetit, ndërsa deklaroi se BE ka dështuar

³⁰⁵ Direktiva e Habiteteve gjendet në: <http://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:01992L0043-20070101&from=EN>

³⁰⁶ Gjendet në: <http://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=CONSLEG:1997R0338:20080411:EN:PDF>

³⁰⁷ Rezoluta gjendet në: http://ec.europa.eu/environment/nature/biodiversity/comm2006/pdf/EP_resolution_april2012.pdf

në realizimin e objektivave të biodiversitetit për vitin 2010, në një kohë kur OKB e ka deklaruar dekadën 2010-2020 si Dekadën e Biodiversitetit, pasi biodiversiteti është thelbësor për ekzistencën e jetës njerëzore dhe mirëqenien e shoqërisë. Të dhënat tregojnë që përfitimet që BE nxjerr nga rrjeti Natura 2000 i zonave të mbrojtura përlllogariten në rreth 200-300 miliardë euro, të barabarta me 4.5-8 milion vende pune, të ardhura direkte prej shpenzimeve të vizitorëve në këto zona dhe në afërsi të tyre. Nga ana tjetër, humbjet në biodiversitet zvogëlojnë Prodhimin e Brendshëm Bruto (PBB) me 3% çdo vit, kurse rreth 65% e habitateve dhe 52% e specieve të listuara në shtojcat e Direktivës së Habitave janë në gjendje jo të mirë ruajtjeje dhe 88% e rezervave të peshkut janë mbishfrytëzuar përtej niveleve të qëndrueshme.

Edhe pse rezoluta nuk ka karakter detyrues, nëpërmjet saj Parlamenti Evropian (PE) i bën thirrje Komisionit dhe shteteve anëtare që të garantojnë ruajtjen e rrjetit Natura 2000 nëpërmjet financimeve të mjaftueshme, duke bashkëpunuar edhe me aktorët e tjerë kombëtarë. PE kërkon në mënyrë të veçantë rritjen e nivelit të zbatimit të legjislacionit mjedisor në gjirin e BE, pasi konstaton se nuk ndodhet në nivele të kënaqshme dhe se ka dallime të konsiderueshme në këtë aspekt, midis shteteve anëtare. Parlamenti shpreh mbështetjen e tij për iniciativat e Komisionit për programet e trainimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve, trainime të cilat shtetet anëtare duhet t'i shtrijnë edhe ndaj profesionistëve që merren me zonat e rrjetit Natura 2000, si për shembull autoritetet vendore dhe agjencitë e zbatimit të ligjit. Më tej, kërkohet integrimi i politikave për mbrojtjen e biodiversitetit në strategjitë e sektorëve të tjerë, si bujqësia, pyjet, peshkimi, ndryshimet klimatike, si edhe vënia në dispozicion e mjeteve financiare për realizimin në praktikë të këtyre politikave. Nga ana e tij, Komisioni Evropian ka miratuar një strategji të veçantë për të ndaluar humbjen e biodiversitetit, e cila përmban 6 objektiva kryesorë dhe 20 veprimtari konkrete për arritjen e tyre. Objektivat përfshijnë zbatimin e legjislacionit për mbrojtjen e biodiversitetit, mbrojtje më të mirë të ekosistemeve, përdorimin e infrastrukturës së gjelbër, bujqësi, peshkim dhe pylltari të qëndrueshme dhe kontrole më të rrepta për ndalimin e specieve të huaja pushtuese.

Programi i Shtatë i veprimit të BE për Mjedisin deri në vitin 2020 u miratua nëpërmjet vendimit 1386/2013/EU, datë 20.11.2013, të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, të titulluar “Të jetojmë mirë, brenda limiteve të planetit tonë”.³⁰⁸ Në të theksohet se BE synon të reduktojë me të paktën 20%, çlirimin e gazeve në atmosferë brenda vitit 2020, të sigurojë që 20% e energjisë së konsumuar të prodhohet prej burimeve të rinovueshme, dhe të arrijë një ulje prej 20% të konsumit të energjisë, duke rritur efikasitetin në përdorimin e saj.

Për sa i përket biodiversitetit, BE angazhohet të ndalojë humbjen dhe degradimin e tij brenda vitit 2020, duke rritur edhe kontributin për shmangien e humbjes së biodiversitetit në nivel global. Ai synon ndalimin e zvogëlimit të sipërfaqeve pyjore në shkallë globale dhe ndalimin e zvogëlimit të shpyllëzimeve tropikale me të paktën 50 %, krahasuar me nivelet e vitit 2008. I gjithë Programi i Shtatë i veprimit të BE për Mjedisin bazohet në parimet e parandalimit dhe të marrjes së masave paraprake, në eliminimin e ndotjes në burim dhe në parimin ‘ndotësi paguan’. Në fund të fundit, synimi i të gjithë programit është arritja e një niveli të lartë mbrojtjeje të mjedisit dhe përmirësimi i cilësisë së jetës për qytetarët evropianë.

³⁰⁸ <http://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:32013D1386&from=EN>

5.2.1 Vlerësimi i ndikimit në mjedis, për mbrojtjen e biodiversitetit.

Vlerësimi i ndikimit në mjedis u parashikua nga Direktiva e Këshillit 85/337/EEC, datë 27.6.1985, për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis të Projekteve. Në nenin 1 të direktivës bëhej dallimi midis termave “publiku” (ku përfshiheshin personat fizikë apo juridikë, shoqatat, organizatat dhe grupet e tyre, që kishin të drejtë të informoheshin rreth një projekti) dhe “publiku i interesuar” (ku përfshiheshin personat që ishin ndikuar ose që mund të ndikoheshin, apo që kishin një interes në procedurat e vendimmarjes mjedisore). Përkufizimi saktësoni që OJF që përfshinin mbrojtjen e mjedisit në sferën e veprimtarisë së tyre dhe që plotësonin kriteret e legjislacioneve kombëtare, konsideroheshin si subjekte që kanë interes në vendimmarjen mjedisore.³⁰⁹

Versioni fillestar i direktivës është amenduar tre herë, në vitet 1997, 2003 dhe 2009. Direktiva 97/11/EC transpozoi detyrimet që buronin prej Konventës së Espoo-s për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis në një Kontekst Ndërkufitar, duke zgjeruar fushën e veprimit të direktivës nëpërmjet zgjerimit të llojeve të projekteve që mbuloreshin prej saj, për të cilët vlerësimi i ndikimit në mjedis ishte i detyrueshëm. Gjithashtu, direktiva përcaktoi edhe kriteret e reja për analizimin e projekteve para miratimit të tyre. Në amendimin e mëpasëm, Direktiva 2003/35/EC EC transpozoi detyrimet që vinin prej Konventës së Aarhusit, duke parashikuar dispozitat që kanë të bëjnë me të drejtën e publikut për të pasur informacion, për të marrë pjesë në vendimmarje dhe për t'iu drejtuar gjykatës për çështjet e mjedisit. Më tej, Direktiva 2009/31/EC amendoi Aneksin I dhe II të direktivës për vlerësimin e ndikimit në mjedis, duke shtuar projektet që kanë të bëjnë me transportin, kapjen dhe ruajtjen e dioksidit të karbonit. Teksti që rezultoi nga të gjitha këto amendime, u kodifikua prej Direktivës 2011/92/EU, datë 13 dhjetor 2011, e cila për vete u amendua para pak muajsh, në 16 prill 2014, prej Direktivës 2014/52/EU, për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis të Projekteve Publike dhe Private.³¹⁰ Në thelb, procedura që duhet ndjekur për realizimin e një projekti, kërkon fillimisht aplikimin e zbatuesit të projektit pranë autoriteteve kompetente për llojin e informacionit që ai duhet të ofrojë dhe më pas duhet të japë informacionin mbi ndikimin në mjedis. Më pas, duhet të informohen dhe zhvillohen konsultime me autoritetet mjedisore dhe publikun, si edhe me shtetet anëtare që mund të ndikohen prej projektit. Pas konsultimeve, autoriteti kompetent merr vendim nëpërmjet një akti administrativ, pasi të ketë marrë në konsideratë rezultatet e konsultimeve. Vendimi duhet shpallur publikisht dhe publiku ka të drejtën që të kërkojë shfuqizimin e tij në gjykatë.³¹¹

Në mënyrë të habitshme, në çështjen *Greenpeace*, të vitit 1995, Gjykata e Shkallës së Parë e BE nuk e mori fare parasysh zbatimin e Direktivës 85/337/EEC, të ndryshuar. Ajo vetëm u shpreh në lidhje me OJF, duke thënë se një shoqatë e formuar për mbrojtjen e interesave kolektive të një kategorie personash nuk mund të konsiderohet se është subjekt individualisht i interesuar, në kuptim të nenit 173 të Traktatit, për një masë që ka ndikim në interesin e përgjithshëm të kesaj

³⁰⁹ Teksti i Direktivës 85/337/EEC në versionin para kodifikimit gendet në:

http://www.environ.ie/en/Publications/Environment/Miscellaneous/FileDownload_8786_en.pdf

³¹⁰ Teksti i Direktivës 2014/52/EU gjendet në:

<http://eur-lex.europa.eu/legal-Content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:32014L0052&from=EN>

³¹¹ Etapat nëpër të cilat ka kaluar i gjithë procesi i vlerësimit të ndikimit në mjedis trajtohen me hollësi në:

<http://ec.europa.eu/environment/eia/eia-legalcontext.htm>

kategorie, prandaj nuk legjitimohet të paraqesë një kërkesë për shfuqizimin e një akti, kur anëtarët e saj nuk mund ta bëjnë një gjë të tillë individualisht. Megjithatë, rrethana të veçanta, siç është p.sh. roli që luan një shoqatë në një procedurë që ka çuar në miratimin e një akti në kuptim të nenit 173 të Traktatit, mund të bëjnë të pranueshme një kërkesë të saj, anëtarët e së cilës mund të mos jenë në mënyrë direkte dhe individualisht të interesuar për aktin që kundërshtohet. Por në rastin konkret, nuk ka rrethana të tilla kur një shoqatë për mbrojtjen e mjedisit kërkon shfuqizimin e një vendimi të Komisionit që i drejtohet një shteti i cili përfiton ndihmë financiare prej Fondit Evropian të Zhvillimit Rajonal për ndërtimin e dy hidrocentraleve, kërkesë që mbështetet për këtë qëllim në një shkëmbim korrespondence dhe një takim me Komisionin. Kontakte të tilla nuk legjitimojnë një shoqatë të tillë që të mbështetet në një interes individual, në kushtet kur Komisioni, para miratimit të vendimit të kontestuar, nuk filloi ndonjë procedurë në të cilën shoqata të ishte njohur si ndërmjetëse dhe kur kontaktet ishin vendosur vetëm për qëllime informimi. Prandaj, Komisioni nuk kishte detyrimin as të konsultohet, dhe as të dëgjonte mendimin e shoqatës para marrjes së vendimit.³¹² Gjykata e Shkallës së Parë duhej të kishte marrë parasysh Direktivën 85/337/EEC dhe të kishte njohur të drejtën e shoqatës për të paraqitur kërkesën në gjykatën kombëtare për shfuqizimin e vendimit të Komisionit, bazuar pikërisht në këtë direktivë. Nëse gjykata kombëtare do kishte pranuar kërkesën, më pas duhej t'ia referonte çështjen Gjykatës së Shkallës së Parë të BE për të marrë vendim, pasi gjykatat kombëtare nuk mund të shqyrtojnë vlefshmërinë e vendimeve të institucioneve të BE.

Edhe GJED ka ndjekur të njëjtën linjë arsyetimi, duke u treguar shume konservatore në lidhje me legjitimitimin e subjekteve për t'iu drejtuar gjykatës. Çështja e interesit individual u diskutua prej saj në vendimin C-50/00 P, datë 25.7.2002, *Unión de Pequeños Agricultores kundër Këshillit*. Ajo u shpreh se sipas sistemit të kontrollit gjyqësor të krijuar nga Traktati, një person fizik ose juridik mund të kundërshtojë një akt vetëm nëse ai ndikohet prej tij në të dyja aspektet, *individualisht dhe në mënyrë direkte* [theksimi im]. Edhe pse ky kushti i fundit duhet interpretuar në kuptim të parimit të ofrimit të mbrojtjes gjyqësore, duke mbajtur parasysh rrethanat e ndryshme që mund të dallojnë individualisht një kërkuar, një interpretim i tillë nuk mund të ketë efektin e mënjanimi të kushtit në fjalë, të caktuar shprehimisht nga Traktati, pa tejkaluar juridiksionin që u është akorduar nga Traktati gjykatave komunitare. Edhe pse duhet pranuar që mund të mendohet një sistem kontrolli gjyqësor ndaj ligjshmërisë së akteve komunitare të zbatimit të përgjithshëm, të ndryshëm nga ai i krijuar prej Traktatit Themelues dhe të pa amenduar për sa i përket parimeve të tij, u takon shteteve anëtare që nëse e shohin të nevojshme, bazuar në nenin 48, të reformojnë sistemin aktual.³¹³ Siç shihet, GJED refuzon të bëjë interpretim të zgjeruar të së drejtës individuale për të kërkuar shfuqizimin e një akti komunitar, por e lë këtë krejtësisht në dorën e shteteve anëtare të BE për ta theksuar këtë shprehimisht në traktat.

Ndërsa në çështjen *Mellor*, Nr. C-75/08, GJED diskutoi nëse është apo jo e nevojshme dhënia e arsyeve për vendimin e marrë prej autoritetit kompetent kombëtar për të mos ndjekur procedurën

³¹² Vendimi nr. T-585/93, datë 9.8.1995, *Stichting Greenpeace Council (Greenpeace International) dhe të tjerë kundër Komisionit*. Gjetet në: <http://curia.europa.eu/juris/showPdf.jsf?docid=103437&doclang=EN>

³¹³ Vendimi nr. C-50/00 P, datë 25.7.2002, *Unión de Pequeños Agricultores kundër Këshillit*, paragraf. 44-45. Gjetet në: <http://curia.europa.eu/juris/showPdf.jsf?docid=47107&pageIndex=0&doclang=EN&mode=lst&dir=&occ=first&part=1&cid=178397>

e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (VNM) kur shqyrtohet kërkesa për ndërtimin e një spitali, një projekt që ky që përfshihet në sferën e veprimit të Aneksit II të Direktivës 85/337. Gjykata vendosi se ndërsa nuk është e domosdoshme që vendimi mbi një projekt të tillë të përmbajë në vetvete arsyet se pse autoriteti kompetent ka vendosur që VNM nuk nevojitet, nëse një palë e interesuar e kërkon një informacion të tillë, autoriteti administrativ kompetent është i detyruar t'i komunikojë arsyet e marrjes së vendimit ose vendimin përkatës dhe dokumentacionin, si përgjigje ndaj kërkesës së bërë.³¹⁴

Me synim kontrollin paraprak të projekteve që kanë ndikim në mjedis, e për rrjedhojë edhe në biodiversitet, rëndësi të veçantë ka Konventa e Espoo-s për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis në Kontekst Ndërkufitar. Ligji i mëparshëm shqiptar për mbrojtjen e mjedisit, nr. 8934, datë 5.9.2002 (tashmë i shfuqizuar prej ligjit nr. 10431, datë 9.6.2011), synoi krijimin e bazës ligjore fillestare për zbatimin e detyrimeve të konventës. Për herë të parë në legjislacionin shqiptar, kreu IV i tij kushtohej vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM), duke sanksionuar që të gjitha projektet publike dhe private të personave fizikë dhe juridikë, vendas ose të huaj, që kërkonin të ushtronin veprimtari në territorin shqiptar dhe që mund të ndikonin në mjedis, duhej t'i nënshtroheshin VNM, përpara miratimit dhe zbatimit të tyre. Ligji përcaktonte edhe dokumentacionin që duhej të shoqëronte kërkesën për miratimin e projektit, përshkrimin e tij, të dhëna për zonën, projektin teknik, përshkrimin e masave për të shmangur, pakësuar dhe rehabilituar pasojat negative në mjedis, të dhënat e nevojshme për identifikimin dhe matjen e ndikimeve të mundshme në mjedis, si edhe variante të ndryshme alternative të projektit. Për projektet që mund të kishin ndikim në mjedisin e një vendi fqinj, neni 27 i ligjit sanksiononte shprehimisht zbatimin e parimeve të konventës, si dhe çdo parim tjetër të përgjithshëm dhe normat e së drejtës ndërkombëtare mjedisore. Kjo dispozitë do të shërbente si baza mbi të cilën u miratua më vonë ligji nr. 9700, datë 26.3.2007, “Për mbrojtjen e mjedisit nga ndikimet ndërkufitare”, i cili zbatohet për të gjitha projektet dhe aktivitetet që janë të renditura në shtojcën 1 të konventës. Pas tij, u miratua edhe VKM nr. 1435, datë 29.1.2009, “Për miratimin e rregullave dhe procedurave për vlerësimin e veprimtarive me ndikime të rëndësishme negative në mjedisin e vendeve fqinje”.

Me qëllim hartimin e normave të posaçme për zbatimin e konventës, u miratua ligji nr. 8990, datë 23.1.2003, “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, duke bërë një plotësim dhe zgjerim të dispozitave mbi VNM, si edhe përcaktoi më hollësisht kërkesat, rregullat, procedurat dhe afatet proceduriale në bazë të cilave duhet kryer procesi i VNM. Ky ligj u shfuqizua më pas prej ligjit nr. 10440, datë 7.7.2011, i cili u përafrua me direktivën 85/337/KEE të Këshillit, datë 27.6.1985, “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis të projekteve publike dhe private”. Ai zbatohet për projektet e propozuara, private apo publike, të cilat mund të shkaktojnë ndikime të rëndësishme negative, të drejtpërdrejta ose jo, në mjedis, si pasojë e madhësisë, natyrës apo vendndodhjes së tyre. Ligji bën ndarjen e projekteve në varësi të ndikimeve të mundshme të tyre në mjedis, sipas raportit të VNM, i cili mund të jetë një raport paraprak i VNM për projektet e shtojcës II, ose raport i thelluar i VNM për projektet e shtojcës I, ku shtojcat ndjekin në kategorizimin e bërë në shtojcat e Konventës së Espoo-s për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis në Kontekst Ndërkufitar.

³¹⁴ Vendimi nr. Nr. C-75/08, datë 30.4.2009, *Christopher Mellor v. Secretary of State for Communities and Local Government*, parag. 61. Gjendet në: <http://curia.europa.eu/juris/document/document.jsf?jsessionid=9ea7d0f130de17139398259b4f3ba5838aa1416455e8.e34KaxiLc3eQc40LaxqMbN4Ob30Me0?text=&docid=73330&pageIndex=0&doclang=en&mode=lst&dir=&occ=fi rst&part=1&cid=332149>

Nga ana tjetër, ligji i ri për mbrojtjen e mjedisit, nr. 10431, datë 9.6.2011, parashikon dy dispozita të veçanta për vlerësimin e ndikimit në mjedis dhe për vlerësimin strategjik mjedisor (VSM). Në lidhje me këtë të fundit, dy vjet më pas u miratua ligji i posaçëm nr. 91/2013, datë 28.2.2013, “Për vlerësimin strategjik mjedisor”, i cili u përafua me Direktivën 2001/42/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 27 qershor 2001, “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis të planeve dhe programeve të caktuara”. Ligji parashikon se i nënshtrohet procesit të VSM hartimi i të gjitha planeve dhe programeve për bujqësinë, pyjet, peshkimin, energjinë, industrinë, industrinë minerare, transportin, menaxhimin e mbetjeve, menaxhimin e ujërave, telekomunikacionin, turizmin, planet kombëtare e vendore të planifikimit të territorit urban e rural, përfshirë mbrojtjen e peizazhit dhe përdorimin e tokës.

Kuadri ligjor u plotësua më pas me ligjin nr. 10448, datë 14.7.2011, “Për lejet e mjedisit”, i cili u përafua me Direktivën 2008/1/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 15.11.2008, “Për kontrollin dhe parandalimin e integruar të ndotjes” (IPPC), si edhe me Direktivën 2001/80/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 23.10.2001, “Për kufizimin e shkarkimeve të disa ndotësve në ajër nga instalimet e mëdha me djegie”. Ligji i ndan lejet mjedisore në 3 kategori, të cilat në varësi të llojit, përgatiten nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit dhe firmosen nga ministri, e lëshohen nga Qendra Kombëtare e Licencave (QKL), ose miratohen nga Agjencia Rajonale e Mjedisit (ARM) dhe lëshohen nga QKL.

Për zbatimin e këtyre ligjeve janë miratuar një sërë aktesh nënligjore, ku përfshihen VKM Nr.249, datë 24.4.2003, “Për miratimin e dokumentacionit për leje mjedisore dhe të elementëve të lejes mjedisore”, VKM nr. 268, datë 24.4.2003, “Për çertifikimin e specialistëve, për vlerësimin e ndikimit në mjedis dhe auditimin mjedisor”, i cili është shfuqizuar prej VKM nr.1124, datë 30.7.2008, “Për miratimin e rregullave, të procedurave dhe kriterëve për pajisjen me çertifikatën e specialistit për vlerësimin e ndikimit në mjedis dhe auditimin mjedisor”. Ndërsa në lidhje me pjesëmarrjen e publikut në vendimmarrjen mjedisore, rregullat dhe procedurat parashikohen në VKM nr. 994, datë 2.7.2008, “Për tërheqjen e mendimit të publikut në vendimmarrje për mjedisin”, duke zbatuar kështu edhe dispozitat e Konventës së Aarhusit, gjithashtu pjesë e rendit tonë të brendshëm juridik. Së fundmi, u miratua edhe VKM nr. 247, datë 30.4.2014, “Për përcaktimin e rregullave, të kërkesave e të procedurave për informimin dhe përfshirjen e publikut në vendimmarrjen mjedisore”, e cila përveç sa përmendet në titull, përcakton edhe afate strikte për ndjekjen e procedurave për përfshirjen e publikut në vendimmarrjen mjedisore. Kështu, që në fillim sanksionohet se AKM, brenda 5 ditëve nga data e marrjes së aplikimit për procedurën paraprake të VNM, publikon në faqen e saj të internetit për 20 ditë rresht, informacionin e plotë për projektin, siç është paraqitur nga zhvilluesi. Ajo duhet të sqarojë publikun për procedurën që do zbatohet dhe afatin e parashikuar të marrjes së vendimit e të publikimit të tij në faqen e saj të internetit, mënyrën dhe afatin kohor të dhënies së mendimeve të publikut përpara marrjes së vendimit, si edhe mënyrën dhe afatin e ankimit ndaj vendimit. Ndërsa vetë procedura e VNM është parashikuar në VKM nr. 13, datë 4.1.2013, “Për miratimin e rregullave, të përgjegjësive e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis”, duke e përafuar kështu me Direktivën nr. 92/2011/EEC, “Për vlerësimin e efekteve që shkaktohen në mjedis nga aktivitetet private dhe publike”.

Pavarësisht kësaj baze ligjore të konsiderueshme, ekzistojnë mangësi në legjislacion që duhen plotësuar. Kështu p.sh., nga sa më sipër, del se nuk ekziston një procedurë e unifikuar, i ashtuquajtur “shërbim në një sportel”, i cili do të mundësonte administratën mjedisore të merrte vendimin mbi bazën e informacionit që disponon ajo vetë, duke bërë pamundësuar kryerjen e disa vlerësimeve të koordinuara, siç edhe kërkohet prej Direktivës për VNM. Një tjetër boshllëk ligjor që duhet plotësuar është edhe pamundësia për të penguar “copëzimin” e projekteve të mëdhenj, në mënyrë që të paraqiten si disa projekte më të vegjël, që të shmangin procedurën e VNM.

5.3 Legjislacioni shqiptar për mbrojtjen e biodiversitetit.

Edhe pse Shqipëria është ndër vendet më të vegjël të Evropës, veçoritë klimatike, pozicioni gjeografik, relievi dhe faktorët hidrologjikë dhe gjeologjikë të saj favorizojnë një zhvillim mjaft të madh të biodiversitetit. Habitatet e saj natyrore ofrojnë kushte për ekzistencën e rreth 3200 lloje bimësh të larta (30% të florës evropiane) dhe të 756 llojeve të rruazorëve.³¹⁵

Por fatkeqësisht, dëmet e shkaktuara në biodiversitet janë të shumta, ku mund të përmendet humbja e copëzimi i habitateve, dëmtimi, varfërimi dhe degradimi i ekosistemeve dhe i habitateve, shfarosja e kafshëve të egra në habitatet e tyre natyrore, etj. Ritmi i humbjeve të biodiversitetit në Shqipëri në këto 50 vitet e fundit mendohet të jetë nga më të lartët në Evropë. Dëme janë shkaktuar edhe nga grumbullimi intensiv i bimëve mjekësore, ku Shqipëria zë vendin e dytë në Evropë për eksportin e tyre. Në Shqipëri janë identifikuar 91 specie të rrezikuara. Ekosistemet dhe habitatet më të rrezikuara në Shqipëri përfshijnë ato detare, bregdetare, grykëderdhjet e lumenjve, lagunat, liqenet bregdetare, livadhet dhe kullotat alpine, etj.

Si rrjedhojë e iniciativave të ndërmarra, zonat e mbrojtura përfshijnë sot 15.8% të territorit të vendit, me një sipërfaqe prej rreth 460.000 ha. Ndërsa në zonat Ramsar janë përfshirë liqenet e Shkodrës, të Prespës e të Butrintit dhe Laguna e Karavastasë. Megjithatë, ky rrjet kombëtar është ende tepër i vogël për të pasur një ndikim efektiv afatgjatë në mbrojtjen e biodiversitetit. Gjithashtu, niveli i mbrojtjes i arritur në shumë zona të mbrojtura nuk është as i përshtatshëm, dhe as i mjaftueshëm. Në shumë prej tyre janë mjaft të përhapura format e paligjshme të shfrytëzimit, si prerjet, gjuetia apo ndërtimet.

Për ruajtjen e biodiversitetit ka rëndësi të veçantë zgjerimi i zonave të mbrojtura, për të siguruar përfaqësimin e të gjitha llojeve të ekosistemeve në rrjetin e këtyre zonave, pasi ky është një prej elementëve kyç të një zhvillimi të qëndrueshëm. Strategjia dhe Plani i Veprimit për Biodiversitetin përbën dokumentin kryesor që përcakton qëllimet, objektivat dhe masat për ruajtjen e biodiversitetit në Shqipëri për periudhën 2000-2015. Politikat e kësaj strategjie përfshihen edhe në Strategjinë Ndërsektoriale të Mjedisit.³¹⁶ Zgjerimi dhe forcimi i rrjetit të

³¹⁵ Strategjia dhe Plani i Veprimit për Biodiversitetin. Gjetet në : http://www.mjedisi.gov.al/files/userfiles/Biodiversiteti/Albania_Strategjia_Plani_Veprimit-Biodiversitetit_Shqiperi_%281999%29_Raporti.pdf

³¹⁶ Strategjia Ndërsektoriale e Mjedisit gjendet në: http://www.mjedisi.gov.al/files/userfiles/Strategjia_Ndersektoriale_e_Mjedisit_2007.pdf

zonave të mbrojtura, si bazë për krijimin e Rrjetit Ekologjik të vendit dhe si pjesë e rrjetit evropian vlerësohet si një nga objektivat më të rëndësishëm të Planit të Veprimit të Biodiversitetit për Shqipërinë. Në këtë dokument, përcaktohet si objektiv vendosja në rrjetin e zonave të mbrojtura e 17% të territorit, duke i dhënë prioritet shpalljes së zonave të mbrojtura detare. Megjithatë, vetëm përcaktimi i zonave si “të mbrojtura”, pa marrë masat e duhura për të garantuar në praktikë këtë mbrojtje, duke siguruar infrastrukturën fizike dhe njerëzore për këtë qëllim, mbetet thjesht në kuadrin e veprimeve formale, për “përmirësimin” e statistikave.

Shqipëria është bërë palë në traktatet kryesore ndërkombëtare për mbrojtjen e biodiversitetit. Ajo ka aderuar në Konventën për Biodiversitetin dhe në Protokollin e saj të Kartagjenës për Biosigurinë, si edhe në Konventën e Ramsarit për Ligatinat me Rëndësi Ndërkombëtare Veçanërisht si Habitata të Shpendëve Ujorë, Konventën e Bernës për Ruajtjen e Florës dhe Faunës së Egër dhe Mjedisit Natyror të Evropës, Konventën për Tregtinë Ndërkombëtare të Specieve të Rrezikuara të Florës dhe Faunës së Egër (CITES), Konventën e Bonit për Ruajtjen e Specieve Shtegtuese të Kafshëve të Egra, Konventën për të Luftuar Shkretëtirëzimin, Konventën e Barcelonës për Mbrojtjen e Mjedisit Detar dhe Rajonit Bregdetar të Mesdheut, etj.

Konventa për Biodiversitetin kërkon prej palëve hartimin e strategjive dhe planeve për ruajtjen dhe përdorimin e qëndrueshëm të biodiversitetit, krijimin e një sistemi për zonat e mbrojtura ose zonat ku nevojitet marrja e masave të veçanta për ruajtjen e tij. Në zbatim të këtyre kërkesave, në vitin 2000 u miratua me VKM nr. 532, datë 5.10.2000, Strategjia dhe Plani Kombëtar i Veprimit për Mbrojtjen e Biodiversitetit, i cili përcaktoi autoritetet përgjegjëse për përmbushjen e detyrimeve të konventës, si edhe strukturat rajonale e vendore siç janë agjencitë rajonale të mjedisit, drejtorite rajonale të pyjeve, Inspektoratin e Mjedisit, etj.

Pas këtij vendimi, në vitin 2002 u miratua ligji nr. 8906, datë 6.6.2002, “Për zonat e mbrojtura” ndërsa në vitin 2006 u miratua edhe ligji i veçantë për mbrojtjen e biodiversitetit, nr. 9587, datë 20.7.2006, të dy të amenduar vitet e fundit, për t’u përfaqësuar me direktivat e BE të përmenduar më sipër. Në ta parashikohen masat që duhet të merren për zonat e mbrojtura, me synimin që në të ardhmen të jenë pjesë e rrjetit ekologjik Natura 2000. Për menaxhimin e habitateve natyrore dhe të habitateve të llojeve, parashikohet përzgjedhja e një liste të zonave me interes për komunitetin, duke identifikuar dukuritë e tipave të habitateve dhe llojet, në çdo rajon përkatës biogeografik, me qëllim propozimin Komisionit Evropian të listës së zonave të cilat strehojnë këta tipa habitatesh dhe llojesh. Për hartimin e listës kombëtare të zonave me interes për komunitetin, ligji i referohet VKM nr. 897, datë 21.12.2011, “Për miratimin e rregullave për përcaktimin e zonave të veçanta të ruajtjes”.

Pavarësisht parashikimit ligjor se brenda 7 vjetëve nga miratimi i ligjit, ministritë përgjegjëse për mjedisin dhe për bujqësinë, në bashkëpunim me organet e tjera shtetërore dhe vendore, me organizatat jofitimprurëse mjedisore dhe me persona juridikë dhe fizikë, duhet të hartojnë planet e menaxhimit, për të mbajtur apo rivendosur statusin e favorshëm të ruajtjes së ekosistemeve, habitateve a peizazheve të mbrojtura, të ekosistemeve, habitateve apo peizazheve veçanërisht të mbrojtura, si dhe të atyre të degraduara, sot janë hartuar një pjesë fare e vogël e këtyre planeve.

Bashkimi Evropian po mbështet rritjen e kapaciteteve të Ministrisë së Mjedisit për hartimin e ligjeve dhe zbatimin e legjislacionit kombëtar të mjedisit nëpërmjet projekteve të asistencës

teknike.³¹⁷ Aktualisht, janë duke u hartuar planet e menaxhimit për parqet në Liqenin e Pogradecit, Bredhin e Hotovës-Dangëlli, Malin e Tomorrit, dhe Korab-Koritnik. Po ashtu, ndihmesë e konsiderueshme po jepet edhe prej projekteve të IUCN, UNDP, Bashkëpunimit italian, etj., me planet e menaxhimit për parqet Shebenik-Jabllanicë, Bunë-Velipojë, Divjakë-Karavasta, si edhe të parkut të zonës detare Karaburun-Sazan.

Në kuadrin rajonal të Këshillit të Evropës, Shqipëria u bë palë në Konventën e Bernës për Ruajtjen e Florës dhe Faunës së Egër dhe Mjedisit Natyror të Evropës me ligjin nr.8294, datë 2.3.1998, i cili ratifikoi këtë konventë. Detyrimet e marra përsipër synojnë të sigurojnë ruajtjen e florës dhe faunës së egër, vendbanimet e tyre natyrale, veçanërisht speciet dhe vendstrehimet, përfshirë speciet shtegtare të kërcënuara nga zhdukja dhe ato të pambrojtura. Për realizimin e këtyre synimeve, është ngritur edhe rrjeti ekologjik “Emerald”, i cili u krijua në vitin 1998 nga Këshilli i Evropës. Palë në konventë është edhe vetë BE, kështu që në fakt, ky rrjet nuk është gjë tjetër veçse zgjerimi i rrjetit Natura 2000, për të përfshirë edhe zona nga shetet që nuk janë pjesë e BE, pasi me statusin e vëzhguesit në mbledhjet e Komitetit të Përhershëm të konventës janë edhe shtete afrikane, si Algjeria, Tunisia, Burkina Faso, Maroku, apo Senegali, ku këto tre të fundit po zbatojnë projekte pilot. Rrjeti Emerald bazohet në të njëjtat parime si edhe Natura 2000, e për këtë qëllim Shqipëria ka propozuar edhe futjen e disa zonave të saj në këtë rrjet, propozim i cili u pranua për renditjen e këtyre zonave si ‘zona kandidate’ në vitin 2011.³¹⁸

Nga ana tjetër, në përmbushje të detyrimeve të marra përsipër në kuadrin e Konventës për Biodiversitetin janë miratuar edhe një sërë ligjesh të tjerë, siç është ligji nr.9385, datë 4.5.2005, “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, ligji nr.9693, datë 19.3.2007, “Për fondin kullosor”, ligji nr. 10006, datë 23.10.2008, “Për mbrojtjen e faunës së egër”, ligji nr.10120, datë 23.04.2009, “Për mbrojtjen e fondit të bimëve mjekësore, eterovajore e tanifere natyrore”, ligji nr. 10253, datë 11.3.2010, “Për gjuetinë”, megjithëse për këtë të fundit, duke parë gjendjen katastrofale të shfarosjes së faunës së egër në vend, u miratua moratoriumi që ndaloi gjuetinë për 2 vjet. Kuadri ligjor është plotësuar vazhdimisht edhe me akte nënligjore, si VKM nr. 676, datë 20.12.2002, “Për shpalljen zonë e mbrojtur të monumenteve të natyrës shqiptare”, VKM nr. 266, datë 24.4.2003, “Për administratat e zonave të mbrojtura”, VKM nr. 267, datë 24.4.2003, “Për procedurat e propozimit dhe shpalljen e zonave të mbrojtura dhe buferike”, VKM nr. 804, datë 4.12.2003, Për miratimin e listës së specieve të florës shqiptare, që vihen në mbrojtje”, VKM Nr. 86, datë 11.2.2005, “Për Krijimin e Komiteteve të Menaxhimit të Zonave të Mbrojtura”, VKM nr. 84, datë 27.1.2009, “Për përcaktimin e kriterëve për ngritjen e rrjetit të inventarizimit dhe monitorimit të biodiversitetit”, VKM nr. 241, datë 6.3.2009, “Për miratimin e listës së llojeve të huaja e invazive dhe përcaktimin e procedurave për ndalimin dhe futjen e tyre në pikat doganore”, VKM nr. 4, datë 18.10.2013, “Për masat emergjente të ndërhyrjes mbrojtëse dhe rehabilituese në zonat me rëndësi kombëtare mjedisore”, etj.

³¹⁷ Instrumenti i Para-Aderimit (Instrument of Pre-Accession). Njëri prej projekteve të BE është SELEA, i cili mbështet Shqipërinë në krijimin e kushteve për zhvillim të qëndrueshëm nëpërmjet përafrimit të legjislacionit me *acquis communautaire*, forcimit të institucioneve mjedisore, konsolidimit të kapaciteteve të tyre për t’iu përshtatur një kuadri ligjor që evoluon. Informacion më i hollësishëm gjendet në:

http://eeas.europa.eu/delegations/albania/press_corner/all_news/news/2012/20120120_01_sq.htm

³¹⁸ Zonat kandidate nga Shqipëria për t’u pranuar në rrjetin “Emerald” gjenden në

<https://wed.coe.int/com.instranet.InstraServlet?command=com.instranet.CmdBlobGet&InstranetImage=1996948&SecMode=1&DocId=1773496&Usage=2>

Siç u përmend më sipër, për të mundësuar pjesëmarrjen e Shqipërisë në rrjetin ekologjik Natura 2000, nisma më e fundit ishte miratimi i ligjit nr. 68/2014, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9587, datë 20.7.2006, “Për mbrojtjen e biodiversitetit”, të ndryshuar, i cili është përafëruar me Direktivën e Këshillit 92/43/KEE, “Për ruajtjen e habitateve natyrore, të faunës dhe florës së egër” (Direktiva e Habitave), dhe miratimi i akteve nënligjore që përafrojnë shtojcat e saj dhe të Direktivës 2009/147/EC (Direktiva e Shpendëve). Ligji parashikon detyrimin e ministrisë përgjegjëse për mjedisin që në kuadër të rrjetit ekologjik Natura 2000, të përgatisë çdo 6 vjet raportin për zbatimin e masave të marra, i cili duhet të përfshijë veçanërisht masat ruajtëse, vlerësimin e ndikimit të tyre për ruajtjen e statusit të llojeve të habitateve natyrore dhe të llojeve të bimëve e kafshëve, si dhe rezultatet kryesore të mbikëqyrjes, raport i cili duhet bërë publik. Aktualisht, është duke u rishikuar Strategjia dhe Plani i Veprimit për Biodiversitetin, në mënyrë që të përditësohen masat që duhen marrë, në përputhje me kushtet ekzistuese.

Me ligjin nr. 8692, datë 16.11.2000, Shqipëria aderoi në Konventën e Bonit për Ruajtjen e Specieve Shtegtuëse të Kafshëve të Egra, si edhe është bërë palë në marrëveshjet e mëpasme për cetacetë (delfinët dhe balenat), lakuriqët e natës dhe për shpendët shtegtarë euroaziatikë. Në zbatim të angazhimeve të marra përsipër në kuadër të këtyre marrëveshjeve, janë hartuar disa plane të veçanta veprimi për mbrojtjen e pesë llojeve të rrezikuara të faunës, siç janë cetacetë, rrëqebulli, ariu i murrmë, karabullaku dhe gjeli i egër. Në vijim, është hartuar edhe Libri i Kuq, ku renditen të gjitha speciet e rrezikuara, kapja apo gjuetia e të cilave është e ndaluar. Për rregullimin e kësaj të fundit, u miratua edhe ligji nr. 10253, datë 11.3.2010, “Për gjuetinë”, i cili e vlerëson faunën e egër si pasuri kombëtare dhe shpall si objektiv menaxhimin e qëndrueshëm të gjuetisë dhe mosdëmtimin e llojeve të faunës së egër e të habitateve të tyre gjatë ushtrimit të saj. Megjithatë ligji përmban dispozita të hollësishme për programin kombëtar të zhvillimit të gjuetisë, zonat e gjuetisë dhe planet e menaxhimit të tyre, sezonin e gjuetisë, testimet dhe kërkesat për t'u pajisur me leje gjuetie, si edhe një sërë masash administrative në rast kundërvajtjesh, për fat të keq, për shkak të moszbatimit flagrant të dispozitave të këtij ligji në praktikë (siç ndodh rëndom në vendin tonë), lindi nevoja e miratimit të një moratoriumi që ndaloj në mënyrë absolute gjuetinë për dy vjet, duke synuar ndalimin e shfarosjes së faunës së egër në Shqipëri, e cila ka arritur në gjëndje kritike, pas disa vitesh abuzimesh të rënda dhe gjuetisë pa kriter.³¹⁹ Nga pikëpamja institucionale, organet përgjegjëse për sigurimin e zbatimit të legjislationit janë Ministria e Mjedisit, në veçanti Drejtoria e Biodiversitetit dhe Zonave të Mbrojtura dhe Drejtoria e Pyjeve, agjencitë rajonale të mjedisit, drejtoritë rajonale të pyjeve, dhe administratat e zonave të mbrojtura.

Në Konventën për Tregtinë Ndërkombëtare të Specieve të Rrezikuara të Florës dhe Faunës (CITES) Shqipëria aderoi me ligjin nr. 9021, datë 6.3.2003, në vijim të të cilit u miratua edhe ligji nr. 9867, datë 31.1.2008, “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për tregtimin ndërkufitar të llojeve të rrezikuara të faunës dhe të florës së egër”, për të vënë në zbatim dispozitat e konventës. Sipas parashikimeve të konventës, ligji i bashkëlidhen edhe 3 anekse: Aneksi 1, ku janë të listuara llojet e kërcënuara nga zhdukja, tregtimi i të cilave lejohet vetëm në rrethana të jashtëzakonshme; Aneksi 2, ku janë të listuara llojet jo detyrimisht të rrezikuara nga zhdukja, por për të cilat duhet kontrolluar tregtimi, për të garantuar mbijetesën e tyre; dhe Aneksi 3, ku janë të listuara llojet që mbrohen të paktën nga një shtet, i cili u ka kërkuar shteteve të tjera palë asistencë në kontrollin e tregtimit të tyre. Për sa i përket strukturave institucionale, ligji i

³¹⁹ Ligji nr. 7/2014, datë 30.1.2014, “Për shpalljen e moratoriumit të gjuetisë në Republikën e Shqipërisë”.

ndan ato në organe menaxhuese, shkencore dhe kontrolluese. Ai cakton ministrinë si autoritet menaxhues dhe si institucionin qendror përgjegjës për zbatimin e kërkesave të konventës, institucionet kërkimore-shkencore për faunën dhe për florën si autoritete shkencore, në rolin e këshilluesve të ministrisë, si edhe autoritetet pyjore, Inspektoratin e Peshkimit dhe doganat, në rolin e autoriteteve kontrolluese, në kuptim të konventës. Regjimi i kontrollit të zbatimit të dispozitave të konventës bazohet në detyrimin e pajisjes së subjekteve importuese dhe eksportuese të specieve të listuara në anekse me lejet përkatëse të lëshuara nga autoriteti shkencor, që duhen paraqitur në çdo rast para autoriteteve doganore. Për këto, vendi ynë harton një raport vjetor për gjendjen aktuale dhe një raport 2-vjeçar për plotësimin e masave ligjore, rregulluese dhe administrative në këtë fushë, të cilët i paraqiten sekretariatit të konventës.

Që në vitin 1996 Shqipëria u bë palë në Konventën e Ramsarit për Ligatinat me Rëndësi Ndërkombëtare Veçanërisht si Habitata të Shpendëve Ujorë. Aktualisht, janë shpallur tre zona të mbrojtura nga kjo konventë: Laguna e Karavastasë, Liqeni i Butrintit dhe Liqeni i Shkodrës, me synimin që të përfshihet edhe zona e liqeneve të Prespës. Në secilën prej tyre funksionojnë administratat përkatëse dhe komitetet e menaxhimit, që kanë hartuar planet e menaxhimit, në bashkëpunim me organet e qeverisjes vendore.

Në Konventën e Kombeve të Bashkuara për të Luftuar Shkretëtirëzimin (UNCCD), Shqipëria aderoi në vitin 2000, me miratimin e ligjit nr. 8556, datë 22.12.1999. Kërkesat e konventës përqendrohen kryesisht në mbrojtjen e tokës, e për këtë qëllim është hartuar edhe kuadri ligjor për administrimin dhe mbrojtjen e tokës, ku përfshihen ligji nr. 7501, datë 19.7.1991, “Për tokën”, ligji nr. 8752, datë 26.3.2001, “Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës, ligji Nr. 9244, datë 17.6.2004, “Për mbrojtjen e tokës bujqësore”, si edhe aktet nënligjore për zbatimin e tyre. Struktura institucionale e ngritur për zbatimin e dispozitave të konventës përfshin Ministrinë e Bujqësisë, Komitetin Shtetëror të Mbrojtjes së Tokës (KSHMT), Inspektoratin Shtetëror të Mbrojtjes së Tokës (ISHMT), këshillat e qarqeve dhe komisionet e mbrojtjes së tokës që funksionojnë pranë tyre, si edhe këshillat e komunave dhe bashkive. Përveç këtyre, një rol të rëndësishëm kanë edhe institucionet shkencore, siç është Instituti i Studimit të Tokave, veprimtaria e të cilit për monitorimin e cilësisë së tokës bujqësore përbën një nga aspektet e rëndësishme të monitorimit të mjedisit, për analizimin e të dhënave për erozionin e tokës, si edhe për gjendjen e fondit të tokës bujqësore dhe cilësinë e tij. Pavarësisht punës së bërë në këtë drejtim, mbrojtja e tokës në Shqipëri është në nivele të pamjaftueshme, po të mbajmë parasysh procesin masiv të ndërtimeve të paligjshme në tokat bujqësore, në kushtet kur Shqipëria nuk e ka një luks të tillë, pasi është e mbuluar në 2/3 e saj me male. Po të shtohet këtu edhe niveli i jashtëzakonshëm i erozionit, për shkak të shfarosjes së pyjeve, mbrojtja e tokës nuk ka gjasa që të jetë e suksesshme.

5.3.1 Mbrojtja e pyjeve në Shqipëri, në funksion të mbrojtjes së biodiversitetit.

Roli i pyjeve në ruajtjen e biodiversitetit është i pazëvendësueshëm. Statistikat tregojnë se pyjet zënë afro një milion hektarë ose rreth 36% të sipërfaqes totale të Shqipërisë. Me ndryshimet e ndodhura pas viteve 90’ dhe ecjen drejt ekonomisë së tregut, si në të gjithë sektorët ekonomikë të vendit, edhe në sektorin e pyjeve, erdhën duke u plotësuar politikatat dhe kuadri ligjor mbi

ekonominë pyjore dhe mjedisin në tërësi. Mund të përmenden këtu ligji për pyjet, i ndryshuar disa herë, ligji për bimët mjekësore, ligji për qeverisjen vendore, ligji për pronat publike, ligji për transferimin e tyre, etj.

Duke iu referuar dispozitave të Traktatit të BE, mbrojtja e pyjeve nuk bën pjesë në fushat që janë kompetencë e Bashkimit, kështu që shtetet anëtare nuk janë të detyruara të ndjekin të njëjtën linjë veprimi, duke e lënë menaxhimin e pyjeve në duart e secilit prej tyre. Përafrimi i politikave pyjore është tentuar të arrihet përmes koordinimit të politikave të përbashkëta të sektorëve të tjerë, si ato mbi mjedisin, energjinë, bujqësinë, industrinë, tregtinë, etj. Kjo çoi kritikët në debate që konsistonin në pamundësinë për të pasur një linjë të përbashkët veprimi mbi pyjet, për shkak të shpërndarjes në kaq shumë sektorë brenda BE.

Nga ana tjetër, të gjitha shtetet anëtare të BE, ashtu si dhe vetë Bashkimi si organizatë ndërkombëtare, janë palë në Konferencën Ministrore për Mbrojtjen e Pyjeve në Evropë (MCPFE), e cila përfshin të gjitha shtetet e tjera evropiane dhe është organizmi përgjegjës për zhvillimin e strategjive të përbashkëta përsa i përket pylltarisë në kontinentin evropian. Ishte pikërisht në Konferencën Ministrore të mbajtur në Oslo të Norvegjisë, në qershor të vitit 2011, ku ministrat përgjegjës për pyjet morën vendimin e rëndësishëm për të nënshkruar mandatin e zhvillimit të bisedimeve për hartimin e një marrëveshjeje me fuqi detyruese mbi pyjet në Evropë.

Bashkimi Evropian, si një entitet i veçantë i së drejtës ndërkombëtare, është palë e Konventës për Biodiversitetin, Konventës Kuadër për Ndryshimet Klimatike dhe Konventës së Kombeve të Bashkuara për të Luftuar Shkretëtirëzimin. Pavarësisht copëzimit në gjirin e tij, BE ka ngritur mekanizma bashkëpunimi dhe koordinimi lidhur me pyjet, për çështje që sjellin pasoja përtej kufijve shtetërorë, ku përfshihen zjarret, sëmundjet në pyje dhe tregtimi i produkteve pyjore. Në kuadër të integritimit evropian, Shqipëria është bërë palë e dy mekanizmave të bashkëpunimit me BE përmes MSA dhe MCPFE, ndërsa në një kontekst më të gjerë, është pjesë e të gjitha konventave ndërkombëtare të sipërpërmendura.

Duke marrë parasysh rolin deciziv dhe shumëfunksional që pyjet luajnë në jetën e njerëzve, duke kontribuar në jetesën e tyre, efektin mbi klimën dhe tokën, si edhe funksionin sigurues të energjisë së qëndrueshme dhe lëndëve të para, një pjesë e legjislacionit mjedisor i kushtohet mbrojtjes së pyjeve. Një ndër aktet e para në këtë drejtim në legjislacionin komunitar ishte Strategjia e Pyjeve, e përcaktuar në Rezolutën 1999/C56/01 të Këshillit, datë 15.12.1998, “Për një strategji mbi pyjet në Bashkimin Evropian”, e cila u vijua nga Plani i Veprimit për Pyjet i BE. Shtyllat kryesore të Strategjisë së Pyjeve bazohen në menaxhimin e qëndrueshëm të pyjeve, zbatimin e parimit të subsidiaritetit, mbrojtjen e trashëgimisë së pyjeve dhe biodiversitetit, si edhe rritjen e efikasitetit në komunikimin, koordinimin dhe bashkëpunimin e shteteve anëtare. Në kushtet e zgjerimit të BE, kjo strategji ritheksoi se pranimi i shteteve të reja mund të arrihej vetëm në respektim të mekanizmave të krijuar për zhvillimin bujqësor dhe rural, ku përfshihen edhe pyjet.

Bazuar në këtë strategji veprimi, përmes Rregullores 1085/2006, datë 17.7.2006, Këshilli krijoi Instrumentin Para-Aderues (IPA) për shtetet kandidate, i cili fokusohet në adoptimin dhe implementimin e plotë të *acquis communautaire* dhe të politikave të përbashkëta bujqësore të

Komunitetit. Shqipëria është ndër shtetet që përfitojnë nga IPA, së bashku me Turqinë dhe vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor.

Që prej nënshkrimit të MSA, Shqipëria ka ndërmarrë një sërë reformash të rëndësishme përsa i përket sektorit të pyjeve, me qëllim përafrimin e politikave dhe legjislacionit të brendshëm me *acquis communautaire*. Si rrjedhojë e përpjekjeve për t'u çliruar nga pasojat e praktikave të shkuara, aktualisht ka një sërë strategjish të vëna në veprim dhe vazhdueshmëri të procesit të përafrimit. Sifoqoftë, procesi në tërësi nuk ka qënë pa të meta dhe është e pashmangshme nevoja e marrjes së masave të tjera, në mënyrë që të përballohen sfidat në rritje lidhur me mjedisin, e në veçanti ato në lidhje me pyjet. Përpos arritjeve dhe zhvillimeve pozitive, vazhdojnë të jenë ekzistente probleme si prerja e paligjshme e pyjeve, dëmtime masive nga zjarret në pyje, kullotja mbi normat e lejueshme dhe erozioni, të cilat sjellin degradimin e mëtejshëm të pyjeve. Informaliteti i lartë në ekonominë shqiptare përfshin edhe sektorin pyjor. Në pjesën më të madhe, përveç problemeve të trashëguara nga regjimi i kaluar, situata e tanishme, përveç faktorëve të tjerë, është pjesërisht edhe pasojë e mungesës së politikave dhe të një sistemi ligjor të përshtatshëm, mungesës së titujve të qartë të pronësisë dhe të moszbatimit të legjislacionit aktual.

Duke vepruar konform detyrimeve të marra në kuadrin e procesit të Stabilizimit dhe Asociimit, të Strategjisë Evropiane për Pyjet dhe Strategjisë Mbarë-Evropiane të Diversitetit Biologjik dhe të Peizazheve, Shqipëria ka miratuar në vitin 2003 Strategjinë Kombëtare të Pyjeve dhe Kullotave, e cila përcakton linjat kryesore të veprimit për 25 vitet e ardhshme, duke formuar kështu edhe një plan veprimi për dekadën në vijim. Mes objektivave të deklaruar renditen ruajtja dhe rivendosja e ekuilibrave natyrorë të burimeve pyjore, administrimi i qëndrueshëm i produkteve të tyre, sigurimi i kontributit sa më optimal të këtij sektori në zhvillimin ekonomik, lufta kundër varfërisë dhe zhvillimi i qëndrueshëm i vendit.

Në tërësi, një pjesë e direktivave të BE janë përafruar në legjislacionin e brendshëm, por gjithësesi, disa aspekte të rëndësishme nuk janë përfshirë në ligjin nr. 9385, datë 4.5.2005, "Për pyjet dhe shërbimin pyjor". Si privatizimi i pyjeve, ashtu edhe shitja e produkteve të përftuara nga to, janë të ndaluara. Gjithashtu, edhe procesi i kthimit të tokave pyjore ish-pronarëve po ecën me ritme të ngadalta, pa ndonjë afat përfundimtar të përcaktuar. Rrjedhimisht, shfaqet nevoja e rishikimit të Strategjisë për Pyjet dhe përfshirja e këtyre aspekteve të rëndësishme në një strategji të re.

Rregullorja 3528/86, datë 17.11.1986, e Këshillit të BE, e amenduar në vitet pasuese 1989, 1992 e 1997, fokusohet në mbrojtjen e pyjeve, duke krijuar një skemë monitorimi për dëmet e ardhura nga ndotja atmosferike. Me qëllim përfundimtar sigurimin e produktivitetit të tokave bujqësore, është e qartë varësia ndaj pyjeve, duke marrë parasysh mbrojtjen që pyjet u ofrojnë këtyre tokave. Përmes caktimit nga të gjithë shtetet anëtare të një numri të caktuar zonash monitorimi, synohet krijimi i një rrjeti të tillë, që përmes vëzhgimeve të vazhdueshme të mbahet një bilanc i dëmit aktual që u shkaktohet pyjeve nga ndotja atmosferike. Rezultatet e nxjerra vihen në përdorim të shteteve anëtare për të hartuar raporte mbi gjendjen e pyjeve, duke përdorur metoda të njëjta shkencore, për t'iu paraqitur më pas Komisionit Evropian për vlerësim.

Këto aspekte janë përfshirë gjithashtu në ligjin e mësipërm për pyjet, ku monitorimi është kryer nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit dhe drejtoritë rajonale të shërbimit pyjor. Nëpër të gjithë vendin janë ngritur një sërë parcelash monitorimi, por gjithësesi, numri i tyre dhe shpeshtësia e monitorimit, së bashku me aparaturat e vëna në dispozicion, janë të pamjaftueshme, e ç'është më e rëndësishmja, ka mungesë fondesh të nevojshme për parandalimin dhe eliminimin e dëmeve të shkaktuara ndaj pyjeve.

Përpos ndotjes atmosferike, një tjetër shkak i mjaft dëmeve në pyje është zjarri, që paraqitet si një pengesë serioze në zhvillimin e qëndrueshëm të tyre. Në kuadrin e masave të marra në luftën kundër këtij fenomeni negativ, Këshilli miratoi Rregulloren 2158/92, datë 23.7.1992, mbi mbrojtjen e pyjeve të Komunitetit nga zjarret, e cila u amendua nga Rregullorja 308/97, datë 17.2.1997. Synimi i kësaj rregulloreje ishte krijimi i një skeme për mbrojtjen e pyjeve nga zjarri, duke përfshirë edhe hartimin e një sistemi të dhënash për shtetet anëtare dhe për Komunitetin, në mënyrë që të arrihet reduktimi i zjarreve në pyje dhe zonave të prekura nga to. Skema përfshin gjithashtu edhe masa për të identifikuar shkaqet e zjarreve në pyje, për përmirësimin e metodave të parandalimit dhe sistemeve monitoruese të pyjeve, etj. Për këtë qëllim, u krijua Sistemi Evropian i Informimit mbi Zjarret në Pyje (EFFIS),³²⁰ që është në shërbim jo vetëm të shteteve Evropiane, por edhe atyre fqinje, duke siguruar informacion mbi zjarret në pyje nëpër të gjithë Evropën.

Në Strategjinë Kombëtare për Menaxhimin e Zjarreve në Pyje dhe Kullota janë përfshirë edhe parimet e Rregullores 2158/92. Për shkak të rrezikut të lartë gjatë sezonit të verës, numri i mbikëqyrësve është rritur dhe janë ndërmarrë një sërë aktiviteteve për të rritur ndërgjegjësimin publik për mbrojtjen e pyjeve nga zjarri. Sidoqoftë, zjarret në pyje mbeten një problem serioz për shkak të pamjaftueshmërisë së infrastrukturës, pajisjeve të nevojshme dhe të fondeve. Shqipëria bën pjesë në zonën me rrezikshmëri të lartë të Mesdheut për zjarre, ku përveç shkaqeve natyrore, aktivitetet e njeriut e përkeqësojnë situatën. Veçanërisht zjarrvëniet mbeten një problem serioz për vendin. Gjatë thatësirave të stinës së verës, zjarrvëniet e qëllimshme prej barinjve për të pastruar zonën për krijimin e livadheve të reja, janë një fenomen i zakonshëm. Pavarësisht dispozitave ligjore që përcaktojnë ndëshkimet për zjarrvëniet e qëllimshme, në realitet rrallë jepen dënime të tilla për dëmet e shkaktuara në pyje. Legjislacioni shqiptar ka parashikuar sanksione penale për veprat e kryera në dëm të pyjeve, ku nenet 205 dhe 206 të Kodit Penal sanksionojnë që prerja apo dëmtimi i pyjeve pa leje apo në kohë dhe vende të ndaluara, kur vepra nuk përbën kundërvajtje administrative, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në një vit, ndërsa prerja e drurëve dekorativë dhe dëmtimi i lulishteve dhe parqeve nëpër qytete përbëjnë kundërvajtje penale dhe dënohen me gjobë. Duke patur parasysh gjendjen e rënduar të zjarreve në pyje, Kodit Penal iu shtua neni 206/a,³²¹ i cili parashikon se shkatërrimi apo dëmtimi me dashje, me pasoja të rënda materiale, i fondit pyjor, i fidanishtes pyjore, i grumbullit pyjor ose i çdo njësie të ngjashme me to, me zjarr, dënohet me burgim nga tre deri në pesë vjet dhe me gjobë nga 500.000 lekë deri në 1 milion lekë. Po kjo vepër, e kryer me qëllim ndryshimin e kategorisë dhe destinacionit të tokës, dënohet me burgim nga tre deri në dhjetë vjet dhe me gjobë nga 500.000 lekë deri në 1 milion lekë. Po kjo vepër, kur ka shkaktuar pasoja të rënda për pronën, shëndetin ose jetën e njerëzve apo shkakton dëme të rënda dhe të zgjatura në kohë ndaj mjedisit apo zonave të mbrojtura, dënohet me burgim nga pesë deri në

³²⁰ Informacion i hollësishëm për EFFIS gjendet në: <http://forest.jrc.ec.europa.eu/effis/>

³²¹ Shtuar me ligjin nr.10023, datë 27.11.2008, neni 22.

pesëmbëdhjetë vjet dhe me gjobë nga 1 milion lekë deri në 2 milionë lekë. Për krahasim, mund të përmendet fakti që neni 169§3 i kushtetutës turke parashikon që edhe në rastet e amnistive apo faljeve për veprat e tjera penale, këto nuk mund të jepen asnjëherë për veprat penale të kryera kundër pyjeve.³²² Pra, në Turqi mund të amnistohen apo falen edhe vrasësit, por jo dëmtuesit e pyjeve.

E lidhur ngushtësisht me mbrojtjen e pyjeve është edhe mbrojtja e florës dhe faunës e për këtë qëllim është miratuar edhe Direktiva e Habitaveve. Nisur nga nevoja për ruajtjen e biodiversitetit, kjo direktivë nxiti shtetet anëtare të marrin masa ekonomike dhe sociale për të rritur ruajtjen e habitaveve natyrore dhe të specieve. Siç u përmend më sipër, Direktiva e Habitaveve kërkon prej shteteve anëtare krijimin e një rrjeti zonash mbrojtjeje, duke përfshirë këtu edhe zona me mbrojtje të veçantë dhe miratimin e disa masave mbrojtëse që përfshijnë plane të veçanta administrimi për këto zona, të cilat duhet të integrohen më pas në plane të tjera zhvillimi, së bashku me masa të tjera administrative.

Të gjitha direktivat dhe rregulloret e sipërpërmendura, duke përfshirë Direktivën 409/79 të Këshillit mbi ruajtjen e shpendëve të egër, Direktivën 88/332/EEC të Këshillit për tregtimin e farave, dhe Rregulloren 2152/2003 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit për monitorimin e pyjeve, janë bërë pjesë e legjislacionit të brendshëm shqiptar përmes ligjit për pyjet dhe shërbimin pyjor.

Ndryshimet dhe plotësimet e bëra në vitin 2007 i shtuan një kapitull të tërë ligjit për pyjet, ku doli në pah detyrimi për krijimin e një sistemi monitorimi dhe të dhënash mbi pyjet, bazuar në direktivat e BE dhe sistemin e përdorur nga FAO lidhur me rolin e pyjeve në përthithjen e karbonit. Plotësimet iu referuan veçanërisht Protokollit të Kiotos, ku Ministria e Mjedisit është caktuar si autoriteti përgjegjës për monitorimin, llogaritjen dhe tregtimin e kuotave të karbonit. Aktualisht është duke u përgatitur një tjetër projektligj për pyjet, me qëllim sigurimin e bazës ligjore për zhvillimin e qëndrueshëm, ruajtjen, administrimin, dhe harmonizimin e sistemit informativ të pyjeve dhe kullotave.

Ligji për pyjet ka përafruar edhe Rregulloren 995/2010, datë 20.10.2010, të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, të ashtuquajturën “Rregullorja e Kujdesit të Duhur”, e cila cakton detyrime për operatorët që tregtojnë lëndë drusore dhe produkte të tij, në përmbushje Planit të Veprimit të BE për Zbatimin e Legjislacionit për Pyjet dhe Tregtinë (FLEGT). Qëllimi i rregullores është të parandalojë hyrjen në treg të lëndës drusore dhe nënprodukteve të përfutuara në mënyrë të jashtëligjshme. Ndikimi real i këtyre masave ligjore ka qënë minimal në Shqipëri, për shkak të korrupsionit edhe në radhët e autoriteteve që kanë për detyrë zbatimin e ligjit.

Jo vetëm në Shqipëri, administrata qendrore dhe vendore duhet të përballet me situatën e vështirë të zgjedhjes midis mbrojtjes së mjedisit në një zonë të caktuar apo zhvillimit ekonomik të kësaj zone. Në rastet e nevojës së implementimit të planeve të zhvillimit që kanë një interes të veçantë publik, edhe kur janë të dëmshme për këto sipërfaqe, direktiva parashikon mundësinë e caktimit të zonave të tjera të mbrojtura, në vendndodhje të ndryshme, në mënyrë që të kompensohet dëmi i shkaktuar në zonat që i janë nënshtruar planeve të zhvillimit. Rrjedhimisht, përmes detyrimit për të informuar Komisionin lidhur me masat e marra për të siguruar kompensimin e mësipërm,

³²² Kushtetuta turke gjendet në: https://www.constituteproject.org/constitution/Turkey_2011

vendet sigurojnë edhe ruajtjen e zbatimit koherent të Direktivës së Habitave për rrjetin Natura 2000.

Nëpër malet e larta shqiptare, gjenden ende pyje të virgjëra me vlera të paçmueshme për sa i përket biodiversitetit, bukurisë së peizazheve dhe monumenteve natyrore. Siç u përmend më sipër, në zbatim të parimeve të Natura 2000, kryesisht në këto zona janë krijuar me ligj ‘Zonat e Mbrojtura’, në të cilat është i ndaluar shfrytëzimi i lëndës drusore dhe në to mund të zhvillohen vetëm disa lloje veprimtarish, me detyrimin për të marrë leje të veçanta. Sidoqoftë, si në mjaft vende të tjera ish-komuniste, prerja e paligjshme e pyjeve mbetet një rrezik i madh në Shqipëri, duke shërbyer si një kërcënim i vazhdueshëm për pyjet dhe biodiversitetin, që ka çuar në shpyllëzime masive dhe degradim të mëtejshëm të tyre.

Në Shqipëri, rreth gjysma e popullsisë jeton në zona rurale, ku i vetmi burim energjie për ushqim dhe ngrohje është zjarri, e rrjedhimisht shumica e këtyre familjeve janë të varur nga pyjet. Ngjarjet e vitit 1997, që sollën cënimin e ligjit dhe të rendit publik në vend, patën pasoja shkatërruese edhe mbi pyjet, për shkak të rritjes së theksuar të sasisë së pyjeve të prera në mënyrë të paligjshme. Këto janë vlerësuar se arrijnë masën 500.000 m³ lëndë drusore vetëm për vitin 1997. Sot, kjo sasi është rreth 10.064 m³.³²³ Gjendja aktuale e pyjeve në Shqipëri është kaq e rëndë, sa në seancën e datës 11 dhjetor 2014, ministri i mjedisit i propozoi Kuvendit miratimin e një moratoriumi 10 vjeçar për pyjet, në mënyrë që t’i vihet fre shkatërrimit të mëtejshëm të tyre. Duket kontradiktore që ministri bën në parlament të tilla deklarata, ndërkohë që qeveria, anëtar i së cilës ai është, pak ditë para fjalës së ministrit në parlament, miratoi me vendimin nr. 845, datë 3.12.2014, heqjen nga fondi pyjor dhe kullor të një sipërfaqeje në Elbasan, për t’u përdorur për ushtrimin e aktivitetit minerar, për shfrytëzim guri gëlqeror dhe me vendimin nr. 825, datë 26.11.2014, miratoi heqjen nga fondi pyjor të sipërfaqeve të dy ekonomive pyjore në Dibër, për t’u përdorur për shfrytëzimin e mineralit të gips alabasterit.³²⁴

Në vendet e Evropës, pronësia private mbi pyjet shtrihet mbi rreth 50% të tyre. Në Shqipëri, përvoja tregon se pyjet private gëzojnë mbrojtje dhe menaxhim më të mirë se ato publike. Në këto kushte, legjislacioni duhet të lejojë decentralizimin e mëtejshëm të menaxhimit të pyjeve, duke kaluar pyjet publike në përdorim dhe pronësi të subjekteve që kanë qenë në përdorim të tyre, fshatrave dhe familjeve bujqësore që banojnë në to. Pronësia e fshatit mbi pyjet ka një traditë të gjerë zakonore në vend, e cila është e nevojshme të rivendoset përmes ligjit.

Ndër aspektet themelore të kuadrit ligjor mbi pyjet përmenden kalimi nga sistemi i ekonomisë së planifikuar e të centralizuar drejt ekonomisë së tregut, privatizimi i aktiviteteve prodhuese dhe shërbimeve në pyje, realizimi i kalimit të mbi 60% të sipërfaqes së pyjeve dhe 70% të sipërfaqes së kullotave në pronësi ose përdorim të komunave dhe bashkive. Gjatë procesit disaveçar të kalimit në pronësi ose përdorim është fituar një përvojë e mirë, pasi mjaft familje bujqësore janë

³²³ Regional Environmental Centre, “*Illegal Logging in South Eastern Europe*”, Raport Rajonal, Shtator 2010, fq. 38.

³²⁴ Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 845, datë 3.12.2014, Për heqjen nga fondi pyjor dhe kullor të sipërfaqes në ngastrat e ekonomisë pyjore “Zaranikë”, objekti “Gropat e Borës”, të rrethit Elbasan, që do të përdoret nga ahoqëria “Elbesa”, sh.p.k., për ushtrimin e aktivitetit minerar, për shfrytëzim guri gëlqeror dhe Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 825, datë 26.11.2014, Për heqjen nga fondi pyjor të sipërfaqes dhe volumit të ekonomive pyjore “Kastriot Sllovë” dhe “Deshat Maqellarë”, Dibër, që do të përdoren nga shoqëria “Heidorn & Binjaku”, sh.p.k., për shfrytëzimin e mineralit të gips Alabasterit, Fletorja Zyrtare nr. 190, datë 16.12.2014.

të njohura me procesin, megjithëse jo plotësisht, përdoruesit janë të interesuar për mbrojtjen dhe mbarështrimin e pyjeve dhe kullotave të tyre.

Në fakt, procesi i kalimit nuk mund të quhet i përfunduar në asnjë komunë ose bashki, pasi ende nuk janë njohur ligjërisht kufijtë midis komunave, fshatrave dhe pyjeve e kullotave të përdoruesve (aq më tepër në kushtet aktuale të reformës administrative territoriale), përdoruesit nuk kanë asnjë dokument që të vërtetojë të drejtat e tyre ekskluzive të përdorimit mbi atë pyll ose kullotë dhe këto nuk janë regjistruar në zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme. Po ashtu, mjaft probleme ekzistojnë në komunat ku procesi i kalimit u realizua brenda një kohe tepër të shkurtër dhe vetëm nga ana dokumentare, por edhe kjo jo e plotë.

Ende mbeten shqetësuese mjaft probleme që kanë të bëjnë me kuadrin ligjor në këtë fushë, i cili nuk është i qartë e i plotë dhe nuk ofron sigurinë juridike të nevojshme. Kryesore janë problemet që kanë të bëjnë me pronësinë në pyje dhe privatizimin e tyre, decentralizimin real dhe të zbatueshëm të qeverisjes së pasurive natyrore dhe legalizimin e informalitetit të hershëm në posedimin e pyjeve pranë fshatrave.

Nga analiza e kuadrit ligjor në pyje rezulton se dispozitat ligjore aktuale nuk lejojnë privatizimin e pyjeve, dhe as ekzistojnë orientime politike për ecjen drejt privatizimit të pyjeve që mbarështrihen nga shteti, komuna ose bashkia. Edhe pronësia mbi pyjet dhe kullotat komunale është lënë e paqartë dhe privatizimi i tyre i pacaktuar. Po ashtu, privatizimi i pasurive të tjera natyrore ende nuk ka filluar. Për më tepër, ka mospërputhje përkufizimesh për gjendje të njëjta të pasurive pyjore e kullimore: ‘në pronësi,’ ‘në pronësi ose në përdorim,’ për pyllin komunal, dhe ‘në administrim’ për kullotat. Ka një përqendrim kompetencash në organet e administratës qendrore edhe për çështje që mund t’i takojnë qeverisjes vendore, si p.sh. për heqjen nga fondi pyjor dhe ndryshimin e përdorimit të tokës, për dhënie e lejeve dhe gjobave të ndryshme, si edhe përqendrim kompetencash në Këshillin e Rregullimit të Territorit të Republikës së Shqipërisë, në Këshillin e Baseneve, Këshillin e Ujit, Këshillin e Turizmit, etj.

Nga ana tjetër, ekzistojnë mospërputhje e mbivendosje kompetencash midis disa ligjeve për administrimin dhe kadastrën e pyjeve dhe kullotave komunale, për kundërvajtjet, për gjobat dhe vjeljen e tyre, për vjeljen e tarifave dhe për lejet mjedisore. Në dispozitat ligjore nuk trajtohen plotësisht marrëdhëniet pronësore për pyjet midis qeverisë qendrore dhe njësisë të qeverisjes vendore, kriteret për kalimin nga një formë pronësie ose përdorimi në tjetrën, përfshirë pyjet e kullotat komunale, marrëdhëniet midis njësisë së qeverisjes vendore dhe përdoruesve (familje bujqësore dhe shoqatat), apo me shërbimin pyjor, si dhe me pronarët privatë. Mungojnë gjithashtu mjetet nxitëse e përfitimet direkte që do të kenë përdoruesit e shoqatat e tyre nga mirëqeverisja e pasurive natyrore, apo kushtet lehtësuese për përdorimin e pyjeve shtetërore nga zonat rurale për zbutjen e varfërisë.

Strategjia Ndërsektoriale e Mjedisit, në lidhje me mbrojtjen e pyjeve parashikon rehabilitimin e vazhdueshëm të tyre, organizimin e një kadastre pyjore moderne si bazë për ruajtjen e tërësisë së fondit pyjor, nxitjen e përdorimit të qëndrueshëm dhe multifunksional të burimeve pyjore dhe kullimore dhe vazhdimin e transferimit të së drejtës së përdorimit dhe të pronësisë të pyjeve dhe kullotave tek pushteti vendor. Pavarësisht parashikimeve ligjore, mbetet ende problematik realizimi i tyre në praktikë.

Për shkak të rolit vendimtar që pyjet luajnë në mbrojtjen e mjedisit, biodiversitetit, në lehtësimin e pasojave të ndryshimeve klimatike, e në ekonominë e vendit në tërësi, Shqipëria jo vetëm që duhet të vazhdojë rrugën e nisur për përafrimin e legjislacionit të brendshëm të këtij sektori me *acquis communautaire*, por edhe të sigurojë zbatimin në praktikë të tij, si e vetmja rrugë për të përmbushur me sukses procesin e integrimit në Bashkimin Evropian.

KREU VI

MBROJTJA E MJEDISIT NGA MBETJET

Njerëzimi e ka konsideruar planetin ku jeton, përveçse si një burim të pashtershëm të mirash materiale, edhe si një vend depozitimi gjigand të mbeturinave që rezultojnë në përfundim të aktiviteteve të ndryshme e të konsumit të përditshëm. Më parë, në kushtet e një popullsie shumë më të vogël në numër, me ritme shumë më të ulëta konsumi se sot e të një zhvillimi teknologjik jo kaq të avancuar, administrimi i mbetjeve nuk përbente ndonjë problem të veçantë. Por në kushtet e rritjes progresive të popullsisë e të zvogëlimit të hapësirave të lira, të rritjes së nivelit të industrializimit, të rritjes përherë e më të madhe të nivelit të prodhimit e të konsumit, e për rrjedhojë edhe të nivelit të krijimit të mbetjeve, administrimi i tyre sot përbën një problem të mprehtë. Edhe pse natyra ka ciklet e veta të rigjenerimit që mundësojnë riparimin e dëmeve që mund të pësojë, shkalla e sotme e ndikimit të njeriut mbi natyrën është e tillë që i tejkalon shumë herë mundësitë rigjeneruese të natyrës, pasi ciklet e zhvillimit njerëzor janë shumë herë më të shpejta se ciklet e rigjenerimit natyror. Kjo është quajtur periudha “*antropocene*”, ku ndikimi i njeriut është faktor tashmë përcaktues dhe në gjendje të ndryshojë edhe ciklet natyrore. Një njeriu të pajisur me një motosharrë i duhen disa minuta për të prerë një pemë që për t’u rritur i duhen disa dekada. Për të mos përmendur pastaj përdorimin e energjisë bërthamore, që ka potencial të shkatërrojë planetin disa herë.

Një ndër përkufizimet më të vështirë është ai i mbetjeve. Në vendimin e çështjes “*Erika*”, GJED mori në shqyrtim këtë përkufizim dhe theksoi se “...*hidrokarburet e derdhura aksidentalisht në det pas mbytjes së një anijeje, të përziera me ujë dhe sediment dhe që enden përgjatë brigjeve të një shteti, deri sa të nxirren në breg, konsiderohen si “mbetje” , në kuptim të Nenit 6 1(a) të Direktivës 75/442, kur nuk është më e mundur që të shfrytëzohen apo tregtohen pa u përpunuar më parë.*”³²⁵

Kur flitet për mbrojtjen e mjedisit nga mbetjet, duhet mbajtur parasysh që kjo nuk ka të bëjë thjesht me caktimin e rregullave sipas të cilave duhet bërë depozitimi i tyre në vendgrumbullimin përfundimtar. Menaxhimi i mbetjeve përfshin para së gjithash rregullimin e procesit të “prodhimit” të tyre, para se një produkt apo material i caktuar të konsiderohet mbetje, duke rritur efikasitetin e përdorimit të materialeve për një përdorim sa më të gjatë dhe efektiv të mundshëm. Pra, synimi kryesor është reduktimi sa më i madh i mundshëm i sasisë së mbetjeve. Së dyti, pasi mbetjet janë krijuar, menaxhimi përfshin shfrytëzimin e të gjitha mundësive për ripërdorimin e tyre. Për shembull, nëse mbajtëset e produkteve, ambalazhet, janë prej letre apo kartoni, ato mundet fare mirë të përdoren përsëri. Pas kësaj faze, duhen parë të gjitha mundësitë e riciklimit, që është në thelb ripërdorim, por pas një lloj përpunimi. Më tej, për mbetjet që nuk mund të riciklohen, duhet shfrytëzuar mundësia e nxjerrjes prej tyre të ndonjë elementi apo materiali të vlefshëm, apo edhe përfitimi i energjisë prej tyre, për shembull, nëpërmjet djegies, e quajtur faza e ‘rikuperimit’, e së fundmi, mbetet depozitimi përfundimtar i tyre. Përveç këtyre fazave, të drejtës ndërkombëtare mjedisore i duhet të rregullojë edhe transportin ndërkufitar të mbetjeve

³²⁵ Gyula Bándi, (red.), “*The Impact of ECJ Jurisprudence on Environmental Law*”, Akaprint Kft, 2009, fq. 22.

dhe tregtinë me to, ndërsa GJEDNJ e lidhi trajtimin e tyre me të drejtat e njeriut, në çështjen *Öneryıldız kundër Turqisë*, e cila do të analizohet me hollësi në vijim.

Për shkak të rritjes së popullsisë, zhvillimit ekonomik dhe industrializimit ka ndodhur një rritje eksponenciale në vëllimin dhe shumëllojshmërinë e mbetjeve që rrezikojnë mjedisin. Sipas Bankës Botërore, niveli aktual i prodhimit vetëm të mbetjeve të ngurta është 1.3 miliardë ton në vit dhe parashikimi është që të arrijë në rreth 2.2 miliardë ton në vitin 2025. Kjo do të thotë një rritje e konsiderueshme në ritmin e prodhimit të mbetjeve për frymë, nga 1.2 në 1.42 kg për person në ditë, në 15 vitet e ardhshëm. Sigurisht, që kjo është një mesatare për mbarë globin, pasi ka dallime të mëdha midis shteteve, ku gjysmën e të gjithë kësaj sasive e prodhojnë vetëm vendet e Organizatës për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD). Sipas vlerësimeve të Bankës Botërore, në vendet në zhvillim është e zakonshme që njësitë e qeverisjes vendore të shpenzojnë deri në 50% të buxheteve të tyre për menaxhimin e mbetjeve të ngurta. Kjo jo vetëm për mbetjet e prodhuara në vend, por edhe për mbetjet dhe substancat e rrezikshme të importuara.³²⁶

Kjo rritje eksponenciale e vëllimit të mbetjeve rrezikon shëndetin e njeriut dhe ekosistemet. Çdo vit prodhohen rreth 1.3 miliardë ton mbetje të ngurta, ndërsa dekompozimi i mbetjeve organike shkakton rreth 5% të gazeve serë. Përlllogaritet se rreth 10% e kësaj sasive transportohet me anije në vende të ndryshme. Për shkak të zhvillimit të teknologjisë dhe përhapjes masive të përdorimit të pajisjeve elektrike dhe elektronike, është rritur shumë vëllimi i pajisjeve që dalin jashtë përdorimit dhe hidhen si mbetje, por që kanë në përbërje të tyre substanca të rrezikshme, të cilat kërkojnë trajtim të veçantë. Nga ana tjetër, administrimi i mbetjeve ofron edhe mundësi të mëdha biznesi që mund të sjellin përfitime të jashtëzakonshme. Ripërdorimi i materialeve nëpërmjet riciklimit kursen burimet natyrore, duke i ruajtur kështu për brezat e ardhshëm. Sipas përlllogaritjeve, për çdo ton letër të ricikluar, kursehen 17 pemë. Ndërsa për çdo ton alumin, kursehen: 1.3 ton mbetje boksitesh, 15 m³ ujë për ftohje, 0.86 m³ ujë të përdorur pas procesit dhe 37 fuçi karburant, përveç shmangies së çlirimit të 2 ton CO₂ dhe 11 kg SO₂. Përveç anëve të tjera pozitive, riciklimi krijon edhe vende të reja pune. Vetëm në 3 vende, Brazil, Kinë dhe SHBA, në industrinë e riciklimit janë punësuar 12 milion njerëz. Seleksionimi i mbetjeve dhe përpunimi i mbetjeve të riciklueshme krijon 10 herë më tepër vende pune sesa thjesht hedhja e tyre në lëndfille apo djegia e tyre.³²⁷

6.1 Legjislacioni ndërkombëtar për mbrojtjen e mjedisit nga mbetjet.

Sipas përlllogaritjeve të Bankës Botërore, rreth 10% e sasisë totale të mbetjeve transportohet midis vende të ndryshme.³²⁸ Kjo sjell nevojën e rregullimit ndërkombëtar të administrimit të mbetjeve, e në mënyrë të veçantë, të mbetjeve të rrezikshme, siç janë kimikatet, mbetjet

³²⁶ World Bank: Waste Generation, Urban Development Series – Knowledge Papers, 2010, fq. 1. Gjetet në: <http://siteresources.worldbank.org/INTURBANDEVELOPMENT/Resources/336387-1334852610766/Chap3.pdf>

³²⁷ UNEP, “Towards a Green Economy: Waste - Investing in energy and resource efficiency”, 2011, fq. 290-291. Gjetet në: http://www.unep.org/greeneconomy/Portals/88/documents/ger/GER_8_Waste.pdf

³²⁸ *Supra.*, shënimi fundor nr. 326.

bërthamore, etj. Rrezikshmëria e tyre nuk lidhet vetëm me dëmtimin që mund të shkaktojnë gjatë përdorimit të tyre, por edhe me efektet dëmtuese potenciale afatgjata pas depozitimit të tyre. Të dyja industritë, si ajo kimike, ashtu edhe ajo bërthamore, zënë një pjesë të mirë të tregut në vendet e zhvilluara industriale.

Ndikimi në mjedis i kimikateve është i madh e i shumëanshëm, duke filluar që në ajrin që thithin njerëzit, në çarjen e shtresës së ozonit, në ujërat dhe në ekosistemet. Prandaj edhe në fakt trajtimi i mbetjeve nuk është i centralizuar, por është i shpërndarë në disa fusha të ndryshme dhe nuk ka edhe një institucion ndërkombëtar, apo as edhe ndonjë seksion të veçantë në organizatat ndërkombëtare që të merret posaçërisht me to.

Sëmundjet e lëkurës dhe helmimet për shkak të kimikateve janë rritur shumë. Ndërsa pasojat që vijnë prej materialeve bërthamore janë shumë herë më të rënda. Aksidentet e Çernobilit në Ukrainë në vitin 1986 dhe ai Fukushima në Japoni në vitin 2011 janë ilustrues të pasojave që vijnë qoftë edhe vetëm prej përdorimit të tyre për qëllime civile, për prodhimin e energjisë. Rreziqet kryesore që lidhen me përdorimin e energjisë bërthamore, që rezultojnë nga çështjet e pazgjidhura janë të shumëfishta, duke filluar që me transportin, depozitimin e tyre si edhe aksidentet që mund të shaktohen nga avaritë e mundshme gjatë funksionimit të impianteve bërthamore, siç ishte rasti i Çernobilit, apo katastrofat natyrore, siç ishte cunami në Fukushima. Edhe në kushtet e kontroleve të rrepta dhe teknologjisë jashtëzakonisht të përparuar, siç është rasti i Japonisë, nuk ka garanci që katastrofat mund të shmangen.

Substanca të tilla si plutoniumi që përdoret si në centralet ashtu edhe në armët bërthamore, mbeten të rrezikshme për mijëra vjet. Rreth 10,000 m³ mbetje të tilla prodhohen çdo vit nga centralet bërthamore të prodhimit të energjisë. Mbi një e treta e energjisë elektrike të prodhuar në centralet bërthamore sot në botë vjen prej plutoniumit. Si pasojë e testeve të armëve bërthamore në vitet 1950-1960, sot ka disa tonë plutonium në biosferë.³²⁹

Si rrjedhojë e këtyre zhvillimeve, gjatë dekadës së viteve '80 filluan të hartohen disa marrëveshje ndërkombëtare në formën e 'ligjit të butë'. Në 1985 FAO miratoi Kodin Ndërkombëtar të Sjelljes për Shpërndarjen dhe Përdorimin e Pesticideve, një nga dokumentet e parë vullnetarë për të rritur sigurinë ushqimore, për të mbrojtur shëndetin e njeriut dhe mjedisin. Më pas, kodi u amendua për të përfshirë edhe procedurën e Miratimit Paraprak mbi Bazën e Informacionit të vitit 1989 dhe përsëri në vitin 2002, për të bashkëlidhur edhe një shtojcë me referenca për politikën ndërkombëtare në lidhje me standardet moderne të menaxhimit të pesticideve. Ky instrument jo i detyrueshëm promovoi një numër standardesh sjelljeje për subjektet publike dhe private, në respekt të përdorimit dhe tregtisë së pesticideve.³³⁰

Me Vendimin 15/30 të Këshillit Qeverisës të vitit 1987, UNEP miratoi Udhëzimet e Londrës për Shkëmbimin e Informacionit mbi Kimikatet në Tregtinë Ndërkombëtare, të cilat u amenduan në vitin 1989. Këto dispozita u rekomandojnë shteteve importuese dhe eksportuese që të zbatojnë procedurën e informimit dhe dhënies së pëlqimit paraprak duke iu referuar regjistrin ndërkombëtar të kimikateve potencialisht toksike. Procedura vullnetare e informimit dhe dhënies

³²⁹ <http://www.world-nuclear.org/info/nuclear-fuel-cycle/fuel-recycling/plutonium/>

³³⁰ Kodi Ndërkombëtar i Sjelljes për Shpërndarjen dhe Përdorimin e Pesticideve gjendet në: <http://www.fao.org/docrep/018/a0220e/a0220e00.pdf>

së pëlqimit paraprak siç u vendos nga FAO dhe UNEP, u ndryshua fillimisht në ‘procedurën interim të informimit dhe të dhënies së pëlqimit paraprak’ nga Konferenca e të Plotfuqishmëve, por u shfuqizua si e tillë, me hyrjen në fuqi të Konventës së Roterdamit në vitin 2006.³³¹

Konferenca e Stokholmit nuk e trajtoi çështjen e mbetjeve, por Parimi 6 i Deklaratës së Stokholmit bëri thirrje që të ndalohej hedhja në mjedis e substancave toksike dhe substancave të tjera, si edhe çlirimi i nxehtësisë në sasi apo përqendrime të tilla që tejkalojnë kapacitetin e mjedisit për t’i bërë ato të padëmshme, për të siguruar që të mos shkaktohen dëme serioze ose të pandreqshme ndaj ekosistemeve. Karta Botërore e Natyrës (Rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme të OKB A/RES/37/7, datë 28.10.1982), në Kapitullin II, pika 12, parashikon që hedhja e ndotësve në sistemet natyrore duhet të shmanget dhe kur kjo nuk është e mundur, ndotësit duhet të trajtohen në burim, duke përdorur mënyrat më të mira praktikisht të mundshme që janë në dispozicion dhe duhen marrë masa paraprake për të parandaluar hedhjen e mbetjeve radioaktive ose toksike. Ndërsa në Seksionin II të Axhendës 21, pikat 19-22 u kushtohen administrimit të duhur mjedisor të kimikateve toksike, mbetjeve të rrezikshme, mbetjeve të ngurta dhe ujërave të zeza, mbetjeve radioaktive dhe parandalimit të trafikut të paligjshëm të produkteve toksike dhe të rrezikshme. Ndërsa Parimi 14 i Deklaratës së Rios parashikon që shtetet duhet të bashkëpunojnë me efektivitet për të dekurajuar dhe parandaluar zhvendosjen dhe transferimin për në shtetet e tjerë të aktiviteteve dhe substancave që shkaktojnë degradim të rëndë të mjedisit ose që janë të dëmshme për shëndetin e njeriut.³³²

Në lidhje me këtë të fundit, në vitin 1989 ishte hartuar Konventa e Bazelit mbi Kontrollin e Lëvizjes Ndërkufitare të Mbetjeve të Rrezikshme dhe Groposjen e Tyre, e cila vuri theksin mbi përgjegjësinë e përbashkët të shteteve eksportuese dhe atyre importuese për zgjidhjen e problemit të menaxhimit të mbetjeve në një mënyrë të përshtatshme për mjedisin. Ajo u hartua si rrjedhojë e reagimit të fuqishëm publik pas zbulimit të fakteve tronditëse në vitet ’80, se në Afrikë dhe në vende të tjera në zhvillim ishin depozituar sasi të mëdha mbetjesh toksike prej vendeve të zhvilluara. Me hyrjen në fuqi në 1992, konventa vendosi një ndalim të pjesshëm të lëvizjes ndërkufitare të mbetjeve, në mënyrë të veçantë drejt vendeve në zhvillim. Për këtë qëllim, kërkohet pëlqimi paraprak i shprehur nga shtetet importuese.

Por, Konventa e Bazelit e ndalon vetëm pjesërisht lëvizjen ndërkombëtare të mbetjeve. Vendet afrikane, së bashku me vende të tjera në zhvillim dhe organizata ndërkombëtare e kritikuan konventën prej fillimit, më tepër si legjitimuese të tregtisë së mbetjeve të rrezikshme, sesa si parandaluese të saj. Më së fundi, në vitin 1994 një koalicion vendesh në zhvillim dhe disa vende evropiane, të mbështetura nga OJF mjedisore *Greenpeace*, mundën të bindin autoritetet drejtuese që të miratonin me konsensus vendimin që ndalonte transportin e mbetjeve nga vendet anëtare të OECD, në vendet jo anëtare. Pas miratimit të këtij vendimi, u argumentua gjithësesi se ky nuk ishte ligjërish i detyrueshëm, nëse konventa nuk amendohej. Pavarësisht kundërshtimit të SHBA, Koresë së Jugut, Australisë dhe Kanadasë, me konsensus u miratua një amendament në vitin 1995, i quajtur Amendamenti i Ndalimit, i cili vendoste një paragraf në preambul, një nen të ri (neni 4§a që përmban vendimin II/12), dhe një annex VII të ri. Sipas nenit 17§5 të konventës,

³³¹ Udhëzimet e Londrës për Shkëmbimin e Informacionit mbi Kimikatet në Tregtinë Ndërkombëtare gjenden në: <http://www.chem.unep.ch/ethics/english/longuien.htm>

³³² Philippe Sands, “*Principles of International Environmental Law*”, Cambridge University Press, Second Edition, 2003, fq. 676.

amendamentent e miratuara do të hyjnë në fuqi ndërmjet palëve që i kanë pranuar ato, 90 ditë pas ratifikimit, miratimit, ose pranimit, nga të paktën $\frac{3}{4}$ e palëve. Megjithatë, ky amendament nuk ka hyrë ende në fuqi, pasi është ratifikuar vetëm prej 79 shteteve, ndërkohë që është i domosdoshëm ratifikimi prej $\frac{3}{4}$ e 181 palëve që ka konventa, pra 135 shtete.³³³

Duke patur parasysh dallimin midis mbetjeve të rrezikshme dhe mbetjeve të tjera, ekziston nevoja për të sqaruar kuptimin e “rrezikshmërisë”. Për këtë qëllim është ngritur grupi teknik i punës. Konferenca e Palëve është përqendruar në çështjet e zbatimit të Konventës. Me këtë synim, ajo miratoi një mekanizëm pajtimi dhe një plan strategjik. Po ashtu, u miratua një deklaratë ministeriale partneriteti për përballimin e sfidës globale të mbetjeve, duke njohur menaxhimin ambientalisht të përshtatshëm të mbetjeve të rrezikshme, si pjesë përbërëse të çështjeve që kanë të bëjnë me mbrojtjen e ujit, higjienës, menaxhimin e mbetjeve të ngurta, dhe zhvillimin ekonomik dhe social. Kjo është në të njëjtën linjë me inkurajimin e përfshirë në nenin 11 të konventës, për përdorimin e marrëveshjeve rajonale dhe marrëveshjeve të tjera, me qëllim kontrollin ndërkombëtar të lëvizjes së mbetjeve. Në vitin 1999 u miratua një protokoll për detyrimet dhe kompensimin, i cili përcaktoi rregullat e detyrimeve dhe kompensimit për dëmtimet e shkaktuara nga derdhjet aksidentale të mbetjeve të rrezikshme gjatë eksportit, importit, ose sistemimit. Hyrja në fuqi e protokollit kërkon ratifikimin prej 20 palëve. Me një total prej 13 nënshkrimesh dhe 11 ratifikimesh,³³⁴ mbetet akoma rrugë për të bërë. Palëve u është bërë thirrje të vazhdojnë të konsultohen në nivel rajonal dhe kombëtar, me qëllim përcaktimin e mjeteve të mundshme për tejkalimin e pengesave për të ratifikuar protokollin.

Duke njohur në preambulën e saj të drejtën sovranë të shteteve për të ndaluar hyrjen ose sistemimin e mbetjeve dhe substancave të rrezikshme të huaja, i jepet përparësi sistemimit në mënyrë të përshatshme nga pikëpamja mjedisore të mbetjeve, në shtetin ku ato janë prodhuar. Duke njohur nevojën e kontrollit të rreptë të lëvizjeve ndërkombëtare të mbetjeve të rrezikshme dhe mbetjeve të tjera dhe shqetësimin për transportimin e paligjshëm ndërkombëtar të mbetjeve dhe substancave të rrezikshme, me hyrjen në fuqi të Konventës së Bazelit, sistemimi i mbetjeve në shtetet e tjera është i lejueshëm vetëm nëse nuk është i dëmshëm.

Mbeturinat e rrezikshme, sipas nenit 1 të konventës, përfshijnë në mënyrë të veçantë mbetjet e listuara në shtojcën 1, si edhe mbetjet e përcaktuara si të rrezikshme nga legjislacioni i brendshëm i palës eksportuese, importuese, ose i asaj tranzit. Përcaktime të tilla kombëtare të mbeturinave të rrezikshme duhet të komunikohen nëpërmjet sekretariatit të konventës.³³⁵ Detyrimet më të rëndësishme të palëve në konventë janë të parashikuara në nenin 4. Sipas paragrafit të parë të këtij neni, çdo palë kontraktore gëzon të drejtën të ndalojë importin e mbeturinave të rrezikshme ose mbeturinave të tjera për sistemim. Në një rast të tillë, palët e tjera duhet të njoftohen mbi këtë vendim. Pas një njoftimi të tillë, çdo palë e konventës duhet të ndalojë eksportimin e të tilla mbetjeve ndaj palës që ndalon importin. Në qoftë se nuk ka njoftim, pala eksportuese duhet të marrë miratimin me shkrim nga ana e palës importuese, ose të ndalojë eksportin e mbetjeve të rrezikshme. Sipas nenit 4§2, çdo shtet palë ka përgjegjësinë të garantojë

³³³ Informacion i datajuar për Konventën e Bazelit gjendet në:

<http://www.basel.int/TheConvention/Overview/tabid/1271/Default.aspx>

³³⁴ Statusi i ratifikimeve të Protokollit gjendet në:

<http://www.basel.int/Countries/StatusofRatifications/TheProtocol/tabid/1345/Default.aspx>

³³⁵ Neni 3.

se prodhimi i mbetjeve të rrezikshme dhe mbetjeve të tjera brenda territorit të tij, është reduktuar në minimum. Po ashtu, ajo duhet të garantojë që ka në dispozicion ndërtesa e mjete për një sistemim të përshtatshëm të tyre dhe se një lëvizje e tillë do të kryhet në mënyrë të tillë, që të mbrojnë mjedisin dhe shëndetin e njerëzve. Për më tepër, shteti i origjinës duhet të ndalojë eksportin, kur ka arsye të dyshojë se mbetjet në fjalë nuk do të menaxhohen në mënyrë të përshtatshme nga pikëpamja mjedisore nga ana e shtetit importues. Në mënyrë të ngjashme, shteti pritës duhet të parandalojë importin nëse ka dyshime të arsyeshme se mbetjet në fjalë nuk do të menaxhohen në mënyrë të përshtatshme. Siç parashikohet nga neni 4§3, palët në konventë e cilësojnë trafikun e paligjshëm të mbetjeve të rrezikshme ose mbetjeve të tjera si vepër penale, dhe bazuar në nenin 9§5, ato duhet të hartojnë legjislacionin e brendshëm të përshtatshëm për të parandaluar dhe ndëshkuar këtë trafik të paligjshëm. Eksportimi dhe importimi prej shteteve jo anëtare është i ndaluar.³³⁶

Në asnjë rast, detyrimi i konventës për shtetet prodhuese të mbetjeve, për të menaxhuar në mënyrë të përshtatshme mbetjet e rrezikshme dhe mbetjet e tjera, nuk transferohet në shtetet importuese apo ato tranzit.³³⁷ Në një kohë që neni 4 vendos një ndalim të pjesshëm për lëvizjen ndërkombëtare të mbetjeve, neni 6 fokusohet në detyrimin për të lajmëruar. Vetëm pas lajmërimeve nga pala eksportuese (ndaj të gjitha shteteve të interesuara, përfshirë sipas nenit 7 edhe shtetet jo anëtare) dhe një përgjigjeje të prerë, pranim me ose pa kushte, ose mohim, nga ana e palës importuese, mundet që pala eksportuese të lejojë lëvizjen ndërkombëtare të këtyre mbetjeve.³³⁸ Shtetet tranzit mund të përdorin të drejtën e tyre të miratimit paraprak, me shkrim. Në këtë rast, pala eksportuese mund të lejojë eksportin, nëse nuk ka një përgjigje nga pala tranzit brenda 60 ditëve nga marrja e njoftimit të dhënë nga shteti tranzit.³³⁹

Neni 8 i Konventës parashikon detyrimin për ri-importimin e mbetjeve, nëse lëvizja ndërkombëtare e mbetjeve nuk mund të kryhet në përputhje me kushtet e përcaktuara. Kjo zbatohet si ndaj palës eksportuese, ashtu edhe ndaj palës tranzit. Nëse konventa shkelet, lëvizja ndërkombëtare e mbetjeve konsiderohet si trafik i paligjshëm, në kuptim të nenit 9§1 të saj. Nëse sjellja e eksportuesit ka qënë shkak i trafikut të paligjshëm, vetë pala eksportuese duhet, nëse është e nevojshme, të marrë mbrapsht mbetjet. Nëse sjellja e importuesit të mbetjeve ka shkaktuar paligjshmërinë e lëvizjes, atëherë vetë pala importuese duhet, nëse është e nevojshme, të sistemojë mbetjet në mënyrë të përshtatshme.³⁴⁰

Sipas nenit 10§1 të konventës, palët duhet të bashkëpunojnë me njëra-tjetrën për të përmirësuar dhe arritur një menaxhim të përshtatshëm nga pikëpamja mjedisore. Siç parashikohet në nenin 12, palët kanë negociuar një protokoll që trajton detyrimin dhe kompensimin për dëmtimet si rezultat i lëvizjes ndërkombëtare dhe sistemimin e mbetjeve, i cili nuk ka hyrë akoma në fuqi. Sekretariati, i cili gjendet në Gjenevë, ka detyrimin për të siguruar zbatimin e konventës dhe promovimin e koordinimit dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet palëve.³⁴¹

³³⁶ Neni 4§5.

³³⁷ Neni 4§10.

³³⁸ Neni 6§1 – 6§3.

³³⁹ Neni 6§4.

³⁴⁰ Neni 9§2 dhe 9§3.

³⁴¹ Neni 16§1.

Edhe Konventa e Lomé-së për bashkëpunimin midis BE-së dhe organizatës Afrikë-Karaibe-Paqësor, e hartuar në vitin 1975, por e ndryshuar disa herë, deri sa u zëvendësua prej Marrëveshjes Cotonou³⁴² në 23 qeshor 2000, e ndryshuar edhe kjo në 25 qershor 2005, parashikonte ndalimin total të transportimit të mbetjeve midis tyre. Për shembull, neni 39 i Marrëveshjes Cotonou IV parashikonte që “...Komuniteti do të ndalojë të gjithë eksportet direkte ose indirekte të mbetjeve drejt vendeve të ACP dhe nga ana tjetër...këto vende do të ndalojnë të gjitha importet e këtyre mbetjeve në vendet e tyre.”³⁴³

Në vitin 1991 u miratua Konventa e Bamakos për Ndalimin e Importit në Afrikë dhe Kontrollin e Lëvizjes Ndërkufitare dhe Menaxhimit të Mbetjeve të Rrezikshme Brenda Afrikës, e cila ndalon importin e të gjitha mbetjeve të rrezikshme në Afrikë, nga vendet që nuk i përkasin Bashkimit Afrikan (BA), por lejon një lëvizje ndërkufitare të caktuar brenda Afrikës. Kjo konventë hyri në fuqi në 1998. Ajo u kërkon palëve që të marrin masa administrative e ligjore për të ndaluar importimin e mbetjeve të rrezikshme prej vendeve të tjera jo-palë dhe ta konsiderojnë atë si vepër penale. Nëpërmjet Sekretariatit të konventës, palët duhet të shkëmbejnë të gjithë informacionin mbi importet e paligjshme të mbetjeve të rrezikshme, të ndalojnë hedhjen e mbetjeve të rrezikshme në det, në ujërat e brendshme dhe në rrjedhat ujore. Shtetet eksportues, nëpërmjet autoriteteteve kombëtare të veta, duhet të njoftojnë ose t’i kërkojnë prodhuesit të mbetjeve ose eksportuesit të njoftojë më shkrim autoritetet kombëtare të importuesit për çdo transport të mundshëm ndërkufitar të mbetjeve të rrezikshme.³⁴⁴

Neni 4§3 thekson masat për reduktimin e prodhimit të mbetjeve të rrezikshme dhe parandalimin e ndotjes nga to brenda Afrikës. Për më tepër, dispozita parashikon një numër kërkesash për transportimin dhe lëvizjen ndërkombëtare të mbetjeve të rrezikshme brenda Afrikës. Përveç këtyre rregullave, konventa përfshin procedurën e informimit dhe të pëlqimit paraprak. Neni 6 kërkon lajmërimin nga shteti eksportues dhe përgjigjen nga shteti importues. Ai specifikon se eksportet nuk do të lejohen, derisa të ketë një miratim të shkruar nga shteti importues, dhe një konfirmim të shkruar të ekzistencës së kontratës midis eksportuesit dhe sistemuesit, duke specifikuar menaxhimin në mënyrë ambientalisht të përshtatshme të mbetjeve. Edhe nëse të gjitha shtetet palë kanë shprehur miratimin e tyre për lëvizjen ndërkombëtare të mbetjeve të rrezikshme, neni 8 parashikon detyrimin për të ri-importuar mbetjet, nëse lëvizja nuk mund të përfundojë në përputhje me kushtet e përcaktuara. Në rast të një trafiku të paligjshëm si pasojë e sjelljes nga ana e eksportuesit, shteti eksportues duhet të sigurohet se mbetjet në fjalë do të merren mbrapsht nga ai vetë, nëse është e nevojshme, brenda 30 ditëve të marrjes së informacionit të trafikut të paligjshëm. Nëse paligjshmëria e lëvizjes ka ardhur si pasojë e sjelljes së importuesit, shteti importues duhet t’ia rikthejë mbetjet eksportuesit.

Neni 10 parashikon që shtetet afrikane do të bashkëpunojnë për përmirësimin dhe arritjen e menaxhimit ambientalisht të përshtatshëm të mbetjeve të rrezikshme. Në rastin e një aksidenti gjatë transportit ndërkombëtar të mbetjeve të rrezikshme ose sistemimit të tyre, kur rrezikohet

³⁴² Tekstet e Konventës së Lomé-së dhe Marrëveshjes Cotonou gjenden në:

<http://ctrc.sice.oas.org/Trade/cotonou/Cotonou.asp>

³⁴³ Konventa Lomé IV gjendet në:

http://www.caricom.org/jsp/community_organs/epa_unit/Cotonou_Agreement_&_Lome4_lome4.pdf

³⁴⁴ Konventa e Bamakos gjendet në: <http://www.cetim.ch/en/documents/conv-bamako-ang.pdf>

dëmtimi i shëndetit të njerëzve, ose mjedisit të shteteve të tjera, palët kanë detyrimin e informimit të menjëhershëm të shteteve të interesuara.³⁴⁵

Konventa e Roterdamit për Procedurën e Dhënies së Pëlqimit Paraprak mbi Bazë Informacioni për Kimikatet dhe Pesticidet në Tregtinë Ndërkombëtare e vitit 1998 ishte traktati i parë shumëpalësh për substancat e rrezikshme me shtrirje globale. Ajo përcaktoi procedurën e dhënies së pëlqimit paraprak mbi bazën e informacionit, si mjeti kryesor për të mbrojtur mjedisin dhe shëndetin e njerëzve, kur tregtohen substanca të rrezikshme. Konventa hyri në fuqi në vitin 2004, por ndërkaq, po atë vit, Konferenca e parë e Palëve e amendoi përsëri konventën, duke shtuar edhe 14 kimikate të reja në shtojcën III të saj si edhe një shtojcë të re, numër VI, për arbitrazhin dhe pajtimin. FAO dhe UNEP ushtrojnë bashkërisht funksionet e Sekretariatit të Konventës së Roterdamit.³⁴⁶

Konventa gjen zbatim për kimikatet e ndaluara apo rreptësisht të kufizuara dhe pesticidet tepër të rrezikshme. të cilat janë të përcaktuara në detaje nga neni 2 i saj. Ajo nuk gjen zbatim për substancat psikotrope dhe drogat narkotike, materialet radioaktive, armët kimike, preparatet farmaceutike, përfshirë medikamentet njerëzore dhe veterinare, kimikatet e përdorur si përbërës të shtuar të ushqimeve, dhe kimikatet në sasi të vogla, të cilat nuk kanë mundësi të ndikojnë në shëndetin e njeriut apo në mjedis dhe që importohen për qëllime kërkimi ose analizash, ose nga një individ për përdorim personal.³⁴⁷

Sipas nenit 1, konventa kërkon të promovojë përgjegjësinë e përbashkët dhe përpjekjet e përbashkëta midis palëve në tregtinë ndërkombëtare të disa kimikateve të rrezikshme, për të mbrojtur shëndetin njerëzor dhe mjedisin nga dëmtimi i mundshëm dhe të kontribuojë në përdorimin në mënyrë të përshtatshme të kimikateve, jo vetëm duke lehtësuar shkëmbimin e informacionit, por gjithashtu duke mundësuar një proces kombëtar vendimmarrës në lidhje me importin dhe eksportin. Ajo cakton procedurat për kimikatet e ndaluara apo rreptësisht të kufizuara dhe pesticidet tepër të rrezikshme dhe parashikon që Konferenca e Palëve merr vendimet për përfshirjen e tyre në Shtojcën III. Nga ana e tyre, të gjitha palët duhet të njoftojnë Sekretariatin për çdo vendim të tyre të brendshëm në lidhje me importin dhe eksportin e kimikateve, të cilave Organizata Botërore e Doganave u cakton një kod specifik sipas Sistemit të Harmonizuar të kodeve të doganave. Pas caktimit të këtij kodi, të gjitha palët duhet të pajisin ngarkesat e tyre me këto kode kur ato eksportohen. Shumë i rëndësishëm është shkëmbimi i informacionit shkencor, teknik, ekonomik dhe ligjor në lidhje me kimikatet duke përfshirë edhe informacionin toksikologjik, eko-toksikologjik dhe atë mbi sigurinë. Palët duhet të marrin masa për të krijuar dhe forcuar institucionet dhe infrastrukturën kombëtare për zbatimin efektiv të konventës, ku përfshihen mbajtja e regjistrave kombëtarë dhe bazës së të dhënave me informacion për sigurinë e kimikateve, inkurajimi i iniciativave të industrisë për të promovuar sigurinë kimike dhe nxitjen e marrëveshjeve të vullnetshme për këto qëllime, si edhe shpërndarja e informacionit në publik, që ai të jetë i informuar mbi përdorimin e kimikateve dhe veprimet që duhen kryer në rast aksidentesh.

³⁴⁵ Neni 13§1.

³⁴⁶ Konventa e Roterdamit e vitit 1988, e ndryshuar në vitin 2004, gjendet në:
https://www.unido.org/fileadmin/user_media/Services/Environmental_Management/GUDDIS/Legal_Frameworks/rotterdam_convention.pdf

³⁴⁷ Neni 3§2.

Për të rritur transparencën, neni 5§1 i konventës kërkon që palët duhet të lajmërojnë sekretariatit për çdo veprim rregullator përfundimtar në lidhje me ndalimin ose kufizimin e kimikateve, jo më vonë se 90 ditë pas bërjes efektive të këtyre masave. Të dhënat e kërkuara si pjesë e këtij lajmërimi janë specifikuar në Shtojcën 1 të konventës. Informacioni i përmbledhur është i disponueshëm për palët pranë Sekretariatit, brenda një afati të caktuar kohor. Nëse një substancë e ndaluar ose rreptësisht e kufizuar eksportohet nga territori i një pale, kjo duhet të lajmërojë palën importuese. Lajmërimi i eksportit duhet të përfshijë informacionin e specifikuar në Shtojcën V. Lajmërimet të tilla duhet të dorëzohen para eksportit të parë, pas një ndalimi ose kufizimi të bërë. Kërkesa për lajmërim paraprak mund të hiqet nga autoritetet e palës importuese.³⁴⁸

Nenet 10 dhe 11 mund të konsiderohen dispozitat kryesore të konventës. Ato parashtrojnë procedurën e dhënies së pëlqimit paraprak, i cili gjen zbatim për të gjitha kimikatet e listuara në Shtojcën III. Çdo palë në momentin e hyrjes në fuqi të konventës merr përsipër detyrimin që të informojë sekretariatit dhe mundësisht të përcaktojë në çfarë shkalle ajo bie dakord që të importojë substancat e listuara në Shtojcën III. Nëse një palë nuk lejon importin ose nëse ajo e lejon atë vetëm në kushte të caktuara, këto duhet të zbatohen ndaj të gjithë imoprtëve pa dallim nga origjina e substancës dhe prodhimi i saj. Palët informohen nga Sekretariati për informacionin e marrë çdo 6 muaj. Çdo palë ka detyrimin që të marrë masa të përshtatshme administrative dhe legjislative për t'u siguruar që për eksportet brenda juridiksionit të vet të jepet çdo përgjigje ndaj shteteve importuese, jo më vonë se 6 muaj pas datës në të cilën Sekretariati informon për herë të parë palët. Nga ana tjetër, nëse në rrethana të jashtëzakonshme një palë importuese dështon në transmetimin e përgjigjes, palët e tjera duhet të garantojnë që kimikatet e listuara në Shtojcën III nuk do të eksportohen nga territoret e tyre në atë shtet.

Në lidhje me pesticidet, vlejnë edhe dispozitat e Konventës së Stokholmit për Ndotësit Organikë të Qëndrueshëm³⁴⁹ që është përmendur më sipër, e cila mban parasysh faktin që përbërës organikë të ndryshëm janë rezistentë ndaj dekompozimit natyral nëpërmjet proceseve kimike, biologjike dhe fotolitike. Kështu, duke mos u shpërbërë në mjedis, ato mund të transportohen në Distanca të Largëta dhe nëse akumulohen tek njerëzit dhe kafshët, ato mund të ndikojnë negativisht në zinxhirin ushqimor e të kenë efekte të dukshme në mjedis dhe në shëndetin e njeriut. Shembuj të tillë të Ndotësve Organikë të Qëndrueshëm (NOQ) janë pesticidet. Konventa e Stokholmit është bazuar në faktin që ekspozimi ndaj ndotësve organikë të qëndrueshëm (që nuk shpërbëhen), ka efekte serioze për shëndetin, ku përfshihen disa lloje kanceri, defekte në lindje, në sistemin riprodhues dhe atë imunitar, rezistencë më e ulët ndaj sëmundjeve, etj. Konventa sanksionon se asnjë qeveri nuk mund t'i përballojë e vetme këto kërcënime. Siç mund të kuptohet nga neni 1 i saj, duke qenë se objektivi i konventës është mbrojtja e mjedisit dhe shëndetit të njerëzve nga NOQ, ajo i referohet në mënyrë të shprehur parimit të parandalimit dhe Parimit 15 të Deklaratës së Rios. Për këtë qëllim, konventa kërkon që palët të miratojnë masa për të reduktuar ose eliminuar lëshimin e NOQ në mjedis nga prodhimi dhe përdorimi ndërkombëtar. Këto masa përfshijnë ndalimin, si edhe masa ligjore dhe administrative për eliminimin e përdorimit dhe prodhimit, importit dhe eksportit të kimikateve të specifikuara në Shtojcën A. Sipas nenit 3§1, kimikatet e listuara në Shtojcën B i nënshtrohen kufizimeve të ndryshme, më tepër sesa eliminimit të tyre. Për më tepër, neni 3§3 kërkon nga palët që të marrin masa për të

³⁴⁸ Neni 12 §1.

³⁴⁹ <http://chm.pops.int/default.aspx>

parandaluar prodhimin dhe përdorimin e pesticideve të reja ose kimikateve të reja industriale, të cilat shfaqin karakteristikat e NOQ.

Përveç ndalimit dhe kufizimit të prodhimit e përdorimit të NOQ dhe vendosjes së kufizimeve në eksportet dhe importet e tyre, konventa përfshin gjithashtu dispozita në lidhje me trajtimin e sigurt të stoqeve ekzistuese.³⁵⁰ Për këtë qëllim, grumbullimet e stoqeve duhet të identifikohen dhe menaxhohen në një mënyrë të përshtatshme për mjedisin. Konventa vendos bashkëpunimin me organet përkatëse të Konventës së Bazelit për të trajtuar ndër të tjera problemin e sistemit të grumbullimeve të stoqeve në mënyrë të përshtatshme për mjedisin. Në vazhdim të ndalimit të NOQ, konventa përfshin gjithashtu dispozita për reduktimin e emetimit të NOQ, si dioksinat dhe furinat. Neni 5 sanksionon qasjen parandaluese, duke iu kërkuar palëve që të zhvillojnë planet përkatëse të veprimit dhe të promovojnë përdorimin e teknikave më të mira të mundshme dhe praktikave më të mira mjedisore, duke shmangur prodhimin e NOQ.

Një tjetër traktat i hartuar në bazë të Konventës së Bazelit është Konventa e Waiganit për Ndalimin e Importit Drejt Forumit të Vendeve Ishullore të Mbetjeve të Rrezikshme dhe Radioaktive dhe për Kontrollin e Lëvizjes Ndërkufitare dhe Menaxhimin e Mbetjeve të Rrezikshme brenda Rajonit të Paqësorit Jugor. Ajo u miratua në vitin 1995 dhe hyri në fuqi në vitin 2001. Ky traktat shkon përtej Konventës së Bazelit, meqenëse mbulon edhe mbetjet radioaktive, si edhe zbatimin territorial i saj shtrihet përtej detit territorial, duke përfshirë edhe Zonën Ekonomike Ekskluzive.³⁵¹

Për nga natyra e tyre, materialet bërthamore janë tepër të rrezikshme dhe përdorimi i tyre duhet bërë sipas rregullave shumë të rrepta. Ndërsa standardet e sigurisë bërthamore janë miratuar tashmë nga Agjencia Ndërkombëtare e Energjisë Bërthamore (IAEA), agjenci e specializuar e OKB,³⁵² instrumentet ndërkombëtarë me forcë detyruese u hartuan gjatë viteve '90. Në to përfshihen Konventa e Sigurisë Bërthamore³⁵³ e vitit 1994, që hyri në fuqi në 1996, dhe Konventa e Përbashkët për Sigurinë e Menaxhimit të Karburantit të Përdorur dhe për Sigurinë e Menaxhimit të Mbetjeve Radioaktive³⁵⁴ e vitit 1997, e cila hyri në fuqi në vitin 2001. Për më tepër, shumë standarde të tjerë minimum në lidhje me transportimin ndërkombëtar të mallrave të rrezikshme mund të gjenden në instrumente jo të detyrueshme nga ana ligjore, si edhe në traktate që kanë në fokus transportin e tyre. Ato merren me identifikimin dhe paketimin e këtyre mallrave dh me standardet e sigurisë për mënyrat individuale të transportit të tyre. Transporti rrugor, hekurudhor, detar dhe ajror janë secili të mbuluar nga instrumente të krijuar nga organizatat ndërkombëtare të specializuara.

Objektivat e Konventës për Sigurinë Bërthamore përfshijnë arritjen dhe mbajtjen e një niveli të lartë të sigurisë bërthamore bazuar në masat kombëtare dhe bashkëpunimin ndërkombëtar. Këtu futen mbrojtja efektive e individëve dhe mjedisit në instalimet bërthamore kundër rreziqeve

³⁵⁰ Neni 6.

³⁵¹ Informacion i detajuar mbi Konventën e Waiganit gjendet në: <https://www.sprep.org/legal/waigani-convention>

³⁵² <http://www.iaea.org/>

³⁵³ Informacion i detajuar mbi Konventën e Sigurisë Bërthamore gjendet në:

<http://www.iaea.org/Publications/Documents/Conventions/nuclearsafety.html>

³⁵⁴ Informacion i detajuar mbi Konventën e Përbashkët për Sigurinë e Menaxhimit të Karburantit të Konsumuar dhe Sigurinë e Menaxhimit të Mbetjeve Radioaktive gjendet në:

<http://www.iaea.org/Publications/Documents/Conventions/jointconv.html>

radiologjike, parandalimi i aksidenteve me pasoja radiologjike dhe zbutja e këtyre pasojave. Konventa kryesisht angazhon palët të miratojnë masa kombëtare për të garantuar që siguria e instalimeve përthamë do të rishikohet sa më shpejt të jetë e mundur. Edhe pse preambula dhe neni 1 u referohen bashkëpunimit ndërkombëtar, vetëm neni 17 përfshin një referencë të shprehur ndaj këtij bashkëpunimi, duke përcaktuar se palët duhet të marrin masat përkatëse për t'u konsultuar në lidhje me afërsinë e një impianti bërthamor të propozuar, për aq sa ata kanë gjasa për t'u prekur nga impianti dhe në bazë të kërkesës, të mundësojnë informacionin e nevojshëm ndaj palëve kontraktuese, për t'u dhënë mundësinë për të bërë vlerësimet e duhura mbi ndikimin e mundshëm të impiantit bërthamor në territorin e tyre. Konventa është një traktat që synon më tepër të jetë një instrument shtysë dhe jo ndëshkues. Ajo është bazuar në interesin e përbashkët të palëve për të arritur nivele të larta sigurie për materialet bërthamore nëpërmjet takimeve të rregullta të palëve, jo nëpërmjet kontrolleve dhe sanksioneve. Ajo detyron palët të paraqesin raporte mbi përmbushjen e detyrimeve, të cilat shqyrtohen në takimet e palëve të organizuara prej IAEA. Ky mekanizëm është edhe risia kryesore që sjell konventa dhe elementi dinamik i saj.³⁵⁵

Konventa e Përbashkët për Sigurinë e Menaxhimit të Karburantit të Konsumuar dhe Sigurinë e Menaxhimit të Mbetjeve Radioaktive është traktati i parë ligjërish i detyrueshëm për trajtimin e mbetjeve radioaktive në nivel universal. Objektivat janë të ngjashëm me Konventën mbi Sigurinë Bërthamore, ofrimi i garancisë që gjatë gjithë fazave të menaxhimit të karburantit të shpenzuar dhe mbetjeve radioaktive merren masa mbrojtëse efektive kundër rreziqeve potenciale për mjedisin dhe jetën e njeriut, si edhe parandalimi i aksidenteve me pasoja radiologjike dhe zbutjen e tyre, nëse ndodhin. Palët janë nën detyrimin fillimisht të marrjes së masave kombëtare.³⁵⁶ Për më tepër, konventa përfshin detyrime procedurale që u kërkojnë palëve të konsiderojnë çështje që prekin sigurinë e shteteve fqinjë. Palët duhet, ndërmjet të tjerave, të zgjedhin në mënyrë të kujdesshme vendet për trajtimin e karburantit të konsumuar dhe sistemimin e mbetjeve radioaktive, si edhe të konsultohen me shtetet fqinje. Shtetet palë duhet të përgatisin planet e emergjencës përpara fillimit të operacionit në çdo objekt me të cilin ka lidhje kjo konventë. Neni 25§2 parashikon se çdo palë duhet të marrë masat përkatëse për përgatitjen dhe testimin e planeve të emergjencës në territorin e saj, për sa kohë që ka mundësi të ndikojë në një ngjarje të emergjencës radiologjike për menaxhimin e karburantit të konsumuar dhe mbetjeve radioaktive. Lajmërimi dhe përgjigja kërkohen për lëvizjen ndërkombëtare të mbetjeve radioaktive dhe të karburantit të konsumuar. Neni 27§2 ndalon në mënyrë të shprehur licencimin e çdo ngarkese me karburant të konsumuar ose mbetje radioaktive në një destinacion më në jug se gjerësia gjeografike 60 gradë për magazinim ose sistemim. Sipas nenit 27§1§iii, lëvizja ndërkombëtare e karburantit të konsumuar dhe mbetjeve radioaktive janë të lejueshme vetëm nëse vendi pritës ka kapacitetin teknik dhe administrativ si dhe strukturën rregullatore të nevojshme për të menaxhuar karburantin e konsumuar dhe mbetjet radioaktive në mënyrë të përshtatshme e në përputhje me dispozitat e konventës.

³⁵⁵ <http://www.iaea.org/Publications/Documents/Conventions/nuclearsafety.html>

³⁵⁶ Nenet 18-26.

6.2 Legjislacioni evropian për mbetjet.

Rregullat evropiane në lidhje me mbetjet janë zhvilluar masivisht pas vitit 1980, në kushtet e rritjes së lëvizjeve ndërkufitare të mbetjeve, veçanërisht në lidhje me eksportin e paligjshëm të mbetjeve nga vendet e zhvilluara, drejt vendeve në zhvillim. Në vitin 1984, Komuniteti Evropian miratoi Direktivën e Këshillit Nr. 84/631 EEC, për Mbikëqyrjen dhe Kontrollin brenda Komunitetit Evropian të Ngarkesave të Mbetjeve Brenda dhe Jashtë Komunitetit Evropian. Ajo u zëvendësua nga Rregullorja (EC) 1013/2006 e Parlamentit Evropian dhe Këshillit, e vitit 2006. Përveç aktivitetit të Bashkimit Evropian, Organizata për Bashkëpunimin Ekonomik dhe Zhvillimin (OECD) ka trajtuar gjithashtu problemin e importit dhe eksportit të mbetjeve që prej vitit 1984. Këto masa u konsoliduan në vitin 2001 dhe në vijim u rishikuan në vitet 2005 dhe 2008, në bazë të një vendimi të Këshillit të OECD për të zbatuar një sistem kontrolli mbi tregtinë e mbetjeve.

Akti kryesor mbi mbetjet në legjislacionin evropian është Direktiva 2008/98/EC, “Për mbetjet”, e quajtur Direktiva Kuadër për Mbetjet.³⁵⁷ Është quajtur si ‘direktivë kuadër’, pasi përveçse amendon direktivat e mëparshme për mbetjet, ajo integron në brendësi të saj edhe direktivat e mëparshme për mbetjet e rrezikshme dhe ato të vajrave, duke i shfuqizuar ato, me efekt prej vitit 2010. Që në preambulën e saj, direktiva përcakton se objektivi parësor i politikave mbi mbetjet është minimizimi i efekteve negative të krijimit dhe të administrimit të mbetjeve në shëndetin e njeriut dhe në mjedis, duke synuar uljen e nivelit të përdorimit të burimeve natyrore dhe klasifikimin hierarkik të mbetjeve në kategori të ndryshme. Klasifikimi hierarkik i mbetjeve përfshin: 1. Parandalimin e krijimit të tyre; 2. Përgatitjen për ripërdorim; 3. Riciklimin; 4. Rikuperimin; dhe 5. Asgjësimin, duke nxitur administrimin efektiv të tyre, nëpërmjet minimizimit sa të jetë e mundur të sasisë së mbetjeve të krijuara dhe të mundësimit të rikuperimit të vlerave maksimale nga mbetjet.

Direktiva bën edhe dallimin midis mbetjeve dhe nënprodukteve, si edhe midis mbetjeve dhe lëndëve të para dytësore, të cilat kanë ende mundësi përdorimi të mëtejshëm dhe që nuk mbulohen prej direktivës. Parimet që ajo sanksionon për administrimin e mbetjeve kanë të bëjnë në radhë të parë me mbrojtjen e shëndetit të njeriut dhe të mjedisit, në mënyrë që këta të mos cënohen prej aktiviteteve që kryhen gjatë procesit të administrimit të mbetjeve. Të gjitha këto aktivitete nuk duhet të rrezikojnë cilësinë e tokës, ajrit, ujit, shëndetin e kafshëve apo bimëve, nuk duhet të shkaktojnë shqetësime për shkak të erërave të këqija apo zhurmave, si edhe nuk duhet të dëmtojnë zonat rurale apo vendet historike. Në eventualitetin që ndodhin cënime të tilla, zbatohet parimi ‘ndotësi paguan’, si edhe parimi i përgjegjësisë së zgjeruar të prodhuesit, në kuptimin që prodhuesi detyrohet të pranojë mbetjet që rezultojnë prej përdorimit të produkteve si edhe administrimin e mëtejshëm të tyre, duke mbajtur edhe përgjegjësinë financiare për kryerjen e këtyre proceseve. Në këtë kuadër, masat që duhet të marrë prodhuesi duhet të përfshijnë edhe informimin e publikut mbi mundësinë e ripërdorimit apo riciklimit të produktit.³⁵⁸ Po ashtu, duhet të respektohen parimet e vetëmjaftueshmërisë dhe të afërsisë, parime që nënkuptojnë që shtetet anëtare duhet të marrin masat që prodhuesi fillestar të kryejë vetë trajtimin e mbetjeve,

³⁵⁷Direktiva Kuadër për Mbetjet gjendet në: <http://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:32008L0098&from=EN>

³⁵⁸ Neni 8 i Direktivës Kuadër për Mbetjet.

osë të sigurojë që ky proces të kryhet prej një entiteti tjetër ose një grumbullues mbetjesh, publik ose privat. Ata duhet të marrin masat e duhura për krijimin e rrjeteve të përshtatshme për asgjësimin e mbetjeve si edhe për rikuperimin prej mbetjeve të përzierra urbane, duke përdorur teknikat më të mira të mundshme (TMD) dhe në impiantet e trajtimit të mbetjeve më të afërta të mundshme, duke mbajtur parasysh edhe karakteristikat gjeografike të vendit. Në mënyrë të veçantë, shtetet duhet të sigurojnë administrimin e mbetjeve të rrezikshme në mënyrë të tillë që të mos çenohet shëndeti i njeriut dhe mjedisi, si edhe të garantojnë që mbetjet e rrezikshme të mos përzihen me mbetjet e tjera. Trajtimi i mbetjeve duhet të rregullohet nëpërmjet sistemit të licencave, të cilat duhet të jepen vetëm në rastet e plotësimit të të gjitha kërkesave të ligjit, mbi llojin dhe sasinë e mbetjeve që mund të trajtohen, mbi kapacitetet teknike, mbi masat e sigurisë dhe proceset e monitorimit dhe kontrollit të këtyre aktivitetëve.

Trajtimi i mbetjeve duhet bërë sipas planeve të administrimit të mbetjeve të hartuara prej autoriteteve kompetente, të cilat duhet të mbulojnë të gjithë territorin e shteteve. Këto plane duhet të përmbajnë një analizë të situatës aktuale në rajonin gjeografik përkatës, si edhe masat që duhen marrë për përmirësimin e situatës mjedisore, duke kryer përgatitjet për ripërdorimin, riciklimin, rikuperimin dhe asgjësimin e mbetjeve. Paralelisht, duhen hartuar edhe plane për parandalimin e krijimit të mbetjeve. I gjithë informacioni mbi këto plane duhet të bëhet i ditur për publikun, të cilit duhet t'i mundësohet pjesëmarrja në hartimin e tyre.

Direktiva parashikoi edhe dy objektiva ambiciozë për t'u arritur brenda vitit 2020, në lidhje me përgatitjen për ripërdorimin dhe riciklimin në masën 50% të mbetjeve urbane apo të ngjashme me to, si edhe përgatitjen për ripërdorimin, riciklimin dhe rikuperimin në masën 70% të mbetjeve prej aktivitetëve të ndërtimit dhe nga prishjet e ndërtesave. Asaj i bashkëlidhen edhe 4 shtojca mbi aktivitetet për asgjësimin dhe rikuperimin e mbetjeve, cilësitë që i bëjnë mbetjet të kategorizohen si të rrezikshme dhe masat e parandalimit të krijimit të mbetjeve.

Përveç Direktivës Kuadër, legjislacioni evropian për mbetjet përfshin edhe Vendimin e Komisionit 2000/532, për Listën e Mbetjeve, Rregulloren e Parlamentit Evropian dhe Këshillit 1013/2006, Direktivën 99/31/KE mbi lëndfillt³⁵⁹ e mbetjeve, Direktivën 75/439/KEE mbi heqjen e vajrave të mbetura, Direktivën 86/278/KEE mbi llumrat e kanalizimeve, Direktivën 94/62/KE mbi paketimin dhe paketimin e mbetjeve, Direktivën 96/59/KE mbi heqjen e PCB/PCT (poliklorinateve), Direktivën 2006/66/KE mbi bateritë dhe akumulatorët, Direktivën 2000/53/KE mbi makinat e nxjerra jashtë përdorimit, Direktivën 2002/96/KE mbi mbetjet e pajisjeve elektrike dhe elektronike (MPEE), Direktivën 2000/76/KE mbi djegien e mbetjeve dhe Direktivën 2006/21/KE mbi administrimin e mbetjeve të prodhuara nga industrinë nxjerrëse.

Aspekte të ndryshme të këtij legjislacioni të hollësishëm janë interpretuar nga ana e GJED, në funksion të garantimit të mbrojtjes së shëndetit dhe të mjedisit. Në lidhje me ndikimin në mjedis të mbetjeve, në çështjen *Mbetjet e Wallon-it (Wallon Waste)*, nr. C-2/90, datë 9.7.1992, Komisioni kundër Belgjikës, GJED u shpreh se mbetjet përbëjnë një çështje të një lloji të

³⁵⁹ Pavarësisht synimit për të përdorur vetëm terma në gjuhën shqipe, për t'i qëndruar besnik legjislacionit shqiptar, në këtë punim janë përdorur edhe termat në gjuhë të huaj, ashtu siç janë adoptuar nga legjislacioni në fuqi.

veçantë, ku grumbullimi i tyre, edhe para se të përbëjë rrëzik për shëndetin, përbën rrezik për mjedisin, po të mbahen parasysh e kapacitetet e kufizuara të çdo rajoni për trajtimin e tyre.³⁶⁰

Në mënyrë të veçantë, jurisprudenca e GJED ka shërbyer për të sqaruar paqartësitë që burojnë nga përdorimi i terminologjisë që bën kategorizimin në ‘mbetje’ dhe ‘produkte’. Kështu, nëse i referohemi termit të përdorur për mbetjen, ajo është përkufizuar si një substancë ose objekt që poseduesi e hedh ose ka ndërmend ta hedhë. Ajo mund të mos jetë mbetje, por produkt, vetëm atëherë kur plotëson kushtet që përdorimi i mëtejshëm është i sigurt, kur mund të përdoret direkt pa ndonjë përpunim të mëtejshëm, kur konsiderohet si një pjesë e rëndësishme e procesit të prodhimit dhe kur përdorimi i mëtejshëm është i ligjshëm, pra që nuk shkakton dëmtim mjedisor apo të shëndetit të njeriut. Mirëpo kjo mund të shkaktojë paqartësi në praktikë, pasi në varësi të kategorizimit, përcaktohet nëse ndaj një substance apo objekti do të gjejë zbatim legjislativ mbi mbetjet, apo ai mbi produktet. Një substancë apo objekt që në një vend jo shumë të zhvilluar mund të konsiderohet si mbetje, pasi nuk mund të përdoret më tej për të nxjerrë ndonjë vlerë ekonomike prej tij, në një vend tjetër më të zhvilluar do të kategorizohet si produkt, pasi teknologjia mundëson përdorimin e tij për të nxjerrë vlerë ekonomike. Me fjalë të tjera, e njëjta substancë apo objekt diku konsiderohet mbetje, e diku tjetër, si produkt. Në çështjen C-422/92, *Komisioni kundër Gjermanisë*, GJED iu referua edhe vendimit të mëparshëm të saj C-359/88, *Zanetti and Others*, ku kishte theksuar se koncepti i mbetjes nuk duhet të kuptohet se përjashton substancat apo objektet që mund të ripërdoren ekonomikisht. Rrjedhimisht, legjislativi kombëtar që e përkufizon mbetjen si të tillë që përjashton substancat dhe objektet që mund të ripërdoren ekonomikisht, nuk është në përputhje me direktivat.³⁶¹

Ndërsa në çështjen C-297/08, datë 4.3.2010, *Komisioni kundër Italisë*, GJED theksoi se një nga masat më të rëndësishme që shtetet anëtare duhet të marrin, është hartimi i planeve të administrimit të mbetjeve, që në mënyrë të veçantë, të krijojnë mundësitë për marrjen e masave për përdorimin racional, grumbullimin, seleksionimin dhe trajtimin e mbetjeve, sipas të cilave duhet krijuar një rrjet për të hedhur mbetjet në një prej impianteve më të afërt. Kështu, kriteret që rregullojnë vendndodhjen e vendgrumbullimeve të mbetjeve duhet të përfshijnë distancën nga vendet e banuara të vendeve ku krijohet mbetja, ndalimin e vendosjes së impianteve në afërsi të zonave delikate, si edhe ekzistencën e infrastrukturës së përshtatshme për transportimin e mbetjeve.³⁶²

Me gjithë këtë kuadër ligjor të gjerë dhe jurisprudencë të konsoliduar, edhe në gjirin e BE mbetet ende për t’u bërë, më së paku për të eliminuar formulimet e mjegullta në legjislativin për administrimin e mbetjeve. Rasti i formulimit të Rezolutës së Këshillit, 97/C 76/01, datë 24.2.1997, “Për Strategjinë e Komunitetit për Administrimin e Mbetjeve”, është ilustrues në këtë drejtim, ku përmendet se “...në lidhje me veprimtarinë e rikuperimit të mbetjeve, Këshilli e pranon që në çdo rast zgjedhja e mënyrës duhet të bëhet duke mbajtur parasysh efektet mjedisore dhe ekonomike, por e konsideron momentalisht, e deri sa të realizohet zhvillimi shkencor dhe

³⁶⁰ Çështja *Walloon Waste*, paragrafi 30 i vendimit. Gjetet në: http://eur-lex.europa.eu/resource.html?uri=cellar:0734e38b-ea29-41b6-99f1-e80df3768271.0002.06/DOC_3&format=PDF

³⁶¹ Vendimi Nr. C-422/92, *Komisioni kundër Gjermanisë*, paragrafi 22. Gjetet në: <http://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:61992CJ0422&from=EN>

³⁶² Vendimi Nr. C-297/08, *Komisioni kundër Italisë*, paragrafi 64-65. Gjetet në: <http://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=CELEX:62008CJ0297:EN:PDF>

teknologjik dhe të zhvillohen akoma më tej analizat e ciklit të jetës, se ripërdorimi dhe rikuperimi i materialeve duhet të konsiderohen si të preferueshme, aty ku dhe për aq sa ato janë opsionet më të mira mjedisore.”³⁶³ Si për çdo aspekt tjetër në vendimmarrjen mjedisore, edhe në fushën e administrimit të mbetjeve, vështirësitë për politikëbërësit qëndrojnë në faktin që ata duhet të balancojnë mbrojtjen e shëndetit e të mjedisit, me krijimin e mundësive për zhvillim ekonomik, të cilat janë shpesh kontradiktë me njëra-tjetrën.

6.3 Legjislacioni shqiptar për mbrojtjen e mjedisit nga mbetjet.

Mjafton një vështrim i shpejtë në mjedisin shqiptar për të kuptuar se sistemi aktual i administrimit të mbetjeve ka mangësi të theksuara. Për momentin, ai kufizohet vetëm në largimin dhe depozitim të tyre në vende të përcaktuara nga organet e qeverisjes vendore, por jo rrallëherë edhe në vende krejtësisht të papërshtatshme, duke mos përjashtuar as rrugët kryesore kombëtare. Administrimi i mbetjeve dhe veçanërisht i vendeve ku ato janë depozituar duhet të jetë prioritet, për shkak të potencialit ndotës të tyre ndaj njeriut dhe mjedisit, kryesisht për tokën, ujërat nëntokësore dhe biodiversitetin, por në Shqipëri nuk duket që të konsiderohet si i tillë, pasi është në një nivel shumë të ulët.

Megjithatë, janë bërë përpjekje edhe në Shqipëri për hartimin e legjislacionit për administrimin e mbetjeve, që përfshijnë ligjet dhe aktet nënligjore për administrimin e tyre, duke synuar përafrimin me *acquis communautaire*, ku siç u analizua më sipër, një vend qendror zë Direktiva Kuadër për Mbetjet. Për këtë qëllim, është hartuar edhe Strategjia Kombëtare e Menaxhimit të Mbetjeve dhe Plani Kombëtar i Menaxhimit të Mbetjeve, të cilët u miratuan me VKM nr.175, datë 19.1.2011.³⁶⁴

Vetë këto dokumente pranojnë që vetëm qytetet janë pajisur me sisteme për grumbullimin e mbetjeve, por jo zonat rurale, ndërsa riciklimi mbetet në nivele shumë të ulëta. Kryesisht mbetjet asgjësohen në vendgrumbullimet e tyre. Me disa përjashtime të vogla, siç janë lëndfilllet e Sharrës në Tiranë dhe të Bushatit në Shkodër, dhe ato që janë planifikuar të ngrihen në Maliq të Korçës e në Bajkaj të Sarandës, nuk ka vendgrumbullime të tjera të planifikuara sipas parametrave shkencorë. Sistemet e grumbullimit në zonat rurale dhe në qytetet e vogla mungojnë krejtësisht, ndërsa pjesa më e madhe e mbetjeve të këtyre zonave depozitohen nëpër lumenj ose në anët e rrugëve. Prej këtej, ato merren më pas nga rrjedhat ujore e për shkak të sistemit të ujërave nëntokësore në Shqipëri, shkaktojnë ndotje masive. Shqetësuese është mungesa e një sistemi të sigurt të administrimit të mbetjeve të rrezikshme, ku pjesa më e madhe e grumbullimit dhe riciklimi të tyre kryhen nga impiantet private, në mungesë të kontrollit rigoroz nga autoritetet shtetërore. Edhe këto impiante riciklimi janë në hapat e parë dhe varen nga importimi i sasisë më të madhe të lëndës së parë për riciklim nga vendet e tjera.³⁶⁵

³⁶³ Rezoluta e Këshillit, 97/C 76/01, datë 24.2.1997, “Për Strategjinë e Komunitetit për Administrimin e Mbetjeve”, preambula, parag. 22. Gjetet në: [http://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:31997Y0311\(01\)&from=EN](http://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:31997Y0311(01)&from=EN)

³⁶⁴ Gjeten në: <http://qbz.gov.al/sites/default/files/36-2011.pdf>

³⁶⁵ *Ibid.*

Një ndër aktet e parë për administrimin e mbetjeve ishte ligji nr. 8094, datë 21.3.1996, “Mbi heqjen publike të mbeturinave”. Ai përmbante dispozita të kufizuara si për sa i përket perkufizimit shumë të ngushtë të mbetjeve, duke lënë jashtë shumë prej tyre, ashtu edhe të kufizuara gjeografikisht, pasi mbulonte vetëm hapësirën në brendësi të territoreve bashkiake e të komunave, sipas vijave kufizuese nën juridiksionin e tyre. Pas tij u miratuan një sërë ligjesh të tjerë që përmbanin dispozita të ndryshme për administrimin e mbetjeve, si ligji nr. 8652, datë 31.7.2000, “Mbi organizimin dhe funksionimin e qeverisë lokale”, ligji nr. 8934, datë 5.9.2002, “Mbi mbrojtjen e mjedisit”, ligji nr. 9010, datë 13.2.2003, “Mbi administrimin e mbetjeve të ngurta”, ligji nr. 9663, datë 18.12.2006, “Mbi koncesionet” dhe ligji nr. 9537, datë 18.5.2006, “Për administrimin e mbetjeve të rrezikshme”.

Për të përmbushur detyrimet e marra përsipër në kuadrin e Konventës së Bazelit “Për kontrollin e lëvizjeve ndërkufitare të mbetjeve të rrezikshme dhe asgjësimin e tyre”, ligji nr. 8934, datë 5.9.2002, “Për mbrojtjen e mjedisit”, ndaloi importimin e lëndëve dhe të mbetjeve të rrezikshme me qëllim ruajtjeje, depozitimi ose asgjësimi dhe ngarkoi Këshillin e Ministrave për hartimin e listës së lëndëve dhe të mbetjeve të rrezikshme të ndaluara dhe për hartimin e rregullave, procedurave, sasive dhe afateve përkatëse. Prandaj u miratua VKM nr. 806, datë 4.12.2003, “Për miratimin e rregullave e të procedurave për importimin e mbetjeve për përdorim, përpunim e riciklim”, i cili parashikonte mundësinë e importimit të mbetjeve nga personat fizikë dhe juridikë, për t’i përdorur, përpunuar e ricikluar, me përjashtim të mbetjeve të rrezikshme, vetëm në kushtet kur përdorimi, përpunimi e riciklimi i tyre kryhet me teknologji bashkëkohore, që garanton mbrojtjen e shëndetit dhe të mjedisit, kur prej tyre përfitohen lëndë ose materiale të dobishme dhe kursehen lëndë të para, dhe transportimi i tyre nuk ndikon negativisht në shëndetin e njeriut dhe në mjedis. Ndërsa me VKM nr. 835, datë 28.12.2005, u miratua lista e mbetjeve të rrezikshme, mbetjeve dhe mbeturinave të tjera, që ndalohen të importohen, me qëllim ruajtjeje, depozitimi dhe asgjësimi, sipas përcaktimeve të bëra në Katalogun Shqiptar të Klasifikimit të Mbetjeve, që nga ana e tij ishte miratuar me VKM nr. 99, datë 18.2.2005, në përputhje me Katalogun Evropian të Mbetjeve.

Për të përballuar problematikat e mëdha që kanë lindur ndërmjet të tjerash edhe prej aktivitetit intensiv ndërtimor që prej fundit të viteve 90’ në Shqipëri, në vitin 2003 u miratua ligji nr. 9010, datë 13.2.2003, “Mbi administrimin e mbetjeve të ngurta”, i cili është amenduar më pas me ligjin nr. 10137, datë 11.5.2009 dhe me ligjin nr. 10463, datë 22.9.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”. Në fushën e veprimit të ligjit nr. 9010 përfshihej administrimi i mbetjeve urbane, industriale, spitalore, ato të ndërtimit, mbetjet në sistemin e kanalizimeve të ujërave të zeza, të kanaleve kulluese e rezervuarëve, mbetjet bujqësore dhe blegtorale, si edhe mbetjet e vëllimshme, duke përcaktuar rregullat për trajtimin e tyre. Neni 9 i tij i detyron personat fizikë dhe juridikë, veprimtaria e të cilëve krijojnë mbetje, që të ndërtojnë linja dhe impiante për riciklimin dhe përpunimin e mbetjeve, në përputhje me teknologjinë, me natyrën dhe sasinë e mbetjeve që krijojnë, t’i ruajnë dhe t’i trajtojnë mbetjet që të mos vështirësojnë proceset pasuese të administrimit mjedisor të tyre dhe të ndajnë mbetjet që në burim. Për plotësimin e kuadrit ligjor, tre vjet pas këtij ligji u miratua edhe ligji nr. 9537, datë 18.5.2006, “Për administrimin e mbetjeve të rrezikshme”, dispozitat e të cilit rregullonin trajtimin e atyre mbetjeve që nuk i përfshinte ligji për mbetjet e ngurta.

Me qëllim për afrimin e Direktivës Kuadër për Mbetjet të Parlamentit Evropian dhe Këshillit dhe zbatimin e një qasjeje të integruar, u miratua ligji nr. 10463, datë 22.9.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”. Ligji ngarkon Ministrinë e Mjedisit me detyrën e hartimit të programeve për parandalimin e krijimit të mbetjeve në përputhje me objektivat dhe parimet e mbrojtjes së mjedisit, jo më vonë se data 1 janar 2017.³⁶⁶ Aktualisht, janë hartuar planë rajonale për menaxhimin e mbetjeve të Tiranës, Durrësit, Elbasanit, Vlorës dhe Korçës, ndërsa me mbështetjen e projektit SELEA të BE,³⁶⁷ ka filluar hartimi i shtatë planeve për rajonet Shkodër, Lezhë, Kukës, Dibër, Fier, Berat dhe Gjirokastrë. Nga pikëpamja institucionale, ligji vendosi krijimin e Komitetit të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve, si organizëm ndërmintor, në nivel zëvendësministrash, cili i paraqet për shqyrtim Këshillit të Ministrave raportin vjetor të gjendjes dhe të menaxhimit të integruar të mbetjeve në shkallë vendi. Në bazë dhe për zbatim të këtij ligji, u miratua VKM nr.967, datë 25.10.2013, “Për mënyrën e organizimit e të funksionimit të Komitetit të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve”, i cili bashkërendon detyrat e ministrive për menaxhimin e integruar mjedisor të mbetjeve.

Ligji për menaxhimin e integruar të mbetjeve përcakton përgjegjësitë e zgjeruara të prodhuesit, sanksionon parimin ‘ndotësi paguan’, parashikon ngritjen e një rrjeti të integruar të impianteve për rikuperimin dhe asgjësimin e mbetjeve të përziera bashkiake nga sektori urban, si dhe të mbetjeve të ngjashme, që grumbullohen nga prodhues të tjerë, mbi bazën e teknikave më të mira të disponueshme. Dispozita të veçanta u kushtohen kontrollit dhe etiketimit të mbetjeve të rrezikshme, masave të nevojshme për parandalimin e krijimit të mbetjeve të ambalazheve, ndalimin e prodhimit, të hedhjes në treg dhe të përdorimit të ndotësve organikë të qëndrueshëm, caktimin e standardeve teknike për hedhjen në treg të baterive dhe akumulatorëve, masat në lidhje me mbetjet e automjeteve dhe të pajisjeve elektrike dhe elektronike, për llumrat e ujërave të zeza dhe për menaxhimin e mbetjeve spitalore, mbetjeve inerte, të mbetjeve të industrisë nxjerrëse, të mbetjeve nga anijet, të mbetjeve nga gomat e përdorura dhe kategoritë e lëndfillleve. Kategoritë e këtyre të fundit dhe përfrimi me direktivën e Këshillit 1999/31/EC, datë 26.4.1999, “Për lëndfillin e mbetjeve”, u bënë nëpërmjet VKM nr. 452, datë 11.7.2012, “Për lëndfilllet e mbetjeve”, ku përcaktohen procedurat e pranimit të mbetjeve në lëndfill.

Problemi qëndron në faktin që një pjesë e mirë e dispozitave të këtyre ligjeve mbeten ende në letër, duke mos u zbatuar për vite me radhë, gjë që konstatohet me një vështrim të shpejtë të mjedisit shqiptar. Kjo ka bërë që në territorin e vendit tonë të futen edhe mbetje të rrezikshme, për shkak të mungesës së kontrollit rigoroz që fillon që nga autoritetet doganore, e deri tek inspektoratet shëndetësore e mjedisore. Duke marrë shkas nga gjendja e rënduar e mjedisit në Shqipëri, një nga ligjet e para që u miratuan pas ndryshimit të qeverisë ishte ligji nr. 156/2013, “Për disa ndryshime në ligjin nr. 10463, datë 22.9.2011, ‘Për menaxhimin e integruar të mbetjeve’, të ndryshuar”, i cili ndaloi importimin e të gjitha mbetjeve, të rrezikshme dhe jo të rrezikshme.

Për arritjen e një zgjidhjeje të qëndrueshme mbi problemin e administrimit të mbetjeve, Strategjia Kombëtare e Menaxhimit të Mbetjeve e përmendur më sipër, fokusohet në katër shtylla kryesore, që përfshijnë planifikimin, edukimin, financimin dhe legjislacionin. Në lidhje

³⁶⁶ Neni 14§2.

³⁶⁷ Informacion për Projektin SELEA gjendet në:

http://eeas.europa.eu/delegations/albania/press_corner/all_news/news/2012/20120120_01_sq.htm

me shtyllën e parë, përgatitja e planeve kalon në dy faza, në përgatitjen e planit kombëtar mbi administrimin e mbetjeve (çka është bërë tashmë realitet) dhe përgatitjen e planeve mbi administrimin e mbetjeve në nivel lokal dhe rajonal. Plani ka përcaktuar gjithashtu dy objektiva të përkohshëm në lidhje me sasinë e mbetjeve të mbledhura nga autoritetet vendore të cilat duhet të jenë ricikluar apo përzier në masën 25% deri në vitin 2015 dhe në masën 55% deri në vitin 2020.

Pavarësisht këtij kuadri ligjor të gjerë, menaxhimi i mbetjeve vazhdon të jetë në nivele shumë të ulëta në Shqipëri dhe shkalla e riciklimit e papërfillshme. Njësitë e qeverisjes vendore kanë kapacitete shumë të dobëta për menaxhimin e mbetjeve, përfshi ato në destinacionin përfundimtar. Pjesa më e madhe e mbetjeve vazhdon të hidhet në mënyrë të pasigurt në vendgrumbullime të ligjshme ose të paligjshme, ose digjet. Ende mungojnë hapësirat për mbetjet e rrezikshme, mjekësore ose ndërtimore, si dhe nuk ka një procedurë të qartë për menaxhimin dhe kontrollin e lëndfilleve.

Ndërsa në lidhje me sanksionet penale, neni 202 i Kodit Penal parashikon që transportimi i mbeturinave toksike apo depozitimi në territorin shqiptar të mbeturinave toksike dhe radioaktive, dënohet me burgim nga një deri në pesë vjet. Në këtë pikë, Shqipëria ka shumë për të bërë, pasi edhe në gjirin e BE ngrihet fuqishëm çështja e përdorimit të legjislacionit penal për mbrojtjen e mjedisit.

KREU VII

MBROJTJA E MJEDISIT DHE TË DREJTAT E NJERIUT

“Konventa e Aarhus-it është përprojekja më ambicioze në fushën e ‘demokracisë mjedisore’ që është ndërmarrë deri tani nga Kombet e Bashkuara”
Kofi Annan

Siç kuptohet nga statistikat e OBSH të paraqitura më sipër mbi numrin e vdekjeve për shkak të ndotjes, masat e përgjithshme të marra për mbrojtjen e mjedisit, ashtu si edhe ato të marra për sektorë të veçantë, si p.sh. ato për mbrojtjen e ajrit, tokës, ujit, biodiversitetit, administrimin e mbetjeve, kanë të bëjnë në mënyrë të drejtpërdrejtë me mbrojtjen e të drejtave të njeriut, e konkretisht, me mbrojtjen e të drejtës së jetës.

Deklarata e Stokholmit që në hyrjen e saj thekson se të dy aspektet e mjedisit ku jeton njeriu, si ai natyror, ashtu edhe ai i krijuar nga dora e tij, janë thelbësore për mirëqenien e tij dhe për gëzimin e të drejtës më themelore, të drejtën e jetës.

Por, nëse të drejtat mjedisore kanë arritur statusin e të drejtave themelore të njeriut apo jo, është çështje e një debati të vazhdueshëm dhe argumentet e ofruara pro dhe kundër janë të shumtë. Siç u përmend më lart, neni 59 i kushtetutës shqiptare sanksionon parimin e zhvillimit të qëndrueshëm duke parashikuar që shteti, brenda kompetencave kushtetuese dhe mjeteve që disponon, si dhe në përbushje të nismës dhe të përgjegjësisë private, synon, ndër të tjera, një mjedis të shëndetshëm dhe ekologjikisht të përshtatshëm për brezat e sotëm dhe të ardhshëm, ndërsa neni 56 i saj sanksionon parimin të drejtës së publikut për të marrë informacion që lidhet me mjedisin dhe mbrojtjen e tij.

Shumë kushtetuta sot në botë përbajnë formulime që interpretohen si njohje të të drejtave mjedisore. Shprehjet që gjenden më shpesh në to kanë të bëjnë më të drejtën për një mjedis ‘të shëndetshëm’, ‘të pastër’, ‘të sigurtë’, ‘të balancuar’, ‘që garanton zhvillimin e qëndrueshëm’, etj.³⁶⁸ Nga ana tjetër, formulimi i përdorur në nenin 21 të kushtetutës holandeze përcakton si detyrë të autoriteteve të mbajnë vendin të banueshëm dhe të mbrojnë e të përmirësojnë mjedisin. Në këtë rast, mbrojtja e mjedisit është parë më tepër nga këndvështrimi i detyrës së qeverisë, sesa i të drejtave të njeriut. Ndërsa kushtetuta gjermane ka shkuar më tej, pas amendimit të saj, pasi nuk e ka kufizuar mbrojtjen vetëm tek të drejtat e njeriut, por e shtrin atë edhe ndaj kafshëve, duke sanksionuar në nenin 20a: *“Duke mbajtur parasysh gjithashtu edhe përgjegjësinë e tij kundrejt brezave të ardhshëm, shteti do të mbrojë me ligj bazën natyrore të jetës dhe kafshët, në përputhje me ligjin dhe drejtësinë, nëpërmjet veprimtarisë ekzekutive dhe gjyqësore, brenda kuadrit të rendit kushtetues.”*³⁶⁹

³⁶⁸ Kushtetutat e vendeve të ndryshme gjenden në: <https://www.constituteproject.org/search>

³⁶⁹ Kushtetuta e Republikës Federale Gjermane, Neni 20a: *“Duke mbajtur gjithashtu parasysh edhe përgjegjësinë e tij kundrejt brezave të ardhshëm, shteti do të mbrojë bazën natyrore natyrore të jetës dhe kafshët, duke u bazuar në ligjin dhe drejtësinë, me vendime ekzekutive dhe gjyqësore, brenda rendit kushtetues.”*

Veçori e përbashkët e këtyre formulimeve kushtetuese për të drejtat mjedisore është se ato janë të një karakteri të përgjithshëm, jo të përcaktuara shumë qartë, e për rrjedhojë, nuk mundësojnë kërkimin e zbatimit të tyre para gjykatave të vendit.³⁷⁰ Në këtë pikë, dallon kushtetuta e Ekuadorit,³⁷¹ e cila sanksionon që në preambul se “...populli i Ekuadorit, respekton natyrën, Nënë Tokë, pjesë e të cilës ai është dhe që është jetësore për ekzistencën e tij.” Më tej, ndër detyrat e shtetit renditet promovimi i zhvillimit të qëndrueshëm, mbrojtja e aseteve natyrore dhe kulturore të vendit, si edhe ndalohen shprehimisht zhvillimi, prodhimi, posedimi, importimi, transportimi, depozitimi, dhe përdorimi i armëve kimike, biologjike dhe bërthamore, ndotësve të qëndrueshëm organikë, kimikateve të ndaluara ndërkombëtarisht, teknologjive eksperimentale biologjike dhe agjentët dhe organizmat gjenetikisht të modifikuar që janë të dëmshëm për shëndetin e njeriut, ose që mund të dëmtojnë sigurimin e ushqimit apo ekosistemet.³⁷² Në disa vende të tjera, kushtetutat nuk i përmendin në mënyrë të shprehur të drejtat mjedisore, por këto të fundit janë pranuar si të tilla prej gjykatave kombëtare, të cilat interpretojnë normat e legjislacionit të brendshëm.

Në këtë pjesë të punimit do të analizohet gjendja aktuale e të drejtave të tilla në aktet juridike ndërkombëtare dhe në legjislacionin e brendshëm shqiptar, për të parë nëse të ashtuquajturat ‘të drejta mjedisore’ kanë përshkuar apo janë shkrirë me të drejtat themelore të njeriut.

7.1 Të drejtat e njeriut dhe të drejtat mjedisore në të drejtën ndërkombëtare.

Debati i sotëm akademik për sa i përket lidhjes midis të drejtave mjedisore dhe të drejtave themelore të njeriut është i përqendruar rreth dy tezave të ndryshme. Teza e parë, e quajtur “teza e të drejtave mjedisore individuale” (qëndrimi antropocentrist) e konsideron mjedisin thjesht si një vlerë që u shtohet kërkesave të tjera që plotësojnë nevojat e individit. Teza e dytë, e quajtur “teza ekologjike” (qëndrimi ekocentrist) e konsideron mjedisin si një kusht të domosdoshëm për jetën, jo vetëm për njerëzit, por edhe për të gjitha gjallesat e tjera që popullojnë planetin, i cili duhet mbrojtur me çdo mënyrë. Kjo teza e vë theksin tek nevoja e vendosjes së kufizimeve ndaj lirisë së individit për shfrytëzimin e mjedisit.

Një vështrim i përgjithshëm i akteve ligjore ndërkombëtare mbi mjedisin tregon se nuk ka ndonjë përcaktim specifik nëse të drejtat mjedisore konsiderohen si të drejta themelore të njeriut. Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut e vitit 1948 thjesht konstatoi se: “Gjithkush ka të drejtë për një nivel jetese të përshtatshëm për shëndetin dhe mirëqenien e tij dhe të familjes së tij...”³⁷³ e cila nënkupton domosdoshmërinë e një mjedisi të pastër, për të garantuar këto të drejta. Por kjo nuk konsiderohet që të jetë shndërruar në një të drejtë të pranuar nga e drejta ndërkombëtare zakonore.

Më pas, Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, i vitit 1966, përgjithësisht ka deklaruar detyrimin e shteteve palë që të njohin të drejtën e secilit për të gëzuar

³⁷⁰ Jan Hancock, “Environmental Human Rights. Power, ethics and law.”, MPG Books Ltd., Great Britain, Bodmin, Cornwall, 2003, fq. 80.

³⁷¹ Kushtetuta e Ekuadorit gjendet në https://www.constituteproject.org/constitution/Ecuador_2008.pdf

³⁷² Kushtetuta e Ekuadorit, neni 3§5, neni 3§7 dhe neni 15§2.

³⁷³ Neni 25, Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut. Gjendet në: <http://www.un.org/en/documents/udhr/index.shtml>

standardin më të lartë të mundshëm të shëndetit fizik dhe mendor dhe për këtë qëllim, për të përmirësuar të gjitha aspektet e higjienës së mjedisit, pa specifikime të mëtejshme se çfarë do të përfshihen në to.³⁷⁴ Ky formulim është interpretuar më tepër si një detyrim ekonomik dhe social i të gjithë komunitetit kundrejt anëtarëve të tij, sesa si një e drejtë e individit kundrejt shoqërisë. Në këtë kuptim, e drejta për një mjedis të pastër duhet konsideruar njësoj si të tjerat, si një e drejtë ekonomike, sociale dhe kulturore, të përfshira në këtë pakt.³⁷⁵

Në vitin 1972, Deklarata e Konferencës së Kombeve të Bashkuara mbi Mjedisin Njerëzor, Deklarata e Stokholmit, iu afrua më pranë përcaktimit të një të drejte të njeriut për mjedisin në Parimin e saj Nr. 1, duke deklaruar që njerëzit kanë të drejtën themelore për “...kushte të përshatshme jetese, në një mjedis të një cilësie të tillë që lejon një jetë dinjitoze dhe në mirëqenie.”³⁷⁶ Por edhe një formulim i tillë është ende larg mundësisë që të konsiderohet se vendos detyrime mbi shtetet të cilat do të duhej që t’i përmbushnin, për të garantuar një mjedis të pastër. Njëzet vjet më vonë, i njëjti model u adoptua nga Deklarata e Rios për Mjedisin dhe Zhvillimin, e cila njohu të drejtën e njerëzve për një jetë të shëndetshme dhe produktive në harmoni me natyrën.³⁷⁷

Ndër dokumentet rajonale, pararendëse e Konventës së Aarhusit ka qenë edhe Deklarata e Salzburgut për Mbrojtjen e të Drejtës për Informim dhe Pjesëmarrje, e miratuar në Konferencën e Dytë Evropiane për Mjedisin dhe të Drejtat e Njeriut, në 3 dhjetor 1980.³⁷⁸ Po ashtu, edhe dy dokumente të tjerë rajonalë vendosin theksin tek rëndësia e sigurimit të informacionit dhe pjesëmarrjes së publikut: Karta Afrikane e të Drejtave të Njeriut dhe të Popujve (Karta e Banxhulit), në kuadër të Organizatës së Unitetit Afrikan (tashmë Bashkimi Afrikan), miratuar në Gambia, në 27 qershor 1981³⁷⁹ dhe Rekomandimi Nr. R (81) 19 i Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës për të Drejtën e Marrjes së Informacionit që Disponohet prej Autoriteteve Publike,³⁸⁰ miratuar në Strasburg të Francës në 25 nëntor 1981.

Në kuadër të BE, në vitin 1985 u miratua Direktiva e Këshillit 85/337/EEC e 27 qershorit, për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis (Direktiva VNM), e cila do të shërbente më pas si bazë për një numër dispozitash të Konventës së Aarhusit në lidhje me pjesëmarrjen e publikut në vlerësimin e ndikimit në mjedis.

³⁷⁴ Neni 12, Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore. Gjetet në:

<http://www2.ohchr.org/english/law/cescr.htm>

³⁷⁵ Edith Brown Weiss, “*The Planetary Trust: Conservation and Intergenerational Equity*”, *Ecological Law Quarterly*, Vol. 11, Nr. 4, 1984, fq. 558.

³⁷⁶ Parimi 1, Deklarata e Konferencës së Kombeve të Bashkuara për Mjedisin Njerëzor. Gjetet në:

<http://www.unep.org/Documents.Multilingual/Default.asp?documentid=97&articleid=1503>

³⁷⁷ Parimi 1, Deklarata e Rios për Mjedisin dhe Zhvillimin, Axhenda 21, Shtojca 1 e Raportit të Konferencës së OKB për Mjedisin dhe Zhvillimin, Rio de Zhaneiro, 3-14 Qershor 1992. Gjetet në:

<http://www.un.org/documents/ga/conf151/aconf15126-1annex1.htm>

³⁷⁸ Carl Bruch dhe Meg Filbey, “*Emerging global norms of public involvement*”, fq. 3, në Carl Bruch (red.), “*The New ‘Public’ - The Globalization of Public Participation*”, *Environmental Law Institute*, 2002. Gjetet në:

<http://www.eli.org/sites/default/files/eli-pubs/d1205.pdf>

³⁷⁹ Karta Afrikane për të Drejtat e Njeriut dhe të Popujve gjendet në:

http://www.achpr.org/english/info/charter_en.html

³⁸⁰ Gjetet në: http://www.access-info.org/documents/Recommendation_81_19.pdf

Konferenca e Autoriteteve Vendore dhe Rajonale të Evropës, e mbajtur në Strasburg në 14 tetor 1986 e përmbante që në titull pjesëmarrjen, u quajt “Konferenca për Rajonet, Mjedisin dhe Pjesëmarrjen”. Në të u miratua Rezoluta Nr. 171, e cila kishte si një nga pjesët kryesore të saj pjesëmarrjen në vendimmarrjen mjedisore.³⁸¹

E drejta për një mjedis të pastër dhe të shëndetshëm u përsërit nga Asambleja e Përgjithshme e OKB-së në Rezolutën 45/94, e cila u kërkoi shteteve anëtare dhe organizatave ndërqeveritare e joqeveritare “...të rrisin përpjekjet e tyre drejt sigurimit të një mjedisi më të mirë dhe të shëndetshëm”.³⁸² Me gjithë rëndësinë e rezolutave të Asamblesë së Përgjithshme në të drejtën ndërkombëtare, siç u përmend më lart, ato përbëjnë atë që quhet ‘*ligj i butë*’, dhe si të tilla nuk kanë fuqi detyruese mbi shtetet.³⁸³ Por në rastin konkret mund të vërehet rëndësia e kësaj rezolute mbi rolin e organizatave ndërqeveritare dhe joqeveritare, kontributi i të cilave në zhvillimin e së drejtës ndërkombëtare mjedisore ka qenë tepër i rëndësishëm. Midis këtyre organizatave mund të përmenden Greenpeace, Unioni Ndërkombëtar për Ruajtjen e Natyrës (IUCN), Fondi Botëror për Kafshët e Egra dhe Natyrën (WWF), Këshilli i Përkujdesjes së Pyjeve (FSC), Shoqata e Mbrojtjes së Kafshëve të Egra, Unioni Botëror për Mbrojtjen e Jetës (WUPL), Qendra Rajonale e Mjedisit (REC), etj.

Raporti Ksentini³⁸⁴ i vitit 1994, formuloi Projekt-Parimet për të Drejtat e Njeriut dhe Mjedisin, të cilat konstatuan lidhjen midis mjedisit dhe të drejtave të njeriut dhe në mënyrë të shprehur formuluan seriozitetin, kompleksitetin dhe natyrën shumëdimensionale të problemeve mjedisore, në kundërshtim me besimin mbizotërues të kohës se burimi i problemeve mjedisore ishin vendet e industrializuara dhe mjetet ligjore duhet të kërkoheshin vetëm për marrjen e masave ndaj tyre.³⁸⁵ Lufta kundër përkeqësimit të mjedisit duhet të jetë shumëdimensionale dhe një betejë që duhet të luftohet në çdo front, në të gjitha vendet ku ai ndodh, duke u përqendruar në analizimin e shkaqeve pse ndodh dhe në sigurimin e mjeteve të duhura ligjore për ta parandaluar dhe shmangur atë.

Edhe pse Raporti Ksentini pohoi se të drejtat mjedisore janë universale, të ndërvarura e të pandashme dhe janë pjesë e të drejtave ekzistuese të njeriut, domethënë të drejta civile, kulturore, ekonomike, politike dhe sociale,³⁸⁶ është e vështirë të arrihet në konkluzione të prera duke iu referuar praktikës shtetërore dhe doktrinës. Ajo që mund të thuhet me një farë sigurie është se zhvillimet bashkëkohore në të drejtën ndërkombëtare kanë qenë të prirura drejt dhënies së të drejtave të moderuara individëve, komuniteteve dhe grupeve të interesit, për të marrë pjesë

³⁸¹ Stephen Stec, “*The Aarhus Convention. An implementation guide*”, United Nations Publications, 2nd edition, 2013, fq. 3

³⁸² Paragrafi 2 i pjesës së përgjithshme e Rezolutës së Asamblesë së Përgjithshme 45/94, mbledhja plenare nr. 68, datë 14.12.1990. Gjetet në: <http://www.un.org/documents/ga/res/45/a45r094.htm>

³⁸³ Për një trajtim të hollësishëm të karakterit të rezolutave të Asamblesë së Përgjithshme të OKB dhe atyre të Këshillit të Sigurimit, shih: Xhezair Zaganjori, “*Jurisprudencë dhe praktikë ndërkombëtare*”, Adelprint, Tiranë 2012, fq. 277.

³⁸⁴ Znj. Fatma Zorah Ksentini, Raportuese e Posaçme e OKB e Nën-Komisionit të Parandalimit të Diskriminimit dhe Mbrojtjes së Minoriteteve, në vitin 1989 u ngarkua me detyrën e hartimit të një raporti të hollësishëm mbi lidhjen midis të drejtave të njeriut dhe mjedisit.

³⁸⁵ Raporti Ksentini (Projekt-Parimet për të Drejtat e Njeriut dhe Mjedisin), Komisioni i OKB i të Drejtave të Njeriut, Nën-Komisioni i Parandalimit të Diskriminimit dhe Mbrojtjes së Minoriteteve, 6 Korrik 1994, fq. 4.

Gjetet në: <http://www.unhcr.ch/Huridocda/Huridocda.nsf/0/eeab2b6937bccaa18025675c005779c3?Opendocument>

³⁸⁶ *Ibid.*, parag. 2.

në vendimmarrjen mjedisore që ndikon në jetën e tyre, si edhe të kenë akses në drejtësi, duke patur mundësi të kufizojnë apo edhe të eliminojnë dëmet e shkaktuara në mjedisin e tyre. Këto zhvillime janë përmbledhur në termin “proceduralizim i të drejtave mjedisore”, në kuptimin e fuqizimit të individit dhe të grupeve të ndryshme shoqërore për të marrë pjesë në procesin e diskutimit të legjislacionit dhe në vendimmarrjen mjedisore, si edhe në shfrytëzimin e mekanizmave ligjorë kundër dëmeve mjedisore.³⁸⁷

Një tjetër dokument i rëndësishëm që shprehet mbi të drejtat mjedisore të një kategorie të veçantë është Deklarata mbi të Drejtat e Popullsive Indigjene, miratuar me Rezolutën 61/295 të Asamblesë së Përgjithshme të OKB, të datës 13 Shtator 2007.³⁸⁸ Neni 29 i deklaratës u njeh popullsive indigjene të drejtën e ruajtjes dhe të mbrojtjes së mjedisit, tokave dhe territoreve të tyre, si edhe vendos detyrimin ndaj shteteve për hartimin e programeve të ndihmës ndaj këtyre popullsive, kujdesin për shëndetin e tyre dhe ndalimin e depozitimit apo hedhjes së materialeve të rrezikshme në këto vende pa u këshilluar më parë me anëtarët e këtyre popullsive.

Për sa i përket mekanizmave ligjorë kundër dëmeve që u shkaktohen njerëzve për shkak të degradimit të mjedisit, kuadri ligjor aktual ndërkombëtar lejon referimin në aktet ndërkombëtare që mbrojnë të drejtat e njeriut, të cilat mund të përcaktojnë masa mbrojtëse kundër veprimeve ose mosveprimeve të një shteti. Në mënyrë të veçantë këtu duhet theksuar fakti se përfshirja e sanksioneve për mosveprim nga ana e shtetit është e një rëndësie të veçantë, pasi në shumicën e rasteve, dëmet mjedisore shkaktohen nga mosmarrja e masave mbrojtëse nga ana e autoriteteve shtetërore. Duke qenë se pika më e rëndësishme e mbrojtjes së të drejtave të njeriut është mbrojtja e individëve nga abuzimi i mundshëm prej pushtetit shtetëror, në të gjitha format që ai mund të paraqitet, shtetet palë në konventat e të drejtave të njeriut kanë marrë përsipër dy detyrime: ose detyrimin për të ofruar mbrojtje paraprake, ose detyrimin të ofrojnë dëmshpërblim *ex post facto*, pra, pasi shkelja ka ndodhur, në të gjitha rastet kur shkelen të drejtat e njeriut, qoftë nga shteti, qoftë nga entitetet joshtetërore. Të gjitha përpjekjet duhet të synojnë drejt parandalimit të rasteve abuzive, por kur kjo nuk arrihet, autoritetet shtetërore kanë detyrimin pozitiv për hetimin e ngjarjeve, ndëshkimin e autorëve dhe ofrimin e mjeteve ligjore për dëmshpërblimin e viktimave të abuzimit, në përputhje me legjislacionin e tyre të brendshëm. Pra, edhe pse momentalisht nuk ka procedura ligjore ndërkombëtare për të drejtat e njeriut të cilat të lejojnë veprime direkte kundër subjekteve private që shkaktojnë dëme mjedisore, këto procedura mund të përdoren kundër një shteti, i cili është i detyruar të ofrojë dëmshpërblim në të tilla raste.³⁸⁹

7.2 Konventa e Aarhusit “Për të drejtën e publikut për të pasur informacion, për të marrë pjesë në vendimmarrje dhe për t’iu drejtuar gjykatës për çështjet e mjedisit” dhe të drejtat mjedisore.

Konventa e Aarhusit u nënshkrua në 25 qershor 1998 në Konferencën e Katërt Ministrore “Mjedisi për Evropën”, të Komisionit Ekonomik të Kombeve të Bashkuara për Evropën (UNECE) dhe hyri në fuqi në 30 tetor 2001. Është një traktat i hapur për aderim për të gjithë

³⁸⁷ Francesco Francioni, “*International Human Rights in an Environmental Horizon*”, The European Journal of International Law, 2010, Vol. 21, nr. 1, fq. 42.

³⁸⁸ Rezoluta gjendet në: <http://www.un-documents.net/a61r295.htm>

³⁸⁹ Dinah Shelton, “*Human rights and the environment: What specific environmental rights have been recognized?*”, Denver Journal of International Law and Policy, Vol. 35:1, 2006, fq. 130.

anëtarët e OKB, sipas nenit 19§3 të saj dhe numëron aktualisht 47 palë. Shqipëria u bë palë në të para se ajo të hynte në fuqi, duke e ratifikuar me ligjin nr. 8672, datë 26.10.2000.³⁹⁰

Konventës i është bashkëlidhur edhe Protokollin për Regjistrat e Shkarkimit dhe të Transferimit të Ndotësve, i cili u nënshkrua në Takimin e Jashtëzakonshëm të Mbledhjes së Palëve në 21 maj 2003, në Kiev, në Konferencën e Pestë Ministrore “Mjedisi për Evropën”, prej 36 shteteve palë dhe Bashkimit Evropian, prej të cilave vetëm 33 e kanë ratifikuar atë. Shqipëria u bë palë në Protokoll duke e ratifikuar me ligjin nr. 9548, datë 1.6.2006. Protokollin është instrumenti i parë ndërkombëtar që përmban detyrime ligjore për krijimin e regjistrave për lëshuesit dhe transferuesit e ndotësve, të cilët duhet të jenë të hapur për publikun në internet, për të cilët palët duhet të raportojnë detyrimisht çdo vit mbi shkarkimet në ajër, ujë dhe tokë, si edhe për transferimin e disa ndotësve prej disa aktiviteteve të caktuara dhe për gazet serë.³⁹¹

Ndërsa në Mbledhjen e Dytë të Palëve në Almaty të Kazakistanit në 27 maj 2005 u nënshkrua në përputhje me nenin 14§4 të konventës amendamenti i saj në lidhje me organizmat e modifikuar gjenetikisht (OMGJ), i cili nuk ka hyrë ende në fuqi, pasi nuk është ratifikuar prej ¾ e numrit të palëve të konventës në kohën e nënshkrimit, siç parashikon vetë teksti i konventës, çka do të thotë që amendamenti duhet të ratifikohet prej 27 palëve, nga 35 që ishte totali në kohën e nënshkrimit. Bën përshtypje fakti që sot amendamenti e ka arritur numrin 27 të palëve që e kanë ratifikuar, por vetëm 22 janë nga ato palë që ishin në momentin e nënshkrimit të amendamentit. Shqipëria është një nga 5 shtetet që nuk e ka ratifikuar ende amendamentin.³⁹²

Që në emërtim kuptohet që Konventa e Aarhusit bazohet në 3 shtylla: 1) E drejta e publikut për të marrë informacion për çështjet e mjedisit; 2) E drejta e publikut për të marrë pjesë në vendimmarrje për çështjet e mjedisit; dhe 3) E drejta e publikut për t’iu drejtuar gjykatës për çështjet e mjedisit. Zgjerimi i aksesit të publikut ndaj informacionit mjedisor dhe shpërndarja e këtij informacioni ndikojnë pozitivisht për një ndërgjegjësim më të madh të publikut për çështjet mjedisore, shkëmbimin e lirë të mendimeve dhe pjesëmarrje më efektive të tij në procesin e vendimmarrjes mjedisore. Madje, që në preambul, konventa përcakton se shteti jo vetëm që duhet t’ia garantojë publikut këto të drejta, por edhe duhet ta ndihmojë për t’i realizuar ato.

Në citimin e vendosur në fillim të këtij kreu, Konventa e Aarhusit është quajtur si “...shtjellimi më mbresëlënës i Parimit 10 të Deklaratës së Rios, që thekson nevojën për pjesëmarrjen e qytetarëve në çështjet e mjedisit dhe për të marrë informacion për çështjet e mjedisit që mbahet prej autoriteteve publike. Si e tillë, është përpjekja më ambicioze në fushën e ‘demokracisë mjedisore’ që është ndërmarrë deri tani nga Kombet e Bashkuara.”³⁹³

Siç shihet, një veçanti e kësaj konvente është natyra e detyrimeve që ajo vendos. Në përgjithësi, konventat e ndryshme u akordojnë palëve të drejta dhe detyrime reciproke, ndërsa Konventa e Aarhusit detyrimet ua vendos palëve, kundrejt qytetarëve të tyre, jo kundrejt palëve të tjera. Për

³⁹⁰ Informacioni i hollësishëm për Konventën e Aarhusit gjendet në:

<http://www.unece.org/env/pp/contentofaarhus.html>

³⁹¹ Informacioni i hollësishëm për Protokollin për Regjistrat e Shkarkimit dhe të Transferimit të Ndotësve gjendet në:

https://treaties.un.org/Pages/ViewDetails.aspx?src=TREATY&mtdsg_no=XXVII-13-a&chapter=27&lang=en

³⁹² Informacioni i hollësishëm për Amendamentin e Konventës së Aarhusit gjendet në:

https://treaties.un.org/Pages/ViewDetails.aspx?src=TREATY&mtdsg_no=XXVII-13-b&chapter=27&lang=en

³⁹³ Koffi Annan, Ish-Sekretar i Përgjithshëm i OKB, 1997-2006.

këtë arsye edhe është etiketuar si një 'konventë jo-konvencionale'.³⁹⁴ Për t'i dhënë forcë detyruese dy të drejtave të para, për të marrë informacion për çështjet e mjedisit dhe për të marrë pjesë në vendimmarrjen për to, konventa ka parashikuar edhe të drejtën për t'iu drejtuar gjykatës për çështjet e mjedisit, si mjete i fundit i disponueshëm në sistemet e brendshme të palëve të saj. Për të siguruar që i gjithë sistemi i brendshëm i palëve të konventës garanton përmbushjen e detyrimeve të sanksionuara prej saj, në Vendimin I/7, të titulluar "Shqyrtimi i zbatueshmërisë", të marrë në 23 tetor 2002, palët vendosën krijimin e Komitetit të Kontrollit të Zbatueshmërisë.³⁹⁵

Komiteti i Kontrollit të Zbatueshmërisë përbëhet prej 8 anëtarësh, shtetas të shteteve palë, të cilët veprojnë në cilësitë e tyre personale, të zgjedhur nga Mbledhja e Palëve me konsensus, e në mungesë të këtij të fundit, me votim të fshehtë. Kompetencat e Komitetit përfshijnë shqyrtimin e të gjitha parashtrësive, referimeve apo komunikimeve të bëra nga palët, Sekretariati apo nga publiku, përgatitja e raporteve mbi zbatimin e dispozitave të konventës, dhe monitorimi dhe lehtësimi i zbatimit të kërkesave për raportim që përmban konventa. Ai mund të shqyrtojë çështje që kanë të bëjnë me zbatimin e konventës dhe të bëjë rekomandimet përkatëse.

Parashtrësat që bëhen prej palëve mund të kenë lidhje me mospërmbushjen e detyrimeve prej një pale tjetër, ose me pamundësinë e vetë asaj për të përmbushur detyrimet që burojnë prej konventës. I gjithë komunikimi realizohet nëpërmjet Sekretariatit të Konventës, i cili ia përcjell më pas Komitetit për të vendosur sa më shpejt të jetë e mundur, se si do të veprojë më tej. Kur parashtrësia bëhet prej Sekretariatit, i cili gjatë shqyrtimit të raporteve të palëve sipas kërkesave të konventës merr dijeni mbi ndonjë mospërmbushje të mundshme prej palëve, mund t'u kërkojë këtyre të fundit të ofrojnë informacion shtesë rreth çështjes. Nëse nuk jepet asnjë përgjigje brenda 3 muajve, apo në çfarëdo rrethanash të tjera, brenda jo më shumë se 6 muajve, Sekretariati njofton Komitetin, i cili e merr çështjen në shqyrtim sa më shpejt të jetë e mundur.

Kur paraqiten Komunikime nga publiku, fillimisht Komiteti shqyrton nëse komunikimi është (a) Anonim; (b) Abuzim me të drejtën e bërjes së një komunikimi të tillë; (c) Haptazi i paarsyeshëm; (ç) Në mospërputhje me Konventën. Më tej, Komiteti shqyrton nëse ekziston ndonjë mjet efektiv ende i pa ezauruar i së drejtës së brendshme, përveç rasteve kur mjete është zvarritur në mënyrë të paarsyeshme ose është haptazi jo efektiv dhe i pamjaftueshëm për të ndrequr shkeljen. Komiteti ndjek vazhdimin e procedurës duke njoftuar palën e cila pretendohet se nuk ka përmbushur detyrimet, e cila ka 5 muaj kohë për të dhënë shpjegime mbi çështjen, e pas tyre Komiteti mund të organizojë edhe seanca dëgjimore.³⁹⁶

Në të gjitha rastet, Komiteti ia referon çështjen Mbledhjes së Palëve, e cila në varësi të natyrës së çështjes, mund të vendosë: (a) Dhënien e këshillave dhe ndihmës ndaj palës për zbatimin e Konventës; (b) Dhënien e rekomandimeve; (c) Bërjen e kërkesës palës që të paraqesë një strategji, përfshirë afatet kohore përkatëse para Komitetit mbi zbatimin e konventës dhe të paraqesë një raport mbi zbatimin e kësaj strategjie; (ç) Në rastet e komunikimeve prej publikut

³⁹⁴ Michael Stanley-Jones, "The Aarhus Convention and e-Democracy", Second Plenary meeting of the ad hoc Committee on e-democracy, Strasbourg, 8-9 October 2007.

³⁹⁵ Vendimi I/7 për krijimin e Komitetit të Kontrollit të Zbatueshmërisë gjendet në:

<http://www.unece.org/fileadmin/DAM/env/pp/documents/mop1/ece.mp.pp.2.add.8.e.pdf>

³⁹⁶ Procedura që ndiqet para Komitetit të Kontrollit të Zbatueshmërisë të Konventës së Aarhusit gjendet në:

<http://www.unece.org/fileadmin/DAM/env/pp/documents/mop1/ece.mp.pp.2.add.8.e.pdf>

bën dhënien e rekomandimeve palës mbi masa specifike për të adresuar çështjet e ngritura nga publiku; (d) Lëshimin e një deklaratë për moszbatim të konventës; (dh) Bërjen e vërejtjeve; (e) Pezullimin e të drejtave dhe privilegjeve të palës, sipas konventës; (ë) Marrjen e masave të tjera jo-konfrontuese, jo-gjyqësore dhe këshilluese, që janë të përshtatshme, sipas rastit.³⁹⁷ E gjithë kjo procedurë, nuk ndikon në mekanizmin e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve sipas nenit 16 të konventës, i cili nga ana e tij parashikon se në rast se ka mosmarrëveshje midis dy ose më shumë palëve për interpretimin ose zbatimin e konventës, do të kërkohet një zgjidhje me anë të negociatave ose mjeteve të tjera të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve. Gjatë nënshkrimit, ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit në konventë ose në çdo kohë pas këtyre fazave, një palë mund t'i deklarojë me shkrim depozituesit që për një mosmarrëveshje të pazgjidhur, ajo pranon njërën ose të dyja mjetet për zgjidhjen e mosmarrëveshjes, si të detyrueshme, në lidhje me çdo palë që pranon të njëjtin detyrim: (i) Paraqitjen e mosmarrëveshjes në Gjykatën Ndërkombëtare të Drejtësisë. (ii) Arbitrazhin, në përputhje me procedurën e vendosur në Aneksin II. Në qoftë se Palët në mosmarrëveshje kanë pranuar të dyja mjetet e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve, mosmarrëveshja mund t'i paraqitet Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë, në qoftë se Palët nuk bien dakord ndryshe. Siç shihet, i gjithë mekanizmi i ngritur nga Konventa e Aarhusit ndjek frymën e të gjitha konventave mjedisore në përgjithësi, synon nxitjen dhe ndihmën e palëve për të përmbushur detyrimet e tyre dhe jo vendosjen e sanksioneve ndëshkuese.

Komiteti i Kontrollit të Zbatueshmërisë ka marrë në shqyrtim edhe rastin “Petrolifera” (Komunikimi ACCC/C/2005/12), të iniciuar nga OJF mjedisore “Aleanca Qytetare për Mbrojtjen e Gjirit të Vlorës”, që do të analizohet më hollësisht në vijim. Në rastin në fjalë pretendohet shkelje e nenit 3§2, nenit 6§2 dhe nenit 7 të konventës. Në përfundim të procesit, Komiteti arriti në konkluzionin që Shqipëria nuk kishte përmbushur detyrimet që kishte marrë përsipër sipas dispozitave të Konventës dhe duhet të merrte masa që legjislacioni shqiptar të jetë i qartë, transparent dhe i qëndrueshëm dhe më efektiv në lidhje me përgjegjësitë e administratës publike.³⁹⁸

Konventa bën lidhjen e të drejtave mjedisore me të drejtat e njeriut dhe sanksionon parimin e përgjegjësisë qeveritare për mbrojtjen e mjedisit. Po ashtu, ajo deklaron që zhvillimi i qëndrueshëm mund të arrihet vetëm nëpërmjet përfshirjes së të gjithë palëve të interesuara, duke lehtësuar ndërveprimin midis publikut dhe autoriteteve, në një kontekst demokratik. Në këtë kuptim, ajo nuk është thjesht një marrëveshje mjedisore, por është në të njëjtën kohë edhe një marrëveshje mbi përgjegjshmërinë, transparencën dhe demokratizimin e qeverisjes.

Që në preambul, konventa thekson se mbrojtja e duhur e mjedisit është thelbësore për mirëqenien e njerëzve dhe ushtrimin e të drejtave bazë njerëzore, duke përfshirë vetë të drejtën për të jetuar. Duke qenë se e drejta për jetën parashikohet nga neni 2 i KEDNJ, është ky i fundit që ka shërbyer për mbrojtjen e kësaj të drejte në çështjet e shqyrtuara nga GJEDNJ, siç është p.sh. çështja *Öneryildiz kundër Turqisë*, e cila do të trajtohet në vijim.

³⁹⁷ Çështjet e marra në shqyrtim nga Komiteti i Kontrollit të Zbatueshmërisë për periudhën 2004-2011 gjenden në: http://www.unece.org/fileadmin/DAM/env/pp/Media/Publications/ACCC_Jurisprudence_Ecoforum_2011.pdf

³⁹⁸ I gjithë dokumentacioni i çështjes “Petrolifera” gjendet në: <http://www.unece.org/env/pp/compliance/Compliancecommittee/12TableAlbania.html>

Një veçanti e spikatur e Konventës së Aarhusit është formulimi i nenit 1 të saj, ku përmendet shprehimisht qëllimi “...që të kontribuojë në mbrojtjen e të drejtës së **çdo individi të brezave të sotëm e të ardhshëm** [theksimi im], për të jetuar në një mjedis të përshtatshëm për shëndetin dhe mirëqenien e tij...”. Duket qartazi që ky është një qëllim shumë ambicioz për t’u arritur, çka detyroi edhe Mbretërinë e Bashkuar të bënte një deklaratë në momentin e nënshkrimit të konventës, e cila u konfirmua edhe në momentin e ratifikimit, e cila sanksiononte që Mbretëria e Bashkuar e kuptonte referencën e nenit 1 dhe të paragrafit 7 të preambulës “e drejta e çdo personi për të jetuar në një mjedis të përshtatshëm për shëndetin dhe mirëqenien e tij”, si shprehje të një aspirote e cila shërbeu si nxitje për diskutimin e kësaj konvente, me të cilën Mbretëria e Bashkuar është plotësisht dakord. Të drejtat ligjore që çdo palë merr përsipër t’i garantojë sipas nenit 1, janë të kufizuara në të drejtën për të pasur informacion, pjesëmarrjen e publikut në vendimmarrje dhe për t’iu drejtuar gjykatës për çështjet e mjedisit, në përputhje me dispozitat e kësaj Konvente.³⁹⁹

Kjo deklaratë nuk është një rezervë, në kuptim të nenit 2 të Konventës së Vjenës Për të Drejtën e Traktateve të vitit 1969, e cila e përkufizon rezervën si një “...deklaratë të njëanshme, pavarësisht se si është shprehur apo emërtuar, e bërë nga një Shtet, në kohën e nënshkrimit, ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit të një traktati, me anën e të cilit ai synon të përjashtojë ose modifikojë efektet ligjore të dispozitave të caktuara të traktatit në zbatimin e tyre në atë Shtet.” Siç shihet nga teksti i deklaratës, Mbretëria e Bashkuar nuk synon të përjashtojë ose modifikojë efektet ligjore të ndonjë prej dispozitave të Konventës së Aarhusit, por synon të sqarojë që ajo nuk pranon që dispozitat e kësaj konvente të mund të përdoren në të ardhmen si bazë ligjore që subjekte të ndryshme të pretendojnë para gjykatave të saj mospërbushjen e detyrimit për t’i garantuar çdo personi, të brezave të sotëm e të ardhshëm, të drejtën për të jetuar në një mjedis të përshtatshëm për shëndetin dhe mirëqenien e tij. Ajo sqaron që konventa formulon një aspiratë, por nuk përcakton një detyrim ligjor në nenin 1 të saj. Duket që me këtë interpretim të Mbretërisë së Bashkuar janë dakord të gjitha shtetet e tjera palë, pasi asnjë prej tyre nuk e ka kundërshtuar këtë deklaratë.

Nenet 2 dhe 3 përmbajnë respektivisht përkufizime dhe klauzola të përgjithshme. Veçantia e tyre qëndron në faktin që si subjektet që gëzojnë të drejtat (publiku), ashtu edhe ato që kanë detyrimet ndaj tyre (autoritetet publike), përfshirë edhe vetë informacionin mjedisor, janë përkufizuar në mënyrë të gjerë. Kështu, “publiku” nënkupton një ose shumë persona fizikë ose juridikë, në përputhje me legjislacionin e praktikat kombëtare, shoqatat, organizatat dhe grupimet e tyre, ndërsa “publiku i interesuar” nënkupton publikun e ndikuar ose që mund të ndikohet, apo që është i interesuar për vendimmarrjen mjedisore, ku specifikohet që për qëllimet e këtij përkufizimi, shoqatat joqeveritare që promovojnë mbrojtjen e mjedisit dhe që plotësojnë kërkesat e parashikuara në ligjet kombëtare konsiderohen subjekte të interesuara. Ndërsa “autoriteti publik” nënkupton: (a) Qeverinë në nivel kombëtar, rajonal, dhe nivel tjetër; (b) Personat fizikë ose juridikë, që kryejnë funksione publike administrative, sipas ligjit kombëtar, duke përfshirë dhe detyra, veprimtari ose shërbime të veçanta në lidhje me mjedisin; (c) Çdo person tjetër fizik ose juridik, që ka përgjegjësi ose funksione publike, ose që ofron shërbime publike, në lidhje me mjedisin, nën kontrollin e një organi ose personi, i cili përfshihet në pikat “a” ose “b”;

³⁹⁹ Rezerva e Mbretërisë së Bashkuar gjendet në:

https://treaties.un.org/Pages/ViewDetails.aspx?src=TREATY&mtdsg_no=XXVII-13&chapter=27&lang=en

(ç) Institucionet e çdo organizate rajonale të integritit ekonomik e cila është palë në Konventë. Nga përkufizimi përshtohen vetëm organet ose institucionet gjyqësore ose legislative. Por, ashtu si edhe në rastin e KEDNJ, Konventa e Aarhusit vendos një standard minimum, ndërsa palët janë të lira, madje janë të inkurajuara të vendosin standarde akoma më të larta në legjislacionet tyre të brendshme. Pikërisht këtë rrugë ka ndjekur Bashkimi Evropian, i cili me Rregulloren 1367/2006 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, të analizuar në vijim, sanksionoi që dispozitat e Konventës mbi informacionin mjedisor do të zbatohen edhe ndaj institucioneve dhe autoriteteve komunitare me karakter legjislativ.⁴⁰⁰ Ndërsa “*informacioni mjedisor*” nënkupton çdo informacion me shkrim, vizual, gojor, elektronik ose çdo lloj forme tjetër materialit mbi: (a) Gjendjen e elementeve të mjedisit, të tilla si, ajri e atmosfera, uji, toka, peizazhi e shumëllojshmëria biologjike dhe komponentët e tij, duke përfshirë organizmat e modifikuar gjenetikë dhe ndërveprimin midis këtyre elementeve; (b) Faktorë, të tillë si substancat, energjia, zhurmat e rrezatimi, dhe veprimtaritë ose masat, përfshirë masat administrative, marrëveshjet mjedisore, politikat, legjislacionin, planet dhe programet, të cilat ndikojnë ose mund të ndikojnë elementet e mjedisit, brenda fushës së pikës “a”, kostot-përfitimet dhe analizat e tjera ekonomike; (c) Gjendjen e shëndetit të njeriut dhe sigurisë së tij, kushtet e jetës njerëzore, vendet kulturore dhe strukturat e ndërtuara nga njeriu, në shkallën në të cilën ato ndikohen ose mund të ndikohen nga gjendja e elementeve të mjedisit, ose përmes këtyre elementeve, nga faktorët, veprimtaritë, ose masat e referuara në pikën “b”.

Në vijim, neni 4 parashikon të drejtën për të marrë informacion për çështjet e mjedisit, brenda kuadrit të ligjit kombëtar, pa qenë e nevojshme që kërkuesi të argumentojë se përse e kërkon këtë informacion. Këtu parashikohen gjithashtu edhe rastet kur autoritetet publike mund të refuzojnë dhënien e informacionit mjedisor, kur dhënia e tij mund të ndikojë negativisht në: (a) konfidencialitetin e procedurave të autoriteteve publike, kur një konfidencialitet i tillë parashikohet nga ligji kombëtar; (b) Marrëdhëniet ndërkombëtare, mbrojtjen kombëtare ose sigurimin publik; (c) Mënyrën e gjyqimit, aftësinë e një personi për të pasur një proces të rregullt gjyqësor ose aftësinë e një autoriteti publik për të kryer një hetim të një natyre disiplinore ose penale; (ç) Konfidencialitetin e informacionit tregtar dhe industrial, në rast se një konfidencialitet i tillë mbrohet me ligj, me qëllim që të mbrohet një interes i ligjshëm ekonomik; (d) Pronësinë intelektuale; (dh) Konfidencialitetin e të dhënave personale dhe/ose dosjeve që kanë lidhje me një person fizik, kur ky person nuk ka dhënë pëlqimin e tij për dhënien e informacionit për publikun, kur një konfidencialitet i tillë parashikohet në ligjin kombëtar; (e) Interesat e një pale të tretë, e cilat e ka dhënë informacionin e kërkuar, por pa qenë e aftë ose pa qenë e detyruar nga ana ligjore për ta bërë këtë dhe ku ajo palë nuk ka dhënë pëlqimin e saj për dhënien e këtij materiali; ose (ë) Mjedisin, me të cilin lidhet informacioni, siç është folezimi i specieve të rralla. Pavarësisht të gjitha këtyre kufizimeve, dispozita sanksionon se arsyet e refuzimit duhet të interpretohen në një mënyrë të kufizuar, duke pasur parasysh që dhënia e informacionit t'i shërbejë interesit publik dhe duke pasur parasysh nëse informacioni lidhet me shkarkimet në mjedis.

Ndaj këtyre tre dispozitave, neneve 4, 5 dhe 6, Franca bëri një deklaratë interpretuese, të së njëjtës natyrë me atë të Mbretërisë së Bashkuar, ku theksonte se ajo do të realizonte shpërndarjen e informacionit përkatës për mbrojtjen e mjedisit, por në të njëjtën kohë, do të garantonte ruajtjen e sekreteve industriale dhe tregtare në përputhje me praktikën e konsoliduar ligjore të saj. Zvicra

⁴⁰⁰ *Infra.*, shënimi fundor nr. 402.

bëri rezervë vetëm ndaj nenit 4, duke u shprehur që në fushën e energjisë bërthamore dhe të mbrojtjes nga rrezatimi, zbatimi i nenit 4 të konventës varet prej nenit 23 të Ligjit mbi Parimin e Transparencës së Administrimit, datë 17.12.2004, i cili garanton akses në dokumentet zyrtare të nxjerra prej autoriteteve pas 1 korrikut 2006, datë në të cilën ligji hyri në fuqi, kur ka kërkesa për dokumente që përmbajnë informacion mbi instalimet bërthamore. Edhe Gjermania bëri një deklaratë referuar të gjithë tekstit të konventës, pasi në këndvështrimin e saj, konventa ngrinte një numër pyetjesh të vështira për sa i përket zbatimit në praktikë në sistemin e saj ligjor, të cilat nuk do të mund të merrnin përgjigje gjatë kohës në dispozicion për nënshkrimin e konventës. Gjithësesi, ajo shprehu besimin se zbatimi i konventës nëpërmjet sistemit të saj administrativ nuk do të pengonte arrijten e objektivave të konventës.⁴⁰¹

Raporti midis Konventës së Aarhusit dhe *acquis communautaire* del prej interpretimit të disa prej dispozitave të traktateve të BE. Kështu p.sh. neni 19§1 i Traktatit të Bashkimit Evropian (TBE) sanksionon që shtetet anëtare sigurojnë rrugë ligjore të mjaftueshme për të garantuar mbrojtjen efektive juridike në fushat që mbulon e drejta e Bashkimit, e në këtë kuptim përfshihet edhe mbrojtja e mjedisit. Po ashtu, neni 37 i Kartës së të Drejtave Themelore të BE parashikon se një nivel i lartë i mbrojtjes mjedisore dhe përmirësimi i cilësisë së mjedisit, duhet të integrohen në politikat e Bashkimit, si dhe të garantohen në përputhje me parimin e zhvillimit të qëndrueshëm. Ndërsa neni 47 i saj parashikon që kushdo, të cilit i janë shkelur të drejtat dhe liritë e garantuara nga e drejta e Bashkimit, ka të drejtën për të marrë zgjidhje ligjore efektive para gjykatës, ka të drejtën për gjykim të drejtë dhe publik, brenda një afati kohor të arsyeshëm, para një gjykate të pavarur dhe të paanshme, të krijuar më parë me ligj.

Në bazë të këtyre dispozitave, është nxjerrë edhe legjislacioni përkatës në nivelin e BE për zbatimin e Konventës së Aarhusit. Për zbatimin e konventës, si e tërë, në nivelin e institucioneve dhe entiteteve të BE është miratuar Rregullorja 1367/2006.⁴⁰² Ndërsa për zbatimin e Shtyllës I, të drejtës për të marrë informacion, në nivelin e shteteve anëtare, është miratuar Direktiva 2003/4.⁴⁰³ Për zbatimin e Shtyllës II, të drejtës për të marrë pjesë në vendimmarrje, është miratuar Direktiva 2003/35.⁴⁰⁴ Për zbatimin e Shtyllës III, është bërë Propozimi COM(2003)624,⁴⁰⁵ datë 24.10.2003, i Komisionit Evropian drejtuar Parlamentit dhe Këshillit për të nxjerrë një direktivë për të drejtën për t'iu drejtuar gjykatës për çështjet mjedisore, i cili nuk është pranuar, për shkak të pretendimeve të shteteve anëtare për shkeljen e parimit të subsidiaritetit, me fjalë të tjera, ruajtjen e autonomisë së shteteve të tyre ligjore. Por kjo autonomi e tyre është e lidhur me detyrimin për plotësimin e dy kushteve: a) respektimin e parimit të barazvlefshmërisë, që do të thotë se rregullat procedurale që garantojnë zbatimin e së drejtës komunitare nuk duhet të jenë më pak të favorshme se ato që garantojnë zbatimin e të

⁴⁰¹ Rezervat e bëra ndaj Konventës së Aarhusit gjenden në:

https://treaties.un.org/Pages/ViewDetails.aspx?src=TREATY&mtmsg_no=XXVII-13&chapter=27&lang=en

⁴⁰² Rregullorja 1367/2006 gjendet në: [http://eur-](http://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=OJ:L:2006:264:0013:0019:EN:PDF)

[lex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=OJ:L:2006:264:0013:0019:EN:PDF](http://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=OJ:L:2006:264:0013:0019:EN:PDF)

⁴⁰³ Direktiva 2003/4 gjendet në: [http://eur-](http://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=OJ:L:2003:041:0026:0032:EN:PDF)

[lex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=OJ:L:2003:041:0026:0032:EN:PDF](http://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=OJ:L:2003:041:0026:0032:EN:PDF)

⁴⁰⁴ Direktiva 2003/35 gjendet në: http://eur-lex.europa.eu/resource.html?uri=cellar:4a80a6c9-cdb3-4e27-a721-d5df1a0535bc.0004.02/DOC_1&format=PDF

⁴⁰⁵ Gjendet në:

[http://www.europarl.europa.eu/registre/docs_autres_institutions/commission_europeenne/com/2003/0624/COM_CO M\(2003\)0624_EN.pdf](http://www.europarl.europa.eu/registre/docs_autres_institutions/commission_europeenne/com/2003/0624/COM_CO M(2003)0624_EN.pdf)

drejtës së brendshme; b) respektimin e parimit të efektivitetit, që do të thotë se zbatimi i rregullave procedurale nuk duhet të vështirësojë mbrojtjen e të drejtave që burojnë prej legjislacionit komunitar.⁴⁰⁶

Propozimi i jep të drejtën anëtarëve të publikut të fillojnë procedurat administrative ose gjyqësore kundër veprimeve ose mosveprimeve që shkelin normat e të drejtës së mjedisit. Kështu, nenet 3 dhe 4 i detyrojnë shtetet anëtare t'u japin të drejtën anëtarëve të publikut, kur ata plotësojnë kriteret sipas legjislacionit të brendshëm, që të kenë akses në procedurat për të kundërshtuar aktet e personave privatë dhe publikë që shkelin normat mjedisore, përfshirë të drejtën për të kërkuar marrjen e masave të sigurimit të padisë. Ndërsa neni 5 i detyron shtetet anëtare t'u japin të drejtën OJF mjedisore që të kenë akses në procedurat, përfshirë të drejtën për të kërkuar marrjen e masave të sigurimit të padisë, pa patur nevojë të provojnë se kanë ndonjë interes apo se u është cënuar ndonjë e drejtë, nëse çështja konkrete përfshihet në statutin e tyre dhe në zonën gjeografike të veprimtarisë së tyre. Një përpjekje tjetër u bë nga Komisioni edhe nëpërmjet Komunikimit COM(2012) 95, datë 7.3.2012,⁴⁰⁷ drejtuar Parlamentit, Këshillit, Komitetit Evropian Ekonomik dhe Social, dhe Komitetit të Rajoneve, por nuk patur asnjë zhvillim në këtë drejtim.

Pavarësisht se ende nuk është nxjerrë një direktivë për të drejtën për t'iu drejtuar gjykatës për çështjet mjedisore në kuadrin e *acquis communautaire*, ka një jurisprudencë të konsoliduar të GJED e cila ka vendosur që Konventa e Aarhusit tashmë është pjesë integrale e regjimit juridik të Bashkimit Evropian.⁴⁰⁸

Përveç këtyre, edhe legjislacioni i analizuar në Kreun VI mbi vlerësimin e ndikimit në mjedis, ku përfshihen Direktiva 2009/31/EC, amenduar prej Direktivës 2011/92/EU, edhe kjo e amenduar prej Direktivës 2014/52/EU, Direktiva 2008/1/EC dhe Direktiva 2010/75/EU për Shkarkimet Industriale (Parandalimi dhe Kontrolli i Integruar i Ndotjes),⁴⁰⁹ së bashku me Direktivën 2004/35/CE për përgjegjësinë në lidhje me parandalimin dhe riparimin e dëmeve mjedisore,⁴¹⁰ ka vënë në zbatim dispozitat e Konventës së Aarhusit.

Në vijim do të bëhet një analizë e përmblendhur e tre shtyllave të konventës.

⁴⁰⁶ Shih vendimin e GJED, C-312/93, datë 14.12.1995, *Peterbroeck kundër Belgjikës*, parag. 9 dhe 12. Gjetet në: <http://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:61993CJ0312&from=EN>

⁴⁰⁷ Komunikimi COM(2012) 95 gjendet në: <http://cor.europa.eu/en/activities/stakeholders/Documents/com2012-95final.pdf>

⁴⁰⁸ Ndër të tjera, shih vendimin e GJED C-344/04 IATA dhe ELFAA datë 10.1.2006, paragrafi 36. Gjetet në: <http://curia.europa.eu/juris/showPdf.jsf?text=&docid=57285&pageIndex=0&doclang=en&mode=lst&dir=&occ=firs t&part=1&cid=302388>

Vendimi C-459/03, *Komisioni kundër Irlandës*, datë 30.5. 2006, paragrafi 82. Gjetet në: <http://curia.europa.eu/juris/showPdf.jsf?text=&docid=57551&pageIndex=0&doclang=en&mode=lst&dir=&occ=firs t&part=1&cid=302191>

⁴⁰⁹ Direktiva 2010/75/EU gjendet në: <http://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=OJ:L:2010:334:0017:0119:en:PDF>

⁴¹⁰ Direktiva 2004/35/CE gjendet në: <http://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=OJ:L:2004:143:0056:0075:en:PDF>

7.2.1 E drejta për të marrë informacion për çështjet e mjedisit.

E drejta e publikut për të marrë informacion është një premisë themelore e një sistemi qeverisës demokratik. Prej saj varen shumë të drejta të tjera, përfshirë të drejtën e lirisë së fjalës, të drejtën e votës, etj. Në fushën e mjedisit, nenet 4 dhe 5 të Konventës së Aarhusit detyrojnë palët të garantojnë që autoritetet publike duhet të zotërojnë informacion mjedisor të përditësuar, duhet të kenë sisteme funksionale që sigurojnë dhënie të vazhdueshme të informacionit mjedisor dhe në rast të ndonjë kërcënimi serioz të shëndetit të njeriut ose mjedisit, i gjithë informacioni që mund të ndihmojë publikun të marrë masa për të parandaluar ose zbutur dënimin që rrjedh nga ky kërcënim, duhet të shpërndahet menjëherë dhe pa vonesë. Po ashtu, mënyra me të cilën autoritetet publike e bëjnë informacionin mjedisor të disponueshëm për publikun duhet të jetë transparente dhe e drejta për ta pasur atë të ushtrohet efektivisht, duke i dhënë publikut informacion të mjaftueshëm, duke i siguruar disponueshmërinë e listave, regjistrave ose dosjeve informative, duke identifikuar pikat e kontaktit, duke dhënë pa pagesë informacionin që përmbajnë listat, regjistrat ose dosjet, si edhe duke siguruar disponueshmërinë e këtij informacioni në mënyrë elektronike. Informacioni duhet të jepet jo më vonë se një muaj pas paraqitjes së kërkesës, nëse volumi dhe kompleksiteti i informacionit e justifikon zgjatjen e kësaj periudhe deri në dy muaj pas kërkesës. Kërkuesi i informacionit do të informohet për çdo shtyrje të afatit kohor dhe për arsyet që justifikojnë këtë shtyrje. Nga ana tjetër, çdo palë duhet të inkurajojë zhvilluesit, veprimtaria e të cilëve ka një ndikim të dukshëm mbi mjedis, të informojë publikun rregullisht mbi ndikimet mjedisore të veprimtarive dhe prodhimeve të tyre.

Në kontekstin evropian, përpara Konventës së Aarhusit, e drejta për të marrë informacion për çështjet e mjedisit ishte sanksionuar edhe në Direktivën e Këshillit 90/313/EEC, datë 7.6.1990, që mbante pikërisht këtë titull dhe që sanksiononte detyrimin e shteteve anëtare për t'i garantuar çdo personi fizik dhe juridik në të gjithë Komunitetin, të drejtën për të marrë informacion për çështjet e mjedisit. Informacioni i cili mbahej prej autoriteteve publike duhet të jepej në formë të shkruar, me gojë, nëpërmjet mjeteve pamore, dëgjimore, apo në formën e bazës së të dhënave, rreth gjendjes së mjedisit, aktiviteteve apo masave që ndikojnë apo që mund të ndikojnë negativisht në mjedis.⁴¹¹

Në kontekstin më të gjerë evropian, në kuadrin e Këshillit të Evropës, e drejta për të marrë informacion për çështjet e mjedisit ishte sanksionuar edhe në Konventën mbi Përgjegjësinë Civile për Dëmet e Shkaktuara prej Aktiviteteve të Dëmshme për Mjedisin, të miratuar, në Lugano, në 21 qershor 1993.⁴¹² I gjithë Kreu III i saj i kushtohet të drejtës për të marrë informacion, ku neni 13 jep një përkufizim të ngushtë të autoriteteve publike qendrore e vendore që zotërojnë informacion mjedisor, duke përjashtuar organet legjislative e gjyqësore. Përveç këtyre autoriteteve publike, neni 15 parashikon të drejtën e marrjes së informacionit edhe prej enteve që ushtrojnë funksione publike për mjedisin apo që janë nën kontrollin e një autoriteti publik. Informacioni duhet të jepet prej autoritetit publik ose prej vetë enteve. Ndërsa neni 16 parashikon të drejtën e marrjes së informacioneve specifike që posedohen prej operatorëve të ndryshëm. Këtu i njihet e drejta një personi që ka pësuar një dëm që t'i drejtohet gjykatës, duke

⁴¹¹ Direktiva e Këshillit 90/313/EEC, datë 7.6.1990, gjendet në: <http://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=CELEX:31990L0313:EN:HTML>

⁴¹² Konventa e Luganos gjendet në: <http://conventions.coe.int/Treaty/en/Treaties/Html/150.htm>

kërkuar që të urdhërojë një operator që ta pajisë me informacion specifik, për aq sa kjo është e nevojshme për të vërtetuar ekzistencën e një pretendimi për dëmshpërblim sipas Konventës. Gjykata mund ta rrëzojë një kërkesë të tillë vetëm në rastet kur operatori ngarkohet me një barrë jo-proporcionale, duke mbajtur parasysh interesat e të gjithë subjekteve të përfshirë. Për të marrë informacion nuk nevojitet të provohet interesi i kërkuesit, ndërsa dhënia e informacionit mund të refuzohet vetëm në rastet përjashtimore, që janë të ngjashme me ato të Konventës së Aarhusit e që do trajtohen në vijim.

Nga një këndvështrim i ngushtë, e drejta e publikut për të marrë informacion duket sikur përfshin vetëm një 'trafik' informacioni me një kah: publiku e kërkon dhe autoritetet publike e ofrojnë, e ashtuquajtura marrje 'aktive' informacioni. Në fakt, e parë në një këndvështrim më të gjerë, e drejta e publikut për të marrë informacion jo vetëm që duhet të përfshijë edhe atë që quhet marrje 'pasive' informacioni, që do të thotë që autoritetet publike me iniciativën e tyre duhet të ofrojnë rregullisht informacion të përditësuar në lidhje me mjedisin dhe problematikat që lidhen me të, por duhet të përfshijë edhe dhënien e informacionit dhe edukimin e publikut gjatë gjithë jetës, duke filluar që nga cikli më i ulët i sistemit arsimor, e deri në ciklet më të larta. Kjo është një domosdoshmëri në kushtet aktuale edhe për vendin tonë, pasi vetëm një popullsi e mirëinformuar për çështjet e mjedisit përbën premisë për të ecur në rrugën e zhvillimit të qëndrueshëm. E drejta e publikut për të marrë informacion për çështjet e mjedisit është baza dhe pika e nisjes për të realizuar të drejtën tjetër të lidhur ngushtë me të, pjesëmarrjen në vendimmarrjen mjedisore, që do të trajtohet në seksionin pasardhës të këtij punimi.

Përveç të gjithë shteteve anëtare në mënyrë individuale, vetë Bashkimi Evropian u bë palë në Konventën e Aarhusit, duke e nënshkruar atë në 25 qershor 1998 e duke aderuar më pas në 17 shkurt 2005. Dispozitat e konventës filluan të bëhen pjesë e *acquis communautaire* nëpërmjet Direktivës 2003/4 dhe Direktivës 2003/35, ku kjo e fundit amendoi dy direktiva të mëparshme: Direktivën 85/337/EEC, për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, të përmendur më sipër, dhe Direktivën 96/61/EC, për Parandalimin dhe Kontrollin e Integruar të Ndotjes.

Më tej, për të bërë të mundur zbatimin e konventës prej institucioneve komunitare, u miratua edhe Rregullorja 1367/2006, e Parlamentit Evropian dhe Këshillit.⁴¹³ Që në preambulën e saj rregullorja përcakton se e drejta për të marrë informacion u takon individëve dhe organizatave të tyre, informacion që mund t'ua kërkojnë autoriteteve publike kurdoherë që ato ushtrojnë kompetencat e tyre. Organizatat që gëzojnë të drejtat perkufizohen në mënyrë të gjerë nga Konventa e Aarhusit, prandaj edhe rregullorja dikton nevojën që institucionet dhe autoritetet komunitare të perkufizohen në po të njëjtën mënyrë. Sipas Konventës së Aarhusit, institucionet dhe autoritetet përjashtohen nga objekti i veprimtarisë së saj kur ushtrojnë funksione gjyqësore apo ligjvënëse. Megjithatë, siç u përmend më sipër, në respektim të parimit të sigurisë juridike dhe për njëtrajtshmëri me Rregulloren (EC) 1049/2001 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit mbi të drejtën e publikut për të marrë informacion nga Parlamenti Evropian, Këshilli dhe Komisioni, rregullorja sanksionoi që dispozitat e Konventës mbi informacionin mjedisor do të zbatohen edhe ndaj institucioneve dhe autoriteteve komunitare me karakter legjislativ.⁴¹⁴

⁴¹³ *Supra.*, shënimi fundor nr. 402.

⁴¹⁴ *Ibid.*, Preambula, paragrafi 7.

Që në nenin 1 të rregullores sanksionohet se kjo është një e drejtë që i garanton publikut marrjen e informacionit mjedisor *të krijuar, të marrë, apo të mbajtur* [theksimi im] prej institucioneve dhe autoriteteve komunitare, duke siguruar që informacioni mjedisor të bëhet i disponueshëm në mënyrë të vazhdueshme dhe t'i shpërndahet publikut. Për këtë qëllim, inkurajohet edhe përdorimi i mjeteve teknologjike e kompjuterike, në mënyrë që informacioni të përhapet në mënyrë transparente, sa më gjerë dhe të bëhen të njohura planet dhe programet që lidhen me mjedisin. Dhënia e informacionit duhet bërë pa asnjë diskriminim bazuar mbi shtetësinë, kombësinë apo vendbanimin, apo në rastet e personave juridikë, pa dallim lidhur me vendin e regjistrimit të tyre.⁴¹⁵

Për shkak të mundësive të mëdha financiare dhe të zhvillimeve teknologjike, përmbushja e detyrimeve që cakton konventa për shpërndarjen aktive të informacionit në kuadrin e BE realizohet edhe nëpërmjet teknologjive moderne që përfshijnë internetin dhe satelitët. Edhe në kushtet e shtëpisë, nëpërmjet një kompjuteri mund të shihen të gjitha zonat e mbrojtura të rrjetit Natura 2000,⁴¹⁶ të kontrollohet niveli i shkarkimeve në ajër në zonën ku banon, apo të merret informacion i gjithanshëm në lidhje me mjedisin. Sasi të jashtëzakonshme informacioni mbahen prej Agjencisë Evropiane të Mjedisit,⁴¹⁷ informacion i mundësuar nga Rrjeti Evropian i Informacionit dhe Vëzhgimit Mjedisor (EIONET), i cili është një rrjet ku bashkëpunojnë autoritetet mjedisore kombëtare dhe qendra kërkimi shkencor publike e private nga shumë vende, për të ofruar informacion mjedisor të saktë e të përditësuar, ekspertizë profesionale për të vlerësuar gjendjen e mjedisit dhe për të identifikuar problemet mjedisore. EIONET përbëhet prej Agjencisë Evropiane të Mjedisit, 6 Qendrave Evropiane Tematike⁴¹⁸ dhe një rrjet prej rreth 1000 ekspertësh nga 39 vende që punojnë në 350 autoritete dhe agjenci mjedisore dhe që merren me informacionin mjedisor. Këto janë të ashtuquajturat Pikat Kryesore Kombëtare (NFP) dhe Qendrat Kombëtare të Referencës (NRC). Nëpërmjet dhënies së informacionit orientohen edhe politikëbërësit që të marrin masat e duhura për mbrojtjen e mjedisit në nivel kombëtar dhe evropian e të monitorojnë vazhdimisht efektivitetin e politikave të tyre.⁴¹⁹

Përveç këtij rrjeti, një rol të rëndësishëm luan edhe Rrjeti i Bashkimit Evropian për Zbatimin dhe Imponimin e së Drejtës Mjedisore (IMPEL),⁴²⁰ një organizatë jo-fitimprurëse ndërkombëtare, e formuar prej autoriteteve mjedisore të shteteve anëtare të BE, së bashku me vende kandidatë, vende të Zonës Ekonomike Evropiane (EEA)⁴²¹ dhe të Shoqatës Evropiane të Tregtisë së Lirë (EFTA).⁴²² IMPEL është themeluar në vitin 1992 si një shoqatë jo-zyrtare e autoriteteve të ngarkuara me zbatimin e së drejtës mjedisore, me selinë dhe sekretariatin në Bruksel të Belgjikës. Ajo numëron 47 anëtarë prej 33 vendeve të ndryshme, ku përfshihen të gjithë anëtarët

⁴¹⁵ *Ibid.*, neni 3.

⁴¹⁶ Rrjeti Natura 2000, gjendet në: <http://natura2000.eea.europa.eu/#>

⁴¹⁷ Agjencia Evropiane e Mjedisit: <http://www.eea.europa.eu/>

⁴¹⁸ Qendrat Evropiane Tematike janë qendra ekspertize të kontraktuara prej Agjencisë Evropiane të Mjedisit për të kryer studime specifike në 6 fushat e identifikuar në strategjinë e saj: 1. Ndotja e Ajrit dhe Përballimi i Ndryshimeve Klimatike; 2. Biodiversiteti; 3. Pasojat e Ndryshimeve Klimatike, Dobësitë dhe Përshtatja; 4. Ujërat e Brendshëm, Bregdetarë dhe Detarë; 5. Informacioni dhe Analiza Hapësinore; dhe 6. Konsumi dhe Prodhimi i Qëndrueshëm.

⁴¹⁹ Rrjeti Evropian i Informacionit dhe Vëzhgimit Mjedisor (EIONET): <http://www.eionet.europa.eu/about>

⁴²⁰ Informacion i hollësishëm për IMPEL gjendet në: <http://impel.eu/>

⁴²¹ Zona Ekonomike Evropiane (EEA) përbëhet nga: Islanda, Lihtenshteini dhe Norvegjia.

⁴²² Shoqata Evropiane e Tregtisë së Lirë (EFTA) përbëhet nga: Islanda, Lihtenshteini, Norvegjia dhe Zvicra.

e BE, si edhe Maqedonia, Turqia, Islanda, Norvegjia dhe Zvicra. Objektivi kryesor i saj është sigurimi i zbatimit dhe imponimit të së drejtës mjedisore, si edhe dhënia e shtysës së nevojshme BE për të realizuar zbatimin e saj në mënyrë efektive. Në funksionet kryesore të saj futen: zhvillimi i aktiviteteve me synim rritjen e shkallës së ndërgjegjësimit për çështjet e mjedisit, krijimi dhe forcimi i kapaciteteve, vlerësimi i kërimit shkencor, shkëmbimi i informacionit dhe përvojës në lidhje me zbatimin, bashkëpunimi për sigurimin e zbatimit, si edhe promovimi dhe mbështetja e legjislacionit mjedisor evropian. Të gjitha këto funksione IMPEL i realizon brenda një strukture projekti. Për funksionet e saj të rëndësishme, IMPEL përmendet në një sërë dokumentesh ligjore e të politikave të BE, siç është Vendimi Nr. 1386/2013/EU, datë 20.11.2013, i Parlamentit Evropian dhe Këshillit, për një Program Veprimi Mjedisor të Përgjithshëm të Bashkimit 2020, ‘Të jetojmë mirë, brenda limiteve të planetit tonë’, hartimin e Programit të Shtatë të Veprimit Komunitar të Mjedisit, Rekomandimin 2001/331/EC, datë 4.4.2001, të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, i cili parashikonte kriteret e standardit minimum për inspektimet mjedisore në shtetet anëtare, etj.

Një nga çështjet më të debatueshme në lidhje me të drejtën për të marrë informacion për çështjet e mjedisit është çështja *Mox Plant*.⁴²³ Në rastin konkret, lindi një mosmarrëveshje midis Irlandës dhe Mbretërisë së Bashkuar (MB) në lidhje me ndërtimin e një impianti për riciklimin e plutoniumit, prej ripërpunimit të karburantit bërthamor. Në vitin 1993, MB vendosi ta ndëronte impiantin në Sellafield, në Detin Irlandez,⁴²⁴ në bregun veriperëndimor të Mbretërisë së Bashkuar, 184 km nga brigjet e Irlandës së Veriut, prandaj Republika e Irlandës e kundërshtoi projektin që në fillim dhe kërkoi të merrte informacion të detajuar për funksionimin e impiantit prej MB, në mënyrë që të mbronte mjedisin detar në atë zonë. MB refuzoi të jepte këtë informacion, duke argumentuar se informacioni i kërkuar kishte të bënte me sigurinë bërthamore, çështje e sigurisë kombëtare që përbënte sekret shtetëror, e prandaj nuk mund të jepej.

Fillimisht, çështja u shqyrtua prej Komisionit Evropian, i cili mbështeti pretendimet e ekspertëve të MB dhe vendosi në favor të MB, në Opinionin 97/C 68/03, datë 11.2.1997, bazuar në nenin 37 të Traktatit të Euratomit. Komisioni argumentoi se funksionimi i impiantit nuk dukej të rezultonte në kontaminim radioaktiv nga pikëpamja e shëndetit, ujit, tokës, apo hapësirës ajrore të ndonjë shteti anëtar, si në rast të funksionimit normal të tij, ashtu edhe në rast të ndonjë aksidenti të mundshëm.⁴²⁵

Duke parë që nuk mund të realizonte të drejtën për të marrë informacion nëpërmjet institucioneve evropiane, Irlanda vendosi t’u drejtohej dy mekanizmave të tjerë për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ndërkombëtare të ofruara respektivisht nga Konventa për Mbrojtjen e Mjedisit Detar të Atlantikut Verilindor (OSPAR) dhe Konventa e OKB për të Drejtën e Detit (UNCLOS), konventa në të cilat edhe vetë Komuniteti Evropian ishte palë, se bashku me Irlandën dhe MB.

⁴²³ Detajet e çështjes *Mox Plant*, të gjykuar nga Gjykata Ndërkombëtare për të Drejtën e Detit, gjenden në: <http://www.itlos.org/index.php?id=102#c376>

⁴²⁴ Ky është emërtimi i detit, impianti do të ndërtohej jashtë detit territorial irlandez.

⁴²⁵ Opinioni i Komisionit Evropian, Nr. 97/C 68/03, datë 11.2.1997. Fletorja Zyrtare e KE, Nr. C 68, Vol. 40, 5.3.1997. Gjendet në: <http://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=OJ:C:1997:068:FULL&from=EN>

Bazuar në nenin 32 të Konventës OSPAR, për zgjidhjen e mosmarrëveshjes Irlanda iu drejtua në vitin 2001 Gjykatës së Përhershme të Arbitrazhit (GJPA).⁴²⁶ Neni 9 i Konventës OSPAR sanksionon se palët duhet të garantojnë dhënien e informacionit prej autoriteteve të tyre çdo personi fizik apo juridik, pas kërkesës së tyre, pa qenë nevoja që ata të provojnë se kanë ndonjë interes, pa i detyruar të paguajnë shuma të paarsyeshme, sa më shpejt të jetë e mundur dhe jo më shumë se dy muaj nga data e kërkesës. Informacioni duhet të jepet me shkrim, me gojë, apo në formën e bazës së të dhënave mbi gjendjen e mjedisit në zonën detare, mbi aktivitetet apo masat e marra që ndikojnë apo që mund të ndikojnë në mjedis. Megjithatë, kjo nuk u mohon palëve të drejtën që në përputhje me legjislacionet e tyre kombëtare dhe normat ndërkombëtare të zbatueshme, të refuzojnë dhënien e informacionit kur ai çënon konfidencialitetin e procedurave para autoriteteve publike apo ndërkombëtare, mbrojtjen kombëtare, sigurinë publike, sekretet tregtare, të dhënat personale, etj.

Përveç kësaj, Irlanda iu drejtua edhe Gjykatës Ndërkombëtare për të Drejtën e Detit (ITLOS) për marrjen e masave të përkohshme, në mënyrë që të pengonte MB, që të mos e vinte në funksionim impiantin. Konventa e OKB për të Drejtën e Detit (UNCLOS) sanksionon në nenin 291/1 se asaj mund t'i drejtohen shtetet palë (Irlanda dhe MB janë shtete palë), si edhe subjektet e tjera që në bazë të nenit 305 të saj, janë bërë apo mund të bëhen palë në të. Në të parashikohen katër mjete alternative për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve në fushën e së drejtës ndërkombëtare të detit: 1. ITLOS (e krijuar nga vetë UNCLOS); 2. Gjykatë Arbitrazhi (e krijuar po ashtu nga vetë UNCLOS, sipas aneksit VII të saj – që flet për Arbitrazhin); 3. Gjykatë Arbitrazhi Speciale (edhe kjo e krijuar nga vetë UNCLOS, por sipas aneksit VIII të saj – që flet për Arbitrazhin Special, ku përfshihen: i. Peshkimi; ii. Mbrojtja dhe ruajtja mjedisit detar; iii. Kërkimi shkencor detar; iv. Lundrimi, përfshirë ndotjen prej anijeve dhe transportit detar); 4. GJND. Palët mund të zgjedhin cilindo prej këtyre mjeteve dhe për këtë qëllim, në përputhje me nenin 287 të UNCLOS, ato duhet të bejnë një deklaratë të veçantë, të cilën duhet ta depozitojnë në Sekretariatin e Përgjithshëm të OKB-së.⁴²⁷

Ndërkohë që po zhvillohej gjykimi në GJPA, duke qenë në pritje të vendimit të saj, ITLOS fillimisht mori një vendim të ndërmjetëm në datën 3 dhjetor 2001, ku i detyronte palët të shkëmbenin informacione në lidhje me pasojat e mundshme në Detin Irlandez që mund të vinin prej funksionimit të impiantit Mox Plant, të monitoronin rreziqet e mundshme dhe të merrnin masat e duhura për parandalimin e ndotjes.⁴²⁸

Nga ana e saj, GJPA vendosi ndër të tjera që kishte juridiksion të shqyrtonte çështjen, përkundër pretendimeve të MB se përmbushja e detyrimit për dhënie informacioni nga ana e autoriteteve kombëtare që buronte prej nenit 9§1 të konventës OSPAR mund të kërkohej vetëm në gjykatat kombëtare të MB. Por nga ana tjetër, vendosi të rrëzojë edhe kërkesën e Irlandës për të marrë informacion, me arsyetimin se kërkesa e saj nuk përfshihej prej nenit 9§2 të konventës OSPAR, kështu që MB nuk kishte shkelur ndonjë detyrim në kuptim të nenin 9 të saj. Në fakt, ky ishte thelbi i gjykimit, pasi nga ana e saj, Irlanda pretendonte se Konventa OSPAR e legjitimonte të kërkonte çfarëdolloj informacioni në lidhje me ndikimin në mjedis të Mox Plant, ndërsa MB

⁴²⁶ Vendimi i GJPA gjendet në: <http://www.pca-cpa.org/upload/files/OSPAR%20Award.pdf>

⁴²⁷ Xhezair Zaganjori, “Jurisprudencë dhe praktikë ndërkombëtare”, Adelprint, 2012, fq. 259.

⁴²⁸ Vendimi i ndërmjetëm i ITLOS gjendet në:

http://www.itlos.org/fileadmin/itlos/documents/cases/case_no_10/Order.03.12.01.E.pdf

refuzonte, duke pretenduar që konventa e detyronte të jepte vetëm informacionin që kishte të bënte specifikisht me shkarkimin e materialeve radioaktive në Detin Irlandez. GJPA i dha të drejtë MB, duke e interpretuar në mënyrë të ngushtë nenin 9§2 të konventës OSPAR.

Po ashtu, GJPA rrëzoi edhe pretendimin tjetër irlandez, që gjykata duhej të bënte interpretim të zgjeruar të normave ndërkombëtare për mbrojtjen e mjedisit, përfshirë këtu Parimin 10 të Deklaratës së Rios, Konventën e Aarhusit, si edhe një projektpropozim për një direktivë të re të KE. Në lidhje me parimin, GJPA u shpreh që ai nuk ka fuqi detyruese, ndërsa në Konventën e Aarhusit nuk janë palë as Irlanda e as MB, kështu që projektpropozimi nuk mund të ketë asnjë efekt për palët. Ajo theksoi se neni 9 nuk ishte një dispozitë garantuese për të marrë informacion lirisht dhe se asnjë prej kategorive të informacionit të kërkuar prej Irlandës nuk mund të konsideroheshin se kishin të bënin me zonën detare, në kuptim të nenit 9§2. Madje, edhe nëse neni 9§2 do të përfshinte informacionin që do të kishte të njëjtin kuptim me ‘informacionin mjedisor’, në kuptim të nenit 2§3 të Konventës së Aarhusit, nuk ishte aspak e sigurtë nëse kërkesa e Irlandës do të mund të mund të pranohej edhe në atë eventualitet.

Në 15 shkurt 2007 Irlanda njoftoi zyrtarisht GJPA se i tërhoqte pretendimet kundër MB dhe në 6.6.2008, GJPA vendosi pushimin e çështjes me anën e Vendimit Nr. 6.⁴²⁹ Arsyja e kërkesës së Irlandës për pushimin e çështjes para GJPA, ishte se në 18 qershor 2001 Komisioni Evropian ishte njoftuar prej Sekretariatit të Konventës OSPAR për procedurën e arbitrazhit që kishte filluar midis Irlandës dhe MB. Nga ana e tij, Komisioni iu drejtua Irlandës, duke iu referuar nenit 292 të Traktatit të KE, dhe nenit 193 të Traktatit të Euratomit, pasi duke iu drejtuar arbitrazhit, Irlanda kishte shkelur juridiksionin ekskluziv të GJED mbi interpretimin dhe zbatimin e së drejtës komunitare. Po ashtu, Komisioni pretendoi se Irlanda kishte shkelur edhe nenin 10 të Traktatit të KE dhe nenin 192 të Traktatit të Euratomit, pasi duke mos u konsultuar me Komisionin para fillimit të procedurës së arbitrazhit, Irlanda kishte penguar arritjen e objektivave prej KE dhe të vetë objektivave të përcaktuar nga Traktati i KE.

Në vendimin e saj, GJED fillimisht bëri dallimin midis kompetencave që kanë shtetet anëtare dhe atyre që ka vetë organizata për çështjet e mbrojtjes së mjedisit. Sipas nenit 176 të Traktatit të KE, kompetenca e Komunitetit për çështjet e mbrojtjes së mjedisit nuk ishte ekskluzive, por në parim ajo ndahej midis Komunitetit dhe shteteve anëtare. Vetë KE mund të bëhej palë në traktate mbi mbrojtjen e mjedisit edhe nëse çështje të veçanta që mbulohen prej këtyre traktateve nuk trajtohen akoma, apo trajtohen vetëm pjesërisht prej dispozitave komunitare. Në kontekstin specifik të UNCLOS, duket që ka një transferim drejt së drejtës komunitare të normave të saj, veçanërisht ato që kanë të bëjnë me ndotjen e zonave detare, posaçërisht nenet 123, 192, 193, 194, 197, 206, 207, 211 dhe 213 të UNCLOS, të cilat rregullohen nga legjislacioni komunitar, disa prej të cilave përmenden shprehimisht në aneksin e Deklaratës së Kompetencës Komunitare që i është bashkëlidhur Vendimit të Këshillit 98/392, me anën e së cilës KE u bë palë në UNCLOS. Nga kjo rrjedh që këto dispozita të UNCLOS përfshihen në kompetencën e KE, kompetencë të cilën Komuniteti ka vendosur ta ushtrojë, duke u bërë palë në të, prandaj edhe këto dispozita janë pjesë e së drejtës komunitare. Kështu që edhe GJED kishte juridiksion për të

⁴²⁹ Gjendet në: <http://www.pca-cpa.org/upload/files/MOX%20Plant%20Order%20No.%206.pdf>

shqyrtuar mosmarrëveshjet që rridhnin prej interpretimit dhe zbatimit të këtyre dispozitave dhe të vlerësonte nëse veprimet e shteteve anëtare ishin në përputhje me to.⁴³⁰

Një marrëveshje ndërkombëtare siç është UNCLOS, nuk mund të ndikojë në ndarjen e përgjegjësiave të përcaktuara në Traktatet e KE dhe për rrjedhojë, as në autonominë e sistemit ligjor komunitar, zbatimin e të cilit e garanton GJED, sipas nenit 220 të Traktatit të KE. Juridiksioni ekskluziv i GJED konfirmohet nga neni 292 dhe neni 220 i Traktatit të KE, sipas të cilit shtetet anëtare merrnin përsipër që çështjet që lidheshin me interpretimin e së drejtës komunitare të mos ia drejtonin për zgjidhje asnjë mekanizmi tjetër, përveç atyre të parashikuar nga vetë traktatet. Për më tepër, vetë UNCLOS e bën qartësisht të mundur respektimin e një rregulli të tillë komunitar mbi juridiksionin ekskluziv, për të ruajtur autonominë e sistemit ligjor komunitar. Nga vetë neni 282 i UNCLOS rrjedh që përderisa ai parashikon procedurat si pasojë e zbatimit të vendimeve të detyrueshme midis palëve, atëherë sistemi i zgjidhjes së mosmarrëveshjeve i parashikuar në Traktatin e KE duhet të ketë përparësi ndaj atij të parashikuar në Pjesën XV të UNCLOS.

Prej këtej, del që nenet 220 dhe 292 të Traktatit të KE ndalojnë fillimin e procedurave para një gjykatë arbitrazhi sipas Aneksit VII të UNCLOS, për zgjidhjen e një mosmarrëveshjeje mbi interpretimin apo zbatimin e dispozitave të konventës, të cilat ndodhen brenda fushës së kompetencës së KE, kompetencë që ky i fundit e shfrytëzoi dukë u bërë palë në konventë, me pasojën që këto dispozita u bënë pjesë përbërëse e së drejtës komunitare. Dështimi i shteteve anëtare për të përmbushur detyrimet që rrjedhin prej së drejtës komunitare të derivuara nga UNCLOS, qartësisht mbulohen nga një prej metodave të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve të caktuara nga Traktati i KE, në kuptim të nenit 292, sipas procedurës së parashikuar në nenin 227 të Traktatit të KE. Në përfundim, GJED vendosi se Irlanda nuk kishte përmbushur detyrimet sipas neneve 10 dhe 292 të Traktatit të KE dhe neneve 192 dhe 193 të Traktatit të Euratomit.⁴³¹

7.2.2 E drejta për të marrë pjesë në vendimmarrje për çështjet e mjedisit.

E drejta e publikut për të marrë pjesë në vendimmarrje ndoshta e ka marrë shtysën prej teorive të Robert Dahl mbi demokracinë pluraliste dhe pjesëmarrëse, ku bëhet fjalë për një shoqëri në të cilën “*demos-i*” është gjithëpërfshirës dhe është ai që ushtron kontrollin përfundimtar mbi vendimet që merren. Për rrjedhojë, rëndësi e madhe duhet t’i kushtohet pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë në vendimmarrje të qytetarëve, jo vetëm nëpërmjet partive politike, por edhe nëpërmjet përfaqësuesve të grupimeve me interesa të ndryshme, siç është shoqëria civile.⁴³²

⁴³⁰ Vendimi i GJED për çështjen *Mox Plant*, Nr. C-459/03, datë 30.5.2006, *Komisioni i Komuniteteve Evropian e kundër Irlandës*, paragraf. 90, 92-95, 108, 110, 120 dhe 121. Gjetet në: http://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/HTML/?ELX_SESSIONID=YLJ7T2PNmp7h5yvgn0hvf0f2sT0SvWshRv9SK5ZfRZN9YY8yL2D1-1697593309?isOldUri=true&uri=CELEX:62003CJ0459

⁴³¹ *Ibid.*, paragraf. 123-126, 128, 133 dhe dispozitivi i vendimit Nr. C-459/03, datë 30 maj 2006, *Komisioni i Komuniteteve Evropian e kundër Irlandës*.

⁴³² Robert A. Dahl, “*Dilemmas of Pluralist Democracy, Autonomy versus Control*”, Yale University Press, 1982. Cituar në: Jane Holder and Maria Lee, “*Environmental Protection, Law and Policy*”, Second Edition, Cambridge University Press, 2007, fq. 115.

E drejta e publikut për të marrë pjesë në vendimmarrje për çështjet e mjedisit trajtohet me hollësi në nenet 6, 7 dhe 8 të konventës, ku përfshihet pjesëmarrja e publikut në vendimet për veprimtari të veçanta, në planet, programet dhe politikat që kanë lidhje me mjedisin, si edhe gjatë përgatitjes së rregulloreve ekzekutive dhe instrumenteve të përgjithshëm ligjorë e normativë. Është e vetëkuptueshme që kjo është një e drejtë e lidhur ngushtë me të mëparshmen, pasi nuk mund të marrësh pjesë në vendimmarrjen mbi mjedisin, pa patur informacion për të. Është një e drejtë që demokratizon procesin e vendimmarrjes, element përbërës i domosdoshëm i asaj që quhet qeverisje e mirë mjedisore. Pakkush mund ta kundërshtojë në parim një të drejtë të tillë, pasi në fund të fundit pasojat e vendimmarrjes mjedisore bien mbi të gjithë pa dallim, prandaj edhe sa më e gjerë të jetë baza e vendimmarrjes, aq më i gjerë është konsensusi, e rrjedhimisht edhe zbatueshmëria e vendimeve. Përveç të tjerave, kjo e drejtë u jep mundësi vendimmarrësve të kenë informacion sa më të plotë, të paraqitur prej të gjithave grupeve të interesit, në mënyrë që vendimi të merret bazuar në një informacion sa më të plotë. Në mënyrë humoristike, e drejta për të marrë pjesë në vendimmarrje është krahasuar me ‘ngrënien e spinaqit’, “*askush nuk e kundërshton, pasi të gjithë e dinë që të bën mirë*”.⁴³³

Përpara Deklaratës së Rios dhe Konventës së Aarhusit, akte të tjera juridike ndërkombëtare të të drejtave të njeriut që parashikojnë të drejtën e publikut për të marrë pjesë në vendimmarrje në kuptimin e gjerë, jo të kufizuar vetëm tek çështjet mjedisore, janë Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut, e miratuar me Rezolutën e Asamblesë së Përgjithshme të OKB 217A(III), e vitit 1948, në nenin 21 të saj⁴³⁴ dhe Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike, i vitit 1966, në nenin 25 të tij.⁴³⁵ Pjesëmarrjen e publikut e parashikon edhe neni 286 i Konventës së Espoo-s për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis në Kontekst Ndërkufitar, e vitit 1991, e cila përcakton se pala e origjinës duhet të sigurojë mundësi për publikun, në fushat e mundshme për t’u prekur, për të marrë pjesë në procedurat përkatëse të vlerësimit të ndikimit të mjedisit në lidhje me veprimtaritë e propozuara dhe do të sigurojë që mundësia e publikut të palës së prekur të jetë e njëjtë me atë që i sigurohet palës së origjinës.

Përveç faktit që vetë BE është palë në Konventën e Aarhusit, e drejta e publikut për të marrë pjesë në vendimmarrje është bërë pjesë e *acquis communautaire* që më parë, nëpërmjet normave për parandalimin dhe kontrollin e integruar të ndotjes dhe vlerësimin e ndikimit në mjedis. Kështu, Direktiva e Këshillit 96/61/EC, datë 24.9.1996, për Parandalimin dhe Kontrollin e Integruar të Ndotjes, në nenin 15 të saj sanksiononte që shtetet anëtare duhej të merrnin të gjitha masat e duhura për të siguruar që të gjitha aplikimet për leje ndërtimi të impianteve të reja apo për ndryshime thelbësore të atyre ekzistuese t’u bëheshin të disponueshme publikut për një periudhë të mjaftueshme kohore për t’i dhënë atij mundësi që të shprehej për to, *përpara* [theksimi im] se autoriteti kompetent të merrte vendimin e tij në lidhje me aplikimin. Pas kësaj, vendimi, së bashku me të paktën një kopje të lejes dhe të çdo azhurnimi të mëtejshëm, si edhe rezultatet e monitorimit të shkarkimeve, sipas kushteve të lejes, duhet të bëheshin publike. Në të njëjtën mënyrë, edhe inventari dhe burimet e shkarkimeve kryesore duhej të publikoheshin çdo

⁴³³Sherry R. Arnstein, “*A Ladder of Citizen Participation*”, Journal of American Planning Association, Vol. 36, 1969, fq. 217. Cituar në: Jane Holder and Maria Lee, “*Environmental Protection, Law and Policy*”, Second Edition, Cambridge University Press, 2007, fq. 85.

⁴³⁴ Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut gjendet në:
<http://www.un.org/cyberschoolbus/humanrights/resources/universal.asp>

⁴³⁵ Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike gjendet në:
<http://www.ohchr.org/en/professionalinterest/pages/ccpr.aspx>

tre vjet nga Komisioni, mbi bazën e të dhënave të ofruara prej vendeve anëtare. Nga ana e tij Komisioni realizon edhe shkëmbimin e të dhënave midis shteteve anëtare dhe industrive të ndryshme, mbi teknikat më të mira të mundshme, monitorimin, dhe zhvillimet e reja, si edhe i publikon rezultatet e shkëmbimit të informacionit çdo tre vjet.⁴³⁶

Në mënyrë të thjeshtuar, kuptimi i së drejtës për të marrë pjesë në vendimmarrje mund të shihet si i ndarë në dy aspekte, në aspektin *material* dhe atë *procedural*. Aspekti material ka të bëjë me vetë thelbin e vendimit që merret, pjesëmarrja e gjerë përmirëson përmbajtjen e tij. Ndërsa aspekti procedural ka të bëjë me faktin që pjesëmarrja në vetvete është pozitive, pavarësisht asaj çka vendoset në fund. Ata që janë pjesë e një procesi janë natyrshëm më të prirur për ta zbatuar atë. Sigurisht, kjo është një ndarje për hir të argumentimit teorik, pasi në praktikë të dy aspektet janë të lidhur ngushtë e të ndërthurur me njëri-tjetrin. Në pjesën më të madhe, vendimmarrja mjedisore i përket një grupi të vogël specialistësh, zakonisht pjesë e një agjencie mjedisore që i është dhënë me ligj ky tagër. Rregullat mbi transparencën dhe përfshirjen sa më të gjerë në këtë vendimmarrje shërbejnë si një ndërmjetës në një rend demokratik, për zbutur ‘tensionin’ midis natyrës politike të vendimmarrjes mjedisore dhe delegimit të së drejtës për të marrë vendimet një grupi ekspertësh që nuk janë të zgjedhur.⁴³⁷

Në fakt, i gjithë procesi është një përplasje interesash të grupeve të ndryshme, sipas interesave që përfaqësojnë, ku tradicionalisht përfshihen ambientalistët, industrialistët, ekspertët, OJF, ndërtuesit, etj. Në vetvete procesi përfshin shpërndarjen e informacionit, njoftimet publike, debatet publike, lobimin, luftën mediatike, investigimet nga ana e medias, konsultimet dhe opinionet e ekspertëve. Një anë tjetër pozitive e të gjithë debatit është që ai mundëson edhe dëgjimin e zërit të atyre që janë më afër problemit, personat mbi të cilët do të bien të parët pasojat e vendimmarrjes. Prej tyre mund të vijnë edhe zgjidhjet më optimale, krahasuar me ata që e shohin problemin nga distanca e janë më pak të interesuar. Edhe perceptimi i rreziqeve mjedisore prej personave që jetojnë më afër problemit mund të marrë parasysh elementë të cilët as ekspertëve të fushës mund të mos u bien ndër mend.

Si ilustrim i një procesi të pjesëmarrjes së publikut në vendimmarrje mund të merret rasti i debatit publik mbi parkun eolik që u propozua të ndërtohej në Karaburun. Në rastin konkret, vendimmarrësit i duhet të balancojnë interesat ekonomike (sigurimi i energjisë, që për më tepër arrihet edhe në përputhje me interesat ambientaliste, pasi është energji e pastër, e prodhuar nga era, energji e rinovueshme), me interesat më të gjera ekologjike (siç është ndikimi negativ tek zogjtë, pasi një numër i konsiderueshëm i tyre vriten prej fletëve gjigande të turbinave të erës), me interesat akoma më të gjera të popullsisë vendase, përfshirë interesin ekonomik të zonës, që është zhvillimi i turizmit. Për të mos folur pastaj për anën estetike, pasi pamja e të gjithë gadishullit do të transformohej rrënjësisht me ngritjen e turbinave, duke humbur bukurinë natyrore.

Një analizë më e hollësishme e përmbajtjes së legjislacionit shqiptar në lidhje me realizimin e të drejtës së pjesëmarrjes së publikut në vendimmarrje bëhet në vijim, në trajtimin e Konventës së Aarhusit dhe legjislacionit shqiptar. Ajo që vihet re ende në Shqipëri është një mungesë e

⁴³⁶ <http://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=CELEX:31996L0061:en:HTML>

⁴³⁷ Jane Holder and Maria Lee, “*Environmental Protection, Law and Policy*”, Second Edition, Cambridge University Press, 2007, fq. 87-89.

theksuar e interesit të publikut për çështjet e mjedisit, pavarësisht një farë ndërgjegjësimiti në rritje kohët e fundit, si rezultat i një aktivizimi më të madh të OJF mjedisore,⁴³⁸ apo kur janë diskutuar çështje delikate me ndikim potencial të jashtëzakonshëm në shkallë vendi, siç ishte diskutimi për sjelljen e armëve kimike siriane për t'u demontuar në Shqipëri.⁴³⁹

Arsyet për një mungesë të tillë angazhimi dhe ndërgjegjësimiti janë të shumta, përfshirë këtu trashëgiminë e lënë nga regjimi totalitar prej disa dekadash, ku individi nuk pyetej për asgjë dhe duhej të priste që për gjithçka zgjidhja të vinte nga qeveria, si edhe çështjet e mentalitetit e të zhvillimit të përgjithshëm shoqëror. Sidomos këto të fundit nuk mund të lihen mënjanë, pasi vetë jeta njerëzore është shpesh e mbërthyer mes tensioneve, kontradiktave dhe konflikteve, sidomos këtu në Shqipëri, të cilat kanë sjellë pasoja katastrofale edhe për mjedisin, përveç dëmeve të jashtëzakonshme në ekonomi, në rendin dhe sigurinë publike, në jetën e shoqërisë në përgjithësi. Mjafton të sjellim ndër mend ngjarjet e vitit të mbrapshtë 1997, ku vetëm pyje u prenë në mënyrë të paligjshme mbi 500.000 m³,⁴⁴⁰ pa llogaritur dëmet e tjera si shkatërrimi i ekosistemeve me lëndë plasëse, masakrat mbi kafshët dhe shpendët prej përdorimit të armëve luftarake të rrëmbyera prej depove të ushtrisë, etj. Siç është shprehur një studiues i njohur: *“Njeriu është një kafshë e veçantë...diapazoni i sjelljeve të tij si një organizëm, praktikisht nuk njuh kufij, meqë ai vetë është krijesë e instinkteve që nuk kufizohen. Në këtë sens, kultura është ajo që vendos limitet në sjelljen njerëzore, duke kompensuar kështu faktin që biologjia nuk ka arritur të vendosë shumë kufizime natyrore...Kultura pra, është hapësira morale brenda së cilës njerëzit jetojnë, ose më mirë, hapësira ku zhvillohen normat zakonore që e bëjnë atë të dallueshme”*.⁴⁴¹

Duke iu rikthyer debatit mbi pjesëmarrjen e publikut në vendimmarrje, në një rast ideal, rezultati përfundimtar i të gjithë procesit të diskutimeve me publikun është një farë kompromisi, ku të gjithë kanë përfituar diçka dhe në të njëjtën kohë kanë hequr dorë nga diçka. Si përherë, dilema e vendimarrjes midis zhvillimit ekonomik dhe mbrojtjes së mjedisit është prezente. Kjo i jep të gjithë procesit të vendimarrjes një natyrë delikate. Çështja bëhet akoma më e komplikuar nëse marrim në konsideratë faktin që vendimmarrësit duhet të mbajnë parasysh edhe interesat e brezave të ardhshëm, që nuk kanë lindur ende.

E rëndësishme është të kuptohet që vlera e procesit të pjesëmarrjes së publikut në vendimmarrje nuk qëndron vetëm tek sasia e informacionit, përfshirë atë shkencor, që mund të përftohet prej debatit, por edhe tek vetë legjitimiteti i tij dhe zgjidhjet optimale që mundëson, duke përfshirë kështu të dy aspektet e diskutuar më sipër, material dhe procedural.⁴⁴²

⁴³⁸ Në këtë drejtim është i spikatur roli i Qendrës Rajonale të Mjedisit për Evropën Qendrore e Lindore (Zyra në Shqipëri - REC Albania), e cila organizon aktivitete të shumta në lidhje me pjesëmarrjen e publikut në vendimmarrjen mjedisore dhe më gjerë. Informacion më i hollësishëm në lidhje me programet e veçanta të REC për këtë qëllim gjendet në: <http://archive.rec.org/REC/Programs/PublicParticipation.html>

⁴³⁹ Për një diskutim më të hollësishëm të problemit të sjelljes së armëve kimike siriane në Shqipëri, autori i këtij punimi ka botuar artikullin “Armët siriane në Shqipëri: vendim politik, por jo ligjor!”. Gjendet në: <http://gazeta-shqip.com/lajme/2013/11/12/armet-siriane-ne-shqiperi-vendim-politik-por-jo-ligjor/>

⁴⁴⁰ Qendra Rajonale e Mjedisit për Evropën Qendrore e Lindore, “*Illegal Logging in South Eastern Europe*.” Szentendre, Hungary, 2010, fq. 38. Gjendet në:

http://www.envsec.org/publications/illegal_logging_in_south_eastern_europe_regional_report_en_oct_2010.pdf

⁴⁴¹ Kai T. Erikson, “*Everything in its path. Destruction of Community in the Buffalo Creek Flood*.”, Simon & Schuster Paperbacks, 1976, fq. 81.

⁴⁴² *Ibid.*, fq. 96

Nga shumica e diskutimeve në literaturë, duket sikur publiku është ai që përherë shqetësohet për mbrojtjen e mjedisit, përkundëjt një administrate që shqetësohet vetëm për zhvillimin ekonomik. Në fakt, në realitet nuk është gjithmonë kështu. Shkalla e pjesëmarrjes së publikut në vendimmarrjen mjedisore varet gjithashtu edhe nga lloji i vendimit që është në shqyrtim dhe nga ndikimi i mundshëm në interesat vetjake të anëtarëve të publikut. Kështu, nuk ngjall të njëjtin interesim, p.sh. një vendim që ka të bëjë me ngritjen e një impianti riciklimi të mbeturinave, krahasuar me vendimin për ndërtimin e një rruge në territoret ku banon komuniteti. Ka disa aspekte, madje për të cilat ndoshta publiku as që do t'ia dijë, por që për vendimmarrësit janë të rëndësishme, përfshi këtu edhe detyrimet që mund të jenë marrë në aspektin ndërkombëtar. Për shembull, çështjet që kanë të bëjnë me ndryshimet klimatike dhe ngrohjen globale janë ilustruese në këtë aspekt. Qeveritë janë të angazhuara në kuadër të traktateve ndërkombëtare për të reduktuar nivelin e çlirimit të dioksidit të karbonit në ajër, e në këtë drejtim janë ndërmarrë edhe nisma të ndryshme, të iniciuara fillimisht nga OJF mjedisore e të mbështetura më pas edhe nga autoritetet publike, siç është nisma për rritjen e numrit të përdoruesve të biçikletave, që të pakësohet numri i makinave në rrugë, e për rrjedhojë edhe niveli i ndotjes prej tyre. Ajo që vihet re, është një reagim pothuajse i papërfillshëm i publikut, në një rast të tillë, kur i preken interesat dhe komoditeti i tij.

Kuptohet që edhe kur ekziston interesimi i publikut për të marrë pjesë në vendimmarrjen mjedisore, influenca e grupeve të ndryshme është e ndryshme. Sidomos për vendime ku janë në lojë interesa të mëdha ekonomike, mjetet dhe burimet, e për rrjedhojë edhe influenca në vendimmarrje që kanë grupet e biznesit dhe të industrisë nuk kanë të krahasuar me ato të individëve apo të OJF. Nëse edhe interesat e grupeve më të dobëta shoqërore nuk mbahen parasysh, rreziku është që i gjithë procesi të shndërrohet në një farsë, e pasojat janë të rënda jo vetëm për vendimin e momentit që merret, por më tepër për zhgënjimin dhe humbjen e besimit të publikut tek i gjithë sistemi, çka sjell edhe mungesën e angazhimit të tij në procese të tjera në të ardhmen.

Ajo që duhet mbajtur parasysh është që ky proces është i vazhdueshëm, jo një destinacion për t'u arritur. Edhe pas vendimmarrjes, debati mund të vazhdojë, pasi ka gjithmonë vend për rishikime e përmirësime, duke mbajtur parasysh edhe rezultatet në praktikë të vetë procesit.

Në jurisprudencë, aspekti procedural i pjesëmarrjes në vendimmarrjen mjedisore u diskutua në çështjen C-263/08, *Djurgården-Lilla Värtans Miljöskyddsförening* (Shoqata e Mbrojtjes së Mjedisit Miljöskyddsförening) kundër *Stockholms kommun genom dess marknämnd* (Bashkisë së Stokholmit), mbi zbatimin e Direktivës 85/337/EEC, që ka të bëjë pikërisht me pjesëmarrjen në vendimmarrjen mjedisore dhe me të drejtën për të vënë në lëvizje mekanizmin e rishikimit të vendimit për miratimin e projekteve që mund të kenë ndikim të rëndësishëm në mjedis.⁴⁴³

Në këtë rast, Bashkia e Stokholmit kishte lidhur një kontratë me një kompani të shpërndarjes së energjisë elektrike për ndërtimin e një tuneli rreth 1 km, i cili përshkonte disa kodra, për të kaluar nëpër të disa kablllo elektrike, që do të zëvendësonin kabllot e tensionit të lartë që ishin mbi tokë. Kjo kërkonte fillimisht heqjen e ujërave nëntokësore që rridhnin në tunel dhe ndërtimin e disa

⁴⁴³ Vendimi Nr. C-263/08, datë 15.10.2009, gjendet në:

<http://curia.europa.eu/juris/document/document.jsf?text=&docid=76763&pageIndex=0&doclang=en&mode=lst&dir=&occ=first&part=1&cid=81993>

objekteve rreth asaj zone që do të thithnin ujin dhe do ta rikthenin në tokë, për të balancuar zvogëlimin e sasisë së ujërave nëntokësore. Bazuar në Kreun 6 të Ligjit për Mjedisin, autoriteti rajonal i Stokholmit vendosi në 27 maj 2004 se bazuar në VNM e kryer për projektin, punimet mund të kishin ndikim të rëndësishëm në mjedis, veçanërisht për ujërat nëntokësore. Por Seksioni Mjedisor i Gjykatës së Stokholmit, me vendimin e datës 13 dhjetor 2006, pranoi kërkesën e bashkisë për të vazhduar punimet për ndërtimin e tunelit, sipas Kreut 11 të Ligjit për Mjedisin. Shoqata për Mbrojtjen e Mjedisit ‘*Miljöskyddsforening*’ e ankimoi vendimin në Gjykatën e Apelit, i cili nuk u pranua, për shkak se kërkuesi nuk kishte plotësuar kushtet e përcaktuar në Ligjin për Mjedisin, i cili kërkonte që shoqata të kishte të paktën 2000 anëtarë, në mënyrë që të mund të ankimonte vendimin. Shoqata ‘*Miljöskyddsforening*’ bëri rekurs në Gjykatën e Lartë kundër vendimit të Gjykatës së Apelit, ku shtrohej pyetja nëse projekti në fjalë përfshihej në fushën e veprimit të Direktivës 85/337, si një projekt i Shtojcës II, pika 10(I), pasi sipas versionit të direktivës në gjuhën suedeze, ajo dispozitë i referohej vetëm nxjerrjes së ujërave nëntokësore për qëllime fitimi. Pyetja tjetër kishte të bënte me të drejtën e ankimit të parashikuar nga Konventa e Aarhusit dhe nëse kushtet e parashikuara nga legjislacioni suedez e kufizonin këtë të drejtë. Gjykata e Lartë suedeze vendosi t’ia referojë çështjen GJED. Në lidhje me pyetjen e parë, GJED vendosi se interpretimi uniform i dispozitave të së drejtës evropiane kërkon që në rast dyshimi, teksti i një dispozite nuk duhet të merret i izoluar në një prej versioneve gjuhësore të tij, por përkundrazi, duhet interpretuar në dritën e versioneve të tjera gjuhësore. Për më tepër, nevoja për një interpretim të tillë kërkon që në rastet kur ka dallime midis këtyre versioneve, dispozita në fjalë duhet interpretuar duke mbajtur parasysh qëllimin dhe kuadrin e përgjithshëm rregullator, pjesë e të cilit ajo është. Në lidhje me pikën 10(I) të Shtojcës II të Direktivës 85/337, dilte qartë nga versionet në anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht, spanjisht, polonisht, etj., se ajo dispozitë përfshinte edhe nxjerrjen e ujërave që nuk kishin qëllime fitimi, prandaj ajo duhej interpretuar në mënyrë të gjerë, pavarësisht qëllimit.

Ndërsa në lidhje me pyetjen e dytë, GJED duhej të vendoste nëse neni 10a i Direktivës 85/337 do të thoshte që publiku i interesuar ka të drejtën të marrë pjesë në procedurën e ankimit kundër një vendimi të gjykatës për miratimin e lejes së zhvillimit, në një kohë që ka patur mundësinë për të marrë pjesë në shqyrtimin gjyqësor dhe të shprehë mendimin e tij. Neni 10a i Direktivës 85/337, duke mbajtur parasysh edhe amendimet që i janë bërë nga Direktiva 2003/35, e cila synoi përafrimin me Konventën e Aarhusit, kërkon që e drejta e publikut të interesuar për t’iu drejtuar gjykatës apo një entiteti tjetër të pavarur, për t’u ankuar për një vendim themeli apo procedural për çështje mjedisore, të jetë e lidhur me plotësimin e disa kushteve. Kështu, sipas tekstit të dispozitës, personat që janë pjesëtarë të publikut të interesuar dhe që kanë një interes të mjaftueshëm, ose nëse këtë e kërkon legjislacioni kombëtar, nëse një prej projekteve brenda fushës së veprimit të Direktivës 85/337 çënon të drejtat e tij, kanë të drejtën e ndjekjes së një procedure ankimi. GJED theksoi se është e qartë prej këtej që çdo OJF që merret më çështjet e mbrojtjes së mjedisit dhe që plotëson kushtet e legjislacionit kombëtar, e gëzon këtë të drejtë. Për më tepër, neni 6§4 i Direktivës 85/337 i garanton publikut të interesuar pjesëmarrje efektive në vendimarrjen mjedisore të projekteve që mund të kenë ndikim të rëndësishëm në mjedis. Fakti që leja e zhvillimit u miratua me vendim të një gjykate administrative, nuk e pengon një shoqatë që plotëson kushtet e mësipërme, që të ushtrojë të drejtën e ndjekjes së një procedure ankimi ndaj këtij vendimi.

Së pari, e drejta e ankimit nuk varet prej faktit nëse autoriteti që dha vendimin është një organ administrativ apo gjyqësor. Së dyti, pjesëmarrja në vendimarrjen mjedisore sipas neneve 2§2 dhe 6§4 të Direktivës 85/337 është e shkëputur dhe ka qëllim të ndryshëm prej shqyrtimit ligjor, pasi ky i fundit mund të kryhet në fund të procedurës. Prej këtej, del që pjesëmarrja në vendimarrjen mjedisore nuk ndikon në kushtet për të përdorur procedurën e ankimit. Prandaj pjesëtarët e publikut të interesuar, në kuptim të neneve 1§2 dhe 10a të Direktivës 85/337, kanë të drejtën e ankimit ndaj vendimit gjyqësor të një vendi anëtar që ka miratuar një leje zhvillimi, pavarësisht rolit që ata mund të kenë luajtur në shqyrtimin e kërkesës duke shprehur mendimin e tyre.

Në lidhje me pyetjen tjetër, nëse shoqatat e vogla mjedisore me karakter lokal, kanë të drejtën e pjesëmarrjes në vendimarrjen mjedisore, por jo të drejtën e ankimit, kur kanë më pak se 2000 anëtarë, sipas legjislacionit kombëtar, gjykata u shpreh se del qartë prej Direktivës 85/337, që ajo bën dallimin midis publikut të interesuar për një prej projekteve që në përgjithësi janë në sferën e veprimtarisë së OJF, dhe nëngrupeve të personave fizikë apo juridikë, të publikut të interesuar, të cilët në kushtet e pozicionit të tyre të veçantë kundrejt projektit në fjalë, sipas nenit 10a, gëzojnë të drejtën e ankimit. Direktiva ia lë të drejtës kombëtare përcaktimin e kushteve për legjitimitimin aktiv (*locus standi*) të subjekteve. Këto kushte mund të jenë pasja e një ‘interesi të mjaftueshëm’ ose ‘cënimi i një të drejte’ dhe në përgjithësi legjislacionet kombëtare përdorin njërin prej këtyre koncepteve, të cilët vlejné edhe për OJF. Nga ana tjetër, gjykata theksoi që numri minimal prej 2000 vetësh që kishte përcaktuar legjislacioni suedez për anëtarësinë e OJF, ka efektin që të përjashtojë OJF lokale nga mundësia për të kontestuar projektet që kanë ndikim të madh në mjedis, në një kohë që vetë përfaqësuesit suedezë pranojnë që vetëm dy prej OJF e plotësojnë këtë kusht. Në këto rrethana, u shpreh gjykata, një sistem i tillë e filtron kaq shumë të drejtën e ankimit, saqë bie ndesh më frymën e direktivës, synimi i së cilës është zbatimi i Konventës së Aarhusit.⁴⁴⁴

Në rastin konkret, GJED ndoqi mendimin e Avokates së Përgjithshme, e cila kishte argumentuar se OJF mjedisore janë mbrojtëse dhe shprehëse të interesave kolektive, të cilat kanë avantazhin se posedojné njohuri teknike, që shpesh individët nuk i zotërojnë, e në këtë mënyrë, ndihmojnë edhe gjykatën për zgjidhjen e drejtë të çështjes. Përveç kësaj, ato mund të shprehin në mënyrë racionale interesat e ndryshme para autoriteteve publike, duke bërë bashkë pretendimet e individëve të ndryshëm, kështu që jo vetëm që nuk i mbingarkojné gjykatat, por krejt e kundërta, bëjnë bashkë disa çështje, në një të vetme. Në kushtet kur Konventa e Aarhusit dhe Direktiva 85/337 nuk pranuan *actio popularis* për çështjet mjedisore, hartuesit e saj vendosën të fuqizojné rolin e OJF mjedisore, duke balancuar kështu kërkesat maksimaliste për *actio popularis*, me ato minimaliste për të drejtën e ankimit individual vetëm në rastet e cënimit të një interesi të drejtpërdrejtë. Kompromisi për dhënien e një vendi të veçantë OJF mjedisore duket shumë i logjikshëm.⁴⁴⁵ Siç shihet, GJED bën një interpretim të tillë të së drejtës komunitare, në mënyrë që ajo të garantojë në mënyrë efektive të drejtën e pjesëmarrjes së publikut në vendimarrjen mjedisore, si një nga shtyllat kryesore të Konventës së Aarhusit.

⁴⁴⁴ *Ibid.*, parag. 32-52 të vendimit.

⁴⁴⁵ Mendimi i Avokates së Përgjithshme Eleanor Sharpston në çështjen C-263/08, parag. 61-63. Gjetet në: <http://curia.europa.eu/juris/document/document.jsf?text=&docid=72567&pageIndex=0&doclang=EN&mode=lst&dir=&occ=first&part=1&cid=6798>

7.2.3. E drejta për t'iu drejtuar gjykatës për çështjet e mjedisit.

Përpjekjet për të fituar të drejtën për t'iu drejtuar gjykatës e kanë zanafillën në vitet '70, fillimisht në SHBA, e më pas në Britaninë e Madhe, për t'u përhapur më pas në vende të tjera. Kjo lëvizje masive është konsideruar si “...rryima më e rëndësishme për formimin e veprimtarisë në interesin publik...e cila fillon me veprimtarinë përfaqësuese...dhe përfundon me ngritjen e pretendimeve [para gjykatave – shënimi im] në interesin publik.”⁴⁴⁶

E drejta për t'iu drejtuar gjykatës për çështjet e mjedisit dallon nga rastet e tjera të mosmarrëveshjeve kur palët i drejtohen gjykatës për të rivendosur në vend të drejtat e tyre private që u janë shkelur, mosmarrëveshje të cilat janë kryesisht të karakterit dypalësh, ndërsa problemet mjedisore janë në vetvete të një natyre policentrike.⁴⁴⁷ Prej këtej, kuptohet që është më e vështirë të argumentosh para gjykatës të drejtën për të mbrojtur të interesa ‘të përgjithshme’.

E drejta për t'iu drejtuar gjykatës për çështjet e mjedisit u parashikua fillimisht nga Parimi 10 i Deklaratës së Rios, e më pas nga neni 9 i Konventës së Aarhusit, i cili sanksionon se palët duhet të sigurojnë që çdo person, i cili mendon se kërkesa e tij për informacion është nënvlerësuar, refuzuar gabimisht, pjesërisht ose tërësisht, i është përgjigjur në mënyrë të pamjaftueshme ose nuk është trajtuar në përputhje me dispozitat e saj, ka të drejtë për të pasur një procedurë shqyrtimi përpara gjykatës ose çdo organi tjetër të pavarur dhe të paanshëm, të krijuar me ligj [theksimi im].⁴⁴⁸ Në rrethanat kur një palë parashikon një shqyrtim të tillë nga një gjykatë, ajo do të sigurojë që ky person të ketë gjithashtu të drejtën për një procedurë të shpejtë dhe efektive, të vendosur me ligj, e cila është pa pagesë ose jo e shtrenjtë, për rishqyrtim prej një autoriteti publik ose nga një organ i pavarur dhe i paanshëm, përveç gjykatës. Vendimet e tyre janë detyruese për autoritetin publik që zotëron informacionin dhe arsyet duhet të jepen me shkrim, të paktën për rastet kur informacioni është refuzuar. Po ashtu, palët, brenda kuadrit të legjislacioneve të tyre kombëtare duhet të sigurojnë që anëtarët e publikut të interesuar kanë interes të mjaftueshëm, ose u është cënuar një e drejtë, në rast se ligji procedural kombëtar e kërkon këtë si parakusht dhe të kenë të drejtën për një procedurë shqyrtimi përpara gjykatës dhe çdo organi tjetër të pavarur dhe të paanshëm, të krijuar me ligj.

Kjo dispozitë që parashikon të drejtën për t'iu drejtuar gjykatës, e konsideruar si shtylla e tretë e Konventës së Aarhusit, përmban në vetvete tre elementë shumë të rëndësishëm, e nuk duhet konsideruar se me të fituar të drejtën për t'iu drejtuar gjykatës, misioni i saj është përmbushur. Në tërësinë e saj, kjo e drejtë përfshin 1. Mundësinë e legjitimitetit aktiv (*locus standi*), pra kush e ka të drejtën për ta vënë në lëvizje, të paraqesë pretendimet në gjykatë; 2. Mundësinë praktike për t'a realizuar këtë të drejtë, mundësinë materiale, në mënyrë që kostot e larta të procesit të

⁴⁴⁶ Carol Harlow, “Public Law and Popular Justice”, Modern Law Review, 2002, Vol. 65, fq. 8-14.

⁴⁴⁷ Elizabeth Fisher, Bettina Lange, Eloise Scotford, “Environmental Law. Text, Cases, Materials.”, Oxford University Press, 2013, fq. 369.

⁴⁴⁸ Ka një dallim nga përkthimi zyrtar që iu bë në fillim nën 6§1 të KEDNJ, ku për arsye të pakuptueshme nuk gjendej togfjalëshi “gjykatë e krijuar me ligj”. Përkthimi zyrtar i nenit 6§1 të KEDNJ, ishte formuluar: “...çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme.” Për fat të mirë, përkthimi i Konventës së Aarhusit është i saktë, përfshin edhe krijimin me ligj të organit ose gjykatës që shqyrton ankimin. Versionet e mëpasme të përkthyer të KEDNJ e kanë korrigjuar gabimin.

mos bëhen pengesë për ta vënë në lëvizje gjykatën; dhe 3. Mundësinë që vendimi që do jepet nga gjykata të rivendosë në vend të drejtën e shkelur.⁴⁴⁹

Referimi në mënyrë të vazhdueshme ndaj legjislacionit kombëtar në nenin 9, nuk do të thotë që palët kanë mundësi t'u shmangen detyrimeve të konventës duke manipuluar rregullimet e tyre të brendshme, pasi kjo do të binte ndesh me Konventën e Vjenës për të Drejtën e Traktateve të vitit 1969,⁴⁵⁰ e cila në nenin 18 të saj sanksionin detyrimin e palëve të një traktati për të mos cënuar objektin dhe qëllimin tij që përpara hyrjes në fuqi të tij, nuk diskutohet më kur traktati është tashmë në veprim. Për më tepër, neni 27 parashikon që një palë nuk mund të përdorë dispozitat e së drejtës së brendshme si justifikim për pamundësinë e tij për të zbatuar një traktat, aq më pak shkaktimin e kësaj pamundësie nga veprimet e vetë asaj. Përkundrazi, referimi ndaj legjislacionit kombëtar synon lënien e lirë të palëve të zgjedhin mënyrën më të përshtatshme sipas sistemeve të tyre të brendshme dhe traditave të tyre për t'u dhënë jetë dispozitave të konventës.

Neni 9 ka të bëjë me mbrojtjen në gjykatë të dy të drejtave të parashikuara në nenet e mëparshëm të konventës, të drejtën e publikut për të marrë informacion për çështjet e mjedisit dhe të drejtën e publikut për të marrë pjesë në vendimmarrjen mjedisore, por gjithashtu edhe me të drejtën për t'iu drejtuar gjykatës për vendime, veprime apo mosveprime që kanë të bëjnë me mjedisin. Parë në këtë prizëm, neni 9 garanton aksesin në gjykatë për të gjitha çështjet mjedisore, por bën një dallim midis 3 kategorive të vendimeve, veprimeve, apo mosveprimeve: 1. Vendimet e refuzimit dhe trajtimi jo në mënyrë e duhur i *kërkesave për informacion mjedisor* [theksimi im] nga ana e autoriteteve publike; 2. Vendimet, veprimet, apo mosveprimet e autoriteteve publike ne lidhje me *lejet, licencat, procedurat e dhënies së tyre* [theksimi im] për aktivitete që ndikojnë në mjedis; 3. Të gjitha llojet e veprimeve apo mosveprimeve të *autoriteteve publike dhe personave privatë* [theksimi im] që bien ndesh me legjislacionin mjedisor kombëtar.⁴⁵¹

Se çfarë përbën interes të mjaftueshëm dhe cënim të një të drejte, konventa e lë në dorën e legjislacioneve kombëtare, me objektivin për t'i dhënë publikut të interesuar të drejta më të zgjeruara për t'iu drejtuar gjykatës. Me qëllim arritjen e këtij objektivi të fundit, konventa e ka përfshirë të drejtën për t'iu drejtuar gjykatës për çështjet e mjedisit për të rritur fuqinë zbatuese të konventës dhe të legjislacioneve të tyre mjedisore kombëtare në mënyrë efektive. Në rastin më të mirë, përpjekjet e publikut duhet t'u bashkohen përpjekjeve të autoriteteve kombëtare për mbrojtjen e mjedisit, e në rastin më të keq, të kundërshtojnë edhe vetë vendimet e autoriteteve, kur ato devijojnë nga qëllimi i mbrojtjes së mjedisit.

Në realitet, vështirësitë për arritjen e realizimit të së drejtës për t'iu drejtuar gjykatës për çështjet e mjedisit janë nga më të ndryshmet. Në disa vende, anëtarët e publikut, përfshirë OJF, nuk gëzojnë të drejtën e legjitimitit aktiv për të kërkuar rivendosjen në vend të të drejtave të tyre të shkelura. Në disa vende të tjera, edhe kur të drejtat procedurale janë të sanksionuara me ligj, procedurat janë shumë të gjata, ose shumë të shtrenjta, sa që ato mbeten jo-efektive. Në disa

⁴⁴⁹ Jane Holder and Maria Lee, "Environmental Protection, Law and Policy", Second Edition, Cambridge University Press, 2007, fq. 116.

⁴⁵⁰ Konventa e Vjenës për të Drejtën e Traktateve gjendet në:

<https://treaties.un.org/doc/Publication/UNTS/Volume%201155/volume-1155-I-18232-English.pdf>

⁴⁵¹ *Supra.*, shënimi fundor nr. 381, fq. 194.

vende të tjera autoritetet gjyqësore nuk e kanë kompetencën e marrjes së masave të sigurimit të padisë, apo të mjeteve të tjera ligjore, që të mund të vënë në zbatim vendimet e tyre.⁴⁵²

E drejta për t'iu drejtuar gjykatës për çështjet e mjedisit, e lidhur me diskutimin mbi gjerësinë e shtrirjes së 'autoriteteve' që kanë detyrimin për dhënien e informacionit, në kuptim të Konventës së Aarhusit, është trajtuar në çështjen *Smartsorce Drainage & Water Reports Ltd v Information Commissioner*, të gjykuar nga Gjykata Administrative e Apelit të Anglisë.⁴⁵³ Thelbi i çështjes kishte të bënte me dhënien përgjigje pyetjes nëse kompanitë private që ofrojnë shërbime publike klasifikohen si 'autoritete publike' në kuptim të Rregulloreve 2(2)(c) dhe 2(2)(d) mbi Informacionin Mjedisor (EIR) të vitit 2004 (Rregulloret SI 2004/3391), rregullore që ishin nxjerrë në zbatim të Konventës së Aarhusit.⁴⁵⁴

Kërkuesi (*Smartsorce*) ishte një biznes i specializuar që ofronte informacion për ujin dhe faturat, vendndodhjen e tubacioneve, e të dhëna të tjera të ngjashme. Në 18 dhjetor 2008 ai u kishte kërkuar informacion në lidhje me shtatë pika të ndryshme, 16 kompanive të ujit sipas rregulloreve që ishin miratuar në zbatim të Konventës së Aarhusit. Kompanitë i ishin përgjigjur vetëm pjesërisht kërkesës, duke dhënë informacion jo të plotë, vetëm për 2 prej 7 pikave, me argumentimin se në radhë të parë ato nuk ishin autoritete publike, e nëse kjo nuk pranohej, ato bënin pjesë në entitetet që përjashtoheshin nga fusha e veprimit të Rregulloreve 2(2)(c) dhe 2(2)(d). Pas kësaj, kërkuesi i ishte drejtuar me një ankim administrativ Komisionerit të Informacionit, i cili në përgjigjen e vet me shkresën e datës 12 mars 2010, u përgjigj se nuk kishte juridiksion të shqyrtonte ankesat kundër kompanive të ujit, pasi sipas tij, ato nuk ishin autoritete publike.

Më tej, kërkuesi iu drejtua Tribunalit të Informacionit (shkalla e parë e ankimit ndaj vendimit të Komisionerit të Informacionit), i cili e konsideroi këtë si një 'çështje pilot' dhe vendosi të pezullojë edhe shqyrtimin e çështjeve të tjera të ngjashme që kishte në proces dhe t'ia dergonte çështjen Gjykatës Administrative të Apelit, që të sqaronte dy aspekte ligjore: 1. Nëse Tribunali i Informacionit kishte juridiksion të shqyrtonte ankimin, i cili në thelb ishte ankim kundër një letre të Komisionerit të Informacionit dhe jo ankim ndaj një vendimi formal; dhe 2. Nëse kompanitë private të ujit klasifikoheshin si 'autoritete publike' në kuptim të Rregulloreve 2(2)(c) dhe 2(2)(d) mbi Informacionin Mjedisor (EIR) të vitit 2004.

Për sa i përket aksesit në gjykatë, Gjykata Administrative e Apelit u shpreh që ajo duhet t'i garantohej kërkuesit, pavarësisht formës me të cilën ishte shprehur Komisioneri i Informacionit, me anë të një letre dhe jo me anë të një vendimi. Forma nuk mund të jetë përcaktuese për këtë qëllim, por përmbajtja e saj. Letra ishte 7 faqe dhe përmbante një analizë ligjore të detajuar, ku përfshinte legjislacionin dhe jurisprudencën përkatëse. Kështu që gjykata vendosi se kishte juridiksion të shqyrtonte çështjen.⁴⁵⁵

⁴⁵² *Supra.*, shënimi fundor nr. 381, fq. 193.

⁴⁵³ Vendimi i Gjykatës Administrative të Apelit të Anglisë gjendet në: http://www.uncece.org/fileadmin/DAM/env/pp/compliance/C2010-55/Communication/Judgment_UpperTribunalNov2010.pdf

⁴⁵⁴ Akte ligjore të së drejtës së brendshme angleze, të nxjerra në zbatim të Konventës së Aarhusit.

⁴⁵⁵ *Ibid.*, parag. 15 dhe 16.

Ndërsa në lidhje me përcaktimin nëse kompanitë e ujit ishin apo jo ‘autoritete publike’, pavarësisht përgjigjes negative, rëndësia e këtij vendimi në këndvështrim të këtij studimi qëndron tek analiza e elementëve që duheshin marrë në konsideratë. Gjykata u mbështet edhe në jurisprudencën e mëparshme, në çështjen e *Kompanive Hekurudhore*, ku ishte vendosur që ato nuk ofronin shërbim publik. Në rastin në fjalë, u shpreh gjykata, kompanitë e ujit kishin akoma më pak elementë të autoriteteve publike sesa kompanitë hekurudhore. Kjo bazuar në faktin që ato nuk përfitonin fonde publike dhe nuk kishin anëtarë të bordeve të tyre drejtuese persona të emëruar nga qeveria. Përpos këtyre elementëve, fakti që disa prej kompanive të ujit ishin në pronësi të kompanive të huaja, që mund t’i blinin apo shisnin sipas dëshirës, tregonte që ato nuk ishin autoritete publike.⁴⁵⁶

Më pas, gjykata i referohet edhe Manualit të Zbatimit të Konventës së Aarhusit,⁴⁵⁷ i cili thekson se zhvillimet e fundit në ‘privatizimin’ e shërbimeve publike e kanë shtuar kompleksitetin e përkufizimit të autoriteteve publike. Konventa e bën të qartë që risi të tilla nuk mund të nxjerrin shërbime të tilla publike jashtë sferës së pjesëmarrjes së publikut dhe informimit të tij. Përveç kësaj, duke vazhduar referimin të manuali, gjykata argumenton se në rastet kur diskutohet kompleksiteti i përkufizimit të një autoriteti publik, ai duhet të vendosë vetë nëse veprimtaria e tij mbulohet prej rregulloreve. Kur ky vendim shtrihet për diskutim çështje ligjore, atëherë duhet kërkuar ndihmë juridike. Në rast mosmarrëveshjeje, kjo duhet t’i referohet Komisionerit të Informacionit, Tribunalit të Informacionit, e së fundmi, gjykatave për të vendosur. Për të vendosur në rastin konkret, gjykata renditi katër elementët përcaktues të një autoriteti publik: 1. Masën e financimit prej fondeve publike për ushtrimin e veprimtarisë së tij; 2. Ushtrimin e këtyre funksioneve sipas statutit të tij të përcaktuar me ligj; 3. Marrjen përsipër të ushtrimit të ndonjë prej funksioneve të qeverisë qendrore apo vendore; dhe 4. Ofrimin e një shërbimi publik. Si elementë shtesë të analizuar në çështjen e *Kompanive Hekurudhore*, u përfshinë edhe: 5. Ushtrimi i funksioneve rregullatore; dhe 6. Shkalla e ushtrimit të kontrollit qeveritar. Gjykata angleze u shpreh se fakti i ushtrimit të një aktiviteti prej një entiteti të pavarur, pavarësisht se si është krijuar apo financuar, si një veprimtari tregtare, në kushtet e konkurrencës në treg dhe sipas ligjeve të tregut, ia heq atij karakteristikat e një autoriteti publik. Sipas saj, marrë në tërësi, kompanitë e ujit nuk mund të konsideroheshin si autoritete publike, e për rrjedhojë, nuk ishin të detyruara të jepnin pjesën tjetër të informacionit që u ishte kërkuar.⁴⁵⁸

Argumentet e gjykatës angleze në vendimin *Smartsources* u kritikuan në qarqet akademike për disa arsye. Ndër të tjera, është kritikuar dhënia e të njëjtës peshë të gjithë elementëve që u morën në shqyrtim, si edhe fokusimi i panevojshëm tek struktura e kompanive të ujit, ndërkohë që fokusi duhej të ishte vendosur tek natyra e shërbimit që ato ofronin, i cili duhej të kishte peshë më të madhe, në krahasim me elementët e tjerë. Përveç kësaj, është argumentuar se mungesa e diskrecionit tregtar që kompanitë e ujit kishin në treg, që gjykata e konsideroi si karakteristikë të një autoriteti jo-publik, duhet të kishte shërbyer krejt për të kundërtën, çka duhej t’i detyronte ato të jepnin informacionin e kërkuar, duke marrë në konsideratë ndikimin unik që ka furnizimi me ujë në të drejtat e njeriut dhe në mjedis.⁴⁵⁹

⁴⁵⁶ *Ibid.*, parag. 78.

⁴⁵⁷ *Supra.*, shënimi fundor nr. 381.

⁴⁵⁸ *Supra.*, shënimi fundor 453, Vendimi i Gjykatës Administrative të Apelit të Anglisë, parag. 30-106.

⁴⁵⁹ Sean Whittaker, “Case Note: Access to environmental information and the problem of defining public authorities”, *Environmental Law Review*, 2013, Vol. 15, fq. 230-238.

Dhe mendimi akademik duket se gjeti mbështetjen edhe të GJED, pasi në çështjen *Fish Legal, Emily Shirley v Information Commissioner, United Utilities Water plc, Yorkshire Water Services Ltd, Southern Water Services Ltd*, Nr. C-279/12, datë 19.12.2013,⁴⁶⁰ u diskutua i njëjti problem, por tashmë para GJED, nëse kompanitë e ujit janë autoritete publike, në kuptim të Direktivës 2003/4/EC. Gjykata theksoi se duke u bërë palë në Konventën e Aarhusit, BE mori përsipër të garantonte të drejtën e marrjes së informacionit mjedisor prej autoriteteve publike dhe siç e konfirmon paragrafi 5 i Preambulës së Direktivës 2003/4, të sigurojë interpretimin e *acquis communautaire* në përputhje me konventën, në kuadrin e një skeme të përgjithshme për t'i garantuar çdo personi fizik dhe juridik të drejtën e marrjes së informacionit mjedisor. Duke iu referuar shprehjes '*sipas legjislacionit kombëtar*', GJED analizoi mospërputhjen midis versioneve në gjuhën angleze dhe franceze të tekstit të direktivës, ku versioni frëngjisht i nenit 2§2§b të saj frazën '*sipas legjislacionit kombëtar*' e lidhte me foljen '*kruej*', kështu që në atë version referimi ndaj legjislacionit kombëtar ka të bëjë më përkufizimin e 'funksioneve të autoriteteve publike'. Ndërsa në versionin anglisht, ndodh e kundërta, folja nuk është e lidhur me funksionet e autoriteteve publike. Por paragrafi 7 i Preambulës së Direktivës 2003/4 përcakton objektivin e shmangies së dallimeve midis legjislacioneve kombëtare, sa i përket të drejtës për të marrë informacion mjedisor, duke shkaktuar kështu pabarazi në gjirin e BE, në lidhje me kushtet e konkurrencës, kështu që edhe përkufizimi i autoriteteve publike nuk mund të jetë i ndryshëm në vende të ndryshme. Në rastin konkret, United Utilities Water plc, Yorkshire Water Services Ltd dhe Southern Water Services Ltd, të cilat ofrojnë shërbime publike që kanë të bëjnë me mjedisin janë nën kontrollin e një autoriteti apo personi që përfshihet nga neni 2§2§a ose 2§2§b i Direktivës 2003/4, prandaj duhet të klasifikohen si autoritete publike.⁴⁶¹

Në lidhje me të drejtën e OJF mjedisore për t'iu drejtuar gjykatës, është shumë i spikatur argumentimi i të parës femër Avokate e Përgjithshme në GJED, Eleanor V. E. Sharpston, në çështjen C-115/09, *Trianel*, e cila në lidhje me pretendimin e qeverisë gjermane mbi sistemin e kontrollit gjyqësor gjerman ndaj akteve administrative, se është mjaft i kujdesshëm dhe i hollësishëm dhe se ofron një nivel të lartë të mbrojtjes së të drejtave të individit, u shpreh "*...Megjithatë, një Ferrari që i ka dyert e mbyllura me çelës, një sistem intensiv kontrolli gjyqësor ka pak vlerë praktike, nëse sistemi në vetvete është totalisht i pa aksesueshëm për disa kategori të caktuara veprimesh. Siç e kuptoj unë, në kushtet kur nuk është në rrezik një e drejtë individuale materiale, as individi, e as një OJF mjedisore, nuk gëzon locus standi për të vënë në lëvizje gjykatën. Askush nuk mund të veprojë në emër të vetë mjedisit.*"⁴⁶² Por megjithatë, ka disa

⁴⁶⁰ Vendimi Nr. C-279/12, datë 19.12.2013 gjendet në:

<http://curia.europa.eu/juris/document/document.jsf?text=&docid=145904&pageIndex=0&doclang=EN&mode=lst&dir=&occ=first&part=1&cid=240672>

⁴⁶¹ *Ibid.*, paragrafi 2 i dispozitivit.

⁴⁶² Në fakt, kjo u tentua të bëhej në SHBA, ku një OJF mjedisore amerikane iu drejtua Gjykatës së Distriktit të Hawaii në emër të kafshëve. Bëhet fjalë për çështjen *Komuniteti i Gjitarëve të Mëdhenj të Detit* (Cetacetë) kundër *George W. Bush* (President i SHBA) dhe *Donald Rumsfeld* (Sekretar i Mbrojtjes), gjykuar nga Gjykata e Apelit të Distriktit 9 të SHBA në vitin 2003. Kërkesit ankimuan vendimin e Gjykatës së Distriktit të Hawaii, që u kishte mohuar të drejtën e legjitimitetit aktiv, të drejtën për të ngritur padi në gjykatë për mbrojtjen e të drejtave të Gjitarëve të Mëdhenj të Detit (balenat dhe delfinët), nga dëmet që u shkaktoheshin prej ultratingujve që lëshoheshin nga nëndetëset amerikane, për të zbuluar nëndetëset e vendeve të tjera. Kërkesa bazohej në Ligjin për Speciet e Rrezikuara, Ligjin për Mbrojtjen e Gjitarëve të Detit, Ligjin për Mbrojtjen e Mjedisit Kombëtar dhe Ligjin e Procedurës Administrative. Gjykata e Apelit la në fuqi vendimin e Gjykatës së Distriktit të Hawaii, me argumentimin se përderisa gjitarët individualisht nuk kishin të drejtën për të ngritur padi në gjykatë, as edhe si grup i përfaqësuar nga OJF nuk e gëzonin këtë të drejtë. Nëse Kongresi do të dëshironte një gjë të tillë, do ta kishte bërë

rrëshana – për shembull, kur një projekt i renditur në Aneksin I të Direktivës mbi Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis (e për rrjedhojë edhe objekt i vlerësimit të detyrueshëm të ndikimit në mjedis sipas Nenit 4§1 e vijues) ndodhet në një zonë të virgjër shumë larg zonave të banuara – kur pjesëmarrja efektive në vendimmarrjen mjedisore dhe monitorimi efektiv i zbatimit të Direktivës mbi Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, e bëjnë të domosdoshme dhënien OJF-ve locus standi për të vënë në lëvizje gjykatën për kontrollin gjyqësor të akteve administrative.”⁴⁶³

Siç është përmendur më sipër, BE është bërë palë në Konventën e Aarhusit në 17 shkurt 2005, me Vendimin e Këshillit 2005/370/EC,⁴⁶⁴ raifikuar në maj 2005. Që në vitin 2003, para se të bëhej palë e konventës, u miratuan akte që zbatonin dy shtyllat e para të konventës: Direktiva 2003/4/EC⁴⁶⁵ e Parlamentit dhe Këshillit, datë 28.1.2003, Për të drejtën e publikut për të marrë informacion mjedisor; dhe Direktiva 2003/35/EC⁴⁶⁶ Parlamentit dhe Këshillit, datë 26 maj 2003, për pjesëmarrjen e publikut në hartimin e planeve dhe programeve që kanë lidhje me mjedisin. Pas ratifikimit të konventës, u miratua Rregullorja e Parlamentit dhe Këshillit (EC) Nr. 1367/2006, datë 6.9.2006, për zbatimin e dispozitave të Konventës së Aarhusit për marrjen e informacionit, për të marrë pjesë në vendimmarrje dhe për t’iu drejtuar gjykatës për çështjet e mjedisit nga Institucionet dhe Autoritetet Komunitare.⁴⁶⁷ Që nga titulli, kuptohet që rregullorja për zbatimin e konventës mbulon jo vetëm të gjitha institucionet, por edhe të gjitha autoritetet, byrotë, zyrat apo agjencitë që mund të krijohen prej traktateve të BE. Sigurisht që ajo mbulon edhe të tre shtyllat e Konventës së Aarhusit, të cilat zbatohen kundrejt institucioneve të vetë organizatës, krahas zbatimit që bëhet individualisht prej shteteve anëtare. Rregullorja u mundëson gjithashtu edhe OJF mjedisore që të kërkojnë edhe shqyrtimin e ligjshmërisë së akteve, veprimeve ose mosveprimeve të ndryshme të kryera nga institucionet dhe autoritetet komunitare.⁴⁶⁸

Në kushtet kur përveç të gjitha shteteve anëtare edhe vetë BE është bërë palë në Konventën e Aarhusit, e drejta për t’iu drejtuar gjykatës për çështjet mjedisore është bërë një ndër çështjet kryesore për të cilat Komisioni kontrollon zbatimin me rigorozitet, e riktheksuar me forcë edhe në Programin e 7 të Veprimit të BE për Mjedisin, ku si Objektiv Prioritar nr. 4 i BE sanksionohet maksimizimi i përfitimeve prej legjislacionit komunitar nëpërmjet përmirësimit të zbatueshmërisë së tij. Për periudhën deri në vitin 2020, gjatë së cilës do të zbatohet ky program, ai parashikon përmirësimin e zbatimit të legjislacionit mjedisor në 4 fusha kryesore: marrjen dhe shpërndarjen e njohurive mbi mënyrën se si duhet bërë zbatimi i legjislacionit mjedisor, shtrirjen e kërkesave që lidhen me inspektimet dhe mbikëqyrjen në të gjithë legjislacionin e gjerë mjedisor komunitar, përmirësimin e mënyrës se si trajtohen ankesat për zbatimin e legjislacionit

këtë haptazi nëpërmjet një ligji të veçantë. Detajet e çështjes gjenden në: <http://law.justia.com/cases/federal/district-courts/FSupp2/249/1206/2460816/>

⁴⁶³ Opinioni i Avokates së Përgjithshme Eleanor Sharpston në çështjen *Trianel*, C-115/09, datë 16.12.2010, paragraf 77. Gjendet në:

<http://curia.europa.eu/juris/document/document.jsf?text=&docid=83086&pageIndex=0&doclang=EN&mode=lst&df=&occ=first&part=1&cid=128243>

⁴⁶⁴ Gjendet në: <http://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:32005D0370&from=EN>

⁴⁶⁵ Gjendet në: <http://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:32003L0004&rid=2>

⁴⁶⁶ Gjendet në: http://eur-lex.europa.eu/resource.html?uri=cellar:4a80a6c9-cdb3-4e27-a721-d5df1a0535bc.0004.02/DOC_1&format=PDF

⁴⁶⁷ Gjendet në: <http://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=OJ:L:2006:264:0013:0019:EN:PDF>

⁴⁶⁸ Shpjegime të hollësishme gjenden në: <http://ec.europa.eu/environment/aarhus/legislation.htm>

mjedisor komunitar, në nivel kombëtar dhe së fundmi, gëzimin prej shtetasve të BE të së drejtës efektive për t'iu drejtuar gjykatës për çështjet mjedisore dhe për mbrojtje ligjore efektive, në përputhje me Konventën e Aarhusit dhe jurisprudencën e GJED. Përveç këtyre, duhet inkurajuar edhe përdorimi i mjeteve të tjera të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve mjedisore, si alternativa ndaj zgjidhjeve gjyqësore.⁴⁶⁹

Në dallim nga harmonizimi i legjislacionit të brendshëm të vendeve anëtare të BE për të drejtën për të marrë informacion mjedisor dhe pjesëmarrjen në vendimmarrjen mjedisore, i cili u krye nëpërmjet miratimit të legjislacionit të posaçëm harmonizues në nivel komunitar, kjo nuk u arrit dot për të drejtën për t'iu drejtuar gjykatës për çështjet mjedisore, për shkak të rezistencës së vendeve anëtare, duke e konsideruar aksesin në gjykatë si një çështje të tyre të brendshme dhe jo të Bashkimit.⁴⁷⁰ Argumenti ishte që një normë e tillë do të cënonte parimin e subsidiaritetit.

Megjithatë, përsëri ka dalë në pah roli i pazëvendësueshëm i GJED, e cila me anë të jurisprudencës së saj ka synuar të plotësojë këtë mungesë të legjislacionit harmonizues në nivel komunitar. Kështu, në çështjen C-240/09, datë 8.3.2011, *Lesoochránárske zoskupenie VLK kundër Slovenskej* (e njohur me emërtimin “Çështja e Ariut të Murrme Sllovak”), në lidhje me mungesën e dispozitave në Konventën e Aarhusit që do të mundësonin zbatimin e saj të drejtpërdrejtë, Dhoma e Madhe u shpreh që edhe pse neni 9§3 i saj është i formuluar në terma të përgjithshëm, ai synon mbrojtjen efektive të mjedisit, kështu që shtetet anëtare duhet të nxjerrin norma të brendshme për këtë qëllim, duke parashikuar rregulla procedurale që garantojnë të drejtat që individëve u burojnë nga legjislacioni i BE, në rastin konkret, nga Direktiva e Habitaveve. Tashmë është e konsoliduar jurisprudenca, e cila ka vendosur se rregullat procedurale për garantimin e këtyre të drejtave nuk mund të jenë më pak të favorshme se ato që mbrojnë të drejtat e garantuara nga legjislacioni i brendshëm (parimi i barazvlefshmërisë) dhe nuk mund të bëjnë të pamundur ose tejet të vështirë në praktikë ushtrimin e këtyre të drejtave të garantuara nga legjislacioni i BE (parimi i efektivitetit). Kjo do të thotë që gjykatat e brendshme të shteteve anëtare duhet të interpretojnë në masën më të madhe të mundshme rregullat procedurale që kanë të bëjnë me kushtet që duhen përmbushur në mënyrë që të mund të iniciohen procedurat administrative apo gjyqësore sipas nenit 9§3 të konventës dhe të garantohet mbrojtja e të drejtave të parashikuara nga legjislacioni i BE, në mënyrë të tillë që t'u mundësojë OJF mjedisore ankimmimin në gjykatë të vendimeve administrative që mund të bien ndesh me legjislacionin mjedisor evropian.⁴⁷¹ Nga ky formulim, del qartë që gjykatat e brendshme kanë detyrimin të garantojnë nëpërmjet vendimeve të tyre të drejtën për t'iu drejtuar gjykatës për çështjet mjedisore edhe kur kjo gjë nuk parashikohet shprehimisht nga legjislacioni i brendshëm.

Përveç garantimit të së drejtës së individit për t'iu drejtuar gjykatës për t'u ankuar për një vendim të autoriteteve publike, GJED ka shkuar edhe më tej, duke njohur madje edhe të drejtën që individit të kërkojë nxjerrjen e një vendimi që ka të bëjë me mjedisin, kur autoriteti publik nuk e

⁴⁶⁹ Programi i 7 i Veprimit të BE për Mjedisin, parag. 56-62. Gjetet në: <http://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:32013D1386&from=EN>

⁴⁷⁰ Suzanne Kingston, “*Surveying the state of EU environmental law: much bark with little bite?*”, International and Comparative Law Quarterly, Nr. 62, 2013, fq. 972.

⁴⁷¹ Vendimi C-240/09, datë 8.3.2011, *Lesoochránárske zoskupenie VLK kundër Slovenskej*, parag. 45-52. Gjetet në: <http://curia.europa.eu/juris/document/document.jsf?text=&docid=80235&pageIndex=0&doclang=en&mode=lst&dir=&occ=first&part=1&cid=11300>

ka bërë një gjë të tillë. Kështu, në çështjen C-237/07, datë 25.7.2008, *Dieter Janecek kundër Freistaat Bayern*, të përmendur më lart, GJED theksoi se neni 7(3) i Direktivës 96/62 duhet të interpretohet në mënyrë të tillë, që në rastet kur ekziston rreziku i tejkalimit të normave të lejuara të ndotjes në mjedis, personat që mund të ndikohen drejtpërdrejt duhet të kenë mundësinë që t'u kërkojnë autoriteteve kompetente kombëtare që të hartojnë planin e veprimit, edhe kur sipas legjislacionit të brendshëm këta persona mund të kenë mjete të tjera të disponueshme për t'u kërkuar autoriteteve marrjen e masave për të luftuar ndotjen atmosferike.⁴⁷²

Në përmbushje të së drejtës për një mjet ankimi efektiv, GJED ka shqyrtuar edhe të drejtën e individit për të kërkuar marrjen e masave të përkohshme, me qëllim shmangien e ndotjes së mjedisit. Në çështjen C-416/10, datë 15.1.2013, *Křižan kundër Sllovakisë*, GJED sanksionoi që garantimi i mjetit efektiv të ankimit të parashikuar në nenin 15a të Direktivës 96/61 për kontrollin dhe parandalimin e integruar të ndotjes, kërkon që pjesëtarët e publikut të interesuar të kenë të drejtën që t'i drejtohen gjykatës ose një autoriteti të pavarur dhe të paanshëm për marrjen e masave të përkohshme, të tilla që mund të parandalojnë ndotjen, duke përfshirë, nëse është e nevojshme, edhe pezullimin e përkohshëm të lejes së akorduar, e cila është bërë objekt gjykimi.⁴⁷³

GJED ka theksuar se kundrejt autoriteteve publike, individët, kanë të drejtë të bazohen në dispozitat e direktivave të cilat janë jo-kushtëzuese dhe mjaftueshmërisht të përcaktuara saktë. Në lidhje me këtë, në çështjen *Ratti*, Nr. 148/78, të 5 prillit 1979,⁴⁷⁴ GJED iu drejtuan dy pyetje kryesore: a) A përbën Direktiva e Këshillit 73/173/EEC, e 4 qershorit 1973, në veçanti Neni 8 i saj, legjislacion direkt të zbatueshëm i cili i jep individit të drejta personale, që duhet të mbrohen prej gjykatave kombëtare? b) A është e ligjshme...të caktohen në legjislacionin e brendshëm dispozita të cilat vendosin detyrime dhe kufizime të cilat janë më të hollësishme dhe më të detajuara se vetë ato të caktuara në vetë direktivën...? GJED u shpreh se ndërsa rregulloret janë direkt të zbatueshme, dhe për nga vetë natyra e tyre, mund të sjellin pasoja direkte, kjo nuk do të thotë që kategori të tjera aktesh nuk mund të sjellin kurrë pasoja të ngjashme. Do të ishte në kundërshtim me efektin detyrues që Neni 189 u akordon direktivave, të përjashtojë në parim mundësia e individëve që të bazoheshin në detyrimet e caktuara prej tyre. Veçanërisht në rastet kur autoritetet komunitare, nëpërmjet direktivave i kanë detyruar shtetet anëtare që të ndjekin një mënyrë të caktuar veprimi, efektiviteti i një akti të tillë do të dobësohej nëse individët nuk do të mund të bazoheshin tek direktiva në procedimet ligjore dhe nëse gjykatat kombëtare do të ndaloheshin ta merrnin atë në konsideratë si një element të së drejtës komunitare.⁴⁷⁵

⁴⁷² Vendimi Nr. C-237/07, datë 25.7.2008, *Dieter Janecek kundër Freistaat Bayern*, paragrafi 42. Gjetet në: <http://curia.europa.eu/juris/document/document.jsf?text=&docid=68148&pageIndex=0&doclang=en&mode=lst&dir=&occ=first&part=1&cid=14624>

⁴⁷³ Vendimi Nr. C-416/10, datë 15.1.2013, *Jozef Křižan kundër Sllovakisë*, paragrafi 109. Gjetet në: <http://curia.europa.eu/juris/document/document.jsf?text=&docid=132341&pageIndex=0&doclang=en&mode=lst&dir=&occ=first&part=1&cid=58353>

⁴⁷⁴ Gjetet në: <http://curia.europa.eu/juris/showPdf.jsf?text=&docid=90084&pageIndex=0&doclang=EN&mode=lst&dir=&occ=first&part=1&cid=409295>

⁴⁷⁵ *Ibid.*, paragrafi 19-21.

Natyrë të njëjtë kanë edhe direktivat që kanë të bëjnë me të ashtuquajturën ‘përgjegjësinë Frankovich’. Në çështjen *Andrea Francovich, Danila Bonifaci dhe të tjerët kundër Italisë*,⁴⁷⁶ GJED sanksionoi se një shtet anëtar i BE i cili nuk ka marrë masat për zbatimin e një direktive brenda afatit të sanksionuar prej saj, nuk mund të çlirohet nga përgjegjësia kundrejt individit për shkak të këtij moszbatimi. Kështu, kurdo që një direktivë duket të jetë jo-kushtëzuese dhe mjaftueshmërisht e përcaktuar saktë, për sa i përket objektit të saj, në mungesë të marrjes së masave zbatuese brenda afatit të caktuar, mund të shërbëjë si bazë ligjore për të kundërshtuar çdo dispozitë të së drejtës së brendshme e cila bie ndesh me direktivën, ose për aq sa dispozitat e direktivës sanksionojnë të drejta me anë të të cilave individët mund t’i kundërshtohen shtetit. Të njëjtin qëndrim kishte mbajtur GJED edhe në çështjen *Becker Finanzamt Münster-Innenstadt*, në vitin 1982.⁴⁷⁷

Paragrafi 5 i nenit 9 të konventës parashikon që me qëllim që të rritet efektiviteti i këtij neni, çdo palë duhet të sigurojë që publikut t’i jepet informacion për të drejtën e tij për t’iu drejtuar procedurave të shqyrtimit administrativ dhe gjyqësor dhe të marrë në konsideratë krijimin e mekanizmave ndihmës të përshtatshëm, për të hequr ose pakësuar pengesat financiare ose pengesa të tjera në ushtrimin e së drejtës për t’iu drejtuar gjykatës.

Roli i vetë gjykatave është parësor në zbatimin e dispozitave të Konventës së Aarhusit dhe për këtë është e domosdoshme rritja e shkallës së ndërgjegjësimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve në drejtim të mbrojtjes së mjedisit. Për këtë qëllim është ndërmarrë një iniciativë e veçantë prej një grupi gjyqtarësh të vendeve të BE, duke krijuar Forumin e Gjyqtarëve të Bashkimit Evropian për Mjedisin (EUFJE), në 28 shkurt 2004, në Paris, me nismën e Kryetarit të Gjykatës së Kasacionit të Francës dhe gjyqtarëve nga Italia, Belgjika dhe Britania e Madhe.⁴⁷⁸ Roli i gjykatave për mbrojtjen e mjedisit, përveçse në Konventën e Aarhusit, është parashikuar në mënyrë specifike edhe në Konventën e Luganos mbi Përgjegjësinë Civile për Dëmet e Shkaktuara prej Aktiviteteve të Dëmshme për Mjedisin të vitit 1973 dhe në Konventën për Mbrojtjen e Mjedisit Nëpërmjet të Drejtës Penale, të miratuar nga Këshilli i Evropës në Strasburg, në 4 nëntor 1998.⁴⁷⁹

Parimet që sanksionon Konventa e Aarhusit për proceset që ndiqen para organeve gjyqësore për mbrojtjen e të drejtave mjedisore, kërkojnë respektimin e të gjithë kritereve që janë vendosur nga nenet 6 dhe 13 të KEDNJ, për një proces të rregullt ligjor dhe mjete ankimi efektive. Çështja duhet të shqyrtohet brenda një afati të arsyeshem, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj dhe vendimi duhet të shpallet publikisht. Po ashtu, duhet garantuar nga legjislationet e brendshme të palëve, që si vendimet administrative, ashtu edhe ato gjyqësore, mund të ankimohen në një instancë më të lartë, e cila mund të korrigjojë gabimet e instancës më të ulët. Në kuadrin e BEë janë adoptuar të njëjtat parime në aktet ligjore kryesore, siç është neni 19 i Traktatit të Lisbonës që garanton mbrojtjen efektive ligjore në shtetet anëtare dhe neni 47 i Kartës së BE për të Drejtat Themelore që përmbledh të dyja të drejtat, të drejtën për një proces të rregullt ligjor dhe të drejtën për të patur mjete ankimi efektive.

⁴⁷⁶ Gjendet në: http://eur-lex.europa.eu/resource.html?uri=cellar:7a76ea3f-a919-475c-8cbe-29e0b260ebc4.0002.03/DOC_1&format=PDF

⁴⁷⁷ *Ibid.*, parag. 11.

⁴⁷⁸ Informacion i hollësishëm për EUFJE gjendet në: <http://www.eufje.org/EN/>

⁴⁷⁹ Konventa e Strasburgut gjendet në: <http://conventions.coe.int/Treaty/en/Treaties/Html/172.htm>

7.3 Konventa e Aarhusit dhe legjislacioni shqiptar.⁴⁸⁰

Konventa e Aarhusit është bërë pjesë e të drejtës së brendshme shqiptare pas ratifikimit me ligjin nr. 8672, datë 26.10.2000. Për zbatimin në praktikë të saj u miratua edhe Strategjia dhe Plani Kombëtar i Veprimit për Zbatimin e Konventës së Aarhusit,⁴⁸¹ që përbën platformën e politikës shtetërore për rritjen e rolit aktiv të shoqërisë civile, të publikut, të OJF, të organizatave të biznesit e të individit në fushën e mbrojtjes së mjedisit. Ndërsa për sa i përket aspektit institucional, për zbatimin e Konventës ndikuan pozitivisht sanksionimi në ligjin për mbrojtjen e mjedisit i funksionimit të rrjetit publik mjedisor shqiptar, si dhe krijimi i një ministrie të veçantë për mjedisin, e cila kryeson këtë rrjet, të përbërë nga agjencitë rajonale të mjedisit, inspektorati që mbulon mjedisin, organizmat mjedisorë në përbërje të organeve qendrore e vendore dhe nga organizmat ndërministrorë, Qendra Kombëtare e Informacionit Mjedisor, etj.

Ndër masat konkrete për zbatimin e konventës parashikohet ndërmarrja e një procesi ndërgjegjësues për të siguruar njohjen dhe zbatimin e kërkesave të Konventës, përfshirë botimet dhe publikimet, organizimi i aktiviteteve njohëse me të rinjtë, me nxënësit dhe studentët, marrja përsipër e hulumtimeve, testeve e investigimeve, shkëmbimi i mendimeve dhe përvojave, ndërgjegjësimi i funksionarëve publikë, si edhe organizimi i veprimtarive të mirëfillta shkencore, si simpoziume e konferenca lokale, kombëtare e ndërkombëtare për problemet më të mprehta të Konventës.

Përveç këtyre masave të karakterit të përgjithshëm, strategjia dhe plani i veprimit parashikojnë edhe plotësimin e rregullave dhe procedurave që lehtësojnë realizimin praktik të kërkesave të Konventës. Për sa i përket kuadrit ligjor mjedisor shqiptar, ai ka ardhur duke u plotësuar në mënyrë të vazhdueshme me akte ligjore e nënligjore që synojnë zbatimin në praktikë të tre shtyllave të konventës. Kështu, në lidhje me të drejtën e informimit, kushtetuta parashikon në nenin 23 se e drejta e informimit është e garantuar dhe se kushdo ka të drejtë, në përputhje me ligjin, të marrë informacion për veprimtarinë e organeve shtetërore, si dhe të personave që ushtrojnë funksione shtetërore, ndërsa në nenin 48 sanksionon se kushdo, vetë ose së bashku me të tjerë, mund t'u drejtojë kërkesa, ankesa ose vërejtje organeve publike, të cilat janë të detyruara të përgjigjen në afatet dhe kushtet e caktuara me ligj. Pra, kushtetuta referon te ligjet e posaçme, ku futen Kodi i Procedurave Administrative dhe ligji nr. 119/2014, datë 18.9.2014, "Për të drejtën e informimit". Ndërsa në lidhje me të drejtën e informimit për marrjen e informacionit mjedisor, neni 56 parashikon se kushdo ka të drejtë të informohet për gjendjen e mjedisit dhe për mbrojtjen e tij. Pra, e drejta e informimit mjedisor i njihet kujtdo, pa patur nevojë të provojë se ka ndonjë interes të veçantë në lidhje me të. Formulim të ngjashëm ka parashikuar edhe neni 3 i ligjit nr. 119/2014, datë 18.9.2014, "Për të drejtën e informimit", sipas të cilit çdo person gëzon të drejtën e njohjes me informacionin publik, pa u detyruar të shpjegojë motivet dhe çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik, nëpërmjet dokumentit origjinal ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentit. Në kuadër të diskutimit të mësipërm për marrjen 'pasive' të informacionit, neni 4 parashikon se autoriteti publik vë në zbatim një program institucional të transparencës, ku përcaktohen

⁴⁸⁰ Informacion i hollësishëm mbi zbatimin e Konventës së Aarhusit në Shqipëri gjendet në: <http://www.aic.org.al/>

⁴⁸¹ Strategjia dhe Plani Kombëtar i Veprimit për Zbatimin e Konventës së Aarhusit gjendet në: http://www.mjedisi.gov.al/files/userfiles/Sherbime/Strategjia_dhe_Plani_i_Veprimit-aarhus.pdf

kategoritë e informacionit që bëhet publik pa kërkesë dhe mënyra e bërjes publike të këtij informacioni.

Ndërsa Kodi i Procedurave Administrative parashikon në nenin 13 që në zbatim të parimit të bashkëpunimit të administratës me personat privatë, organet e administratës publike e zhvillojnë veprimtarinë e tyre në bashkëpunim të ngushtë me personat privatë duke u siguruar personave privatë informacionin dhe sqarimet e nevojshme. Më tej, i gjithë Kreu II (nenet 51-55), i kushtohet të drejtës për informim.

Ligji nr. 10431, datë 22.06.2011, “Për Mbrojtjen e Mjedisit”, parashikon fillimisht në nenin 11 bashkëpunimin mjedisor ndërkombëtar për shkëmbimin e informacionit mjedisor, e më tej në nenin 13 shprehet se çdo person ka të drejtë t'i jepet në kohë informacion për gjendjen e mjedisit, ndotjen e tij dhe masat e marra në përputhje me legjislacionin të cilit ai i referohet. Në po këtë nen, parashikohet edhe pjesëmarrja e publikut në vendimmarrjen mjedisore, duke përcaktuar se gjatë zgjidhjes institucionale të problemeve të mbrojtjes së mjedisit, autoritetet publike përkatëse sigurojnë që publiku dhe palët e interesuara të kenë mundësi reale për të marrë pjesë në procedurat për identifikimin e gjendjes së mjedisit, hartimin dhe miratimin e strategjive, planeve e të programeve që kanë të bëjnë me mbrojtjen e mjedisit dhe përbërësit e mjedisit, si dhe në hartimin dhe miratimin e rregulloreve e të akteve me karakter të përgjithshëm, që kanë të bëjnë me mbrojtjen e mjedisit dhe vendimmarrjen për dhënien e lejeve përkatëse të mjedisit. Ndërsa neni 14 sanksionon që autoritetet publike, fusha e veprimit të të cilave përfshin funksione të lidhura me mbrojtjen e mjedisit, brenda kompetencave të tyre, nxitin informimin, ndërgjegjësimin dhe edukimin e publikut për mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin e qëndrueshëm. Neni 32, që bën fjalë për Regjistrin e Shkarkimit dhe Transferimit të Ndotësve, parashikon se në përmbushje të detyrimeve që rrjedhin nga marrëveshjet ndërkombëtare, ky regjistër mundëson të drejtën e publikut për t'iu dhënë ky informacion. Ndërsa i gjithë Kreu VII i dedikohet informacionit mjedisor. Në të parashikohet që sistemi i informacionit mjedisor i shërben mbrojtjes dhe menaxhimit të integruar të mjedisit dhe përbërësve të tij, monitorimit të zbatimit të politikave mjedisore, raportimeve të ndërsjella, në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, dhe sigurimit të informimit të publikut. Ai përmban të dhëna për gjendjen e mjedisit, ngarkesën ndotëse dhe ndikimet në mjedis dhe reagimin e publikut. Informacioni mjedisor përfshin çdo informacion të paraqitur në formë zanore, vizuale, elektronike, me shkrim, ose në ndonjë mënyrë tjetër. Çdo personi fizik dhe juridik i sigurohet informacioni i disponueshëm për mjedisin, pa qenë nevoja të shfaqë një interes specifik për të. Përcaktimeve të këtij ligji për informacionin mjedisor u referohet edhe neni 23 i ligjit nr.10 448, datë 14.7.2011, “Për lejet e mjedisit”, i cili në lidhje me menaxhimin e informacionit përcakton se të gjitha informacionet, lidhur me instalimet e kategorieve të ndryshme bëhen publike dhe janë pjesë e sistemit të informacionit mjedisor, dhe agjencia rajonale e mjedisit e mban dhe përditëson regjistrin me të dhënat përkatëse.

Në bazë dhe për zbatimin e këtyre dispozitave të ligjit, u miratua edhe VKM nr. 16, datë 4.1.2012, “Për të drejtën e publikut për të pasur informacion mjedisor”, i cili përcaktoi kushtet dhe mënyrat e ushtrimit të së drejtës për të pasur informacion mjedisor, për shkëmbimin e opinionit të publikut, si dhe për pjesëmarrjen efektive të tij në vendimmarrjen mjedisore. Ky vendim e ndan informacionin mjedisor në tre kategori, ku futen materialet informuese që u referohen elementeve mjedisore të vendit, ato mbi faktorët natyrorë, substancat, energjinë, zhurmat, etj, si edhe të dhënat për sigurinë e shëndetit dhe kushteve të jetës së njerëzve, gjendjen

aktuale të zonave kulturore dhe ndikimet e mundshme të faktorëve të kategorisë së dytë mbi këto zona. Ai parashikon detyrimin e autoritetit publik përkatës të vërë në shërbim të publikut dhe t'i shpërndajë atij informacionin që disponon, ku futen tekstet e konventave ose marrëveshjeve ndërkombëtare, tekstet e legjislacionit evropian, aktet ligjore dhe nënligjore kombëtare ose vendore që lidhen me mjedisin, politikat, strategjitë, planet dhe programet që lidhen me mjedisin, raportet për progresin e bërë, raportet për gjendjen e mjedisit, të dhënat ose përmbledhjen e të dhënave të mbledhura nga monitorimi i veprimtarive që ndikojnë ose që mund të ndikojnë në mjedis, autorizimet, lejet dhe licencat për veprimtaritë me ndikim në mjedis dhe marrëveshjet mjedisore ose të dhëna për vendin se ku mund të kërkohet ose të gjendet ky informacion, si edhe studimet për ndikimin mjedisor dhe vlerësimin e rreziqeve që lidhen me elementët mjedisorë. Përveç këtij vendimi, Urdhëri i Kryeministrit nr. 202, datë 16.12.2005, “Për forcimin e transparencës, nëpërmjet rritjes së përdorimit të internetit dhe përmirësimit të faqeve ekzistuese të internetit”, ndryshuar me Urdhërin nr. 199, datë 26.10.2013, parashikon që institucionet në varësi të Këshillit të Ministrave apo të Kryeministrit, përfshirë dhe prefektët, duhet të krijojnë faqet e tyre në internet ose të përmirësojnë ato ekzistuese, për rritjen e transparencës, nëpërmjet përdorimit të internetit. Paraqitja e informacionit duhet të bëhet në mënyrë metodike e funksionale nga ato institucione që realizojnë shërbime për publikun, japin licenca, leje, autorizime, çertifikata, vërtetime apo kryejnë shërbime të tjera të ngjashme.

Ligji nr.10440, datë 7.7.2011, “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, në nenin 10 të tij, i cili bën fjalë për paraqitjen e kërkesës për vlerësimin e ndikimit në mjedis nga zhvilluesi, kërkon prej këtij të fundit që për projektet me ndikim në mjedis, të paraqesë pranë Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL), përveç dokumentacionit të kërkuar sipas ligjit për licencat, autorizimet dhe lejet, edhe dokumentacionin përkatës për procedurën e VNM-së, përfshirë informacionin për informimin dhe konsultimin me publikun. Ndërsa neni 12 që bën fjalë për deklaratën mjedisore, thekson që në përfundim të procedurës së thelluar të vlerësimit të ndikimit në mjedis, ministri lëshon deklaratën mjedisore, e cila përmban edhe informacion për procesin e realizuar të konsultimit me publikun. Më pas, nenet 16 dhe 17 bëjnë rregullimin e informimit të publikut gjatë VNM, ku zhvilluesi, për projektet që i nënshtrohen procedurës së thelluar të VNM, informon dhe konsultohet me publikun e interesuar për vlerësimin e ndikimit në mjedis të veprimtarisë së tij. Agjencia Kombëtare e Mjedisit gjatë procedurës së VNM të thelluar, zhvillon seancë dëgjimore me publikun dhe OJF e interesuara, duke synuar tërheqjen e mendimit të tyre në vendimmarrjen përfundimtare për projektin. Seanca dëgjimore zhvillohet në bashkëpunim edhe me njësinë e qeverisjes vendore dhe me zhvilluesin e projektit. Menjëherë pas përcaktimit të vendit, datës dhe orës për zhvillimin e seancës dëgjimore, njësia e qeverisjes vendore bën njoftimin drejtuar publikut dhe OJF të interesuara për të marrë pjesë në takim. Mendimi dhe komentet e publikut e të OJF të pranishëm në takim, janë kriter i domosdoshëm, gjatë procesit të vendimmarrjes së VNM. Informacionin për informimin dhe konsultimin me publikun, zhvilluesi e paraqet si pjesë të dokumentacionit të nevojshëm gjatë aplikimit për deklaratën në QKL.

Për hartimin e rregullave, kërkesave dhe procedurave për informimin dhe përfshirjen e publikut në vendimmarrjen mjedisore, është miratuar VKM nr. 994, datë 2.7.2008, “Për tërheqjen e mendimit të publikut në vendimmarrje për mjedisin”, i ndryshuar me VKM nr. 247, datë 30.4.2014. Ai parashikon që pjesëmarrja e publikut në hartimin e politikave, të strategjive rajonale e kombëtare, të përgjithshme a sektoriale, dhe të planeve të veprimit, në zbatim të tyre, që kanë lidhje me mjedisin, përbën kërkesë ligjore në procesin e hartimit të këtyre dokumenteve,

që përmirëson përmbajtjen dhe lehtëson zbatimin e tyre. Në vijim, vendimi kërkon nga autoritetet publike që pjesëmarrjen e publikut të ndikuar ta realizojnë duke i siguruar atij informacionin e nevojshëm, duke përcaktuar rregulla dhe procedura sa më të thjeshta, dhe sigurimin e kushteve dhe të zgjidhjeve praktike, të përshtatshme për tërheqjen e mendimit të tij. Ai përcakton në mënyrë të hollësishme edhe procedurat që duhen ndjekur nga autoritetet publike për të garantuar pjesëmarrjen e publikut dhe kontributin e tij dhe ngarkon Ministrinë e Mjedisit të publikojë matricën e akteve që do të hartohen e miratohen gjatë vitit kalendarik, në të gjitha publikimet periodike të saj, të shkruara dhe elektronike, si dhe për çdo projektakt, që do të futet në procedurat e shqyrtimit e të miratimit, të njoftojë publikun e ndikuar, OJF mjedisore dhe grupet e tjera të interesit, në formë elektronike dhe shkresore. Për të mundësuar tërheqjen e mendimit të publikut në kontrollet mjedisore të inspektoratit të mjedisit, kërkohet edhe dhënia e informacionit për programet vjetore të kontrollit të inspektoratit të mjedisit, të programeve vjetore të monitorimit të mjedisit e të përbërësve të tij, si edhe të planeve mujore të agjencive rajonale të mjedisit. Po ashtu, parashikohen edhe procesi i informimit dhe i përfshirjes së publikut gjatë procedurës paraprake të VNM, informimi dhe përfshirja e publikut si gjatë procedurës së thelluar të VNM, ashtu edhe gjatë procesit të monitorimit të ndikimeve në mjedis të projektit, përveç detyrimeve të zhvilluesit, AKM, ARM-ve dhe njësisve të qeverisjes vendore.

Edhe ligji nr. 91/2013, “Për vlerësimin strategjik mjedisor”, në nenin 10 që bën fjalë për hartimin dhe konsultimin e raportit paraprak të VSM me publikun dhe grupet e interesit, parashikon që autoriteti propozues, pasi të ketë hartuar raportin paraprak të VSM, realizon konsultimin me publikun dhe grupet e interesit, përfshirë dhe OJF, për rezultatet paraprake të raportit. Ai duhet të sigurojë njoftimin, informimin e konsultimin me publikun e grupet e interesuara, duke u krijuar mundësi praktike dhe duke vënë në dispozicion, të paktën për 30 ditë kalendarike, raportin paraprak të VSM, që të njihen dhe të shprehin mendimin e tyre në lidhje me cilësinë dhe rezultatet paraprake të tij, si dhe të bëjnë sugjerime për mbrojtjen e mjedisit nga pasojat negative të planit apo programit të propozuar. Zhvillimi i konsultimit me grupet e interesit dhe publikun, të raportit paraprak të VSM, është kusht i domosdoshëm që ministria të marrë në shqyrtim dhe të miratojë deklaratën.

Për zbatimin e shtyllës së tretë të Konventës së Aarhusit, neni 48 i ligjit nr. 10431, datë 22.6.2011, “Për Mbrojtjen e Mjedisit”, bën fjalë për të drejtën për padi gjyqësore dhe thekson se në rast kërcënimi ndaj mjedisit, ndotjeje dhe dëmtimi të tij, publiku ka të drejtë t’u kërkojë autoriteteve publike përkatëse marrjen e masave të duhura brenda afateve dhe në përputhje me autoritetin që u jep ligji dhe të ngrejë padi në gjykatë, në përputhje me kushtet e parashikuara nga Kodi i Procedurës Civile, kundër autoritetit publik ose personit fizik e juridik që ka sjellë dëme në mjedis ose që rrezikon ta dëmtojë atë. Referimi në Kodin e Procedurës Civile, përveç dispozitave të përgjithshme për paraqitjen e padisë në gjykatë, ka të bëjë me Kreun e II të kodit, e posaçërisht nenet 324-333, që rregullojnë gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative. Këto të fundit rregullohen me hollësi prej ligjit nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, por analiza e dispozitave të këtij ligji del jashtë objektit dhe qëllimit të këtij studimi. Për të drejtën për t’u drejtuar gjykatës, nenet 42 dhe 44 të kushtetutës parashikojnë që kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe të interesave të tij kushtetues dhe ligjorë, ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj dhe ka të drejtë të rehabilitohet dhe/ose të

zhëdmtohet në përputhje me ligjin, në rast se është dëmtuar për shkak të një akti, veprimi ose mosveprimi të paligjshëm të organeve shtetërore. Nga ana tjetër, Kodi i Procedurave Administrative, në nenin 137§3 parashikon se në parim, palët e interesuara mund t'i drejtohen gjykatës vetëm pasi të kenë ezauruar rekursin administrativ, çka do të thotë që kjo vlen edhe për paditë që kanë të bëjnë me mbrojtjen e të drejtave mjedisore. Ndërsa Kodi Civil, në nenin 624 parashikon përgjegjësinë për mjedisin, në përputhje me parimin 'ndotësi paguan', duke sanksionuar se personi që me faj ka cënuar mjedisin, duke e keqësuar, ndryshuar ose dëmtuar atë, tërësisht ose pjesërisht, detyrohet të shpërblejë dëmin e shkaktuar.

Së fundmi, në lidhje me rolin e legjislacionit penal për mbrojtjen e mjedisit, Kodi Penal parashikon në Kreun IV (nenet 201-207), veprat penale kundër mjedisit. Në to përfshihen ndotja e ajrit përmes çlirimit të tymrave, gazrave dhe lëndëve të tjera toksike radioaktive e bërë tej kufirit të normave të lejuara, transportimi tranzit apo depozitimi në territorin shqiptar të mbeturinave toksike dhe radioaktive, ndotja e ujërave të deteve, lumenjve, liqeneve apo burimeve të rrjetit grumbullues e shpërndarës të ujrave me lëndë toksike, radioaktive apo substanca të tjera, që prishin ekuilibrin ekologjik, ndotja e ujërave të deteve, lumenjve, liqeneve apo burimeve të rrjetit grumbullues e shpërndarës të ujrave me lëndë toksike, radioaktive apo substanca të tjera, që prishin ekuilibrin ekologjik, shkelja e rregullave për karantinën e bimëve apo të kafshëve, kur ka sjellë pasoja të rënda materiale ose që rrezikojnë jetën e shëndetin e njerëzve, prerja apo dëmtimi i pyjeve pa leje apo në kohë dhe vende të ndaluara, prerja e drurëve dekorativë dhe dëmtimi i lulishteve dhe parqeve nëpër qytete, shkatërrimi apo dëmtimi me dashje, me zjarr, me pasoja të rënda materiale, i fondit pyjor, i fidanishtes pyjore, i grumbullit pyjor ose i çdo njësie të ngjashme me to.

Në lidhje me këto të fundit, pavarësisht se i gjithë legjislacioni i mësipërm, së bashku me strategjitë dhe planet e veprimit synojnë demokratizimin e marrëdhënieve mjedisore, ngushtimin e hapësirave për abuzime në fushën e mjedisit, ekuilibrimin dhe amortizimin e trysnive të politikës dhe të biznesit, sigurimin e një niveli të lartë të transparencës në vendimmarrjen e organeve publike për çështjet e mjedisit, madje deri edhe te mbajtja e referendumeve për çështjet mjedisore dhe sanksionet penale, për fat të keq, shumë pak prej tyre rezultojnë të jenë zbatuar në praktikë. Këtë e tregon gjendja e rënduar e mjedisit në përgjithësi, e në mënyrë të veçantë gjendja katastrofale e pyjeve të shfarosur. Po të ishte ndryshe, nuk do të kishte lindur nevoja e ndalimit total të gjuetisë për dy vjet, e as nuk do ishin bërë propozimet që po shpallen publikisht për ndalimin total të shfrytëzimit të pyjeve për dhjetë vjet, për t'u dhënë kohë që të rigjenerohen. Edhe pse neni 206/a i Kodit Penal parashikon që shkatërrimi apo dëmtimi me dashje, me pasoja të rënda materiale, i fondit pyjor, i fidanishtes pyjore, i grumbullit pyjor ose i çdo njësie të ngjashme me to, me zjarr, kur ka shkaktuar pasoja të rënda për pronën, shëndetin ose jetën e njerëzve apo shkaktuar dëme të rënda dhe të zgjatura në kohë ndaj mjedisit apo zonave të mbrojtura, dënohet me burgim nga pesë deri në pesëmbëdhjetë vjet dhe me gjobë nga një milion lekë deri në dy milionë lekë, nuk rezultojnë që gjykatat shqiptare të kenë dhënë dënime të tilla. Nësë bëhet krahasimi me dispozitën e kushtetutës turke të përmendur më lart, e cila ndalon akordimin e faljeve apo amnistive për dëmtuesit e pyjeve, dallimi në vullnetin për mbrojtjen e pyjeve në veçanti, dhe mjedisit në përgjithësi, është i dukshëm.

7.4 Traktatet për të Drejtat e Njeriut dhe të drejtat mjedisore.

Një ndër traktatet me ndikimin më të madh për mbrojtjen e të drejtave të njeriut është Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ). Edhe pse kjo konventë është konsideruar si një nga dokumentet më të avancuar ndërkombëtarë lidhur me mbrojtjen e të drejtave të njeriut, në kohën e miratimit të saj në vitin 1950, të drejtat individuale që lidhen me mjedisin nuk ishin fare në rendin e ditës, prandaj edhe nuk përmenden në tekstin e saj. Në atë kohë, mbrojtja e të drejtave civile dhe politike ka qenë në qendër të vëmendjes, në krahasim me të drejtat ekonomike, sociale e kulturore.⁴⁸²

Për shkak të mungesës së të drejtave mjedisore në tekstin e KEDNJ, asnjë individ nuk mund të kërkojë dëmshpërblim në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ) në Strasburg. Çdo aplikim i mundshëm në këtë drejtim do të konsiderohej si i pabazuar *ratione materiae*, pasi nuk ka asnjë të drejtë mjedisore të shkruar as në tekstin e Konventës, as në protokollet e saj shtesë.⁴⁸³

Megjithatë, ashtu siç është shprehur vetë GJEDNJ në një nga vendimet e saj historike, “Konventa është një **instrument dinamik**,⁴⁸⁴ [theksimi im] i cili... duhet të interpretohet në dritën e kushteve aktuale.”⁴⁸⁵ Në këtë sens, zhvillimet e fundit në sferën e mbrojtjes së të drejtave mjedisore kanë çuar në kuptimin se ato janë të lidhura ngushtë me mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Për këto arsye, GJEDNJ ka tentuar të shkojë nëpërmjet jurisprudencës së saj drejt lidhjes së të drejtave mjedisore me të drejtat themelore të njeriut dhe është pikërisht jurisprudenca e saj që përcakton vetë kuptimin e Konventës, siç ai evoluon përgjatë viteve. Duke marrë shkas nga thënia: “Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut nuk është teksti i shkruar i saj, por ajo çka Gjykata e Strasburgut vendos në lidhje me të”, në vijim do të bëhet një analizë e pëmbledhur e disa prej vendimeve të GJEDNJ që kanë të bëjnë me mjedisin.

Për lidhjen midis nenit 2 të konventës dhe të drejtave mjedisore mund të përmendet çështja *LCB kundër Mbretërisë së Bashkuar*, në të cilën doli në pah vështirësia e të provuarit të lidhjes shkakësore midis ndotjes së mjedisit dhe dëmtimit të shëndetit. Kërkesja pretendonte se sëmundja e leuçemisë nga e cila vuante që prej lindjes, ishte shkaktuar prej rrezatimit ndaj të cilit ishte ekspozuar i ati gjatë shpërthimeve bërthamore, ndërkohë që ai shërbente në ushtrinë britanike, në vitet 1957 dhe 1958. Kërkesja argumentonte se sipas raportit të Shoqatës Britanike të Veteranëve të Provave Bërthamore, kishte një numër të lartë të të sëmurëve me leuçemi në radhët e fëmijëve të veteranëve të ushtrisë. Por gjykata nuk e pranoi këtë argument, duke vendosur se pas shqyrtimit të provave të paraqitura në gjykim, nuk provohej lidhja shkakësore midis ekspozimit të prindit ndaj rrezatimit dhe leuçemisë së fëmijës të lindur më pas.⁴⁸⁶

⁴⁸² Daniel Garcia San José, “Environmental protection and the European Convention on Human Rights”, Botim i Këshillit të Europës, Strasburg, 2005, fq. 5.

⁴⁸³ *Ibid.*, fq. 6.

⁴⁸⁴ Terminologjia e përdorur në vendimin origjinal në gjuhën angleze është “living instrument”. Autori i këtij punimi është i mendimit se termi “instrument dinamik”, pasqyron më saktë natyrën e KEDNJ, në krahasim me termin “instrument i gjallë”, siç është përkthyer rëndom.

⁴⁸⁵ Çështja *Soering kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Vendimi nr. 14038/88, datë 7.7.1989, paragraf. 102.

⁴⁸⁶ Çështja *LCB kundër Mbretërisë së Bashkuar*, vendimi nr. 14/1997/798/1001, datë 9.6.1998, paragraf. 39.

Një çështje tjetër në të cilën u deklarua shkelja e nenit 2, së bashku me nenin 1 të Protokollit 1, është *Öneryıldız kundër Turqisë*, ku gjykata vendosi që edhe në rastin e një ndërtimi të paligjshëm në zonën e vendgrumbullimit të mbetjeve në periferi të Stabollit, shteti ka detyrimin e mbrojtjes së jetës së njerëzve, si edhe të së drejtës së pronës. Kërkuesi kishte humbur shtëpinë dhe nëntë anëtarë të familjes në shpërthimin e datës 28 prill 1993, si rezultat i çlirimit të gazit të metanit në vendgrumbullimin e mbetjeve. Në lidhje me nenin 2, Gjykata theksoi jo vetëm detyrimin e shtetit për të mos kryer akte që u marrin jetën personave në mënyrë të qëllimshme e të paligjshme, por edhe të garantojnë të drejtën e jetës në përgjithësi e të marrin masa për mbrojtjen e të drejtës së jetës së personave që ndodhen nën juridiksionin e tyre. Autoritetet administrative ishin përgjegjëse për mosnjohimin e banorëve në zonën e vendgrumbullimit të mbetjeve për rreziqet që u kanoseshin dhe për mosmarrjen e masave për eliminimin e këtyre rreziqeve. Duke qenë që gjykata gjeti shkelje të nenit 2, për arsytet që ishin të njëjta me ato për nenin 8, vendosi që këto të fundit të mos i shqyrtonte më vete. Ndërsa në lidhje me nenin 1 të Protokollit 1 për mbrojtjen e të drejtës së pronës, gjykata tha që ushtrimi efektiv i saj nuk kërkon vetëm që autoritetet shtetërore të mos ndërhyjnë për ta cënuar atë, por mund të kërkojë edhe marrjen aktive të masave. Në rastin konkret, dukej qartë lidhja shkakësore midis një sërë mosveprimesh të autoriteteve shtetërore dhe shkatërrimit të banesave, kështu që u gjet shkelje e nenit 1 të Protokollit 1 të Konventës.⁴⁸⁷

Në çështjen *López Ostra kundër Spanjës*, u analizua dilema me të cilën përballen në ditët e sotme shtetet, veçanërisht vendet në zhvillim, për të bërë zgjedhjen midis zhvillimit të ekonomisë dhe mbrojtjes së mjedisit. Gjykata duhej të shqyrtonte me kujdes “...nëse autoritetet kombëtare morën masat e nevojshme për të mbrojtur të drejtën e kërkueses për të respektuar shtëpinë e saj dhe jetën e saj private dhe familjare sipas nenit 8...”⁴⁸⁸ Në rastin konkret, autoritetet vendore të qytetit duhej të balanconin nga njëra anë, nevojën për zhvillimin e qytetit, duke lejuar funksionimin e industrisë së lëkurës, qëllim për të cilin ishin ndërtuar disa fabrika, duke punësuar disa qindra njerëz, me nevojën për të mbrojtur mjedisin dhe shëndetin e njerëzve. Në vendimin e saj, GJEDNJ deklaroi se “...shteti nuk ka arritur me sukses të vendosë një ekuilibër të drejtë ndërmjet interesit të mirëqenies ekonomike të qytetit - atë të të paturit e një impianti të trajtimit të mbeturinave - dhe gëzimit efektiv të së drejtës së aplikantes për respektimin e shtëpisë së saj dhe jetës së saj private dhe familjare.”⁴⁸⁹ Do të kishte qenë me interes zhvillimi i ndonjë procesi gjyqësor të ngjashëm në ndonjë prej gjykatave të brendshme shqiptare, ndoshta në mënyrë të veçantë në gjykatën e Krujës, në lidhje me funksionimin e guroreve të panumërta që shkaktonin një ndotje të jashtëzakonshme të ajrit që mund të konstatohej me sy të lirë, para urdhërimit të mbylljes së tyre, apo të veprimtarisë së fabrikave të çimentos.

Të njëjtës çështje iu referua përsëri GJEDNJ në vendimin *Kyrtatos kundër Greqisë*. Ajo u shpreh se sipas jurisprudencës së saj të konsoliduar, ndotja e mjedisit mund të ndikojë në mirëqenien e njeriut dhe gëzimin e banesës e të jetës familjare, por pa dëmtuar rëndë shëndetin e njeriut. *Elementi përcaktues nëse ka cënim të së drejtës së mbrojtur nga neni 8 i konventës ka të bëjë me jetën private dhe familjare dhe jo me dëmtimin e mjedisit në përgjithësi.* [theksimi im] As neni 8, e as ndonjë nen tjetër i konventës nuk janë hartuar për mbrojtjen e mjedisit. Për këtë,

⁴⁸⁷ Çështja *Öneryıldız kundër Turqisë*, vendimi 48939/99, datë 18.6.2002, parag. 122 dhe 154.

⁴⁸⁸ Çështja *López Ostra kundër Spanjës*, vendimi nr. 16798/90, datë 9.12.1994, parag. 55.

⁴⁸⁹ *Ibid*, parag. 58.

instrumente të tjerë ligjorë, kombëtarë e ndërkombëtarë, janë më të përshtatshëm.⁴⁹⁰ Në përfundim të analizës, gjykata vendosi që zhurmat apo ndriçimi i fortë gjatë natës në afërsi të banesës së aplikantit nuk kishin arritur atë shkallë sa të konsideroheshin si shkelje të nenit 8.

Edhe në çështjen *Taşkın dhe të tjerë kundër Turqisë*, GJEDNJ theksoi se neni 8 i KEDNJ është i zbatueshëm në rastet e ndotjeve të rënda të mjedisit, që çënojnë mirëqënien e individëve dhe i pengojnë nga gëzimi i banesës në mënyrë të tillë që ndikojnë negativisht në jetën e tyre private e familjare, por pa dëmtuar seriozisht shëndetin e tyre. Përveç aspektit material të nenit 8, gjykata analizoi edhe aspektin procedural, në lidhje me procesin vendimmarrës mjedisor, që në rastin konkret kishte të bënte me lejimin e funksionimit të një miniere ari, që përdorte cianurin për nxjerrjen e arit dhe shkaktonte ndotje të rrymave të ujërave nëntokësore. Ajo theksoi që edhe pse shteteve u lihet një hapësirë e gjerë vlerësimi kur marrin vendime delikate mjedisore, ata kanë detyrimin që fillimisht të kryejnë studime në mënyrë që të jenë në gjendje të parashikojnë dhe vlerësojnë ndikimin e mundshëm negativ në mjedis të këtyre aktiviteteve, për të balancuar interesat e ndryshme që ndeshen. E drejta e publikut për t'u njohur me këto studime, që të jenë në gjendje të vlerësojnë rrezikun që mund t'u kanoset, është e pamohueshme, ashtu siç është edhe e drejta për t'iu drejtuar gjykatës, kur procesi vendimmarrës nuk u ka dhënë rëndësinë e duhur interesave të tyre. Në përfundim të analizës, gjykata vendosi që kishte shkelje të nenit 8 të konventës.⁴⁹¹

Ndër të tjera, GJEDNJ ka shqyrtuar edhe gjerësinë e hapësirës së vlerësimit që lihet në dorën e autoriteteve shtetërore kur marrin në konsideratë probleme që lidhen me mbrojtjen e mjedisit. Në çështjen *Hatton dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar*, në gjykimin e Dhomës së Madhe është deklaruar se “...thjesht referimi ndaj mirëqenies ekonomike të vendit nuk është i mjaftueshëm për të peshuar më shumë se të drejtat e të tjerëve [...] Neni 8 mund të gjejë zbatim në çështjet mjedisore nëse ndotja është shkaktuar drejtpërsëdrejti nga shteti apo nëse përgjegjësia e shtetit lind nga dështimi i tij për të rregulluar industrinë private në mënyrën e duhur. Nëse çështja është analizuar në aspektin e një detyrimi pozitiv për shtetin për të marrë masa të arsyeshme dhe të përshtatshme për të siguruar të drejtat e kërkuarve sipas paragrafit 1 të nenit 8, apo në kushtet e një ndërhyrjeje nga një autoritet publik që mund të justifikohet bazuar në paragrafin 2, parimet e zbatueshme janë shumë të ngjashme. Në të dy kontekstet, duhet mbajtur parasysh balancimi i drejtë që duhet vendosur midis interesave të individit që janë në konkurrencë me ato të komunitetit si një i tërë.”⁴⁹² Ndërsa para kësaj, në vendimin e Dhomës së Seksionit të Tretë, GJEDNJ ishte shprehur se “Gjykata vlerëson se shtetet duhet të minimizojnë sa më shumë që të jetë e mundur, ndërhyrjen ndaj këtyre të drejtave, duke u munduar të gjejnë zgjidhje alternative dhe përgjithësisht duke synuar të arrijnë qëllimet e tyre në mënyrën më pak të dëmshme ndaj të drejtave të njeriut. Që të arrijë ta bëjë këtë, përpara realizimit të projektit përkatës, shteti duhet të ndërmarrë një hulumtim dhe studim të duhur dhe të plotë, me qëllim gjetjen e zgjidhjes më të mirë të mundshme, e cila do të vendosë në realitet ekuilibrin e duhur.”⁴⁹³

⁴⁹⁰ *Kyrtatos kundër Greqisë*, vendimi nr. 41666/98, datë 22.8.2003, parag. 52.

⁴⁹¹ Çështja *Taşkın dhe të tjerë kundër Turqisë*, vendimi nr. no. 46117/99, datë 10.11.2004, parag. 113, 118 dhe 126.

⁴⁹² Çështja *Hatton dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Vendimi i Dhomës së Madhe, nr. 36022/97, datë 8.7.2003, parag. 86.

⁴⁹³ Çështja *Hatton dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar*, vendimi nr. 36022/97, Vendimi i Dhomës së Seksionit të Tretë, datë 2.10.2001, parag. 97.

Një çështje që ka lidhje me një nga problematikat e mprehta edhe në Shqipëri, atë të ndotjes akustike, është *Moreno Gomez kundër Spanjës*. Kërkuesi pretendonte shkeljen e nenit 8, për shkak të zhurmave që vinin prej klubeve të natës dhe vështirësimit të gjumit, në nivele që akti i ekspertimit i kishte konsideruar si të papranueshme. Gjykata vendosi që autoritetet publike kishin dështuar në vazhdimësi të zbatonin rregulloret për kontrollin e zhurmave, duke dhënë leje për diskoteka dhe bare, në një zonë të banuar. Zhurmat tej limiteve të lejuara gjatë natës dhe vazhdimi i gjendjes për vite me radhë u konsideruan se përbënin shkelje të nenit 8.⁴⁹⁴

Ndërsa në lidhje me nenin 10, në çështjen *Bladet Tromsø dhe Stensaas kundër Norvegjisë*, u diskutua mbi të drejtën e një gazete për të botuar informacion mjedisor që kishte të bënte me pasojat e gjuetisë së fokave, si edhe interesin e përgjithshëm, kombëtar e ndërkombëtar. Në rastin konkret, kërkuesit, gazeta 'Bladet Tromsø' dhe redaktori i saj Z. Stensaas, ishin dënuar për shpifje nga gjykata norvegjeze, pasi kishin bërë publike metodat e jashtëligjshme të gjuetisë së fokave të përdorura nga disa prej anëtarëve të ekuipazhit të anijes që gjuante foka. Gjykata u shpreh se neni 10 është i zbatueshëm jo vetëm për informacionet apo idetë që priten mirë prej publikut, apo që konsiderohen si jo fyese, apo që priten në mënyrë indiferente, por edhe ndaj atyre që ofendojnë, trondisin apo shqetësojnë shtetin apo cilëndo pjesë të popullsisë. Por ndërsa media nuk duhet të shkelë kufijtë që mbrojnë interesat dhe reputacionin e individëve privatë, ato kanë të drejtën të përhapin informacion dhe ide për çështje që kanë të bëjnë me interesin publik. Jo vetëm që media ka një detyrë të tillë, por edhe publiku ka të drejtën që ta marrë këtë informacion. Më tej, në vendimin e saj gjykata u shpreh se ndërgjegjësimi dhe debati publik që rezultojnë prej tij, kanë prioritet ndaj reputacionit të anëtarëve të ekuipazhit. Pavarësisht hapësirës së vlerësimit që kanë autoritetet kombëtare, kufizimet e vendosura ndaj lirisë së shprehjes nuk ishin proporcionale.⁴⁹⁵ Ky është një vendim shumë i rëndësishëm për sa i përket të drejtës themelore për të marrë informacion mbi aktivitetet që dëmtojnë mjedisin, në rastin konkret, mbi faunën detare. Duke patur këtë informacion, publiku është i mirëpajisur si për të marrë pjesë në vendimmarrjen mjedisore, ashtu edhe për t'iu drejtuar gjykatës për çështjet e mjedisit.

Për t'u vlerësuar është qëndrimi i GJEDNJ në çështjen *Brosset-Triboulet dhe të tjerët kundër Francës*, ku Dhoma e Madhe e përcaktoi interesin e autoriteteve publike për të mbrojtur mjedisin si primar ndaj të drejtave të tjera të individit, si p.sh., ndaj të drejtës së pronës në rastin konkret, e cila ishte kufizuar në favor të interesit publik, mbrojtjes së bregdetit e të mjedisit. Në vendimin e saj, gjykata theksoi se mbrojtja e mjedisit, e cila në shoqërinë e sotme ka marrë një rëndësi të veçantë, është shndërruar në një kauzë, mbrojtja e së cilës zgjon interesin e menjëhershëm e të vazhdueshëm të publikut, e për rrjedhojë edhe të autoriteteve publike. Më tej, gjykata iu referua edhe vendimeve të tjera të meparshme të saj, ku ka mbajtur të njëjtin qëndrim, si *Fredin kundër Suedisë*, apo *Turgut dhe të tjerët kundër Turqisë* për mbrojtjen e pyjeve, *Köktepe kundër Turqisë*, dhe *Şatir kundër Turqisë*. Gjykata argumentoi që ndërhyrja e autoriteteve publike ndaj të drejtës individuale të pronës kishte një qëllim të ligjshëm dhe ishte në interesin e përgjithshëm.⁴⁹⁶

Gjithashtu në Evropë, neni 37 i Kartës së të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian vendos ndaj organizatës detyrimin për të integruar në politikat e saj një nivel të lartë të mbrojtjes së mjedisit dhe përmirësimin e cilësisë së mjedisit, në përputhje me parimin e zhvillimit të

⁴⁹⁴ Çështja *Moreno Gomez kundër Spanjës*, vendimi nr. 4143/02, datë 16.11.2004, paragraf. 59-63.

⁴⁹⁵ Çështja *Bladet Tromsø dhe Stensaas kundër Norvegjisë*, vendimi nr. 21980/93, datë 20.5.1999, paragraf. 62 dhe 73.

⁴⁹⁶ Çështja *Brosset-Triboulet dhe të tjerët kundër Francës*, vendimi nr. 34078/02, datë 29.3.2010, paragraf. 84.

qëndrueshëm.⁴⁹⁷ Në fakt, në gjirin e kësaj organizate rajonale janë arritur me të vërtetë standardet më të larta të mbrojtjes së mjedisit.

Përveç traktateve evropiane, edhe në akte të tjera ndërkombëtare është synuar përfshirja e të drejtave mjedisore në të drejtat themelore të njeriut. Karta Afrikane për të Drejtat e Njeriut dhe të Popujve (Karta e Banxhulit) e miratuar në vitin 1981, ka përcaktuar një të drejtë mjedisore themelore të njeriut, duke sanksionuar se “Çdo individ do të ketë të drejtë të gëzojë gjendjen më të mirë të mundshme të shëndetit fizik dhe mendor...Shtetet Palë në këtë Kartë do të marrin masat e nevojshme për të mbrojtur shëndetin e popujve të tyre dhe do të garantojnë që atyre do t’u ofrohet kujdesi mjekësor kur janë të sëmurë...Të gjithë popujt do të kenë të drejtën për një mjedis të përgjithshëm, **të kënaqshëm** [theximi im], e të favorshëm për zhvillimin e tyre.”⁴⁹⁸ Një formulim i tillë që e konsideron gëzimin e këtyre të drejtave si të menjëhershëm është kritikuar si fiktiv, nëse mbahet parasysh gjendja reale në Afrikë.⁴⁹⁹

E veçanta e këtij dokumenti që e dallon atë nga traktatet evropiane dhe amerikane është se ai është i vetmi dokument që përqendrohet në të drejtat kolektive, konkretisht, në të drejtat e popujve. Kjo mund t’u ofrojë një mekanizëm shtesë Komisionit Afrikan për të Drejtat e Njeriut dhe të Popujve dhe Gjykatës Afrikane për të Drejtat e Njeriut dhe të Popujve që të mbështesin mbrojtjen e të drejtave të popujve, përveç të drejtave individuale. Në të gjithë traktatet e tjerë, të drejtat mjedisore janë konsideruar si “të bashkëlidhura” ndaj të drejtave të tjera, si e drejta e jetës, shëndetit, privatësisë, jetës familjare, të drejtës së pronës, etj. Një qasje e tillë individuale ndaj të drejtave mjedisore, edhe pse përbën një zgjidhje të përkohshme të problemeve të mprehta mjedisore aktuale që çenojnë individët, është kritikuar si penguese e zhvillimit më tej të të drejtave mjedisore dhe të jurisprudencës përkatëse, sepse nuk mban parasysh lidhjen midis interesave të individit dhe interesave kolektive të shoqërisë.⁵⁰⁰

Një rast që kishte të bënte me të drejtat mjedisore të popullatës Ogoni në Nigeri u paraqit para Komisionit Afrikan në vitin 2001, ku ndër të tjera u ngritën pretendime për shkelje të të drejtave mjedisore, bazuar në nenin 24 të Kartës Afrikane. Në raportin e tij, Komisioni konstatoi se qeveria e Nigerisë kishte dështuar në përmbushjen e detyrimeve të saj sipas Kartës Afrikane, duke lejuar korporatën “Shell” dhe shoqërinë me kapital shtetëror “Kompania Kombëtare Nigeriane e Karburanteve” (Nigerian National Petroleum Corporation), të shkatërronin mjedisin e atij rajoni.⁵⁰¹

Në kontinentin amerikan, ashtu si edhe në rastin e Evropës, nuk është përmendur ndonjë e drejtë mjedisore në tekstin origjinal të Konventës Amerikane për të Drejtat e Njeriut të vitit 1969. Më pas, në Protokollin e saj Shtesë të San Salvadorit të vitit 1988 u parashikua e drejta për një

⁴⁹⁷ Karta e të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian, Neni 37. Gazeta Zyrtare e Komiteteve Evropiane e, C364/1, datë 18.12.2000. Gjetet në: http://www.europarl.europa.eu/charter/pdf/text_en.pdf

⁴⁹⁸ Karta Afrikane për të Drejtat e Njeriut dhe të Popujve, Nenet 16 dhe 24. Gjetet në: http://www.achpr.org/english/info/charter_en.html

⁴⁹⁹ Günter Handl, “Human Rights and the Protection of the Environment”, në Svetlana Kravchenko and John E. Bonine, (red.), “Human Rights and the Environment – Cases, Law and Policy”, Carolina Academic Press, 2008, fq.7.

⁵⁰⁰ Francesco Francioni, “International Human Rights in an Environmental Horizon”, The European Journal of International Law, 2010, Vol. 21, nr. 1, fq. 44.

⁵⁰¹ Detajet e çështjes “Ogoni” gjenden në: <http://www.corteidh.or.cr/tablas/R21584.pdf>

mjedis të shëndetshëm dhe akses në shërbimet bazë për të gjithë, duke vendosur detyrime mbi shtetet palë për të promovuar mbrojtjen, ruajtjen, dhe përmirësimin e mjedisit.⁵⁰²

Megjithatë, deri tani nuk ka pasur ndonjë tregues përfundimtar të gatishmërisë së shteteve palë për të vendosur mbrojtjen e mjedisit shumë lart në listën e tyre të prioritetëve. Komisioni Ndër-Amerikan për të Drejtat e Njeriut vendosi në rastin ‘Yanomami’ në vitin 1985 se qeveria braziliane kishte dështuar në mbrojtjen e të drejtave mjedisore dhe të drejtave kulturore të indianëve Yanomami, të cilat u ishin shkelur nga ndërtimi i një autostrade përmes territorit që i përkiste prej shekujsh indianëve Yanomami.⁵⁰³ Rëndësia e këtij vendimi qëndron në faktin se Komisioni Ndër-Amerikan për të Drejtat e Njeriut zgjeroi kuptimin e “të drejtës për jetën”, që të përfshijë edhe “kërcënimet mjedisore ndaj jetës”.

Përveç këtij vendimi, edhe Gjykata Ndër-Amerikane për të Drejtat e Njeriut (GJNADNJ), në çështjen *Mayagna (Sumo) Awas Tingni Community kundër Nikaraguas*, duke iu referuar nenit 180 të kushtetutës së Nikaraguas, theksoi që komunitetet e bregut të Atlantikut kanë të drejtën të jetojnë e të zhvillohen sipas formave të organizimit shoqëror, sipas traditave të tyre historike dhe kulturore, ndërsa shteti u garanton atyre gëzimin e burimeve të tyre natyrore. Ajo vendosi që Nikaragua kishte shkelur të drejtën e pronës, të garantuar nga neni 21 dhe të drejtën e mbrojtjes gjyqësore të garantuar nga neni 25 i Konventës Ndër-Amerikane për të Drejtat e Njeriut, duke mos kryer delimitimin dhe demarkimin e pronave të komunitetit indigjen Mayagna, por pa përmendur ndonjë të drejtë mjedisore.⁵⁰⁴ Qëndrim të njëjtë mbajti kjo gjykatë edhe në çështjen *Saramaka People kundër Surinamit*, datë 28.11.2007, duke gjetur shkelje të po këtyre dispozitave të konventës.⁵⁰⁵

Ndërsa vendimi më i spikatur i GJNADNJ, në të cilin gjykata shprehu qartë lidhjen midis të drejtave të njeriut dhe mbrojtjes së mjedisit është ai në çështjen *Kawas-Fernández kundër Hondurasit*, për vrasjen e një aktivisteje mjedisore, drejtuese e OJF mjedisore “Prolansate”, që kundërshtonte zhvillimin e projekteve brenda parqeve kombëtare dhe zonave të mbrojtura në Honduras. Përveç shkeljes të së drejtës për jetën nga ana e Hondurasit, gjykata u shpreh që shteti kishte shkelur edhe të drejtën e organizimit, pasi në lidhje me mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe rolin e OJF në shoqëritë demokratike, shtetet kanë detyrimin pozitiv të parandalojnë sulmet ndaj tyre dhe të hetojnë veprimet që kufizojnë këto të drejta. Për realizimin e këtyre të drejtave, shtetet kanë detyrimin që kur është e nevojshme, t’i ndërmarrin këto veprime edhe në marrëdhëniet midis individëve. Ata kanë detyrimin që të sigurojnë mjetet që mbrojtësit e të drejtave të njeriut të ushtrojnë lirshëm aktivitetin e tyre, t’i mbrojnë ata kur u kërcënohet jeta apo siguria dhe të mos u vendosin kufizime në punën e tyre. Më tej përveç jurisprudencës së saj, gjykata i referohet edhe jurisprudencës së GJEDNJ, duke deklaruar se sipas saj, “...**ekziston një lidhje e pamohueshme midis mbrojtjes së mjedisit dhe gëzimit të të drejtave të tjera** [theksimi

⁵⁰² Protokoll i Shtesë i Konventës Amerikane për të Drejtat e Njeriut në Fushën e të Drejtave Ekonomike, Sociale dhe Kulturore (Protokoll i San Salvadorit), 17.11.1988, neni 11. Gjetet në:

<http://www.oas.org/juridico/english/treaties/a-52.html>

⁵⁰³ Vendimi i Komisionit Ndër-Amerikan për të Drejtat e Njeriut gjendet në:

<http://www.cidh.oas.org/annualrep/84.85eng/brazil7615.htm>

⁵⁰⁴ Vendimi i GJNADNJ *Mayagna (Sumo) Awas Tingni Community v. Nicaragua*, datë 31.8.2001, gjendet në:

http://www.corteidh.or.cr/docs/casos/articulos/seriec_79_ing.pdf

⁵⁰⁵ Vendimi i GJNADNJ *Saramaka People v. Suriname*, datë 28.11.2007, gjendet në:

http://www.corteidh.or.cr/docs/casos/articulos/seriec_172_ing.pdf

im]. Mënyrat se si degradimi i mjedisit dhe efektet negative të ndryshimeve klimatike kanë çënuar gëzimin efektiv të të drejtave të njeriut në këtë kontinent janë bërë objekt diskutimesh në Asamblenë e Përgjithshme të OAS dhe OKB.”⁵⁰⁶ Pastaj gjykata vëren edhe faktin që tashmë shumë shtete kanë në kushtetutat e tyre dispozita që njohin shprehimisht të drejtën për një mjedis të pastër.

7.5 Të drejtat e njeriut dhe të drejtat mjedisore në të drejtën e brendshme shqiptare.

Si edhe në vendet e tjera në zhvillim, legjislacioni mjedisor shqiptar është përpjekur të vendosë një ekuilibër midis nevojës për zhvillim dhe mbrojtjes së mjedisit. Politikat mjedisore, që të jenë të zbatueshme dhe efektive, duhet të jenë të mbështetura në një kuadër të plotë ligjor dhe në struktura administrative efçente. Aktualisht, ekziston një kuadër ligjor i cili synon drejt një mbrojtjeje efektive të mjedisit, i udhëhequr nga parimi i zhvillimit të qëndrueshëm. Ky legjislacion është relativisht i ri, në krahasim me atë të vendeve të tjera evropiane. Politikat e para mjedisore u hartuan në kontekstin e Strategjisë Kombëtare të Mjedisit të vitit 1993 dhe të Planit Kombëtar të Veprimit për Mjedisin të vitit 1994.

Si dokument që sanksionon edhe të drejtat themelore të njeriut, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë shprehet që shteti, brenda kompetencave kushtetuese dhe mjeteve që disponon, si dhe në plotësim të nismës dhe të përgjegjësisë private, synon, ndërmjet të tjerash, edhe një mjedis të shëndetshëm dhe ekologjikisht të përshtatshëm për brezat e sotëm dhe të ardhshëm.⁵⁰⁷ Ky është adoptim i parimit të zhvillimit dhe përdorimit të burimeve natyrore, pa çënuar mundësitë dhe nevojat e brezave të ardhshëm, si e vetmja alternativë me një të ardhme për mjedisin. Përveç kësaj, duke qenë se po hartohet në të njëjtën kohë, Kushtetuta adoptoi edhe parimin themelor të Konventës së Aarhus-it, të drejtën e publikut për të patur informacion për mjedisin dhe për mbrojtjen e tij.⁵⁰⁸

Pas miratimit të Kushtetutës, u miratua një kuadër i gjerë ligjor mbi mjedisin, i përbërë nga ligje dhe akte nënligjore, të cilët synojnë mbrojtjen e mjedisit nga ndotja dhe dëmtimi, si dhe marrjen e masave parandaluese dhe rehabilituese. Ndër të tjera, një nga më të rëndësishmit për kohën ishte ligji nr. 8934, datë 5.9.2002, “Për mbrojtjen e mjedisit”, i cili synonte rregullimin e marrëdhënieve midis njerëzve dhe mjedisit, mbrojtjen e përbërësve të mjedisit dhe proceseve mjedisore, sigurimin e kushteve materiale për zhvillimin e qëndrueshëm, duke hedhur një hap të rëndësishëm drejt një kuadri ligjor të domosdoshëm për një mjedis ekologjikisht të pastër. Ky ligj përfshinte parimet kryesore të mbrojtjes së mjedisit, siç është parimi i përdorimit të qëndrueshëm të burimeve natyrore, parimi i kujdesit për mjedisin, parimi i parandalimit, parimi ‘ndotësi paguan’, parimi i riparimit të dëmeve mjedisore, përtëritjes dhe rehabilitimit të zonave të dëmtuara, parimi i sanksionimit të përgjegjësisë ligjore, parimi i mbrojtjes së mjedisit në shkallë të lartë, parimi i integritimit të mbrojtjes së mjedisit në politikat sektoriale, parimi i sensibilizimit të publikut dhe i pjesëmarrjes së tij në vendimmarrje dhe parimi i transparencës në

⁵⁰⁶ Vendimi i GJNADNJ *Kawas-Fernández kundër Hondurasit*, datë 3.4.2009, parag. 148. Gjetet në: http://www.corteidh.or.cr/docs/casos/articulos/seriec_196_ing.pdf

⁵⁰⁷ Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 59/d.

⁵⁰⁸ *Ibid*, neni 56.

vendimmarrjen mjedisore.⁵⁰⁹ Më pas, ky ligj u shfuqizua prej ligjit nr. 10431, si edhe u miratuan një sërë ligjesh të tjerë, për mbrojtjen e ajrit, ujit, tokës, biodiversitetit, për zonat e mbrojtura, për gjuetinë, për menaxhimin e integruar të mbetjeve, për vlerësimin e ndikimit në mjedis, për vlerësimin strategjik mjedisor, e të tjerë, të analizuar më lart, duke krijuar një kuadër të gjerë ligjor për mbrojtjen e mjedisit.

Megjithatë, ekzistenca e një kuadri ligjor në letër nuk garanton mbrojtjen e të drejtave të njeriut në praktikë. Siç ndodh edhe në vende të tjera, edhe në Shqipëri, janë zakonisht komunitetet e varfëra dhe të lënë mënjane të cilët bartin pasojat e ndotjes së mjedisit dhe të degradimit të burimeve natyrore. Ata mund t'u nënshtrohen presioneve për shpronësim të tokës dhe burimeve të tjera natyrore dhe për shkak se zakonisht atyre u ofrohet mbrojtja më e pakët, ata nuk janë në gjendje të kërkojnë kompensim të drejtë apo të kundërshtojnë zhvillimet e padëshiruara.⁵¹⁰

Një rast i tillë është rasti 'Petrolifera' i përmendur më sipër, ku autoritetet shqiptare nuk njoftuan dhe as u konsultuan me publikun e interesuar gjatë vendimmarrjes mbi planifikimin e një parku industrial, i cili do të përmbante tubacione naftë dhe gazi natyror, depozita për magazinimin e naftës, tre termocentrale dhe një rafineri, pranë Lagunës së Nartës, e shpallur si Zonë e Mbrojtur, në afërsi të qytetit të Vlorës.⁵¹¹ Pavarësisht nga protestat masive të banorëve të Vlorës në favor të ruajtjes së një zone të deklaruar si e mbrojtur me ligj, autoritetet shtetërore vendosën të vazhdojnë lejimin e ndërtimit të parkut industrial, i cili rezultoi në spastrimin e një sipërfaqeje prej 500 ha dhe prerjen e mijëra pishave. Si rezultat i veprimit të ndërmarrë nga OJF mjedisore "Aleanca Qytetare për Mbrojtjen e Gjirit të Vlorës" para Komitetit të Zbatueshmërisë të Konventës së Aarhus-it, Komiteti rekomandoi që Shqipëria duhet të "...të marrë masat e nevojshme legislative, administrative, e masa të tjera, për të siguruar që: a) Të krijohet në legjislacionin shqiptar një kuadër i qartë, transparent dhe i qëndrueshëm, për zbatimin e dispozitave të Konventës, përfshirë një skemë më të qartë dhe më efektive të përgjegjësive të administratës qeverisëse..." Gjithësesi, Parku Industrial vazhdon funksionimin e tij dhe ndotja e pashmangshme e Gjirit të Vlorës tashmë ka filluar. Siç pritej, në 12 korrik 2011, në plazhin e Zvërnecit, rreth një ton karburant u derdh në det, duke sjellë ndotjen e të gjithë bregut të Adriatikut në afërsi të Zvërnecit. Përveçse katastrofë ekologjike, një gjë e tillë bie ndesh edhe me strategjinë qeveritare për zhvillimin e bregdetit, ku turizmi është konsideruar si një prioritet. Është jo logjike të mendohet se turizmi dhe një park industrial mund të zhvillohen pranë njëri-tjetrit.

Ngjarje të tilla nuk ndodhin vetëm në Shqipëri, ky është një fenomen që ndodh edhe në vendet e zhvilluara.⁵¹² Vetë Komisioni i BE, në komunikimin me me Parlamentin Evropian, Këshillin, Komitetin Evropian Ekonomik dhe Social dhe Komitetin e Rajoneve, mbi Rishikimin e Ndërmjetëm të Programit të Gjashtë të Veprimit Mjedisor të Komunitetit, është shprehur se "Pas 35 vitesh zhvillimesh ligjore, tashmë është ngritur një kuadër politikash mjedisore. Megjithatë,

⁵⁰⁹ Ligji nr. 8934, datë 5.9.2002, "Për mbrojtjen e mjedisit", nenet 1 dhe 4.

⁵¹⁰ Lyuba Zarsky. "Conflicts, Ethics, and Globalization", redaktuar nga Lyuba Zarsky, "Human Rights and the Environment. Conflicts and Norms in a Globalizing World.", Earthscan Publications, London, UK, 2002, fq.1.

⁵¹¹ *Supra.*, shënimi fundor nr. 398. Shih Raportin e Komitetit të Zbatueshmërisë së Konventës së Aarhusit, Gjenevë, 13–15 Qershor 2007. Gjendet në

http://www.unece.org/env/documents/2007/pp/ECE_MP.PP_C_1_2007_4_Add_1.pdf

⁵¹² Për të dhëna statistikore të derdhjes së karburanteve në det, shih informacionin e Agjencisë Evropiane të Mjedisit: <http://www.eea.europa.eu/data-and-maps/indicators/accidental-oil-spills-from-marine-shipping-1>

numri i madh i ankesave dhe procedurave të shkëlqes, janë tregues të faktit që zbatimi i legjislacionit mjedisor mbetet larg të qënit i kënaqshëm.”⁵¹³ Por problemi në Shqipëri, si edhe në shumicën e vendeve në zhvillim, është mungesa e institucioneve të forta për të mbështetur zbatimin e ligjit dhe një sistem i dobët gjyqësor që mund të ofrojë mjetet e duhura. Nëse bëjmë krahasimin me një rast të ngjashëm në Hungari, dallimi me vendin tonë është i dukshëm. Në rastin në fjalë, një investitor aplikoi pranë autoriteteve mjedisore për një leje ndërtimi të një fabrike përpunimi të baterive të vjetra, duke i bashkëlidhur kërkesës edhe Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, ashtu siç parashikohet nga *acquis communautaire* (Direktiva e Këshillit 92/43/EEC – Direktiva e Habitave) dhe nga legjislacioni kombëtar hungarez, për të marrë lejen mjedisore. Problemi qëndronte në faktin që vendi i zgjedhur për ndërtimin e fabrikës ndodhej në një zonë që ishte pjesë e territoreve të rrjetit Natura 2000, zonë e mbrojtur, me interes për Komunitetin Evropian, pasi aty gjendej një specie e mbrojtur, zogu migrator *Otis Tarda*. Vetë autoriteti administrativ, Drejtoria e Rezervateve Natyrore të Rajonit Hortobágy në vendimin e saj kishte argumentuar se fabrika zinte një sipërfaqe të vogël (rreth 4000 m²) në krahasim me sipërfaqen që ishte pjesë e rrjetit Natura 2000 (rreth 500.000 m²), duke e miratuar kështu dhënien e lejes mjedisore. Pas ngritjes së padisë së përbashkët nga ana e pronarit të truallit ngjitur me territorin ku do të ngrihej fabrika dhe nga organi i pushtetit vendor në afërsi të këtij territori, gjykata e shkallës së parë e kishte pranuar argumentimin e Drejtorisë së Rezervateve Natyrore duke vendosur rrëzimin e padisë dhe lejimin e ndërtimit të fabrikës, pasi përbënte një çështje sociale të rëndësishme, me interes publik. Pas bërjes së rekursit nga ana e paditësve, Gjykata e Lartë e Hungarisë iu referua në mënyrë të drejtpërdrejtë Direktivës së Habitave dhe vendimit të GJED në çështjen *Dragaggi*.⁵¹⁴ Në vendimin e saj ajo u shpreh se interesi publik në rastin konkret ishte mbrojtja e shëndetit dhe e sigurisë publike, si edhe çështjet parësore të mbrojtjes së mjedisit. Në rastet kur diskutohen interesat publike, autoritetet vendimmarrëse duhet të marrin në konsideratë zgjidhjet alternative që mund të ekzistojnë [theksimi im]. Pika 4 e nenit 6 të Direktivës së Habitave nuk lë asnjë dyshim në lidhje me zgjidhjet alternative për një plan apo projekt që ka rëndësi publike, të karakterit ekonomik apo social. Shteti anëtar duhet të marrë të gjitha masat kompensuese, në mënyrë që të ruhet koherenca e përgjithshme e rrjetit Natura 2000. Duke marrë parasysh të gjitha këto, Gjykata e Lartë vendosi pranimin e padisë, e duke iu referuar çështjes *Dragaggi* të GJED, theksoi se në rastet e zonave të identifikuara si zona të mundshme me interes për Komunitetin dhe që figurojnë në listat kombëtare të këtyre zonave të përcjella Komisionit Evropian ku ndodhen habitate dhe specie të mbrojtura, shtetet anëtare duhet të marrin masat e duhura mbrojtëse sipas Direktivës, me qëllim realizimin e interesave ekologjike.⁵¹⁵ Të njëjtin qëndrim ka mbajtur GJED edhe në çështjen “*Bund Naturschutz*”, Nr. 244/05, datë 14.9.2006,⁵¹⁶ të paraqitur nga Gjykata Administrative e Bavarisë. Paditësit kishin kërkuar para kësaj gjykate ndalimin e ndërtimit të seksionit të autostradës Forstinning-Pastetten, pjesë e

⁵¹³ Komunikim i Komisionit me Parlamentin Evropian, Këshillin, Komitetin Evropian Ekonomik dhe Social dhe Komitetin e Rajoneve, mbi Rishikimin e Ndërmjetëm të Programit të Gjashtë të Veprimit Mjedisor të Komunitetit, COM (2007), fq. 16.

⁵¹⁴ Çështja *Società Italiana Dragaggi SpA and Others v Ministero delle Infrastrutture e dei Trasporti and Regione Autonoma Friuli Venezia Giulia*. Me anën e këtij vendimi GJED synoi të përcillte mesazhin tek shtetet anëtare të BE-së që të mos i bënin Komisionit propozime për të futur në listën e rrjetit Natura 2000, zona në të cilat nuk merren masa për mbrojtjen e tyre. Se çfarë masash duheshin marrë, GJED e la në diskrecionin e gjykatave kombëtare. Gjendet në: <http://curia.europa.eu/juris/liste.jsf?language=en&num=C-117/03>

⁵¹⁵ *Supra.*, shënimi fundor nr. 91, fq. 47-50.

⁵¹⁶ Analiza e hollësishme e çështjes gjendet në: <http://onlinelibrary.wiley.com/doi/10.1111/j.1467-9388.2007.00545.x/pdf>

superstradës A94 Mynih-Mühldorf-Simbach-Pocking, e cila do të lidhte Mynihun me Bavarinë Juglindore dhe Austrinë. Në planet e zhvillimit të rrugëve kombëtare ky segment klasifikohet si ‘prioritet absolut’, por për paditësit, kalimi i kësaj rruge në afërsi të fshatit Haag konsiderohet i papërshtatshëm, pasi vetë autoritetet gjermane e kishin përcaktuar këtë zonë si zonë të mbrojtur, që në 29 shtator 1994, si zonë të mundshme për t’u përfshirë në listën e zonave të mbrojtura të Komisionit Evropian. Aq më tepër që autostrada do të kalonte në afërsi të brigjeve të lumenjve Hammerbach dhe Isen, si edhe degëve të tyre, Lappach, Goldach and Rimbach, ku dëmi ekologjik do të ishte i pariparueshëm. Pyetjet që iu drejtuan GJED kishin të bënin me atë se çfarë regjimi mbrojtës caktohet prej nenit 3§1, së bashku me paragrafin 6 të preambulës së Direktivës së Habitave në lidhje me zonat që mund të listohen si me interes për Komunitetin, përpara se ato të përfshihen në listën përkatëse të Komisionit, por që janë tashmë të përfshira në listën kombëtare që shteti anëtar ia ka paraqitur Komisionit, sipas nenit 4§1? GJED konfirmoi edhe një herë qëndrimin e mbajtur në çështjen *Dragaggi*, duke vendosur se shetet anëtare, pasi i kanë përcjellë Komisionit listat e tyre kombëtare që mund të jenë të rëndësishme për Komunitetin, nuk mund të miratojnë lejimin e ndërhyrjeve që rrezikojnë karakteristikat ekologjike të këtyre zonave.⁵¹⁷

Ajo çka u tha për gjyqësorin shqiptar nuk nënkupton se vetëm ai ka përgjegjësinë për të garantuar të drejtën për një mjedis të shëndetshëm. Gjyqësori duhet të jetë hallka e fundit në zinxhirin që duhet të fillojë me familjen dhe sistemin e arsimit, institucionet e qeverisjes vendore dhe asaj qendrore, OJF, Avokatin e Popullit, e kështu me radhë. Shumë e rëndësishme është edhe tradita e një vendi në mbrojtjen e mjedisit, sepse vërtet pak më sipër u soll ndër të tjera edhe shembulli i Hungarisë, por nuk duhet harruar që tradita ligjore ambientaliste në atë vend është shumë më e hershme, ku ligji për ndalimin e gjuetisë së shpendëve në periudhën e çiftëzimit daton që prej vitit 1729, ndërsa ligji për parandalimin e shkaktimit të dëmeve mjedisore nga industria, që prej vitit 1874.⁵¹⁸

Një model bashkëkohor në lidhje me qëndrimin e industrisë ndaj komunitetit dhe mjedisit ku ai vepron është modeli i quajtur ‘modeli i përgjegjshmërisë shoqërore të kompanive’. Njëri element i këtij modeli konsiston në atë që kompanitë duhet të ndërgjegjësohen që jo vetëm aksionerët, por edhe komunitetet vendore preken prej veprimtarisë së tyre. Elementi tjetër ka të bëjë me ngritjen e një sistemi auditimi të brendshëm të kompanisë, i cili mbikëqyr respektimin e legjislacionit vendas që ka të bëjë jo vetëm me normat për mbrojtjen e mjedisit, por edhe me legjislacionin e punës, atë për pagat, sigurimet shoqërore, orarin e punës, pushimin, etj. Elementi i tretë i modelit refelekton marrëdhëniet e kompanisë me të tretët, që do të thotë bërjen publike të aspekteve të ndryshme të veprimtarisë së saj dhe zhvillimin e diskutimeve me komunitetin, në mënyrë që ai të jetë i informuar dhe t’i jepet mundësia që të shfaqë edhe ai mendimin e tij.⁵¹⁹ Në stadin e zhvillimit në të cilin ndodhet Shqipëria, zbatimi i modelit të përgjegjshmërisë shoqërore të kompanive duket ende i largët.

⁵¹⁷ Vendimi i GJED “*Bund Naturschutz*”, Nr. 244/05, datë 14.9.2006, parag. 41, 42, 44-47, 51.

⁵¹⁸ Nora Katalin Bonomi, “*The role of the public prosecutor in environmental enforcement*”, në Gyula Bándi, (red.), “*The Impact of ECJ Jurisprudence on Environmental Law*”, Akaprint Kft, 2009, fq. 51.

⁵¹⁹ *Supra.*, shënimi fundor 192, fq. 36.

KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

Nga analiza e realizuar në këtë punim rezulton që ashtu siç ka evoluar zhvillimi i shoqërisë njerëzore drejt globalizimit, edhe normat e së drejtës ndërkombëtare mjedisore tashmë kanë evoluar prej rregullimit të marrëdhënieve të ngushta dy apo shumëpalëshe midis shteteve sovraane, në norma që synojnë përballimin e problemeve globale mjedisore, siç janë çarja e shtresës së ozonit, ngrohja globale, ruajtja e ekosisteve dhe biodiversitetit, të cilat i përkasin të gjithë komunitetit ndërkombëtar, e deri te sigurimi i një trashëgimie të pastër mjedisore për brezat e ardhshëm.

Nga çështjet e shqyrtuara në këtë punim, dalin disa tipare të së drejtës ndërkombëtare mjedisore me të cilat përballen gjykatat. Një ndër to është karakteristika e veçantë e traktateve mjedisore në krahasim me traktatet e degëve të tjera të së drejtës, që në përmbajtje kanë norma që janë më tepër arritje kompromisesh për të nxitur palët që të bashkëpunojnë për mbrojtjen e mjedisit, sesa norma detyruese, në të cilat mund të mbështeten gjykatat për dhënien e vendimeve të tyre. Një tipar tjetër është debati që zhvillohet mbi bazën shkencore të gjetjeve të ndryshme, që ka shërbyer si katalizator për hartimin e normave të së drejtës ndërkombëtare mjedisore. Edhe për çështje që në pamje të parë janë të prekshme për komunitetin ndërkombëtar, siç është ngrohja globale, zhvillohet debat i ashpër nëse ngritja e temperaturave ka ardhur për shkak të aktivitetit njerëzor apo për shkaqe natyrore, siç është aktiviteti i rritur i njollave të diellit. Gjykatave u duhet të marrin vendime në kushtet e pretendimeve po aq shkencore që mund të vijnë prej palëve. Po kështu, rrallë ndodh që gjykatave t'u paraqiten për zgjidhje çështje që kanë të bëjnë me aspekte krejtësisht mjedisore. Ato që në zhargonin e përditshëm quhen 'të drejta mjedisore' pothuajse gjithmonë janë shoqëruese të të drejtave të tjera të parashikuara në traktate, qofshin këto të drejta të karakterit ekonomik, siç u konstatua nga analiza që iu bë jurisprudencës së GJED, si p.sh. të drejtës së konkurrencës në BE, lirisë së qarkullimit, apo të drejta dhe liri themelore të njeriut, siç u pa në analizën e jurisprudencës së GJEDNJ, ku ato shoqërojnë të drejtën e jetës, të drejtën për jetë private e familjare, të drejtën e pronës, etj. Përveç të tjerash, aktorët kryesorë sot në arenën ndërkombëtare, shtetet, nuk mbajnë të njëjtin qëndrim ndaj mjedisit. Veçanërisht i theksuar është dallimi në qëndrim midis shteteve të zhvilluara dhe atyre në zhvillim, ku këto të fundit janë të gatshme të sakrifikojnë respektimin e normave mjedisore, në favor të nxitjes së zhvillimit të tyre ekonomik. Këtyre u shtohet edhe raporti që zënë çështjet mjedisore në krahasim me të gjithë volumin e çështjeve me tematika të tjera, i cili është tepër i ulët, çka është tregues i qartë që shtetet ende nuk janë të gatshëm që t'u drejtohen gjykatave për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve mjedisore.⁵²⁰

Siç është evidente, edhe nga ky studim rezulton që problemet mjedisore në Shqipëri janë të shumta, duke përfshirë ndotjen e ajrit, ujërave nëntokësore, tokës, zvogëlimin drastik të sipërfaqeve të gjelbra, shpyllëzimet masive, erozionin, humbjen e zonave ligatinore, ndotjen nga pesticidet dhe amianti (azbesti), shrytëzimin pa kriter të brigjeve të lumenjve, ndotjen nga mungesa e sistemit të përpunimit të mbeturinave, etj. Në kushtet e problemeve të tilla të rënda,

⁵²⁰ Philippe Sands, "Litigating environmental disputes: Courts, tribunals and the progressive development of International Environmental Law", Global Forum of International Investment, Contribution to the Liber Amicorum of Judge Thomas Menash, 2007, fq. 3-5. Gjetendet në: <http://www.oecd.org/investment/globalforum/40311090.pdf>

mbetet i pazëvendësueshëm roli i administratës publike në zbatimin e politikave mjedisore, jo vetëm në kuadrin e detyrave institucionale, por edhe duke dhënë shembullin individual nëpërmjet aplikimit të praktikave të mira. Ajo ndodhet së pari para vështirësive për transpozimin e një sasive të konsiderueshme legjislacioni, çka nuk është e lehtë për asnjë administratë shtetërore, lëre pastaj për atë shqiptare, që nuk ka as madhësinë, as kapacitetet njerëzore e financiare për ta realizuar këtë. Së dyti, përveç njohjes së normave, administrata duhet të njohë edhe vendimet gjyqësore ndërkombëtare, veçanërisht ato të GJED dhe GJEDNJ, që kanë të bëjnë me mjedisin. Realiteti është që administrata ka prirjen të zbatojë vetëm atë çka urdhërohet në letër administrativisht, pa u kujdesur shumë për t'u njohur me vendimet e gjykatave, aq më pak me vendimet e gjykatave ndërkombëtare. Në këto kushte, administrata publike duhet t'i nënshtrohet vazhdimisht një procesi reformimi dhe aftësimi të vazhdueshëm në lidhje me çështjet mjedisore. Për të siguruar cilësi dhe efektivitet në punën që bëhet për zbatimin e konventave, me ndikime të ndjeshme pozitive janë kualifikimet e trainimet e personelit që merret me zbatimin e tyre, pasi janë specialistët ata që në fundit të fundit mund të garantojnë vënien në zbatim të normave të legjislacioni kombëtar e ndërkombëtar.

Për sa i përket përafrimit me legjislacionin komunitar, Shqipërisë i duhet të ndërmarrë hapa seriozë në drejtim të mbrojtjes së ajrit dhe administrimit të ujërave, pasi në kuadrin e legjislacioni evropian këto janë fusha që kanë një rregullim të gjerë. Në veçanti, politika e re evropiane e ujërave dhe Direktiva Kuadër e Ujit, janë të bazuara në 'qasjen e kombinuar', parimin e marrjes së masave paraprake, parimin e parandalimit, parimin sipas të cilit dëmet mjedisore duhen riparuar në burim, si edhe në parimin e mbajtjes parasysh të kushteve mjedisore specifike të rajoneve të ndryshme. Në Shqipëri, kapacitetet për menaxhimin e ujërave janë ende të kufizuara, dhe ngritja e tyre është një domosdoshmëri. Një mangësi jo e vogël është mungesa e një strategjie për administrimin e burimeve ujore, e cila duhet hartuar sa më parë. Përveç kësaj, përpjekje serioze duhen bërë për zbatimin e legjislacioni të BE për ujërat, ku një rol të rëndësishëm luajnë organet e pushtetit vendor, të cilat në vetvete janë në proces transformimi e ristrukturimi. Me to duhet punuar, sidomos për ushtrimin e kontrolleve për mbrojtjen e ujërave nga ndotja dhe për hartimin e programeve të trainimit për mënyrat e inspektimit dhe kontrollit të cilësisë së ujërave. Transferimi i dijeve, ekspertizës dhe mbështetja për njohjen e legjislacioni evropian duhet të aplikohet në të gjitha nivelet.

Për sa i përket mbrojtjes së biodiversitetit, përparësi duhet t'i jepet edhe zbatimit të planeve të administrimit për zonat e mbrojtura ekzistuese prioritare, siç janë: Rezervat Strikt Natyrore, Parqet Kombëtare dhe Monumentet e Natyrës dhe të kryhet në vazhdimësi procesi i monitorimit të biodiversitetit. Forcimi i mëtejshëm i nivelit të administrimit të zonave të mbrojtura duhet të arrihet nëpërmjet riorganizimit të Administratës për Zonat e Mbrojtura. Gjithashtu, shumë i rëndësishëm është edhe përdorimi dhe menaxhimi i informacionit mbi biodiversitetin. Duhet bërë përpjekje për përmirësimin e cilësisë dhe përdorimin e informacionit dhe të dhënave mbi biodiversitetin, si edhe për plotësimin dhe standardizimin e të dhënave. Realizimi i këtyre detyrave sigurisht që kërkon rritje të konsiderueshme të nivelit të burimeve në dispozicion të insitucioneve përkatëse.

Shqipëria ka shumë hapësira për reduktimin e emetimeve, kryesisht në sektorin e energjisë, duke synuar përdorimin maksimal të mundshëm të energjive të rinovueshme, duke bërë transformim rrënjësor të sektorit të mbetjeve, që është tepër i prapambetur, por që mbetjet mund të përbëjnë

një burim energjie, për shembull, nëpërmjet djegies. Pavarësisht një kuadri ligjor të gjerë, menaxhimi i mbetjeve vazhdon të jetë në nivele shumë të ulëta në Shqipëri dhe shkalla e riciklimit e papërfillshme. Njësitë e qeverisjes vendore kanë kapacitete shumë të dobëta për menaxhimin e mbetjeve. Pjesa më e madhe e mbetjeve vazhdon të hidhet në mënyrë të pasigurt në vendgrumbullime të ligjshme ose të paligjshme, ose digjet. Ende mungojnë hapësirat për mbetjet e rrezikshme, mjekësore ose ndërtimore, si dhe nuk ka një procedurë të qartë për menaxhimin dhe kontrollin e lendfilleve.

Nga analiza e legjislacionit të kryer në kuadër të këtij punimi, rezulton se në Shqipëri ka ende nevojë për asistencë për plotësimin e legjislacionit mjedisor, në të cilin mund të mbështetet reforma në mjedis, në kuadër të përafrimit me legjislacionin komunitar. Në bashkëpunim edhe me vendet fqinje, duhet adoptuar një qasje strategjike rajonale e përbashkët për përafrimin, verifikimin e përputhshmërisë, ngritjen e kapaciteteve, si edhe shkëmbimin e eksperiencave midis tyre. Përveç faktit që të gjitha vendet e rajonit kanë probleme të ngjashme mjedisore, bashkëpunimi bëhet akoma më tepër i domosdoshëm për shkak se të gjitha këto vende janë kandidatë për anëtarësim në BE, e do të ishtë në interesin e tyre të përgatisin projekte të përbashkëta mjedisore rajonale, duke rritur ndjeshëm edhe mundësitë për financim prej BE, aq të nevojshme për të gjitha këto vende.

Për nga vetë natyra e kësaj fushe, shumë i rëndësishëm është edhe kontributi që mund të japë komuniteti shkencor, prandaj vëmendje më e madhe duhet t'i kushtohet mendimit shkencor. Ky studim ka identifikuar një nevojë të ngutshme për zhvillimin e kërkimit shkencor mjedisor në Shqipëri. Tashmë është bërë i domosdoshëm koordinimi i veprimtarive të institucioneve shkencore shqiptare me ato të huaja, si dhe ndihma e organizatave jofitimprurëse, të cilat mund të punojnë për zbatimin e projekteve të ndryshme dhe në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit mund të marrin pjesë në zhvillimin e programeve mësimore mjedisore, për rritjen e sensibilizimit për çështjet mjedisore edhe midis brezit të ri. Përveç kësaj, rëndësi i duhet kushtuar investimeve përgjatë gjithë zinxhirit, duke filluar që me sistemin arsimor, gjatë fazës së përgatitjes së shkencëtarëve të rinj, e duke vazhduar me investimet për ngritjen dhe pasurimin e infrastrukturës së përshtatshme për kërkimin shkencor. Kjo nuk duhet të kufizohet vetëm në ciklet e ulëta të shkollës, por duhet shtrirë përgjatë të gjithë sistemit arsimor.

Edhe ndërgjegjësimi dhe pjesëmarrja e publikut në çështjet mjedisore duhet të jenë në një shkallë më të lartë. Edhe pse në vitet e fundit ka një rritje të ndjeshmërisë qytetare ndaj fenomeneve negative që dëmtojnë mjedisin dhe një pjesëmarrje më aktive në aktivitete të ndryshme që kanë lidhje me mjedisin, fushatat e sensibilizimit duhet të jenë shumë më të fuqishme, në mënyrë që njerëzit të ndërgjegjësohen që përpjekjet për ruajtjen e mjedisit nuk bëhen vetëm për të tashmen, por sigurojnë edhe një jetë më të shëndetshme e një mjedis më të sigurt për brezat e ardhshëm. Në këtë drejtim, edhe mediat mund të luajnë një rol shumë konstruktiv, duke marrë iniciativën e promovimit të çështjeve mjedisore.

Me gjithë ndikimin pozitiv të së drejtës ndërkombëtare mjedisore, në fund të fundit, zbatimi i normave për mbrojtjen e mjedisit e për rrjedhojë edhe të shëndetit të njerëzve, mbetet më së shumti në dorën e autoriteteve kombëtare. Janë këto të fundit që duhet të kenë angazhimin maksimal dhe vullnetin për të bërë realitet atë çka parashikojnë normat e së drejtës mjedisore. Ligjet e hartuar bukur në letër nuk kanë asnjë vlerë, nëse nuk realizohet zbatimi i tyre në

praktikë. Nëse për disa prej konventave, si për shembull për Konventën e Biodiversitetit, për Konventën e Aarhusit apo për Konventën e Ndotësve Organikë të Qëndrueshëm janë hartuar e janë miratuar kohë pas kohe me vendime të Këshillit të Ministrave strategji e plane të veçanta veprimi, kjo nuk mund të thuhet për çdo konventë apo për secilin protokoll në të cilët Shqipëria është bërë palë. Nga shqyrtimi konkret i secilës konventë e protokoll ku Shqipëria ka aderuar, ky studim arrin në përfundimin se janë më shumë konventa e protokolle për të cilat nuk janë hartuar strategji apo plane veprimi, sesa ato që janë pajisur me dokumente të tillë. Ndër më kryesoret, për zbatimin e Konventës së Bazelit, Konventës për Mbrojtjen e Detit Mesdhe, Konventës për Luftën Kundër Shkretëtirëzimit, Konventës së ESPOO-s, etj, ku Shqipëria është palë, nuk janë hartuar ende strategjitë dhe planet kombëtare të veprimit për përmbushjen e detyrimeve që burojnë prej tyre. Ky konstatim është më i dukshëm për protokollat, si shtojca të konventave, ku për shumicën e tyre nuk janë hartuar e miratuar dokumente të tillë të veçantë.

Moszbatimi i legjislacionit nuk është problem ekskluziv i vendeve në zhvillim. Ai nuk vjen vetëm si pasojë e mungesës së vullnetit, mundësive, ekspertizës, mjeteve financiare, por edhe thjesht për shkak të vonësive në vendimmarrje, të cilat në fushën e mjedisit mund të sjellin pasoja të rënda, ndonjëherë të pariparueshme. Vonesa të tilla çojnë së pari në dëmtimin e shëndetit të njeriut, e përveç kësaj, krijojnë edhe pasiguri për bizneset dhe industrinë, aktiviteti i të cilave është i lidhur ngushtësisht me kuadrin rregullator. Komunitetit Evropian iu deshën më tepër vite për të vendosur mbi mënyrën e zbatimit të Konventës së Bazelit për Kontrollin e Lëvizjeve Ndërkufitare të Mbetjeve të Rrezikshme dhe Asgjësimin e tyre të vitit 1989, sesa iu deshën për të gjithë procesin e negociatave, nënshkrimit, ratifikimit dhe hyrjen në fuqi të saj.⁵²¹ Ashtu si edhe në fushën e mjekësisë, parandalimi është mënyra më e mirë dhe më pak e kushtueshme për mbrojtjen e mjedisit dhe të shëndetit të njeriut.⁵²² Si mjet final për garantimin e implementimit të normave mjedisore, duhet zbatuar me rigozitet edhe legjislacioni penal, e në kuadër të këtij studimi propozohet edhe ngritja e një strukture të veçantë pranë prokurorisë për ndjekjen e veprave penale kundër mjedisit.

Pavarësisht problematikave të shumta, ka po ashtu edhe arsye për optimizëm, për përballimin me sukses të tyre dhe për përmirësimin e gjendjes së mjedisit. Ndër zhvillimet e kohëve të fundit, duhet përmendur fakti që Presidenti i SHBA, ndotësit më të madh të botës sot për frymë popullore, deklaroi vendosjen e kufijve maksimalë për shkarkimet në atmosferë prej centraleve që punojnë me qymyr. Një ditë pas kësaj deklarate, Kina, ndotësi më i madh i planetit në terma absolutë, vendosi mbylljen e disa centraleve të tilla. Kërkimi shkencor ka avancuar ndjeshëm, duke çuar në uljen e kostove të prodhimit të paneleve diellore me afër 2/3 vetëm në 6 vitet e fundit, çka ka sjellë rritjen e përdorimit të tyre, përfshirë Shqipërinë. E njëjta gjë po ndodh me energjitë e tjera të rinovueshme, të cilat tashmë po thithin më tepër investime sesa karburantet fosile, duke ndryshuar edhe sjelljen e konsumatorëve, drejt rritjes së përdorimit të tyre. Veprimet e konsumatorit rregullojnë sjelljen në treg të kompanive. Shitja e makinave elektrike po dyfishohet çdo vit. Nëse konsumatori i largohet konsumit të karburanteve, edhe kompanitë do e zhvendosin aktivitetin e tyre drejt teknologjive fitimprurëse.⁵²³

⁵²¹ *Supra.*, shënimi fundor nr. 22, fq. 41.

⁵²² <http://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=COM:2012:0095:FIN:EN:PDF>

⁵²³ Karl Mathiesen, "10 reasons to be hopeful that we will overcome climate change", The Guardian, 30.7.2014.

Gjendet në: <http://www.theguardian.com/environment/2014/jul/30/reasons-hopeful-overcome-climate-change-solar>

Pavarësisht arritjeve të konsiderueshme, ka ende shumë skepticizëm mbi të drejtën e njeriut për një mjedis të shëndetshëm. Në lidhje me këtë janë ngritur institucione përkatëse në të cilat mund të shqyrtohen çështjet mjedisore. Megjithatë, ajo që shihet edhe nga jurisprudenca ndërkombëtare e analizuar në kuadër të këtij studimi, është se përveç Kartës së Banxhulit, të drejtat mjedisore janë parë më tepër si ‘të drejta individuale të derivuara’, të përftuara si rrjedhojë e interpretimit të zgjeruar të të drejtave të tjera ‘themelore’ të përcaktuara shprehimisht në tekstet e konventave, siç janë e drejta e jetës, e drejta për një jetë familjare, e drejta e pronës, por jo si një e drejtë kolektive, që mund të shkelet në rastet e dëmtimit të mjedisit. Edhe pse kjo mund të përbëjë një farë ‘zgjdhjeje’, nuk lejon zhvillimin e mëtejshëm të të drejtave mjedisore, duke i lënë ato në një nivel më të ulët mbrojtjeje, në krahasim me të drejtat e tjera, të konsideruara si të drejta ‘të brezit të parë’, ose të ‘dytë’, apo të drejta ‘themelore’.

Në këtë punim u ofrua gjithashtu një analizë e përmblendhur e situatës aktuale të shkrirjes së të drejtave të mjedisit dhe të drejtave themelore të njeriut në të drejtën ndërkombëtare dhe në legjislacionin e brendshëm shqiptar. Fusha e veprimit të normave mjedisore është mbrojtja e të gjithë komponentëve të mjedisit, duke përfshirë tokën, ujin, ajrin, florën, faunën, biodiversitetin, menaxhimin e mbetjeve, etj., ndërsa normat për të drejtat e njeriut e kanë fokusin e tyre në mbrojtjen e të drejtave sociale, ekonomike, politike dhe kulturore. Në mënyrë që të sigurohet edhe mbrojtja e mjedisit dhe e të drejtave njerëzore thelbësisht të lidhura me të, qëllimi i legjislacionit përkatës nuk duhet të jetë vetëm përcaktimi i të drejtave, por edhe caktimi i detyrimit për kujdesin ndaj mjedisit. Me gjetjen e zgjidhjeve për problemet e mjedisit, të drejtat themelore të njeriut mund të jenë të garantuara. Në gjendjen e tyre aktuale, të drejtat e mjedisit nuk mund të konsiderohen si të shkrira me të drejtat themelore të njeriut, kështu që rruga më e mirë për t'u ndjekur për mbrojtjen e tyre është mbrojtja e të drejtave themelore që janë prekur prej tyre, të tilla si e drejta e jetës, e drejta për respektimin e jetës private dhe familjare, e drejta e pronës, apo ndalimi i trajtimit çnjerëzor dhe degradues.

Për më tepër, duhet të kuptohet se thjesht ekzistenca e një kuadri të mirë ligjor nuk garanton përfundimisht mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Janë njerëzit vetë që duhet të përdorin pushtetin e tyre të dhënë nga legjislacioni për të siguruar mbrojtjen e të drejtave të tyre. Ashtu si një nga baballarët themelues të Shteteve të Bashkuara të Amerikës ka deklaruar: *“Unë nuk njoh asnjë vend depozitimi të sigurt të pushtetit të një shoqërie, përveçse në vetë njerëzit dhe në qoftë se ne mendojmë se ata nuk janë mjaftueshëm të aftë të ushtrijnë kontrollin e tyre me diskrecion të plotë, zgjidhja nuk vjen duke ua marrë atyre këtë diskrecion, por duke i informuar ata mbi këtë diskrecion.”*⁵²⁴ Kjo duhet të bëhet një nga detyrat më të rëndësishme të ne juristëve.

Çështja e zbatimit të normave të së drejtës mjedisore është një problem që duhet të na shqetësojë në mënyrë të vazhdueshme e të pandalshme, nuk është një proces që ka një fillim e një fund. Për nga vetë natyra e tyre, standardet mjedisore nuk janë statike, por në ndryshim të vazhdueshëm, e për rrjedhojë edhe sigurimi i zbatimit të tyre duhet që po ashtu të jetë një proces i tillë, i vazhdueshëm. Reformat duhet të vazhdohen duke punuar pandërprerë dhe duke synuar rritjen e shkallës së ndërgjegjësimit të shoqërisë për mbrojtjen e mjedisit, si një e mirë e përbashkët që na përket jo vetëm ne të gjithëve sot, por edhe brezave që do të vijnë.

⁵²⁴ Thomas Jefferson, letër drejtuar Charles Jarvis, 28 shtator 1820. Cituar në Aaron Sachs, *“Eco-Justice: Linking Human Rights and the Environment”*, Worldwatch Paper 127, Worldwatch Institute, 1995, fq. 9.

BIBLIOGRAFIA

Libra:

Anderson, Frederick R., Mandelker, Daniel R., *et. al.*, “Environmental Protection: Law and Policy”, Little Brown & Co., 1990.

Bándi, Gyula., (red.), “The Impact of ECJ Jurisprudence on Environmental Law”, Akaprint Kft, 2009.

Bándi, Gyula., Csapó, Orsolya., Kovács-Végh, Luca., Stágel, Bence., Szilágyi, Szilvia., “The Environmental Jurisprudence of the Evropean Court of Justice”, Akaprint Kft, 2008.

Beyerlin, Ulrich., Marauhn, Thilo., “International Environmental Law”, Hart Publishing, 2011.

Birnie, Patricia., Boyle, Alan., Redgwell, Catherine., “International Law and the Environment”, Oxford University Press, Third Edition, 2009.

Bodansky, Daniel., “The art and craft of International Environmental Law”, Harvard University Press, 2009.

Bodansky, Daniel., Brunnée Jutta., Hey, Ellen., “The Oxford Handbook of International Environmental Law”, (red.) Oxford University Press, 2007.

Brownlie, Ian., “Principles of Public International Law”, 7th ed., Oxford University Press, 2008.

Dahl, Robert A., “*Dilemmas of Pluralist Democracy, Autonomy versus Control*”, Yale University Press, 1982.

Erikson, Kai T., “Everything in its path. Destruction of Community in the Buffalo Creek Flood.”, Simon & Schuster Paperbacks, 1976.

Fisher, Elizabeth., Lange, Bettina., Scotford, Eloise., “Environmental Law. Text, Cases, Materials.”, Oxford University Press, 2013.

Francioni, Francesco., Scovazzi, Tullio., (red.), “International Law for Antarctica”, Giuffre Editore, Milano, 1987.

Garcia San José, Daniel., “Environmental protection and the European Convention on Human Rights”, Botim i Këshillit të Europës, Strasburg, 2005.

Gleeson, B. Low, N., (red.), “Governance for the Environment: Global Problems, Ethics and Democracy”, London, Palgrave, 2001.

Glowka, Lyle, Burhenne-Guilmin, Françoise., Synge, Hugh., McNeely, Jeffrey A., Gündling, Lothar., “A guide to the Convention on Biological Diversity”, International Union for the Conservation of Nature, 1994.

Hancock, Jan., “Environmental Human Rights. Power, ethics and law.”, MPG Books Ltd., Great Britain, Bodmin, Cornwall, 2003.

Hanxhari, Romeo., “Politikat e Mjedisit. Niveli global dhe niveli lokal. Analizë teorike dhe raste studimi”, Intergrafika, 2011.

Holder, Jane., Lee, Maria., “Environmental Protection, Law and Policy”, Second Edition, Cambridge University Press, 2007.

Jans, Jan. H., Macrory, Richard., Moreno Molina, Angel-Manuel., “National Courts and EU Environmental Law”, Evropa Law Publishing, Groningen, 2013.

Keohane, R.O., Ostrom, Elinor., “Local Commons and Global Interdependence: Heterogeneity and Cooperation in Two Domains”, London: Sage Publications, 1995.

Kiss, Alexandre., Shelton, Dinah., “Manual of European Environmental Law”, Cambridge: Grotius Publications, 1993.

Kravchenko, Svitlana., Bonine, John E., (red.), “Human Rights and the Environment – Cases, Law and Policy”, Carolina Academic Press, 2008.

Krämer, Ludwig., “Casebook on EU Environmental Law”, Hart Publishing, Oxford, 2002.

Krämer, Ludwig., “EC Environmental Law”, London, Thomson-Sweet&Maxwell, 2007.

Krämer, Ludwig., “EU Environmental Law”, 7th edition, Sweet & Maxwell, 2012

Lee, Maria., “EU Environmental Law: Challenges, Change and Decision Making”, Oxford and Portland, Oregon, 2005.

Macrory, Richard., (red.), “Principles of European Environmental Law”, Groningen, Europa Law Publishing, 2004.

McCaffrey, Stephen., Shelton, Dinah., Cerone, John., “Public International Law: Cases, Problems and Texts”, LexisNexis, 2011.

Mowbray, Alastair., “Cases, Materials, and Commentary on the European Convention on Human Rights”, Third Edition, Oxford University Press, 2012.

Muharremaj, Vezir., “Shkenca e Tokës”, Polis Press, 2013.

Omari, Luan., Anastasi, Aurela., “E drejta kushtetuese”, Shtëpia Botuese ABC, Tiranë, 2010.

- Ostrom, Ellinor., “Governing the Commons”, Cambridge University Press, 1990.
- Sachs, Wolfgang., “The Development Dictionary”, Zed Books, 1992.
- Sadeleer De, Nicolas., “Environmental Principles. From Political Slogans to Legal Rules”, Oxford University Press, 2002.
- San José, Daniel Garcia., “Environmental protection and the European Convention on Human Rights”, Council of Europe, Strasbourg, 2005.
- Sand, Philip., “Transnational Environmental Law”, Kluwer Law International, London, 1999.
- Sands, Philippe., “*Principles of International Environmental Law*”, Cambridge University Press, Second Edition, 2003.
- Sands, Philippe., “Litigating environmental disputes: Courts, tribunals and the progressive development of International Environmental Law”, Global Forum of International Investment, Contribution to the Liber Amicorum of Judge Thomas Menash, 2007.
- Schmitt, Michael N., (red.), “International Law Across the Spectrum of Conflict. Essays in Honour of Professor L.C. Green on the Occasion of His Eightieth Birthday”. International Law Studies, Naval War College, Newport, 2000.
- Schrijver, Nico., dhe Weiss, Friedl., (red.), “International Law and Sustainable Development: Principles and Practice”, Leiden: Martinus Nijhoff, 2004.
- Somsen, Han., (red.), “Protecting the European Environment: Enforcing EC Environmental Law”, London, Blackstone, 1996.
- Stec, Stephen., “The Aarhus Convention. An implementation guide”, United Nations Publications, 2nd edition, 2013.
- Tatham, Allan F., “EC Law in Practice. A Case-Study Approach.”, HVG-Orac, 2006.
- Weatherill, Stephen., “Cases and Materials on EU Law”, 7th Edition, Oxford University Press, 2005.
- Wiener, Norbert., “The Human Use of Human Beings: Cybernetics and Society”, Boston: Houghton-Mifflin, 1954.
- Zaganjori, Xhezair., “Jurisprudencë dhe praktikë ndërkombëtare”, Adelprint, 2012.
- Zarsky, Lyuba., (red.), “Human Rights and the Environment”, Earthscan Publications Ltd., London, 2002.

Artikuj shkencorë:

Arnstein, Sherry R., "A Ladder of Citizen Participation", Journal of American Planning Association, Vol. 36, 1969.

Benvenisti, Eyal., "Collective action in the utilization of shared freshwater: The challenges of international water resources law", American Journal of International Law, Vol. 90, 1996.

Boyle, Alan E., "Globalising environmental liability: The interplay of national and international law", Journal of Environmental Law, Vol 17, No 1, 2005.

Bragdon, Susan H., "National Sovereignty and Global Environmental Responsibility: Can the Tension be Reconciled for the Conservation of Biological Diversity?" 33 Harvard International Law Journal, 1992.

Brown Weiss, Edith., "The Planetary Trust: Conservation and Intergenerational Equity", 11 Ecology Law Quarterly, 1984.

Carson, Rachel., "Silent Spring", The New Yorker, 1962.

Francioni, Francesco., "International Human Rights in an Environmental Horizon", The European Journal of International Law, Vol. 21, nr. 1, 2010.

Goodland, Robert., "The World Bank versus the World Commission on Dams", Water Alternatives, 2010.

Hardin, Garrett., "The Tragedy of the Commons", 162 Science, 1968.

Harlow, Carol., "Public Law and Popular Justice", Modern Law Review, 2002

Hershman, Ellyn Adrienne., "California Legislation on Air Contaminant Emissions from Stationary Sources", California Law Review, 1970.

Kellermann, Alfred., "Impakti i anëtarësimit në BE në rendin e brendshëm ligjor të Republikës së Shqipërisë", "E drejta parlamentare dhe politikat ligjore", nr.1, 2007.

Kingston, Suzanne., "Surveying the state of EU environmental law: much bark with little bite?", International and Comparative Law Quarterly, Nr. 62, 2013.

McCaffrey, Stephen C., "The Harmon Doctrine One Hundred Years Later: Buried, Not Praised", Natural Resources Journal, Vol. 36, 1996.

Norse, Elliott A., Amos, John., "Impacts, Perception, and Policy Implications of the Deepwater Horizon Oil and Gas Disaster", Environmental Law Reporter, Vol. 40, 2010.

Powers, Ann., "The Rio+20 Process: Forward Movement for the Environment?" *Transnational Environmental Law*, Vol.1, Nr.2, 2012.

Rockström, Johan., et. al, "Planetary Boundaries: Exploring the Safe Operating Space for Humanity", *Ecology & Society*, 2009.

Sachs, Aaron., "Eco-Justice: Linking Human Rights and the Environment", *Worldwatch Paper* 127, Worldwatch Institute, 1995.

Shelton, Dinah., "Human rights and the environment: What specific environmental rights have been recognized?", *Denver Journal of International Law and Policy*, Vol. 35, nr. 1, 2006.

Stephens, Tim., "Multiple International Courts and the 'Fragmentation' of International Environmental Law", *25 Australian Year Book of International Law*, 2006.

Whittaker, Sean., "Case Note: Access to environmental information and the problem of defining public authorities", *Environmental Law Review*, 2013.

Zaganjori, Xhezair., "Vendi i së Drejtës Ndërkombëtare në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë", *Jeta Juridike*, Nr. 2, shkurt 2004, *Shkolla e Magjistraturës së R.SH.*

Konventa mjedisore:

Konventa e Londrës për Mbrojtjen e Florës dhe Faunës në Afrikë (1900).

Konventa për Mbrojtjen e Fokave (1911)

Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut (1950).

Konventa e Gjenevës për Peshkimin dhe Ruajtjen e Gjallesave në Det të Hapur (1958).

Konventa e Parisit për Përgjegjësinë e Palëve të Treta në Fushën e Energjisë Bërthamore (1960)

Konventa e Vjenës për Përgjegjësinë Civile për Dëmin Bërthamor (1963).

Konventa Afrikane për Mbrojtjen e Natyrës dhe Burimeve Natyrore (1968).

Konventa për Ndërhyrjet në Det të Hapur në Rastet e Dëmeve të Shkaktuara nga Ndotja prej Naftës (1969).

Konventa për Përgjegjësinë Civile për Dëmet e Shkaktuara nga Ndotja prej Naftës (1969).

Konventa e Vjenës Për të Drejtën e Traktateve (1969).

Konventa Amerikane për të Drejtat e Njeriut (1969).

Konventa e Brukselit për Përgjegjësinë Civile në Fushën e Transportit Detar të Materialeve Bërthamore (1971).

Konventa e Brukselit për Krijimin e një Fondi Ndërkombëtar për Kompensimin e Dëmeve të Shkaktuara nga Ndotja prej Naftës (1971).

Konventa e Ramsarit për Ligatinat me Rëndësi Ndërkombëtare, Veçanërisht si Habitata të Shpendëve Ujorë (1971).

Konventa e Oslos për Parandalimin e Ndotjes së Deteve prej Hedhjeve nga Anijet dhe Avionët (1972).

Konventa e Londrës për Parandalimin e Ndotjes së Deteve prej Hedhjeve të Mbeturave dhe Substancave të Tjera (1972).

Konventa e Parisit për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore dhe Natyrore të Botës (1972).

Konventa Ndërkombëtare për Parandalimin e Ndotjes prej Anijeve (MARPOL) (1973).

Konventa për Tregtinë Ndërkombëtare të Specieve të Rrezikuara të Florës dhe Faunës (CITES) (1973).

Konventa e Luganos mbi Përgjegjësinë Civile për Dëmet e Shkaktuara prej Aktiviteteve të Dëmshme për Mjedisin (1973).

Konventa e Parisit për Parandalimin e Ndotjes së Deteve që Vjen nga Burimet Tokësore (1974).

Konventa e Lomé-së për bashkëpunimin midis BE-së dhe organizatës Afrikë-Karaibe-Paqësor (1975).

Konventa e Barcelonës për Mbrojtjen e Mjedisit Detar dhe Rajonit Bregdetar të Mesdheut (1976).

Konventa për Ndotjen Ndërkufitare të Ajrit në Distanca të Largëta (LRTAP) (1979).

Konventa e Bonit për Mbrojtjen e Specieve Shtegtuese të Kafshëve të Egra (1979).

Konventa e Bernës për Ruajtjen e Florës dhe Faunës së Egër dhe Mjedisit Natyror të Evropës (1979).

Konventa e OKB për të Drejtën e Detit (UNCLOS) (1982).

Konventa e Vjenës për Mbrojtjen e Shtresës së Ozonit (1985).

Konventa e Vjenës mbi Njoftimin e Hershëm të një Aksidenti Bërthamor (1986).

Konventa e Vjenës për Ndhimën në Rast të një Aksidenti Bërthamor ose Emergjence Radiologjike (1986).

Konventa për Përgjegjësinë Civile për Dëmin e Shkaktuar gjatë Transportimit të Mallrave të Rrezikshme me Automjete Rrugore, Hekurudhore dhe Anije (1989).

Konventa e Bazelit mbi Kontrollin e Lëvizjes Ndërkufitare të Mbetjeve të Rrezikshme dhe Groposjen e Tyre (1989).

Konventa e OKB për të Drejtat e Fëmijëve (1989).

Konventa e Bamakos për Ndalimin e Importit në Afrikë dhe Kontrollin e Lëvizjes Ndërkufitare dhe Menaxhimit të Mbetjeve të Rrezikshme Brenda Afrikës (1991).

Konventa e Espoo-s për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis në Kontekstin Ndërkufitar (1991).

Konventa për Mbrojtjen e Alpeve (1991).

Konventa e Helsinkit për Mbrojtjen e Mjedisit Detar të Zonës së Detit Balltik (1992).

Konventa e Helsinkit për Mbrojtjen dhe Përdorimin e Rrjedhave Ujore Ndërkufitare dhe Liqeneve Ndërkombëtarë (1992).

Konventa Kuadër për Ndryshimet Klimatike (1992).

Konventa për Biodiversitetin (1992).

Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Luftuar Shkretëtirëzimin (UNCCD) (1992).

Konventa për Mbrojtjen e Mjedisit Detar të Atlantikut Verilindor (OSPAR) (1992).

Konventa për Krijimin e një Fondi Ndërkombëtar për Kompensimin e Dëmit prej Ndotjes nga Nafta (1992).

Konventa e Sofjes për Bashkëpunimin për Ruajtjen dhe Përdorimin e Qëndrueshëm të Lumit Danub (1994).

Konventa e Sigurisë Bërthamore (1994).

Konventa e Waiganit për Ndalimin e Importit Drejt Forumit të Vendeve Ishullore të Mbetjeve të Rrezikshme dhe Radioaktive dhe për Kontrollin e Lëvizjes Ndërkufitare dhe Menaxhimit të Mbetjeve të Rrezikshme brenda Rajonit të Paqësorisë Jugor (1995).

Konventa për Përgjegjësinë dhe Kompensimin për Dëmin në lidhje me Transportin e Substancave të Rrezikshme dhe Helmuese nga Deti (1996)

Konventa për Kompensimin Plotësues për Dëmin Bërthamor (1997).

Konventa e Përbashkët për Sigurinë e Menaxhimit të Karburantit të Përdorur dhe për Sigurinë e Menaxhimit të Mbetjeve Radioaktive (1997).

Konventa për të Drejtën e Përdorimit të Rrjedhave Ujore Ndërkombëtare për Qëllime të Ndryshme nga Lundrimi (1997).

Konventa e Aarhusit “Për të drejtën e publikut për të pasur informacion, për të marrë pjesë në vendimmarrje dhe për t’iu drejtuar gjykatës për çështjet e mjedisit” (1998).

Konventa e Roterdamit për Procedurën e Dhënies së Pëlqimit Paraprak mbi Bazë Informacioni për Kimikatet dhe Pesticidet në Tregtinë Ndërkombëtare (1998).

Konventa për Mbrojtjen e Mjedisit Njëpërmjet të Drejtës Penale (1998).

Konventa e Bernës për Mbrojtjen e Rinit (1999).

Konventa për Përgjegjësinë Civile për Dëmin e Ndotjes nga Nafta të Hambarëve të Anijeve (2001).

Konventa e Stokholmit për Ndotësit Organikë të Qëndrueshëm (2001).

Legjislacion mjedisor shqiptar:

Ligji nr. 7501, datë 19.7.1991, “Për tokën”.

Ligji nr. 8025, datë 9.11.1995 “Për mbrojtjen nga rrezatimet jonizuese”.

Ligji nr. 8094, datë 21.3.1996, “Mbi heqjen publike të mbeturinave”.

Ligji nr. 8216, datë 13.5.1997, “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën e Bazelit “Për kontrollin e lëvizjeve ndërkufitare të mbetjeve të rrezikshme dhe asgjësimin e tyre”.

Ligji nr. 8294, datë 2.3.1998, “Për ratifikimin e Konventës së Bernës “Për ruajtjen e florës dhe faunës së egër dhe mjedisit natyror të Evropës”.

Ligji nr. 8556, datë 22.12.1999, “Për aderimin në Konventën e Kombeve të Bashkuara “Për të luftuar shkretëtirëzimin në ato vende që kanë kaluar thatësira serioze dhe/ose shkretëtirëzim, veçanërisht në Afrikë”.

Ligji nr. 8652, datë 31.7.2000, “Mbi organizimin dhe funksionimin e qeverisë lokale”.

Ligji nr. 8672, datë 26.10.2000, “Për ratifikimin e Konventës së Aarhusit “Për të drejtën e publikut për të pasur informacion, për të marrë pjesë në vendimmarrje dhe për t’iu drejtuar gjykatës për çështjet e mjedisit”.

Ligji nr. 8692, datë 16.11.2000, “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në konventën e Bonit “Për mbrojtjen e llojeve shtegëtuese të kafshëve të egra” dhe mirëkuptimet e kësaj konvente.

Ligji nr.8897, datë 16.5.2002, “Për mbrojtjen e ajrit nga ndotja”.

Ligji nr. 8906, datë 6.6.2002, “Për zonat e mbrojtura”.

Ligji nr. 8934, datë 5.9.2002, “Për mbrojtjen e mjedisit”.

Ligji nr. 8990, datë 23.1.2003, “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”.

Ligji nr. 9010, datë 13.2.2003, “Mbi administrimin e mbetjeve të ngurta”.

Ligji nr. 9021, datë 6.3.2003, “Për aderimin në Konventën “Për tregtinë ndërkombëtare të llojeve të rrezikuara të florës dhe faunës së egër”.

Ligji Nr. 9244, datë 17.6.2004, “Për mbrojtjen e tokës bujqësore”.

Ligji nr. 9334, datë 16.12.2004, “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Protokollin e Kiotos të Konventës Kuadër të Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike”.

Ligji nr. 9374, datë 21.4.2005 “Për ndihmën shtetërore”.

Ligji nr. 9379, datë 28.4.2005, “Për efikasitetin e energjisë”.

Ligji nr. 9385, datë 4.5.2005, “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”.

Ligji nr. 9425, datë 6.10.2005, “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën “Për ndotjen ndërkufitare të ajrit në distanca të largëta””.

Ligji nr. 9480, datë 16.2.2006, “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në amendamentin e Kopenhagenit të protokollit të Montrealit “Për substancat që hollojnë shtresën e ozonit””.

Ligji nr. 9484, datë 2.3.2006, “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në amendamentin e Londrës, aneksi II, të protokollit të Montrealit “Për substancat që hollojnë shtresën e ozonit””.

Ligji nr. 9485, datë 6.3.2006, “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në amendamentin e Montrealit, të protokollit të Montrealit “Për substancat që hollojnë shtresën e ozonit””.

Ligji nr. 9486, datë 6.3.2006, “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në amendamentin e Pekinit, të protokollit të Montrealit “Për substancat që hollojnë shtresën e ozonit””.

Ligji nr. 9537, datë 18.5.2006, “Për administrimin e mbetjeve të rrezikshme”.

Ligji nr. 9548, datë 1.6.2006, “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Protokollin “Mbi Regjistrat e Shkarkimit dhe Transferimit të Ndotësve” i Konventës së Aarhus-it “Mbi të drejtën e informimit, pjesëmarrjen e publikut në vendimmarrje si dhe të drejtën për t’iu drejtuar gjykatës për problemet mjedisore”.

Ligji nr. 9587, datë 20.7.2006, “Për mbrojtjen e biodiversitetit”.

Ligji nr. 9590, datë 27.07.2006, “Për ratifikimin e Marrëveshjes të Stabilizim-Asocimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komuniteteve Evropiane e Shteteve të Tyre Anëtare”.

Ligji nr. 9663, datë 18.12.2006, “Mbi koncensionet”.

Ligji nr.9693, datë 19.3.2007, “Për fondin kullosor”.

Ligji nr. 9700, datë 26.3.2007, “Për mbrojtjen e mjedisit nga ndikimet ndërkufitare”.

Ligji nr. 9867, datë 31.1.2008, “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për tregtimin ndërkufitar të llojeve të rrezikuara të faunës dhe të florës së egër”.

Ligji nr. 10006, datë 23.10.2008, “Për mbrojtjen e faunës së egër”.

Ligji nr.10062, datë 29.01.2009, “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në protokollin “Për kontrollin e shkarkimeve të oksideve të azotit apo flukseve të tyre ndërkufitare”, të konventës së vitit 1979 “Për ndotjen ndërkufitare të ajrit në distancë të largët””.

Ligji nr. 10063, datë 29.01.2009, “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në protokollin “Për reduktimin e shkarkimeve të squfurit apo të flukseve të tyre ndërkufitare, të paktën në masën 30 për qind” të konventës së vitit 1979 “Për ndotjen ndërkufitare të ajrit në distancë të largët””.

Ligji nr.10120, datë 23.04.2009, “Për mbrojtjen e fondit të bimëve mjekësore, eterovajore e tanifere natyrore”.

Ligji nr. 10253, datë 11.3.2010, “Për gjuetinë”.

Ligji nr. 10277, datë 13.5.2010, “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën e Roterdamit “Mbi procedurën e njoftimit të pëlqimit paraprak për disa kimikate dhe produkte të rrezikshme për mbrojtjen e bimëve në tregtinë ndërkombëtare”.

Ligji nr. 10431, datë 9.6.2011, “Për mbrojtjen e mjedisit”.

Ligji nr. 10436, datë 28.6.2011, “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në protokollin “Për reduktimin e mëtejshëm të çlirimit të squfurit” të konventës “Për ndotjen ndërkufitare të ajrit në rreze të gjatë”, 1979”.

Ligji nr.10440, datë 7.7.2011, “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”.

Ligji nr. 10448, datë 14.7.2011, “Për lejet e mjedisit”.

Ligji nr. 10463, datë 22.9.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”.

Ligji nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

Ligji nr. 111/2012, datë 15.11.2012, “Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore”.

Ligji nr. 91/2013, datë 28.2.2013, “Për vlerësimin strategjik mjedisor”.

Ligji nr. 7/2014, datë, 30.1.2014, “Për shpalljen e moratoriumit të gjuetisë në Republikën e Shqipërisë”.

Ligji nr. 119/2014, datë 18.9.2014, “Për të drejtën e informimit”.

Vendime gjyqësore:

Gjykata e Përhershme e Drejtësisë Ndërkombëtare

Vendimi datë 10.9.1929, *Mbretëria e Bashkuar, Çekosllovakia, Danimarka, Franca, Gjermania, Suedia kundër Polonisë (Juridiksioni Territorial i Komisionit Ndërkombëtar të Lumit Oder)*.

Vendimi datë 28.6.1937, *Hollanda kundër Belgjikës (Devijimi i Ujit prej (Lumit) Meuse)*.

Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë

Vendimi datë 9.4.1949, *Mbretëria e Bashkuar kundër Shqipërisë (Incidenti i Kanalit të Korfuzit)*.

Vendimi datë 25.7.1974, *Mbretëria e Bashkuar kundër Islandës (Juridiksioni i Peshkimit)*.

Vendimi datë 14.6.1993, *Danimarka kundër Norvegjisë (Ishujt Jan Mayen)*.

Mendimi Këshillimor datë 8.7.1996, *Ligjshmëria e Kërcënimit apo Përdorimit të Armëve Bërthamore*.

Vendimi datë 25.9.1997, *Hungaria kundër Sllovakisë (Projekti Gabčíkovo-Nagymaros)*.

Mendimi Këshillimor datë 9.7.2004, *“Pasojat Ligjore të Ndërtimit të një Muri në Tokat e Pushtuara Palestineze”*.

Vendimi datë 20.4.2010, *Argjentina kundër Uruguajit (Fabrikat e Letrës në Lumin Uruguaj)*.

Gjykata Ndërkombëtare për të Drejtën e Detit

Vendimet datë 27.8.1999, *Zelanda e Re kundër Japonisë dhe Australia kundër Japonisë (Peshku Ton Bishtblu Jugor)*.

Vendimi nr. 10, datë 3.12.2001, *Irlanda kundër Mbretërisë së Bashkuar (MOX Plant), (Marrja e Masës së Sigurimit të Padisë)*.

Gjykata e Përhershme e Arbitrazhit Ndërkombëtar

Vendimi Nr. 6, datë 6.6.2008, *Irlanda kundër Mbretërisë së Bashkuar (MOX Plant), (E drejta për të marrë informacion mjedisor)*.

Arbitrazh Ndërkombëtar

Vendimi *Behring Fur Seals (Fokat e Detit të Behringut)*, datë 15.8.1893, *SHBA kundër Mbretërisë së Bashkuar*.

Vendimi *Trail Smelter (Fonderia Trail)*, datë 16.4.1938, *SHBA kundër Kanadasë*.

Vendimi *Lac Lanoux (Liqeni Lanoux)*, datë 16.11.1957, *Spanja kundër Francës*.

Gjykata Evropiane e Drejtësisë

Vendimi Nr. 148/78, datë 5.4.1979, *Pubblico Ministero v. Tullio Ratti*.

Vendimi Nr. 240/83, datë 7.2.1985, *Procureur de la République v. Association de défense des brûleurs d'huiles usagées*.

Vendimi Nr. 302/86, datë 20.9.1988, *Commission v. Denmark*.

Vendimi Nr. C-359/88, datë 29.3.1990, *Prétura di San Vito al Tagliamento – Italy (E. Zanetti and Others)*

Vendimi Nr. C-62/88, datë 29.3.1990, *Hellenic Republic v. Council of the European Communities*.

Vendimi Nr. 106/89, datë 13.11.1990, *Marleasing SA v. La Comercial Internacional de Alimentación SA*.

Vendimi Nr. C-300/89, datë 11 June 1991, *Commission v. Council of the European Communities*.

Vendimi Nr. C-2/90, datë 9.7.1992, *Commission of the European Communities v. Belgium*.

Vendimi Nr. C-422/92, datë 10.5.1995, *Commission of the European Communities v. Federal Republic of Germany*.

Vendimi Nr. C-341/95, datë 14.7.1998, *Gianni Bettati v. Safety Hi-Tech Srl*.

Vendimi Nr. C-157/96, datë 5.5.1998, *The Queen v Ministry of Agriculture, Fisheries and Food, Commissioners of Customs & Excise*.

Vendimi Nr. C-180/96, të datë 12.7.1998, *United Kingdom of Great Britain and Northern Ireland v. Commission of the European Communities*.

Vendimi Nr. C-6/99, datë 21.3.2000, *Association Greenpeace France and Others v. Ministère de l'Agriculture et de la Pêche and Others*.

Vendimi Nr. C-440/01 P(R), datë 14.2.2002, *Commission of the European Communities v. Artgodan GmbH*.

Vendimi Nr. C-50/00 P, datë 25.7.2002, *Unión de Pequeños Agricultores v. Council of the European Communities*.

Vendimi Nr. C-127/02, datë 7.9.2004, *Landelijke Vereniging tot Behoud van de Waddenzee and Nederlandse Vereniging tot Bescherming van Vogels v. Staatssecretaris van Landbouw, Natuurbeheer en Visserij*.

Vendimi Nr. C-41/02, date 2.12.2004, *Commission of the European Communities v. Kingdom of the Netherlands*.

Vendimi Nr. C-494/01, datë 26.4.2005, *Commission v. Ireland*.

Vendimi Nr. C-6/04, datë 20.10.2005, *Commission v. United Kingdom*.

Vendimi Nr. C-459/03, datë 30.5.2006, *Commission v. Ireland (Mox Plant)*.

Vendimi Nr. C-237/07, datë 25.7.2008, *Dieter Janecek v. Freistaat Bayern*.

Vendimi Nr. C-75/08, datë 30.4.2009, *Christopher Mellor v. Secretary of State for Communities and Local Government*.

Vendimi Nr. C-263/08, datë 15.10.2009, *Djurgården-Lilla Värtans Miljöskyddsförening v. Stockholms kommun genom dess marknämnd*.

Vendimi Nr. C-297/08, datë 4.3.2010, *Commission v. Italy*.

Vendimi Nr. C-115/09, datë 16.12.2010, *Bund für Umwelt und Naturschutz Deutschland, Landesverband Nordrhein-Westfalen v. Bezirksregierung Arnsberg*.

Vendimi Nr. C-240/09, datë 8.3.2011, *Lesoochránárske zoskupenie VLK v. Slovakia*.

Vendimi Nr. C-416/10, datë 15.1.2013, *Križan v. Slovakia*.

Vendimi Nr. C-279/12, datë 19.12.2013, *Fish Legal, Emily Shirley v Information Commissioner, United Utilities Water plc, Yorkshire Water Services Ltd, Southern Water Services Ltd*.

Gjykata e Shkallës së Parë të Bashkimit Evropian

Vendimi nr. T-585/93, datë 9.8.1995, *Stichting Greenpeace Council (Greenpeace International) v. Commission of the European Communities*.

Vendimi Nr. T-199/96, datë 16.7.1998, *Laboratoires Pharmaceutiques Bergaderm SA and Jean-Jacques Goupil v. Commission of the European Communities*.

Vendimi i përbashkët i çështjeve Nr. T-74/00, T-76/00, T-83/00 to T-85/00, T-132/00, T-137/00 dhe T-141/00, datë 26.11.2002, *Artogodan GmbH (and others) v. Commission of the European Communities*.

Vendimi Nr. T-229/04, datë 11.7.2007, *Kingdom of Sweden v. Commission of the European Communities*.

Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut

Vendimi Nr. 14038/88, datë 7.7.1989, *Soering kundër Mbretërisë së Bashkuar*.

Vendimi Nr. 14282/88, datë 25.11.1993, *Zander kundër Suedisë*.

Vendimi Nr. 18928/91, datë 23.2.1994, *Fredin kundër Suedisë*.

Vendimi Nr. 16798/90, datë 9.12.1994, *López Ostra kundër Spanjës*.

Vendimi Nr. 116/1996/735/932, datë 19.2.1998, *Guerra dhe të tjerë kundër Italisë*.

Vendimi Nr. 14/1997/798/1001, datë 9.6.1998, *LCB kundër Mbretërisë së Bashkuar*.

Vendimi Nr. 21980/93, datë 20.5.1999, *Bladet Tromsø dhe Stensaas kundër Norvegjisë*.

Vendimi Nr. 36022/97, datë 2.10.2001, *Hatton dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar (Dhoma e Seksionit të Tretë)*.

Vendimi Nr. 48939/99, datë 18.6.2002, *Öneryıldız kundër Turqisë*.
Vendimi Nr. 36022/97, datë 8.7.2003, *Hatton kundër Mbretërisë së Bashkuar (Dhoma e Madhe)*.
Vendimi Nr. 46117/99, datë 10.11.2004, *Taşkın dhe të tjerë kundër Turqisë*.
Vendimi Nr. 4143/02, datë 16.11.2004, *Moreno Gomez kundër Spanjës*.
Vendimi Nr. 35785/03, datë 22.7.2008, *Köktepe kundër Turqisë*.
Vendimi Nr. 36192/03, datë 10.3.2009, *Şatir kundër Turqisë*.
Vendimi nr. 34078/02, datë 29.3.2010, *Brosset-Triboulet dhe të tjerët kundër Francës*.
Vendimi Nr. 4860/09, datë 26.3.2013, *Turgut dhe të tjerët kundër Turqisë*.

Gjykata Ndër-Amerikane për të Drejtat e Njeriut

Vendimi datë 31.8.2001, *Mayagna (Sumo) Awas Tingni Community v. Nicaragua*.
Vendimi datë 28.11.2007, *Saramaka People v. Suriname*.
Vendimi datë 3.4.2009, *Kawas-Fernández v. Honduras*.

Gjykata e Lartë e Republikës së Shqipërisë

Vendimi Unifikues Nr.1, datë 17.1.2011, i Kolegjeve të Bashkuara.
Vendimi i Unifikues Nr.2, datë 27.3.2012, i Kolegjeve të Bashkuara.
Vendimi Nr. 22, datë 19.1.2011, i Kolegjit Civil.

Gjykata Supreme e Filipineve

Vendimi datë 27.10.1983, *Tan v. Director of Forestry (Tan kundër Drejtorit të Pyjeve)*.
Vendimi datë 30.7.1993, *Oposa et al. v. Fulgencio S. Factoran, Jr. et al (Të Miturit Oposa kundër Sekretarit të Departamentit të Mjedisit dhe Burimeve Natyrore)*.

Gjykata Administrative e Apelit të Anglisë

Vendimi Nr. GI/2458/2010, datë 23.11.2010, *Smartsorce Drainage & Water Reports Ltd v Information Commissioner*.